C) Erupsionit papulo-skuamoz ne faqen palamre të duarve dhe shputën e këmbëve.

D) Instalim insidioz, gradual i simptomave.
E) Oligoartropatisë periferike asimetrike.
PS)C

Pyetja 191 V)3

Anemia e uremisë kronike vjen kryesisht si pasojë e:

A) Absorbimit të pakësuar të Fe-së.
B) Mungesës së Vit B12.
C) Mungesës së acidit folik.
D) Mungesës së eritropoietinës.
E) Hemoglobinurisë.
PS)D

Pyetja 192 V)1

Veshka e majtë është në raport me organet e mëposhtëm përveç:

A) Shpretkës.
B) Kolonës.
C) Pankreasit.
D) Stomakut.
E) Mëlçisë.
PS)E

Pyetja 193 V)3

Efektshmëria antituberkulare e streptomicinës kufizohet nga:

A) Shfaqja e shpeshtë e mycobaktereve rezistente.
B) Ekskrecioni i shpejtë tubular (renal) i antibiotikut.
C) Metabolizmi i shpejtë hepatik i antibiotikut.
D) Shfaqja e shpeshtë e granulocitopenisë.
E) Shfaqja e shpeshtë e fenomeneve alergjikë.
PS)A

Pyetja 194 V)1

Çfarë janë pirogenet endogjene?

A) Molekula si IL1 dhe TNK
B) Produkte të paretit bakterial
C) Receptorë të limfociteve
D) Agjente përgjegjës për ustione
E) Aktivizues të komplementit
PS)A

Pyetja 195 V)2

Cili nga këta medikamente mund të induktojë (me një frekuencë më të shtuar se të tjerët) një kuadër klinik të lupusit eritematoz?

A) Hidralazina
B) Indometacina
C) Flufenazina
D) Noradrenalina
E) Lidokaina
PS)A

Pyetja 196 V)1

Cili nga manifestimet e mëposhtëm është shprehje e toksicitetit nga mbidozimi i medikamenteve?

A) "Sindromi gri" i kloramfenikolit
B) Anemia aplazike e kloramfenikolit
C) lupus eritematoz i procainamidit
D) Ethet nga sulfamidiket
E) Dermatiti eksfoliativ nga barbiturikët
PS)A

Pyetja 197 V)1

Poliarteriti nodoz karakterizohet nga:

A) Një vaskulit leukocitoklastik me detrite nukleare.
B) Eozinofilia me interesim pulmonar.
C) Nodule subkutane.
D) Lezione të arterieve të kalibrit të mesëm dhe të vogel në pikat e bifurkacioneve.
E) Hipokomplementemia.
PS)D

Pyetja 198 V)1

Me termin 'displazia' nënkuptojmë:

A) Rritjen e volumit të një indi nga rritja volumetrike e elementeve qelizorë përberës.
B) Transformacionin e një indi në një tjetër.
C) Rritjen e volumit të një indi nga rritja numerike e elementeve qelizore përberës.
D) Një proliferim qelizor që paraqet karakteristika atipike.
E) Degjenerimin neoplazik të një indi.
PS)D

Pyetja 199 V)1

Cili është ekzaminimi i nevojshëm për diagnozën etiologjike të një versamenti pleural?

A) Radiografia e toraksit
B) CT skaner i toraksit
C) Torakocenteza
D) Bronkoskopia
E) Ekografia torakale
PS)C

Pyetja 200 V)2

IgA sekretore gjenden:

A) Në rrugët respiratore të sipërme dhe të poshtme.
B) Në nivel të ganglioneve nervore.
C) Në alveola.
D) Në intersticiumin pulmonar.
E) Në nivel të kapilarëve pulmonarë.
PS)A

Pyetja 201 V)1

Cili nga medikamentet e mëposhtëm mund të shkaktojë hiperuricemi dhe potencialisht një atak podagre?

A) Diuretikët tiazidikë
B) Ciklosporina
C) Acidi askorbik
D) A+B
E) Aspirina
PS)D

Pyetja 202 V)1

Cili nga parametrat e mëposhtëm nuk përfshihet në percaktimin e indeksit te Apgar-it?

A) Frekuenca kardiake
B) Presioni arterial
C) Tonusi muskular
D) Respiracioni
E) Ngjyra
PS)B

Pyetja 203 V)2

Shkaku me i shpeshtë i hipotiroidizmit të përhershëm është:

A) Tiroiditi post-partum.
B) Tiroiditi limfocitar kronik.
C) Tiroiditi subkaut.
D) Struma multinodulare jotoksike.
E) Tiroiditi nga rrezatimi.
PS)B

Pyetja 204 V)1

Ikteri obstruktiv karakterizohet nga:

A) Rritja e bilirubinës së konjuguar.
B) Pakësimi i fosfatazës alkaline.
C) Anemia hemolitike.
D) Steatorrhea.
E) Feçe hiperkromike.
PS)A

Pyetja 205 V)2

Karakteristika përcaktuese midis skoliozës dhe qëndrimit skoliotik është:

A) Lokalizimi i kurbës.
B) Rotacioni vertebral.
C) Mosha e shfaqjes.
D) Dhembja.
E) Heterometria e anesive inferiore.
PS)B

Pyetja 206 V)1

ACE-inhibitorët janë të kundër-indikuar

A) Në insuficiencën kardiake kongjestive.
B) Në shtatzëni.
C) Në hipertiroidizëm.
D) Pas menopauzës.
E) Në diabetin tip I.
PS)B

Pyetja 207 V)1

Një burrë 72 vjeçar paraqet dhembje të forta në shpinë, nje masë abdominale pulsuese dhe hipotension. Diagnoza për të cilën dyshohet është:

A) Infarkti intestinal.
B) Aneurisma disekante e aortës.
C) Ruptura ose fisurimi i aneurizmës së aortës abdominale.
D) Sindromi Leriche.
E) Aneurizma e arteries hepatike.
PS)C

Pyetja 208 V)2

Me 'adrenarche' nënkuptojmë:

A) Shfaqjen e hirsutizmit përpara menarkeve.
B) Shfaqjen e pelurisë pubike afërsisht 2 vjet përpara pubertetit e bashkëshoqeruar me rritje të nivelit serik të DHEA-së.
C) Shfaqjen e hirsutizmit me origjinë surenaliene tek femra.
D) Praninë në fëmijëri të një tumori surenal që prodhon DEA-S.
E) Shfaqjen e cikleve menstruale tek pacientët me sindromin adreno-genital.
PS)B

Pyetja 209 V)2

Cila triade identifikon sëmundjen e Huntington-it?

A) Lëvizje të pavullnetshme-demence-asinergji
B) Katarakt-demencë-asinergji
C) Ataksi-demencë-asinergji
D) Lëvizje koreike-katarakt-akromegali
E) Epilepsi-lëvizje të pavullnetshme-kardiopati
PS)A

Pyetja 210 V)1

Medikamentet e mëposhtëm përdoren në insuficiencën kardiake kronike, përveç:

A) Digoksinës.
B) ACE-inhibitorët.
C) Diuretikët e ansës.
D) Diuretikët kali-protektore.
E) Cimetidinës.
PS)E

Pyetja 211 V)2

Në cilën nga rrethanat e mëposhtme mund të vërehet 'turgori jugular'?

A) Hipertensioni arterial
B) Obstruksioni i vena cava superior

C) Obstruksioni i vena cava inferior
D) Stenoze aorte
E) Struma multinodulare
PS)B

Pyetja 212 V)3

Cili organ midis të poshtë shënuarve përfshihet shpesh në dekursin e panarteritit nodoz?

A) Kocka
B) Kartilago
C) Veshi
D) Veshka
E) Uretra
PS)D

Pyetja 213 V)3

Me çfarë mund të bashkëshoqërohet fenomeni RAYNAUD?

A) Tromboflebit
B) Eritermalgji
C) Sklerodermi
D) Limfadenitis
E) Dermatitis
PS)C

Pyetja 214 V)2

Psoriasis i lëkurës me flokë indukton:

A) Një alopeci tranzitore.
B) Një alopeci definitive.
C) Një alopeci vetëm të vertex-it dhe të regjioneve frontale.
D) Nuk indukton alopeci.
E) Zbardhjen e flokut.
PS)D

Pyetja 215 V)1

Cili është shkaku më i shpeshtë i sterilitetit femëror?

A) Hormonal (mungesë ovulacioni)
B) Tubarik
C) Uterin
D) Kongenital
E) Vaginal

PS)A

Pyetja 216 V)1

Nje vlerë e Kaliumit 7mEq/L

A) Është normale
B) Është një vlerë e rritur e shkaktuar nga diarreja dhe të vjellat.
C) Është e reduktuar.
D) Është teresisht jashtë vlerave.
E) Është një vlerë e rritur që mund të provokojë iritabilitet muskular.
PS)E

Pyetja 217 V)2

Cili nga këta trajtime do të duhej të përdorej në rutinë për trajtimin e pre-eklampsisë?

A) Diuretikët
B) Kufizimi i kripës
C) Propranololi
D) Sulfati i magneziumit
E) Deambulacioni (qëndrimi në kembë)
PS)D

Pyetja 218 V)1

Cili nga diuretikët e mëposhtëm është një antagonist i aldosteronit

A) Furosemidi
B) Spironolaktoni
C) Acetazolamidi
D) Manitoli
E) Hidroklortiazidi
PS)B

Pyetja 219 V)3

Cili nga tumoret testikularë të mëposhtëm ka prognozë me të keqe?

A) Seminoma anaplazike
B) Karcinoma embrionale infantile
C) Teratoma
D) Koriokarcinoma
E) Poliembrioma
PS)D

Pyetja 220 V)2

Përqendrimet plazmatike të C3, C4 janë gjithnjë të reduktuara në fazen e aktivizimit të cilës nga sëmundjet e mëposhtme?

A) Lupus eritematoz sistemik (i diseminuar)
B) Miastenia gravis
C) Astma
D) Sarkoidoze
E) Sëmundja e Alzheimer-it
PS)A

Pyetja 221 V)1

Cila nga këto enzima dëshmon për një dëmtim hepatocelular?

A) Aminotransferazat (ALT e AST)
B) Fosfataza acide (ACP)
C) Kreatin fosfokinaza (CPK)
D) Glukozë 6 fosfat dehidrogjenaza (G6PD)
E) Enolazë neuron specifike (NSE)
PS)A

Pyetja 222 V)1

Diagnoza citologjike e kancerit bronkogen tek një pacient me ekzaminim ekspektorant dhe bronkoskopi negative mund të perftohet nga:

A) Aspirimi me age.
B) CT skaner.
C) Stratografia.
D) Shintigrafia.
E) Bronkografia.
PS)A

Pyetja 223 V)1

Kur niveli i glukozës në gjak është i ulur, në mëlçi aktivizohet:

A) Sinteza e acideve yndyrore.
B) Glikoliza.
C) Fosforilimi oksidativ.
D) Cikli i Krebs-it.
E) Glukoneogjeneza.
PS)E

Pyetja 224 V)1

Diabeti mellitus i tipit I karakterizohet nga të gjitha gjendjet shëndetësore të mëposhtme, përveç

A) Poliurisë.
B) Polifagisë.
C) Shtimit në peshë.
D) Polidipsisë.
E) Dhembjes abdominale.
PS)C

Pyetja 225 V)1

Aneuploidia është:

A) Një alterim i numrit te kromozomeve.
B) Një defekt i shikimit.
C) Një alterim i strukturës së kromozomeve.
D) Prania e delecioneve të kromozomeve.
E) Një metafaze anormale.
PS)A

Pyetja 226 V)1

Faktorët reumatoide janë:

A) Imunoglobulinat (Ig) specifike për fragmentin Fc te IgG-ve.
B) Faktorët serikë të pranishëm në reumatizmin artikular akut.
C) Antikorpet anti-membrane sinoviale.
D) Të pranishëm në menyrë tipike në podagër.
E) Pozitive tek pacientët me osteoartrozë.
PS)A

Pyetja 227 V)1

Mediatorët përgjegjës për bronkospazmën në astmë nuk përfshijnë:

A) Leukotrienët.
B) Acetilkolinën.
C) Histaminën.
D) Prostaglandinën D2.
E) TGF-beta.
PS)E

Pyetja 228 V)1

Kur një proteinuri e 24-orëve do të quhet nefrotike?

A) Proteinuria>3g
B) Proteinuria>2g
C) Proteinuria>1g
D) Proteinuria> ose e = 5g
E) Proteinuria> ose e = 8g
PS)A

Pyetja 229 V)2

Shfaqja e atakut të podagrës akute artikulare i detyrohet:

A) Një reduktimi të papritur të vlerave te uricemisë.
B) Fagocitozës, nga ana e neutrofilëve të likidit sinovial të kristaleve të urateve të natriumit.
C) Theksimit të nje uricemie të shtuar dhe ngulmuese.
D) Pranisë së një metaboliti të veçantë të acidit urik me likidin sinovial.
E) Pranisë së tofeve (depozitimeve të forta e të dhembshëm të kristaleve të acidit urik)
PS)B

Pyetja 230 V)1

Heparina vepron:

A) Si një antikoagulant kryesisht duke bllokuar protrombinën.
B) Si antikoagulant falë ndërveprimit me antitrombinën e inhibimit të faktorit X dhe trombinës.
C) Si antikoagulant kryesisht duke inhibuar fibrinogenin.
D) Si antikoagulant kryesisht duke inhibuar fibrinën.
E) Duke bllokuar antitrombinën.
PS)B

Pyetja 231 V)2

Cila nga këto citokina është faktori rritës me i rëndësishëm për eozinofilët?

A) IFN
B) IL4
C) IL2
D) IL1
E) IL5
PS)E

Pyetja 232 V)2

Cili është komplikacioni i menjëhershëm dhe më i shpeshtë në luksacionin posterior të kofshës?

A) Nekroza avaskulare e caput femuri

B) Tromboza e vena profonde të anesive inferiore
C) Coxartroza
D) Ishemia e anësise inferiore
E) Paraliza e nervit shiatik
PS)E

Pyetja 233 V)1

Teknika për vlerësimin statistikor të rezultateve komplekse të disa studimeve epidemiologjike që evidentojnë një faktor risku të një sëmundjeje është

A) Standartizimi i vlerave.
B) Regresioni i shumëfishtë.
C) Evidencë based medecine.
D) Llogaritja e vlerave specifike.
E) Meta-analiza.
PS)E

Pyetja 234 V)2

Të gjitha gjendjet e mëposhtme bashkëshoqërohen me sindromin Pickwick, përveç:

A) Obezitetit
B) Somnolencës.
C) Oreksit të shtuar.
D) Anemisë.
E) Policitemisë.
PS)D

Pyetja 235 V)1

Mosha e shfaqjes së një skizofrenie hebefrenetike në përgjithësi është:

A) Midis 6-10 vjeç.
B) Midis 30-40 vjeç.
C) Midis 16-20 vjeç.
D) Para 4 vjeç.
E) Pas 70 vjeç.
PS)C

Pyetja 236 V)1

Cili nga parametrat e mëposhtëm ka rëndësi të pakët në studimin e mirëqenies në ambientet e banimit?

A) Temperatura
B) Lagështia

C) Presioni
D) Nxehtësia rrezatuese
E) Lëvizja e ajrit
PS)C

Pyetja 237 V)3

Cili është tipari karakteristik citodiagnostik i pemfigus-it?

A) Granulocitet neutrofile
B) Granulocitet bazofile
C) Granulocitet eozinofile
D) Qelizat akantolitike
E) Qelizat balloniforme
PS)D

Pyetja 238 V)1

Nga matja e volumit të O2-së të konsumuar dhe të CO2-së të ekspiruar ne mund të llogarisim:

A) Volumin e vdekur respiratore.
B) Presionin parcial të CO2-së.
C) Metabolizmin energjetik bazal.
D) Presionin parcial të O2-së.
E) Koeficientin respirator.
PS)E

Pyetja 239 V)1

Ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë brenda 90 ditëve të para është e lejuar ne rastin e:

A) Patologjisë së nënës.
B) Malformacioneve fetale.
C) Motivacioneve ekonomike.
D) Kërkesën e babait
E) A+B+C
PS)E

Pyetja 240 V)1

Cili është agjenti etiologjik i zgjebes?

A) Stafilokoku aureus
B) Streptokoku piogen
C) Ascaris lumbricoides
D) Treponema pallidum

E) Sarcoptes scabiei
PS)E

Pyetja 241 V)1

Faktori reumatoid përbëhet nga një imunoglobuline

A) IgG anti-IgA
B) IgE anti-IgM
C) IgA anti-IgE
D) IgD anti-IgG
E) IgM anti-IgG
PS)E

Pyetja 242 V)2

Në acidozën respiratore të kompensuar, cili nga këta parametra përkon gjithnjë me vlerat normale?

A) PaO2
B) PaCO2
C) PH
D) SatO2
E) HCO3-
PS)C

Pyetja 243 V)1

Agjenti etiologjik i hepatitit C është një:

A) RNA virus.
B) DNA virus.
C) Bakter.
D) Protozoar.
E) Helmint.
PS)A

Pyetja 244 V)3

Cili nga këta agjentë kolonizon veçanërisht lezionet bronko-ektazike?

A) Aspergillus terrum
B) Citomegalovirus
C) Pseudomona aeruginoza
D) Mykoplazma pneumonie
E) Micobakterium tuberkulosis
PS)C

Pyetja 245 V)1

Cilat anastomoza aktivizohen në rast të obstruksionit te vena porta ?

A) Midis venës mesenterike inferior dhe venave rektale superiore
B) Midis venës splenike dhe venës gastro-epiploike sinisitra
C) Midis venës gastrike sinistra dhe venës ezofageale
D) Midis venave paraumbelikale dhe venave epiploike
E) Midis venës cava superior dhe venave lumbare ascendente
PS)C

Pyetja 246 V)1

Në cilën sëmundje është e pranishme hiperkaliemia?

A) Morbus Addison
B) Diabet mellitus
C) Sindromen Gilbert
D) Cirrhose hepatike
E) Tireotoksikozë
PS)A

Pyetja 247 V)1

Psikodrama terapeutike:

A) Konsiston në recitimin nje grupi pacientësh të roleve të ndryshme nga jeta e tyre dhe me problematikat e tyre.
B) Është një vepër teatrale me përmbajtje të thellë psikologjike që shfaqet me qëllim terapeutik.
C) Konsiston në recitimin e pacientëve të teksteve teatrale klasike emotive të rëndësishëm.
D) Konsiston në ndihmën ndaj pacientëve per recitimin e teksteve teatrale klasikë emotivë të rëndësishë.
E) Është një term që tregon një formë të veçantë të psikoterapisë së shkurtër.
PS)A

Pyetja 248 V)2

Lazer-i në terapinë e retinopatisë diagnetike përdoret sepse

A) Shkatërron neovazat (vazat e sapoformuara).
B) Rrit vaskularizimin .
C) Pengon formimin e mikroaneurizmave.
D) ?on në pakësimin e dilatacioneve venoze.
E) Rrith grenazhin limfatik.
PS)A

Pyetja 249 V)1

Vlera anormale në formulën leukocitare të mëposhtme është

A) Granulocitet neutrofilike: 57%.
B) Granulocitet eozinofilike: 15%.
C) Granulocitet bazofilike: 0.5%.
D) Monocitet:5.5%.
E) Limfocitet: 22%.
PS)B

Pyetja 250 V)1

Cili nga medikamentet e mëposhtëm antihipertensive mund të shkaktoje kollë?

A) Antagonistët alfa-1 adrenergjikët
B) Sartanët
C) ACE-inhibitorët
D) Kalci-bllokuesit
E) Nitratet
PS)C

Pyetja 251 V)1

Një krizë epileptike parciale motore e djathtë mund të shkaktohet nga një vatër epileptike e lokalizuar në:

A) Lobin frontal të djathtë.
B) Lobin parietal të majtë.
C) Lobin ocipital të majtë.
D) Talamusin e djathtë.
E) Zonën rolandike të majtë.
PS)E

Pyetja 252 V)3

Përballë cilës rrethanë do të perjashtonit me një probabilitet të lartë, diagnozën e lupus-it ?

A) Mungesa e rash-it
B) Teste normale të funksionit renal
C) Mungesa e antikorpeve anti-nukleare
D) Prania e faktorit reumatoid
E) Reperti ekografik i hipertensionit pulmonar
PS)C

Pyetja 253 V)1

Arteria dorsalis pedis mund të vlerësohet:

A) Në dorsum pedis midis metatarsit te I e II.
B) Në nivel retromalleolar te brendshëm.
C) Në nivel retromalleolar të jashtëm.
D) Në nivel pre-malleolar.
E) Në dorsum pedis midis metatarsit te IV dhe V.
PS)A

Pyetja 254 V)1

Ngjyra e verdhë e lëkurës në mungesë të ngjyrës së verdhë të sklerave është për shkak të sasisë së tepërt në:

A) Melaninë.
B) Bilirubinë.
C) Karoten.
D) Hemoglobinë e glukozuar.
E) Hemoglobinë e sulfuruar.
PS)C

Pyetja 255 V)1

Në ulcerën duodenale, terapia më e mirë është:

A) Kirurgjia.
B) Dieta.
C) Me medikamente frenues të pompës.
D) Vagotomia.
E) Me sukralfat për os.
PS)C

Pyetja 256 V)1

Cili është agjenti etiologjik klasik i erizipelës?

A) Stafilokokus aureus
B) Stafilokokus epidermidis
C) Streptokokus pyogenes
D) Korinebakterium minutissimum
E) Bartonella toruidea
PS)C

Pyetja 257 V)1

Manifestimet klinike të Miastenia Gravis janë për shkak të:

A) Turbullimeve të përçimit elektrik përgjatë nervit motor.
B) Alterimit në nivel të sinapsit neuromuskular.
C) Neoplazive cerebrale.
D) Alterimeve të qelizave të cornu anterior.
E) Turbullimeve funksionale në nivel mezencefalik.
PS)B

Pyetja 258 V)2

Infeksioni kronik nga virusi i hepatitit C bashkëshoqërohet me cilën nga këta manifestime?

A) Purpura krioglobulinemike
B) Sëmundje e Churg-Strauss
C) Leucemi me qeliza capullute
D) Panarterit nodoz
E) Polimialgji reumatike
PS)A

Pyetja 259 V)3

Cila nga manifestimet e mëposhtëm nuk bën pjesë në kuadrin klinik të ethes mesdhetare familjare?

A) Ethe
B) Dhimbje abdominale
C) Pleuriti
D) Ikteri
E) Artralgjia
PS)D

Pyetja 260 V)2

Cilët janë shkaqet me të zakonshëm të deficitit të ereksionit me natyrë organike?

A) Vaskulare
B) Nervore
C) Iatrogene
D) Hormonale
E) Patologjie e trupit kavernoz
PS)A

Pyetja 261 V)1

Meningiti limfocitar me hipoglikoraki shkaktohet nga

A) Meningokoku.

B) Pneumokoku.
C) Mykobacterium tuberkulozit.
D) Ekovirus.
E) Penicilum Roqueforti.
PS)C

Pyetja 262 V)1

Terapia me gonadotropina mund të realizohet në të gjitha rrethanat e mëposhtme, përveç:

A) Anovulacionit me nivele të ulura të gonadotropinave.
B) Anovulacionit me nivele normale të gonadotropinave.
C) Anovulacionit me nivele të larta të gonadotropinave.
D) Policistozes ovarike.
E) Hipogonadizmit hipogonadotropik.
PS)C

Pyetja 263 V)2

Cili është trajtimi i zgjedhjes së parë në embolinë arteriale?

A) Terapia fibrinolitike
B) Vazodilatatorët
C) Pritje
D) Antibiotikët
E) Kortizoni
PS)A

Pyetja 264 V)2

Refleksi i akomodimit të syve konsiston në:

A) Midriaze, konvergjencë dhe rritje e kurbaturës së kristalinit.
B) Midriaze, rotacion intern dhe rritje e kurbaturës se kristalinit.
C) Miozë, divergjencë dhe rritje e kurbaturës së kristalinit.
D) Miozë, konvergjencë dhe rritje e kurbaturës së kristalinit.
E) Miozë, rrotullim ekstern dhe ptosis.
PS)D

Pyetja 265 V)1

Në prani të insuficiencës hepatike nga hepatiti kronik C, është pak e mundshme të gjendet një shenjë klinike si:

A) Purpura e palpueshme në gjymtyrët e poshtme
B) Topitje e lëvizshme gjatë perkusionit abdominal
C) FLapping tremor

D) Unaza e Kayser-Fleisch
E) Nevus si merimangë
PS)D

Pyetja 266 V)2

Dhembja, shpesh e fortë, nivel peri-umbelikal dhe epigastrik dhe posteriorisht në 1/3 e poshtme të toraksit, zakonisht është për shkak të:

A) Ulcerës gastrike.
B) Ulcerës duodenale.
C) Pankreatopatisë akute dhe difuze.
D) Kolonopatisë e transversum-it.
E) Kolonopatisë e descendentit dhe sigmës.
PS)C

Pyetja 267 V)1

Cili është agjenti etiologjik i pneumonisë atipike primare?

A) Mykoplazma pneumonie
B) Legionela pneumofila
C) Diplokokus pneumonie
D) Streptokokus pneumonie
E) Mycoplazma arthritidis
PS)A

Pyetja 268 V)1

Rezistenca që kundërshton fluksin e gjakut në një vaze gjaku:

A) Është e pavarur nga statusi i muskulaturës së lëmuar të paretit vazal.
B) Është ne proporcion të kundërt me viskozitetin e gjakut.
C) Varet nga trashësia e endoteliumit.
D) Ndryshon në proporcion të drejtë me gjatësinë e vazës.
E) Zvogëlohet me 12 herë kur rrezja e vazës reduktohet në një të tretën.
PS)D

Pyetja 269 V)1

Cili nga AIJS e mëposhtëm ka potencialin gastrotoksik me të dobët?

A) Acidi acetil salicilik
B) Diklofenak
C) Indometacina
D) Paracetamoli
E) Sulindak

PS)D

Pyetja 270 V)2

Tek femrat e moshës nën 40 vjeç, mamografia është:

A) E indikuar.
B) Potencialisht karcinogenike.
C) Absolutisht e kundër-indikuar.
D) Paraqet një rezolucion diagnostik të dobët për problemet e lidhura me përbërjen glandulare.
E) Ka një rezolucion të madh diagnostik sepse gjendra është me dense.
PS)D

Pyetja 271 V)1

Nje cist paraziti në shpretkë vjen si pasojë e:

A) Filarias.
B) Askarideve.
C) Entamebas.
D) Ekinokokut
E) Tenias.
PS)D

Pyetja 272 V)3

Degëzimi si gjethe fieri i mukusit endocervikal vërehet:

A) Në shtatzëni
B) Në menopauzë
C) Në fazë ovulatore
D) Në periudhë menstruale
E) Në rast të hiper-estrogjenizmit
PS)C

Pyetja 273 V)2

Në cilën sëmundje renale haset më rrallë hipertensioni?

A) Pielonefriti kronik
B) Glomerulosklerоza dianetike
C) Glomerulonefriti kronik
D) Tuberkulozi renal
E) Reni polikistik
PS)D

Pyetja 274 V)1

Kur një embol mbyll trungun kryesor të arteries pulmonare tek një grua adulte cila do të ishte pasoja?

A) Vdekja imediate
B) Infarkti pulmonar hemorragjik
C) Infarkti pulmonar anemik
D) Staza pulmonare
E) Edmea pulmonare
PS)A

Pyetja 275 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me enzimat është i gabuar ?

A) Enzimat furnizojnë substratet me energji duke i lejuar kështu të tejkalojnë barrierën e përfaqësuar nga energjia e aktivizimit.
B) Enzimat janë, në shumicën e rasteve proteina.
C) Enzimat paraqesin specificitet për substratin.
D) Aktiviteti i një enzime mund t'i nënshtrohet rregullimit.
E) Në dekursin e reaksionit enzimatik, normalisht enzima rishfaqet e paalteruar në fund të reaksionit.
PS)A

Pyetja 276 V)1

Njësia e matjes së fushes magnetike në sistemin ndërkombëtar është:

A) Gauss/m
B) Tesla
C) Weber/cm
D) A/mq
E) Xhaul
PS)B

Pyetja 277 V)1

Kriteri kryesor diagnostik i sëmundjes hemolitike autoimune bazohet në:

A) Testin Coomb.
B) Formën e eritrociteve.
C) Rezistëncën osmotike të eritrociteve.
D) Praninë e pikëzimive bazofilike.
E) Sidereminë.
PS)A

Pyetja 278 V)3

Një përqindje e madhe e individëve me deficit të alfa-1-antitripsinës zhvillojne një sëmundje pulmonare obsktruktive kronike ose emfizeme. Graviteti i sëmundjes mund të ndikohet në mënyrë domethënëse nëse pacienti është:

A) Neutropenik.
B) Homozigote peralelet nul të genit për elastazën.
C) Një grua.
D) Heterozigote për nje mutacion me një kopje normale të genit per alfa-1-antitripsinën.
E) Duhanpirës i rëndë.
PS)A

Pyetja 279 V)2

Çfarë mund të evidentojë ekzaminimi spirometrik në dekursin e astmës bronkiale?

A) Sindrom disventilator të tipit restriktiv
B) Vlerat në limitet e normës.
C) Sindrom disventilator i tipit obstruktiv
D) Reduktim të volumit rezidual
E) Reduktim të izoluar të kapacitetit funksional rezidual
PS)C

Pyetja 280 V)1

Cili nga lezionet e mëposhtëm është pre-kanceroz?

A) Keratoza atinike
B) Veruke vulgare
C) Verruke plana
D) Keratoza seborroike
E) Lichen Ruben planus
PS)A

Pyetja 281 V)2

DSM-IV është një sistem klasifikimi i sëmundjeve psikike:

A) Hierarkik multiaksial.
B) Dimensional.
C) Kategorial.
D) Hierarkik.
E) Kategorial multiaksial.
PS)E

Pyetja 282 V)1

Në cilën gjendje pH i gjakut është i rritur?

A) Hiperventilim
B) Eklampsi
C) Acidozë diabetike
D) Pneumoni
E) Uremi
PS)A

Pyetja 283 V)1

Përmbajtja hemoglobinike normale e gjakut tek njeriut është:

A) 3-5 g%.
B) 7-10g%.
C) 13-16g%.
D) 18-20g%.
E) 22-25g%.
PS)C

Pyetja 284 V)1

Depozitimi i kompleksëve imune fluoreshente në nivel të membranës bazale glomerulare, vërehet në të gjitha patologjitë e mëposhtme, me përjashtim të:

A) Glomerulonefritit me lezione minimale.
B) Glomerulonefritit proliferativ endokapilar.
C) Glomerulonefritit proliferativ mezangial.
D) Glomerulonefritit proliferativ endo-extra-kapilar.
E) Glomerulonefritit proliferativ mezangio-kapilar.
PS)A

Pyetja 285 V)1

Një obstruksion urinar që shkakton hidronefrozë tek femija normalisht shkaktohet nga:

A) Malformacioni kongenital i traktit urinar.
B) Vaza anormale që komprimojne ureterin.
C) Kalkula.
D) 'Kingking' të një ureteri si pasojë e renit heptozik.
E) Fimozë tepër e rëndë.
PS)A

Pyetja 286 V)1

Administrimi i TRH-ësë tek një subjekt normal provokon:

A) Vetëm sekretimin e TSH-ësë.
B) Sekretimin e TSH-ësë dhe PRL-së.
C) Sekretimin e TSH-ësë dhe ACTH-së.
D) Sekretimin e TSH-ës, LH-së e FSH-ësë
E) Sekretimin e TSH-ës e GH-ësë.
PS)B

Pyetja 287 V)1

Për të drejtuar ajrin e ambientit të jashtëm drejt alveolave, është e nevojshme të gjenerohet një gradient presioni midis alveolave dhe ajrit ambiental. Cila nga fjalitë e mëposhtme është e vërtetë?

A) Depresioni intrapleurik (presioni negativ i kavitetit pleural) nuk i transmetohet alveolave.
B) Përftohet i njëjti fluks ajri duke aplikuar një presion pozitiv në ajrin ekstern, ose një presion të njëjtë negativ intrapleural.
C) Ventilatorët artificialë gjenerojnë në mënyrë artificiale një presion negativ intrapleural.
D) Alveolat fryhen më tepër kur nuk realizohet reduktimi i presionit pleural.
E) Tensioni superficial i alveolave frenon transmetimin e depresionit intrapleural drejt alveolave
PS)B

Pyetja 288 V)1

Aminoacidet riabsorbohet plotësisht nga filtri glomerular përmes transportit aktiv në:

A) Ansën ascendente të Henle.
B) Tubulin proksimal.
C) Ansen escendente te Henle
D) Tubulin distal.
E) Duktusin kolektor.
PS)B

Pyetja 289 V)1

Disfunksionet seksuale më të zakonshme tek meshkujt janë:

A) Mungesa e kenaqësisë seksuale.
B) Ejakulacioni retrograd.
C) Dispareunia.
D) Fetishizmi.
E) Transseksualizmi.
PS)B

Pyetja 290 V)1

Hormoni luteinizues (LH) ka këto veprime, përveç:

A) Promocionit e ovulacionit.
B) Stimulimit të drejtpërdrejtë të spermatogjenezës.
C) Promocionit të luteinizimit të folikujve orvariene.
D) Stimulimit të prodhimit të progesteronit të corpus luteum.
E) Stimulimit të sekretimit të testosteronit.
PS)B

Pyetja 291 V)1

Në grafikun elektroforetik normal, proteinat në sasi më të madhe janë:

A) Albumina.
B) Alfa-1-globulina.
C) Alfa-2-globulina.
D) Beta-globulina.
E) Gama-globulina.
PS)A

Pyetja 292 V)1

Pielonefriti akut:

A) Është sëmundja karakteristike e seksit mashkull.
B) Prek vetëm subjektet në moshë të avancuar.
C) Karakterizohet vetëm nga prania e etheve të tipit septik.
D) Paraqitet me vlera normale të eritrosedimentit dhe proteinës C reaktive.
E) Paraqitet me një neutropeni të theksuar.
PS)C

Pyetja 293 V)3

Cila nga sindromat e mëposhtme epileptike paraqet prognozën më të rëndë?

A) Epilepsia e tipit të absencave tek femija
B) Epilepsia e tipit të absencave juvenile
C) Epilepsia me absenca mioklonike
D) Epilepsia nioklonike juvenile
E) Epilepsia parciale beninje e fëmijërisë me maja centro-temporale
PS)C

Pyetja 294 V)2

Një neoplazi e ventrikulit të IV do të japë lehtësisht:

A) Hemorragji subaraknoidale.

B) Verbim.
C) Malaci multiple.
D) Hidrocefali.
E) Paralizë spastike.
PS)D

Pyetja 295 V)1

Në limfocitogramën e gjakut periferik mbizotërojnë:

A) Limfocitet gama/delta.
B) Limfocitet T CD4+.
C) Limfocitet T CD8+.
D) Limfocitet B CD19+.
E) Qelizat Natural Killer NK CD16+.
PS)B

Pyetja 296 V)1

Hipokalcemia në insuficiencë renale kronike vjen si pasojë e:

A) Hiperkalciurisë.
B) Marrjes së pakësuar te kalciumit në dietë.
C) Mungesës së vitaminës D aktive.
D) Mungesës së PTH-ësë
E) Hiperparatiroidizmit.
PS)C

Pyetja 297 V)2

Në dyshimin klinik të bronkoektazisë me radiografi toraksi në dukje normale është e nevojshme të kërkohet:

A) Një bronkografi.
B) Një fibrobronkoskopi.
C) Një CT skaner toraksi me rezolucion të lartë.
D) Një shintigrafi vaskulare pulmonare.
E) Një ekografi toraksi.
PS)C

Pyetja 298 V)1

Humbja e ujit në 24 orë përmes rrugëve respiratore dhe perspirimit insensibilis tek një subjekt adult i shëndoshë, në kushte ambientale normale është rreth:

A) 100-200 ml.
B) 200-400 ml.

C) 400-800 ml.
D) 800-1000ml.
E) 1300-1500ml.
PS)D

Pyetja 299 V)1

Nitratet:

A) Japin vazodilatacion vetëm në prani të integritetit endotelial të ruajtur.
B) Janë vazodilatatorë specifikë për arteriolat dhe vazat prekapilare.
C) Reduktojnë si input-in ashtu edhe output-in.
D) Nuk veprojnë mbi muskulin e lemuar ekstravaskular.
E) Induktojnë efekte inotrope e kronotrope negative.
PS)C

Pyetja 300 V)2

Cili nga efektet e mëposhtëm të AIJS është i reduktuar në rastin e inhibitorëve selektivë të COX-2?

A) Efektshmëria anti-inflamatore.
B) Rreziku i hemorragjisë gastro-intestinale.
C) Rreziku i insuficiencës renale akute.
D) Rreziku i nefropatisë nga analgjezikët.
E) Rreziku i reaksioneve idiosinkrazike.
PS)B

Pyetja 301 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me verapimil-in nuk është i saktë ?

A) Duhet të administrohet në bashkëshoqërim me beta-bllokues adrenergjikë.
B) Është i dobishëm në trajtimin e flaterit atrial.
C) Është i dobishëm në trajtimin e fibrilacionit atrial.
D) Efekti i tij inotrop negativ e kufizon përdorimin në rastet me demtime kardiake.
E) Është i dobishem në trajtimin e takikardisë supraventrikulare paroksistike.
PS)A

Pyetja 302 V)2

Një djalë 20 vjeçar u dërgua me urgjencë sepse ishte letargjik, me ethe (T 39°C)Dhe petekie. Menjëherë i nënshtrohet punksionit lumbar dhe likidi cerebro-spinal ka një pamje të ngjashme me një meningit bakterial. Cilin nga këta agjente etiologjikë do
A) Neisseria gonorrhea
B) Neisseria meningitidis
C) Streptokoku pyogenes

D) Listeria monocytogenes
E) Mycobacterium tuberculosis
PS)B

Pyetja 303 V)3

Cili nga parametrat e mëposhtëm është nje tregues i konsumimit alkoolik të shtuar?

A) Volumi globular <80fl
B) Uremia>80mg/dl
C) Creatinemia urinare < 15mg/kg/dite
D) Raporti AST/ALT>2
E) Bilirubina e konjuguar <0.3mg/dl
PS)D

Pyetja 304 V)1

Është indeks i efikasitetit (fuqise) se nje medikamenti:

A) T1/2
B) EC50
C) CL
D) Vd
E) AUC
PS)B

Pyetja 305 V)1

Busulfani është :

A) Një derivat i metilhidralazinës.
B) Një antibiotik.
C) Një agjent alkilant.
D) Një kortikosteroid.
E) Një nitrozourë.
PS)C

Pyetja 306 V)3

Në shumicën e rasteve të membranave biologjike janë te pranishme glikosfingolipidet. Cila pjesë e këtyre molekulave pritet të gjendet vetem në pjesën e jashtme të membranës?

A) Zinxhiri akilik i ceramides
B) Zinxhiri akilik i sfingozinës
C) Ciladoqoftë pjese e lipidit
D) Zinxhiri oligosakaridik
E) Grupi fosfat

PS)D

Pyetja 307 V)2

Një tumefasion monolateral i qafës në nivel të fossa supraklavikulare të majtë verehet me incidencë të shtuar në patologjinë e:

A) Leucemisë limfatike akute.
B) Leucemisë limfatike kronike.
C) Metastazës karcinomatoze të stomakut.
D) Limfomës Hodgkin.
E) Limfosarkomatozës.
PS)C

Pyetja 308 V)2

Diagnoza e malacisë kraniale post-traumatike mund të bëhet përmes radiologjisë duke u nisur nga cili moment i kohës?

A) Menjëherë
B) Në distancë 1 mujore
C) Në distancë 3 mujore
D) Në distancë prej të paktën 8 muajsh
E) Pas të pakten 3 vjetësh
PS)D

Pyetja 309 V)1

Është e saktë të pohosh se hormoni adrenokortikotrop (ACTH) :

A) Favorizon mobilitetin e kalciumit nga kocka.
B) Është i natyrës steroidiene.
C) Sintetizohet në neurohipofizë
D) Rrit prodhimin e adrenalinës.
E) Stimulon prodhimin e glukokortikoideve.
PS)E

Pyetja 310 V)1

Parathormoni siguron efektet e mëposhtme, përveç:

A) Inhibon riabsorbimin tubular të fosfateve.
B) Rrit aktivitetin osteoklastik.
C) Stimulon sintezën e 1-25(OH) vitamina D.
D) Stimulon riabsorbimin renal të kalciumit.
E) Redukton ekskretimin urinar te bikarbonatit
PS)E

Pyetja 311 V)1

Simptoma e hershme me e shpeshtë e një tumori të ezofagut është:

A) Disfagia.
B) Disfonia.
C) Hematemeza
D) Rektorragjia.
E) Temperatura e lartë.
PS)A

Pyetja 312 V)2

Janë shkaqe të dispnesë në insuficiencen e majtë të gjitha alterimet e mëposhtme, përveç:

A) Hipoksisë.
B) Edemës se mukozës bronkiale.
C) Rritjes së rigiditetit (elesticitet i ulur) pulmonar.
D) Edema intersticiale pulmonare
E) Sensibilitet me i shtuar i qendrave respiratore
PS)E

Pyetja 313 V)1

Cili është përbërësi kryesor i kilomikroneve?

A) Trigliceridet
B) Fosfogliceridet
C) Acidet yndyrore
D) Kolesteroli
E) Proteinat
PS)A

Pyetja 314 V)3

Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk bën pjesë tek faktorët prognostikë që ndikojnë pozitivisht në diagnozën e skizofrenisë?

A) Prania e simptomatologjise negative.
B) Prania e ngjarjeve stresante që kane paraprire fillimin e simptomave.
C) Fillimi i shpejtë dhe akut i sëmundjes.
D) Jeta sociale e kënaqshme përpara sëmundjes.
E) Ko-ekzistenca e çrregullimeve të humorit.
PS)A

Pyetja 315 V)1

Në cilën nga sëmundjet infektive të mëposhtme haset me shpesh glomerulonefriti?

A) Fruthi
B) Skarlatina
C) Rubeola
D) Parotiti epidemik
E) Difteria
PS)B

Pyetja 316 V)2

Cili nga indikacionet e mëposhtëm përbën një përdorim të përshtatshëm të imipraminës?

A) Pagjumësia
B) Epilepsia
C) Enuresis nokturna e fëmijës
D) Glaukoma
E) Mania
PS)C

Pyetja 317 V)1

Të gjithë termat e mëposhtëm mund të përdoren për të treguar një çrregullim të shkaktuar nga një medikament tek një individ i caktuar, përveç:

A) Efekteve anësore të medikamentit
B) Sinjalit
C) Ngjarje risku
D) Reaksion risku
E) Çrregullim iatrogenik
PS)B

Pyetja 318 V)3

Nga trunkusi celiak marrin origjinën:

A) Arteria gastrike e djathtë, a hepatike komune, a splenike.
B) Arteria gastrike e majte, a hepatike komune, a splenike.
C) Arteria hepatike e djathte, a hepatike e majte, a splenike.
D) Arteria mezenterike superior, a hepatike komune, a splenike.
E) Arteria mezenterike superior, a hepatike e majtë dhe e djathtë.
PS)B

Pyetja 319 V)3

Cila nga rrethanat e mëposhtme mund të shkaktojë SIADH (Syndrom of Inappropriate

ADH)?

A) Karcinoma bronkiale
B) Hipokaliemia
C) Tumoret e prostatës
D) Hiperkalcemia
E) Sindroma Cushing
PS)A

Pyetja 320 V)2

Të gjitha rrethanat morboze të mëposhtme janë të transmetuara në mënyrë autozomale dominante, përveç:

A) Akondroplazisë.
B) Miotonisë kongenitale.
C) Sklerozës tuberoze.
D) Fibrozës kistike.
E) Osteogenezës imperfekte.
PS)D

Pyetja 321 V)3

Cila nga substancat e mëposhtme, përbërës të disa ushqimeve të dietës normale të përditshme, mund të provokojë një krizë hipertensive në subjektet që marrin inhibitorët e MAO-A?

A) Tiramina
B) Tirosina
C) Acetilkolina
D) Acidi oleik
E) Muskarina
PS)A

Pyetja 322 V)1

Për cilin nga këto hepatite ekziston një vaksinë?

A) Hepatitin A e C
B) Hepatitin C
C) Hepatitin D
D) Hepatitin A e B
E) Hepatitin G, A e B
PS)D

Pyetja 323 V)1

Cila nga këto sigla identifikon kompleksin madhor të histokompatibilitetit?

A) HLA
B) ABC
C) ZWA
D) ALH
E) LAH
PS)A

Pyetja 324 V)1

Cila nga këto qeliza prodhon interferonin?

A) Eritrocitet
B) Makrofagët
C) Mastocitet
D) Osteoblastet
E) Qelizat e pankreasit endokrin
PS)B

Pyetja 325 V)1

Me miotoni nënkuptojmë

A) Një gjëndje persistente kontraktimi muskular me krampe.
B) Një shtim persistent të tonusit muskular të tipit elastik, me shtim të reflekseve tendinoze.
C) Një shtim të tonusit muskular të tipit plastik, me spazma muskulare.
D) Një deficit i relaksimit muskular nga kontraktimi persistent edhe pas mbarimit të stimulit.
E) Një çrregullim motor central me lëvizje të përsëritura të vazhdueshme dhe posturë anormale.
PS)D

Pyetja 326 V)1

Feokromacitoma shkakton

A) Krizë hipertensive.
B) Kolaps.
C) Sepsis.
D) Abdomen akut.
E) Asgjë.
PS)A

Pyetja 327 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm mbi etiopatogenezën e artritit reumatoid (RA) është i gabuar?

A) Gratë nullipare kanë nje risk të shtuar për të zhvilluar RA-në.
B) Në tre muajt që pasojnë shtatzaninë risku i RA-së është i shtuar.
C) Në shtatzani sëmundja zakonisht përmirësohet.
D) Në RA raporti M:F është pothuaj 1:2-3
E) Përdorimi i kontraceptivëve orale precipiton manifestimet klinike.
PS)E

Pyetja 328 V)3

Në cilin nga vaskulitet sistemike të mëposhtme raportohet më shpesh prekja e aparatit respirator?

A) Sëmundja Kawasaki
B) Purpura e Schonlein-Henoch
C) Arteriti me qeliza gjigande
D) Sindromi Cogan
E) Granulomatoza Wegener
PS)E

Pyetja 329 V)2

Insulina indukton të gjitha efektet metabolike të mëposhtmme, përveç

A) Fuqizimit të magazinimit dhe përdorimit të energjisë.
B) Stimulimit të sintezës e lipoproteinë lipazës (LPL)
C) Induktimit të enzimës malike
D) Induktimit të glukozë-7-fosfat dehidrogjenazës
E) Stimulimit të qelizave muskulare dhe adipoze për të sekretuar glukozë
PS)E

Pyetja 330 V)1

Acidet yndyrore transportohen në plazmë nga

A) Albumina.
B) Fosfolipaza A2.
C) Lipoproteina (a).
D) Acil koenzima A.
E) Karnitina.
PS)A

Pyetja 331 V)1

Absorbimi i cilës nga substancat e mëposhtme rezulton më i prekuri pas një rezeksioni të ileumit distal?

A) Glukoza

B) Vitamina B12
C) Uji
D) Kripa
E) Fibrat vegjetale
PS)B

Pyetja 332 V)1

Në vendet e industrializuara, cili është agjenti më i shpeshtë i gastroenteritit akut në moshën pediatrike?

A) E coli
B) Salmonela
C) Rotavirus
D) Adenovirus
E) Giardia
PS)C

Pyetja 333 V)3

Glomerulonefriti proliferativ ekstrakapilar ('crenscente') përkufizon

A) Një sëmundje specifike të karakterizuar nga prania e gjysmëhënave epiteliale ("crescents") në shumicën e glomerulave.
B) Një sindrom anatomo-klinik me etiologji multiple, që e patrajtuar çon në insuficiencë renale kronike shpesh irreversibile për jave/muaj.
C) Një sindrom anatomo-klinik me etiologji multiple që çon shpesh në insuficiencë renale kronike shpesh irreversibile në javë/muaj.
D) Një sindrom anatomo-klinik me etiologji multiple gjithnjë të karakterizuar nga prania e komplekseve imune në imunofluoreshencë
E) Një sëmundje specifike me etiologji auto-imune e karakterizuar nga prevalenca e antigenëve
PS)B

Pyetja 334 V)3

Një djalë 18 vjeçar paraqet ethe, dhimbje fyti, asteni e limfadenopati laterocervikale. Në ekzaminimin objektiv paraqitet faringo-tonsilit, petekie në palatum, limfadenopatia cervikale, aksilare dhe inguinale; hepatosplenomegali. Ekzaminimet laboratorike
A) Virusi Epstein-Barr
B) Neisseria gonorrhoeae
C) CMV
D) Mykoplasma hominis
E) Streptokoku grupit A
PS)A

Pyetja 335 V)1

Pas lindjes, ku ndodh diferencimi i limfociteve B?

A) Në timus
B) Në palcën kockore
C) Në hepar
D) Në qendrat germinale të limfonodulave
E) Në qendrat germinale të shpretkës
PS)B

Pyetja 336 V)1

Ekzaminimet e screening-ut

A) Vlerësojnë shpërndarjen e një neoplazie pas ndërhyrjes kirurgjikale.
B) Kërkojnë praninë e nje neoplazie specifike në nje popullatë të shendoshë në risk për këtë neoplazi.
C) Kërkojnë metastazat eventuale përpara një ndërhyrjeje kirurgjikale.
D) Kërkojnë praninë e një neoplazie specifike tek subjektet me simptoma dyshuese për këtë neoplazi.
E) Bëjnë pjesë në parandalimin primar të tumoreve.
PS)B

Pyetja 337 V)1

Substratet energjetike që truri mund të përdorë janë

A) Glukoza dhe trupat ketonike.
B) Ekskluzivisht glukozë.
C) Ekskluzivisht glutamat dhe glukozë.
D) Ekskluzivisht proteina.
E) Ekskluzivisht yndyrna.
PS)A

Pyetja 338 V)2

Në trajtimin e një kuadri konfuzional do të duhej

A) Të siguronim për pacientin një prani të vazhdueshme.
B) Të mbanim pacientin në kushtet e errësirës dhe izolimit.
C) Të përdornim sasi të mëdha sedativësh.
D) Të përdornim antidepresivët triciklikë.
E) Të mbanim pacientin të zgjuar me çdo kusht.
PS)A

Pyetja 339 V)2

Në dyshim për polimiozit, ekzaminimi fillestar dhe shumë i indikuar është

A) Kërkimi i antikorpeve antinukleare.
B) Eritrosedimenti.
C) Fibrinogjeni.
D) Dozimi i enzimave muskulare.
E) Biopsia e arteries temporale.
PS)D

Pyetja 340 V)2

Sediment i lartë, ethe, leukocitozë me neutrofili janë shenja të

A) Tuberkulozit kockor.
B) Mielomës multiple.
C) Metastazës kockore
D) Osteomielitit akut.
E) Osteomës osteoide.
PS)D

Pyetja 341 V)1

Cila nga të dhënat laboratorike të mëposhtme vërehet në fenilketonuri?

A) Acidoza metabolike
B) Hiperamoniemia
C) Ketoza
D) Shtimi i nivelit plazmatik të fenilalaninës
E) Shtimi i niveleve plazmatike të aminoacideve të degëzuara (izoleucina, valina, leucina)
PS)D

Pyetja 342 V)1

Vlera normale e pH-it arterial është

A) 7.15-7.25.
B) 7.25-7.35.
C) 7.35-7.45.
D) 7.45-7.55.
E) 7.55-7.65.
PS)C

Pyetja 343 V)3

Në dekursin e një infeksioni nga HIV-1 cili nga këto ekzaminime të mëposhtme përdoret zakonisht për monitorimin e dekursit dhe progresionit të sëmundjes?

A) Eritrosedimenti, hematokriti
B) Nënpopullata limfocitare, HIV-RNA
C) Nënpopullata limfocitare, HIV-DNA
D) Eritrosedimenti, beta-2 mikroglobulina
E) Antikorpet anti-HIV
PS)B

Pyetja 344 V)1

Sa ventrikuj cerebralë janë gjithsej?

A) Një
B) Dy
C) Tre
D) Katër
E) Pesë
PS)D

Pyetja 345 V)1

Në kontraksionin e sarkomerit

A) Është e rëndësishme sasia e kalciumit që futet në citoplazëm nga jashtë.
B) Është e rëndësishme sasia e natriumit që futet nga jashtë në citoplazëm.
C) Është e rëndësishme sasia e kalciumit që hyn në citoplazëm nga retikulumi sarkoplazmatik.
D) Strijet Z largohen.
E) Kalciumi ndahet nga miozina.
PS)C

Pyetja 346 V)1

Cili është rezervuari natyral i toxoplazmës?

A) Fëmijët e moshës shkollore
B) Ekskrementet e zogjve
C) Peshqit e kontaminuar
D) Macja
E) Gjaku
PS)D

Pyetja 347 V)1

Ovociti në momentin e ovulacionit

A) Nuk është i veshur nga asnjë strukturë.
B) Është i veshur vetëm nga zona pelucida.
C) Është i veshur nga zona pelucide, nga qelizat e korona radiata dhe nga oofori.

D) Është i veshur nga një shtresë lidhore e lëmuar.
E) Është i veshur nga një shtresë lidhore dense.
PS)C

Pyetja 348 V)2

Cili është faktori prognostik kryesor në një karcinomë mamare të operuar në mënyrë radikale?

A) Mosha
B) Mutacioni i BRCA1
C) Përdorimi i estroprogestativëve
D) Prekja limfonodulare
E) Dimensionet e T (tumorit)
PS)D

Pyetja 349 V)1

Cilat janë simptomat specifike të periudhës menopauzale?

A) Djersitja nokturne
B) Pagjumësia
C) Rënia në peshë
D) Fraktura
E) Rritja në peshë.
PS)A

Pyetja 350 V)1

Me pneumoni nozokomiale kuptojmë

A) Një formë të pranishme në momentin e hospitalizimit.
B) Një formë që manifestohet të paktën 48 ore pas hospitalizimit dhe që nuk ishte në inkubacion në momentin e shtrimit në spital.
C) Një formë e fituar gjatë hospitalizimit në repartin e riaftësimit.
D) Një formë e fituar gjatë hospitalizimit në repartin e Terapisë Intensive.
E) Një formë që manifestohet në dalje nga spitali.
PS)B

Pyetja 351 V)1

Një dëmtim glomerular mund të përbëjë një komplikacion të rëndësishëm të të gjitha patologjive të mëposhtme, përveç

A) Lupusit eritematoz të diseminuar.
B) Amiloidozës.
C) Purpura e Schonlein-Henoch.
D) Hiperkalcemisë.

E) Sindromit Goodpasture.
PS)D

Pyetja 352 V)3

Shpërndarja botërore e beta-talasemisë, drepanocitozës dhe deficiencës së glukozë-6-fosfat-dehidrogenazës (G6PD) koincidon me atë të

A) Malaries.
B) Sklerozës multiple.
C) Kolerës.
D) Persistencës së laktazës.
E) Gripit.
PS)A

Pyetja 353 V)1

Sëmundja e Dupuytrenit karakterizohet nga retraksioni i strukturës

A) Aponeurozës së muskulit psoas.
B) Aponeurozës palmare.
C) Aponeurozës perineale media.
D) Ligamentit inguinal.
E) Fascia dorsalis e këmbës.
PS)B

Pyetja 354 V)3

Në komën diabetike, në fazë fillestare, pupilat zakonisht janë

A) Normale.
B) Miotike.
C) Midriatike.
D) Anizohorike.
E) Duke paraqitur fenomenin e Argyll-Robertson.
PS)C

Pyetja 355 V)1

Forma më e shpeshtë e hipertensionit arterial është

A) Hipertensioni renovaskular.
B) Hipertensioni esencial.
C) Hipertensioni nga morbus Cushing.
D) Hipertensioni në sindromin Conn.
E) Hipertensioni neurogen.
PS)B

Pyetja 356 V)1

Një shtim i hemoglobinës (>18g%) vërehet në patologjinë e

A) Neoplazive malinje të rënda.
B) Sëmundjeve infektive invalidizuese.
C) Anemisë hemolitike.
D) Morbus Vaquez.
E) Klorozës.
PS)D

Pyetja 357 V)1

Trashëgueshmëria në distrofinë muskulare të Duchenne është

A) E lidhur me transmetimin me seksin.
B) E tipit mitokondrial.
C) Autozomal recesiv.
D) Autozomal dominant.
E) Mund të jetë ose autozomal recesiv ose autozomal dominant.
PS)A

Pyetja 358 V)2

Karnitina përdoret si përbërës ushqimor për përmirësimin e performancës agonistike sepse

A) Shton transportin e acideve yndyrore permes membranes plazmatike.
B) Aktivizon acidet yndyrore në citozol.
C) Është një rregullator alosterik i acil-CoA dehidrogjenazës.
D) Shton transportin e acideve yndyrore përmes membranës mitokondriale interne.
E) Transporton acetatin gjatë konvertimit të acetil-CoA në trupa ketonikë.
PS)D

Pyetja 359 V)1

Në cilën nga këto sëmundje bashkëshoqërohet neuriti optik ?

A) Cistitis
B) Pankreatitis
C) Skleroza me pllaka
D) Pneumonia
E) Ulcera gastrike
PS)C

Pyetja 360 V)1

Përse përdoret adrenalina në anestezinë lokale?

A) Rrit rrjedhjen
B) Pakëson rrjedhjen hematike
C) Shton edemën
D) Nuk përdoret asnjëherë
E) Pakëson dhëmbjen
PS)B

Pyetja 361 V)1

Cila nga gjetjet e mëposhtme është e pranishme në insuficiencën mitrale kronike?

A) Ritmi sinusal
B) Zhurma holosistolike
C) Vala "V" e atriumit të majtë shumë të rritur.
D) Toni i parë i përforcuar
E) Galop presistolik
PS)B

Pyetja 362 V)1

Cili nga këta medikamente ka një veprim fibrinolitik të shtuar?

A) Dikumarol
B) Streptokinaza
C) Heparina
D) Fenidioni
E) Kumopirani
PS)B

Pyetja 363 V)1

Deficiti i nervit të IV kranial provokon

A) Diplopi në shikimin poshtë.
B) Hemianopsia bilaterale.
C) Diplopi në shikimin anash.
D) Nistagmus.
E) Ndryshime pupilare.
PS)A

Pyetja 364 V)2

Sinusi koronarian i zemrës normale drenon zakonisht në

A) Atriumin e djathtë.

B) Atriumin e majtë.
C) Ventrikulin e majtë.
D) Ventrikulin e djathtë.
E) Vena cava superior.
PS)A

Pyetja 365 V)3

Një djalë 24 vjeçar vjen për një vlerësim të një enjtjeje në kaviljen e djathtë. Kavilja ka qënë e fryrë për një ditë. Në të shkuarën ai ka patur një trombozë të venave të thella, në moshën 17 vjeçare, për të cilën kishte marrë ' warfarinë' për 3 muaj. N
A) Antikorpet antifosfolipidike.
B) Neoplazi okulte.
C) Hemoglobinuria paroksistike nokturne.
D) Mutacioni i faktorit V të Leiden.
E) Homocisteinemia.
PS)D

Pyetja 366 V)2

Në rastet e angina pectoris instabile, cila do të konsiderohej terapia kryesore, përveç medikamenteve të nevojshme për të kontrolluar simptomat e anginës?

A) Aspirina 100mg/ditë.
B) Aspirina 325mg/dite + kalciparine 0.5mgx2/ditë.
C) Diltiazem.
D) Verapamil 240mg + nifedipine 40mg/ditë.
E) Antikoagulantët oralë.
PS)B

Pyetja 367 V)2

Çrregullimet psikiatrike të zakonshme

A) Verifikohen tek 50% e grave në një vit.
B) Nuk i pergjigjen psikoterapisë.
C) Duhet të vlerësohen gjithnjë tek psikiatri.
D) Paraqiten shpesh me simptoma fizike.
E) Shpesh paraqiten me agresivitet të lartë.
PS)D

Pyetja 368 V)2

Sick Sinus Syndrom (sëmundja e nyjes sinusale) nënkupton çrregullime të shumta të formimit dhe përçimit të stimulit. Nga të poshtë permendurit, cila alternativë duhet përjashtuar?

A) Ndalimi funksional i nyjes sino-atriale.

B) Blloku i degës së djathtë ose të majtë.
C) Blloku sino-atrial.
D) Bradikardi e theksuar sinusale me ekstrasistola atriale.
E) Sindromi taki-bradikardik.
PS)B

Pyetja 369 V)1

Dhëmbja që nga peritoneumi parietal është e tipit

A) Somatik.
B) Visceral superficial.
C) Visceral profund.
D) Të projektuar.
E) Radikular.
PS)A

Pyetja 370 V)1

Nga e merr më shpesh origjinën tumori i prostatës?

A) Zona centrale.
B) Zona periferike.
C) Zona tranzicionale.
D) Vezikulat seminale.
E) Uretra prostatike.
PS)B

Pyetja 371 V)2

Cila nga rrethanat e mëposhtme përfaqëson një kundër-indikacion relativ për realizimin e një shintigrafie perfuzionuese pulmonare?

A) Insuficienca renale kronike.
B) Koagulopatia nga konsumi.
C) Insuficienca kardiake.
D) Shtatzania.
E) Shoku septik.
PS)D

Pyetja 372 V)1

Cili nga lokalizimet e mëposhtëm është i pasur me gjëndra apokrine

A) Regjioni perianal.
B) Lëkura me flokë.
C) Regjioni palmo-plantarë.

D) Faqia.
E) Arkada supraciliare.
PS)A

Pyetja 373 V)1

Është një formë sekondare e cefalesë

A) Hemikrania pa aura.
B) Hemikrania me aura.
C) Cefalea tensive.
D) Cefalea akute idiopatike.
E) Arteriti temporal.
PS)E

Pyetja 374 V)1

Në absceset pelvike, kuadri klinik karakterizohet nga

A) Konstipacion.
B) Mbrojtja ("defanse") abdominale difuze.
C) Dhembja abdominale difuze.
D) Pamundësia për eleminim të gazrave dhe konstipacion.
E) Trishtimi.
PS)A

Pyetja 375 V)1

Artroza është një sëmundje e karakterizuar nga

A) Humbja e masës kockore.
B) Çrregullime primare të trofizmit muskular.
C) Ecurisë migrante dhe zëvendësuese.
D) Harxhimit të kartilagos artikulare.
E) Infeksioneve artikulare recidivante.
PS)D

Pyetja 376 V)1

Cila nga patologjitë e mëposhtme nuk indukton hipertension arterial?

A) Hipersurrenalizmi.
B) Feokromocitoma.
C) Pielonefriti kronik.
D) Hipertiroidizmi.
E) Anemia.
PS)E

Pyetja 377 V)1

Një katalizator

A) Zhvendos përqendrimet në ekuilibër.
B) Ul energjinë e aktivizimit të një reaksioni të caktuar.
C) Është shpesh e konsumuar gjatë reaksionit.
D) Është gjithnjë një substancë gazoze.
E) Është e nevojshme për çfarëdolloj reaksioni.
PS)B

Pyetja 378 V)1

Cili është përkufizimi i saktë i ' kongenitales'?

A) E lidhur me trashëgiminë paternale.
B) E pranishme në anëtarët e tjerë të familjes.
C) Që mund të përsëritet tek femijët e tjerë.
D) Që do të lërë gjurmë në gjeneratat e ardhshme.
E) Që është e pranishme në lindje.
PS)E

Pyetja 379 V)1

Tek një paciente e prekur nga hernia diskale L5-S1 të djathtë shenjat e Lassegue dhe Wassermann janë

A) Negative.
B) Pozitive.
C) Lassegue pozitiv e Wassermann negativ.
D) Wassermann pozitiv e Lassegue negativ.
E) Lassegue e Wassermann lehtesisht pozitiv.
PS)C

Pyetja 380 V)1

Terapia kirurgjikale e hernies inguinale kongjenitale tek fëmijët konsiston në

A) Mbylljen e urakut.
B) Mbylljen e ductus peritoneal vaginal.
C) Mbylljen e unazës inguinale të jashtme.
D) Vendosjen e patch në zonën e lokalizimit të hernies.
E) Vendosjen e patch në skrotum.
PS)B

Pyetja 381 V)1

Korteksi visiv vaskularizohet kryesisht nga arteria

A) Cerebrale anteriore.
B) Cerebrale media.
C) Oftalmike.
D) Cerebrale posteriore.
E) Vertebrale e djathtë.
PS)D

Pyetja 382 V)1

Cili nga efektet e mëposhtëm lidhet me aktivitetin fiziologjik të gastrinës?

A) Stimulimi i sekretimit të acidit klorhidrik.
B) Stimulimi i sekretimit të kolecistokininës.
C) Përshpejtimi i zbrazjes gastrike.
D) Stimulimi i sekretimit të bikarbonateve.
E) Stimulimi i ekskrecionit të bilës.
PS)A

Pyetja 383 V)2

Cili është mekanizmi patogjenetik që akuzohet veçanërisht në gjenezën e fibrozës kistike?

A) Inhalacioni i pluhurave me veprim fibrotizues.
B) Shtimi i numrit dhe funksionalitetit të gjëndrave seromukozale të aparatit respirator.
C) Shtimi i transportit të ujit në nivel të membranës qelizore.
D) Transport i alteruar i joneve në nivel të membranës qelizore.
E) Riabsorbim i shtuar i ujit në nivel të membranave qelizore.
PS)D

Pyetja 384 V)1

Në çfare intervali përfshihet PH i gjakut normal ?

A) 7.24-7.28
B) 7.29-7.35
C) 7.36-7.41
D) 7.42-7.46
E) 7.47-7.52
PS)C

Pyetja 385 V)2

Cili është lezioni elementar i moluskum contagiosum?

A) Vesikula me përmbajtje seroze.
B) Bula hemorragjike hemisferike.
C) Papula hemisferike umbelikale.
D) Pllaka eritematoze.
E) Skuamim sero-hematik.
PS)C

Pyetja 386 V)1

Adenoma hipofizare GH-sekretore indukton

A) Akromegali në subjektet post-pubertet, gjigandizëm në subjektet pre-pubertet dhe prirje për hyperglicemi.
B) Akromegali tek subjektet post-pubertet.
C) Gjigandizëm tek subjektet pre-pubertet.
D) Prirje për hiperglicemi.
E) Akromegali tek subjektet post-pubertet, gjigandizëm tek subjektet pre-pubertet.
PS)A

Pyetja 387 V)1

Në ekografinë kardiake, infarkti karakterizohet nga:

A) Hipertrofia e ventrikulit të majtë.
B) Hipertrofia e ventrikulit të djathtë.
C) Hipokinezia-akinezia e një zone të miokardit.
D) Rritje e atriumit të majtë.
E) Rritje e atriumit të djathtë.
PS)C

Pyetja 388 V)1

Neuropatia diabetike përmban në mënyrë tipike

A) Një dhëmbje të tipit somatik.
B) Një dhëmbje të tipit visceral.
C) Një dhëmbje të tipit neuropatik.
D) Një dhëmbje homeopatike.
E) Një dhëmbje adianatike.
PS)C

Pyetja 389 V)1

Qelizat beta të ishujve të Langerhansit sekretojnë

A) Somatostatinë.
B) Glukagon.

C) ACTH.
D) FSH.
E) Insulinë.
PS)E

Pyetja 390 V)1

Terapia e hipogonadizmit hipofizar kryhet me

A) Klomifen.
B) Gonadotropinë.
C) Testosteron.
D) Estroprogesteronikë.
E) Ciklofenil.
PS)B

Pyetja 391 V)1

Miringitis është një infeksion

A) I meningjeve.
B) I membranave timpanike.
C) Mukozës rinofaringeale.
D) Membranës tektale.
E) Tubave ovarienë.
PS)B

Pyetja 392 V)2

Cili është komplikacioni më i rënde nga ana prognostike i cirrhozës hepatike?

A) Sindromi hepatorenal.
B) Insuficienca ascitike.
C) Edema.
D) Shfaqja e variçeve ezofageale.
E) Encefalopatia porto-sistemike.
PS)A

Pyetja 393 V)1

Cili nga ekzaminimet e mëposhtëm është më i dobishmi për diagnozën e një neoplazie periferike të pulmonit?

A) Radiografia standarte e toraksit.
B) Shintigrafia pulmonare.
C) CT scaner.
D) Bronkografia.

E) Bronkoskopia.
PS)C

Pyetja 394 V)1

Cila anemi hemolitike zakonisht nuk është normokromike?

A) Anemia hemolitike autoimune.
B) Hemoglobinuria paroksistike nokturne.
C) Talasemia major.
D) Ikteri hemolitik konstitucional.
E) Anemia hemolitike nga mangesi në enzima.
PS)C

Pyetja 395 V)1

Cili është përkufizimi më i saktë i termit 'keloid'?

A) Një rezultat i shumicës së plagëve të infektuara.
B) Faza fillestare e indit të granulacionit.
C) Një cikatricë hipertrofike.
D) Një tumor beninj me origjinë melanocitike.
E) Një tumor malinj i indit fibroz.
PS)C

Pyetja 396 V)1

Limfocitet B marrin pjesë në mbrojtjen e organizmit si

A) Pjesë e sistemit qelizor jospecifik.
B) Pjesë e sistemit mekanik të mbrojtjes.
C) Përgjegjës të sistemit humoral specifik të imunitetit.
D) Pjesë e sistemit qelizor specifik.
E) Përgjegjës të sistemit humoral të imunitetit të vonuar.
PS)C

Pyetja 397 V)1

Çfarë është shenja Blumberg?

A) Dhimbje e provokuar në pikën cistike.
B) Dhimbje e provokuar nga tërheqja e menjëhershme e dorës nga abdomeni.
C) Dhimbje e prodhuar nga kompresioni manual i abdomenit.
D) Dhimbje e provokuar në fosa iliake sisnistra.
E) Dhimbje e provokuar në regjionin apendikular.
PS)B

Pyetja 398 V)1

Cila nga ngjarjet e mëposhtme pason më shpesh një frakturë kostale?

A) Hemotoraksi.
B) Hemopneumotoraksi.
C) Pneumotoraksi.
D) Piopneumotoraksi.
E) Hemoperikardiumi.
PS)C

Pyetja 399 V)1

Gjuha si luleshtrydhe vërehet në

A) Skarlatinë.
B) Sindromin Down.
C) Anemi pernicioze.
D) Sprue celiake.
E) Pelagra.
PS)A

Pyetja 400 V)2

Cili nga variablat e mëposhtëm është më specifiku në diagnozën e podagrës?

A) Anamneza familjare.
B) Matja e uricemisë.
C) Llogaritja e fraksionit të ekskrecionit të acidit urik.
D) Radiografi e këmbëve, kaviljeve, gjurit.
E) Artrocenteza dhe observacionet e likidit sinovial nën dritë të polarizuar.
PS)E

Pyetja 401 V)1

Çfarë është një papulë?

A) Hiperemi e thjeshtë me vazodilatacion.
B) Hiperemi, vazodilatacion, infiltracion celular.
C) Dëmtim kapilar.
D) Degjenerim vaskular e akantolizë.
E) Degjenerim retikular me nekrozë.
PS)B

Pyetja 402 V)2

Cila nga zonat e mëposhtme të zemrës vaskularizohet nga ramus circumflexum i arteries koronare të majte?

A) Atriumi i majtë dhe ventrikuli i majtë.
B) Atriumi i djathtë e ventrikuli i majtë.
C) Atriumi i djathtë dhe ventrikuli i djathtë.
D) Apeksi i zemrës.
E) Ventrikuli i majtë dhe i djathtë.
PS)A

Pyetja 403 V)1

Shkaku kryesor i obstruksionit të rrugëve ajrore tek pacientët pa vetëdije është

A) Rënia e gjuhës posteriorisht.
B) Fleksioni i epiglotisit.
C) Bronkospazma.
D) Obstruksioni i salivës.
E) Kolapsi i trakesë.
PS)A

Pyetja 404 V)1

Qelizat e mesangiumit janë të lokalizuara

A) Në ansën e Henle.
B) Në arteriolën aferente në korpuskulin renal.
C) Në duktusin kolektor.
D) Në glomerulin renal.
E) Në kaliksin minor.
PS)D

Pyetja 405 V)3

Të gjitha rrethanat e mëposhtme karakterizojnë 'encefalitin herpetik ', përveç

A) Prekjes në mënyre tipike të lobeve oksipitale.
B) Prekjes së individëve të çdo lloj moshe.
C) Alterimeve të tipit nekrotik hemorragjik.
D) Manifestimit me çrregullime psikike.
E) Prekjes së subjekteve imunokompetente.
PS)A

Pyetja 406 V)1

Cili simptom nuk është tipik ne TIA?

A) Hemiplegjia.
B) Vertigo.
C) Afazia tranzitore.
D) Humbje e vetëdijes.
E) Ataksia.
PS)A

Pyetja 407 V)1

Cili nga parametrat e mëposhtëm të pranishëm në likidin ascitik shkakton diagnozën e peritonitit bakterial spontan?

A) Aspekti si qumësht.
B) Prania e 300 granulociteve neutrofile/mm3.
C) Prania e 300 leukociteve totale/mm3.
D) Prania e mbi 3g% të proteinave.
E) Aspekti hemorragjik.
PS)B

Pyetja 408 V)1

Cistet e Echinococcus granulosus gjënden tek njeriu më shpesh në

A) Gjak.
B) Hepar.
C) Intestin.
D) Muskulin e strijuar.
E) Lëkurë.
PS)B

Pyetja 409 V)1

Në rast hipertiroidizmi primar, përqëndrimi i TSH (hormon tireotrop) në gjak është

A) I rritur ose normal.
B) Në limitet e normës.
C) I pakësuar.
D) Fortësisht i rritur.
E) I rritur.
PS)C

Pyetja 410 V)2

Cilat anomali laboratorike vërehen shpesh në evolucionin e mononukleozës infektive?

A) Leukopenia e trombopenia.
B) Leukocitozë neutrofilike dhe rritje e transaminazave.

C) Leukocitozë limfocitike dhe rritje e transaminazave.
D) Leukopenia dhe rritja e bilirubinës.
E) Anemi dhe trombopeni.
PS)C

Pyetja 411 V)2

Cila nga këto shenja takohet vetëm në rast të një aneurizme aorte abdominale të pakomplikuar?

A) Vertigot.
B) Shok.
C) Dhëmbje abdominale akute.
D) Masë pulsuese abdominale.
E) Okluzion intestinal.
PS)D

Pyetja 412 V)1

Në insuficiencën kardiake të lehtë në të moderuar, trajtimi farmakologjik i preferuar konsiston në

A) Digitalizim me digoksinos e digitoksinë.
B) Medikamente ACE-inhibitore dhe diuretikët, në bashkëshoqërim me beta-bllokues.
C) Diuretikët kali-protektore.
D) Inotropet pozitive jodigitalike, ose amrinone ose enoximone.
E) Antagonistë beta-1 selektive, tipi i dobutaminës.
PS)B

Pyetja 413 V)1

Koha e protrombinës është e rritur në patologjinë e

A) Fibrinolizës primare.
B) Koagulimit intravaskular të diseminuar.
C) Trombopenisë.
D) Hipernatremisë.
E) Hipokloremisë.
PS)B

Pyetja 414 V)2

Cili nga agjentët e mëposhtëm mund të jetë shkaku i akalazisë?

A) Helicobacter pylori.
B) Schistosoma mansoni.
C) Tripanosoma cruzi.

D) Necatoer americanus.
E) Leishmania donovani.
PS)C

Pyetja 415 V)3

Mezotelioma pleurale mund të shfaqet me karakteristikat e mëposhtme, përveç

A) Opacitetit difuz të hemitoraksit.
B) Spostimit kontrolateral të mediastinit.
C) Versamentit hematik pleural.
D) Dispnesë.
E) Dhëmbjes difuze torakale.
PS)B

Pyetja 416 V)2

Në psikiatri termi 'melankoli' e merr origjinën

A) Nga greqishtja antike, që tregon një çrregullim të bilës.
B) Nga emri i një mali në afërsi të të cilit gjendej një i shenjtë i famshëm.
C) Nga emri i nje qyteti antik të famshëm të Anatolit.
D) Nga emri i një perëndie.
E) Nga një term gjeografik antik grek.
PS)A

Pyetja 417 V)1

Do të ketë një probabilitet të lartë për të zhvilluar cianozë një person i prekur nga

A) Edema e glotisit.
B) Intoksikacioni me oksid karboni.
C) Intoksikacioni me cianur kaliumi.
D) Anemia pernicioza.
E) Insuficienca renale.
PS)A

Pyetja 418 V)1

Diagnoza e hipertensionit esencial është

A) E sigurtë.
B) Përjashtuese.
C) Instrumentale.
D) Histologjike.
E) Serologjike.
PS)B

Pyetja 419 V)1

Mbrojtja imunitare specifike e mukozave karakterizohet nga prania e

A) Granulociteve neutrofile.
B) Granulociteve eozinofile.
C) IgM e IgG.
D) IgA sekretore.
E) Interleukina dhe kemokinat.
PS)D

Pyetja 420 V)1

Një trup i huaj endo-bronkial

A) Mund të trajtohet me terapi konservative.
B) Duhet të hiqet nën endoskop.
C) Duhet të hiqet me rrugë kirurgjikale.
D) Duhet të hiqet përmes endoskopit, vetëm në se është me thepa.
E) Duhet të hiqet në rruge kirurgjikale, vetëm nëse është me thepa.
PS)B

Pyetja 421 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë lidhur me reaksionet kutane si efekte anësore të medikamenteve?

A) Eritema fikse është forma më tipike.
B) Eritema fikse nuk recidivon në të njëjtin vend pas rimarrjes së medikamentit përgjegjës.
C) Antibiotikët beta-laktamike nuk japin asnjeherë reaksione.
D) Laksativët nuk japin asnjëhere reaksione.
E) Nga tipi i kuadrit klinik mund të arrish me siguri në medikamentin përgjegjës.
PS)A

Pyetja 422 V)1

Cili nga organet e mëposhtëm rezulton më shpesh i prekur nga proceset psikosomatike?

A) Koloni.
B) Veshi i mesëm.
C) Veshka.
D) Shpretka.
E) Testikuli.
PS)A

Pyetja 423 V)1

Mungesa e surfaktantit, që ndodh në sindromën infantile të distresit respirator, rezulton në

A) Një shtim të kompliancës.
B) Në stabilizimin e volumit alveolar.
C) Një shtim të forcës retraktuese të pulmoneve.
D) Një reduktim i diferencës alveolo-arteriale të PO2.
E) Një pakësim të forcës së filtracionit në kapilarët pulmonare.
PS)C

Pyetja 424 V)3

Cili është mekanizmi i veprimit të triciklikeve?

A) Stimulojnë sintezën e serotoninës.
B) Bllokojnë riabsorbimin e GABA.
C) Potencojnë transmetimin kolinergjik.
D) Nuk veprojnë në nivel sinaptik.
E) Bllokojnë rikapjen e serotoninës e noradrenalinës.
PS)E

Pyetja 425 V)2

Cilat janë komplikacionet kryesore të frakturës së collum femuri ?

A) Shiatalgjia.
B) Insuficienca venoze në anësitë inferiore.
C) Nekroza aseptike e kokës së femurit dhe pseudoartroza.
D) Rigiditet i kofshës.
E) Kofsha doloroze.
PS)C

Pyetja 426 V)1

Cili nga steroidet e mëposhtëm prodhohet më shumë se 90% nga testikuli?

A) Estradioli.
B) Dihidrotestosteroni.
C) Testosteroni.
D) Androstenedioni.
E) 17-OH-progesteroni.
PS)C

Pyetja 427 V)2

Cila nga të mëposhtmet nuk është nje diarre sekretore?

A) Diarrea nga infesioni nga vibrio cholerae.
B) Diarrea nga sindromi karcinoid.
C) Diarrea nga VIPoma.
D) Diarrea nga deficiti i disakaridazës.
E) Diarrea nga infeksioni nga Escherichia coli.
PS)D

Pyetja 428 V)1

Rinolalia e hapur shkakton

A) Hipoakuzi transmisioni.
B) Pneumoni ab ingetis.
C) Refluks nazal.
D) Obstruksion tubarik.
E) Pamundësi për të artikuluar fjalët.
PS)C

Pyetja 429 V)2

Cili është simptomi imediat i rupturës së një aneurisme aorte ?

A) Dhëmbja e papritur akute dhe/ose shok.
B) Melena.
C) Hematemezë.
D) Anuri.
E) Shfaqja e pulseve periferike.
PS)A

Pyetja 430 V)3

Në cilën nga këto rrethana haset linja e Ellis-Damoiseau ?

A) Pleurit eksudativ.
B) Hidropneumotoraks.
C) Pneumotoraks.
D) Perikardit.
E) Pneumoni lobare.
PS)A

Pyetja 431 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me hiperkolesteroleminë familjare homozigotë është i vërtetë?

A) Paraqet një pakesim të kapacitetit të heparit për të metabolizuar kolesterolin.
B) Mungojnë receptorët qelizorë për LDL që për pasojë akumulohen në gjak.

C) Paraqet një shtim të absorbimit të acideve yndyrore nga ana e epitelit intestinal.
D) Paraqet një pakësim të eleminimit të acideve yndyrore përmes rrugëve biliare.
E) Mungojnë receptorët për kolesterolin në nivel të hepatociteve.
PS)B

Pyetja 432 V)2

Cili nga hormonet e mëposhtëm është një oligopeptid?

A) Insulina.
B) Progresteroni.
C) Tridotironina.
D) Vazopresina (ADH).
E) Tireotropi.
PS)D

Pyetja 433 V)1

Cila nga këto sëmundje mund të ketë si komplikacion rupturën splenike?

A) Cirrhoza hepatike.
B) Sëmundja Fanconi.
C) Mieloma.
D) Mononukleoza infektive.
E) Anemia e May-Hagglin.
PS)D

Pyetja 434 V)1

Vena porta dërgon në mëlçi përqindjen e gjakut prej

A) 20%.
B) 50%.
C) 75%.
D) 20%.
E) 95%.
PS)C

Pyetja 435 V)1

Cili është agjenti etiologjik i pneumonisë jashtë-spitalore që haset më shpesh?

A) Legionela pneumofila.
B) Klebsiella pneumoniae.
C) Sreptokoku pneumonieae.
D) Stafilokoku.
E) Enterokoku.

PS)C

Pyetja 436 V)2

M.I.C tregon

A) Koncentrimin më të lartë të antibiotikut që lejon zhvillimin e variantit bakterial në antibiogramë.
B) Përqëndrimin minimal të antibiotikut që frenon zhvillimin e variantit bakterial në antibiogramë.
C) Sasinë e antibiotikut që vret variantin bakterial në kulturë.
D) Sasinë e antibiotikut që favorizon zhvillimin e variantit bakterial në antibiogramë.
E) Përqëndrimin minimal të mikrobeve të afta për të infektuar një kafshë laboratori.
PS)B

Pyetja 437 V)1

Në kushte normale pH i gjakut është

A) 7.50+/-0.02.
B) 7.40+/-0.02.
C) 7.30+/-0.02.
D) 7.20+/-0.02.
E) 7.10+/-0.02.
PS)B

Pyetja 438 V)1

Elementi diagnostik i erizipelës është

A) Dhëmbje e gjallë dhe shpuese.
B) Shënja e "shkallës".
C) Konsistenca e butë.
D) Aspekt nekrotik central.
E) Shënja e "krepitantes"
PS)B

Pyetja 439 V)2

Ku pozicionohet rruga e hyrjes së mediastinoskopisë?

A) Përmes sternumit.
B) Në hapesiren e III interkostale parasternale të djathtë.
C) Në hapesirën e II interkostale parasternale të majtë.
D) Në fossa jugulare.
E) Në lokalizim infra-ksifoid.
PS)D

Pyetja 440 V)1

Virilizimi mund të vërehet në rrethanat e

A) Hiperplazisë surenaliene.
B) Miksedemës.
C) Hipopituitarizmit.
D) Hipertiroidizmit.
E) Sindromit Turner.
PS)A

Pyetja 441 V)3

Përse në disa zona gjeografike është i përhapur aleli për beta-talaseminë?

A) Për shkak të prejardhjes gjenetike.
B) Sepse përmban një avantazh selektiv në klimat e ngrohta.
C) Sepse në heterozigotë ka avantazh selektiv duke u përballur me malarjen e përhapur në ato zona.
D) Sepse frenon përhapjen e sëmundjes në popullatë.
E) Sepse frenon infeksionin nga ana e virusit të malarjes në heterozigotet.
PS)C

Pyetja 442 V)1

Komplikacioni më i shpeshtë i një infarkti miokardi është

A) Ruptura e muskulit papilar.
B) Perikarditi hemorragjik.
C) Instalimi i nje aritmie.
D) Ruptura e septumit interventrikular.
E) Miokarditi.
PS)C

Pyetja 443 V)2

Prania në qarkullimin e IgM specifike ndaj një agjenti të caktuar sugjeron

A) Nje infeksion pre-ekzistent.
B) Një vaksinim të mëparshëm.
C) Një infeksion recent.
D) Një sëmundje kronike.
E) Një infeksion i sigurtë bakterial.
PS)C

Pyetja 444 V)1

Nga cili kombinim anormal kromozomik karakterizohet sindromi Klineferter?

A) XO.
B) Trisomi 15.
C) Delecioni i krahut te shkurtër të kromozomit 18.
D) XXY.
E) XYY.
PS)D

Pyetja 445 V)2

Cila nga motivacionet e mëposhtme nuk është percaktuese për rekomandimin e analizave laboratorike?

A) Konfirmim i një dyshimi klinik.
B) Formulim i një prognoze.
C) Përjashtim i një diagnoze.
D) Konfirmim i një diagnoze.
E) Kërkesa e pacienti.
PS)E

Pyetja 446 V)1

Një karcinomë është:

A) Një neoplazi beninje.
B) Një proces inflamator.
C) Një neoplazi epiteliale malinje.
D) Një neoplazi mezenkimale malinje.
E) Një infeksion purulent.
PS)C

Pyetja 447 V)1

Të gjithë medikamentet e mëposhtëm përdoren në terapinë e astmës, përveç

A) Terbutalinës.
B) Teofilinës.
C) Kromoglikatit të natriumit.
D) Neostigminës.
E) Prednisonit.
PS)D

Pyetja 448 V)3

Leucemia akute me qeliza T e adultit bashkëshoqërohet me

A) Citomegalovirus.
B) HTLV-1.
C) Parvovirus.
D) Adenovirus.
E) Virus Epstein-Barr.
PS)B

Pyetja 449 V)2

Cili lezion elementar karakterizon pemfigus?

A) Papula me lokalizim intraepidermik.
B) Papula me lokalizim subepidermik.
C) Bula me lokalizim intraepidermik.
D) Bula me lokalizim subepidermik.
E) Bula me lokalizim subkutan.
PS)D

Pyetja 450 V)1

Osteoporoza e tipit I është e korreluar me deficiencën e hormonit

A) Kalcitoninë.
B) Testosteroni.
C) Estrogeni.
D) Parathormoni.
E) Tireotropi.
PS)C

Pyetja 451 V)1

Cili nga produktet e mëposhtëm, që bëjnë pjesë në ushqime, nuk ka vlerë ushqimore të rëndësishme?

A) Celuloza
B) Glikogeni
C) Fruktoza
D) Lecitina
E) Kolesteroli
PS)A

Pyetja 452 V)1

Përkufizohet 'anginë e efortit'

A) Angina de novo.

B) Angina stabile.
C) Angina Prinzmetal.
D) Angina e qetësisë.
E) Angina me ngarkesë variabile.
PS)B

Pyetja 453 V)1

Në ikterin obstruktiv rezulton i rritur

A) Albuminemia.
B) Fosfataza alkaline.
C) Y-globulinemia.
D) Urobilina.
E) Amoniemia.
PS)B

Pyetja 454 V)1

Cili është nënkuptimi i termit 'seropozitiv' në infeksionin nga HIV?

A) Subjekt që ka kontakt me infeksionin.
B) Subjekt i sëmurë me AIDS.
C) Subjekt i shëruar nga infeksioni.
D) Subjekt që është i mbrojtur nga kontakti me infeksionin.
E) Subjekt i ekzaminuar në periudhën e inkubacionit.
PS)A

Pyetja 455 V)2

Kohëzgjatja mesatare e episodit depresiv të patrajtuar është

A) 1 muaj
B) 6 muaj
C) 12 muaj
D) 2 vjet
E) 3 vjet
PS)B

Pyetja 456 V)1

Nga dallojnë grupet e gjakut A, B, AB, O?

A) Disa kanë një proteinë në siperfaqet e eritrociteve ndërsa të tjerët jo .
B) Kanë rezidua karbohidratesh të lidhura me molekulat lipidike që dalin nga membrana e eritrocitit.
C) Kanë sekuenca të ndryshme DNA-je për një proteinë esenciale.

D) Numri i atomeve të hekurit në grupet hemo ndryshon nga një grup në tjetrin.
E) Forma e eritrociteve ndryshon nga nje grup gjaku në tjetrin.
PS)B

Pyetja 457 V)1

Cilat janë qelizat protagoniste të inflamacionit kronik ?

A) Monocitet, makrofaget, limfocitet e fibroblastet
B) Limfocitet e granulocitet
C) Fagocitet mononukleare e polimorfonukleare
D) Qelizat endoteliale
E) Qelizat endoteliale e fibroblastet
PS)A

Pyetja 458 V)2

Duktuset kolektore të veshkës

A) Mund të sekretojnë në mënyre aktive molekula uji në urinë.
B) Janë përgjegjës për shumicën e riabsorbimit të ujit që vjen në veshka.
C) Janë përgjegjës të osmolaritetit final të urinës
D) Janë shndëruar të papërshkueshëm nga uji përmes veprimit të hormonit anti-diuretik.
E) Sekretojnë në mënyre aktive urenë.
PS)C

Pyetja 459 V)3

Sëmundja e Menetrier karakterizohet nga

A) Disfagia.
B) Fistula intestinale rekurente.
C) Hipertrofia gjigande e plikave gastrike.
D) Divertikuloza.
E) Atrofia gastrike.
PS)C

Pyetja 460 V)1

Kreatin fosfokinaza (CPK) katalizon

A) Formimin e fosfokreatininës nga kreatina dhe ATP-ja.
B) Formimin e fosfokreatinës nga kreatina dhe acidi fosforik.
C) Formimin e kreatininës.
D) Formimin e kreatininës dhe acidit fosforik nga fosfokreatina.
E) Formimin e fosfokreatinës.
PS)A

Pyetja 461 V)2

Cila nga këto simptoma nuk është karakteristike për një çrregullim të sjelljes?

A) Fuga
B) Thyerja e rregullave
C) Agresionet
D) Gënjeshtrat
E) Tiket
PS)E

Pyetja 462 V)3

Karcinoma prostatike metastazon më shpesh

A) Në skelet.
B) Në surenale.
C) Në mëlçi.
D) Në mushkëri.
E) Në tru.
PS)A

Pyetja 463 V)1

Dimensionet e aksoneve janë të ndryshme në pjesë të ndryshme të sistemit nervor. Cila është gjatësia maksimale që mund të arrijnë?

A) Jo më shumë se një nanometër
B) 1-100 mikron
C) 1-10 milimetra
D) Decimetra
E) Deri në 100 centrimetra e më tepër
PS)E

Pyetja 464 V)1

Manitoli është

A) Një antikoagulant oral.
B) Një diuretik osmotik.
C) Një beta-bllokues.
D) Një kalci-bllokues.
E) Një antidot që kelaton plumbin.
PS)B

Pyetja 465 V)1

Një astrupogramë e dhënë: pH=7.41, pCO2=40.3, pO2=106, nënkupton

A) Insuficiencë respiratore akute normokapnike të kompensuar.
B) Insuficiencë respiratore kronike normokapnike te pakompensuar.
C) Astrupogramë në limitet e normës.
D) Acidozë respiratore e kompensuar.
E) Alkalozë respiratore e kompensuar.
PS)C

Pyetja 466 V)2

Hemikrania mund të karakterizohet nga të gjitha simptomat e mëposhtme, përveç

A) Alterimeve të pamjes.
B) Shenjës së Kernig pozitiv.
C) Anoreksisë.
D) Nauzesë.
E) Dhëmbjes në fillim pulsante.
PS)B

Pyetja 467 V)2

Cila nga pohimet e mëposhtëm lidhur me sklerozën multiple është e gabuar?

A) Prek vetëm sistemin nervor qëndror.
B) Incidenca është shumë më e lartë në zonat me temperaturë kontinentale tropikale.
C) Aspekti patologjik karakteristik është alteracioni i substancës gri.
D) Diagnoza mund të bëhet nga potencialet e evokuara vizive.
E) Janë gjetur shpesh nivele të larta të IgG në likidit cerebro-spinal.
PS)C

Pyetja 468 V)1

Çfarë rroli kanë muskujt sternokleidomastoid dhe skalenë në respiracion?

A) Inspiratorë e ekspiratorë ndihmës
B) Nuk ndërhyjnë në respiracion
C) Inspiratorë kryesorë
D) Inspiratorë ndihmës
E) Ekspiratorë ndihmës
PS)D

Pyetja 469 V)3

Cili nga këto ekzaminime ka sensibilitetin më të lartë për diagnozën e Lupusit Eritematoz të diseminuar?

A) Antikorpet antinukleare
B) Kërkimi i qelizave LE
C) Testi i fiksimit të komplementit
D) Dye test
E) Reaksioni i Paul Tunnel
PS)A

Pyetja 470 V)2

Të gjitha janë efekte anësore të rëndësishme të ciklosporinës, me përjashtim të

A) Nefrotoksicitetit.
B) Hiperkaliemisë.
C) Hipertensionit.
D) Hepatotoksicitetit.
E) Alopecisë.
PS)E

Pyetja 471 V)1

Shkaku më i shpeshtë i iktusit kardio-embolik është

A) Prolapsi i valvulës mitrale.
B) Stenoza aortës.
C) Fibrilacioni atrial jo-valvular.
D) Miksoma atriale.
E) Tetralogjia Fallot.
PS)C

Pyetja 472 V)1

Me luksacion nënkuptohet

A) Një laçeracion ligamentoz total.
B) Një humbje e përkohshme e raporteve artikulare.
C) Një frakturë artikulare.
D) Një humbje permanente e raporteve artikulare.
E) Një frakturë artikulare e shoqëruar me lezion kapsulo-ligamentoz.
PS)D

Pyetja 473 V)1

Cila nga situatat e mëposhtme nuk hyn midis atyre në të cilat administrimi i ACE-inhibitorëve mund të induktojë insufiçiencën renale akute?

A) Pacient anefritik

B) Pacient i moshuar me insufiçiencë kardiake kongjestive
C) Stenoza bilaterale e arteries renale
D) Dizanteria akute me dehidratim
E) Stenoza e arteries renale tek pacientë me një veshkë
PS)A

Pyetja 474 V)2

Tek një pacient i dehidratuar uji korporal duhet të rikonstituohet nëpërmjet një perfuzioni endovenoz të

A) Ujit të distiluar.
B) Solucionit të NaCl 0.9%.
C) Solucionit hipertonik të albuminës.
D) Solucionit NaCl 5%.
E) Soluciont glukozë 10%.
PS)B

Pyetja 475 V)1

Episodet hemorragjike mund të shoqërohen me një defiçit të

A) Prekalikreinës.
B) Proteinës S.
C) Faktorit XII.
D) Faktorit VIII.
E) Heparin-sulfatit me peshë të lartë molekulare.
PS)D

Pyetja 476 V)1

Cili është trajtimi i zgjedhur i pemfigus?

A) Antibiotikët
B) Vazodilatatorët
C) Vazokonstriktorët
D) Antiprotozoarët
E) Kortikosteroidet
PS)E

Pyetja 477 V)1

Çfarë nënkupton testi ELISA?

A) Një provë imuno-enzimatike
B) Nje test radio-imunologjik
C) Një provë hemoaglutinimi pasiv.

D) Një ngjyrim i mikroskopisë elektronike.
E) Një metodë për llogaritjen e ngarkesës virale
PS)A

Pyetja 478 V)1

Trombocitopatia përkufizohet si

A) Reduktim i trombociteve.
B) Deficit i adezionit ose agregimit trombocitar.
C) Shtim i numrit të trombociteve.
D) Difekt i prodhimit të trombociteve.
E) Shtim i degradimit trombocitar.
PS)B

Pyetja 479 V)2

Cila është enzima që mungon në zonën glomerulare të korteksit surenal?

A) 21-hidroksilaza
B) 17-alfa-hidroksilaza
C) 11-hidroksilaza
D) 3-holo-dehidrogenaza
E) Desolaza
PS)B

Pyetja 480 V)2

Çfare është fusha e vetëdijes?

A) Tërësia e kujtimeve
B) Momenti që paraprin rizgjimin
C) Shtrirja e konfabulacioneve
D) Vetëdija e fushës vizive
E) Tërësia e përmbajtjes aktuale të vetëdijes në një moment të dhënë
PS)E

Pyetja 481 V)1

Përmes placentës kalojnë

A) IgM-ja.
B) IgG-ja.
C) Imunokomplekset me shumicë antigenësh.
D) Imunokomplekset me shumicë antikorpesh.
E) Imunokomplekset me komplement të fiksuar.
PS)B

Pyetja 482 V)1

Për kërkimin e metastazave pulmonare, ekzaminimi më i përshtatshëm është

A) CT skaneri.
B) Rezonanca magnetike.
C) Angiografia.
D) Ekografia.
E) Shintigrafia.
PS)A

Pyetja 483 V)1

Si quhet një ankth i fortë i padominuar dhe i pamotivuar nga situatat, veprimet apo objektet?

A) Frikë
B) Fobi
C) Obsesion
D) Pseudohallucinacion
E) Delirium
PS)B

Pyetja 484 V)1

Kolapsi pulmonar mund të verifikohet në të gjitha rrethanat e mëposhtme, përveç

A) Pneumotoraksit.
B) Plagës pulmonare.
C) Obstruksionit bronkial.
D) Plagës parietale.
E) Hemotoraksit.
PS)C

Pyetja 485 V)2

Çfarë pozicioni zënë qelizat plazmatike në popullaten limfoide?

A) Janë progenitorë të limfociteve supresore
B) Marrin origjinën nga limfocitet T në nivel të timusit
C) Janë stadi i maturuar terminal i linjës B limfocitare
D) Janë të afta të diferencohen nën stimujt antigenikë.
E) Proliferojnë nën veprimin e PHA(PhytoHemagglutinin)
PS)C

Pyetja 486 V)1

Në kushte normale, kohëzgjatja e intervalit P-Q të EKG-së së një adulti është rreth

A) 0.12-0.20 sekonda.
B) 0.18-0.24 sekonda.
C) 0.06-0.08 sekonda.
D) 0.10-0.12 sekonda.
E) 0.24-0.30 sekonda.
PS)A

Pyetja 487 V)1

Biodisponibiliteti i një medikamenti

A) Është matja e fraksionit të dozës së administruar që arrin qarkullimin sistemik.
B) Është proporcional me efikasitetin.
C) Është në përpjestim të drejtë me dozën e administruar.
D) Nuk varion në funksion nga rruga e administrimit të përdorur.
E) Është i ulur për medikamentet më pak të fuqishëm.
PS)A

Pyetja 488 V)1

Roli kryesor fiziologjik i mioglobinës është

A) Të transportojë O2 në muskul.
B) Të magazinojë informacionin genetik.
C) Të kontraktojë muskujt.
D) Të magazinojë O2.
E) Të transportojë glukozën.
PS)D

Pyetja 489 V)2

Çfarë nënkuptojmë me tumor Pancoast?

A) Tumor i kufizuar në hilusin pulmonar.
B) Tumor me prekje të nervit laringeal recurens.
C) Tumor me zona likuidifikimi në brendësi.
D) Tumor që ka origjinën në sulkusin superior me prekje të pleksit brakial.
E) Tumor me metastaza cerebrale unike.
PS)D

Pyetja 490 V)1

Rritja e IgE serike mund të haset më shpesh në

A) Leuceminë mieloide kronike.

B) Aneminë hemolitike nga difekt i PK-së.
C) Favizëm.
D) Parazitozë.
E) Saturnizëm.
PS)D

Pyetja 491 V)2

Nefropatia që shkakton më shpesh IRK është

A) Nefropatia diabetike.
B) Nefropatia intersticiale.
C) Nefropatia glomerulare.
D) Nefropatia vaskulare.
E) Nefropatia tubulare.
PS)A

Pyetja 492 V)1

Cila simptomë okulare vërehet në miasteni?

A) Keratitis.
B) Konjuktivitis.
C) Ptoza palpebrale.
D) Entropioni.
E) Ektropioni.
PS)C

Pyetja 493 V)1

Të gjitha shenjat e mëposhtme janë pjesë e sëmundjes së Cushing, përveç

A) Policitemisë.
B) Facies lunaris.
C) Eozinofilisë.
D) Diabetit.
E) Osteoporozës.
PS)C

Pyetja 494 V)1

Cili është presioni i oksigjenit që përmbahet normalisht në ajrin e ambientit?

A) Rreth 7%
B) Rreth 12 %
C) Rreth 40%
D) Rreth 22 %

E) Rreth 30%
PS)D

Pyetja 495 V)3

Tek një pacient me kuadër klinik të akromegalisë dhe nivele të GH=4.8ng/ml, mënyra më e thjeshtë për të vendosur nëse ka akromegali aktive është

A) Realizimi i rezonancës magnetike të sela turcica.
B) Dozimi i IGF-1.
C) Praktikimi i testit të TRH.
D) Praktikimi i testit me bromkriptinë.
E) Praktikimi i testit me somatostatinë.
PS)B

Pyetja 496 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me output-in kardiak është i gabuar?

A) Reduktohet në pozicion në këmbë.
B) Rritet për një gradë të ulët të hipoksisë.
C) Rritet në insuficiencën kardiake.
D) Rritet në ethe
E) Është rreth 4-6 litra.minutë tek adulti mesatar
PS)C

Pyetja 497 V)2

Quhen izotope, bërthamat që diferencohen mes tyre nga numri i

A) Neutroneve dhe protoneve.
B) Vetëm protoneve.
C) Elektroneve dhe protoneve.
D) Vetëm neutroneve.
E) Neutroneve dhe elektroneve.
PS)D

Pyetja 498 V)1

Të gjitha rezultatet klinike laboratorike të mëposhtme hedhin dyshime për diagnozën e sindromës Zollinger-Ellison, përveç

A) Pozitivitetit të testit respirator me ureazë.
B) Nivelit të shtuar të gastrinës serike.
C) Ulcerave multiple gastro-intestinale.
D) Pozitivitetit të testit të stimulimit të sekretinës.
E) B+D

PS)A

Pyetja 499 V)1

Nga cila arterie merr origjinën arteria silviane?

A) Nga arteria cerebrale anteriore.
B) Nga arteria pulmonare.
C) Nga arteria temporale.
D) Nga arteria vertebrale.
E) Nga arteria karotide.
PS)E

Pyetja 500 V)2

Në një atak astmatik ekspektorati i prodhuar në mënyrë tipike mund të përmbajë

A) Korpuskulat e Mallory.
B) Qelizat e Reed-Sternberg.
C) Spiralet e Curschmann.
D) Eritrocitet.
E) Qelizat mezoteliale.
PS)C

Pyetja 501 V)1

Cili nga medikamentet e mëposhtme antituberkulare ka si efekt kolateral shfaqjen e çrregullimeve vizive?

A) Etambutoli
B) Izoniazidi
C) Streptomicina
D) Pirazinamide
E) Rifampicina
PS)A

Pyetja 502 V)2

Tek cila kafshë prodhohen oocistet e Toxoplasma gondii?

A) Papagalli
B) Macja
C) Qeni
D) Gjedhët
E) Derri
PS)B

Pyetja 503 V)2

Cili është ekzaminimi i zgjedhur për studimin e neoplazive retroperitoneale?

A) Urografia
B) CT skaner
C) Aortografia
D) Retropneumoperitoneum
E) Kiazma optike
PS)B

Pyetja 504 V)3

Tumori më i shpeshtë i gjëndrës parotis është

A) Karcinoma adenocistike.
B) Cistadenolimfoma.
C) Adenoma pleomorfe.
D) Karcinoma duktale.
E) Karcinoma mukoepidermoide.
PS)C

Pyetja 505 V)2

Cilët janë efektet kryesore të rrezatimit jonizues?

A) Somatike
B) Gjenetike
C) Somatike dhe gjenetike
D) Konstipacioni
E) Pakësimi i eritrosedimentit
PS)C

Pyetja 506 V)1

Cilat teste laboratorikë janë të pritshme në diagnozën e pankreatitit akut?

A) Bilirubinemia
B) Fosfataza alkaline
C) Amilaza dhe lipaza
D) Urobilinogeni
E) Pankreozimia
PS)C

Pyetja 507 V)2

Vdekja cerebrale nënkupton

A) Gjëndje vegjetative persistente.
B) EEG izoeletrike.
C) Glasgow Coma Scale e barabartë me 3.
D) Prania e Babinskit bilaterale.
E) Koma të zgjatur.
PS)B

Pyetja 508 V)3

Në komën uremike është i pranishëm çrregullimi i

A) Të vjellave.
B) Hiperglicemisë.
C) Urobilinurisë.
D) Poliglobulisë.
E) Dhëmbjes abdominale.
PS)A

Pyetja 509 V)2

Lezionet e morbus celiake takohen në nivel

A) Të stomakut.
B) Vetëm të jejunumit.
C) Të duodenit dhe jejunumit.
D) Të kolonit
E) Vetëm të duodenit.
PS)C

Pyetja 510 V)2

Cili nga aminoacidet e mëposhtëm përmban një grup sulfhidrik?

A) Cisteina
B) Ascidi aspartik
C) Alanina
D) Prolina
E) Tirozina
PS)A

Pyetja 511 V)1

Rritja e perimetrit kranial mund të jetë një shenjë e

A) Spasticitetit.
B) Epilepsisë.

C) Vuajtjes cerebrale
D) Hidrocefalisë.
E) Sëmundjeve neuromuskulare.
PS)D

Pyetja 512 V)1

Koha e protrombinës influencohet nga

A) Pakësimi i numrit të trombociteve.
B) Shtimi i faktorit anti-heparinik.
C) Mungesa e faktorit të VII.
D) Mungesa e faktorit të VIII.
E) Mungesa e faktorit të IX.
PS)C

Pyetja 513 V)3

Në lidhje me pneumotoraksin hipertensiv, cili pohim është i gabuar?

A) Verifikohet kur një sasi ajri futet në hapësirën pleurale në çdo inspirim për të dalë më pas në ekspiracionin e rradhës.
B) Përbën një urgjencë kirurgjikale.
C) Dhëmbje torakale, polipnea, cianozë, turgor i jugulareve janë shënja tipike edhe pse jo gjithnjë janë të pranishme.
D) Inserimi në urgjencë i një ageje me kalibër të madh në kavitetin pleural çon në transformimin e një pneumotoraksi hipertensiv në pneumotoraks jo-hipertensiv, formë më pak e rëndë në planin respirator dhe hemodinamik.
E) Shtimi i presioneve intrapleurale provokon kolapsin pulmonar dhe më pas zhvendosjen e mediastinit në anën e kundërt.
PS)A

Pyetja 514 V)3

Të gjitha të mëposhtmet klasifikohen si spondiloartropati, përveç

A) Artritit psoriatik.
B) Artritit reaktiv.
C) Sëmundjes së reiter.
D) Polimialgjisë reumatike.
E) Spondilitit ankilozant.
PS)D

Pyetja 515 V)2

Kur aktivizohen, secili prej faktorëve të mëposhtëm të koagulimit veprojnë si një serinë-protezë, përveç

A) II.
B) VII.
C) VIII.
D) IX.
E) XI.
PS)C

Pyetja 516 V)1

Në insuficiencën e aortës kemi një aspekt ekokardiografik të

A) Hipertensionit pulmonar.
B) Mungesës së kordave tendinoze.
C) Dilatimit atrial të majtë.
D) Dilatimit ventrikular të djathtë.
E) Flutering të lembos anteriore të valvulës mitrale.
PS)E

Pyetja 517 V)1

Hapi i parë për diagnozën e Policitemisë Vera është

A) Të përcaktohet masa e eritrociteve dhe volumit plazmatik.
B) Të përcaktohen nivelet serike të eritropoetinës.
C) Të realizohet një ekografi renale.
D) Të realizohet një astrupogramë.
E) Të përcaktohet fosfataza alkaline leukocitare.
PS)A

Pyetja 518 V)2

Një i ri 25 vjeçar vdes papritmas. Një ekzaminim toksikologjik evidenton nivele të larta të amfetaminës. Cila nga alternativat e mëposhtme është gjetja anatomo-patologjike më e mundëshme?

A) Infarkti i miokardit.
B) Miokardit bakterial.
C) Rupturë e aortës.
D) Insuficiencë valvulare akute.
E) Tamponada e zëmrës.
PS)A

Pyetja 519 V)2

Cili pohim është i saktë?

A) Ekzistojnë vetëm gjëndje trombofilike kongenitale.
B) Lupusi eritematoz i diseminuar bashkëshoqërohet gjithnjë me një gjëndje trombofilike.
C) Lupusi eritematoz shpesh bashkëshoqëron praninë e antikorpeve antifosfolipidike që predispozojnë për trombozë.
D) Lue përfaqëson një gjëndje trombofilike.
E) Mutacioni i Leiden është një alterim i proteinës C të koagulimit.
PS)C

Pyetja 520 V)1

Hiperketonemia vërehet në rrethanën e

A) Hemikranisë.
B) Konstipacionit.
C) Atakut të angina pectoris.
D) Dispepsisë hipopeptike.
E) Atrofisë akute të verdhë.
PS)E

Pyetja 521 V)3

Terapia e pneumonisë jashtë-spitalore

A) Është pothuajse gjithnjë empirike ose racionale.
B) Nuk udhëhiqet nga një diagnozë etiologjike.
C) Udhëhiqet gjithnë nga një diagnozë etiologjike.
D) Udhëhiqet nga një ekzaminim radiologjik.
E) Konsiston në përdorimin e cefalosporinave me spekter të gjerë veprimi.
PS)A

Pyetja 522 V)2

Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk bën pjesë në sindromën hiperosmolare jo-ketozike?

A) Glicemia>600mgdl.
B) Acidet yndyrore plazmatike të rritura.
C) Shfaqje e mundëshme pas infeksioneve të rënda.
D) Incidenca e lartë tek personat e moshuar.
E) Laktatet e ulura.
PS)E

Pyetja 523 V)1

Sasia totale e gjakut tek njeriu adult është rreth

A) 2% e peshës trupore.
B) 4% e peshës trupore.

C) 8% e peshës trupore.
D) 10% e peshës trupore.
E) 15% e peshës trupore.
PS)C

Pyetja 524 V)2

Në lidhje me pneumotoraksin hipertensiv, të gjitha pohimet janë të gabuara me përjashtim të:

A) Shoqërohet me hipertension arterial.
B) Kërkon dekompresionin imediat.
C) Nuk provokon alteracione të respiracionit.
D) Shkaktohet nga versamentet pleurale.
E) Kërkon vendosjen e një sonde nazo-gastrike.
PS)B

Pyetja 525 V)2

Një komplikacion i rëndë i korrigjimit tepër të shpejtë të hipernatremisë është

A) Edema cerebrale.
B) Mielinoliza pontine centrale.
C) Hemorragjia subaraknoidale.
D) Hemorragjia subdurale.
E) Hemorragjia intracerebrale.
PS)A

Pyetja 526 V)1

Noradrenalina dhe adrenalina janë

A) Dy hormone të prodhuara nga shtresa amedulare e surenales.
B) Prekursorë të hormonit dopaminë.
C) Ndërmjetës metabolikë në sintezën e tirozinës.
D) Dy katekolamina me veprim hormonal të prodhuara nga shtresa medulare e surenales.
E) Dy polipeptide të perfshirë në katabolizmin e grupeve aminikë.
PS)D

Pyetja 527 V)2

Agjenti etiologjik i epiglotitit akut është

A) Bacili i Plaut-Vincent.
B) Mycoplazma pneumonie.
C) Pseudomonas aeruginoza.
D) Hemofilus influenze.
E) Stafilokoku.

PS)D

Pyetja 528 V)2

Cila nga këto shenja është patognomonike për glomerulonefritin me lezione minimale?

A) Proteinuria selektive
B) Mikrohematuria
C) Hiperazotemia
D) Leukocituria
E) Cilindruria
PS)A

Pyetja 529 V)1

Çfarë është një neoplazi?

A) Një proliferim i qelizave tumorale.
B) Një proliferim i qelizave normale.
C) Një proliferim i qelizave tumorale e normale.
D) Një proliferim i qelizave hiperplazike.
E) Një proliferim i qelizave tumorale beninje.
PS)A

Pyetja 530 V)1

Në fenilketonuri vërehet një shtim hematik i

A) Yriptofanit.
B) Glicinës.
C) Leucinës.
D) Homocisteinës.
E) Fenilalaninës.
PS)E

Pyetja 531 V)2

Reaksioni akrozomial

A) Është një fazë e spermatogjenezës.
B) Është një fazë e spermiohistogjenezës.
C) Është një fazë e oogjenezës.
D) Është një fazë e fekondimit.
E) Është një fazë e zhvillimit të embrionit.
PS)D

Pyetja 532 V)3

Cili nga tipet qelizorë përfaqëson targetin kryesor të veprimit farmakologjik të ciklosporinës dhe të tacrolimus?

A) Qelizat dentritike
B) Limfocitet B
C) Limfocitet T
D) Makrofaget
E) Qelizat NK
PS)C

Pyetja 533 V)2

Cila nga alternativat e mëposhtme është një funksion fiziologjik i rëndësishëm i lëngut biliar?

A) Konjugimi me toksikët në mënyrë favorizimin e ekskrecionit të tyre.
B) Lejon eleminimin e produkteve të breakdown të hemoglobinës.
C) Lehtësimi i absorbimit të yndyrnave ushqimore.
D) Lejimi i absorbimit të vit B12.
E) Mbajtja e një pH të përshtatshëm intestinal.
PS)C

Pyetja 534 V)1

Nga e kanë origjinën arteriet koronariene?

A) Nga aorta.
B) Nga arteria pulmonare.
C) Nga arteria subklavia.
D) Nga sinusi koronarien.
E) Nga ventrikuli i majtë.
PS)A

Pyetja 535 V)2

Diagnoza e abscesit subfrenik saktësohet më tepër me

A) Pneumoperitoneum.
B) Radiografi direkte të abdomenit.
C) CT skaner.
D) Kolangiografi.
E) Ekzaminim objektiv.
PS)C

Pyetja 536 V)3

Cili infeksion kongjenital mund të dyshohet tek një neonat me mikrocefali, kalcifikime cerebrale, korioretinit?

A) VZV
B) HSV
C) Toksoplazmozë
D) Rubeolë
E) CMV
PS)C

Pyetja 537 V)1

Aktiviteti i qëndrave respiratore ndikohet më shumë nga

A) Hiperkapnia.
B) Hipoksemia.
C) Lëvizjet e paretit torakal.
D) Alkaloza.
E) Acidoza.
PS)A

Pyetja 538 V)3

Kur përdoret minoxidil në solucion 2%?

A) Infeksione nga Gram-pozitivët
B) Psoriaza pustuloze
C) Akne vulgaris
D) Alopecia androgenica
E) Alopecia cikatriciale
PS)D

Pyetja 539 V)2

Aldosteroni

A) Sekretohet nga aparati juxtaglomerular.
B) Sekretohet në sasi të madhe kur shtohet përqëdrimi i likidit ekstraqelizor.
C) Shton riabsosbimin e fosfatit në nefronin distal.
D) Sktivizon riabsorbimin e natriumit në nefronin distal.
E) Sekretohet si përgjigje ndaj një hormoni hipofizar.
PS)D

Pyetja 540 V)1

Acidi klavulanik paraqet karakteristikën e

A) Spektrit të gjerë antibakterial.
B) Rezistencës ndaj beta-laktamazës.
C) A+B.
D) Specifitetit për mikrobet gram pozitive.
E) Specificitetit për mikrobet gram negative.
PS)B

Pyetja 541 V)1

Tumori renal më i shpeshtë është

A) Tumori Wilms.
B) Karcinoma me qeliza të qarta.
C) Adenoma.
D) Leiomioma.
E) Leiomiosarcoma.
PS)B

Pyetja 542 V)1

Përsa i përket astmës bronkiale, cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar?

A) Shumë bronke të mesme dhe të vogla janë të mbushura me mukus viskoz.
B) Membrana bazale në epitelin alveolar është e holluar.
C) Në ekskrete vërehen spiralet e Curshmann.
D) Në rastet tipike hasen kristalet e Charcot-Leiden.
E) Karakterizohet nga dispnea, kolla dhe sibilanca në auskultacion.
PS)B

Pyetja 543 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me urinë e zgjatur nuk është i saktë?

A) Neoglukogjeneza hepatike është veçanërisht aktive dhe e stimuluar nga glukokortikoidet.
B) Cikli i Krebsit është i ngadalësuar me pakësim sekondar të sintezës së trupave ketonike.
C) Truri adaptohet të përdorë edhe trupat ketonike.
D) Përqëndrimi i proteinave plazmatike pakësohet duke provokuar kështu mbajtjen e ujit në inde (edema e urisë).
E) Lipoliza është e përshpejtuar.
PS)B

Pyetja 544 V)3

Cili është ekzaminimi i zgjedhur për diagnozën e displazisë kongenitale të kofshës?

A) Ekzmainimi radiografik
B) Artrografia

C) Rezonanca
D) Ekografia
E) CT skaner
PS)D

Pyetja 545 V)2

Cila nga rrethanat e mëposhtme shkakton hiperkaliemi?

A) Acidoza
B) Hiperkalçemia
C) Alkaloza respiratore
D) Alkaloza metabolike
E) Të vjellat
PS)A

Pyetja 546 V)1

Trombocitemia esenciale dhe policitemia vera janë

A) Sindromë mielo-displazike
B) Sindromë mieloproliferative kronike
C) Aplazi medulare
D) Sëmundje sekondare ndaj inflamacionit kronik
E) Shpesh shoqërohen me imunodefiçiencë.
PS)B

Pyetja 547 V)2

Cila nga alternativat e mëposhtme është një vaskulitis i vazave të vogla me interesim kutan

A) Arteriti Takayasu
B) Poliangeiti mikroskopik
C) Sëmundja e Wegener
D) Vaskuliti krioglobulinemik
E) Dermatomioziti
PS)D

Pyetja 548 V)1

Arteria koronare interventrikulare anteriore e merr origjinën e saj

A) Në vazat marginale obtuze.
B) Në vazat marginale akute.
C) Në vazat septale.
D) Në arterien e nyjes sinusale.
E) Në arterien e nyjes atrio-ventrikulare.

PS)C

Pyetja 549 V)1

Cila është shënja indirekte e një kalkuli urinar në ekografi?

A) Formacione ekzogene
B) Hija akustike
C) Dilatacion i rrugëve urinare në mënyrë retrograde
D) Radio-opaciteti
E) Radiotransparenca
PS)C

Pyetja 550 V)3

Alterimi karakteristik i ezofagut, në dekursin e sklerozës sistemike është

A) Devijimi i saj në disa drejtime.
B) Evidentimi i divertikulit me traksion.
C) Identifikimi i divertikulit me pulsion.
D) Hipotonia dhe rigiditet të pareteve dhe dilatimi i tij.
E) Zbrazje e vonuar nga spazma kardiale.
PS)D

Pyetja 551 V)2

Të gjithë hormonet

A) Janë steroide që ushtrojnë veprimin e tyre në distancë.
B) Ndërveprojnë me receptorët e vendosur mbi membranën plazmatike.
C) Përbëjnë të ashtuquajturit 'mesazheret dytësore' në brendësi të qelizës bersaglio.
D) Mund të veprojnë në përqëndrime tepër të ulëta.
E) Induktojnë proliferimin dhe diferencimin qelizor.
PS)D

Pyetja 552 V)1

Për mashkullin adult, nevoja e përditshme në hekur është

A) Më e madhe se sa për gratë.
B) 1 mg.
C) 10mg.
D) E njëjtë me gratë.
E) Në varësi të aktivitetit fizik.
PS)C

Pyetja 553 V)1

Cilat qeliza janë target i medikamenteve imunosupresore?

A) Granulocitet
B) Trombocitet
C) Limfocitet
D) Endoteli
E) Monocitet
PS)C

Pyetja 554 V)1

Kotrimoksazoli është

A) Bakteriostatik.
B) Baktericid.
C) Bakteriostatik në doza më të larta se 3g/ditë.
D) Baktericid në doza më të ulëta se 2 g/ditë
E) Bakteriostatik në doza të ulëta dhe baktericid në doza me të larta se 2g/ditë.
PS)B

Pyetja 555 V)2

Cili marker tumoral përdoret tek tumoret e diferencuar të tiroides?

A) CEA-ja
B) TPA-ja
C) Tireoglobulina.
D) Alfa-fetoproteina/
E) Ca 125
PS)C

Pyetja 556 V)2

Era e bajames së hidhur është karakteristike e intoksikacionit me

A) Arsenik.
B) Cianur.
C) Botulizëm.
D) Amfetaminë.
E) Antidepresivët triciklikë.
PS)B

Pyetja 557 V)3

Fraktura crushing e trupit të vertebrës përbën një problem shumë të zakonshëm në osteoporozën e tipit I (post-menopauzale) sepse

A) Kocka trabekulare absorbohet në mënyrë të preferuar në këtë situatë me turnover të lartë kockor.
B) Humbja e përmbajtjes hidrike e diskut rrit forcën e ngarkesës mbi trupat vertebrale.
C) Stresi shkaktohet nga rigiditeti relativ i artikulacioneve posteriore artrozike.
D) Kërkesat e rritura energjetike i kundërvihen reduktimit të qarkullimit të gjakut në trupat vertebralë
E) Trashësia e kockës kortikale që gjëndet në trupin e e vertebrës absorbohet në mënyre të shpejtë nga reduktimi i estrogjenëve
PS)A

Pyetja 558 V)2

Atrezia koanale është

A) Pasojë e akteve kirurgjikale në fossa nazale.
B) Një malformacion i porcionit posterior të fossa nazale.
C) Një malformacion trakeal.
D) Një malformacion i rhinofaringut.
E) Një patologji kronike e kordave vokale.
PS)B

Pyetja 559 V)1

Collum uteri është në raport

A) Posteriorisht me vezikën.
B) Posteriorisht me ureteret.
C) Anteriorisht me kolon sigmoid.
D) Lateralisht me ureteret.
E) Lateralisht me tubat uterinë.
PS)D

Pyetja 560 V)2

Pozitiviteti i cilit test kutan midis këtyre të përmendur evokon diagnozën e sarkoidozës?

A) Tuberkulina
B) Kveim
C) Prick test
D) Bentoniti
E) Penicilina
PS)B

Pyetja 561 V)2

Cili është indikacioni elektiv i trajtimit me diazepam intra-venoz?

A) Delirium
B) Absenca temporale
C) Paraliza periodike
D) Delirium i xhelozisë
E) Status (etat de mal) epileptik
PS)E

Pyetja 562 V)2

Endokarditi shfaqet më shpesh në dekursin e

A) Infarktit të miokardit.
B) Hipertensionit arterial.
C) Valvulopatisë mitrale.
D) Diabetes mellitus
E) Cor pulmonare kronike.
PS)C

Pyetja 563 V)2

Në një skedë vdekjeje, cila nga të dhënat e mëposhtme është më e rëndësishme për vlerësimin e ecurisë së vdekshmërisë sipas shkakut në një popullatë?

A) Shkaku përfundimtar i vdekjes
B) Shkaku i ndërmjetëm i vdekjes
C) Shkaku fillestar i vdekjes.
D) Vëndi i vdekjes.
E) Mosha e pacientit.
PS)C

Pyetja 564 V)1

Cili nga këta hormone prodhohet në zonën fashikulare të gjëndrës surenale?

A) Aldosteron
B) Kortizol
C) Adrenalin
D) Adrenosteron
E) Progesteron
PS)B

Pyetja 565 V)2

Në intoksikacionin nga monoksidi i karbonit, cila nga këto alteracione kutane është tipike?

A) Cianoza labiale dhe unguale

B) Lëkurë e zbehtë dhe djersitje
C) Ikter
D) Lëkura e kuqe-qershi
E) Mavijosje kutane difuze
PS)D

Pyetja 566 V)1

Çfarë mund të shkaktojë tek gjiri një cirrozë hepatike?

A) Ekztazi të duktuseve
B) Mastit akut
C) Gjinekomasti
D) Hiperpigmentim alveolar
E) Fibroadenomë
PS)C

Pyetja 567 V)2

'Virilizmi' mund të shoqërohet me gjëndjen e

A) Miksedemës.
B) Hipopituitarizmit.
C) Hipertirozinemisë.
D) Hiperplazisë.
E) Hiperplazisë të korteksit surenal.
PS)E

Pyetja 568 V)1

Policitemia nënkupton

A) Shtim të numrit të eritrociteve në gjakun qarkullues.
B) Shtim të numrit të trombociteve në gjak.
C) Prani të shumë formacioneve cistike në një organ visceral.
D) Shtim të të gjithë komponentëve korpuskulare të gjakut në një organ
E) Shtim të dimensioneve të komponentëve korpuskularë të gjakut.
PS)A

Pyetja 569 V)1

Fosfokreatina përdoret në muskul

A) Si rezervë energjie për fosforilimin e glukozës.
B) Si rezervë energjie për fosforilimin e ADP-së.
C) Si depozitë fosfati inorganik.
D) Për transferimin në veshka të fosfatit të tepërt.

E) Për rregullimin e kontraktimit.
PS)B

Pyetja 570 V)1

Me cilën nga këto teknika radiologjike nuk është e mundur të vizualizohet ureteri?

A) Urografia
B) Tomografia e kompiuterizuar
C) Urografia me rezonancë magnetike
D) Radiografia direkte e abdomenit
E) Pielografia transnefrostomike descendente
PS)D

Pyetja 571 V)1

Cila simptomë nuk karakterizon depresionin?

A) Ngadalësimi i proceseve ideore
B) Përmbajtje ideore të trishtuara, të dhëmbëshme dhe vetë-akuzimit
C) Ndjenja trishtimi
D) Ngadalësimi i lidhjeve asociative
E) Ngadalësimi psikomotor
PS)D

Pyetja 572 V)2

Në terapinë e KID akute hemorragjike, trajtimi i zgjedhjes së parë është

A) Trombina intra-venoze
B) Col fibrine
C) Koncentrate eritrocitare
D) Plazmë e freskët e ngrirë
E) Heparina
PS)D

Pyetja 573 V)1

Anemia megaloblastike mund të shkaktohet nga të gjitha arësyet e mëposhtme, përveç

A) Mungesës së vitaminës B12.
B) Mungesës së faktorit intrinsek të Castle
C) Mungesës së transferinës
D) Infestimi nga botriocefalus
E) Sprue tropikale
PS)C

Pyetja 574 V)3

Një nënpunës 43 vjeçar, njihet prej kohësh si HbsAg pozitiv, por me transaminaza normale. Në javët e fundit, ankon për dobësi, ethe, mialgji/artralgji. Ekzaminimet laboratorike evidentojnë një rritje të dukëshme të transaminazave. Laboratori ju informon
A) Riaktivizim të hepatitit B.
B) Faza e serokonversionit HbeAg/antiHBe.
C) Co-infeksion HCV.
D) Mbi-infeksion HDV.
E) Co-infeksion HDV.
PS)A

Pyetja 575 V)2

Diagnoza diferenciale midis adenomës folikulare dhe karcinomës folikulare të tiroides bazohet në cilin parametër?

A) Atipia citologjike
B) Prania e qelizave gjigande
C) Prania e papilave
D) Sasia e koloidit në folikuj
E) Infiltrimi kapsular e vaskular
PS)E

Pyetja 576 V)2

Tek një pacient me ascit që është formuar si pasojë e një hipertensioni portal do të vërejmë

A) Rritje të amilazës në ascit.
B) Diferenca midis albuminës serike dhe asaj ascitike >11g/l.
C) Kolesteroli në likidin ascitik është më i madh se kolesteroli serik.
D) Prani të qelizave atipike në ascit.
E) Prani të eritrociteve në ascit >100.000mm3.
PS)B

Pyetja 577 V)1

Cili është trajtimi më i dobishëm në zhbllokimin e rrugëve ajrore tek një pacient i prekur nga fibroza cistike?

A) Drenazhi postural
B) Antibiotikët
C) Bronkodilatatorët
D) Antikolinergjikët
E) Kortikosteroidet
PS)A

Pyetja 578 V)2

Një refluks pozitiv hepato-jugular, i provokuar duke shtypur kuadrantin abdominal superior të djathtë tregon

A) Insufiçiencë kongjestive.
B) Obstruksion në vena cava superior.
C) Obstruksion i vena cava inferior.
D) Obstruksion i vena porta.
E) Variant i normës.
PS)A

Pyetja 579 V)2

Bleomicina është aktive para së gjithash

A) Në karcinomën skuamocelulare.
B) Në hepatitin viral.
C) Në lupus eritematoz të diseminuar.
D) Në tifon ekzantematike.
E) Në sklerozen multiple.
PS)A

Pyetja 580 V)1

Cila nga anemitë hemolitike i detyrohet një defekti kongenital të një enzime eritrocitare (G6PDH) ?

A) Favizmi
B) Sferocitoza
C) Eliptocitoza
D) Stomatocitoza
E) Hemoglobinuria paroksistike
PS)A

Pyetja 581 V)1

Një konstipacion është simptom jo i rrallë i

A) Hipogonadizmit.
B) Timomës.
C) Hipoparatiroidizmit.
D) Hiperparatiroidizmit.
E) Feokromacitomës.
PS)D

Pyetja 582 V)2

"Calvaria si furçë" vërehet në dekursin e

A) Plasmocitomës.
B) Metastazave kockore të karcinomës.
C) Anemisë falciforme.
D) Morbus Cooley.
E) Anemisë diseritropoietike.
PS)D

Pyetja 583 V)1

Në plazmë, hekuri transportohet nga cila proteinë?

A) Transferina
B) Hemoglobina
C) Ceruloplazmina
D) Albumina
E) Haptoglobina
PS)A

Pyetja 584 V)2

Arteriopatia obliterante karotidiene studiohet në radhë të parë me

A) Angiografi.
B) Radiografi direkte e indeve të buta.
C) Angio-RM.
D) Angio-CT skaner.
E) Echo-Doppler me ngjyra.
PS)E

Pyetja 585 V)1

Si quhet një ngritje solide dhe e shpejtë e lëkurës?

A) Bula
B) Njolla
C) Urtikarie
D) Nodul
E) Papula
PS)C

Pyetja 586 V)2

Në prani të cilit prej neoformacioneve mediastinale të mëposhtme mund të bashkëshoqërohet një simptomatologji miastenike?

A) Limfoma
B) Timoma
C) Karcinoidi
D) Sëmundja e Castleman
E) Strumë zhytëse
PS)B

Pyetja 587 V)1

Në edemën pulmonare akute, kuadri klinik karakterizohet nga të gjitha simptomat e mëposhtme përveç

A) Sibilancës.
B) Dispnesë grave.
C) Ralet krepitante.
D) Ekspektorant shkumoz me strie gjaku.
E) Ndjenjës së vdekjes imediate.
PS)A

Pyetja 588 V)1

Cilat janë karakteristikat klinike më të zakonshme në akromegali?

A) Visceromegalia, ulje e volumit të ekstremiteteve akrale, obezitet tronkularë
B) Visceromegalia, rritje volumetrike e ekstremiteteve akrale, fascies leonina
C) Poliuria e polidipsia
D) Gjinekomastia
E) Struma difuze
PS)B

Pyetja 589 V)1

Me oliguri të adultit nënkuptojmë

A) Një diurezë 24-orëshe < 1000 ml.
B) Një diurezë 24-orëshe < 800 ml.
C) Një diurezë 24-orëshe < 500 ml.
D) Një diurezë 24-orëshe < 300 ml.
E) Një diurezë 24-orëshe < 100 ml.
PS)C

Pyetja 590 V)1

Në cilën zonë të prostatës e merr më shpesh origjinën karcinoma e prostatës?

A) Zona subkapsulare periferike

B) Zona intermediale
C) Zona tranzicionale
D) Zona periuretrale
E) Verumontanum
PS)A

Pyetja 591 V)1

Në dhënien e çertifikates mjekësore duhet vlerësuar e vërtetuar

A) Sugjerimi i pacientit.
B) Elementët që i sjellin përfitim pacientit.
C) Të dhënat klinike të konstatuara.
D) Të dhënat klinike që nuk përbëjnë rrezik për mjekun.
E) Të dhënat klinike që nuk përbëjnë rrezik për pacientin.
PS)C

Pyetja 592 V)1

Me flegmonë nënkuptojmë

A) Një inflamacion supurativ të disa apareteve pilo-sebace.
B) Një inflamacion akut purulent të gishtave.
C) Një inflamacion eksudativ purulent difuz në indet konektiv.
D) Një mbledhje pusi në një kavitet të neoformuar.
E) Një inflamacion akut supurativ të gjëndrave sudoripare.
PS)C

Pyetja 593 V)2

Shkaku më i shpeshtë i vdekjes tek gratë që manifestojnë eklampsi është

A) Ruptura e mëlçisë.
B) Insuficenca renale akute.
C) Hemorragjia cerebrale.
D) Embolia pulmonare.
E) Shoku septik.
PS)C

Pyetja 594 V)2

Në diagnozën e apendisitit akut më e rëndësishmja është

A) Ekografia abdominale.
B) Skaneri
C) Radiografia e traktit tretës.
D) Klizma opake.

E) Anamneza e ekzaminimit objektiv.
PS)E

Pyetja 595 V)2

Cila prej sëmundjeve nuk paraqet 'vitiligo' si manifestim?

A) Tiroiditi
B) Morbus Addison
C) Anemia pernicioze
D) Diabeti mellitus
E) Diabeti brun (hemokromatoza)
PS)E

Pyetja 596 V)3

Nga bashkimi i nervit petroz superficial major me nervin petroz të thellë merr origjinë nervi

A) Staped.
B) Aurikulari posterior.
C) Facial.
D) Vidian.
E) Petroz superficial minor.
PS)D

Pyetja 597 V)2

Cili nga preparatet e mëposhtëm mund të konsiderohet si zgjedhje e parë në terapinë ambulatore të një pacienti me insuficiencë kardiake?

A) Dobutamina
B) Amrinoni
C) Enalaprili
D) Digitozina
E) Nitroprusidi i natriumit
PS)C

Pyetja 598 V)2

Antibioterapia në bronkopneumopatinë kronike obstruktive vendoset

A) Gjithmonë.
B) Asnjëherë.
C) Në riakutizim të simptomave respiratore të shoqëruara me volum të shtuar e purulent të espektoratit.
D) Gjithmonë, tek subjekte me moshë më të madhe se 35 vjeç.
E) Gjithmonë, tek subjekte me moshë më të vogël se 50 vjeç.

PS)C

Pyetja 599 V)2

Në ekzaminimin hemokromocitometrik, parametri RDW (Red Cell Distribution Width)

A) Është një matës i volumit eritrocitar total dhe shërben për diagnozën e çrregullimeve të sintezës së hemoglobinës.
B) Është një matës i shpërndarjes së volumit të eritrociteve dhe shërben për diagnozën diferenciale të anemive.
C) Është një matës i volumit eritrocitar total dhe shërben për diagnozën diferenciale të anemive.
D) Tregon përqindjen e blasteve mieloid në qarkullim.
E) Është një matës i përmbajtjes mesatare të hemoglobinës së eritrociteve.
PS)B

Pyetja 600 V)1

Cili ngjyrim përdoret zakonisht për identifikimin e shpejtë të Mycobacterium tuberculosis?

A) Gram-i
B) Hematoksilina
C) Gimsa
D) Ziehl-nielsen
E) Papanicolau
PS)D

Pyetja 601 V)2

Cili nerv mund të kompromentohet në një rast me mizerim të dorës që përfshin sipërfaqen palmare të gishtit të 1-rë, 2-të, e 3-të i shoqëruar me një dobësi të muskujve të eminenca tenar?

A) Musculo-cutan
B) Ulnaris
C) Radialis
D) Median
E) Coraco-brachialis
PS)D

Pyetja 602 V)1

Hematokriti është raporti midis

A) Albuminës e rruazave.
B) Rruazave të bardha e të kuqe.
C) Trombociteve e rruazave të kuqe.

D) Plazmës e rruazave të bardha.
E) Plazmës e rruazave të kuqe.
PS)E

Pyetja 603 V)1

Cili nga faktorët e mëposhtëm favorizon më tepër drejt infeksioneve fungine invazive?

A) Deficiti i komplementit
B) Neutropenia e zgjatur
C) Lezionet kutane
D) Hipogamaglobulinemia
E) Limfopenia
PS)B

Pyetja 604 V)1

Shintigrafia pulmonare e perfuzionit

A) Është e nevojshme për diagnozën, por jo për stadifikimin prognostik të embolisë pulmonare.
B) Nuk mund të japë vlera kuantitative të mungesës së perfuzionit në emboline pulmonare.
C) Është i nevojshëm për diagnozën dhe për kuantifikimin e difektit të perfuzionit në embolinë pulmonare
D) Nuk kryhet kurrë përballë një dyshimi për emboli pulmonare.
E) Është i panevojshëm në dyshimin e një embolie pulmonare.
PS)C

Pyetja 605 V)2

Në patologjinë herniare, së bashku me dhëmbjen, cila është shënja më e rëndësishme dhe më e shpejtë për të vendosur një diagnozë të strangulacionit herniar dhe hospitalizimin konseguent?

A) Të vjellat
B) Mbyllja e alvit për feçe e gazra
C) Pamundësi për modifikim të tumefaksionit herniar
D) Temperatura
E) Hematemeza
PS)C

Pyetja 606 V)2

Plagët e abdomenit quhen pernetruese nëse

A) Shoqërohen me lezione të organeve abdominale.
B) Nuk arrijnë limitin peritoneal.

C) Nëse provokohen nga armë me majë të mprehtë.
D) Shoqërohen me hemorragji abondante.
E) Vendosin në komunikim kavitetin peritoneal me ambientin e jashtëm.
PS)E

Pyetja 607 V)1

Cila është koha ideale për të riperfuzionuar arterien koronare pas një infarkti miokardi akut?

A) 0-3 orë nga dhëmbja
B) 4-6 orë nga dhëmbja
C) 6-8 orë nga dhëmbja
D) 8-12 orë nga dhëmbja
E) >12 orë nga dhëmbja
PS)A

Pyetja 608 V)2

Cila nga ekzaminimet laboratorike nevojitet për të vlerësuar aktivitetin inflamator në hepatitin kronik?

A) Dozimi i imunoglobulinave serike
B) Dozimi i albuminemisë
C) Dozimi i bilirubinemisë
D) Dozimi i fosfatazemisë alkaline.
E) Gama-GT
PS)A

Pyetja 609 V)2

Në fazën e refraktaritetit absolut, zemra është

A) E eksituar.
B) Pjesërisht e ekzitueshme.
C) E paekzitueshme.
D) Në fazë diastolike.
E) Në fazë sistolike.
PS)C

Pyetja 610 V)2

Cili nga rrezultatet e mëposhtëm tregon një anemi me rigjenerim të dobët?

A) Volumi korpuskolar mesatar (MCV) normal.
B) Shpërndarje e shtuar e rruazave të kuqe (RDW).
C) Numër i ulët i retikulociteve.
D) Nivelet e ulura të hemoglobinës.

E) Sideremi e rritur.
PS)C

Pyetja 611 V)2

Nodujt që hasen në evolucionin e artrozave quhen

A) Nodujt e Heberdenit.
B) Nodujt e Oslerit.
C) Nodujt e Schmorlit.
D) Noduj subkutanë.
E) Noduj reumatoidë.
PS)A

Pyetja 612 V)2

Cila nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me kloramfenikolin është i saktë

A) Ka efekt baktericid.
B) Efekti i tij potencohet nga penicilina.
C) Në doza të larta mund të bllokojë sintezën e proteinave edhe në qelizat e palcës kockore në mamiferë.
D) Inaktivizohet nga beta-laktamazat e baktereve.
E) Efekti i tij është kryesisht në bakteret Gram-pozitive.
PS)C

Pyetja 613 V)1

Diagnoza e hiperparatiroidizmit primitiv bazohet në gjetjen e

A) PTH i paprekur (PTHi) i lartë, Kalcemia e ulur, Fosforemia e ngritur.
B) Kalcemia e rritur, Fosforemia e rritur, PTHi e padozueshme.
C) PTHi e rritur, Kalcemia e rritur.
D) Kalçemia e rritur, fosfataza alkaline e rritur.
E) Kalçemia e rritur me hiperakumulim në shintigrafi kockore
PS)C

Pyetja 614 V)1

Cila nga simptomat nuk gjëndet në intoksikimin akut nga morfina?

A) Bradipnea
B) Pupilat majë gjilpërë
C) Oliguria
D) Hiperpireksia
E) Flashkësi muskulare
PS)D

Pyetja 615 V)2

Çfarë e karakterizon sindromën karcinoide?

A) Konstipacioni
B) Bradikardia
C) Flushing
D) Hematemesa
E) Poliuria
PS)C

Pyetja 616 V)1

Cila patologji favorizohet nga mutacioni inaktivizues i gjenit BRCA1?

A) Bronkiti kronik
B) Neoplazia e gjirit
C) Neoplazitë hepatike
D) Aplazia medulare
E) Emfizema
PS)B

Pyetja 617 V)3

Një grua e re, operuar (heqje) për një strumë voluminoze, shfaq tri javë më pas kriza tetanike në fytyrë. Cili nga këta komplikime mund të ketë ndodhur?

A) Dëmtimi i nervit rikurrent
B) Hipoparatiroidizmi iatrogjen
C) Nevralgjia faciale
D) Hipotiroidizmi
E) Kondromalacia trakeale
PS)B

Pyetja 618 V)2

Lëkura e fytyrës (shpesh edhe e anësive, abdomenit etj.) me aspekt druri haset në patologjinë e

A) Poliartritit kronik primar.
B) Dermatomiozitit.
C) Sklerodermisë.
D) Diskoidit fiks.
E) Lupusit eritematoz sistemik.
PS)C

Pyetja 619 V)1

Në cilën prej situatave të mëposhtme mund të haset hiperkolesterolemia?

A) Hipotiroidizmi
B) Morbus Addison
C) Hepatiti kronik pa kolestazë
D) Koliti ulceroz
E) Morbus Crohn
PS)A

Pyetja 620 V)2

Cili nga pohimet në lidhje me limfomën Burkitt është i gabuar?

A) Përhapje endemike në Afrikë.
B) Prek kryesisht fëmijët.
C) Është një limfomë me limfocite T.
D) Fillimi është i lidhur me lokalizimin ekstranodal.
E) Ka karakteristikë praninë e translokacionit t(8:14)
PS)C

Pyetja 621 V)1

Tumori beninj më i shpeshtë i gjirit është

A) Fibroadenoma.
B) Lipoma.
C) Hemangioma.
D) Papilloma subareolare.
E) Histiocitoma fibroze.
PS)A

Pyetja 622 V)2

Intoksikimi nga kripërat e litiumit përmirësohet nga

A) Urea, kloruri i natriumit, acetazolamide, hemodializa.
B) Neuroleptikët.
C) Ansiolitikët.
D) Ujë me doza abondante.
E) Hepatoprotektore.
PS)A

Pyetja 623 V)2

Pacienti me rektorragji diskrete post alvi dhe tenezëm rektale. Cili është ekzaminimi i linjës së parë?

A) Eksplorim rektal dixhital dhe ano-rektoskopi
B) Pankolonoskopia
C) Klizëm opake me dopio kontrast
D) Ekzaminim kimik e parazitologjik i feçeve
E) Analizë për gjak okult në feçe
PS)A

Pyetja 624 V)1

Cila nga simptomat/shënjat e mëposhtme nuk bën pjesë në kuadrin e hiperkortizolemisë?

A) Obeziteti centripet
B) Facies lunaris
C) Hipotrofia muskulare
D) Reduktim i tolerancës glucidike/diabeti mellitus
E) Hipotensioni arterioz
PS)E

Pyetja 625 V)1

Si mund të vlerësohet temperatura?

A) Zakonisht është e rrezikshme.
B) Është gjithmonë e rrezikshme.
C) Është gjithmonë e parrezikshme
D) Duhet luftuar gjithmonë me antipiretikë.
E) Është një komponent i rëndësishëm i mekanizmit mbrojtës të organizmit.
PS)E

Pyetja 626 V)2

Ateroskleroza e arterieve të vogla ndodh zakonisht tek

A) Hipertensivët.
B) Dislipidemikët.
C) Diabetikët dhe duhan-pirësit.
D) Obezët.
E) Sedentarët.
PS)C

Pyetja 627 V)1

Nuk mund të jetë shkak i cirrozës hepatike

A) Infeksioni nga virusi A.
B) Infeksioni nga virusi C.
C) Inflamacioni kronik i rrugëve biliare.
D) Hemokromatoza.
PS)A

Pyetja 628 V)1

Cila lëvizje e pavullnetëshme është karakteristike në sëmundjen e Parkinsonit?

A) Ateoza
B) Klonitë
C) Krizat okulocefalogire
D) Distonitë
E) Tremor
PS)E

Pyetja 629 V)2

Shfaqja e hirsutizmit tek një femër 20 vjeçe shkaktohet nga

A) Hiperplazia kongenitale e deficitit të 21-hidroksilazës me shfaqje të vonshme.
B) Neoplazia e mbiveshkores.
C) Marrja e pilulës estroprogesteronike.
D) Policistoza ovarike.
E) Marrja e androgenëve.
PS)D

Pyetja 630 V)2

Infeksioni i gjëndrave sudoripare apokrine quhet

A) Periporite infantil.
B) Hidrosadenitë.
C) Eritasma.
D) Sikoza.
E) Furunkul.
PS)B

Pyetja 631 V)1

Glukoza e filtruar nga glomeruli ri-absorbohet në

A) Segmentin e trashë të ansës së Henles.
B) Tubulin kontort proksimal.
C) Degën deshendente të ansës së Henles.
D) Degës ashendente të ansës së Henles.

E) Tubulin kontort distal.
PS)B

Pyetja 632 V)2

Për vlerësimin e kapacitetit të përqëndrimit renal, përcaktimi bëhet nëpërmjet

A) Peshës specifike urinare.
B) Proteinurisë.
C) Ozmolaritetit urinar.
D) Elektrolitëve në gjak
E) PH urinar.
PS)C

Pyetja 633 V)1

Një imunodefiçencë primitive manifestohet zakonisht me

A) Infeksione të rënda virale si varicela-zoster e herpes simplex.
B) Infeksione respiratore të shpeshta e të rënda.
C) Kandidoza muko-kutane.
D) Anergjia kutane.
E) Infeksione fulminante nga Epstein-Barr.
PS)C

Pyetja 634 V)3

Hemoglobina rregullohet nga efektorë allosterikë, nga të cilët 2, 3-difosfoglicerati. Cili është efekti fiziologjik i këtij të fundit në funksionin e hemoglobinës?

A) Favorizim i lëshimit të oksigjenit në nivel të indeve periferike.
B) Ndalim i formimit të bikarbonatit në nivel periferik.
C) Ndalim i formimit të methemoglobinës.
D) Të bëjë hemoglobinën fetale më pak të disponueshme për oksigjenin.
E) Të reduktojë degradimin e hemoglobinës.
PS)A

Pyetja 635 V)1

Gjatë periudhës embrionale, hemopoeza observohet fillimisht në

A) Në mëlçi.
B) Në shpnetkë.
C) Në palcën kockore.
D) Në sakusin vitelin.
E) Në bursën e Fabricios.
PS)D

Pyetja 636 V)1

Artikulacioni i cili ka luksacion më të shpeshtë është

A) Kofsha.
B) Gjuri.
C) Kavilja.
D) Shpatulla.
E) Radiokarpal.
PS)D

Pyetja 637 V)1

Cili nga variantet e mëposhtëme është vendimi më i mirë për terapinë afatgjatë në anginën e Printzmetalit?

A) Kaptopril
B) Aspirina
C) Propranololi
D) Nifedipina
E) Angioplastika koronare perkutane transluminale (PTCA)
PS)D

Pyetja 638 V)1

Në obezitet indeksi i masës trupore (BMI) është

A) >30.
B) >10.
C) >20.
D) >25.
E) >40.
PS)A

Pyetja 639 V)1

Në ekzaminimin e fundus oculi shihet stazë papilare në rastin e

A) Cefalesë nga neuralgjia e nervave kranialë.
B) Hemikranisë ofalmoplegjike.
C) Cefalesë nga intoksikimi alkoolik.
D) Cefalesë nga artriti temporal.
E) Cefalesë nga hipertensioni intrakranial.
PS)E

Pyetja 640 V)1

Cila nga sëmundjet e mëposhtme konsiderohet një zoonozë?

A) Askaridioza
B) Ankilostomiaza
C) Amebiaza
D) Toksoplasmoza
E) Enterobiaza
PS)D

Pyetja 641 V)2

Krepitancat pulmonare indux e redux shihen në evolucionin e

A) Pneumonisë lobare.
B) Bronkitit azmatik.
C) Fibrozës pulmonare.
D) Pleuritit eksudativ.
E) Pleuritit të thatë.
PS)A

Pyetja 642 V)2

Insuficienca kardiake kongjestive shoqërohet me aktivizimin e shumë sistemeve neuro-hormonale dhe në të njëjtën kohë nuk ka hiperaktivizim të

A) Vazopresinës.
B) Bradikininës.
C) Hormonit natriuretik.
D) TSH-së.
E) Sistemit renin-angiotensin.
PS)B

Pyetja 643 V)2

Në radiografi, gjetja e "kranium me vrima çifte" është tipik për

A) Mikrociteminë.
B) Osteoporozën.
C) Makroglobulineminë e Waldestrom.
D) Plasmocitomën.
E) Metastazën kockore nga mikrocitoma.
PS)D

1.Fondi A
Pyetja 1 V)2

Aspirimi citologjik i një noduli tiroidien është i besueshëm në diagnozën e neoplazisë malinje, përveç rastit të karcinomës

A) Papillifere.
B) Folikulare.
C) Medullare.
D) Me qelizat e Hurtle.
E) Anaplazike.
PS)B

Pyetja 2 V)1

Potenciali i veprimit në fibrën nervore

A) Gjenerohet me hapjen e një kanali selektivisht permeabël ndaj anioneve.
B) Shkakton një ulje të ndjeshme të kondutancës elektrike të membranës.
C) Ka shpejtësi konstante pavarësisht kalibrit aksonal.
D) Gjenerohet vetëm kur potenciali i membranës ulet dhe arrin një vlerë të caktuar.
E) Zgjat mesatarisht 5-8 msek.
PS)D

Pyetja 3 V)1

Tek femrat, incidenca më e lartë e metastazave kockore ndodh në karcinomën e

A) Gjirit.
B) Endometritit.
C) Vezores.
D) Qafës së mitrës.
E) E kolonit.
PS)A

Pyetja 4 V)2

Cili nga grupet e gjeneve të histokompatibilitetit përmban allele të lidhur ngushtë me predispozicionin ose refraktaritetin e diabetit mellitus tipi I?

A) HLA-A
B) HLA-B
C) HLA-DP
D) HLA-DN
E) HLA-DR
PS)E

Pyetja 5 V)1

Flitet për hipovolemi relative kur ka

A) Ulje të fraksionit të ejeksonit.
B) Shtim të kthimit venoz.
C) Kapacitet vazal të shtuar në kushte mase normale
D) Reduktim i kapacitetit vazal me masë qarkulluese normale
E) Prani eksudatesh intra kaviteteve të sekuestruar
PS)C

Pyetja 6 V)2

Muskujt kriko-aritenoid lateralë e inter-aritenoide shkaktojnë

A) Aduksionin e kordave vokale.
B) Abduksionin e kordave vokale.
C) Rritjen e tensionit të kordave vokale.
D) Ngritjen e larinksit.
E) Uljen e larinksit.
PS)A

Pyetja 7 V)1

Cila është rruga kryesore e eliminimit nga organizmi i kontrasteve të iodizuar?

A) Hepatike
B) Renale
C) Kutane
D) Rektale
E) Salivare
PS)B

Pyetja 8 V)1

Cilin veprim respirator kryejnë muskujt abdominalë?

A) Aksion inspirator
B) Asnjë veprim
C) Rritjen e presionit intrapleural
D) Aksion ekspirator
E) A dhe C janë të sakta
PS)D

Pyetja 9 V)2

Simptomat e mëposhtme janë efekte kolaterale të zakonshme në përdorimin e benzodiazepinave, përveç

A) Cefalesë.
B) Inkoordinimit motor.
C) Vertigos.
D) Amnezia anterograde
E) Konstipacionit.
PS)E

Pyetja 10 V)3

Tek qelizat eukariote, pjesa më e madhe e enzimave të ciklit të Krebsit janë të lokalizuara në

A) Citozol.
B) Aparatin e Golxhit.
C) Ribozomë.
D) Matriksin mitokondrial.
E) Membranën e jashtme mitokondriale.
PS)D

Pyetja 11 V)1

Shkaku më i shpeshtë i dështimit të kontraceptivëve oralë, që ka si rezultat një shtatëzani të padëshiruar është

A) Ovulim në mes të ciklit.
B) Frekuenca e raporteve seksuale.
C) Përdorimi jo i saktë i kontraceptiveve oralë.
D) Malabsorbiment gastrointenstinal.
E) Prodhim i antitrupave.
PS)C

Pyetja 12 V)2

Cili fenotip HLA ndeshet më shpesh në sindromën e Reiter?

A) B16
B) B17
C) B5
D) B27
E) B13
PS)D

Pyetja 13 V)1

Në cilën ditë, hormoni LH arrin nivelin më të lartë tek një grua që ka një cikël menstrual 30 ditësh?

A) Ditën e 12-të

B) Ditën e 14-të
C) Ditën e 16-të
D) Ditën e 18-të
E) Ditën e 27-të
PS)C

Pyetja 14 V)2

Tek pacientët e prekur nga karcinoma rektale

A) Hemorragjia rektale është e shpeshtë.
B) Radioterapia adiuvante e kimioterapia nuk përmirësojnë jetëgjatësinë.
C) Vëndi më i shpeshtë i metastazave është truri.
D) Recidiva lokale nuk përbën problem.
E) Është e pranishme splenomegalia.
PS)A

Pyetja 15 V)3

Cila nga sëmundjet dermatologjike shoqërohet më shpesh me celiakinë?

A) Dermatiti herpetiform
B) Psoriaza
C) Pemfigoidi
D) Pemfigo
E) Urtikaria
PS)A

Pyetja 16 V)2

Neuralgjia trigeminale esenciale karakterizohet nga

A) Kriza të dhëmbëshme akute unilaterale.
B) Kriza të dhëmbëshme akute bilaterale.
C) Kriza të dhëmbëshme kronike bilaterale.
D) Kriza parestezike bilaterale.
E) Kriza të dhëmbëshme djegëse bilaterale.
PS)A

Pyetja 17 V)2

Një nga komplikimet më të shpeshta të sëmundjes divertikulare të kolonit është

A) Hemorragjia.
B) Okluzioni intestinal.
C) Fistula enterokutane.
D) Fistula anale.

E) Koliti ishemik.
PS)A

Pyetja 18 V)2

Në astmën bronkiale, nga çfarë varet ulja e fluksit ekspirator maksimal?

A) Rritje e kompliancës
B) Rritje e kondutancës
C) Ulje e rrezistencës
D) Rritje e rrezistencës
E) A-ja e D-ja janë të sakta.
PS)D

Pyetja 19 V)1

Hemoglobina

A) Është mesatarisht më e lartë tek meshkujt se tek femrat.
B) Rritet në rast makrocitoze.
C) Bën pjesë tek proteinat e fazës akute.
D) Ka vlera normale 12-17 mg/dl.
E) Është në gjëndje të transportojë 10 molekula oksigjen për molekulë.
PS)A

Pyetja 20 V)2

Endokarditi infektiv tek subjektet toksikodependente shkaktohet më shpesh nga

A) Streptokoku fekal.
B) Stafilokoku aureus.
C) Kandida albikans.
D) Serratia marcescens.
E) Streptokoku viridans.
PS)B

Pyetja 21 V)2

Në rastin e diagnozës prenatale të renit multikistik, cila nga manovrat e mëposhtme është e saktë?

A) Kontroll ekografik të shtatzanisë e sectio cesareo në term fiziologjik.
B) Kontroll ekografik të shtatzanisë e sectio cesareo përpara termit fiziologjik (sapo të ketë arritur maturitetin pulmonar)
C) Kontroll ekografik të shtatzanisë e lindje normale në term.
D) Kontroll ekografik të shtatzanisë e seksio cesareo në muajin e shtatë.
E) Kontroll ekografik të shtatzanisë dhe induktim të lindjes normale sapo të arrihet.

maturiteti pulmonar
PS)C

Pyetja 22 V)1

Probabiliteti që një fëmijë i një pacienti me "hemofili grave" të ketë hemofili është

A) 0%.
B) 25%.
C) 50%.
D) 75%.
E) 100%.
PS)A

Pyetja 23 V)2

Cila nga shenjat e mëposhtme nuk është e pranishme në embolinë pulmonare masive?

A) Dispnea severe e cinozë
B) Dhëmbje e tipit anginoz
C) Deficit i furnizimit cerebral
D) Edemë në formë manteli
E) Turgor i venave jugulare
PS)D

Pyetja 24 V)1

Diabeti në distancë dëmton sistemin nervor, duke shkaktuar kryesisht

A) Kriza epileptike.
B) Rritje të frekuencës së tumoreve.
C) Degjenerim të qelizave të kornu anterior.
D) Neuropati periferike.
E) Prekje të sensibilitetit të thellë.
PS)D

Pyetja 25 V)2

Në rast perforimi të uterusit gjatë një ekzaminimi të kavitetit uterin duhet

A) Ndërprerë interventi.
B) Të fillohet një trajtim me antibiotikë.
C) Të kryhet një laparotomi eksplorative.
D) Suturimi i dëmtimit.
E) A+B
PS)E

Pyetja 26 V)2

Temperaturë intermitente e tipit ondulant shihet shpesh në sëmundjen e

A) Pertusit.
B) Tifos abdominale
C) Difterisë
D) Brucelozës.
E) Sepsit puerperal.
PS)D

Pyetja 27 V)3

Trajtimi më i mirë i metastazave hepatike solitare të karcinomës së kolonit është

A) Radioterapia.
B) Kimioterapia.
C) Kimioterapia nëpërmjet arteries hepatike.
D) Krioterapia.
E) Rezeksioni kirurgjikal.
PS)E

Pyetja 28 V)2

Prekursori i Prostaglandinave është

A) Acidi arakidonik.
B) Acidi linoleik.
C) Acidi palmitik.
D) Acidi stearik.
E) Acidi laktik.
PS)A

Pyetja 29 V)1

Cili është hormoni tiroidien fiziologjikisht më aktiv?

A) Tireoglobulina
B) Monoiodotirozina
C) Diiodotirozina
D) Triiodotirozina
E) Tiroxina
PS)D

Pyetja 30 V)1

Koka dhe pjesa mediale e colli femuri janë të vaskularizuara nga

A) Arteria femorale komune.
B) Arteria circumflekse.
C) Arteria pudente.
D) Arteria obturatore.
E) Arteria gluteale.
PS)B

Pyetja 31 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë kur bëhet fjalë për një pacient me hiperkalçemi nga sarkoidoza?

A) Radiografia torakale është gjithmonë normale.
B) Përthithja intestinale e Ca është e rritur.
C) Eliminimi urinar i Ca është normal.
D) Niveli i PTH serik është i rritur.
E) Është shpesh e pranishme hipogamaglobulinemia.
PS)B

Pyetja 32 V)1

Cila nga vlerat e presionit arterial konsiderohet si limiti superior normal në një subjekt 40 vjeç?

A) 150/90
B) 130/70
C) 140/90
D) 160/100
E) 150/100
PS)C

Pyetja 33 V)2

Një efekt kolateral veçanërisht i rrezikshëm i kloramfenikolit është

A) Proteinuria.
B) Ikteri kolostatik.
C) Agranulocitoza.
D) Diabeti.
E) Anemia hemolitike.
PS)C

Pyetja 34 V)1

Nëse vlerat e hormoneve FT3 dhe FT4 të tiroides janë të rritura, ndërsa vlera e TSH është e ulur (frenuar), mund të jemi në prani të

A) Infarktit te miokardit.
B) Metastazave kockore.
C) Osteomielitit.
D) Morbus Bazedow.
E) Morbus Alzaimer.
PS)D

Pyetja 35 V)2

Përdorimi kronik i etanolit shoqërohet me shpeshtësi të rritur të

A) Kolestazës.
B) Steatozës.
C) Hemokromatozës.
D) Hipertrofisë së retikulumit endoplazmatik.
E) Nekrozës koagulative.
PS)B

Pyetja 36 V)1

Cili nga parametrat e mëposhtëm serologjikë duhet monitoruar gjatë terapisë me heparinë?

A) APTT
B) PT (koha e protrombinës)
C) INR (International Normalised Ratio)
D) Numri i trombociteve
E) A+D
PS)E

Pyetja 37 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm që lidhet me inspirimin gjatë maksimumit të provës ushtrimore është i gabuar?

A) Diafragma zbret më shumë se 3 cm.
B) Diametri anësor i toraksit rritet.
C) Muskujt interkostal të jashtëm kontraktohen.
D) Muskuli sternokleidomastoid kontraktohet.
E) Presioni intraabdominal reduktohet.
PS)E

Pyetja 38 V)1

Shkaku më i zakonshëm jo neoplazik i hipopituitarizmit tek të rriturit është

A) Trauma kraniale.
B) Inflamacioni.

C) Idiopatike.
D) Sindroma Sheehan.
E) Amiloidoza.
PS)D

Pyetja 39 V)1

Për të penetruar me një age në kavitetin pleurik përgjatë vijës medio-aksilare, kalohet përmes të gjithë strukturave të mëposhtme, përveç

A) Muskulit interkostal të brendëshëm.
B) Muskulit ngritës të brinjëve .
C) muskulit interkostal të jashtëm.
D) Pleurës parietale.
E) Fascies endotorakale.
PS)B

Pyetja 40 V)2

Mohimi i lëshimit të raportit mjekësor është legjitim vetëm nëse

A) Personi i asistuar mund të ekspozohet ndaj proçedimit penal.
B) Personi i asistuar mund të ekspozohet ndaj proçedimit civil.
C) Mjeku mund të ekspozohet ndaj proçedimit penal.
D) Mjeku mund të ekspozohet ndaj proçedimit civil.
E) Asnjëherë.
PS)A

Pyetja 41 V)1

Çfarë kemi parasysh kur themi "kohë dyfishimi" (doubling time)?

A) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dyfishuar vëllimin e tij.
B) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dyfishuar diametrin e tij.
C) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dyfishuar vëllimin dhe diametrin e tij.
D) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dhënë metastaza në distancë.
E) Koha që i duhet një lezioni nodular për të dyfishuar perimetrin e tij.
PS)A

Pyetja 42 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar?

A) Citologjia eksfoliative përdoret si screening për karcinomën e qafës së mitrës.
B) Citologjia eksfoliative mund të përdoret për diagnozën e karcinomës bronkiale.
C) Citologjia eksfoliative përdoret mbi qelizat e përftuara përmes aspirimit me age të hollë (FNA)

D) Citologjia eksfoliative ndonjëherë përdoret për diagnozën e sëmundjeve mezoteliale.
E) Citologjia eksfoliative mund të përdoret për të studiuar sëmundjet e majës së gjirit
PS)C

Pyetja 43 V)1

Lokalizimi më i shpeshtë i një enteriti segmentar është

A) Ileumi.
B) Koloni.
C) Stomaku.
D) Rektumi.
E) Ezofagu.
PS)A

Pyetja 44 V)1

Simptoma kryesore e pacientit me akalazi është

A) Apiroza.
B) Dhëmbja epigastrike.
C) Dhëmbja gjate gëlltitjes .
D) Refluksi acid.
E) Disfagia.
PS)E

Pyetja 45 V)1

Hiperaktiviteti bronkial

A) Shoqërohet gjithmonë me astmë bronkiale të diagnostikuar.
B) Mund të evidentohet edhe tek pacientët asimptomatikë.
C) Zakonisht evidentohet me inhalimin e atropinës.
D) Zakonisht evidentohet me inhalimin e salbutamolit.
E) Theksohet nga inhalimi i antikolinergjikëve si p.sh ipratropium bromur.
PS)B

Pyetja 46 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me amilazën është i gabuar?

A) Gjatë insuficiencës renale kronike, niveli urinar i amilazës është i ulur.
B) Makroamilazemia ndeshet zakonisht gjatë pankreatitit akut.
C) Në prani të makroamilazemisë, nivelet plazmatike të amilazës janë të rritura.
D) Në subjektin normal, rreth 50% e amilazës së pranishme në plazëm është e tipit salivar.
E) Gjatë pankreatitit, rritja e amilazave shoqërohet shpesh nga rritje e njëkohshme e lipazave.
PS)A

Pyetja 47 V)1

Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk i përket barnave gjenerikë?

A) Prodhohen nga industria.
B) Janë të dobishëm në patologji të shumta, pasi nuk janë specifik.
C) Janë bioekuivalentë krahasuar me barin referencë.
D) Nuk mbrohen nga patenta.
E) Zakonisht kushtojnë më pak krahasuar me barin referencë.
PS)B

Pyetja 48 V)2

Cili element patogjenetik i mëposhtëm nuk është tipik i astmës bronkiale?

A) Bronkospazma
B) Mbiprodhimi i mukusit
C) Edema e mukozës bronkiale
D) Infeksion i mukozës bronkiale
E) Granuloma eozinofile
PS)E

Pyetja 49 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me anti inflamatorët jo steroidal është i vërtetë?

A) Frenojnë agregimin e trombociteve pasi ulin nivelet plazmatike të Ca++.
B) Aspirina frenon agregimin e trombociteve pasi frenon ciklooksigjenazën.
C) Rikthimi i trombociteve në funksionin e tyre normal kërkon të paktën 3 javë kohë pas ndërprerjes së administrimit të aspirinës.
D) Doza antiagregante e aspirinës është 20 mg/kg në ditë.
E) Të gjithë barnat anti inflamatore josteroidale frenojnë në mënyrë të pakthyeshme agregimin e trombociteve.
PS)B

Pyetja 50 V)1

Metotreksati është një bar antiblastik i grupit të

A) Alkilanteve.
B) Antimetaboliteve.
C) Antibiotikëve.
D) Helmeve.
E) Alkaloideve të vinkës.
PS)B

Pyetja 51 V)2

Cila alternativë është e saktë kur një i porsalindur prematur ka vështirësi të frymëmarrjes?

A) Nuk janë zhvilluar ende plotësisht pneumocitet e tipit 1.
B) Trakea nuk është ende plotesisht e hapur (e përshkueshme).
C) Nuk është akoma i plotë mikroqarkullimi alveolar.
D) Nuk janë zhvilluar ende plotësisht pneumocitet e tipit 2.
E) Nuk janë zhvilluar ende plotësisht terminacionet nervore zonale.
PS)D

Pyetja 52 V)3

Një paciente 70 vjeçare, e cila i nënshtrohet një ndërhyrjeje kirurgjikale për protezën e artikulacionit kokso-femoral, pas një jave shfaq shenja të trombocitopenisë (40 000/mikroL). Cili është shkaku më i mundshëm i trombocitopenisë në këtë rast ?

A) Trombocitopenia është induktuar nga terapia heparinike.
B) Një purpur idiopatike trombocitopenike.
C) Një hipoplazi medulare.
D) Shfaqja e një mielodisplazie.
E) Një koagulopati intravaskulare e shpërndarë.
PS)A

Pyetja 53 V)1

Funksioni i tiroides është i lidhur funksionalisht me atë të

A) Hipofizës.
B) Epifizës.
C) Gjëndrës mbiveshkore.
D) Gjëndrës parotide.
E) Ovareve.
PS)A

Pyetja 54 V)1

Të gjithë barnat e mëposhtëm janë antagonistë beta-adrenergjikë, përveç

A) Adrenalinës.
B) Izoproterenolit.
C) Noradrenalinës.
D) Fentolaminës.
E) Dobutaminës.
PS)D

Pyetja 55 V)2

Për cilën nga analizat e mëposhtme është i detyrueshëm të qënurit esëll?

A) HBsAg
B) Glicemia
C) Eritrosedimentacioni
D) Monotesti
E) Grupi dhe faktori Rh
PS)B

Pyetja 56 V)2

Shpnetka arrin vlera maksimale të vëllimit në subjekte të prekura nga

A) Sëmundja Hodgkin.
B) Leuçemia akute.
C) Leuçemia mieloide kronike.
D) Mononukleoza infektive.
E) Limfomat jo-Hodgkin.
PS)C

Pyetja 57 V)1

Cili nga parametrat e mëposhtëm është më i rritur në gjakun arterial krahasuar me atë venoz?

A) Presioni i anhidridit karbonik
B) Presioni i oksigjenit
C) Përqëndrimi i bikarbonatit
D) Përqëndrimi i amonit
E) Përqëndrimi i acidit laktik
PS)B

Pyetja 58 V)1

Nervi sural

A) Është nerv sensitiv i gjymtyrës së poshtmë.
B) Është degë e nervit peroneal.
C) Është nerv i përzier i këmbës.
D) Fillon nga rrënjët spinale L3-L4-L5.
E) Është njësoj si nervi tibial posterior.
PS)A

Pyetja 59 V)2

Kur një person i shëndetshëm mendërisht, refuzon me vullnet të lirë dhe vetëdije të ushqehet, mjeku

A) Duhet të marrë inisiativë për ushqim të detyruar artificial.
B) Mund të mundësojë metoda bashkëpunuese për ushqyerje artificiale.
C) Nuk duhet të ndërmarrë asnjë nga veprimet e dy përgjigjeve të para, por mund të terhiqet nga të asistuarit e pacientit.
D) Nuk duhet të ndërmarrë asnjë nga veprimet e dy përgjigjeve të para, por duhet të vazhdojë të asistuarit e pacientit.
E) Duhet të denoncojë pacientin tek autoritetet ligjore.
PS)D

Pyetja 60 V)1

Gangrena e thatë është

A) Një proçes inflamator.
B) Një proçes neoplazik.
C) Një nekrozë iskemike.
D) Një glikogjenozë.
E) Një koloni fungale.
PS)C

Pyetja 61 V)2

Shunti intrapulmonar përcakton

A) Një reduktim të PaO2.
B) Një reduktim të pO2 alveolar.
C) Një rritje të PaCO2.
D) Hiperventilacion sekondar.
E) Një rritje të PaO2.
PS)A

Pyetja 62 V)1

Cila nga të mëposhtmet nuk është shenje ekstraintestinale e alergjisë ushqimore?

A) Dermatiti atopik
B) Urtikaria
C) Cefalea
D) Bronkospazma, kolla e thatë persistente
E) Onikomikoza
PS)E

Pyetja 63 V)2

Për cilën nga sëmundjet e mëposhtme kromozomike është karakteristike "pterigium colli"?

A) Sindroma Down
B) Sindroma Klinefelter
C) Sindroma Turner
D) Sindroma Patau
E) Sindroma Cri du Chat
PS)C

Pyetja 64 V)1

Në cilën prej situatave të mëposhtme dallojmë poliglobulinë?

A) Hipertension arterial sistemik
B) Zemër pulmonare kronike
C) Mbingarkesë ventrikulare e majtë
D) Infarkt miokardi
E) Miokardioskleroze koronare
PS)B

Pyetja 65 V)2

Omeprazoli është produkti fillestar i një kategorie barnash të përdorur në terapinë e ulcerës peptike. Veprimi i tij farmakologjik konsiston në

A) Antagonizëm të receptorëve H2.
B) Bllokim të pompës protonike.
C) Frenim të antiportit Na+/H+.
D) Aktivitet kemioterapik antiviral.
E) Aktivitet antikolinergjik.
PS)B

Pyetja 66 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtme që ka të bëjë me një nga veprimet e insulinës është i vërtetë?

A) Stimulon glikogjenolizën.
B) Rrit gliceminë.
C) Shpejton kalimin e glukozës në qeliza.
D) Shkakton formimin e trupave ketonikë.
E) Favorizon glukoneogjenezën.
PS)C

Pyetja 67 V)2

Në cilën situatë nuk mund të zbulohet ngjyrimi i verdhë i lëkurës për shkak të hiperkarotenemisë ?

A) Miksedema

B) Sëmundja Simmonds
C) Sindroma Stevens-Johnson
D) Tejkalim i marrjes ushqimore të karotenit
E) Aktivitet hormonal androgjenik i ulur
PS)C

Pyetja 68 V)2

Në insuficiencën renale akute të shkaktuar nga nekroza tubulare akute gjejmë

A) PS në urinë të rritur.
B) Rritje të eliminimit të uresë.
C) Rritje te eliminimit të acidit urik.
D) Rritje të fluksit plazmatik renal.
E) Ekskretim te natriumit relativisht te rritur.
PS)E

Pyetja 69 V)1

Anemia hipokromike mikrocitike i detyrohet mungesës së

A) Vitaminës B12.
B) Hekurit.
C) Acidit folik.
D) Acidit folik + vitaminës B12.
E) Aminoacideve esenciale.
PS)B

Pyetja 70 V)2

Cila prej simptomave të mëposhtme nuk dallohet në akromegalinë e skeletit ?

A) Osteoliza e falangeve terminale
B) Sela turcica më e gjerë
C) Tuberkulë selare më e shprehur
D) Diploe e dendësuar
E) Kondile mandibulare të theksuara
PS)A

Pyetja 71 V)1

Në shumicën e rasteve, përgjegjëse për shokun anafilaktik tek njeriu është imunoglobulina

A) IgA.
B) IgE.
C) IgM.
D) IgD.

E) IgG e tipit joreakativ.
PS)B

Pyetja 72 V)1

Cili nga barnat e mëposhtëm ka veprim antimykotik?

A) Neomicina
B) Tifamicina
C) Polimiksina B
D) Bacitracina
E) Griseofulvina
PS)E

Pyetja 73 V)2

Në cilën nga situatat e mëposhtme rritet magnezemia ?

A) Alkoolizëm kronik
B) Tetanoz
C) Hiperaldosteronizëm
D) Insufiçiencë renale kronike oligurike
E) Tireotoksikozë
PS)D

Pyetja 74 V)3

Cila simptomë nuk është e pranishme në sindromën Schmidt ?

A) Hipotiroidizëm
B) Insuficiencë kortikosurrenale
C) Rënie e 17 OH-streoideve
D) Diabet
E) Kardiomegali
PS)E

Pyetja 75 V)1

Cila nga substancat e mëposhtme është simpatikomimetike?

A) Pilokarpina
B) Dopamina
C) Arekolina
D) Muskarina
E) Fizostigmina
PS)B

Pyetja 76 V)2

Aktiviteti i ulur hemolitik komplementar total (hipokomplementemia) që shfaqet në glomerulonefritin akut karakterizohet nga kjo sjellje reciproke e fraksioneve C3 dhe C4 të komplementit

A) C3 e reduktuar dhe C4 normale.
B) C3 e reduktuar dhe C4 e reduktuar.
C) C3 e reduktuar dhe C4 e rritur.
D) C3 normale dhe C4 e reduktuar.
E) C3 e rritur dhe C4 e reduktuar.
PS)A

Pyetja 77 V)1

Sa është numri i kockave të veshit të mesëm?

A) 5
B) 3
C) 4
D) 10
E) 2
PS)B

Pyetja 78 V)1

Cilën ose cilat nga formacionet vaskulare takon ansa e nervit rekurrent të majtë?

A) Arterien subklavia të majtë
B) Venën subklavia të majtë
C) Dy të mësipërmet
D) Degën e majtë të trungut pulmonar
E) Harkun e e aortës
PS)E

Pyetja 79 V)2

Në cilën gjendje dallohet blloku alveolo-kapilar?

A) Versamenti perikardial
B) Perikarditi konstriktiv
C) Tamponada kardiake
D) Fibroza intersticiale pulmonare
E) Vesi mitral i trikuspidalizuar
PS)D

Pyetja 80 V)3

Transmetimi i zërit, edhe pse i pështpëritur në nivel të kolonës poshtë vertebrave III-IV torakale (shenja Espine), na bën të dyshojmë për një:

A) Stenozë trakeale.
B) Stenozë të bronkut të lobit pulmonar të poshtëm.
C) Atelektazi të lobit të mesëm pulmonar.
D) Masë mediastinike anteriore.
E) Mase mediastinike posteriore.
PS)E

Pyetja 81 V)2

Cila nga sëmundjet e mëposhtme përkufizohet edhe si "the little imitator" për shkak të aftësisë për të simuluar katër të tjerat?

A) Apendicit akut
B) Helmimi nga Pb (plumbi)
C) Sindroma Korsakoff
D) Okluzioni intestinal
E) Porfiria akute intermitente
PS)E

Pyetja 82 V)2

Në sindromën nefrozike nga skleroza glomerulare, beta-1 C globulina:

A) Është normale
B) Është e reduktuar
C) Është e rritur
D) Mungon
E) Është thellësisht e denatyruar
PS)A

Pyetja 83 V)2

Cila nga këto nefropati shoqërohet shumë shpesh nga hiperuricemia?

A) Glomerulonefroza
B) Saturnizmi
C) Neoplazia renale
D) Ekinokokoza renale
E) Hipertensioni nefrovaskular
PS)B

Pyetja 84 V)2

Pas menopauzës, involucioni uterin:

A) Është më i lartë në qafë sesa në trup.
B) Është më i lartë në trup sesa në qafë.
C) Është njëlloj në të dy segmentet.
D) Nuk ekziston
E) Përcillet përmes rritjes së trupit dhe një reduktim të lehtë të qafës.
PS)A

Pyetja 85 V)1

Glukozuria me grafik normal të ngarkesës me glukozë vërehet në:

A) Diabetin melit.
B) Diabetin hipofizar.
C) Diabetin insipid.
D) Diabetin akromegalik.
E) Diabetin renal.
PS)E

Pyetja 86 V)2

Në atrofine akute flava, rezulton e ulur:

A) Amoniemia.
B) Bilirubinemia totale.
C) Urobilinuria.
D) Protrombinemia
E) ?-Glutamiltranspeptidaza
PS)D

Pyetja 87 V)1

Dhembja në anus pas defekimit është shenje e:

A) Kancerit të sigmës rektale.
B) Abcesit pelvik.
C) Hipertrofisë së prostatës.
D) Fisurës anale.
E) Polipozës rektale.
PS)D

Pyetja 88 V)1

Splenomegalia nga kolagjenopatia është ajo e:

A) Leishmaniozës.

B) Amiloidozës.
C) Dermatomiozitit.
D) Malaries.
E) Lipidozës cerebrozidike.
PS)C

Pyetja 89 V)2

Në një litër të një tretësire molare të glukozës përmbahen:

A) 4,5 gr glukozë.
B) 9 gr glukozë.
C) 18 gr glukozë.
D) 36 gr glukozë.
E) 72 gr glukozë.
PS)C

Pyetja 90 V)2

Paraliza radikulare e muskujve të eminencës hipotenare duhet të na bëjë të supozojmë përfshirjen e fibrave nervore medulare që dalin nga:

A) C5.
B) C6.
C) C7.
D) C8.
E) T1.
PS)D

Pyetja 91 V)2

Në cilën situatë nuk dallohet pulsi i shpejtë?

A) Ductus Botalli apertum
B) Hipertiroidizëm
C) Aneurizma të mëdha arterio-venoze
D) Stenozë aortike
E) Gjendje të shtuara febrile
PS)D

Pyetja 92 V)3

Lokalizimi patognomonik në artritin reumatoid është alterimi që vërehet në nivel të

A) Artikulacionit II dhe III metakarpofalangeal.
B) Artikulacionit karpo-metakarpik.
C) Artikulacionit skapulo-humeral.

D) Artikulacionit te gjurit.
E) Artikulacionit talo-krural.
PS)A

Pyetja 93 V)2

Në cilën situatë nuk mund të eliminohet 'Fremitus vokale taktile'?

A) Diafragëm kongjenitale laringeale
B) Enfizemë pulmonare
C) Pleurit eksudativ
D) Hidrotoraks
E) Infarkt pulmonar
PS)E

Pyetja 94 V)3

Në flebogramë, faza e kolapsit venoz shprehet nga luhatja

A) Pozitive a.
B) Negative x.
C) Pozitive c.
D) Negative y.
E) Pozitive v.
PS)B

Pyetja 95 V)2

Si matet frekuenca e një dridhjeje zanore?

A) Herc
B) Vat
C) Meter
D) Kyri
E) Xhaul
PS)A

Pyetja 96 V)2

Në cilën prej patologjive të mëposhtme shfaqen iriti, uretriti dhe tendiniti (i tendinit te Akilit)?

A) Sarkoidozë
B) Spondilit ankilopoietik
C) Cistinuri
D) Infeksion kronik i vezikës urinare
E) Porfirinuri
PS)B

Pyetja 97 V)2

Në cilën patologji vërehet 'një leukocitozë me deviacion majtas të grafikut Ameth ?

A) Rikeciozë
B) Cirrozë hepatike
C) Tifo abdominale
D) Infeksione me procese supurative
E) Sëmundje virale
PS)D

Pyetja 98 V)3

Metabolizimi i shtuar i acidit arakidonik tregon:

A) Aktivizim të trombociteve.
B) Displasminogjenemi.
C) Prani në plazëm të kompleksеve të tretshme të monomereve të fibrinës.
D) Fibrinolizë të reduktuar.
E) Diabet latent.
PS)A

Pyetja 99 V)2

Cilët mediatorë paraformohen në granulat e mastociteve dhe bazofileve?

A) Prostaglandinat
B) Histamina dhe faktorët kemiotaktil
C) Oksidi nitrik
D) Leukotrienet
E) Porfirina
PS)B

Pyetja 100 V)2

Fosfataza acide rritet në gjak nga:

A) Osteomalacia.
B) Ikteri okluziv.
C) Sarkoidoza.
D) Karcinoma e prostatës.
E) Neoplazitë hepatike.
PS)D

Pyetja 101 V)2

Ndryshimi tipik i sekretimit të djersës për shkak të rritjes së përqendrimit të NaCl vërehet në:

A) Brucelozë.
B) Mukovishidozë
C) Sudaminë.
D) Hiperhidrozë.
E) Efidrozë.
PS)B

Pyetja 102 V)3

Nga purpurat e mëposhtme, cila përkufizohet si purpura vaskulare?

A) Purpura e Schonlein-Henoch
B) Purpura idiopatike trombocitopenike
C) Purpura trombotike trombocitopenike
D) Sëmundja Werlhof
E) Purpura hiperglobulinemike
PS)A

Pyetja 103 V)2

Goditja perikardike i detyrohet:

A) Zhurmës sistolike nga kontraktimi miokardik.
B) Tërheqjes sistolike të paretit anterior të toraksit.
C) Tërheqjes sistolike të paretit posterior të toraksit.
D) Sklerozës miokardike.
E) Zhurmës protodiastolike anormale për shkak të përfundimit të menjëhershëm të mbushjes së shpejtë.
PS)E

Pyetja 104 V)3

Vesi kardiak kongjenital i emërtuar "shumë zhurmë për asgjë" për simptomatologjinë akustike është:

A) Anomalia Ebstein.
B) Ductus Botalli apertum .
C) Komunikim interventrikular mjaft i madh dhe i gjerë.
D) Komunikim interventrikular mjaft i ulët dhe modest (semundja Roger).
E) Komunikim interatrial.
PS)D

Pyetja 105 V)2

Cila nga kardiopatitë kongjenitale të meposhtme është zakonisht cianogjene?

A) Defekt interventrikular
B) Defekt interatrial
C) Kanali atrioventrikular i përbashkët
D) Stenoza e arteries pulmonare
E) Tetrada e Fallot
PS)E

Pyetja 106 V)1

Cila nga strukturat e mëposhtme nuk është e pranishme në 'mediastinin posterior'?

A) Trakea
B) Azigos
C) Ezofagu
D) Duktusi torakal
E) Aorta descendente
PS)A

Pyetja 107 V)3

Në sindromën Stein-Leventhal ose policistoza ovarike shfaqet:

A) Dobësi trupore.
B) Cikle menstruale të rregullt.
C) 17 Keto-Steroide urinare të ulura.
D) Hirsutizëm.
E) Testosteronemi e ulur.
PS)D

Pyetja 108 V)2

Hipotensioni arterial vërehet zakonisht në:

A) Glomerulosklerozën e Kimmelstiel-Wilson.
B) Insuficiencën aortike.
C) Sindromën Kushing.
D) Fistulën arterio-venozë.
E) Sëmundjen Bartter.
PS)E

Pyetja 109 V)1

Çrregullimi i ndjeshmërisë esteroceptive ose sipërfaqësore është një çrregullim i sensibilitetit:

A) Stereognostik.
B) Presor.

C) Vibrator.
D) Të pozicionit.
E) Taktil.
PS)E

Pyetja 110 V)3

Në njërën nga sëmundjet renale të mëposhtme mund të shfaqet një nefrit intersticial kronik që nuk ka lidhje me komplikimin bakterial. Cila është kjo sëmundje?

A) Veshkë policistike
B) Hidronefrozë kongjenitale
C) Ureterocelë
D) Veshkë në formë patkoi
E) Nefropati nga fenacetina
PS)E

Pyetja 111 V)2

Bakteriofagu është:

A) Një virus patogjen për bakteret.
B) Një faktor rritjeje bakteriale.
C) Një shigelë.
D) Një vibrion.
E) Një rikecie.
PS)A

Pyetja 112 V)1

Në cilën prej sëmundjeve të mëposhtme kemi mungesë të urobilinogjenit në urinë ?

A) Ikter okluziv i plotë
B) Ikter obstruktiv i pjesshëm
C) Hepatopati parenkimale
D) Ikter hemolitik
E) Sëmundje Dubin-Johnson
PS)A

Pyetja 113 V)1

Në hipertensionin portal, hemoragjia që vërehet më shpesh është:

A) Hemoptoe.
B) Melena.
C) Epistaksi.
D) Hematuria.

E) Menorragjia.
PS)B

Pyetja 114 V)2

Në cilën patologji shfaqet 'shenja e balotazhit' ?

A) Megakolon
B) Veshkë e lëvizshme dhe e palpueshme
C) Ansa e zgjeruar mbistenotike
D) Versamenti ascitik
E) Splenomegali
PS)B

Pyetja 115 V)2

Në epilepsinë Jaksoniane epiqendra irritative gjendet:

A) Në lobin temporal.
B) Në lobin pre-frontal.
C) Në cirkonvolucionin frontal ngjitës.
D) Në lobin oksipital.
E) Në talamus.
PS)C

Pyetja 116 V)2

Në cilën prej patologjive gjejmë një ekskretim renal të acidit vanilmandelik sa dyfishi i normës?

A) Tubulonefrozë
B) Infeksion tuberkular renal
C) Cirrozë hepatike
D) Feokromocitomë
E) Hepatopati obstruktive
PS)D

Pyetja 117 V)3

Cilën nga gjendjet e mëposhtme shpreh vala negative ? e flebogramës?

A) Sistola atriale
B) Kontraksion ventrikular të djathtë
C) Faza të kolapsit venoz
D) Mbushje të atriumit të djathtë
E) Boshatisje të atriumit të djathtë
PS)E

Pyetja 118 V)1

Imunoglobulinat IgG gjenden në serum në sasi normale prej:

A) 800-1400 mg/100 ml.
B) 300-500 mg/100 ml.
C) 50-100 mg/100 ml.
D) 40-50 mg/100 ml.
E) 0,5-1,5 mg/100 ml.
PS)A

Pyetja 119 V)1

Prania e monociteve/makrofageve është karakteristike në:

A) Inflamacionin akut.
B) Indin e granulimit.
C) Eksudatin purulent.
D) Inflamacionin kronik.
E) Eksudatin fibrinoz.
PS)D

Pyetja 120 V)2

Në cilën patologji shfaqen edema fuziforme të artikulacioneve interfalangeale?

A) Artrit reumatoid
B) Reumatizem artikulare akute
C) Gute (podagra)
D) Osteoartrozë primare
E) Akropaki
PS)A

Pyetja 121 V)1

Cila nga qelizat e mëposhtme nuk mund të rigjenerohet nëse shkatërrohet?

A) Qeliza adipose
B) Qeliza muskulare
C) Qeliza nervore
D) Qeliza epiteliale
E) Qeliza endoteliale
PS)C

Pyetja 122 V)1

Në insuficiencën aortike kemi:

A) Rritje të presionit maksimal dhe të atij minimal.
B) Ulje të presionit maksimal dhe të atij minimal.
C) Rritje të presionit maksimal dhe ulje të atij minimal.
D) Rritje të presionit minimal dhe ulje të atij maksimal.
E) Nuk ka modifikime të ndjeshme të presionit.
PS)C

Pyetja 123 V)2

Cila nga patologjitë e mëposhtme nuk mund të përfaqësojë 'komplikacione të një kolelitiaze të hershme' ?

A) Absesi hepatik
B) Pankreatiti akut
C) Kolangiti
D) Koledociti
E) Neoplazia hepatike
PS)E

Pyetja 124 V)2

Gjate sindromës së sekretimit të papërshtatshëm të ADH-së (Hormonit Anti-Diuretik) kemi:

A) Rritje të vëllimit plazmatik.
B) Ulje të vëllimit plazmatik
C) Ulje të vëllimit ekstraqelizor.
D) Ulje të vëllimit intraqelizor.
E) Sekretim të shtuar të aldosteronit.
PS)A

Pyetja 125 V)2

Në cilën prej patologjive të mëposhtme kemi zmadhim të atriumit të djathtë?

A) Sindromën Ebstein
B) Stenozën aortike
C) Stenozën mitrale
D) Koartacionin aortik
E) Kompleksin e Eisenmenger
PS)A

Pyetja 126 V)3

"Njollat e Koplik" shfaqen gjatë:

A) Fruthit.

B) Herpes zoster.
C) Erizipelës.
D) Lisë.
E) Mononukleozës infektive.
PS)A

Pyetja 127 V)2

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është provë e screening të hemostazës?

A) Koha e koagulimit
B) Koha e hemorragjisë
C) Koha e tromboplastinës së pjesshme
D) Koha e protrombinës
E) Numri i trombociteve
PS)A

Pyetja 128 V)2

Cili prej parametrave të mëposhtëm nuk është normal në rastet e anemisë për shkak të hemorragjisë akute, menjëherë pas humbjes së gjakut?

A) Hemoglobina
B) Retikulociti
C) Hematokriti
D) Volemia
E) Numri i rruazave te kuqe
PS)D

Pyetja 129 V)1

Cilit prej formacioneve të mëposhtëm i detyrohet harku i dytë në profilin e djathtë të zemrës?

A) Arteries pulmonare
B) Ventrikulit të djathtë
C) Aortës
D) Atriumit të djathtë
E) Venës cava superior
PS)D

Pyetja 130 V)1

Gjatë ekzaminimit radiologjik, hija e vogël renale shfaqet në:

A) Sindromën nefrozike.
B) Nefropatinë policistike.
C) Glomerulonefritin kronik.

D) Hidronefrozën.
E) Hipernefromën.
PS)C

Pyetja 131 V)1

Cila nga të mëposhtmet është formula e alkoolit etilik?

A) CH3-OH
B) CH3-CH2OH
C) CH3-CH2-CH2OH
D) CH3-CH2-CH2-CH2OH
E) CH2OH I CH2OH
PS)B

Pyetja 132 V)2

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme patologjike zbulohet osteopatia infektive?

A) Sëmundja Paget
B) Rakitizmi
C) Atrofia kockore e Sudeck
D) Sindroma Albright
E) Sifilizi
PS)E

Pyetja 133 V)2

Në cilën prej gjendjeve zbulohet 'kretinizmi'?

A) Hipotiroidizëm nga dishormonogjeneza
B) Tiroiditi Hashimoto
C) Të dhëna për tiroidit të rëndë
D) Tiroidektomi totale
E) Hipotiroidizëm nga mungesa e fituar e TSH
PS)A

Pyetja 134 V)1

Një infeksion i rrugëve urinare diagnostikohet kur numri i kolonive bakteriale gjatë ekzaminimit te urokulturës është (për ml) më i madh se:

A) 1000.
B) 10 000.
C) 100 000.
D) 500 000.
E) 1 000 000.

PS)C

Pyetja 135 V)3

Cila nga sëmundjet e mëposhtme infektive zhvillon me shpesh miokardit?

A) Fruthi
B) Lija e dhenve
C) Skarlatina
D) Bruceloza
E) Parotiti
PS)C

Pyetja 136 V)1

Zona glomerulare e kortikales së mbiveshkores sekreton:

A) Hormone mineralokortikoide.
B) Hormone glukokortikoide.
C) Androgjene.
D) Estrogjene.
E) Katekolamina.
PS)A

Pyetja 137 V)1

Proteina C reaktive është:

A) Një pentraksinë.
B) Një kolektinë.
C) Një proteinë e transduktimit të sinjalit të aktivizimit të limfociteve T.
D) Një proteinë e transduktimit të sinjalit të aktivizimit të limfociteve B.
E) Një proteinë e transduktimit të sinjalit të mastociteve.
PS)A

Pyetja 138 V)2

Mielofibroza është një sëmundje me:

A) Splenomegali.
B) Osteoporozë të përhapur.
C) Fibrozë hepatike.
D) Hematuri.
E) Alopeci
PS)A

Pyetja 139 V)3

Në cilën pneumopati hemoptoe shfaqet njëkohësisht ose pak përpara shfaqjes së nefropatisë?

A) Sëmundja Bartter
B) Sëmundja Goodpasture
C) Sëmundja De Toni-Debre-Fanconi
D) Veshkë tuberkulare
E) Sëmundja Kimmelstiel-Wilson
PS)B

Pyetja 140 V)2

Në cilin prej rasteve të mëposhtëm vërehet rritje e ndjeshme e trupave ketonikë në gjak?

A) Diabet melit i rëndë
B) Diabet hipofizar
C) Diabet renal
D) Diabet insipid
E) Sindromë nefrozike
PS)A

Pyetja 141 V)1

Cila nga drithërat e mëposhtme ka mesatarisht përmbajtjen më të lartë të celulozës (>2 gr %) ?

A) Krundet
B) Orizi
C) Misri
D) Mielli i thekrës
E) Mielli i grurit integral
PS)E

Pyetja 142 V)1

Të gjitha valvulat kardiake rezultojnë të mbyllura gjatë ciklit kardiak në fazën e:

A) Kontraktimit ventrikular izometrik.
B) Mbushjes së shpejtë ventrikulare.
C) Diastazës.
D) Efluksit ventrikular.
E) Sistolës atriale.
PS)A

Pyetja 143 V)2

Cila prej të dhënave të mëposhtme tek një subjekt i prekur nga tuberkulozi pulmonar, na bën të dyshojmë më shume se të tjerët për një proçes në aktivitet?

A) Zbehtësia e lëkurës
B) Leukocitoza neutrofile
C) Kolla persistente
D) Eritrosedimentacioni i rritur
E) Astenia juvenile
PS)D

Pyetja 144 V)2

Shenjë karakteristike e intoksikimit me digitalis është:

A) Diarrea.
B) Dridhja me lëkundje të vogla.
C) Fibrilacioni atrial.
D) Akufenia.
E) Bigeminizmi ekstrasistolik ventrikular.
PS)E

Pyetja 145 V)2

Dora si kthetër është tipike e:

A) Artritit reumatoid.
B) Sklerozës laterale amiotrofike.
C) Sklerozës multiple.
D) Siringomielisë.
E) Tabes dorsalis.
PS)B

Pyetja 146 V)2

Presioni fillestar likuoral është normal në shumicën e rasteve të:

A) Meningitit tuberkular.
B) Hemorragjisë subaraknoide.
C) Meningitit purulent akut.
D) Hemorragjisë cerebrale.
E) Sklerozës me pllaka.
PS)E

Pyetja 147 V)2

Në granulomatozën pulmonare të Wegener dallojmë shpesh:

A) Glomerulonefrit.
B) Cirrozë hepatike.
C) Periartrit skapulo-homeral.
D) Pankreatit kronik.
E) Pneumotoraks.
PS)A

Pyetja 148 V)2

Në sëmundjen Addison, përveç hiponatremisë, zakonisht kemi edhe:

A) Hipokalemi.
B) Hiperkloremi.
C) Hiperglicemi.
D) Hiperkalemi.
E) Hiperbikarbonatemi.
PS)D

Pyetja 149 V)3

Karcinoma e stomakut jep më shpesh metastaza:

A) Në mushkëri.
B) Në vertebra.
C) Në tru.
D) Në linfonodujt tributarë.
E) Në ovare.
PS)D

Pyetja 150 V)2

Në cilën gjendje nuk dallohet nefrokalcinoza e shkaktuar nga kalciuria persistente?

A) Acidozës tubulare
B) Hiperparatiroidizmit
C) Hipertiroidizmit
D) Sindromës nga qumështi dhe lëndët alkaline
E) Oksalozës
PS)C

Pyetja 151 V)2

Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk konsiderohet si faktor predispozues për zhvillimin e kancerit të gjirit?

A) Primipariteti i vonshëm
B) Kohëzgjatja më e vogël totale e ushqyerjes me gji

C) Menarka e vonshme
D) Hiperestrogjenizmi
E) Përdorimi i kontraceptiveve përpara shtatzënisë së parë
PS)C

Pyetja 152 V)2

Sindroma obstruktive e hepatokoledokut me shkak organik ekstrinsek është ajo që i detyrohet:

A) Koledocitit kronik.
B) Litiazës biliare.
C) Stenozës cikatriciale intraduktale.
D) Odditit stenozant sklero-atrofik.
E) Neoplazisë së kokës së pankreasit.
PS)E

Pyetja 153 V)3

Në fibrinolizën sistemike primare dallojmë:

A) Rritje të antiplazminës.
B) Rritje të plazminës.
C) Rritje të faktorit V të koagulimit.
D) Rritje të faktorit VIII të koagulimit.
E) Ulje të PDF (produkte të fragmentimit të fibrinogjenit).
PS)B

Pyetja 154 V)2

Në leuceminë limfatike kronike, gamaglobulinat:

A) Mungojnë.
B) Ulen.
C) Janë normale.
D) Rriten.
E) Rriten së tepërmi.
PS)B

Pyetja 155 V)3

Pepsinogjeni hematik rritet në:

A) Ulcerën duodenale.
B) Gastritin atrofik.
C) Neoplazinë gastrike.
D) Sëmundjen Addison.

E) Aneminë pernicioze.
PS)A

Pyetja 156 V)3

Edemat e gjymtyrëve të poshtme, në krah dhe në hemitoraksin e majtë, me versament kiloz në hapësirën peritoneale dhe pleurike, dallohen në shtypjen mediastinike të:

A) Trungut pulmonar.
B) Venave pulmonare.
C) Venes cava superior.
D) Duktusit toracik.
E) Arterieve te mëdha.
PS)D

Pyetja 157 V)3

Në poliomielit dallojmë gjithë shenjat e mëposhtme, përveç:

A) Manifestimeve prodromike katarrale 2-5 ditë përpara shfaqjes.
B) Shfaqjen e paralizës brenda pak ditëve.
C) Mungesë të çrregullimeve të ndjeshmërisë.
D) Lokalizimit simetrik të manifestimeve.
E) Disociacion cito-albuminik në lëngjet e ditëve të para.
PS)D

Pyetja 158 V)3

Në rabdomiolizë mund të rritet:

A) GOT.
B) CPK-MB.
C) CPK.
D) CHE.
E) GammaGT.
PS)C

Pyetja 159 V)2

Reaksioni i Arthus është një reaksion imun nga:

A) Antikorpet serike që reagojnë me antigjenet e konjuguar me qeliza indore.
B) Antikorpet precipitante që reagojnë me antigjenin në hapësirat indore, gjatë mureve të vazave ose në qarkullim.
C) Antikorpet serike që reagojnë me përbërësit e qelizave indore.
D) Limfocitet që reagojne direkt me antigjenin.
E) Antikorpet serike që reagojnë me haptene të konjuguar me qeliza indore.

PS)B

Pyetja 160 V)2

Edema mund të fillojë pas abuzimit me barna laksative për shkak të:

A) Hiponatremisë.
B) Hipokloremisë.
C) Hipolipemisë.
D) Hiperlipemisë.
E) Hipopotasemisë.
PS)E

Pyetja 161 V)3

Në cilën prej sëmundjeve të mëposhtme dallohet 'koilonikia' ?

A) Anemitë sideropenike
B) Sëmundja Raynaud
C) Veset kongjenitale të zemrës
D) Pneumopatia kronike
E) Celiakia
PS)A

Pyetja 162 V)3

Në cilën prej gjendejeve të mëposhtme dallohet blloku alveolo-kapilar (pneumopatia intersticiale e përhapur) ?

A) Kifoskoliozë
B) Sëmundjen Pickwick
C) Sarkoidozë
D) Astmë bronkiale
E) Emfizemë pulmonare
PS)C

Pyetja 163 V)2

Nefropatia që vërehet më shpesh gjatë sforcimeve të lindjes është:

A) Glomerulonefriti akut.
B) Sindroma nefrozike.
C) Nekroza kortikale renale bilaterale simetrike.
D) Glomerulonefriti i Goodpasture.
E) Glomeruliti segmentar.
PS)C

Pyetja 164 V)2

Përqëndrimi serik i proteinave rritet në:

A) Diabet latent.
B) Diabet insipid.
C) Diabet melit.
D) Diabet idiopatik .
E) Diabet gjatë shtatzënësisë.
PS)B

Pyetja 165 V)1

Imunoglobulinat përbëhen nga:

A) 48 zinxhirë polipeptidikë.
B) 24 zinxhirë polipeptidikë.
C) 12 zinxhirë polipeptidikë.
D) 8 zinxhirë polipeptidikë.
E) 4 zinxhirë polipeptidikë.
PS)E

Pyetja 166 V)2

Përmbajtja e glucideve në bukën e bardhë është mesatarisht:

A) Gr 20%.
B) Gr 40%.
C) Gr 60%.
D) Gr 80%.
E) Gr 85%.
PS)C

Pyetja 167 V)1

Valët zanore përhapen:

A) Në vijë të drejtë.
B) Në mënyrë oblike .
C) Në mënyrë transversale.
D) Në mënyrë pingule.
E) Në mënyrë sferike.
PS)E

Pyetja 168 V)2

Në atrofinë akute flava kemi ulje të:

A) Transaminazemisë.
B) Pseudokolinesterazës.
C) Bilirubinemisë totale.
D) Urobilinurisë.
E) Amoniemisë.
PS)B

Pyetja 169 V)2

Interferoni dezintegrohet me shpejtësi:

A) Nga kimiotripsina.
B) Nga ribonukleaza.
C) Nga dezoksiribonukleaza.
D) Nga papaina.
E) Nga plazmina.
PS)A

Pyetja 170 V)1

Eozinofilet vrasin kryesisht:

A) Qelizat e infektuara nga viruset.
B) Bakteret.
C) Qelizat allogjenike.
D) Parazitët.
E) Qelizat tumorale.
PS)D

Pyetja 171 V)3

Në sëmundjen von Willebrand dallojmë:

A) Cianozë.
B) Kohë të hemorragjisë të shkurtuar.
C) Trombocitopati.
D) Trombocitopeni.
E) Rritje të faktorit VIII të hemokoagulimit.
PS)C

Pyetja 172 V)2

Sëmundja kostitucionale nga trisomia 21 është:

A) Mongolizmi.
B) Sëmundja Klinefelter.

C) Sëmundja Turner.
D) Sëmundja Raynaud.
E) Sëmundja Felty.
PS)A

Pyetja 173 V)2

Projektimi mbi paretin torakal të ndarëses që ndan në të djathtë lobin pulmonar të mesëm nga ai i sipërm, shtrihet përpara nga vija aksilare posteriore duke ndjekur

A) Brinjen III.
B) Brinjen IV.
C) Brinjen V.
D) Brinjen VI.
E) Brinjen VII.
PS)B

Pyetja 174 V)3

Tek subjektet neurolabilë, aerofagia me zgjerim të konsiderueshëm të bulës gastrike provokon shpesh

A) Dhembje në zonën apendikulare.
B) Ekstrasistoli.
C) Kollë.
D) Claudicatio intermittens.
E) Lombalgji.
PS)B

Pyetja 175 V)3

Sindroma e De Toni-Debre-Fanconi tek i rrituri mund të provokohet ndonjëherë nga

A) Glomerulonefriti akut i përhapur.
B) Diabeti insipid.
C) Sindroma nefrozike.
D) Litiaza renale.
E) Mieloma multiple.
PS)E

Pyetja 176 V)2

Dispnea nga insuficienca pulmonare obstruktive dallohet si

A) Atelektazi.
B) Astmë bronkiale.
C) Fibrozë pulmonare.

D) Pneumoni.
E) Versament pleural.
PS)B

Pyetja 177 V)1

Në një dietë që përmban mesatarisht 50 gr lipide, koeficienti i përthithjes së yndyrnave, normalisht është baraz me

A) 50-55%.
B) 60-65%.
C) 70-75%.
D) 80-85%.
E) 93-95%.
PS)E

Pyetja 178 V)2

Cila nga sëmundjet e mëposhtme ndikohet në mënyrë të favorshme nga administrimi i vazopresinës?

A) Diabeti melit
B) Diabeti renal
C) Diabeti insipid
D) Diabeti idiopatik
E) Nefropatia hiperkalcemike (sindroma alkaline)
PS)C

Pyetja 179 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme është lezion malinj i gjirit?

A) Mastopatia fibrocistike
B) Fibroadenoma
C) Mastiti
D) Sëmundja Paget
E) Galaktocela
PS)D

Pyetja 180 V)1

Kaliumi (K+) ushqimor përthithet në nivel të

A) Fundusit të stomakut.
B) Antrumit gastrik.
C) Zorrës së hollë.
D) Cekumit.

E) Kolonit ashendent dhe transvers.
PS)C

Pyetja 181 V)2

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme dallojmë hiperlipemi?

A) Nefrozë me lezione minimale
B) Hipertiroidizëm
C) Sindrome malabsorbimi
D) Sindrome diarreike
E) Avitaminoze B
PS)A

Pyetja 182 V)2

Prania e një pakete limfonodale të izoluar me konsistencë të fortë 'si dru' që i korrespondon fosës supraklavikulare sinistra tregon:

A) Limfomë.
B) Metastazë të neoplazive pulmonare.
C) Metastazë të karcinomës gastrike.
D) Limfoadenit tubercular.
E) Sarkoidozë.
PS)C

Pyetja 183 V)2

Tiroiditi i Hashimoto në 25% të rasteve shoqërohet më të gjithë sëmundjet e mëposhtme, përveç:

A) Artritit reumatoid.
B) Sindromës Sjogren.
C) Pielonefritit.
D) Sklerodermisë.
E) Eritrodermisë.
PS)C

Pyetja 184 V)3

Sëmundja Berger karakterizohet nga depozita granuloze mezangiale të imunoglobulinave, fraksionit C3 të komplementit etj, por me mbizotërim të dukshëm të:

A) IgA.
B) IgG.
C) IgM.
D) C3.

E) Properdinës.
PS)A

Pyetja 185 V)3

Cila nga enzimat e mëposhtmë është e rëndësishme për prodhimin e prostaglandinave?

A) Ciklooksigjenaza I dhe II (COX 1) (COX2)
B) Mieloperoksidaza
C) 5- Lipooksigjenaza
D) 12- Lipooksigjenaza
E) Oksid nitrik sintetaza
PS)A

Pyetja 186 V)2

Dhimbja frenike i korrespondon të gjithë zonave të mëposhtme, me përjashtim të:

A) krahut homolateral.
B) shpatullës homolaterale.
C) anës së përparme të muskulit trapez.
D) rajonit akromial homolateral.
E) rajonit nënklavikular homolateral.
PS)A

Pyetja 187 V)3

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme vërehet papiledema me repert në vatër si "fije pambuku" në fund të syrit ?

A) hipertension arterial i shkallës së ulët
B) hipertension arterial i shkallës së mesme
C) hipertension arterial i rëndë
D) hipertension arterial malinj
E) diabet melit
PS)D

Pyetja 188 V)2

Vendndodhje e rrallë e karcinomës së stomakut është:

A) Pilori.
B) Kurbatura minor.
C) Pjesa kardiale.
D) Pareti anterior ose posterior i trupit gastrik.
E) Kurbatura major.
PS)D

Pyetja 189 V)2

Shenjë klinike e mungesës së vitaminës A është shfaqja e:

A) Rakitizmit.
B) Osteomalacisë.
C) Stomatitit angular.
D) Hemeralopisë.
E) Pelagrës.
PS)D

Pyetja 190 V)1

Amoniemia gjendet në gjakun venoz zakonisht në sasi:

A) 5-10 mikrogram %.
B) 15-25 mikrogram %.
C) 30-70 mikrogram %.
D) 75-100 mikrogram %.
E) 110-120 mikrogram%.
PS)C

Pyetja 191 V)1

Disfagia sideropenike është karakteristike e

A) Sindromës Plummer-Vinson.
B) Sindromës Heerfordt.
C) Sindromës Mikulicz.
D) Sindromës alterne të Millard-Gubler.
E) Sindromës nefrozike.
PS)A

Pyetja 192 V)2

Një bradikardi e reflektuar nga përgjigja vagale karakterizon shokun:

A) Kardiogjen primar.
B) Kardiogjen sekondar.
C) Septik.
D) Neurogjen.
E) Hipovolemik.
PS)D

Pyetja 193 V)2

Cila nga gjendjet e mëposhtme vërehet gati gjithmonë në 'pielonefritin akut '?

A) Ndryshime morfologjike të kaliceve
B) Reduktim i ekzaminimit radiologjik të hijeve renale
C) Funksionalitet renal i ruajtur mirë
D) Urokulturë sterile
E) Hipertension arterial
PS)C

Pyetja 194 V)2

Gurët e oksalatit të kalciumit kanë konsistencë:

A) Të butë.
B) Të fortë.
C) Të shkrifët.
D) Shumë të fortë.
E) Mesatare.
PS)D

Pyetja 195 V)1

Insulina formohet nga:

A) Dy vargje polipeptidike të lidhur nga dy ura disulfurore.
B) Tre vargje polipeptidike të lidhur nga tre ura disulfurore.
C) Katër vargje polipeptidike të lidhur nga katër ura disulfurore.
D) Gjashtë vargje polipeptidike të lidhur nga dy ura disulfurore.
E) Tetë vargje polipeptidike të lidhur nga gjashtë ura disulfurore.
PS)A

Pyetja 196 V)3

Sindroma e vjedhjes se subklavias karakterizohet nga të gjithë fenomenet e mëposhtëm, përveç:

A) Ndryshimit të presionit mes gjymtyrëve të sipërme.
B) Asimetrisë së pulseve të gjymtyrëve të sipërme.
C) Zhurmës nga fishkëllima në zonën supraklavikulare.
D) Çrregullimeve iskemike të gjymtyrës së sipërme homolaterale.
E) Inversionit të fluksit të gjakut në arterien vertebrale kontrolaterale.
PS)E

Pyetja 197 V)2

Zgjatja e segmentit P-R ne EKG dallohet me shpeshtësi të rritur në:

A) Manifestimet akute të artritit reumatoid.
B) Manifestimet akute të sëmundjes reumatizmale.
C) Osteoartrozen ankilopoietike.
D) Atakun akut të gutës.
E) Artritin akut nga gonokoku.
PS)B

Pyetja 198 V)2

Nga se është i përbërë sfinkteri pilorik?

A) Nga një dendësim i shtresës muskulare longitudinale gastrike
B) Nga muskuli pilorik
C) Nga fibra muskulare të veçanta që vijnë nga duodeni
D) Nga një dendësim i shtresës muskulare rrethore gastrike
E) Nga një dendësim i të dy shtresave të muskulatures gastrike
PS)D

Pyetja 199 V)3

Në cilin prej infiltrimeve eozinofilike të pulmonit mungon gjithmonë splenomegalia?

A) Sëmundja Hodgkin
B) Eozinofilia tropikale
C) Granulomatoza alergjike
D) Infiltrimi eozinofilik i Loeffler
E) Periartriti nodoz
PS)D

Pyetja 200 V)3

Në enzimopatitë ereditare të lokalizuara mbi rrugën e Embden-Meyerhof ajo që ka më pak gjasa hemolitike është enzimopatia e shkaktuar nga mungesa e

A) Ekzokinazës.
B) Triozofosfat-izomerazës.
C) Fosfofrukto-kinazes.
D) Piruvat-kinazes.
E) ATP eritrocitare.
PS)C

Pyetja 201 V)2

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme rritet zakonisht 'amoniemia'?

A) Hepatit akut anikterik
B) Hepatit kronik persistent

C) Atrofi akute flava
D) Hepatit kronik aktiv
E) Ikter mekanik
PS)C

Pyetja 202 V)1

Cili nga të mëposhtmit është bar ganglioplegjik?

A) Digitali
B) Kokaina
C) Morfina
D) Dopamina
E) Hekzametoniumi
PS)E

Pyetja 203 V)2

Ekzaminimi radiologjik i toraksit në sindromën obstruktive pulmonare kronike të tipit emfizematoz (pink puffer) tregon zakonisht:

A) Fusha pulmonare normotransparente.
B) Rritje të diametrave kardiake.
C) Diametra kardiakë normale.
D) Diafragmën normale.
E) Dendësi pulmonare të shtuar.
PS)C

Pyetja 204 V)2

Në sklerozën me pllaka (sklerozën multiple) shenja më e zakonshme mes shenjave të mëposhtme është:

A) Nistagmus.
B) Vertigo.
C) Spasticitet.
D) Çrregullime të të folurit.
E) Hipoestezi.
PS)C

Pyetja 205 V)1

Përmbajtja normale e natriumit (Na) në djersë varion ndërmjet vlerave:

A) 1-2 mq/l.
B) 2-3 m Eq/l.
C) 3-5 m Eq/l.

D) 5-80 m Eq/l.
E) 80-140 m Eq/l.
PS)D

Pyetja 206 V)1

Cili nga faktorët e mëposhtëm është "faktor risku" për një tromboflebit?

A) Obeziteti
B) Mosha e re
C) Përkatësia në grupin e gjakut O
D) Seksi mashkull
E) Anemia
PS)A

Pyetja 207 V)2

Prostatektomia shoqërohet me:

A) Osteoporozë.
B) Anemi.
C) Ejakulacion retrograd.
D) Ejakulacion prekoks.
E) Ejakulacion të vonuar.
PS)C

Pyetja 208 V)2

Sekretimi autokrin është:

A) Sekretim autonom me ndikim mbi qelizat përreth.
B) Sekretim që nëpërmjet intersticiumit vepron mbi vetë qeliza sekretuese.
C) Sekretim që ezaurohet brenda vetë qelizës sekretuese.
D) Sekretim që ndikon mbi organin në të cilin bëjnë pjesë qelizat sekretuese.
E) Sekretim që vetëshkaktohet.
PS)B

Pyetja 209 V)1

Melatonina paraqet ritëm circadian të sinkronizuar me alternimin e:

A) Gjumit/zgjimit.
B) Gjendjes esëll/gjendjes pas të ngrënit.
C) Errësirës/dritës.
D) Të ftohtit/të ngrohtit.
E) Aktivitetit fizik/pushimit fizik.
PS)C

Pyetja 210 V)1

Një substancë quhet hormon kur:

A) Sintetizohet nga një qelizë dhe vepron mbi po të njëjtën qelizë.
B) Transportohet me rrugë limfatike dhe ushtron 'veprime' mbi qelizat shenjë (target).
C) Sintetizohet, transportohet në qarkullim dhe ushtron 'veprime' mbi qelizat shenjë (target).
D) Sintetizohet nga qelizat endokrine dhe vepron në përqendrim të ulët.
E) Sintetizohet nga qelizat endokrine dhe ushtron veprimin vetëm kur ndodhet në përqendrim shumë të lartë.
PS)C

Pyetja 211 V)1

Melatonina është një hormon:

A) Indolik.
B) Steroid.
C) Polipeptidik.
D) Glukoproteik.
E) Peptidik.
PS)A

Pyetja 212 V)1

Tek personat e shëndetshëm, TRH stimulon sekretimin e:

A) TSH dhe GH.
B) TSH dhe ACTH.
C) TSH dhe PRL.
D) TSH dhe LH.
E) TSH dhe AVP.
PS)C

Pyetja 213 V)1

Cila nga simptomat e mëposhtme vërehet më shpesh tek gratë në post-menopauzë?

A) Afshet e nxehta dhe djersitjet nokturne
B) Humbjet e kujtesës
C) Frakturat vertebrale
D) Cefaletë
E) Galaktorrea
PS)A

Pyetja 214 V)2

Mekanizmi i feedback-ut negativ të kortizolit vepron mbi:

A) ACTH dhe opioidet.
B) CRH dhe serotoninën.
C) CRH dhe opioidet.
D) CRH dhe ACTH.
E) CRH dhe noradrenalinën.
PS)D

Pyetja 215 V)1

Përqendrimi spermik normal është:

A) >20.000/ml.
B) >200.000/ml.
C) >2.000.000/ml.
D) >20.000.000/ml.
E) >200.000.000/ml.
PS)D

Pyetja 216 V)2

Ritmi infradian është ritëm me interval:

A) Mbi 24 orë
B) Nën 24 orë
C) Nën 24 orë
D) Nën 18 orë
E) Nën 6 orë
PS)A

Pyetja 217 V)1

Cilët janë hormonet e neurohipofizës tek meshkujt?

A) Hormoni antidiuretik (HAD)/argininëvazopresinë dhe oksitocina
B) Prolaktinë dhe HAD
C) GnRH dhe oksitocinë
D) Melatoninë dhe oksitocinë
E) GnRH dhe HAD
PS)A

Pyetja 218 V)1

Sekretimi i GH-së kontrollohet nga:

A) Sistemi i GnRH dhe somatostatina.
B) GnRH.
C) CRH.
D) Sistemi GnRH dhe prolaktina.
PS)A

Pyetja 219 V)1

Gjatë hipoparatiroidizmit në përgjithësi vërehet:

A) Hipokalcemi, hiperfosfatemi, hipokalciuri, hipofosfaturi.
B) Hipokalcemi, hipofosfatemi, hiperkalciuri, hiperfosfaturi.
C) Hiperkalcemi, hipofosfatemi, hiperkalciuri, hipofosfaturi.
D) Hipokalcemi, hiperfosfaturi, hiperkalciuri, hiperfosfaturi.
E) Hiperkalcemi, hipofosfatemi, hipokalciuri, hipofosfaturi.
PS)A

Pyetja 220 V)2

Morbus Addison, morbus Flajani-Basedow dhe disa forma të diabetitinsulinovartës kanë etiopatogjenezë:

A) Inflamatore.
B) Tumoralë.
C) Degjenerative.
D) Nekrotike.
E) Autoimune.
PS)E

Pyetja 221 V)1

Testosteroni i biodisponueshëm përbëhet nga:

A) Fraksioni i lirë dhe fraksioni i lidhur me SHBG-ënë.
B) Fraksioni i lidhur me SHGB ënë dhe fraksioni i lidhur me albuminën.
C) Fraksioni i lirë.
D) Fraksioni i lidhur me albuminën dhe fraksioni i lirë.
E) Fraksioni i lidhur me albuminën.
PS)D

Pyetja 222 V)2

Gjatë sindromës të aplazisë germinale vetëm të qelizave të Sertolit, normalisht vërehet:

A) LH i rritur, FSH i rritur, testosteron i reduktuar, inhibinë normale.
B) LH i reduktuar, FSH i reduktuar, testosteron i reduktuar, inhibinë e reduktuar.

C) LH normal, FSH i rritur, testosteron normal, inhibinë e reduktuar.
D) LH normal, FSH i rritur, testosteron normal, inhibinë e rritur.
E) LH i rritur, FSH i reduktuar, testosteron normal, inhibinë e reduktuar.
PS)C

Pyetja 223 V)1

Vlerat normale të natremisë janë :

A) 100-110 mEq/l.
B) 100-110 mg%.
C) 120-140 mg%.
D) 135-145 mEq/l.
E) 2,5-5,0 mEq/l.
PS)D

Pyetja 224 V)2

Tek gratë, galaktorrea mund të shkaktohet në përgjithësi nga:

A) Hipotiroidizmi dhe hiperparatiroidizmi.
B) Hipoparatiroidizmi dhe hipoprolaktinemia.
C) Hipotiroidizmi dhe hiperprolaktinemia.
D) Hiperprolaktinemia dhe hipoprolaktinemia.
E) Hiperprolaktinemia dhe hiperparatiroidizmi.
PS)C

Pyetja 225 V)2

Tek një mashkull i prekur nga sindroma Kallmann vërehen më shpesh:

A) LH i reduktuar, FSH i rritur, testosteron i reduktuar.
B) LH i rritur, FSH i reduktuar, testosteron normal.
C) LH i rritur, FSH i reduktuar, testosteron i reduktuar.
D) LH i reduktuar, FSH i rritur, testosteron normal.
E) LH i reduktuar, FSH i reduktuar, testosteron i reduktuar.
PS)E

Pyetja 226 V)2

Cili është defekti më i shpeshtë i shikimit tek pacientët me adenomë hipofizare?

A) Hemianopsi temporale
B) Hemianopsi nazal
C) Kuadrantopsia temporale
D) Skotoma
E) Reduktim i mprehtësisë viziv

PS)A

Pyetja 227 V)1

Gjendja funksionale e gjëndrës mbiveshkore vlerësohet më mirë nëpërmjet:

A) Matjes së kortizolit plazmatik në orën 8:00 dhe 23:00.
B) Matjes së kortizolit urinar në dy momente të ndryshme.
C) Matjes së aldosteronit dhe të 17-OH progesteronit.
D) Provës së stimulitmit me ACTH me doza të ulëta.
E) Matjes së kombinuar të kortizolit urinar dhe të ACTH-ësë.
PS)E

Pyetja 228 V)2

Hormonet tiroidiene ushtrojnë veprim feedback negativ mbi:

A) Paratiroidet.
B) Neurohipofizën.
C) Sistemin limbik.
D) Hipofizën anteriore dhe hipotalamusin.
E) Hipofizën anteriore.
PS)D

Pyetja 229 V)1

Cili është përqendrimi fiziologjik i glicemisë në gjendje esëll (mg/dl)?

A) 110-120
B) 70-110
C) 80-160
D) 80-100
E) 50-80
PS)B

Pyetja 230 V)1

Rritja e përqendrimit të glicemisë shkakton rritje të sintezës së:

A) Adrenalinës.
B) Kortizolit.
C) Glukagonit.
D) Hormonit të rritjes.
E) Insulinës.
PS)E

Pyetja 231 V)1

Histotipi më i shpeshtë i adenomës hipofizare është:

A) Adenoma GH-sekretuese.
B) Adenoma ACTH-sekretuese.
C) Adenoma PRL-sekretuese.
D) Adenoma TSH-sekretuese.
E) Adenoma josekretuese.
PS)C

Pyetja 232 V)1

Sinteza e cilit hormon kontrollohet nga somatostatina?

A) Prolaktina
B) Hormoni i rritjes
C) Gonadotropinat
D) Hormoni antidiuretik
E) Kortikotropina
PS)B

Pyetja 233 V)2

Cili është medikamenti më i përdorur për induktimin e ovulacionit tek gratë me sindromë të ovarit polikistik?

A) Tiboloni
B) Troglitazoni
C) Medroksiprogesteron acetati
D) Klomifen citrati
E) Ciproteroni
PS)D

Pyetja 234 V)1

Hormoni antidiuretik vepron mbi:

A) Aparatin jukstaglomerular.
B) Glomerulin.
C) Tubulin proksimal.
D) Ansën Henle.
E) Tubulin distal.
PS)E

Pyetja 235 V)1

Spermatozoidet prodhohen në:

A) Prostatë.
B) Intersticiumin testikular.
C) Tubujt seminiferë.
D) Rete testis.
E) Epididimus.
PS)C

Pyetja 236 V)1

Granulat mature të sekretimit që çlirohen nga pankreasi përmbajnë:

A) Insulinë.
B) Peptid C.
C) Proinsulinë.
D) Insulinë dhe peptid C në përqendrim equimolar dhe sasi të vogla proinsuline.
E) A-ja dhe C-ëja.
PS)D

Pyetja 237 V)2

Cila endokrinopati shoqërohet më shpesh me hiperkolesterolemi?

A) Hipertiroidizmi
B) Hipotiroidizmi
C) Morbus Cushing
D) Morbus Addison
E) Akromegalia
PS)B

Pyetja 238 V)1

Cili ndërlikim klinik vërehet më shpesh gjatë hiperkolesterolemisë familjare?

A) Iktusi cerebral
B) Kardiopatia ishemike
C) Arteriopatia periferike
D) Angina abdominale
E) Demenca senile
PS)B

Pyetja 239 V)1

Frenimi i TSH-ësë me vlera normale të hormoneve tiroidiene flasin për:

A) Hipotiroidizëm subklinik.
B) Hipertiroidizëm subklinik.

C) Hipotiroidizëm klinik.
D) Hipertiroidizëm klinik.
E) Sindromë të rezistencës ndaj hormoneve tiroidiene.
PS)B

Pyetja 240 V)1

Frekuenca e diabetit mellitus tip 1 në popullatën e përgjithshme është:

A) <0,1%.
B) 0,3-0,5%.
C) 3-5%.
D) 10-20%.
E) 20-40%.
PS)B

Pyetja 241 V)2

Gjatë krizës tireotoksike mund të jetë i/e pranishme:

A) Hipertermia.
B) Konstipacioni.
C) Bradikardia.
D) Intoleranca ndaj të ftohtit.
E) Anhidroza.
PS)A

Pyetja 242 V)2

Cila është mbijetesa 20-vjeçare e karcinomës papilare?

A) 15%
B) 35%
C) 45%
D) 65%
E) 95%
PS)E

Pyetja 243 V)1

Cilat të dhëna laboratorike përputhen me hipotiroidizmin sekondar?

A) Përgjigje e ekzagjeruar e TSH ndaj TRH
B) FT3 i ulët dhe FT4 normal
C) FT4 i ulët dhe TSH normal ose i ulët
D) FT3 normal dhe TSH i rritur
E) FT4 dhe TSH të rritur

PS)C

Pyetja 244 V)1

Prodhimi i insulinës:

A) Është i pavarur nga prodhimi i peptidit C.
B) Stimulohet nga përqendrimi i lartë i peptidit C.
C) Inhibohet nga përqendrimi i lartë i peptidit C.
D) Stimulon prodhimin e peptidit C.
E) Është ekuimolar me prodhimin e peptidit C.
PS)E

Pyetja 245 V)1

Vazopresina njihet edhe me emrin:

A) Hormon antidiuretik.
B) Angiotensinë.
C) Oksitocinë.
D) Reninë.
E) Faktor natriuretik atrial.
PS)A

Pyetja 246 V)1

Kariotipi i sindromës Turner është:

A) XXX.
B) YO.
C) XO.
D) XY.
E) XXY.
PS)C

Pyetja 247 V)1

Cila nga substancat e mëposhtme nuk ndikon mbi sekretimin e prolaktinës?

A) Benzodiazepinat
B) ACTH
C) TRH
D) Estrogjeni
E) Dopaminergjikët
PS)B

Pyetja 248 V)2

Citotrofoblasti prodhon:

A) PRL.
B) GH.
C) HCG.
D) Estradiol.
E) Progesteron.
PS)C

Pyetja 249 V)1

Nga cilat qeliza të pankreasit endokrin sekretohet insulina?

A) Qelizat alfa
B) Qelizat beta
C) Qelizat gama
D) Qelizat delta
E) Qelizat alfa dhe beta
PS)B

Pyetja 250 V)1

Katabolizmi i proteinave favorizohet nga:

A) PTH-ëja.
B) Insulina.
C) FSH- ëja.
D) Kortizoli.
E) Prolaktina.
PS)D

Pyetja 251 V)2

Katabolizmi dhe eleminimi i katekolaminave kryhet kryesisht nëpërmjet:

A) Degradimit enzimatik lizozomial.
B) Konjugimit me acidin glukuronik.
C) Deaminimit/dekarboksilimit.
D) Dejodizimit.
E) Kapjes dhe degradimit në nivel qelizor.
PS)C

Pyetja 252 V)2

Cili është markuesi për vlerësimin e ecurisë së karcinomës tiroidiene të diferencuar pas tiroidektomisë totale?

A) CEA
B) Tireoglobulina
C) Kalcitonina
D) Anti-TPO
E) Beta-HCG
PS)B

Pyetja 253 V)1

Enzima 5-alfa-reduktaza katalizon transformimin e:

A) Testosteronit në estradiol.
B) Androstenedionit në estradiol.
C) Testosteronit në dihidrotestosteron.
D) 17-OH-progesteronit në androstenedion.
E) DHEA në androstenedion.
PS)C

Pyetja 254 V)1

Çfarë funksioni kryen oksitocina?

A) Favorizon prodhimin e qumështit.
B) Favorizon fazat e fundit të procesit të lindjes dhe laktacionin.
C) Favorizon fiksimin e kalciumit në kocka.
D) Redukton diurezën.
E) Nuk njihet funksioni i saj tek njerëzit.
PS)B

Pyetja 255 V)1

Gjatë morbus Addison është e pranishme:

A) Dismenorrea.
B) Alopecia.
C) Melanodermia.
D) Pagjumësia.
E) Hiperglicemia.
PS)C

Pyetja 256 V)1

Cili është shkak për hiperprolaktineminë?

A) Gjinekomastia
B) Menopauza

C) Hiposurrenalizmi
D) Terapia me dopaminergjikë
E) Terapia me haloperidol
PS)E

Pyetja 257 V)2

Cili është faktori kryesor i kontrollit inhibitor të lëshimit të prolaktinës?

A) VIP (peptidi intestinal vazoaktiv)
B) Serotonina
C) Dopamina
D) Somatostatina
E) Acetikolina
PS)C

Pyetja 258 V)1

Diametri i folikulit të maturuar, gjatë fazës predeiscente, është:

A) 2 mm.
B) 8 mm.
C) 20 mm.
D) 40 mm.
E) 80 mm.
PS)C

Pyetja 259 V)3

Një vajzë 16-vjeçare, me shëndet të mirë, shfaq amenorre primare. Gjatë ekzaminimit objektiv: organe gjenitale femërore me pak qime pubike dhe aksilare, FSH 9,3 mU/ml, LH 30,5 mU/ml, Testosteron 8,9 ng/ml, DHT 57 ng/dl, PRL 6 ng/ml, E2 50 pg/ml; kariotip
A) Deficit i 5-alfa-reduktazës.
B) Sindromë Klinefelter.
C) Sindromë Morris.
D) Sindromë Kallmann.
E) Vonesë e pubertetit.
PS)C

Pyetja 260 V)2

A ekziston nga pikëpamja statistikore një lidhje në përpjesëtim të drejtë midis rritjes së peshës trupore dhe rritjes së nivelit të presionit arterial?

A) Po, dhe rezulton domethënëse në shumicën e studimeve epidemiologjike.
B) Po, por nuk rezulton domethënëse në shumicën e studimeve epidemiologjike.
C) Jo.

D) Jo, ekziston një lidhje në përpjesëtim të zhdrejtë ndërmjet peshës trupore dhe presionit arterial.
E) Jo, luhatjet e peshës trupore nuk ndikojnë aspak mbi presionin arterial.
PS)A

Pyetja 261 V)1

Angiotensina është një polipeptid që nevojitet për sintezën e:

A) Aldosteronit.
B) Testosteronit.
C) Kortikosteronit.
D) Kortizolit.
E) Epiandrostenedionit.
PS)A

Pyetja 262 V)2

Për të përcaktuar nëse hiperaldosteronizmi është primar apo sekondar duhet të kryhet dozimi i:

A) Natremisë.
B) Aldosteronit plazmatik.
C) Kalemisë.
D) Aktivitetit plazmatik të reninës .
E) Kortizolemisë.
PS)D

Pyetja 263 V)1

Nga se ndryshojnë hormonet që veprojnë mbi receptorët nuklerë nga hormonet që veprojnë mbi receptorët e membranës?

A) Lidhje më e fortë me proteinat plazmatike
B) Gjysmëjetë plazmatike e reduktuar
C) Mungesë e ndërveprimit me mesazherin dytësor
D) Ndërveprim me proteinën G
E) Sekretim pulsues
PS)C

Pyetja 264 V)1

Diabeti insipid qëndror shkaktohet nga:

A) Nefropatia kronike.
B) Oksitocina e tepërt.
C) Mungesa e HAD.

D) Tepria e HAD-së
E) Mungesa e oksitocinës.
PS)C

Pyetja 265 V)1

Cili çrregullim elektrolitik vërehet gjatë morbus Addison primar?

A) Hipokalemi dhe hipokloremi
B) Hipokalemi dhe hipernatremi
C) Hipokalemi dhe hiponatremi
D) Hiperkalemi dhe hipernatremi
E) Hiperkalemi dhe hiponatremi
PS)E

Pyetja 266 V)1

Kolestaza shoqërohet me rritjen e:

A) Triglicerideve.
B) Fosfolipideve.
C) Acideve yndyrore.
D) Kolesterolit.
E) Lp(a).
PS)D

Pyetja 267 V)1

Hormonet steroide derivojnë nga:

A) Metabolizmi i tirozinës.
B) Metabolizmi i pro-opiomelanokortinës.
C) Kolesterolit.
D) Acidit retinoik.
E) 1-25-dihidroksikolekalciferolit.
PS)C

Pyetja 268 V)2

Dëmtimi primar i tubujve seminiferë shkakton:

A) Reduktim të LH- ësë dhe FSH-ësë.
B) Rritje të LH- ësë dhe FSH- ësë normal.
C) Rritje të FSH- ësë.
D) Reduktim të testosteronit.
E) Rritje të testosteronit.
PS)C

Pyetja 269 V)1

Në cilat javë të shtatzënisë HCG- ëja arrin vlera më të larta në urinë?

A) Javët 10-12.
B) Javët 20-22.
C) Javët 30-32.
D) Javët 22-30.
E) Javët 39-40.
PS)A

Pyetja 270 V)2

Efekti më i madh i insulinës me veprim të ndërmjetëm të dhënë me rrugë subkutane arrihet pas:

A) 2-3 orëve.
B) 6-8 orëve.
C) 10-16 orëve.
D) 12-20 orëve.
E) 18-24 orëve.
PS)B

Pyetja 271 V)3

Sindroma Sheehan është hipopituitarizëm i shkaktuar nga:

A) Procese infiltrative të regjionit hipotalamo-hipofizar.
B) Adenoma josekretuese e hipofizës.
C) Nekroza post-partum e hipofizës.
D) Hipofiziti limfocitar autoimun.
E) Deficiti kongjenital i izoluar i gonadotropinave.
PS)C

Pyetja 272 V)2

Ciproteron acetati, që përdoret gjatë terapisë së prostatës, shkakton:

A) Stimulim të biosintezës së androgjeneve në surenale.
B) Rritje të lëshimit të LH nga hipofiza.
C) Inhibim të biosintezës së androgjeneve në surenale.
D) Reduktim të lëshimit të LH nga hipofiza.
E) Rritje të prodhimit testikular të testosteronit.
PS)C

Pyetja 273 V)3

Prania e obezitetit visceral (ose intra-abdominal) shoqërohet shpesh me:

A) Vlera të larta të HDL-ësë.
B) Vlera të ulëta të Lp(a).
C) Lipidogramë normale.
D) HDL e ulët, LDL të vogla dhe dense, trigliceride të larta.
E) HDL normal, trigliceride normale, LDL të larta.
PS)D

Pyetja 274 V)3

Kuadri shumë i rrallë i hipertiroidizmit paraneoplazik mund të shkaktohet nga:

A) Karcinoma medulare e tiroides.
B) Feokromocitoma.
C) Koriokarcinoma.
D) Hipernefroma.
E) Karcinoma ovariene.
PS)C

Pyetja 275 V)1

Insulina:

A) Aktivizon glukoneogjenezën.
B) Frenon glikogjenogjenezën dhe lipogjenezën.
C) Stimulon glikogjenogjenezën dhe lipogjenezën.
D) Stimulon urogjenezën.
E) Stimulon glikogjenolizën dhe lipolizën.
PS)C

Pyetja 276 V)1

Sekretimi i cilit hormon stimulohet nga arginina:

A) TSH.
B) Prolaktina.
C) GH.
D) LH.
E) Vazopresina.
PS)C

Pyetja 277 V)1

Somatostatina kontrollon sintezën e:

A) Prolaktinës.
B) Hormonit të rritjes.
C) Gonadotropinave.
D) Hormonit antidiuretik.
E) Kortikotropinës.
PS)B

Pyetja 278 V)1

Cili nga këto efekte nuk shkaktohet nga terapia me kortizonikë?

A) Retensioni i natriumit
B) Hiperkalemia
C) Ulçera peptike
D) Osteoporoza
E) Hiperglicemia
PS)B

Pyetja 279 V)2

Gjatë sindromës Conn indikohet trajtimi me:

A) Diuretikë tiazidikë.
B) Spironolakton.
C) Kripëra të kaliumit.
D) Rezerpinë.
E) Alfa-metil-dopa.
PS)B

Pyetja 280 V)1

Prania e obezitetit dyfishon riskun për kardiopati ishemike.

A) E gabuar, statistikisht prania e obezitetit e rrit riskun për kardiopati ishemike me 30%
B) E gabuar , prania e obezitetit e ul riskun për kardiopati ishemike.
C) E vërtetë, por vetëm tek meshkujt.
D) E vërtetë, por vetëm tek femrat.
E) E vërtetë, si për meshkujt ashtu edhe për femrat.
PS)E

Pyetja 281 V)2

*80% e pacientëve me hiperparatiroidizëm:

A) Paraqesin kalkulozë renale.
B) Paraqesin dhembje abdominale.
C) Paraqesin çrregullime psikiatrike.

D) Paraqesin dhembje kockore.
E) Nuk paraqesin shenja klinike apo simptoma të sëmundjes.
PS)E

Pyetja 282 V)1

Feokromocitoma është një:

A) Adenomë.
B) Adenokarcinomë.
C) Tumor i qelizave kromafine.
D) Epiteliomë.
E) Sarkomë.
PS)C

Pyetja 283 V)2

Kalcifikimi i gjëndrës pineale vërehet jo rrallë dhe si rrjedhojë prodhimi i melatoninës rezulton:

A) Me ritëm të alteruar.
B) I reduktuar.
C) I rritur.
D) I pamodifikuar.
E) I papranishëm.
PS)D

Pyetja 284 V)1

Intervali kohor i ritmit cirkadian është:

A) 24 orë
B) 2 ditë
C) 7 ditë
D) 2 javë
E) 28 ditë
PS)A

Pyetja 285 V)2

Cilat janë zonat kryesore përgjegjëse për insulinorezistencën?

A) Muskujt, hepari dhe indi dhjamor, të cilat janë zona që shfaqin të njëjtin nivel të insulinorezistencës.
B) Kryesisht muskujt dhe hepari, indi dhjamor luan një rol më të vogël për shfaqjen e gjendjes insulinorezistente.
C) Muskujt, truri dhe ovari, të cilat janë zona që shfaqin të njëjtin nivel të insulinorezistencës.

D) Vetëm hepari.
E) Muskuj, hepari dhe truri.
PS)B

Pyetja 286 V)1

Inhibina ushtron feed-back:

A) Negativ mbi LH.
B) Pozitiv mbi FSH.
C) Pozitiv mbi FSH.
D) Negativ mbi FSH.
E) Negativ mbi TSH.
PS)D

Pyetja 287 V)2

Cili është substrati i fosfodiesterazës?

A) Glukoproteinat
B) Fosfolipidet
C) Proteinat
D) Lipidet
E) Nukleotidet
PS)E

Pyetja 288 V)2

Tek personat me predispozicion gjenetik, nëse sasia e kalorive është e njëjtë, cili nga kombinimet e mëposhtme ushtron rolin më të rëndësishëm diabetogjen?

A) Dieta e pasur me karbohidrate
B) Dieta hiperlipidike, e pasur me karbohidrate, hipoproteinike dhe e varfër me fibra
C) Dieta hiperlipidike dhe e varfër në karbohidrate dhe fibra
D) Dieta hipolipidike dhe e pasur në karbohidrate
E) Dieta normolipidike, hipoproteinike dhe e pasur me karbohidrate
PS)B

Pyetja 289 V)3

Agjërimi shkakton hiperuricemi si rrjedhojë e:

A) Reduktimit të klirensit të acidit urik nga acidoza.
B) Rritjes së sintezës së acidit urik nga rritja e katabolizmit nukleoproteinik.
C) A- së dhe B-ësë.
D) Reduktimit të filtrimit glomerular.
E) Reduktimit të sasive të purinave të konsumuar nëpërmjet dietës.

PS)C

Pyetja 290 V)1

Receptori i insulinës është një:

A) Serino-kinazë.
B) Treonino-kinazë.
C) Tirozino-kinazë.
D) Fosfatazë.
E) Treonino-fosfatazë.
PS)C

Pyetja 291 V)2

Ekzaminimi instrumental më i dobishëm për të identifikuar zonat me autonomi funksionale gjatë tireotoksikozës tek një pacient me strumë multinodulare është:

A) Ekografia e tiroides.
B) CT-ëja e tiroides.
C) MRI-ja e tiroides.
D) Shintigrafia e tiroides.
E) Radiografia e toraksit.
PS)D

Pyetja 292 V)1

Folikuli ovarin prodhon:

A) HPL.
B) Prolaktinë.
C) FSH.
D) LH.
E) Inhibinë.
PS)E

Pyetja 293 V)2

Etiologjia më e shpeshtë e insuficiencës surenaliene është:

A) TBC- ëja.
B) Terapia antikoagulante.
C) AIDS.
D) Autoimune.
E) Deficiti glukokortikoid familjar.
PS)D

Pyetja 294 V)1

Leptina:

A) Prodhohet nga indi adipoz dhe stimulon oreksin.
B) Prodhohet nga indi adipoz dhe inhibon oreksin.
C) Prodhohet nga hepari dhe inhibon metabolizmin bazal.
D) Prodhohet nga indi adipoz dhe inhibon metabolizmin bazal.
E) Nuk prodhohet nga indi adipoz.
PS)B

Pyetja 295 V)2

Sindroma Laron është një:

A) Sëmundje autoimune.
B) Sëmundje infektive.
C) Sëmundje neoplazike.
D) Hipogonadizëm sekondar.
E) Sindromë nga rezistenca ndaj hormoneve.
PS)E

Pyetja 296 V)1

Prekursori fillestar për sintezën e hormoneve ovariene është:

A) LDL-kolesteroli.
B) Gangliozidet.
C) HDL-kolesteroli.
D) Trigliceridet.
E) Fosfolipidet.
PS)A

Pyetja 297 V)1

Emri kimik i melatoninës është:

A) 6-Hidroksi-melatoninë sulfat.
B) N-acetil-5-metoksitriptamina.
C) 5-Hidroksitriptofoli.
D) 5-Metoksitriptofoli.
E) 5-Metoksitriptamina.
PS)B

Pyetja 298 V)1

Funksionimi i saktë i sistemit riprodhues femëror varet nga ndërveprimi i disa hormoneve. Përveç hormoneve hipofizare, nga cili organ/gjëndër sekretohen hormonet e tjera?

A) Ovari
B) Tubat dhe uterusi
C) Ovari dhe uterusi
D) Ovari dhe tubat
E) Uterusi
PS)A

Pyetja 299 V)2

Cila diagnoza mund të vendoset nëpërmjet matjes së nivelit të kalcitoninës?

A) Karcinoma papilare
B) Karcinoma folikulare
C) Karcinoma medulare
D) Karcinoma anaplazike
E) Adenoma tireotoksike
PS)C

Pyetja 300 V)1

Stimuli më i fuqishëm për sekretimin e insulinës është:

A) Acidet yndyrore.
B) Adrenalina.
C) Glukagoni.
D) Aminoacidet.
E) Leptina.
PS)C

Pyetja 301 V)1

Në dietën e ekuilibruar, cilat janë përqindjet e karbohidrateve, proteinave dhe lipideve?

A) Karbohidrate = 50-60%, proteina = 20%, lipide = 20-30%
B) Karbohidrate = 40-50%, proteina = 20%, lipide = 30-40%
C) Karbohidrate = 30-40%, proteina = 20%, lipide = 40-50%
D) Karbohidrate = 20-30%, proteina = 20%, lipide = 50-60%
E) Karbohidrate = 40-50%, proteina = 40%, lipide = 10-20%
PS)A

Pyetja 302 V)2

Gjatë hipokortikosurenalizmit kronik indikohet terapia me:

A) Prednizon.
B) Prednizolon.
C) Hidrokortizon.
D) Deksametazon.
E) ACTH.
PS)C

Pyetja 303 V)1

Gjatë insuficiencës renale kronike vërehet shpesh:

A) Hipertrigliceridemi.
B) Rritje e lipoproteinës (a).
C) Reduktimi i aktivitetit të lipoproteinlipazës endoteliale.
D) Ksantoma eruptive.
E) Rritja e aktivitetit lipazik.
PS)A

Pyetja 304 V)1

Cila është incidenca e akromegalisë?

A) 3-4 raste / 100 individë.
B) 3-4 raste / 1.000 individë.
C) 3-4 raste / 10.000 individë
D) 3-4 raste / 100.000 individë.
E) 3-4 raste / 1.000.000 individë.
PS)E

Pyetja 305 V)1

Qelizat Sertoli ndodhen në:

A) Epididimus.
B) Tubulat seminifer.
C) Indin intersticial.
D) Prostatë.
E) Vezika seminale.
PS)B

Pyetja 306 V)1

Tek gratë me peshë normale, cila është përqindja e masës trupore që përbëhet nga ind adipoz?

A) 10-20%
B) 20-30%

C) 30-40%
D) 40-50%
E) 50-60%
PS)B

Pyetja 307 V)1

Reduktimi i androgjeneve pas dhënies së deksametazonit flet për praninë e:

A) Sindromës adrenogjenitale kongjenitale.
B) Neoplazisë ovariene.
C) Sindromës Conn.
D) Neoplazisë surenaliene.
E) Sindromës së ovarit polikistik.
PS)A

Pyetja 308 V)1

Shkaku më i shpeshtë i hipoparatiroidizmit është:

A) Idiopatik.
B) Post kirurgjikal.
C) Post rrezatim.
D) Zhvillimi i alteruar i paratiroideve.
E) Infiltrimi ose metastazat paratiroidiene.
PS)B

Pyetja 309 V)1

Struktura bazë e hormoneve steroide rrjedh nga:

A) Një acid yndyror i poli-pasaturuar.
B) Ciklopentanoperhidrofenantreni.
C) Di-naftaleni.
D) Struktura me katër unaza pirolike.
E) Acidi arakidonik.
PS)B

Pyetja 310 V)2

Cili hormon ka receptorë brendaqelizorë?

A) TRH
B) LH
C) Tiroksina
D) Prostaglandinat
E) Katekolaminat

PS)C

Pyetja 311 V)1

Kur personi humbet peshë:

A) Nuk modifikohet vëllimi dhe numri i adipociteve.
B) Reduktohet numri por jo vëllimi i adipociteve.
C) Reduktohet edhe vëllimi edhe numri i adipociteve.
D) Reduktohet vëllimi por jo numri i adipociteve.
E) Rritet vëllimi dhe numri i adipociteve.
PS)D

Pyetja 312 V)1

Trupi luteal prodhon:

A) PRL.
B) HCG.
C) ACTH.
D) Progesteron.
E) Estradiol.
PS)D

Pyetja 313 V)1

Mekanizmi më i shpeshtë nëpërmjet të cilit medikamentet shkaktojnë hiperprolaktinemi është:

A) Çlirimi i dopaminës.
B) Çlirimi i VIP.
C) Çlirimi i TRH.
D) Bllokimi i receptorëve dopaminergjikë.
E) Bllokimi i receptorëve muskarinikë.
PS)D

Pyetja 314 V)2

Cili pohim nuk është i saktë për sindromën Cushing paraneoplazike?

A) Ndodh shpesh gjatë mikrocitomës pulmonare.
B) Mund të shkaktohet nga karcinoidi bronkial okult.
C) Tumori sekreton kortizol.
D) Tumori sekreton fragmente të ACTH.
E) Tumori mund të prodhojë beta-lipotropinë.
PS)C

Pyetja 315 V)1

Azospermi do të thotë:

A) Më pak se 100 mijë spermatozoidë në ejakulat.
B) Mungesa e ejakulimit.
C) Mungesa e testikujve në bursat skrotale.
D) Prania e gjakut në ejakulat.
E) Mungesa e spermatozoidëve në ejakulat.
PS)E

Pyetja 316 V)2

Tek pacientët me hipoglicemi të dyshuar, rikthyeshmëria e simptomave pas konsumimit të sheqernave:

A) Është diagnostikuese për hipoglicеminë.
B) Është diagnostikuese për hipoglicеminë reaktive.
C) Është diagnostikuese për hipoglicеminë organike.
D) Nuk e hedh poshtë diagnozën e hipoglicemisë.
E) E përjashton diagnozën e hipoglicemisë.
PS)D

Pyetja 317 V)2

Adenilciklaza është:

A) Hormon peptidik.
B) Hormon steroid.
C) Enzimë e membranës.
D) Neurotransmetues.
E) Receptor i membranës.
PS)C

Pyetja 318 V)2

Katekolaminat nxisin:

A) Liposintezën.
B) Glikogjenolizën.
C) Anabolizmin e proteinave.
D) Metabolizmin e kolesterolit.
E) Metabolizmin e acideve yndyrore.
PS)B

Pyetja 319 V)2

Hiperlipidemia sekondare si rrjedhojë e diabeti mellitus tip 2 paraqitet me:

A) Hiperkolesterolemi.
B) Hipertrigliceridemi.
C) Hiperkilomikronemi.
D) Hiper-HDL.
E) Hipo-HDL.
PS)B

Pyetja 320 V)2

Cili është objektivi i trajtimit të niveleve të larta të LDL-kolesterolit gjatë parandalimit parësor?

A) 100 mg/dl
B) 130 mg/dl
C) 150 mg/dl
D) 160 mg/dl
E) 190 mg/dl
PS)B

Pyetja 321 V)1

Glukagoni dhe katekolaminat stimulojnë glikogjenolizën në nivel:

A) Hepatik.
B) Cerebral.
C) Muskulor.
D) Adipoz.
E) Renal.
PS)A

Pyetja 322 V)2

Alterimi elektrolitik kryesor i pranishëm në morbus Addison është:

A) Hipokalemia.
B) Hipokalcemia.
C) Hiperkalcemia.
D) Hiponatremia.
E) Hipomagnezemia.
PS)D

Pyetja 323 V)2

Hipokalemia mund të vërehet në të gjitha këto situata, me përjashtim të:

A) Hiperaldosteronizmit parësor.

B) Morbusit Addison.
C) Sindromës Bartter.
D) Konsumit të jamballës.
E) Hiperaldosteronizmit sekondar.
PS)B

Pyetja 324 V)1

Akronimi APUD tregon qeliza të afta për të:

A) Inkorporuar aminat biologjike dhe për t'i dekarboksiluar ato.
B) Inkorporuar dhe dekarboksiluar prekursorët e aminave biogjene.
C) Inkorporuar dhe depolimerizuar prekursorët e aminave biogjene.
D) Shkaktuar osteosarkoma.
E) Shkakuar lipoma.
PS)B

Pyetja 325 V)1

Antagonist i insulinës është:

A) Somatomedina.
B) Tiroksina.
C) ACTH.
D) GH.
E) PRL.
PS)D

Pyetja 326 V)2

Në dietën e një personi me diabet, një ndarje e pranueshme në përqindje e karbohidrateve, proteinave dhe yndyrnave mund të jetë përkatësisht (në %):

A) 33-33-33.
B) 40-40-20.
C) 50-20-30.
D) 25-35-40.
E) Nuk ka rëndësi të veçantë.
PS)C

Pyetja 327 V)2

Gjatë morbusit Addison mund të vihet re:

A) Hiperkalemi.
B) Hipernatremi.
C) Hiperfosforemi.

D) Hipokalemi.
E) Hipokalcemi.
PS)A

Pyetja 328 V)2

Cili është stimuli kryesor për prodhimin e eritropoietinës?

A) Vlerat e hemoglobinës
B) Ferritina
C) CO2
D) Oksidi nitrik
E) Hipoksia
PS)E

Pyetja 329 V)1

Cila lipoproteinë përbën përqindjen më të lartë në trigliceride?

A) VLDL
B) IDL
C) LDL
D) HDL
E) Lipoproteina-a
PS)A

Pyetja 330 V)3

Gjatë sindromës Klinefelter karakteristike, vërehen gjithmonë vlera të larta të:

A) Testosteronit.
B) Prolaktinës.
C) FSH-së.
D) HCG-së.
E) LH-së.
PS)C

Pyetja 331 V)2

Cili nga tumoret e mëposhtëm mund të shkaktojë më shpesh një kuadër klinik akromegalie nga sekretimi ektopik i GHRH?

A) Karcinoidi bronkial
B) Osteosarkoma
C) Karcinoma e gjirit
D) Karcinoma medulare e tiroides
E) Hepatoma

PS)A

Pyetja 332 V)2

Stimuli fiziologjik më i fuqishëm për sekretimin e hormonit natriuretik atrial është:

A) Sekretimi i katekolaminave.
B) Rritja e rezerves trupore të natriumit.
C) Sekretimi i insulinës.
D) Nivelet e rritura të proreninës.
E) Humbja e proteinave nëpërmjet urinës.
PS)B

Pyetja 333 V)2

Adrenarka përkon me rritjen e niveleve plazmatike të:

A) DHEAS.
B) Androstenedionit.
C) Kortizolit.
D) Aldosteronit.
E) 17-OH-progesteronit.
PS)A

Pyetja 334 V)1

Cili nga receptorët e mësipërm ka një domen autofosforilimi?

A) Receptorët me shtatë domene transmembranore
B) Receptorët për hormonet steroide
C) Receptorët për GABA
D) Receptorët për faktorët e rritjes dhe insulinën
E) Receptorët për katekolaminat
PS)D

Pyetja 335 V)2

Nëse kryhet një analizë e vetme hormonale, analiza më e dobishme për diagnostikimin e sindromës Cushing është:

A) Kortizoli plazmatik.
B) Kortizoli urinar i 24 orëve.
C) ACTH plazmatik.
D) 17-OH-kortikosteroidët urinarë gjatë 24 orëve.
E) Kalemia.
PS)B

Pyetja 336 V)1

Cili hormon përgjigjet ndaj stresit?

A) T4
B) Glukagoni
C) FSH
D) PRL
E) Insulina
PS)D

Pyetja 337 V)2

Cilat janë alterimet lipidike më të shpeshta tek pacientët me obezitet qendror?

A) Janë të rritura nivelet plazmatike të HDL-kolesterolit.
B) Janë të reduktuara nivelet plazmatike të triglicerideve.
C) Janë të rritura nivelet e kolesterolit total.
D) Janë të rritura nivelet plazmatike të acideve yndyrore të lira, të triglicerideve dhe LDL-lipoproteinave të vogla dhe dense, ndërkohë që janë të reduktuara nivelet plazmatike të HDL-kolesterolit.
E) Pacienti obez nuk shfaq alterime karakteristike në lipidogramë.
PS)D

Pyetja 338 V)2

Veprimi kryesor i hormonit FSH tek meshkujt ushtrohet mbi:

A) Qelizat Leydig.
B) Tubujt seminiferë.
C) Vezikulat seminale.
D) Epididimusin.
E) Prostatën.
PS)B

Pyetja 339 V)1

Glicemia 160 mg/dl 2 orë pas ngarkesës orale me glukozë sugjeron :

A) Metabolizëm normal të karbohidrateve.
B) Tolerancë të dëmtuar ndaj karbohidrateve.
C) Diabet mellitus.
D) Diabet sekondar.
E) Diabet gestacional.
PS)B

Pyetja 340 V)1

Hipoglicemia mund të ndodhë gjatë:

A) Tumorit me qeliza alfa.
B) Adenokarcinomës pulmonare.
C) Tumorit retikulo-endotelial IGF-II-sekretues.
D) Karcinoidit.
E) Tumorit interstinal.
PS)C

Pyetja 341 V)2

Tek meshkujt, në shumicën e rasteve, shenja e parë e zhvillimit pubertal është:

A) Shfaqja e qimeve aksilare.
B) Shfaqja e qimeve pubike.
C) Shfaqja e qimeve mbi buzën e sipërme.
D) Rritja e vëllimit të penisit.
E) Rritja e vëllimit të testikujve.
PS)E

Pyetja 342 V)1

Sekretimi i prolaktinës stimulohet nga:

A) Dopamina.
B) ACTH.
C) GnRH.
D) GH.
E) TRH.
PS)E

Pyetja 343 V)1

Alterimi më i shpeshtë i ritmit kardiak në rastet me adenomë toksike tiroidiene është:

A) Flateri atrial.
B) Fibrilacioni ventrikular.
C) Fibrilacioni atrial.
D) Arresti kardiak.
E) Takikardia ventrikulare.
PS)C

Pyetja 344 V)2

Markuesi i hiperplazisë surenaliene kongjenitale nga deficiti i 21-hidroksilazës është rritja e:

A) Delta-4-androstenedionit.
B) Kortizolit.
C) Testosteronit.
D) 11-Dezoksikortizolit.
E) 17-OH-progesteronit.
PS)E

Pyetja 345 V)2

Ekzaminimi diagnostik më i mirë për morbusin Addison është:

A) Ritmi cirkadian i kortizolit.
B) Kortizoli urinar i 24 orëve.
C) Numri i eozinofileve.
D) 17-Ketosteroidet urinare të 24 orëve.
E) Prova e stimulitmit me ACTH.
PS)E

Pyetja 346 V)1

Tek gratë e shëndetshme, nivelet plazmatike më të larta të gonadotropinave vërehen:

A) Në momentin e lindjes.
B) Në fazën premenstruale.
C) Në mes të ciklit të ovulacionit.
D) Në fazën luteinike.
E) Në menopauzë.
PS)E

Pyetja 347 V)2

Cila endokrinopati mund të shkaktojë hiperprolaktinemi?

A) Hiposurenalizmi primar
B) Hipoparatiroidizmi
C) Hipotiroidizmi primar
D) Hipogonadizmi primar
E) Hipertiroidizmi
PS)C

Pyetja 348 V)2

Çfarë ndikimi ka insulina mbi aktivitetin e lipoproteinlipazës së indit adipoz?

A) e stimulon
B) e inhibon
C) redukton sintezën

D) nuk e ndikon
E) B-ëja dhe C-ëja
PS)A

Pyetja 349 V)2

Rezinat me shkëmbim jonik veprojnë duke:

A) aktivizuar qarkullimin entero-hepatik të acideve biliare.
B) inhibuar qarkullimin entero-hepatik të acideve biliare.
C) induktuar një efekt hipokolesterolemik në nivel rreth 90%.
D) rregulluar pH e sekretimeve gastro-entero-pankreatike.
E) favorizuar depozitimin e acideve biliare në kolecistë.
PS)B

Pyetja 350 V)1

Funksioni metabolik që aktivizohet më shumë nga insulina është:

A) Liposinteza.
B) Glikogjenoliza.
C) Katabolizmi i proteinave.
D) Metabolizmi i kolesterolit.
E) Metabolizmi i acideve nukleare.
PS)A

Pyetja 351 V)1

Hiperaldosteronizmi primar karakterizohet nga:

A) Reninemia e lartë.
B) Hipotensioni.
C) Hipokalemia.
D) Hiponatremia.
E) ?rregullimet fekale.
PS)C

Pyetja 352 V)1

Hipertiroidizmi favorizon:

A) Riskun për aterosklerozë vaskulare.
B) Eleminimin hepatik të kolesterolit.
C) Reduktimin e sintezës së kolesterolit.
D) Rritjen e niveleve të triglicerideve.
E) Reduktimin e acideve yndyrore esenciale.
PS)B

Pyetja 353 V)2

Cili hormon i hipofizës stimulon qelizat intersticiale të testikulit?

A) ACTH
B) FSH
C) GH
D) TSH
E) LH
PS)E

Pyetja 354 V)1

Veprimi i PTH-së mbi sintezën e vitaminës 1,25(OH)2D3 ushtrohet në:

A) Lëkurë.
B) Hepar.
C) Veshkë.
D) Zorrë.
E) Skelet.
PS)C

Pyetja 355 V)2

Ndërlikimi më i shpeshtë i strumës toksike difuze është:

A) Hipokalcemia.
B) Tiroiditi.
C) Dekompensimi kardiak.
D) Hipertensioni.
E) Spazmat muskulore.
PS)C

Pyetja 356 V)1

Rritja e ekskretimit urinar të albuminës shoqëron shpesh :

A) Diabetin e bronztë.
B) Intolerancën ndaj karbohidrateve.
C) Diabetin infantil.
D) Diabet mellitus prej shumë vitesh.
E) Diabet insipid.
PS)D

Pyetja 357 V)2

Përbri disa sindromave paraneoplazike janë vendosur tumoret që janë shkaku më i shpeshtë i tyre. Cili është kombinimi i gabuar?

A) Akromegali - karcinoid bronkial
B) Sindromë Cushing - mikrocitomë pulmonare
C) Hipoglicemi - karcinomë ovariene
D) Eritrocitozë - hemangiomë cerebelare
E) Hiperkalcemi - karcinomë pulmonare me qeliza skuamoze
PS)C

Pyetja 358 V)2

Lloji histologjik më i shpeshtë i neoplazive të tiroides është:

A) Limfoma.
B) Karcinoma medulare.
C) Karcinoma anaplazike.
D) Karcinoma folikulare.
E) Karcinoma papilare.
PS)E

Pyetja 359 V)2

Cili nga këta faktorë mund të rrisë HDL?

A) Obeziteti
B) Diabeti mellitus tip II
C) Progestinikët
D) Estrogjenikët
E) Diuretikët tiazidikë
PS)D

Pyetja 360 V)3

Cila është formë e anovulacionit hipotalamik disfunksional?

A) Sindroma Turner
B) Sindroma Sheehan
C) Sindroma e ovarit rezistent
D) Sindroma Kallmann
E) Amenorrea e atleteve
PS)E

Pyetja 361 V)1

Inhibina prodhohet nga:

A) Qelizat Sertoli.
B) Spermatogonet.
C) Qelizat Leydig.
D) Qelizat mioide.
E) Spermatozoidët maturë.
PS)A

Pyetja 362 V)1

Sekretimi i kortizolit është i tipit:

A) Cirkadian.
B) Ultradian.
C) Infradian.
D) Me pik te pasdites.
E) I vazhdueshëm.
PS)A

Pyetja 363 V)1

Prekursori steroid i kortizolit (një proces më përpara) është:

A) 18-Hidroksikortikosteroni.
B) 11-Dezoksikortikosteroni.
C) Androstenedioni.
D) 11-Dezoksikortizoli.
E) Dehidroepiandrosteroni.
PS)D

Pyetja 364 V)2

Gjendra pineale, sipas vëzhgimit anatomik, ndodhet:

A) Në zonën postrema.
B) Në hipokampus.
C) Në sella turcica.
D) Ndërmjet kolikujve superiorë.
E) Mbi traktin olfaktiv.
PS)D

Pyetja 365 V)1

Kilomikronet janë lipoproteinat:

A) Me densitetin më të lartë.
B) Me densitetin më të ulët.
C) Me mobilitet të lartë elektroforetik.

D) Që përmbajnë 90% të kolesterolit.
E) Që nuk pluskojnë mbi ujë.
PS)B

Pyetja 366 V)1

Cila nga alertenativat e mëposhtme inhibon sintezën e TSH-së?

A) Adrenalina
B) Somatostatina
C) Somatomedina
D) TRH
E) Prolaktina
PS)B

Pyetja 367 V)2

Era e gojës si 'mollë të thartuara" vërehet gjatë:

A) Acidozës laktike.
B) Hipoglicemisë.
C) Sindromës hiperosmolare hiperglicemike.
D) Ketoacidozës diabetike.
E) Ketoacidozës nga intoksikimi me salicilate.
PS)D

Pyetja 368 V)1

Sekretimi i kortizolit tek personat e shëndetshëm është:

A) I vazhdueshëm.
B) I reduktuar në rast stresi.
C) Ekskluzivisht cirkadian.
D) Cirkadian me rritje fazike në rast stresi.
E) I vazhdueshëm me rritje fazike në rast stresi.
PS)D

Pyetja 369 V)2

Një person me diurezë 3-4 litra/ditë me peshë specifike (densitet) 1024 mund të ketë:

A) Diabet insipid.
B) Nefrit.
C) Diabet mellitus.
D) Hiperaldosteronizëm.
E) Cistit.
PS)C

Pyetja 370 V)2

Cili nga hormonet e mëposhtme prodhohet nga neurohipofiza?

A) Insulina
B) Progesteroni
C) Trijodtironina
D) Hormoni antidiuretik
E) Faktori natriuretik atrial
PS)D

Pyetja 371 V)2

Çfarë është dhe si vepron metformina?

A) Është një sulfanilure
B) Është një anoreksik serotoninergjik.
C) Është një medikament termogjenik
D) Është një biguanid, i cili shfrytëzohet për veprimin e tij anoreksik.
E) Është një inhibitor i glukozidazave intestinale.
PS)E

Pyetja 372 V)2

Cili nga këto hormone përdoret gjatë terapisë së hipogonadizmit hipogonadotrop?

A) HCG
B) ACTH
C) HGH
D) GIF
E) TSH
PS)A

Pyetja 373 V)1

Cili nga këto parametra përdoret më shpesh gjatë praktikës klinike për të vendosur diagnozën e obezitetit tek të rriturit?

A) Tabelat e peshës ideale në varësi të gjatësisë
B) Indeksi i masës trupore (BMI)
C) Formula e Lorenz
D) Formula e Broca
E) formula e Willy
PS)B

Pyetja 374 V)1

Cili është ndërlikimi më i shpeshtë për pacientet me sindromë të ovarit polikistik?

A) Hipertension arterial
B) Krampe
C) Intolerancë glucidike dhe/ose diabet mellitus
D) Insuficiencë renale
E) Karcinomë ovariene
PS)C

Pyetja 375 V)2

Cili është kundërindikim për terapinë me jod radioaktiv tek personat me hipertiroidizëm?

A) Mosha e madhe
B) Shtatzënësia
C) Morbusi Basedow
D) Adenoma toksike tiroidiene
E) Struma toksike multinodulare
PS)B

Pyetja 376 V)2

Gjatë sindromës Cushing nga neoplazia surenaliene, sekretimi i ACTH-së është:

A) Normal.
B) I reduktuar.
C) I rritur.
D) I alteruar nga ana strukturore.
E) Shfaq inversion të ritmit cirkadian.
PS)B

Pyetja 377 V)1

Hormonet polipeptidike lidhen me receptorë:

A) Të membranës.
B) Nuklearë.
C) Mitokondrialë.
D) Citoplazmatikë.
E) Të retikulit endoplazmatik.
PS)A

Pyetja 378 V)3

Hiperparatiroidizmi primar dhe hiperkalcemia paraneoplazike tumorale kanë disa ngjashmëri biokimike. Cila nga të dhënat e mëposhtme mund të bëjë të lindë dyshimi për sindromë paraneoplazike?

A) Kalcemia 13,5 mg/dl
B) Fosfatemia 2,1 mg/dl
C) Fosfataza alkaline normale
D) AMP-ciklike nefrogjene shumë e lartë
E) Raporti Cl-/fosfat në gjak <35
PS)E

Pyetja 379 V)1

Në prani të nivelit të PRL 220 ng/ml, diagnoza më e mundshme është:

A) Sella turcica e zbrazët.
B) Prolaktinoma.
C) Hipotiroidizmi.
D) Insuficienca renale kronike.
E) Hiperprolaktinemia idiopatike.
PS)B

Pyetja 380 V)2

Cila nga këto sëmundje është shkaku më i shpeshtë i osteoporozës mashkullore?

A) Sëmundjet gastrointestinale
B) Hiperparatiroidizmi
C) Hipogonadizmi
D) Nefropatitë
E) Sëmundjet hematologjike
PS)C

Pyetja 381 V)2

Çfarë përdoret gjatë terapisë së tiroiditit De Quervain?

A) Antibiotikët
B) Tiroksina
C) Kortizonikët
D) Antitiroidienët
E) Sulfamidikët
PS)C

Pyetja 382 V)1

Tek pacientët me morbus Addison, në rast hipertermie, terapia glikoaktive duhet:

A) Të vazhdohet pa ndryshime.
B) Të dyfishohet.
C) Të ndërpritet
D) Të dhjetëfishohet.
E) Të përgjysmohet.
PS)B

Pyetja 383 V)1

Përbërësi proteinik i lipoproteinave përbëhet nga:

A) Aminoacide esenciale.
B) Glukoproteina.
C) Aminoacide të degëzuara.
D) Proteina ushqimore.
E) Miozina.
PS)B

Pyetja 384 V)2

Cila nga këto sindroma paraneoplazike shoqërohet më shpesh me mikrocitomën pulmonare?

A) Sindroma e sekretimit të papërshtatshëm të HAD
B) Sindroma hipoglicemike
C) Akromegalia
D) Osteomalacia
E) Eritrocitoza
PS)A

Pyetja 385 V)1

Si është kariotipi në sindromën Noonan?

A) 47, XXY
B) 45, X0
C) 45, X/46, XY
D) 47, XXX
E) 46, XY
PS)E

Pyetja 386 V)1

Cilat qeliza ndodhen në tubujt seminiferë?

A) Qelizat spermatogjenike
B) Qelizat Sertoli

C) A dhe B
D) Qelizat Leydig
E) Fibroblastet
PS)C

Pyetja 387 V)1

Shkaku më i shpeshtë i hipotiroidizmit kongjenital është:

A) Agenezia ose disgenezia tiroidiene.
B) Deficiti i pompës jodike.
C) Defekti i organifikimit të jodit.
D) Defekti i sintezës së tireoglobulinës.
E) Sindroma Di George.
PS)A

Pyetja 388 V)2

Cili faktor nuk ndikon në hipertensionin arterial?

A) Trashëgimia
B) Konsumi i kripës
C) Sistemi nervor simpatik
D) Sistemi reninë-angiotensinë-aldosteron
E) Djersitja
PS)E

Pyetja 389 V)1

Hormonet steroide karakterizohen nga fakti që

A) Sintetizohen dhe konservohen në qelizat sekretuese.
B) Sintetizohen si prohormone në qelizat sekretuese.
C) Prodhohen vazhdimisht dhe degradohen në qelizat sekretuese nëse nuk stimulohet sekretimi i tyre.
D) Sekretohen në formë inaktive në qarkullim.
E) Sintetizohen me shpejtësi nga prekursorët dhe sekretohen në qarkullim.
PS)E

Pyetja 390 V)2

Citokromet P450 janë të përfshirë në sintezën e

A) Hormoneve tiroidiene.
B) Neurotransmetuesve.
C) Prostaglandinave.
D) Hormoneve polipeptidike.

E) Hormoneve steroide.
PS)E

Pyetja 391 V)2

Ekzoftalmia është shenjë klinike karakteristike e

A) Tiroiditit subakut.
B) Hipotiroidizmit.
C) Tiroiditit të heshtur .
D) Morbusit Basedow.
E) Morbusit Plummer.
PS)D

Pyetja 392 V)1

Cilët janë faktorët hormonalë që ndikojnë metabolizmin bazal?

A) Hormonet tiroidiene
B) Estrogjenet
C) Hormonet tiroidiene dhe katekolaminat
D) Katekolaminat dhe kortizoli
E) Insulina
PS)C

Pyetja 393 V)2

Cili është alterimi tiroidien më i shpeshtë gjatë terapisë me interferon?

A) Tiroiditi Hashimoto
B) Tireotoksikoza inflamatore
C) Hipertiroidizmi
D) Hipotiroidizmi
E) Interferoni nuk e ndikon funksionin tiroidien
PS)D

Pyetja 394 V)2

Cili medikament nuk shkakton hiperprolaktinemi?

A) Klorpromazina
B) Haloperidoli
C) Sulpiridi
D) Propranololi
E) Metoklopramidi
PS)D

Pyetja 395 V)2

Testosteroni ushtron veprim feedback negativ mbi

A) LH-ënë.
B) Dihidrotestosteronin.
C) Inhibinën.
D) Prolaktinën
E) 17-beta-estradiolin.
PS)A

Pyetja 396 V)1

Hipoglicemia postprandiale te obezët shkaktohet nga

A) Hiperinsulinemia
B) Insulinorezistenca
C) Përgjigja insulinike e vonuar pas konsumit të ushqimit
D) A-ja dhe C-ëja.
E) B- ëja dhe C-ëja.
PS)A

Pyetja 397 V)1

Cili hormon ka prekursor një aminoacid?

A) Noradrenalina
B) Aldosteroni
C) HAD
D) GH
E) Vitamina D
PS)A

Pyetja 398 V)2

Cili është faktori hipotalamik që stimulon fiziologjikisht sekretimin e prolaktinës?

A) GnRH
B) TRH
C) CRH
D) Somatostatina
E) GHRH
PS)B

Pyetja 399 V)1

Diagnoza e sigurtë e artritit të cermës vendoset përmes

A) Vlerësimit të uricemisë.
B) Vlerësimit të uricurisë së 24 orëve.
C) Vlerësimit të klirensit të acidit urik.
D) Artrocentezës.
E) Biopsisë së artikulacionit.
PS)D

Pyetja 400 V)2

Mekanizmi i veprimit të receptorëve 'klasikë' të hormoneve steroide është

A) Stimulimi i adenilciklazës membranore.
B) Aktivizimi i kanaleve voltazh-vartëse të kalciumit.
C) Modulimi i transkriptimit të gjeneve.
D) Rregullimi i funksionit të aparatit Golgi.
E) Veprimi i ushtruar mbi retikulin endoplazmatik të lëmuar.
PS)C

Pyetja 401 V)1

Obeziteti është risk më i lartë për diabet për shkak të

A) Sekretimit të ulët të GIP.
B) Hipertonusit adrenergjik.
C) Hiperglukagonemisë.
D) Deficitit insulinik.
E) Insulino-rezistencës.
PS)E

Pyetja 402 V)1

Ndër adenomat hipofizare, cila përqindje përbëhet nga prolaktinoma?

A) 5%
B) 10-20%
C) 40-50%
D) 70-80%
E) 80-90%
PS)C

Pyetja 403 V)2

Sinteza dhe ekskretimi i kortikotropinës kontrollohet nga

A) Estradioli.
B) Kortizoli.

C) Kortikosteroni.
D) Progesteroni.
E) Epiandrostenedioni.
PS)B

Pyetja 404 V)2

Cila është sëmundje endokrine e shkaktuar nga një adenomë surenaliene që sekreton glukokortikoide?

A) Morbus Addison
B) Hiperaldosteronizmi
C) Hirsutizmi
D) Dindroma Cushing
E) Obeziteti idiopatik
PS)D

Pyetja 405 V)3

Te cilat forma të karcinomës tiroidiene është dokumentuar trasmetimi gjenetik?

A) Folikulare
B) Papilare
C) Mikse
D) Medulare
E) Anaplazike
PS)D

Pyetja 406 V)3

Pseudohipoparatiroidizmi shkaktohet nga

A) Sekretimi i alteruar i kalcitoninës.
B) Mungesa e vitaminës D.
C) Defekti i sintezës së parathormonit.
D) Defekti i receptorit të parathormonit.
E) Defekti i receptorit të vitaminës D.
PS)D

Pyetja 407 V)2

Cila patologji mund të dëmtojë pankreasin, aq sa mund të shkaktojë diabet insulino-vartës?

A) Feokromocitoma
B) Hipopituitarizmi
C) Hemokromatoza
D) Obeziteti

E) Diabeti insipid
PS)C

Pyetja 408 V)3

Një grua 45-vjeçare ankohet për asteni dhe dobësi muskulore. Pohon edhe episode të përsëritura me dhimbje koke. Ekzaminimi objektiv është negativ, me përjashtim të presionit 155/105 mmHg. Ekzaminimet laboratorike nuk tregojnë alterime, me përjashtim të
A) Dozimi i aldosteronit plazmatik pas infuzionit endovenoz të solucionit fiziologjik.
B) Dozimi i aldosteronit plazmatik pas agjërimit gjatë natës.
C) Matja e katabolitëve të katekolaminave në një kampion urine të 24 orëve.
D) Skanimi abdominal me CT.
E) Testi i frenimit me deksametazon.
PS)A

Pyetja 409 V)1

Në cilën nga gjendjet mjekësore të mëposhtme nuk vihet re hipertension?

A) Hiperaldosteronizëm primar
B) Hiperaldosteronizëm sekondar nga hipovolemia
C) Stenozë e arteries renale
D) Sindromë Cushing
E) Feokromocitomë
PS)B

Pyetja 410 V)2

Në cilën fazë të ciklit menstrual vërehet aktiviteti më i lartë mitotik i gjirit?

A) Në fazën menstruale.
B) Në fazën ovulatore.
C) Në fazën luteinike.
D) Në të gjitha fazat e ciklit.
E) Në asnjë fazë të ciklit.
PS)C

Pyetja 411 V)1

Cila patologji mund të shkaktojë diabet mellitus duke antagonizuar efektet e insulinës?

A) Feokromocitoma
B) Hipopituitarizmi
C) Hemokromatoza
D) Pankreatiti
E) Diabeti insipid
PS)A

Pyetja 412 V)1

Hormoni i rritjes kontrollon sintezën e

A) Kolagjenit tip II.
B) Heparansulfatit.
C) Somatostatinës.
D) Somatomedinës.
E) Insulinës.
PS)D

Pyetja 413 V)2

Cili nga këta makronutrientë zotëron nivelin më të lartë kalorik?

A) Proteinat
B) Karbohidratet
C) Lipidet
D) Vitaminat
E) Kripërat minerale
PS)C

Pyetja 414 V)2

Sindroma adrenogjenitale shkaktohet nga

A) Adenoma surenaliene.
B) Marrja e kortizonikëve.
C) Marrja e androgjenëve.
D) Defektet enzimatike të mbiveshkores.
E) Adenoma ACTH-sekretuese.
PS)D

Pyetja 415 V)3

Një mashkull 47 vjeç ankohet prej disa javësh për asteni të theksuar. Anamneza patologjike është negative. Gjatë ekzaminimit objektiv nuk vërehen të dhëna domethënëse. Analizat laboratorike tregojnë kalcemi 14,1 mg/dl, fosfatemi 2,1 mg/dl, kalemi 4,2 mm
A) Hiperparatiroidizmi primar
B) Neoplazia
C) Hiperkalcemia hipokalciurike familjare
D) Intoksikimi nga vitamina D
E) Hipertiroidizmi
PS)B

Pyetja 416 V)2

Cila terapi intravenoze indikohet gjatë krizës tetanike nga deficiti paratiroidien?

A) Vitamina D
B) Kalciumi
C) Fosfatet
D) Diuretikët
E) Parathormoni
PS)B

Pyetja 417 V)2

Manifestimi më i shpeshtë gjatë hipertiroidizmit te të moshuarit është

A) Fibrilacioni atrial.
B) Defekimet e shpeshta.
C) Angina pektoris.
D) Axhitimi psiko-motor.
E) Infarkti i miokardit.
PS)A

Pyetja 418 V)2

Angiotensinogjeni prodhohet nga

A) Veshkat.
B) Mushkëritë.
C) Mëlçia.
D) Zona glomerulare e mbiveshkores.
E) Zona jukstaglomerulare e veshkës.
PS)C

Pyetja 419 V)1

Sekretimi i kortizolit tek personat normalë

A) Stimulon sekretimin e aldosteronit.
B) Ushtron efekt feedback negativ në hipofizë.
C) Ushtron efekt feedback pozitiv në hipofizë.
D) Ushtron efekt feedback pozitiv në hipotalamus.
E) Inhibon drejtpërdrejtë sekretimin e insulinës.
PS)B

Pyetja 420 V)2

Biosinteza e hormoneve steroide fillon nga

A) Dipalmitoil-lecitina.
B) Acidi retinoik.
C) Katekolestrogjenet.
D) D-alanina
E) Kolesteroli.
PS)E

Pyetja 421 V)1

Spermatogjeneza kontrollohet nga

A) Prolaktina.
B) Kortizoli.
C) FSH-ëja.
D) Kalcitrioli.
E) Progesteroni.
PS)C

Pyetja 422 V)2

Deficiti i cilës gjëndër mund të shkaktojë shtatshkurtësi në moshën fëminore

A) Tiroide
B) Mbiveshkore
C) Gonade
D) Pineale
E) Pankreas
PS)A

Pyetja 423 V)1

Tek femrat, në shumicën e rasteve, shenja e parë e zhvillimit pubertal është

A) Shfaqja e qimeve aksilare.
B) Shfaqja e qimeve pubike.
C) Shfaqja e zhvillimi i gjirit.
D) Menarka.
E) Rritja e vëllimit të uterusit.
PS)C

Pyetja 424 V)2

Përdorimi i estroprogestinikëve

A) Është faktor predispozues për hipertrigliceridemi.
B) Rrit nivelin e HDL-ësë.
C) Bllokon receptorin e lipoproteinave.

D) Alteron apoproteinat.
E) Favorizon shfaqjen e steatozës hepatike.
PS)A

Pyetja 425 V)1

Cili është alterimi patologjik më i shpeshtë i hiperaldosteronizmit?

A) Adenoma
B) Hiperplazia
C) Karcinoma
D) TBC
E) Atrofia
PS)A

Pyetja 426 V)2

Tek pacientët me nanizëm Laron, vlerat serike të GH dhe të IGF-I janë

A) Normale.
B) Të dy të reduktuar.
C) Të dy të rritur.
D) GH i rritur, IGF-I i reduktuar.
E) GH i reduktuar, IGF-I i rritur.
PS)D

Pyetja 427 V)1

Insulina stimulon

A) Lipolizën.
B) Glikogjenolizën.
C) Glukoneogjenezën.
D) Glikogjenosintezën.
E) Sintezën e kolesterolit.
PS)D

Pyetja 428 V)1

Niveli më i lartë ovulator i LH-së

A) Paraprin ovulacionin.
B) Paraprin nivelin më të lartë të estradiolit.
C) Pason nivelin më të lartë të FSH-ësë.
D) Pason rritjen e progesteronit.
E) Inhibon sekretimin e LHRH-ësë.
PS)A

Pyetja 429 V)2

Neoplazia më e shpeshtë e gjëndrës pineale është

A) Tumori Wilms.
B) Mikrocitoma.
C) Meduloblastoma.
D) Germinoma.
E) Oligodendroglioma.
PS)D

Pyetja 430 V)2

Sindroma Kallmann karakterizohet nga

A) Hipogonadizmi hipergonadotrop.
B) Hipogonadizmi hipergonadotrop i shoqëruar me anozmi.
C) Hipoplazi surenaliene kongjenitale.
D) Hipogonadizëm hipogonadotrop dhe distrofi miotonike.
E) Hipogonadizëm hipogonadotrop të shoqëruar me anozmi.
PS)E

Pyetja 431 V)1

Cila është vlera e glicemisë mbi të cilën vendoset diagnoza e diabetit mellitus?

A) 120 mg/dl
B) 126 mg/dl
C) 140 mg/dl
D) 150 mg/dl
E) 200 mg/dl
PS)B

Pyetja 432 V)2

Aktiviteti biologjik i reduktuar i insulinës te personat obezë ndodh si pasojë e

A) Sasisë së tepërt të proinsulinës.
B) Insulinës anormale.
C) Antitrupave anti-insulinikë.
D) Defekteve receptorial edhe/ose post-receptoriale.
E) Antitrupave anti-receptorë insulinikë.
PS)D

Pyetja 433 V)1

Në 90% të rasteve, feokromocitoma e merr origjinën nga

A) Zona medulare surenaliene.
B) Organi Zuckerkandl.
C) Zona kortikale surenaliene.
D) Paraganglionet e sistemit nervor autonom.
E) Glomusit karotidien.
PS)A

Pyetja 434 V)3

Cilat analiza janë thelbësore për diagnostikimin e neoplazisë androgjen-sekretuese tek një femër me hirsutizëm?

A) 17-OH-progesteroni
B) DHEAS
C) Testosteroni i lirë
D) Estroni
E) Testosteroni dhe DHEAS
PS)E

Pyetja 435 V)2

Elektroforeza i veçon lipoproteinat serike sipas

A) Dendësisë së tyre.
B) Ngarkesës elektrike të tyre.
C) Kapacitetit të tyre për të pluskuar.
D) Peshës molekulare të tyre.
E) Përqendrimit plazmatik të tyre.
PS)B

Pyetja 436 V)1

Në etiopatogjenezën e diabetit mellitus tip 1 mund të luajë rol

A) Obeziteti.
B) Infeksioni viral i mëparshëm.
C) Klima.
D) Pozicioni gjeografik (gjerësia dhe lartësia gjeografike).
E) Ushqyerja e pasur me karbohidrate.
PS)B

Pyetja 437 V)2

Orkidopeksia duhet të kryhet

A) Përpara se fëmija të mbushë 1 vjeç.
B) Në moshën 2 deri 4 vjeç, por gjithsesi përpara fillimit të zhvillimit pubertal.
C) Në moshën 8 deri 10 vjeç.
D) Në fazën fillestare të zhvillimit pubertal.
E) Në moshë post-pubertet.
PS)B

Pyetja 438 V)2

Gjatë morbusit Basedow, hiperfunksioni tiroidien shkaktohet nga

A) Rritja e sekretimit të TSH-ësë.
B) Imunoglobulinat tireostimuluese.
C) Rritja e sekretimit të TRH- ësë.
D) Antitrupat anti-tireoglobulinë.
E) Hipersekretimi autonom.
PS)B

Pyetja 439 V)1

Adenoma hipofizare më e shpeshtë është adenoma

A) TSH-sekretuese.
B) GH-sekretuese.
C) PRL-sekretuese.
D) ACTH-sekretuese.
E) Josekretuese.
PS)C

Pyetja 440 V)2

Cili nga hormonet e mëposhtme është hormon anti-insulinik që shkakton hiperglicemi?

A) Tiroksina
B) Kortizoli
C) Aldosteroni
D) Angiotensina II
E) PRL
PS)B

Pyetja 441 V)1

Oksitocina është hormon

A) Proteinik.
B) Lipoproteinik.
C) Glukoproteinik.

D) Peptidik.
E) Fenolik.
PS)D

Pyetja 442 V)2

Cili hormon qarkullon në përqindje të lartë të lidhur me proteina transportuese?

A) Glukagoni
B) Kalcitrioli
C) LH
D) Kalcitonina
E) Testosteroni
PS)E

Pyetja 443 V)1

Gjatë osteoporozës post-menopauzë, kalcemia është

A) E rritur.
B) Pak e rritur.
C) Normale.
D) E reduktuar.
E) I reduktuar kalciumi i jonizuar.
PS)C

Pyetja 444 V)1

Cila patologji karakterizohet nga prania e autoantitrupave kundër receptorit të TSH?

A) Adenoma hipofizare TSH-sekretuese
B) Morbus Basedow
C) Morbus Plummer
D) Sindroma e rezistencës ndaj hormoneve tiroidiene
E) Sindroma e rezistencës ndaj AMP-ciklike
PS)B

Pyetja 445 V)1

Metaboliti aktiv i vitaminës D (1-25,OH-D3) formohet në

A) Lëkurë.
B) Mëlçi.
C) Veshkë.
D) Kockë.
E) Zorrë.
PS)C

Pyetja 446 V)2

Cila nga këto patologji shoqërohet më shpesh me disfunksion erektil?

A) Hiperparatiroidizmi primar
B) Prostatiti akut
C) Diabeti
D) Fimoza
E) Varikocela
PS)C

Pyetja 447 V)1

Hormonet tiroidiene derivojnë nga metabolizmi i

A) Tirozinës.
B) Acidit iopanoik.
C) Pentajodtironinës.
D) Acetilkolinës.
E) Kolesterolit.
PS)A

Pyetja 448 V)1

Sëmundja më e shpeshtë e tiroides është

A) Hipotiroidizmi.
B) Hipertiroidizmi.
C) Tiroiditi.
D) Struma e thjeshtë.
E) Kanceri i tiroides.
PS)D

Pyetja 449 V)2

Në cilën strukturë qelizore ndodhet adenilat-ciklaza?

A) Membranë plazmatike
B) Citoplazmë
C) Retikul endoplazmatik
D) Membranë lizozomiale
E) Mitokondri
PS)A

Pyetja 450 V)2

Cili hormon ka analogji strukturore me TSH?

A) Progesteroni
B) Insulina
C) Prolaktina
D) Gastrina
E) LH
PS)E

Pyetja 451 V)3

Gjatë shtatzënësisë, terapia farmakologjike e diabetit mellitus kryhet me

A) Sulfanilure me posologji të ulët.
B) Biguanide.
C) Kombinim sulfanilure me biguanide.
D) Insulinë.
E) Terapi e kombinuar hipoglicemiantë oralë me insulinë.
PS)D

Pyetja 452 V)1

Kortizoli qarkullues transportohet nga

A) SHBG-ëja.
B) Transkortina.
C) TBG- ëja.
D) Neurofizinat
E) IGF-BP3-i.
PS)B

Pyetja 453 V)2

Cili nga këto tumore është përgjegjësi më i shpeshtë për shfaqjen e sindromës Cushing nga ACTH ektopik?

A) Karcinoma pulmonare me qeliza të vogla
B) Osteosarkoma
C) Karcinoma e gjirit
D) Tumori Wilms
E) Karcinoma ovariene
PS)A

Pyetja 454 V)3

Karakteristikë e përgjithshme e tumoreve që mund të shkaktojnë sindroma paraneoplazike është prodhimi i

A) Hormoneve tiroidiene.
B) Hormoneve peptidike.
C) Steroideve surenaliene.
D) Steroideve seksuale.
E) Katekolaminave.
PS)B

Pyetja 455 V)2

Cili ekzaminim është në gjendje që të diagnostikojë diabetin mellitus në rastet e dyshimta?

A) Insulinemia
B) Hemoglobina e glukozuar
C) Mikroalbuminuria
D) Prova e tolerancës ndaj ngarkesës orale me glukozë (OGTT)
E) Prova me glukagon
PS)D

Pyetja 456 V)1

Infarkti i parakohshëm në moshë të re ndodh më shpesh gjatë

A) Hiperkolesterolemisë familjare.
B) Hipertrigliceridemisë.
C) Hiperkilomikronemisë.
D) Hiper-HDL-kolesterolemisë.
E) Hipo-HDL-kolesterolemisë.
PS)A

Pyetja 457 V)1

Adrenalina

A) Shkakton bronkodilatacion.
B) Redukton frekuencën kardiake.
C) Stimulon glikogjenosintezën.
D) Redukton reninën.
E) Provokon hipoglicemi.
PS)A

Pyetja 458 V)3

Në kuadrin klinik karakteristik të MEN 2A bën pjesë

A) Karcinoma medulare e tiroides.
B) Karcinoma folikulare e tiroides.

C) Adenoma hipofizare.
D) Neuromat multiple.
E) Gastrinoma.
PS)A

Pyetja 459 V)2

Raporti insulinë:peptid C të sekretuara është

A) 10:1.
B) 2:1.
C) 1:1.
D) 1:2.
E) 1:4.
PS)C

Pyetja 460 V)2

Diagnoza më e mundshme tek një paciente femër me masë surenaliene unilaterale, hipertension, hipokalemi dhe hirsutizëm është

A) Adenoma surenaliene kortizol-sekretuese.
B) Sindroma Conn.
C) Karcinoma surenaliene.
D) Adenoma surenaliene virilizuese.
E) Feokromocitoma.
PS)C

Pyetja 461 V)1

PTH është i rritur ose në kufinjtë e normës në të gjitha këto patologji, me përjashtim të

A) Hiperparatiroidizmit primar.
B) Osteomalacisë.
C) Pseudohipoparatiroidizmit.
D) Hiperkalcemisë neoplazike.
E) Osteodistrofisë renale me turnover të lartë.
PS)D

Pyetja 462 V)1

Hormonet hipofizare janë

A) Derivate aminoacide.
B) Polipeptide.
C) Glukopeptide dhe polipeptide.
D) Glukopeptide.

E) Derivate aminoacide dhe glukopeptide.
PS)C

Pyetja 463 V)2

Cili hormon vepron më shumë mbi matriksin proteinik të kockës?

A) Kortizoli
B) Kalcitonina
C) Parathormoni
D) Insulina
E) LH
PS)A

Pyetja 464 V)1

Cili hormon përbëhet nga nën-njësi?

A) PRL
B) GH
C) HCG
D) ACTH
E) Somatomedinat
PS)C

Pyetja 465 V)2

Hormonet steroide veprojnë mbi qelizat shenjë:

A) Pasi transformohen në molekula kolesteroli.
B) Duke hyrë në qeliza nëpërmjet difuzionit dhe duke ndërvepruar me receptorët citoplazmatikë.
C) Pasi lidhen me receptorët e pranishëm mbi membranat e jashtme të qelizave.
D) Duke ndërvepruar drejtpërdrejtë me gjenomën e qelizës shenjë.
E) Duke aktivizuar ose duke inhibar enzimat citoplazmatike që modulojnë sintezën proteinike.
PS)B

Pyetja 466 V)1

Cili nga këto diuretikë depoziton Kaliumin?

A) Spironolaktoni
B) Acetazolamidi
C) Furosemidi
D) Klortiazidi
E) Acidi etakrinik

PS)A

Pyetja 467 V)1

Inervimi sensitiv i laringut realizohet nga nervi:

A) Vidian.
B) Rekurens.
C) Frenik.
D) Glosofaringeal.
E) Laringeus superior.
PS)E

Pyetja 468 V)2

Kodi deontologjik shprehet mbi këmbënguljen terapeutike. Cili prej pohimeve të mëposhtme është në përputhje me formulimet e kodit deontologjik?

A) Mjeku duhet të përpiqet gjithmonë që ta zgjasë sa më shumë të jetë e mundur jetën e pacientit duke përdorur gjithmonë dhe gjithsesi të gjitha mjetet terapeutike që ka në dispozicion.
B) Mjeku në kurimin e patologjive të rënda dhe progresive duhet të ndërhyjë gjithmonë qoftë në rast kur është e mundur të ndërhyhet në ecurinë e sëmundjes edhe në rastet kur kjo gjë nuk është e mundur
C) Mjeku nuk duhet të vazhdojë me trajtime nga të cilat me arsye nuk pret që të sjellin benefite domethënëse në ecurinë e sëmundjes ose në cilësinë e jetës.
D) Në rast sëmundjeje të avancuar dhe të pakthyeshme mund të ndërpritet trajtimi nëse familjarët shprehen të gjithë dakort.
E) Për të ndërprerë trajtimin në rast sëmundjeje të avancuar dhe të pakthyeshme duhet miratimi i Urdhrit të Mjekut.
PS)C

Pyetja 469 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm mbi sindromat e dehidratimit është gabim?

A) Në komën diabetike ketoacidozike kemi dehidratim me humbje urinare të natriumit dhe ujit.
B) Në raste diarreje mund të kemi dehidratim hipotonik me hiponatriemi.
C) Të vjellat e bollshme shkaktojnë hipernatriemi me acidozë metabolike.
D) Abuzimi me diuretikë shkakton dehidratim që mund të jetë hipernatriemik ose, më rrallë hiponatriemik.
E) Në diabetin e dekompensuar kemi humbje të natriumit nëpërmjet urinës.
PS)C

Pyetja 470 V)3

Cili nga përshkrimet e mëposhtme mbi pleksin lumbar nuk është i saktë?

A) Pleksi shtrihet në muskulin psoas.
B) Pleksi formohet nga degë të pasme të katër nervave të parë lumbarë.
C) Nervi femoral del në nivelin e ekstremit margos laterale të muskulit psoas.
D) Nervi obturator del në margon mediale të muskulit psoas.
E) Nervi femurokutan del në margon laterale të muskulit psoas.
PS)B

Pyetja 471 V)2

Cili nga 5 parametrat e përdorur për klasifikimin Child/Pugh të cirrozës hepatike është i gabuar?

A) Albuminemia
B) Asciti
C) Bilirubina
D) Kolinesteraza
E) Encefalopatia
PS)D

Pyetja 472 V)2

Me cilën patologji tjetër mund të shoqërohet azma atopike?

A) Kolit irritativ
B) Ekzema
C) Okulorinit
D) Sinuzit
E) B+C
PS)E

Pyetja 473 V)1

Kortikosteroidet nuk kanë indikacion në trajtimin e:

A) Herpes simpleks ocular.
B) Gjendje astmatike.
C) Sindroma nefrozike.
D) Kolagenopati.
E) Pamjaftueshmëri veshkore kronike.
PS)A

Pyetja 474 V)2

Kapaciteti i depërtimit të oksigjenit në pulmone varet nga:

A) Trashësia e membranës alveolare.
B) Vëllimi relativ i eritrociteve në kapilarët alveolarë.
C) Afiniteti i hemoglobinës per oksigjenin.
D) Toni i muskulaturës së lemuar bronkiale.
E) Dimensionet e eritrociteve.
PS)A

Pyetja 475 V)2

Limfocitet T:

A) Lindin në timus ku bëhen dhe imunokompetente.
B) Lindin në palcën e kockave dhe bëhen imunokompetente në timus.
C) Lindin në qendrat germinative të sistemit limfatik dhe bëhen imunokompetnte në timus.
D) Lindin nga aktivizimi i limfociteve b dhe migrojnë më pas në timus.
E) Lindin në palcën e kockave dhe shkatërrohen në timus kur plaken.
PS)B

Pyetja 476 V)2

Shfaqja e alkalozës metabolike mund të shkaktohet nga:

A) Diabeti melit i ndryshueshëm
B) Të vjella të pandalshme
C) Gjendje shoku
D) Hipertiroidizmi
E) Fistulë pankreatike
PS)B

Pyetja 477 V)3

Cili nga elementët e mëposhtëm nuk ka lidhje me sindromën CREST?

A) Kalcinoza
B) Raynaud
C) Ndryshime të lëvizshmërisë ezofageale
D) Sklerodaktilia
E) Trombocitopenia
PS)E

Pyetja 478 V)1

Abdomeni akut është:

A) Një sindromë komplekse

B) Një shenjë klinike
C) Një simptomë
D) Një ekzaminim radiologjik
E) Një sëmundje ekzantematike
PS)A

Pyetja 479 V)3

Cili nga efektet e mëposhtme anësore të njohura të antipsikotikëve duhet të trajtohet menjëherë?

A) Shfaqja graduale e lëvizjeve të përsëritshme të rrudhjes labiale
B) Përkeqësimi i shpejtë i ngurtshmërisë shoqëruar me një rritje të madhe të numrit të leukociteve dhe të aktivitetit të kreatinkinazës
C) Prodhim qumështi tek një femër që nuk është duke ushqyer me gji
D) Ngadalësim i lehtë i hapit
E) Përgjumje e lehtë
PS)B

Pyetja 480 V)1

Një individ i prekur nga sindroma Down ka për kromozomin 21:

A) Një çift
B) Dy çifte
C) Tre çifte
D) Asnjë çift
E) Katër çifte
PS)C

Pyetja 481 V)1

Diabeti melitus shfaqet kryesisht:

A) Tek duhanpirësit intensivë
B) Tek personat obezë
C) Tek personat që vuajnë nga arterioskleroza
D) Tek subjektet me hiperuricemi
E) Tek personat me rezerva të rritura glukozi ushqimor
PS)B

Pyetja 482 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtme në lidhje me alfa 1-antitripsinën nuk është i vërtetë?

A) Alfa 1- antitripsina merr pjesë në tretjen e ushqimeve

B) Alfa 1- antitripsina është një prej frenuesve më të rëndësishëm të proteazave serine ekstraqelizore ashtu si kolagjenaza dhe elastaza që çlirohen lokalisht gjatë proceseve infiamatore nga leukocitet
C) Mungesa e alfa 1- antitripsinës shoqërohet me enfizemë pulmonare në dhjetëvjeçarin e dytë, të tretë të jetës
D) Është një proteinë plazmatike relativisht në sasi të mëdha (80-220 mg/dl)
E) Mungesa e alfa 1- antitripsinës është një sëmundje gjenetike
PS)A

Pyetja 483 V)1

Cili muskul i syrit inervohet nga nervi abducent?

A) Rektus superio
B) Rektus inferior
C) Rektus ekstern
D) Rektus intern
E) Rektus medium
PS)C

Pyetja 484 V)2

Stridori i lindur i laringut shfaqet:

A) Tek të sapolindurit
B) Në moshën parashkollore
C) Në moshën e fëmijërisë.
D) Në adoleshencë
E) Në periudhën e ndryshimit të zërit
PS)A

Pyetja 485 V)2

Cila prej të mëposhtmeve nuk është shenjë e shkëputjes së placentës?

A) Gjakderdhja vaginale
B) Zgjatimi umbelikal jashtë vaginës
C) Ngritja e fundit të mitrës
D) Mitra që po bëhet e fortë dhe e rrumbullakët
E) Qafa e mitrës është e dukshme në hyrje
PS)E

Pyetja 486 V)1

Indi muskulor me strie i skeletit paraqitet:

A) Pa funde nervore sensitive

B) I inervuar nga fibra nervore të lëvizshme të organeve të brendshme
C) I formuar nga fibra njëbërthamore
D) I formuar nga fibra të gjata që mund të shkojnë edhe disa centimetra
E) Me prejardhje endodermike
PS)D

Pyetja 487 V)2

Trungu celiak del:

A) Nga aorta ascendente
B) Nga harku i aortës
C) Nga istmusi i aortës
D) Nga aorta e toraksit
E) Nga aorta abdominale
PS)E

Pyetja 488 V)3

Një vaskulit sistemik i arterieve me kalibër të vogël ka lidhje në radhë të parë me aparatin e frymëmarrjes dhe veshkat dhe lidhet me praninë e antikorpeve anti-citoplazëm të neutrofileve (C-ANCA). Bëhet fjalë për:

A) Arteritin me qeliza gjigante.
B) Sëmundjen Takayasu.
C) Sëmundjen Kawasaki.
D) Granulomatozën Wegener.
E) Poliartritin nodular .
PS)D

Pyetja 489 V)1

Toni kardiak është i njëkohësishëm me:

A) mbylljen e valvulave atrio-ventrikulare.
B) valën B të elektriokardiogramës.
C) një ulje të presionit atrial.
D) një ulje të presionit ventrikular.
E) mbylljen e valvulave semilunare .
PS)A

Pyetja 490 V)2

Cila prej këtyre terapive farmakologjike këshillohet më tepër për pacientin me sëmundje nga Refluksi gastroezofageal me shenja endoskopike refluksi?

A) Me antagonistë të receptorëve H2 të histaminës

B) Me frenues të pompës protonike
C) Antiacidë
D) Prokinetikë
E) Terapi kirurgjikale
PS)B

Pyetja 491 V)2

Cila prej këtyre imunodefiçencave primare është ajo që haset më shpesh në praktikën klinike?

A) Imunodefiçenca e zakonshme variabël
B) Mungesa e IgA
C) Imunodefiçenca e kombinuar e rëndë
D) Sindroma Wiskott-Aldrich
E) Agamaglobulinemia e Burton-it
PS)B

Pyetja 492 V)1

Shkaqet e hipertensionit sistolik të izoluar janë:

A) Hipertiroidizmi
B) Hiperaldosteronizëm fillestar
C) Tumore që sekretojnë reninën
D) Perikarditi
E) Tireotoksikoza
PS)E

Pyetja 493 V)2

Me termin "petit mal" kuptohet:

A) Një formë e lehtë e "grand mal"
B) Një ndryshim i ndërgjegjes me bazë jo organike
C) Një kuadër epileptik me aspekte klinike specifike dhe elektroencefalografike
D) Epilepsia e fëmijërisë së hershme
E) Epilepsia psikomotore
PS)C

Pyetja 494 V)1

Gjendrat paratiroidiene janë zakonisht në numër :

A) 2
B) 4
C) 6

D) 8
E) 10
PS)B

Pyetja 495 V)2

Cila prej shenjave apo simptomave të mëposhtme nuk shfaqet tek latantët me meningit?

A) Kriza konvulsive
B) Hepatomegalia
C) Rigor nucalis
D) Të vjella
E) Ethe dhe/ose hipotermi
PS)B

Pyetja 496 V)1

A është e vërtetë që rritja e ndërthurur e LDL-së dhe VLDL-së është e pranishme tek:

A) Fenotipi IIA.
B) Fenotipi IV.
C) Fenotipi III.
D) Fenotipi IIB.
E) Fenotipi V.
PS)D

Pyetja 497 V)1

Kardiomiopatia hipertrofike dëmton në radhë të parë:

A) Funksionimin e sistemit përçues
B) Mbushjen diastolike
C) Funksionimin e valvulave AV
D) Efikasitetin sistolik
E) Qarkullimin koronar
PS)B

Pyetja 498 V)2

Me depersonalizim nënkuptohet:

A) Një ndjenjë përjashtimi ndaj vetes dhe botës që të rrethon
B) Një alterim i gjendjes së ndërgjegjies
C) Një delir hipokondriak
D) Një iluzion
E) Një cefale
PS)A

Pyetja 499 V)2

Prania tek pacienti diabetik e një mikroalbuminurie prej 80 mg/24 është tregues:

A) Nefropatie në fazë fillestare
B) I asnjë ndryshimi në nivel renal
C) I sindromës nefrozike
D) I kalkulozës renale
E) Cistitit
PS)A

Pyetja 500 V)1

Tek njeriu, në kushte të mira ushqimi:

A) Piruvati i përftuar nga degradimi i aminoacideve proteinike përdoret për glukoneogjenezën
B) Insulina redukton sintezën e trigliceridеve tek hepatocitet
C) Albumina plazmatike transporton acidet yndyrore nga mëlçia dhe zorra tek indi adipoz
D) Glikoliza hepatike rezulton e frenuar
E) Riaktivizohen rezervat me glikogjen hepatik
PS)E

Pyetja 501 V)1

Cili prej grupeve të mëposhtme të ilaçeve është efikas në trajtimin e astmës bronkiale?

A) Antibiotikë
B) Mukolitikë
C) Antikoagulantë
D) Kortikosteroidë
E) Diuretikë
PS)D

Pyetja 502 V)2

Tek një pacient me kolesterol total të lartë dhe trigliceride të larta cilat lipoproteina ka të ngjarë të rriten:

A) LDL dhe HDL
B) Vetëm kilomikronët
C) Vetëm VLDL
D) LDL dhe VLDL
E) Vetëm HDL
PS)D

Pyetja 503 V)2

Cila nga zonat e mëposhtme të infeksionit gonokoksik është më e shpeshta në fazë akute?

A) Uretrale
B) Vulvare
C) Vaginale
D) Çervikale
E) Endometriale
PS)A

Pyetja 504 V)1

Anemia në insuficiencën renale kronike:

A) Ka lidhje në thelb me një mangësi në përthithjen e hekurit
B) Ka lidhje në thelb me një mangësi në prodhimin e eritropoietinës
C) Trajtohet vetëm me transfusion gjaku
D) Nuk duhet trajtuar pasi ndihmon në ruajtjen e vlerave të pranueshme të tensionit
E) Prek kryesisht femrat në moshë fertiliteti
PS)B

Pyetja 505 V)2

Glukozaminoglikanët janë :

A) Lipide
B) Përbërës normal të substancës kryesore të kartilagove në artikulacione
C) Përbërës normal të membranës sinoviale
D) Produkte të degradimit të fibrave kolagjene
E) Përbërës anormal të kartilagut të nyjeve te personat që vuajnë nga kondrokalcinoza
PS)B

Pyetja 506 V)2

Si paraqitet lëkura e një pacienti me ketoacidozë diabetike?

A) E lagësht
B) Ikterike
C) E zbehtë
D) E dehidratuar
E) E skuqur
PS)D

Pyetja 507 V)2

Mund të paraqesë komplikacione të rënda puçrra e lokalizuar:

A) Në zonën e qafës
B) Në buzën e sipërme
C) Në zonën e sqetullave
D) Në gjymtyrët e poshtme
E) Në gjymtyrët e sipërme
PS)B

Pyetja 508 V)3

Medulloblastoma është një tumor:

A) I palcës kurrizore
B) I pjesës palcore të linfonodulave
C) I pjesës palcore të gjëndrës mbiveshkore
D) I indit nervor
E) Pa stromë
PS)D

Pyetja 509 V)3

Mukoza fungoide është:

A) Një formë sarkome e lëkurës
B) Një infeksion mykotik i lëkurës
C) Një proces infiamator kronik i lëkurës
D) Një linfomë në fazë fillestare e lëkurës me qeliza t
E) Neoplazi atriale
PS)D

Pyetja 510 V)2

Embolitë septike shkak i dobësimeve cerebrale të vazhdueshme me evolucion në rritje ka më shumë të ngjarë që të jenë shkatuar nga:

A) Aortitit luetik
B) Tromboflebit migrues
C) Panarterit nyjor
D) Endokardit bakterial
E) Neoplazi atriale
PS)D

Pyetja 511 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtme mbi insuficiencën renale nuk është i saktë?

A) Gjatë insificiencës renale akute ekskrecioni fraksional i natriumit urinar zvogëlohet

B) Në fazë akute vërehet shpesh hipokaliemia
C) Në fazën funksionale para-veshkore vërehet një mbizotërim i ngushtimit vazal të pjesës kortikale
D) Nekroza e epitelit tubular është më e hershme në format toksike dhe më e vonshme në ato ishemike
E) Është e shpeshtë prania në urinë e cilindrave kokrrizorë dhe hematikë
PS)B

Pyetja 512 V)2

Cili është mekanizmi patogjen që qëndron në bazë të karditit reumatik?

A) Infeksioni hematogjen
B) Dëmtim i drejtpërdrejtë nga toksina
C) Mikroembolitë septike
D) Dëmtim nga imunokompleksi
E) Reaktivitet antigjenik i kryqëzuar
PS)E

Pyetja 513 V)2

Nivelet hematike të 17 -OH - progesteron janë shumë të larta tek hiperplazia mbiveshkore e lindur për shkak të:

A) Mungesës së 11 - hidroksilazës
B) Mungesës së 17 - hidroksilazës
C) Mungesës së 3 - olodeidrogjenazës
D) Mungesës së 21 - hidroksilazës
E) Mungesës së 2- 22 - dezmolazës
PS)D

Pyetja 514 V)2

Një perikardit hemorragjik sinjalizon fort:

A) Një sëmundje të sistemit imunitar
B) Insuficiencë renale kronike
C) Sëmundje reumatike
D) Metastazë karcinomatoze
E) Rrezatim toraksi
PS)D

Pyetja 515 V)2

Cili nga fenomenet e mëposhtëm nuk ndodh kur urina lihet për një kohë të gjatë në Temperaturë ambienti?

A) Shkatërrim i elementëve qelizorë
B) Formim i kristaleve
C) Acidifikim i urinës
D) Rritje bakteriale
E) Rritje e turbullirës së urinës
PS)C

Pyetja 516 V)3

Një prej tumoreve të mëposhtme malinje që shfaqet më shpesh në adoleshencë është:

A) Karcinoma veshkore
B) Sarkoma osteogjenike
C) Medulloblastoma
D) Rabdomiosarkoma
E) Leucemia kronike granulocitike
PS)B

Pyetja 517 V)1

Manovra e Giordano-s është pozitive gjatë:

A) Meningitit
B) Kolikës biliare
C) Kolikës renale
D) Apendicitit
E) Ulcerës gastrike
PS)C

Pyetja 518 V)2

Cili nga shkaqet e mëposhtëm është shkaku më i shpeshtë i hipertensionit arterioz dytësor?

A) Hiperaldosteronizmi në fazë fillestare
B) Sindroma cushing
C) Feokromocitoma
D) Kontraceptivët oralë
E) Sëmundja nefrovaskulare
PS)E

Pyetja 519 V)2

Pacienti shfaq dhimbje kurrizore dhe anësore, shqetësime të lehta të lëvizjes dhe të sfinkterëve me një livel të dyshimtë sensitiv. Cili është dyshimi klinik?

A) Sklerozë multiple
B) Sklerozë laterale amiotrofike

C) Hidrocefali
D) Kompresion medullar
E) Poliradikuloneurit
PS)D

Pyetja 520 V)3

Për të bërë një perikardiocentezë duhet të fusim agen:

A) Në hapësirën e dytë ndërbrinjore në nivelin e mesit të klavikulës së djathtë
B) Në hapësirën e dyrë ndërbrinjore në niveline e mesit të klavikulës së majtë
C) Në hapësirën e katërt ndërbrinjore në nivelin aksilar të përparmë të djathtë
D) Në hapësirën e katërt ndërbrinjore në nivelin aksilar të përparmë të majtë
E) Në bazën e apendiksit ksifoid
PS)E

Pyetja 521 V)2

Toksiciteti kardiak kufizon përdorimin klinik të cilëve medikamenteve antitumoralë?

A) Aktinomicinë D
B) Doxorubicinë
C) Bleomicinë
D) Cisplatinum
E) Vinkristinë
PS)B

Pyetja 522 V)3

Tek oftalmopatia Basedoviane mund të jenë të pranishme të gjitha këto shenja, me përjashtim të

A) Ezoftalmisë
B) Diplopisë
C) Fotosensibilitetit
D) Neuriti optik
E) Hemianopsisë bitemporale
PS)E

Pyetja 523 V)2

Mungesa selektive e IgA-së:

A) Mund të jetë pa simptoma .
B) Nuk shfaqet kurrë me infeksione në frymëmarrje.
C) Është një sëmundje tipike tek të moshuarit.
D) Është një prej imunodeficiteve primare .

E) Jep disfagi paradokse.
PS)A

Pyetja 524 V)3

Tek hipoparatiroidizmi shfaqja e tetanisë lehtësohet nga:

A) Rënia e ph hematik.
B) Rritja e kalciumit plazmatik.
C) Rënia e fosfatit plazmatik.
D) Rënia e kaliumit plazmatik.
E) Një hipervetilim pulmonar.
PS)E

Pyetja 525 V)1

Osteofitet shfaqen kryesisht gjatë:

A) Artrozës.
B) Osteoporozës.
C) Artritit reumatoid.
D) Konjuktivitit.
E) Artritit urik.
PS)A

Pyetja 526 V)2

Çfarë anomalish elektrolitike hasen shpesh gjatë insufiçencës kortikosurenale?

A) Hiperglicemia
B) Hipokalcemia
C) Hipopotasemia
D) Hipernatriemia dhe hipopotasemia
E) Hiponatriemia dhe hiperpotasemia
PS)E

Pyetja 527 V)1

Seborrea është:

A) Një patologji funksionale e gjendrës dhjamore
B) Shoqërohet gjithmonë me akne
C) Nuk prek sulkuset nazolabiale
D) Nuk reagon ndaj asnjë terapie
E) Terapia konsiston në heqjen e kistit
PS)A

Pyetja 528 V)2

Kripërat e litiumit përdoren kryesisht në:

A) Skizofreni
B) Depresion endogjen
C) Intoksikim neuroleptik
D) Psikozë maniako-depresive
E) Nevrasteni
PS)D

Pyetja 529 V)2

Në cilën prej sëmundjeve të mëposhtme haset prania e kromozomit Philadelphia?

A) Leuçemia linfloblastike kronike
B) Leuçemia mieloide kronike
C) Sindroma Marfan
D) Sëmundja Hunter
E) Homocistinemia
PS)B

Pyetja 530 V)1

Si quhen enzimat që transferojnë një fosfat nga ATP-ja në një molekulë tjetër?

A) Oksidoreduktazë
B) Kinazë
C) Fosfatazë
D) Proteazë
E) Nuklotidazë
PS)B

Pyetja 531 V)2

Rritja e qarkullimit të hormoneve të tiroides është tregues i hipertiroidizmit me përjashtim të rasteve të:

A) Shtatëzanisë
B) Sëmundjes Basedov
C) Adenomës toksike
D) Adenomës hipofizare që sekreton TSH
E) Prodhimit ektopik të TSH
PS)A

Pyetja 532 V)1

Imuniteti që vjen si pasojë e injektimit të një vaksine është:

A) I menjëhershëm dhe zakonisht me kohëzgjatje të madhe
B) Zakonisht me kohëzgjatje të madhe por jo i menjëhershëm
C) Me kohëzgjatje të shkurtër dhe jo i menjëhershëm
D) I menjëhershëm por me kohëzgjatje të shkurtër
E) I trashëguar
PS)B

Pyetja 533 V)1

Përbërësi kryesor i paretit bakterial është

A) Lipopolisakaridi
B) Membrane citoplazmatike
C) Peptidoglikani
D) Kapsula
E) Spiralja
PS)C

Pyetja 534 V)1

Proteinuria fiziologjike gjatë 24 orëve është në nivele:

A) 5 -10 mg
B) 15-20 mg
C) 20-30 mg
D) <150 mg
E) >150 mg
PS)D

Pyetja 535 V)1

Si mund ta përkufizojmë korpus luteum?

A) Një gjëndër ekzokrine që sekreton myk.
B) Një gjëndër endokrine të mukozës së qafës së mitrës.
C) Një gjëndër endokrine që formohet në vezore pas çdo ovulimi.
D) Një gjëndër endorkine e placentas.
E) Një organ që prodhon ovogone.
PS)C

Pyetja 536 V)1

Kur hemoglobina është e ngopur me O2 në masën 100% sa O2 përmban një gram hemoglobinë?

A) 0.30 Ml
B) 0.72 ml
C) 1.34 ml
D) 2.70 ml
E) 5.80 ml
PS)C

Pyetja 537 V)2

Tek pacientët me bronkoektazi nuk haset:

A) Nxjerrje pështyme në sasi në mëngjes
B) Bllokim i venave të qafës
C) Gishta në formë shkop daulleje
D) Zhurmë në frymëmarrje me flluska te mëdha dhe mesatare
E) Kollë kronike dhe ndonjëherë edhe hemoftizi
PS)B

Pyetja 538 V)1

Cila prej këtyre veçorive të karcinomës së padiferencuar të tiroides nuk është e saktë?

A) Prek moshat e reja.
B) Mund të ketë strukturë histologjike me qeliza anaplastike, gjigante, polimorfe.
C) Mund të ketë strukturë histologjike me qeliza të ndërfutura, sarkomatoide.
D) Mund të ketë strukturë histologjike me qeliza të vogla.
E) Mund të gjeten mbetje të një karcinome të diferencuar papilare ose folikulare.
PS)A

Pyetja 539 V)2

Koncepti i shëndetit në kodin deontologjik kuptohet si (neni 3):

A) Mungesë sëmundjeje
B) Mirëqënie psikike
C) Mirëqënie fizike
D) Mirëqënie kolektive
E) Mirëqënie psiko-fizike e personit
PS)E

Pyetja 540 V)3

Zana, një paciente 38 vjeç, para pak kohësh ka përfunduar procedurën e stadiacionit për limfomën Hodgkin. E.O dhe TAC total body treguan prekjen ekskluzive të nyjeve limfatike laterocervikalë të dyanshëm dhe nyjeve limfatike mbiklavikulare të djathta. A
A) IIE.
B) IIIA

C) IA
D) II
E) IIIB.
PS)D

Pyetja 541 V)1

Sindroma më e zakonshme që lidhet me një adenomë beninje e kortekstit mbiveshkor është:

A) Virilizëm
B) Hiperaldosteronizëm primar
C) Sindroma Cushing
D) Sëmundja Addison
E) Pseudohermafroditizëm
PS)B

Pyetja 542 V)2

Vlerësimi i Angiotensin-Converting Enzyme tek serumi përdoret për të monitoruar aktivitetin e sëmundjes gjatë:

A) Pielonefritit kronik.
B) Sklerozës sistemike progresive.
C) Veshkës policistike
D) Sarkoidozës.
E) Artritit rheumatoid.
PS)D

Pyetja 543 V)2

Tek këmba e shtrembër e lindur variacioni më i shpeshtë është:

A) Talo valgo prone
B) Metatars - var
C) Ekuino varo supine
D) Konkave reflekse
E) Dystaban
PS)C

Pyetja 544 V)2

Cila prej shenjave të mëposhtme nuk i referohet një dëmtimi të motoneuronit të parë?

A) Fashikulacionet
B) Shtimi i reflekseve të osteotendinoze
C) Shenja e Babinskit
D) Hipertonia muskulare

E) Deficiti i forcës.
PS)A

Pyetja 545 V)2

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme shfaqet zgjerimi ose/dhe deformimi i C-së duodenale?

A) Gastroduodenit
B) Koledocit akut
C) Bllokim i duktusit cistik
D) Neoplazi e antrumit gastrik
E) Neoplazi e kokës së pankreasit
PS)E

Pyetja 546 V)1

Gjatë perikarditit dhimbja lehtësohet:

A) Duke përkulur para toraksin
B) Me gëlltitjen
C) Me inspirimin
D) Me ortostatizmin
E) Me klinostatizëm
PS)A

Pyetja 547 V)2

Cila prej gjendjeve të mëposhtme nuk përfshihet tek faktorët që janë në gjendje të shkaktojnë një encefalopati hepatike?

A) Hemorragjitë tretëse
B) Alkaloza
C) Sedativët
D) Acidoza
E) Infeksionet
PS)D

Pyetja 548 V)1

Cilat qeliza karakterizojnë reaksionet e llojit granulomatoz?

A) Makrofagët dhe limfocitete
B) Qelizat e Lengerhansit
C) Mastocitet
D) Qelizat fulikulare dendriktike
E) Qelizat epiteliale
PS)A

Pyetja 549 V)1

Tek glomeruli renal:

A) Shpejtësia e filtrimit glomerular rritet pas ngushtimit të enëve të gjakut të arteriolës hyrëse.
B) Përqëndrimi i natriumit në ultrafiltrim është më i madh se ai i plazmës.
C) Përbërja e ultrafiltrimit varet edhe nga mekanizmat e transportit aktiv.
D) Kalimi i një substance nëpërmjet barrierës glomerulare varet nga pesha e saj molekulare.
E) Kapilarët janë më të përshkueshëm nga uji sesa nga shtretërit e tjerë kapilarë.
PS)D

Pyetja 550 V)2

Me cilën prej sëmundjeve të mëposhtme lidhet HTL VII ?

A) Leucemia mieloide kronike
B) Leucemia limfoblastike akute
C) Leucemia a qelizave kapelute
D) Sëmundja Hodgkin
E) Sindroma Sezary
PS)C

Pyetja 551 V)2

Cili prej këtyre pohimeve në lidhje me ACE inhibitorët nuk është i saktë?

A) Nuk ndryshojnë metabolizmin e lipideve
B) Reduktojnë proteinurinë e lidhur me nefropatinë diabetike
C) Mund të përshpejtojnë shfaqjen e insuficencës renale
D) Nuk duhet të përdoren tek pacientët në terapi trombolitike
E) Duhet të përdoren me kujdes tek pacientët që marrin diuretikë
PS)D

Pyetja 552 V)2

Feokromocitoma ka një sjellje biologjike malinje:

A) Në të gjitha rastet
B) Asnjëherë
C) Nëse është në përmasa më të mëdha se 10 cm
D) Në 10% të rasteve
E) Në gjysmën e rasteve
PS)D

Pyetja 553 V)1

Gjatë osteoporozës:

A) Ndodh një ndryshim i formës së kockave
B) Ndodh një reduktim i masës kockore
C) Ndodh një ulje e përthithjes kockore osteoklastike
D) Mungesë kalcifikimi i matricës së kockave
E) Prekja në mënyrë ekskluzive rrjetën kockore
PS)D

Pyetja 554 V)1

Komplikacioni më i shpeshtë i terapisë me insulinë është:

A) Reaksioni alergjik.
B) Rezistenca ndaj insulinës.
C) Glikozuria.
D) Lipodistrofia.
E) Hipoglicemia.
PS)E

Pyetja 555 V)2

Gjatë enfizemës pulmonare:

A) Rritet ekspiracioni
B) Ndodh rritja e sipërfaqes alveolo-kapilare
C) Reduktohet hapësira e vdekur funksionale
D) Reduktohet murmuri vesicularis
E) Ndodh hemorragji pleurale
PS)D

Pyetja 556 V)2

Tek një pacient që vuan nga emfizema pulmonare obstruktive cili rezultat nuk është i shpeshtë?

A) Frymënxjerrja e zgjatur
B) Boshllëku i bifurkacionit trakeal në rx
C) Transparenca e zvogëluar pulmonare
D) Rritja e rezonancës me perkusion
E) Toni kardiak i zbutur
PS)C

Pyetja 557 V)1

Infarkti i miokardit është:

A) Një nekrozë ishemike
B) Një nekrozë kolikuative
C) Një nekrozë fibrinoide
D) Një degjenerim ne forme tullumbace
E) Një proces viral
PS)A

Pyetja 558 V)1

Cili është mikrobi që ka tendencën të kolonizojë rrugët ajrore tek pacientët me fibrozë cistike?

A) Streptokokus pneumonia
B) Haemophilus influenza
C) Moraxella spp
D) Pseudomonas aeruginosa
E) Haemophilus parainfluenzae
PS)D

Pyetja 559 V)2

Tek matrica stromale e palcës hemopoietike janë të pranishme të gjitha glikoproteinat e mëposhtme, me përjashtim të:

A) Fibronektinës
B) Lamininës
C) Alfa2 makroglobulinës
D) Kolagjenit
E) Proteoglikanit
PS)C

Pyetja 560 V)2

Cila prej masave të mëposhtme është ajo më efikasja në trajtimin e torticollis spastik?

A) Toksina botulinike
B) Klonazepami
C) Rizotomia
D) Fizioterapia
E) Haloperidoli
PS)A

Pyetja 561 V)2

Pulsi arterial paradoksal vërehet në rast:

A) Stenoze të aortës sopravalvulare
B) Insuficence aortike
C) Tamponade kardiake
D) Insuficence kontraktuese të rëndë
E) Kardiomiopatie hipertrofike bllokuese
PS)C

Pyetja 562 V)1

Cili prej grupeve të mëposhtme me antigjenë nuk bën pjesë tek eritrocitet?

A) ABO
B) Kell
C) Lewis
D) HLA
E) Rh
PS)D

Pyetja 563 V)1

Një EEG normale në gjendje të qetë tek nje person adult i shëndetshëm në moshë të re karakterizohet nga:

A) Një përgjigje e evokuar në lobet ballore me stimulim stroboskopik.
B) Një shtim i frekuencës së ritmit të pasëm gjatë fazave të gjumit nga 1 në 4.
C) Një ritëm alfa të pasëm nga 4 në 7 Hz.
D) Një ritëm Alfa të predominuar tek lobet ballore kur sytë janë të mbyllur.
E) Një ngadalësim i ritmit alfa bazë dhe shfaqja e valëve beta në pjesën ballore simetrike kur sytë janë të hapur.
PS)E

Pyetja 564 V)2

Zhurma diastolike auskultohet gjatë:

A) Stenozës së valvulës mitrale
B) Insuficences të venës trikuspide
C) Stenozës pulmonare
D) Tetralogjisë Fallot
E) Insufiçencës së valvulës mitrale
PS)A

Pyetja 565 V)3

Në tumorin e këndit ponto-cerebelar haset më shpesh:

A) Diplopia

B) Të përzierët dhe vjellje
C) Marrje mendsh
D) Deficite në lëvizje
E) Kriza epileptike
PS)C

Pyetja 566 V)3

Çfarë kuptohet me sinoviektomi?

A) Shkatërrim klinik i membranës sinoviale
B) Shkatërrim kirurgjik i membranës sinoviale
C) Heqje kirurgjikale e membranës sinoviale
D) Incizionin e indit kartilaginoz
E) Heqjen e thoit
PS)C

Pyetja 567 V)2

Nga cili prej gjendjeve të mëposhtme shkaktohet më shpesh okluzioni i zorrës së trashë?

A) Aderencat
B) Volvulusi
C) Hernia
D) Karcinoma
E) Divertikuliti
PS)D

Pyetja 568 V)3

Një burrë 41 vjeç shfaq gjak okult në feçe. Kolonoskopia evidentoi një polip të pedunkuluar prej 1 cm në pjesën ascendente të zorrës së trashë. Ekzaminimi histologjik i polipit të operuar karakterizohet me gjendra të shumta të llojit tubular me atipi qel
A) Polip adenomatoz
B) Polip fibroid infiamator
C) Polipi Peutz - Jehgers
D) Kolit ulceroz
E) Polip hiperplastik
PS)A

Pyetja 569 V)2

Pacemaker-at ndihmëse të tufës së Hisit kanë një frekuencë:

A) >60 bpM
B) 40-60 bpm
C) 25-40 bpm

D) <25 bpm
E) >75 bpm
PS)B

Pyetja 570 V)2

Tumori primitiv pulmonar që jep metastaza të herëshme në distancë është:

A) Adenokarcinoma
B) Karcinoid
C) Mikrocitoma
D) Adenoskuamoz
E) Tumor me qeliza jo të vogla
PS)C

Pyetja 571 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtëm në lidhje me sëmundjen e celiakisë nuk është i saktë?

A) Shoqërohet përgjithësisht me praninë e antikorpeve anti-endomiozium në serumin e gjakut
B) Mund të lidhet me sëmundje së sistemit imunitar
C) Mund të shfaqet në fillim me një anemi sideropenike
D) Ka nevojë për një dietë pa gluten deri ne regresionin e plotë të simptomave
E) Ekzaminimi histologjik tek fragmenti bioptik tregon ndryshime të vileve
PS)D

Pyetja 572 V)1

Parandalimi i TBC-së bëhet me:

A) Ciprofloxacinë
B) PAS
C) Isoniazid
D) Etambutol
E) Streptomicinë
PS)C

Pyetja 573 V)2

Në cilën sëmundje jo neoplastike vërehen shpesh elementë plazmacelularë në gjakun periferik?

A) Artrit rheumatoid
B) Anemi megaloblastike
C) Mononukleozë infective
D) Reumatizëm artikular akut

E) LES
PS)C

Pyetja 574 V)2

Apendiks vermiformis karakterizohet nga:

A) Një numër i madh vilesh
B) Nga një sasi e madhe indi limfoid të mukozës
C) Muscularis mucosae e konsiderueshme
D) Shiritë
E) Prani indi muskular me hulli të pavullnetshme
PS)B

Pyetja 575 V)2

Nivele të larta të HB A2 hasen tek:

A) Anemia megaloblastike
B) Anemia sideropenike
C) Leucemia
D) Depranocitoza
E) Beta-talasemia
PS)E

Pyetja 576 V)1

Presioni hidrostatik:

A) Përcaktohet nga pesha e lëngut mbi nivelin e konsideruar
B) Prodhohet nga elasticitetei i pareteve të kontenitorit
C) Është më i lartë në qendër të kontenitorit
D) Nuk varet nga dendësia e lëngut
E) Përcakton lëvizjet konvektive brenda lëngut
PS)A

Pyetja 577 V)1

Hemikrania pa aurea është më e shpeshtë:

A) Në moshën e fëmijërisë
B) Tek të moshuarit
C) Gjatë shtatëzanisë
D) Në moshën e rinisë së hershme
E) Gjatë menopauzës
PS)D

Pyetja 578 V)2

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme eozinofilet në gjak janë pothuajse në mungesë?

A) Leucemi eozinofile
B) Tifo abdominale
C) Ekinokokozë
D) Astma bronkiale
E) Panarterit nodoz
PS)B

Pyetja 579 V)3

Një pacient 70 vjeç, deri në 3 muaj më parë i rregullt në funksionet e zorrës paraqet konstipacion. Analizat e laboratorit tregojnë që ka një anemi hipokromike, hiposidermike. Cilat janë analizat që duhet të bëjë në vijim?

A) Ezofagogastroduodenoskopia (EGDS)
B) Ferritinemia dhe transferrinemia
C) Test për funksionimin e tiroides
D) Kolonoskopia
E) Koha e kalimit oralo-anal
PS)D

Pyetja 580 V)1

Avantazhet e aktivitetit fizik sportiv vërehen:

A) Tek personat me hipertension
B) Tek diabetikët
C) Tek obezët
D) Në gjithë kategoritë e mësipërme
E) Tek pacientët me anemi hemolitike
PS)D

Pyetja 581 V)2

Sëmundja neurologjike që karakterizohet nga zona të përhapura të demielinizuara me përfshirje përkatëse të cilindrazës është:

A) Sifilizi
B) Poliomieliti
C) Skleroza multiple
D) Anemia shkatërruese
E) Skleroza laterale amiotrofike
PS)C

Pyetja 582 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtëm në lidhje me glukokortikoidët është nuk është i vërtetë?

A) Maskojnë simptomat e sëmundjes
B) Dhënia e menjëhershme sjell gjithmonë efekte të padëshirueshme
C) Dhënia e vazhdueshme sjell gjithmonë efekte të padëshirueshme
D) Terapia me glukokortikoidë përgjithësisht nuk është vendimtare
E) Janë të nevojshëm në rastet kur reagimi i personit ku janë injektuar është shkaku i sëmundjes
PS)B

Pyetja 583 V)1

Cila prej patologjive të mëposhtme nuk paraqet një infeksion oportunist?

A) Kriptosporidoza
B) Infeksioni me mykoplazëm
C) Pneumocistoza
D) Kriptokokoza
E) Kandidoza e ezofagut
PS)B

Pyetja 584 V)1

Në cilin prej gjendjeve të mëposhtme mund të përcaktohet prania e insuficencës respiratore?

A) Hemogazanalizë: PaO2 70mmHg, PaCO2 55 mmHg
B) Hemogazanalizë: PaO2 67mmHg, PaCO2 38 mmHg
C) Hemogazanalizë: PaO2 45mmHg, PaCO2 60 mmHg
D) Hemogazanalizë: PaO2 95mmHg, PaCO2 41 mmHg
E) Hemogazanalizë: PaO2 65mmHg, PaCO2 47 mmHg
PS)C

Pyetja 585 V)2

Gjatë një hepatiti viral bradikardia shkaktohet nga rritja në qarkullim e:

A) Bilirubinës direkte
B) Bilirubinës indirekte
C) Trinsaminazës
D) Kripërave biliare
E) LDH-së
PS)D

Pyetja 586 V)2

Cili është faktori që ndikon më shumë tek prognoza e karcinomës kolon-rektale?

A) Shkalla histologjike
B) Përmasat e neoplazisë
C) Pozicioni i neoplazisë
D) Klasifikimi i Dukes
E) Mosha e pacientit
PS)D

Pyetja 587 V)1

Sinteza e hormoneve proteinike dhe poliptedike kryhet:

A) Tek ribozomet e rrjetit endoplazmatik të ashpër
B) Nëpërmjet shndërrimeve enzimatike
C) Tek lizozomet
D) Tek bërthama
E) Tek mitokondria
PS)A

Pyetja 588 V)2

Cili ekzaminim radiologjik duhet kryer në rast se dyshohet për një bllokim të zorrëve?

A) Klizma opake
B) CT
C) Radiografi me barium
D) Radiografi abdominale pa kontrast
E) Ekografi
PS)D

Pyetja 589 V)1

Leukopenia tek pacientët me lupus eritematoz sistemik shkaktohet në thelb nga pakësimi i:

A) Bazofileve
B) Eozinofileve
C) Faktorit reumatoid
D) Limfociteve
E) Eritrociteve
PS)D

Pyetja 590 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me digitalis është i gabuar?

A) Struktura kryesore e molekulës është ciklopentanoperidrofenantrene

B) Vetia e saj kryesore terapeutike është efekti inotrop pozitiv
C) Ka efekt mbi shpejtësinë e tejçimit të stimulit
D) Shkakton retension të Na+
E) Toksicitetii saj rritet nga hipopotasiemia
PS)D

Pyetja 591 V)1

Cili prej këtyre barnave mund të japër efekt ototoksik?

A) Diuretikët
B) Antispasmodikët
C) Hipoglicemizantët
D) Antikonvulsivantët
E) Kortizonikët
PS)A

Pyetja 592 V)2

Tek distrofia miotonike:

A) Debulesa dhe miotonia zakonisht shfaqen me vonesë
B) Muskujt e inervuar facial dhe sternokleidomastoid preken rëndë zakonisht
C) Kontraktime spontane shfaqen në rreth gjysmat e rasteve
D) Miotonia ngadalësohet nga i ftohti
E) Miotonia shfaqet zakonisht tek muskuli tenar dhe rrallë në gjuhë
PS)B

Pyetja 593 V)2

Me terapi të krizës së cefalesë së migrenës me intensitet të fortë duhet përdorur më mirë:

A) Ergotamina ose diidroergotamina në rrugë orale
B) Acidi acetilsalicilik me doza më të mëdha se 1000 mg ne rrugë orale
C) FANS
D) Triptanët
E) Nuk ka ndonjë dallim thelbësor mes barnave të treguara më sipër
PS)D

Pyetja 594 V)2

Fraksioni i sekretuar nga natriumi i filtruar normalisht është:

A) Më i vogël ose i barabartë me 1%
B) 1.5-3%
C) 3-4.5%
D) 4.5-6%

E) 6.5-8%
PS)A

Pyetja 595 V)2

Cila prej këtyre lidhjeve me hernien është e saktë?

A) Hernia krurale / raste të shumta strangulacioni intestinal tek femrat
B) Hernie indirekte / hernie nëpërmjet trekëndëshit të Hasselbach
C) Hernie incizionale / hernie nëpërmjet vijës semilunare
D) Hernie direkte / hernie që zbret në skrotum
E) Hernia e Spigelios / hernia me bllokim të një pjese të paretit intestinal
PS)A

Pyetja 596 V)1

Gonadi primitiv paraqitet identik në të dy sekset dhe është potencialisht biseksuale tek:

A) 6 javët e para të jetës
B) 8 javët e para të të jetës
C) 10 javët e para të jetës
D) 12 javët e para të jetës
E) 14 javët e para të jetës
PS)A

Pyetja 597 V)1

Të gjitha llojet e imunoglobulinave kanë të përbashkët:

A) Përbërjen e zinxhirëve të rëndë
B) Përbërjen e zinxhirëve të lehtë
C) Kostanten e sedimentimit.
D) Peshën muskulare.
E) Zonën hiper të ndryshueshme
PS)A

Pyetja 598 V)2

Hidatidoza shkaktohet nga:

A) Ekinokoku
B) Taenia
C) Hymenolepis nana
D) Leptospiri
E) Agjentë të ngjashëm prionikë
PS)A

Pyetja 599 V)2

Sëmundja Vaquez karakterizohet nga:

A) Shtimi i eosinofileve
B) Prania e elementëve imaturë në qarkullim
C) Eritropenia
D) Shtimi i rruazave të bardha në qarkullim
E) Shtimi i rruazave të kuqe në qarkullim
PS)E

Pyetja 600 V)3

Cili është shkaku më i shpeshtë i të vjellave tek latantët?

A) Infeksione urinare të shpeshta
B) Celiakia
C) Zorrë e trashë e irrituar
D) Refluksi gastro ezofageal
E) Rrotullim i keq i zorrës
PS)D

Pyetja 601 V)3

Cila është procedura e menjëhershme që duhet kryer mes alternativave të mëposhtme , tek një pacient 21 vjeçar që vuan nga astma bronkiale, që trajtohet në banesë me beta - agonistë, teofilinikë dhe steroidë i cili që prej disa orësh shfaq simptomat e hip
A) Trajtim sistematik me kortikosteroidë
B) Natrium kromoglikato me gëlltitje
C) Kontakt telefonik dhe diskutim me mjekun personal për të marrë të dhëna të tjera
D) Pregatitje për intubim endotrakeal
E) Ipratrop bromuri me gëlltitje
PS)D

Pyetja 602 V)1

Cilën nga gjendjet e mëposhtme shkakton Megakoloni toksik?

A) Rektokolitin ulceroz
B) Sëmundjen Crohn
C) Divertikolozën e zorrës së trashë
D) Enterokolitin amebic
E) Një stenozë neoplastike të zorrës së trashë
PS)A

Pyetja 603 V)2

Rruga e brendshme dhe e jashtme përgjegjëse për koagulimin e gjakut konvergojnë mbi faktorin X, i cili:

A) Është një endopeptidazë që shndërron protrombinën në trombinë.
B) Vepron si oksidant tek fibrinogjeni që shndërrohet në fibrinë.
C) Favorizon lëshimin e fibrinogjenit nga trombocitet.
D) Quhet ndryshe edhe faktori christmas.
E) Aktivizohet nga prokonvertina e aktivizuar dhe nga tromboplastina.
PS)A

Pyetja 604 V)1

Cili prej barnave të mëposhtëm duhet përdorur gjatë fibrilacionit ventrikular gjatë një infarkti akut të miokardit?

A) Lidokaina
B) Digoksina
C) Kinidina
D) Flekainidi
E) Propranolol
PS)A

Pyetja 605 V)2

Cili nga ekzaminimet e mëposhtme nuk rekomandohet për një pacient 60 vjeçar që paraqet proktoragji?

A) Pankolonoskopia
B) Klizma opake
C) Rx direkte e zorrës
D) Eksplorim rectal
E) Klizëm opake me kontrast të dyfishtë
PS)C

Pyetja 606 V)1

Një protozoar është:

A) Një organizëm njëqelizor
B) Një organizëm i papajisur me membranë bërthamore
C) Një parazit bakterial
D) Një organizëm shumëqelizor
E) Një organizëm pa aparat mitokondrial
PS)A

Pyetja 607 V)2

Në cilën sëmundje të lëkurës haset shenja e "shkallëzës"?

A) Sifilizi primar
B) Tuberkuloz ulcerativ
C) Epiteliomë poshtëqelizore
D) Erisipela
E) Eritemë nodoze
PS)D

Pyetja 608 V)1

Kalcifikimet biliare te bilirubinatit të kalciumit hasen më shpesh tek pacientët e prekur nga:

A) Sëmundja ileale Crohn
B) Rezeksion ileal
C) Anemi hemolitike kronike
D) Ulcera peptike
E) Rektokoliti ulceroz
PS)C

Pyetja 609 V)1

Mikroorganizmat oportunistë:

A) Janë agjentë intoksikimesh ushqimore
B) Janë përgjegjës për infeskionet tek personat imunodepresivë
C) Janë gjithmonë të ndjeshëm ndaj antibiotikëve të zakonshëm
D) Janë të pajisur me faktorë të posacëm virulentë
E) Janë të pranishëm vetëm tek indet njerëzore të infektuara
PS)B

Pyetja 610 V)2

Tek hiperlipoproteinemia familjare e kombinuar (hiperlipoproteinemia lloji II B) janë rritur:

A) VLDL dhe/ose LDL
B) VLDL dhe /ose kilomikronët
C) Vetëm kilomikronët
D) Vetëm HDL
E) HDL dhe/ose kilomikronët
PS)A

Pyetja 611 V)1

Avitaminoza PP mund të shkaktojë:

A) Rakitizëm

B) Beri-beri
C) Skorbut
D) Kwarshiorkor
E) Pellagra
PS)E

Pyetja 612 V)2

Cili prej markerave të mëposhtëm për autoantikorpet është më karakteristik për lupus eritematoz sistemik?

A) Anti Scl-70
B) Anti ADN native
C) Anti - Jo1
D) Anti - RNP
E) Anti-gliadinë
PS)B

Pyetja 613 V)1

Cila prej këtyre sëmundjeve bakteriale është më e shpeshtë tek meshkujt sesa tek femrat?

A) Pielonefriti
B) Sëmundja e Basedovit
C) Anoreksia psikike primare
D) Sindroma Takayasu
E) Artriti gutik
PS)E

Pyetja 614 V)2

Acidoza metabolike mund të zhvillohet për shkak të:

A) shtimit të bikarbonateve plazmatike
B) insuficencës renale
C) reduktimit të prodhimit të laktatit
D) fekalomës
E) strumës
PS)B

Pyetja 615 V)2

Cili pohim është i gabuar lidhur me shpejtësinë e fluksit hematik?

A) Është e ulët tek kapilarët sepse kanë rezistencë të lartë
B) Është më e madhe tek venat sesa tek venulat
C) Tek arteriet është më e madhe se tek arteriolat

D) Tek enët e mëdha të gjakut është më e madhe drejt qendrës sesa drejt periferisë
E) Tek venulat është më e vogël se tek vena kava inferiore
PS)A

Pyetja 616 V)2

Embolia gazoze e zhytësit favorizohet nga:

A) hiperventilimi i zgjatur
B) hiperventilimi me oksigjen
C) zhytjet e shpeshta
D) aktiviteti i paktë fizik
E) raca kaukaze
PS)C

Pyetja 617 V)1

Diabeti mielit i llojit 1:

A) është një sëmundje gjenetike
B) është një sëmundje poligjenike në të cilën trashëgohet predispozita për t'u sëmurur dhe faktorët ambientalë janë evente që shkaktojnë sëmundjen
C) është një sëmundje imunitare e ndërmjetësuar nga antikorpet
D) karakterizohet nga një sekretim anormal insulin
E) prek vetëm fëmijët
PS)B

Pyetja 618 V)2

Cili prej barnave të mëposhtëm që përdoret në terapinë per artritin reumatoid mund të shkaktojë retinopati?

A) Methotrexate
B) kripëra ari
C) D-penicilamina
D) Hidroklorokina
E) sulfasalazina
PS)D

Pyetja 619 V)2

Alternimi i rrahjeve të gjera me rrahjet e vogla të zemrës në interval të rregullta duket tek

A) pulsi anakrotik
B) pulsi dikrotik
C) puls i ndryshueshëm
D) pulsi i alternuar

E) puls i shpejtë dhe i fortë
PS)D

Pyetja 620 V)3

Lidhja 2,3 - bisfogliceratit me hemoglobinën shkakton cilën nga pasojat e mëposhtme?

A) Hemoglobina fiton më shumë aftësi për të lëshuar oksigjen
B) Hemoglobina fiton më pak aftësi për të lëshuar oksigjen
C) Hemoglobina lidh më fortë CO2
D) Hemoglobina lëshohet nga qelizat e kuqe
E) Oksigjeni nuk lidhet me hemoglobinën
PS)A

Pyetja 621 V)3

Çfarë është kanjula e dyfishtë e Mayo-s?

A) mjet për spirometrinë
B) mjet që mbahet në xhep për frymëmarrjen artificial
C) maskë kundragaz
D) eritemë fytyre nga monoksidi i karbonit
E) një lloj shiringe
PS)B

Pyetja 622 V)2

Tek pneumonia lobare përshkruhen zakonisht në nivel anatomo-patologjik disa stade evolutive. Si renditen ato?

A) kongjestion? hepatizim gri? Karnifikim? Zgjidhje?
B) kongjestion? hepatizim i kuq? Hepatizim gri? Zgjidhje?
C) hepatizim i kuq? Hepatizim gri? Kolikuacion? Zgjidhje?
D) hepatizim i kuq? Kongjestion? Infiltrim inflamator? Zgjidhje?'
E) kongjestion? Hepatizim i kur? Karnifikim? Zgjidhje?
PS)B

Pyetja 623 V)2

Në kushte fiziologjike kuota më e madhe e T3 tek indet periferike vjen nga:

A) ndarja e tiroglobulinës
B) monodezjodizimi ekstratiroidal i T4
C) bashkimi i MIT dhe DIT
D) jodizimi intratiroidal i DIT
E) monodezjodizimi ekstratiroidal i T4
PS)B

Pyetja 624 V)3

Sindroma malinje i neuroleptikëve karakterizohet nga:

A) mendime keqadashëse dhe negative
B) defiçit i sistemit imunitar me leukopeni
C) hipertermi
D) ngrurtësim muskular, hipertermi, shqetësime neurovegjetative
E) mërzitje
PS)D

Pyetja 625 V)1

Arteria vertebrale e djathtë zakonisht fillon tek:

A) harku i aortës
B) subklavja e djathtë
C) karotidja e djathtë
D) trungu anonim
E) humeralja e djathtë
PS)B

Pyetja 626 V)2

Nga çfarë varet aksioni mbështetës i ekstrogjenëve tek karcinoma e mamelës?

A) aktivizimi i virusit Epstein - Barr
B) aktivizimi i prokarcinogjenëve kimikë
C) pengimi i shprehjes së genit receptor të progesteronit
D) stimulimi i aktivitetit riprodhues të epitelit mamar
E) mutacionit inaktivizues i genit onkosopresor P53
PS)D

Pyetja 627 V)1

Tek kulloshtra, klasa predominuese e Ig-së është:

A) IgM
B) IgG
C) IgA
D) IgD
E) IgE
PS)C

Pyetja 628 V)1

Cila prej substancave të mëposhtme metabolizohen në nivel pulmonar?

A) substanca P
B) istamina
C) dopamine
D) angiotensina II
E) angiotensina I
PS)E

Pyetja 629 V)1

Ndjeshmëria nga dhembja pengohet nga:

A) sistemi simpatik.
B) sistemi kolinergjik.
C) bradikina.
D) endorfina.
E) naloksoni.
PS)D

Pyetja 630 V)1

Cila prej gjendjeve të mëposhtme lidhet me praninë e antikorpeve antibërthamë në pothuajse shumicën e rasteve?

A) lupus sistemik
B) sindroma e antikorpeve me antifosfolipidë primitivë
C) poliartriti nodoz
D) sindroma nga lodhja kronike
E) fibromialgia
PS)A

Pyetja 631 V)1

Eleminimi antigjen - specifik ndodh falë:

A) makrofagëve
B) linfociteve B
C) linfociteve Ts
D) monociteve
E) zëvendësuesit
PS)C

Pyetja 632 V)2

Çfarë janë qelizat CD4 pozitive?

A) granulocite neutrofile
B) paraardhëse të trombociteve
C) limfocite totale
D) limfocite T suppressor
E) limfocite T helper
PS)E

Pyetja 633 V)1

Dozimi RIA është:

A) një teknikë imunoradiometrike
B) një teknikë radioimunologjike
C) një teknikë imunoenzimatike
D) një teknikë kemiolumineshente
E) një teknikë elektrokemiolumineshente
PS)B

Pyetja 634 V)2

Në marrëdhënien me pacientin për psikiatrin është e rëndësishme:

A) të ruhet distance dhe paanshmëria
B) të shmanget shprehja e gjykimeve fajësuese
C) të akuzohet pacienti për gabimet e tij
D) të edukohet pacienti
E) të shtypen veprimet e tij të papërshtatshme
PS)B

Pyetja 635 V)3

Kondroma është:

A) një tumor malinj i indit sinovial
B) një tumor malinj kërcor
C) një dëmtim pseudotumoral
D) një degjenerim i kërcit artikular
E) një tumor beninj i kërcit
PS)E

Pyetja 636 V)2

Cili prej këtyre pohimeve është i saktë në lidhje me barrierën hematoencefalike?

A) Përshkohet lirisht nga jonet inorganike
B) Përshkohet lirisht nga gazet
C) Përshkohet lirisht nga joni natrium

D) Përshkohet lirisht nga joni bikarbonat
E) Përshkohet lirisht nga uji
PS)E

Pyetja 637 V)1

Cili prej këtyre pohimeve është i gabuar?

A) Refluksi gastroezofageal është një dukuri normale në muajt e parë të jetës
B) Sëmundja e refluksit gastroezofageal lidhet gjithmonë me hernien hiatale
C) E vjella hematike mund të tregojë ekzistencën e një ezofagiti
D) Ndryshimet disfonike mund të jenë simptomë e sëmundjes së refluksit gastroezofageal
E) Bronkopneumonia recidive mund të shkaktohet nga refluksi gastroezofageal
PS)B

Pyetja 638 V)2

Cila prej këtyre patologjive nuk bën pjesë tek uropatitë malformuara?

A) refluksi veziko-uretero-renal
B) valvulat e uretrës së pasme
C) hipertrofia klitoridiene
D) përçueshmëria e urakut
E) hidronefroza
PS)C

Pyetja 639 V)1

Mikrobi që shkakton zakonisht infeksionet e likidit ascitik është:

A) E. Coli
B) K. Pneumoniae
C) Str. Pneumonia
D) Str. Viridans
E) S. Aureus
PS)A

Pyetja 640 V)1

Tek latantët me infeksion në rrugët urinare shfaqja klinike më e shpeshtë është:

A) ethet
B) dizuria
C) polakiuria
D) dhimbja në pjesën lombare
E) inkontinenca
PS)A

Pyetja 641 V)2

Një dëmtim i nervit peronien i zakonshëm (shiatik popliteal ekstern) shkakton:

A) paaftësi për të ekstenduar këmbën.
B) paaftësi për të flektuar këmbën.
C) paaftësi për të flektuar këmbën mbi kofshë.
D) paaftësi për të ekstenduar këmbën mbi kofshë.
E) paaftësi për të qëndruar në majë të gishtave të këmbës.
PS)B

Pyetja 642 V)1

Shkaku më i shpeshtë i sindromës nefrotike tek i rrituri është:

A) glomerulonefriti me lezione minimale.
B) glomerulonefriti membranoproliferativ.
C) glomerulоskleroza diabetike.
D) glomerulonefriti membranoz.
E) nefroskleroza beninje dhe malinje.
PS)D

Pyetja 643 V)1

Maturimi i spermatozoidëve bëhet në nivel:

A) epididimik.
B) të vezikulave seminale.
C) të kanalit vaginal.
D) të duktus deferencial.
E) në kontakt me ovocitet.
PS)A

Pyetja 644 V)2

Në pllakën motore përfundon:

A) një fibër nervore mielinike sensitive somatike.
B) një fibër nervore amielinike motore somatike.
C) një fibër nervore mielinike motore somatike.
D) një fibër nervore amielinike motore viscerale.
E) një fibër nervore mielinike motore viscerale.
PS)C

Pyetja 645 V)1

Qelizat Natural Killer (NK) janë:

A) përbërës të sistemit makrofageal
B) paraprirës të limfociteve Th1
C) paraprirës të limfociteve B
D) limfocite të mëdha granulare
E) qeliza që paraqesin antigjenin (APC)
PS)D

Pyetja 646 V)2

Cili prej këtyre pohimeve është me siguri i vlefshëm për Sarkoidozën?

A) Shfaqjet klinike që prekin mushkëritë janë në mënyrë absolute më të shpeshta.
B) Shfaqjet klinike që prekin sistemin kardiovaskular janë në mënyrë absolute më të shpeshta
C) Hipoventilimi është i pranishëm në mënyrë të pandryshueshme.
D) Azma bronkiale përfaqëson një komplikacion të vonë.
E) Diagnoza bazohet tek e dhëna e alveolitit linfocitar në lavazhin bronko alveolar.
PS)A

Pyetja 647 V)1

Sindroma Mallory Weiss verifikohet në rast:

A) tumori endokrin të pankreastit.
B) diarreje sekretuese.
C) të vjellash të përsëritura.
D) tumori hipofizar.
E) polipozë në moshë të re.
PS)C

Pyetja 648 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtëm jep informacionin më të mirë në lidhje me prognozën në fazë malinje të hipertensionit?

A) niveli i tensionit sistolik
B) niveli i tensioni diastolik
C) shpeshtësia kardiake
D) ndryshimet në funksionimin e veshkave
E) përmasat kardiake
PS)D

Pyetja 649 V)1

Cili prej barnave i jepet pacientit me glikozuri normoglicemike?

A) insulin
B) sulfaniluret
C) biguanidet
D) asnjë prej tyre
E) të tre barnat në ditë të ndryshme
PS)D

Pyetja 650 V)3

Një adoleshent konstaton një masë, në formë kordoni në anën e majtë të skrotumit. Cila prej diagnozave të mëposhtme është më e mundshmja?

A) hidrocelë
B) variokokelë
C) epididemit
D) përdredhje e testikulit
E) përdredhje e appendix testis
PS)B

Pyetja 651 V)2

Një dhembje akute në nivelin e artikulacionit të parë metakarpo-falangeal me fryrje, shtim të temperaturës lokale dhe dhimbje është tregues i:

A) kondrokalcinozës
B) artritit gutik (podagrik)
C) artrozës
D) artritit reaktiv
E) artritit rheumatoid
PS)B

Pyetja 652 V)1

Prania e antikorpeve kundër receptorit TSH është përgjegjëse për:

A) tiroiden e infektuar
B) miastenia gravis
C) sklerozën multiple
D) sëmundjen Graves
E) sindromën Goodpasture
PS)D

Pyetja 653 V)2

Vlera e alfa1 fetoproteinës më e madhe se 100 ng/ml tek pacienti HBsAg dhe/ose HCV pozitiv sugjeron praninë e:

A) hepatitit kronik aktiv
B) hepatokarcinomës
C) hepatitit akut
D) Hemokromatozës
E) steatozës hepatike
PS)B

Pyetja 654 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtëm në lidhje me trombocitet është i vërtetë?

A) Kolagjeni pengon bashkimin e tyre
B) Nuk janë qeliza
C) Tek gjaku periferik janë të pajisura me një bërthamë shumë të vogël
D) Tek gjaku periferik janë më të shumta në numër se eritrocitet
E) Rrjedhin nga metamieloblasti
PS)B

Pyetja 655 V)2

Cili nga elementët e mëposhtëm nuk sugjeron diagnozën e encefalopatisë tek një pacient me Cirrozë?

A) ndryshim humori
B) inversion i ritmit gjumë - zgjuar
C) flapping tremor
D) aftësi e ndryshuar tek testet psikometrike
E) Diplopia
PS)E

Pyetja 656 V)2

Bazat e ADN-së përbëhen nga gjithë këto elementë me përjashtim të njërit që është karakteristik i ARN-së. Cila është baza që nuk është e pranishme tek AND-ja?

A) uracili
B) adenine
C) guanine
D) citozina
E) timina
PS)A

Pyetja 657 V)1

Tek subjektet e prekur nga divertikuloza ezofageale, ezofagoskopia është:

A) për t'u këshilluar
B) duhet evituar plotësisht
C) e nevojshme
D) duhet praktikuar me kujdes pas ekzaminimit radiografik
E) e domosdoshme
PS)D

Pyetja 658 V)3

Një femër 56 vjeç, që prej 2 vjetësh në menopauzë, po trajtohet me estrogjenë për osteoporozë. Të gjitha komplikacionet e mëposhtme mund të shfaqen me përjashtim të:

A) karcinomës endometriale
B) patologjisë së tëmthit
C) hipertensionit
D) melanomës malinje
E) tromboembolisë
PS)D

Pyetja 659 V)2

Simptoma fillestare më e shpeshtë e neurinomës së nervit akustik është:

A) hipoakuzia receptive e njëanshme
B) marrje mendsh
C) hipoakuzia receptive e dyanshme
D) sinkopi
E) afazi
PS)A

Pyetja 660 V)1

Në lidhje me perikarditin, cilat pohime janë të vërteta?

A) tuberkulozi është shkaku më i zakonshëm
B) zakonisht nuk arrihet të përcaktohet shkaku i sëmundjes
C) uremia mund të jetë shkaku i perikarditit
D) perikarditi kronik kostriktiv paraqet shenja hemodinamike të përbashkëta me amiloidozën kardiake
E) tri pohimet e fundit janë të vërteta
PS)E

Pyetja 661 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtëm në lidhje me nefropatinë diabetike nuk është i saktë?

A) Shfaqja e nefropatisë ndodh benda një viti nga shfaqja e diabetit

B) Vëllimi i veshkës zmadhohet
C) Shfaqja e nefropatisë ndodh benda 5-15 vjetësh nga shfaqja e diabetit
D) Shfaqja e nefropatisë paraprihet nga mikroalbuminuria
E) Shfaqja e nefropatisë lidhet me proteinurinë e izoluar
PS)A

Pyetja 662 V)2

Një nënë me grup gjaku AB, Rh-pozitiv pret një fëmijë nga një baba me grup gjaku 0 Rh negativ. Cilën procedurë duhet të adaptojmë për të parandaluar një anemi të mundshme hemolitike të fetusit?

A) dhënien e medikamentit anti Rh nënës përpara lindjes
B) dhënien e medikamentit anti Rh nënës pas lindjes
C) dhënien e medikamentit anti Rh nënës dhe fetusit në rast se fetusi është A Rh pozitiv ose B Rh pozitiv
D) nuk jepet medikament sepse nuk ka rrezik për sëmundje hemolitike
E) dhënien e medikamentit anti AB
PS)D

Pyetja 663 V)1

Cila e dhënë kontribuon në mënyrë përcaktuese në diagnozën e epilepsisë?

A) elektroencefalograma dhe anamneza
B) ekzaminimi objektiv i pacientit
C) TC cerebral
D) RM cerebrale
E) kërkimi gjenetik
PS)A

Pyetja 664 V)2

Nga një pikëpamje etiologjike shkaku më i shpeshtë i perikarditit kostriktiv është:

A) tuberkulozi
B) trauma të mbyllura të toraksit
C) infeksione nga piogjenët
D) infeksione nga mykozat
E) plagë të perikardit
PS)A

Pyetja 665 V)1

Cili prej baktereve të mëposhtëm transmetohet në rrugë seksuale?

A) streptokokus pyogenes

B) neisseria gonorrhoeae
C) staphylococcus aureus
D) mycobacterium tuberculosis
E) pseudomonas aeruginosa
PS)B

Pyetja 666 V)2

Cili është shkaku kryesor i vdekjeve nga SLA?

A) infarkti i miokardit
B) bronkopneumonia
C) herniacioni cerebral
D) demenca
E) insuficienca respiratore
PS)E

Pyetja 667 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtëm mbi nitroprusidin e natriumit ka më shumë të ngjarë të mos jetë i vërtetë?

A) Është një dilatator enësh gjaku që vepron direkt tek muskulatura e enëve të gjakut
B) Përcakton një reduktim të prengarkesës dhe postngarkesës
C) Kur nuk jepet më, efekti përfundon pas 10-15 minutash
D) Duhet përdorur me kujdes tek pacientët me bashkëpunim të ulët intrakranial
E) Mund të shkaktojë toksicitet nga cianuri, trajtohet me natrium tiozolfati.
PS)C

Pyetja 668 V)1

Në cilat degëzime ndahet tufa e Hisit?

A) të djathtë e të majtë
B) të djathtë, të majtë, të majtë e përparme dhe e majtë e pasme
C) e djathtë e përparme, e djathtë e pasme dhe e majtë
D) e majtë e përparme, e majtë e pasme
E) e majtë e majtë e përparme dhe e majtë e pasme, e djathtë e përparme dhe e pasme
PS)B

Pyetja 669 V)2

Në rast mbidoze opioidi, antidoti specifik është:

A) metadoni
B) buprenorfina
C) naloxoni

D) triamcinoloni
E) fenilbutazon.
PS)C

Pyetja 670 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtëm përshkruan në mënyrën më të duhur në foramen ovale tek fetusi?

A) Devijon gjakun nga e djathta në të majtë
B) Lidh arterien pulmonare me aortën
C) Devijon gjakun e paoksigjenuar tek atriumi i majtë
D) Është një shunt ekstrakardiak
E) Është funksionale pas lindjes
PS)A

Pyetja 671 V)1

Kur bëhet kardioversioni elektrik i sinkronizuar?

A) takikardi ventrikulare pa puls
B) bllokim A -V i llojit të I° a Mobitz II
C) bllokim A -V i llojit të II° a Mobitz II
D) flutter arterial
E) disocim elektromekanik
PS)D

Pyetja 672 V)2

Displazia është aspekti histologjik karakteristik i cilit polip intestinal?

A) hiperplastik
B) adenomatoz
C) amartomatoz
D) infiamator
E) të kohëve të fundit
PS)B

Pyetja 673 V)2

Cila prej substancave të mëposhtme stimulon në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë sekretimin e brendshëm të ACTH-së?

A) Anfenoni
B) metopironi
C) bromokriptina
D) ciproteroni

E) betamentazoni
PS)B

Pyetja 674 V)1

Organi më i madh hematopoietik në fazën embrionale është:

A) palca kurizore hematopoietike
B) mëlçia
C) shpretka
D) nyjet limfatike
E) sakusi vitelin
PS)E

Pyetja 675 V)3

Cili nga markuesit e mëposhtëm është një markues shumë i vlefshëm serologjik për Cirozën biliare primitive?

A) antikorpet anti mitokondre
B) antikorpet anti bërthamë
C) antikorpet anti LKM
D) antikorpet anti muskul i lëmuar
E) antikorpet anti citoplazëm të neutrofileve
PS)A

Pyetja 676 V)2

Në terapinë e komës ketoacidozike bikarbonatët duhet të jepen me ngadalë për të shmangur:

A) hiperkaleminë e rëndë
B) kalimin e reduktuar të O2 nga hemoglobin tek indet
C) uljen e pH në likuidin cefalorakidian
D) hipokaleminë e rëndë me kalim të reduktuar të O2 nga hemoglobina tek indet dhe rënie të pH në likuidin cefalorakidian
E) koha e dhënies nuk ka asnjë rëndësi. Është thelbësore sasia e bikarbonatëve të injektuara
PS)D

Pyetja 677 V)2

Cili prej dëmtimeve të mëposhtme duhet të konsiderohet si prekanceroz?

A) herpes siplex
B) leukoplakia
C) dermatitis polimorf diellor
D) verruca volgaris

E) plagë nga dekubitusi
PS)B

Pyetja 678 V)3

Një patolog trajton rastin e një mashkulli 32 vjeçar me "apendicit akut". Në mikroskop infiamacioni duket se prek vetëm membranën seroze. Për çfarë duhet të dyshojë fort patologu?

A) apendicit akut i lehtë në fazë fillestare
B) apendicit kronik
C) poliarterit nodoz
D) peritonit nga sëmundja e një organi tjetër
E) apendiksi është normal
PS)D

Pyetja 679 V)1

Anemia makrocitike nga defiçiti i vitaminës B12 mund të haset më zakonisht tek infektimi me:

A) candida albicans
B) entameba histolytica
C) echinococcus granulosus
D) difillobotrium latum
E) pneumokok
PS)D

Pyetja 680 V)2

Zhvendosja e mediastinit drejt anës së sëmurë vërehet në gjendjen e:

A) empiemës
B) fibrozës pulmonare
C) hidrotoraksit
D) pleuritit eksudativ
E) pneumotoraks
PS)B

Pyetja 681 V)2

Pseudo haluçinacionet janë:

A) interpretime të sakta të një stimuli ndjesor
B) kanë veçoritë e ndjeshmërisë
C) përbëjnë një komponent të fortë përfaqësues
D) vërehen shpesh në dëmtimet oksipitale ose temporal

E) janë alterime të senso-perceptimeve që kanë të bëjnë me hapësirën e brendshme të trupit
PS)E

Pyetja 682 V)2

Cili prej antibiotikëve të mëposhtëm përdoret për të trajtuar kolitin nga Clostridium difficile?

A) rifampicina
B) eritromicina
C) vankomicina
D) klindamicina
E) cefazolina
PS)C

Pyetja 683 V)1

Cilat janë qelizat më të rëndësishme në dëmtimet pulmonare të një pacienti te sekrecionet e mukozës së të cilit gjenden bakteret acido-alkol rezistente?

A) makrofagët
B) fibroblaste
C) neutrofile
D) mastocite
E) trombocite
PS)A

Pyetja 684 V)1

Zona motore (4) e kores cerebrale vaskularizohet nga:

A) arteria komunikuese posteriore
B) arteria komunikuese anteriore
C) arteria cerebrale posteriore
D) arteria cerebrale anteriore dhe arteria cerebrale media
E) arteria cerebrale anteriore dhe arteria cerebrale posteriore
PS)D

Pyetja 685 V)1

TRH-ja çon në sekretimin e cilit prej hormoneve të mëposhtëm?

A) VIP
B) somatostatinë
C) TSH
D) kortizol
E) testosterone

PS)C

Pyetja 686 V)2

Cila prej sëmundjeve të mëposhtme karakterizohet nga një difekt i metabolizmit të kolagjenit të llojit I?

A) nanizëm distrofik
B) osteogjenezë imperfekte
C) mukopolisakaridozë
D) pseudoakondroplazi
E) displazi hipofizare e shumëfishtë
PS)B

Pyetja 687 V)1

Cili verifikim instrumental është thelbësor për diagnostikimin e endokarditit?

A) ECG
B) Ekokardiograma
C) Rx i toraksit
D) TAC
E) EEG
PS)B

Pyetja 688 V)2

Bronkoektazitë shkaktojnë në raste të rralla:

A) dhimbje në toraks
B) infeksion pulmonar
C) hemoptizi
D) sekrecione të shumta
E) gishta në formë shkopinjsh daulleje
PS)A

Pyetja 689 V)1

Vala P e EKG-së tregon:

A) depolarizimin atrial
B) depolarizimin ventrikular
C) ripolarizimin ventrikular
D) ripolarizimin atrial
E) mbushjen e atriumit të djathtë
PS)A

Pyetja 690 V)2

Veshka multicistike është një anomali renale:

A) e lindur
B) ndonjëherë e fituar, ndonjëherë e lindur
C) e fituar
D) e fituar vetëm për seksin femër
E) e fituar vetëm për seksin mashkull
PS)A

Pyetja 691 V)2

Neoplazia malinje më e shpeshtë në moshën pediatrike është:

A) retinoblastoma
B) Neuroblastoma
C) sarkoma Ewing
D) leucemia limfoblastike akute
E) tumori Wilms
PS)D

Pyetja 692 V)2

Progresioni neoplastik lidhet me fenomenet e:

A) displazisë
B) rritjen progresive të qelizës neoplastike
C) shtypjes selektive mbi klonet qelizore të ndryshuara
D) hipertrofisë
E) diskeratozës
PS)C

Pyetja 693 V)1

Cila është zona ku shfaqet më shpesh ulcera gastrike?

A) corpus
B) antrum
C) cardias
D) fundus
E) kurvatura minor
PS)E

Pyetja 694 V)2

Cili prej faktorëve prognostikë të mëposhtëm lidhet më shpesh me një prognozë të keqe

të karcinomës mamare?

A) forma diploide e ADN-së
B) vendndodhja e tumorit
C) metastaza e nyjeve limfatike
D) dozimi receptor negativ për ekstrogjenin dhe progesteronin
E) madhësia e tumorit
PS)C

Pyetja 695 V)1

Cili është komplikacioni më i shpeshtë i stenozës valvulare aortike?

A) endokarditi bakterial
B) sinkopi ose vdekja e papritur
C) edema në gjymtyrët e poshtme
D) embolia polmonare
E) extrasistola
PS)B

Pyetja 696 V)2

Një gastrinemi më e madhe se 1000 pg/ml sugjeron praninë e:

A) sindromës Zollinger Ellison
B) sindromës Menetrier
C) sindromës Mallory - Weiss
D) sindromës Werner - Morrison
E) sindromës së kavitetit gastrik
PS)A

Pyetja 697 V)1

Gjetja e niveleve thelbësore të asistencës shëndetësore i takon:

A) shtetit
B) krahinave dhe provincave autonome
C) ASHR-ësë
D) spitaleve
E) rretheve
PS)A

Pyetja 698 V)2

Faza REM e gjumit karakterizohet nga:

A) lëvizje okulare të ngadalta

B) shtim të tonit muskular
C) reduktim të pragut sensitive
D) desinkronizim i EEG-së
E) sinkronizim i EEG-së
PS)D

Pyetja 699 V)1

Gjatë eksperimentimit klinik "endpoint" janë:

A) variabla të paracaktuara që përdoren për të vlerësuar efektet e trajtimit
B) afate brenda të cilave duhet kryer eksperimentimi
C) marrëveshje mes sponsorit dhe eksperimentuesit
D) variabla primitive dhe që kanë ardhur si rrjedhim
E) variabla që në fund të eksperimentimit rezultojnë të jenë më të mirat për të treguar efektet e trajtimit
PS)A

Pyetja 700 V)3

Pas një lindjeje distocike me humbje të konsiderueshme hematike një femër shfaq shenja panhipopituitarizmi. Cili prej kushteve të mëposhtëm mund të jetë shkaku?

A) terapi e zgjatur me kortizon
B) tumor supraakselar
C) miokardiopati dilatative post-partum
D) pre-eklampsi
E) nekrozë hipofizare post partum
PS)E

Pyetja 701 V)3

Një vaskulit që shfaqet tek enët e gjakut me kalibër mesatar ose të vogël, me simptoma neurologjike (polineuropati asimetrike), të lëkurës (livedo reticularis, ulçer të lëkurës, purpur), renale (glomerulonefrit, insufiçencë renale, hipertension), dhim
A) arterie me qeliza gjigante
B) sëmundjen Takayasu
C) sëmundjen Kawasaki
D) granulomatozën Wegener
E) panarterit nodoz
PS)E

Pyetja 702 V)2

Cila nga simptomat e mëposhtme nuk haset tek 'pneumotoraksi akut' ?

A) dhembje akute e papritur

B) hiperlëvizshmëri hemitorkasit të prekur
C) dispne
D) cianozë
E) hiperfonezë hemitoraks i prekur
PS)B

Pyetja 703 V)1

Protoksidi i azotit:

A) është një metabolit aktiv i nitroderivateve
B) është një anestetik i përjithshëm që merret në rrugë inhalatore
C) nuk ka aktivitet analgjezik
D) shkakton hypotension dipendent ndaj dozës
E) pengon kontraktimet e mitrës
PS)B

Pyetja 704 V)1

PH normal në gjakun arterial tek njeriu është:

A) 6.57 - 6.98
B) 7.15 -7.27
C) 7.35 - 7.41
D) 7.45 - 7.49
E) 7.60 - 7.65
PS)C

Pyetja 705 V)1

Vëllimi i lëngut ekstraqelizor është funksion i gjithë kushteve të mëposhtme me përjashtim të:

A) pH të lëngut ekstraqelizor
B) humbjes ose marrjes së ujit nëpërmjet traktit gastrointestinal
C) sekretimit të Aldosteronit nga mbiveshka
D) humbje të pamjaftueshme uji nëpërmjet lëkurës dhe frymëmarrjes
E) sekretimit të vazopresinës nga gjendra pituitare e pasme
PS)A

Pyetja 706 V)2

Duke hamendësuar që efikasiteti i një vaksine është i barabartë me 87% dhe duke ditur që shpeshtësia e sëmundjes është 7%, numri i rasteve që priten në një kampion prej 4.000 subjektesh të vaksinuar dhe në një kampion prej 3.500 subjektesh të pavaksin
A) 280 në kampionin me subjekte të vaksinuar dhe 245 në kampionin me subjekte të pavaksinuar

B) 280 në kampionin me subjekte të vaksinuar dhe 32 në kampionin me subjekte të pavaksinuar
C) 36 në kampionin me subjekte të vaksinuar dhe 32 në kampionin me subjekte të pavaksinuar
D) nga 157 në secilin prej dy grupeve
E) 36 në kampionin me subjekte të vaksinuar dhe 245 në kampionin me subjekte të pavaksinuar
PS)E

Pyetja 707 V)1

Aldosteroni është një hormon që sekretohet nga:

A) zona fashikulare e korteksit mbiveshkor
B) zona retikulare e korteksit mbiveshkor
C) zona glomerulare e korteksit mbiveshkor
D) pjesa medulare e mbiveshkores
E) pjesa qëndrore e veshkës
PS)C

Pyetja 708 V)1

Cili pohim nuk është i vërtetë në lidhje me apoptozën?

A) Është vdekja e një qelize të vetme
B) Shkaktohet nga një endonuklеazë endogjene jo lizozomiale
C) Është një dukuri fiziologjike
D) Mund të shihet në seksione histologjike
E) Lë një sërë detritesh celulare të përhershme
PS)E

Pyetja 709 V)2

Defekti i lindur më i shpeshtë i steroidogjenezës është:

A) deficiti i 5 - alfa reduktazës
B) deficiti i 21 -hidrolazës
C) deficiti i 11- beta -hidrolëzës
D) deficiti i 3- beta - hidrosisteroidodeidrogjenazës
E) deficiti i aromatazës
PS)B

Pyetja 710 V)1

Shenja e Babinskit shfaqet nga alterimi i:

A) rrugës piramidale

B) sistemit cerebellar
C) rrugës ekstrapiramidale
D) nervave kranialë
E) rrugëve ndjesore
PS)A

Pyetja 711 V)2

Tek hepatiti akut me gjurmë kolestatike, kolesterolemia:

A) shfaqet e rritur
B) shfaqet e ulur
C) shfaqet normale
D) ulet vetëm fraksioni i lirë
E) ulet vetëm fraksioni i jashtëm
PS)A

Pyetja 712 V)2

Si sillet përqindja e ujit në organizmin e subjektit të moshuar kundrejt atij në moshë të re?

A) mbetet e pandryshuar
B) rritet në mënyrë relative
C) rritet në masë të konsiderueshme
D) ulet në mënyrë relative
E) rithithet në mënyrë progresive
PS)D

Pyetja 713 V)1

Komplikacionet e vonshme të frakturës së bërrylit janë/është:

A) kalcifikime me ngurtshmëri të artikulacioneve
B) pseudoartroza
C) artroza post-traumatike
D) insuficencë muskulare
E) ankiloza kockore
PS)A

Pyetja 714 V)3

Fenomeni Wenckebach karakterizohet nga:

A) kompleksi ventrikular që nuk paraprihet nga vala P
B) rrahje e ngadaltë ose evasion junksional
C) sistola atrioventrikulare
D) ritëm idionodal

E) zgjatim progresiv i tejçimit sinoatrial derisa një impul të tejçohet
PS)E

Pyetja 715 V)1

Antibiotiku aktiv vetëm tek flora intestinale sepse nuk përthithet nga tubi tretës është:

A) ciprofloxacina
B) Amoxicillina
C) Neomicina
D) lvofloxacina
E) klaritromicina
PS)C

Pyetja 716 V)1

Çfarë janë kromozomet homologe?

A) Kromozome me të njëjtat përmasa
B) Të gjitha kromozomet me përjashtim të atyre seksuale
C) Kromozomet tek të cilat janë lokalizuar gene për funksione të ngjashme
D) Kromozome me centromere identike
E) Kromozome që përmbajnë alele për të njëjtat gene
PS)E

Pyetja 717 V)1

Imuniteti humoral ndërmjetësohet nga:

A) limfocitet T
B) limfocitet B.
C) monocitet
D) eosinofilet
E) basofilet
PS)B

Pyetja 718 V)3

Klaudio, jë barist nga Fushëkruja 55 vjeç, ka vuajtur nga piroza për rreth 10 vjet. Është kuruar në mënyrë të pavarur me antagonistë H2 duke pasur një benefit simptomatologjik vetëm të pjesshëm. Pasi dëgjoi në Tv që gjendja e tij mund të shkojë drejt n
A) hernie iatale.
B) ezofagit kronik (nga barnat).
C) ezofag të Barret.
D) tumor të ezofagut.
E) ezofagit shkaktuar nga Helicobacter pylori.
PS)C

Pyetja 719 V)2

Cila është shenja cilësuese e dëmtimeve të ligamenteve të kryqëzuara të gjurit?

A) shenja e sirtarit
B) grinding test
C) shenja Oudard
D) manovra Lasègue
E) manovra Ferrero
PS)A

Pyetja 720 V)1

Cili prej rekomandimeve të mëposhtme është pjesë e rekomandimeve të U.S. Preventive Service Task Force?

A) kryerja e mamografisë duke filluar nga mosha 40 vjeç
B) kryerja e kolonoskopisë çdo 5 vjet duke fillaur nga mosha 50 vjeç
C) matja e kolesterolemisë totale në moshën 35 vjeç
D) kryerja e screening oftalmologjik vjetor duke nisur nga mosha 50 vjeç
E) të masin të gjithë tensionin arterial të paktën një herë në vit
PS)E

Pyetja 721 V)1

Diabeti melit i tipi 2 përcaktohet nga:

A) sekretimi i papërshtatshëm i insulinës + rezistenca ndaj insulinës
B) kryesisht rezistenca ndaj insulinës
C) kryesisht defiçiti i insulinës
D) autoimun ndaj insulinës
E) obeziteti
PS)A

Pyetja 722 V)2

Cili prej gjendjeve të mëposhtme tregon që ikteri që shfaqet gjatë javës së parë të jetës, tek një foshnje që ka lindur mes javes 37 dhe 41 të shtatëzanisë, ka më shumë të ngjarë që të shkaktohet nga fenomene fiziologjikë?

A) prani e njëkohësishme e feçeve akolike
B) prani e ikterit që zgjat për 1 muaj
C) prani e ikterit të dukshëm në moshën 20 ditëshe
D) bilirubinë e lëngshme direkte (e bashkuar) më e madhe se 2 mg/dl
E) rritje e bilirubinës direkte me më pak se 0.5 mg/dl
PS)E

Pyetja 723 V)2

Një dëmtim i nervit optik shkakton:

A) verbëri monolaterale
B) verbëri bilateral
C) atrofi tek të dy sytë
D) asnjë diferencë tek diametri pupilar
E) një dëmtim të kornesë
PS)A

Pyetja 724 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtme në lidhje me ndërveprimin ilaç-receptor është i saktë?

A) Trajtimi i tejzgjatur me një antagonist mund të çojë në mungesën e sensibilizimit receptorial
B) Në prani të një antaonisti jo kompetitiv Emax i një agonisti është më i madh sesa ai i vetë agonistit vetëm
C) Një antagonist kompetitiv redukton fuqinë e dukshme të një agonisti
D) Lidhja ilaç-receptor është gjithmonë e kthyeshme
E) Një antagonist kompetitiv shtyn majtas kurbën dozë-përgjigje të një agonisti
PS)C

Pyetja 725 V)1

Lidhja e një sulfamidi dhe pirimetamine rekomandohet për trajtimin e (trego pohimin e saktë):

A) malaries nga Plasmodium falciparum rezistente ndaj klorokinës
B) infeksione nga Trichomonas vaginalis
C) infeksione nga Histoplasma capsulatum
D) infeksione nga Entamoeba histolytica
E) infeksione nga candida albicans
PS)A

Pyetja 726 V)2

Cili sinjal tek EKG-ja të orienton drejt një perikarditi?

A) Q patologjike në I - III
B) mbidisnivelim i ST-së në të gjitha derivimet
C) deformim i QRS-së
D) mungesa e R në I-II
E) zgjatimi P-R
PS)B

Pyetja 727 V)1

Nefropatia e shtatzënisë ose gjestoza karakterizohet nga:

A) mungesa e edemave
B) hypertension arterioz
C) hipouricemi
D) fund okular normal
E) hematuria pa proteinuria
PS)B

Pyetja 728 V)2

Cili prej ekzaminimeve instrumentale nuk përdoret për karakterizimin e metastazave të kockave?

A) shintigrafia kockore
B) TAC
C) Radiografia
D) Ekografia
E) RMN
PS)D

Pyetja 729 V)1

Cila pjesa e lëkurës nuk preket asnjëherë nga zgjebja?

A) koka
B) parakrahët
C) trungu
D) krahët
E) duart
PS)A

Pyetja 730 V)2

Në një program screening për difektet e tubit neural duke përdorur alfa feto proteinën e Likidit matern (ms AFP) veprimi që duhet bërë pas rezultateve të larta të ms AFP në gjak në 2 teste radhazi duhet të jetë:

A) një përcaktim i tretë i alfa feto proteinës (ms AFP)
B) ekzaminim ekografik
C) amniocenteza
D) amniografia
E) këshillim për të ndërprerë shtatëzaninë
PS)B

Pyetja 731 V)2

Cili është tumori i vezoreve shkak i sindromave mashkullore?

A) tumori me qeliza Sertoli - Leydig
B) teratoma
C) tumoret e tekës
D) disgerminoma
E) tumori Brunnes
PS)A

Pyetja 732 V)1

Hipoteza më e akredituar aktualisht në lidhje me etiopatogjenezën e emfizemës është

A) pulmonite të shpeshta
B) ekspozim ndaj azbestit
C) shkatërrim i elastinës pulmonare për shkak të prodhimit të tepërt të elastazës nga ana e neutrofileve
D) dëmtim të kapilarëve pulmonarë si efekt i trysnisë endoalveolare
E) stimulim kronik i gjendrave mukoze bronkiale si pasojë e duhanpirjes
PS)C

Pyetja 733 V)2

CFU-GM është një pararendës hemopoetik që mund të japë tek kultura "in vitro"

A) koloni granulocitare dhe makrofage
B) koloni granulocitare
C) koloni makrofage
D) koloni eritroidesh
E) koloni megakariocitike
PS)A

Pyetja 734 V)2

Cili prej alterimeve të mëposhtme të likuorit cerebrospinal diferencon meningjitin bakterial nga ai viral?

A) hiperproteinorrakia
B) pleiocitoza e likuorit
C) hipoglikorrakia
D) mbizotërimi i limfociteve
E) shtimi i trysnisë së likuorit
PS)C

Pyetja 735 V)2

Cili prej medikamenteve të mëposhtëm përdoret me sukses për të kontrolluar emezën nga kemioterapikët?

A) anti-istaminikë
B) frenues të pompës protonike
C) antiinfiamatorë jo stereoidë
D) anti-serotoninergjikë
E) kalcium antagonistë
PS)D

Pyetja 736 V)1

Kuadri klinik karakteristik i astmës bronkiale nuk përfshin:

A) dispnenë
B) hemoftizinë
C) frymëmarrjen me fishkëllimë
D) kollën
E) ndjesinë e ngushtimit të kraharorit
PS)B

Pyetja 737 V)1

Cilat lloje rrezatimi përdoren për të bërë një CT?

A) ultraviolet
B) ultratinguj
C) rreze X
D) valë elektromagnetike
E) infra të kuqe
PS)C

Pyetja 738 V)1

Në lidhje me angina pectoris, cili prej pohimeve të mëposhtëm nuk është i vërtetë?

A) Angina e qëndrueshme shtyhet nga ushtrimi dhe ndalon gjatë pushimit
B) Angina e paqëndrueshme shfaqet edhe në gjendje qetësie
C) Angina e qëndrueshme shfaqet vazhdimisht me një dhimbje konstante
D) Angina e paqëndrueshme është më e vështirë për t'u trajtuar sesa ajo e qëndrueshme
E) Iskemia miokardike është në shumicën e rasteve asimptomatike
PS)C

Pyetja 739 V)1

Fjala edemë tregon:

A) akumulimin e likidit në kavitetin pleurik
B) akumulimin e yndyrës në nënlëkurë
C) formimin e embolive të yndyrshme në qarkullimin pulmonar
D) akumulimin e lëngut në hapësirën intersticiale
E) akumulimin e yndyrës në indin muskulor të skeletit
PS)D

Pyetja 740 V)1

Frekuenca e astmës bronkiale:

A) është e qëndrueshme tashmë prej disa vitesh
B) është reduktuar gjatë dy viteve të fundit
C) është në rritje të vazhdueshme
D) paraqet periudha të alternuara rritjeje dhe uljeje
E) është përgjysmuar gjatë 5 viteve të fundit
PS)C

Pyetja 741 V)2

Cili prej faktorëve të mëposhtëm rezulton që të jetë rritur gjatë hepatit kronik agresiv aktiv?

A) albuminemia
B) transaminasemia
C) pseudokolinesteraza
D) urobilinogeni fekal
E) protrombinemia
PS)B

Pyetja 742 V)1

Gjendja e mosushqyerjes së zgjatur shkakton:

A) ulje të triglicerideve
B) ulje të bilirubinës
C) rritje të acideve yndyrore të lira
D) rritje të kolesterolit
E) rritje të glicemisë
PS)C

Pyetja 743 V)2

Limfoshintigrafia për kërkimin e nyjave limfatike sentinel vizualizon:

A) nyjen e parë limfatike drenuese limfatike të tumoreve

B) vendndodhjen e metastazave të melanomës
C) numrin e nyjeve limfatike metastatike
D) pengesën për drenazhin limfatik
E) të gjitha gjendjet limfonoidale të trupit
PS)A

Pyetja 744 V)2

Cila është ngjarja negative më e rëndë gjatë kryerjes së patch test?

A) "angry back"
B) sensibilizimi aktiv
C) leukodermë kontakti
D) urtikare nga kontakti
E) reaksion anafilaktik
PS)B

Pyetja 745 V)2

Cili nuk mund të jetë evolucioni i menjëhershëm i gëlltitjes së substancave kaustike?

A) mediastinit akut
B) perforacion gastric
C) perforacion ezofagu
D) hematemezë
E) stenozë e cikatrizuar
PS)E

Pyetja 746 V)1

Çfarë janë faktorët e rritjes?

A) vitamina
B) glikopeptide të nevojshme për riprodhimin qelizor
C) faktorë të nevojshëm për rritjen e zinxhirit polipeptidik
D) kushte ambientale që favorizojnë rritjen e një popullsie
E) faktorë të nevojshëm në fazën e maturimit të molekulave me RNA
PS)B

Pyetja 747 V)2

Nga një veçori patologjike recesive (a) lidhur me kromozomin X, nga cili prej bashkimeve të mëposhtëm nuk do të ketë pasardhës të prekur?

A) AA x Ay
B) aa X aY
C) Aa x AY

D) Aa x aY
E) aa x AY
PS)A

Pyetja 748 V)1

Cili prej efekteve të mëposhtëm anësore nuk hyn tek ato të përshkruara për minoxidilin?

A) hipetrikoza
B) sindroma lupoide
C) mbajtje e ujit dhe natriumit
D) takikardi
E) shqetësime gastrintestinale
PS)B

Pyetja 749 V)2

Cila prej patologjive të mëposhtme mund të shfaqet me një dëmtim të kavitetit të mushkërive?

A) tuberkulozi
B) alveoliti alergjik jokarakteristik
C) astma bronkiale
D) hipertension pulmonar primitiv
E) proteinoza alveolare
PS)A

Pyetja 750 V)3

Cilat janë qelizat e prekura më shumë nga imunopatogjeneza e sarkoidozës?

A) limfocitet CD8
B) limfocitet CD4
C) makrofagët
D) neutrofilet
E) qelizat plazmatike
PS)B

Pyetja 751 V)3

Cili është komplikacioni më i shpeshtë i karcinozës peritoneale?

A) okluzioni intestinal
B) neutropenia
C) anemia
D) diarrea
E) hipotensioni

PS)A

Pyetja 752 V)1

Pilula estro-progestinike vepron mbi të gjitha (për qëllime kontraceptive) në nivelin e:

A) hipofizës
B) tubit uterin
C) qafës së mitrës
D) vezores
E) mbiveshkores
PS)A

Pyetja 753 V)1

Pështyma e pacientëve astmatikë është veçanërisht e pasur me:

A) trombocite
B) eozinofile
C) eritrocite
D) bazofile
E) limfocite
PS)B

Pyetja 754 V)2

Antigjenet Onko-fetale shkaktohen nga fenomenet e:

A) metaplazisë
B) hiperplazisë
C) anaplazisë
D) riprogramimit të shprehjes gjenike
E) alterime të metabolizmit glucidik të qelizës tumorale
PS)D

Pyetja 755 V)1

Simptoma dhe shenja pothuajse konstante gjatë rubeolës është:

A) kolla
B) shtim i vëllimit të nyjeve limfatike retronukale
C) trombocitozë
D) opistotonus
E) diarre me mukus dhe gjak
PS)B

Pyetja 756 V)1

Në çfarë moshe fillon të ecë vetë, pa ndihmë?

A) 7-8 muajsh
B) 9-10 muajsh
C) 11-15 muajsh
D) 16-19 muajsh
E) 20-22 muajsh
PS)C

Pyetja 757 V)2

Një defiçit vitamine K evidentohet nga një alterim i cilit prej ekzaminimeve të mëposhtëm?

A) numri i trombociteve
B) koha e protrombinës (PT)
C) koha e tromboplastinës së pjesshme (PTT)
D) koha e trombinës
E) koha e hemorragjisë
PS)B

Pyetja 758 V)3

Nga çfarë karakterizohet një delir i kthjellët?

A) ndërgjegjia e sëmundjes
B) aletrim i organeve ndjesore
C) gjendje onirike
D) gjendje ndërgjegjieje hipervigjilente
E) gjendje ndërgjegjieje e pandryshuar
PS)E

Pyetja 759 V)3

Krizat epileptike toniko-klonike të përseritura:

A) përbëjnë një emergjencë mjekësore dhe kërkojnë dhënien në kohë të ilaçeve antiepileptike dhe shpesh kërkojnë edhe ndërhyrjen e reanimatorit
B) nuk kërkojnë ndërhyrje farmakologjike por vetëm marrjen e masave të llojit jospecifik (psh të evitohet që pacientit ti shkaktohen dëmtime traumatike)
C) kërkojnë vetëm ndërhyrjen e reanimatorit (monitorim të funksioneve jetësore etj.) por nuk kanë nevojë për një trajtim urgjent me barna antiepileptike
D) përbëjnë një emergjencë neurokirurgjikale
E) janë shpesh të vetëlimituara dhe si të tilla nuk kërkojnë asnjë trajtim specifik
PS)A

Pyetja 760 V)2

Tek nefropatia e llojit familjar ose sindroma Alport shfaqja më e shpeshtë është:

A) hematuria
B) Hipokomplementemia
C) leukocituria
D) hiper reninemia
E) hipertensioni arterial
PS)A

Pyetja 761 V)1

Cili është "gold standart" për të bërë diagnozën e sëmundjes Hirschprung?

A) ph-metria
B) klizma opake
C) biopsia rektale
D) ekografia abdominale
E) manometria anorektale
PS)C

Pyetja 762 V)1

Cili është eventi që haset më shpesh në fillim të kuadrit klinik të stenozës mitrale?

A) prekordialgjia
B) hemoftizia
C) dispnea
D) iktus
E) raucedina
PS)C

Pyetja 763 V)2

Shkallëzimi neoplastik sipas Gleasonit bën të mundur një vlerësim të shkallës së karcinomave të shfaqura në:

A) veshkë
B) mushkëri
C) fshikëzën e urinës
D) prostatë
E) zorrë e trashë
PS)D

Pyetja 764 V)2

Cili shtë organi i origjinës së tumoreve që japin më shpesh metastaza tek nyjet limfatike aksilare?

A) tiroidja
B) parotida
C) mushkëria
D) mamela
E) ezafagu
PS)D

Pyetja 765 V)3

Tek favizmi haset një deficit:

A) faktori VIII
B) glukoz - 6 - fosfato - dehidrogjenazë
C) piruvato kinazë
D) Gliceraldeid - 3 -fosfat - dehidrogjenazë
E) faktor i brendshëm
PS)B

Pyetja 766 V)1

Lumboischalgjia mund të jetë simptomë nga:

A) intoksikim alimentar
B) polineurit toksik
C) infeksione të fshikëzës së urinës
D) thyerje të meniskut
E) hernie e diskut
PS)E

Pyetja 767 V)2

Një prej medikamenteve të mëposhtëm alkilantë paraqet një efekt disnivelues relativisht selektiv mbi indin myeloid. Cili prej tyre?

A) busulfani
B) melfalani
C) ciklofosfamidi
D) klormetina
E) klorambucili
PS)A

Pyetja 768 V)1

Shtimi i trashësisë së membranës bazë të glomerulit renal çon në:

A) hipertension arterial
B) anemi
C) proteinuri
D) hematuri
E) kolikë renale
PS)C

Pyetja 769 V)2

Cili nga pohimet nuk është i vërtetë në lidhje me një pacient me anemi pernicioze (AP) ?

A) Rreth 75% e pacientëve paraqesin antikorpe kundër faktorit të brendshëm
B) AP-ja mund të shoqërohet me tiroiditin e Hashimotos
C) Vegjetarianët prej një kohe të gjatë shfaqin AP-në pasi përdorin pak faktorin e brendshëm
D) Rreth 90% e pacientëve shfaq antikorpe kundër qelizave parietale gastrike
E) AP-ja mund të jetë pasoja e një gastriti kronik që zgjat që prej shumë vjetësh me pasojë atrofi të qelizave sekretuese të stomakut
PS)C

Pyetja 770 V)1

Tek hiperaldosteronizmi primar vërehen:

A) hipotension arterial
B) ulje të sekretimit të brendshëm të insulinës
C) hiperrefleksi
D) hipobiokarbonatemi
E) hipopotasemi
PS)E

Pyetja 771 V)2

Tek sindroma obstruktive pulmonare, dispnea shkaktohet nga:

A) shtim i punës muskulare për të mposhtur rezistencat elastike të mushkërisë
B) shtim i kthimit venoz në zemër përcaktuar nga disniveli i lartë intrapleurik me pasojë insufiçencë kardiake kongjestive
C) shtim i punës muskulare për të mposhtur ngurtshmërinë e kafazit të kraharorit gjatë inspirimit
D) shtim i punës muskulare për të mposhtur rezistencat e rrugëve të vogla ajrore gjatë frymëmarrjes dhe frymënxjerrjes që nga pasive bëhet aktive
E) mosfunksionim i diafragmës
PS)D

Pyetja 772 V)3

Një specialist i mirëmbajtjes së kanalizimeve të ujërave të zeza shfaq ethe (38-40°), të dridhura, dhimbje koke të fortë, infeksion konjuktival pa eksudat purulent, dhimbje barku dhe diarre. Ju dyshoni për:

A) infeksion toksik nga stafilokoku
B) hepatit viral A
C) leptospirozë
D) ethe tifoide
E) grip
PS)C

Pyetja 773 V)1

Ushtrimi fizik i zgjatur dhe i përsëritur:

A) rrit kolesteroleminë HDL
B) ul kolesteroleminë totale
C) përmirëson tolerancën glucidike
D) ka të gjitha efektet e mësipërm A,B,C
E) shkakton aritmi tek gjithë praktikuesit
PS)D

Pyetja 774 V)1

Aftësia e një mikroorganizmi patogjen për të kaluar nga një subjekt pritës tek një tjetër quhet:

A) vitalitet
B) virulencë
C) ngarkesë infektuese
D) infektivitet
E) ngjitshmëri
PS)E

Pyetja 775 V)1

Ku ndodh sinteza e albuminës?

A) tek rruaza e kuqe
B) tek palca kurrizore
C) tek mëlçia
D) tek pankreasi endokrin
E) tek veshka
PS)C

Pyetja 776 V)2

Një shenjë e vlershme për të diferencuar bllokimin mekanik të zorrës së hollë nga peritoniti është:

A) dhembja
B) timpanizmi abdominal
C) hiperperistaltika
D) shtrirja abdominale
E) masa abdominale e prekshme në pjesën e poshtëm majtas
PS)C

Pyetja 777 V)1

Izoenzimat janë:

A) forma molekulare të ndryshme të së njëjtës enzimë
B) nën-njësitë e ndryshme që marrin pjesë në formimin e një enzime
C) enzima që njohin dy format izomerike të së njëjtës nënshtresë
D) enzima identike nga pikëpamja strukturale dhe me të njëjtin specificitet nënshtrese
E) enzima identike nga pikëpamja strukturale dhe me të njëjtin specificitet reagimi
PS)A

Pyetja 778 V)1

Cila prej këtyre gjendjeve nuk përbën faktor risku për embolinë pulmonare?

A) trauma/fraktura
B) mosha e madhe
C) insuficienca venoze kronike
D) hipotiroidizimi
E) obeziteti
PS)D

Pyetja 779 V)1

Cila është etiopatogjeneza e hernies inguinale tek fëmija?

A) dobësia e paretit abdominal
B) moszbritja e testikulit
C) persistenca e duktusit peritoneo-vaginal
D) trauma nga lindja
E) flogozë e kanalit inguinal
PS)C

Pyetja 780 V)1

RM-ja (Rezonanca Magnetike):

A) është metoda e parë që jep një vision të drejtpërdrejtë të palcës së kockave
B) nuk jep një pamje të qartë të likuidit cefalorakidian
C) nuk lejon studimin e rrënjëve të nervave spinalë
D) nuk është ekzaminimi i parë në studimin e patologjisë palcore
E) kërkon përdorimin e valëve ultrazanore
PS)A

Pyetja 781 V)1

Feokromocitoma është një neoplazi e llojit:

A) beninje në 30% të rasteve
B) beninje në 90% të rasteve
C) beninje në 50% të rasteve
D) gjithmonë malinje
E) malinje në 80% të rasteve
PS)B

Pyetja 782 V)1

Filtrimi glomerular tek një subjekt adult normal ndodh:

A) me 150 ml/minutë
B) me 200 ml/minutë
C) me 75 ml/minutë
D) me 600 ml/minutë
E) me 120 ml/minutë
PS)E

Pyetja 783 V)2

Cili është aspekti klinik i epidermomikozës?

A) njolla eritemato-deskuamative me kufij të ndarë me rezolucion qendror
B) pllaka eritemato-luspore
C) nyje me evolucion ulçerativ
D) flluska hematike
E) flluska me përmbajtje të lëngshme purulente
PS)A

Pyetja 784 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm mbi astmën bronkiale është i gabuar?

A) Tek ekzaminimi spirometrik vërehet një shtim i FEVI >15%
B) Salbutamoli është një medikament i zgjedhur në terapi
C) Tek spirometria vërehet një rritje e VR-së

D) Tek spirometria vërehet një ulje e FEVI-t
E) Klinikisht është karakteristike prania e fishkëllimave respiratore
PS)A

Pyetja 785 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm mbi kortizolin është i gabuar?

A) Stimulon katabolizmin proteik të muskulit
B) Aktivizon glukoneogjenezën
C) Ul përmbajtjen hepatike të glikogjenit
D) Stimulon lëshimin e glicerolit dhe acideve yndyrore të indit adipoz
E) Ushtron një efekt antiflamator
PS)C

Pyetja 786 V)1

Me mbetje fikse (solide) të ujit kuptohet:

A) përmbajtja e kripërave alkalinë tokësorë në 750 ml ujë
B) përmbajtja totale e kripërave për litër uji
C) përmbajtja e bikarbonateve për litër uji
D) përmbajtja e kripërave më përjashtim të atyre alkalino tokësore për litër uji
E) përmbajtja e lëndëve organike për litër uji
PS)B

Pyetja 787 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm mbi limfocitet T është i gabuar?

A) Mund të kenë funksion helper ose supresor ose citotoksik
B) Rrjedhin nga një qelize staminale që ndodhet në palcën e kurrizit
C) Janë më shumicë tek shpretka dhe timusi
D) Maturimi i tyre funksional ndodh tek shpretka
E) Në qarkullim janë më të shumta në numër se limfocitet B
PS)D

Pyetja 788 V)2

Indi më pak i zakonshëm për vendosjen e metastazave është/janë:

A) nyjet limfatike
B) truri
C) zemra
D) mushkëritë
E) mëlçia
PS)C

Pyetja 789 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtëm në lidhje me fazën III të eksperimentimit klinik të medikamenteve është i saktë?

A) Kryhet në persona vullnetarë të shëndetshëm
B) Kryhet në një numër të vogël pacientësh (50-60)
C) Parashikon një grup kontrolli
D) Shërben për të përcaktuar dozën minimale të toleruar
E) Shërben për të përcaktuar dozën minimale toksike
PS)C

Pyetja 790 V)2

Një pneumotoraks (PNX) mund të shfaqet pas një:

A) plage me prerje penetruese në nivel të toraksit
B) bllokim të papritur të një bronkeje nga ana e një mase neoplastike
C) aspirim të një trupi të huaj
D) carjes së një flluske enfizematoze të skajshme
E) A+D
PS)E

Pyetja 791 V)1

Cili prej këtyre faktorëve nuk favorizon formimin e një edeme?

A) hipoxia
B) rritja e tensionit arterial
C) rritja e tensionit venoz
D) çlirim lokal kinine
E) staza limfatike
PS)B

Pyetja 792 V)2

Papaverus somniferum album është baza për të nxjerrë:

A) atropinën
B) morfinën
C) cannabis
D) opiumin
E) LSD-në
PS)D

Pyetja 793 V)3

Qelizat oksifile të paratiroideve paraqesin:

A) një aparat Golxhi të zhvilluar mirë
B) paraqesin një aparat Golxhi të pa zhvilluar mirë
C) nuk paraqesin aparatin e Golxhit
D) paraqesin aparatin e Golxhit me tre dhoma
E) paraqesin aparatin e Golxhit pa anë të pamaturuara
PS)C

Pyetja 794 V)2

Cila është terapia e zgjedhur për një neoplazi vezikale infiltrative?

A) rezeksion endoskopik
B) rezeksion i pjesshëm i fshikëzës
C) limfoadenoktomi pelvike + cistoprostatektomi radikale
D) radioterapi pelvike
E) kemioterapi sistemike
PS)C

Pyetja 795 V)2

Sëmundja Cushing karakterizohet nga:

A) hipertrofia e gjymtyrëve të poshtme
B) hipotrofia e gjymtyrëve të poshtme
C) dobësimi
D) fytyrë pa mimikë
E) zë dytonësh
PS)B

Pyetja 796 V)3

Trajtimi i zgjedhjes së një neoplazie hepatike kufizuar në një prej dy lobeve kryesore eshtë:

A) radioterapia dhe kemioterapia
B) vetëm kemioterapia
C) vetëm radioterapia
D) kemioterapia endoarteriale hepatike
E) hepatektomia (e djathtë ose e majtë) e ndjekur mundësisht nga kemioterapia
PS)E

Pyetja 797 V)2

Pruriti nokturn është tipik i cilës sëmundje të lëkurës?

A) dermatit kontakti
B) dermatit atopik
C) mukozë kërpudhore
D) scabies
E) lichen planus
PS)D

Pyetja 798 V)2

Kuota ditore e rekomanduar për proteinat është:

A) 40-50% e energjisë.
B) 30-40% e energjisë.
C) 0.8 gr/kg peshë.
D) 1.5 gr/kg peshë.
E) 2 gr/kg peshë.
PS)C

Pyetja 799 V)1

Me mani kuptohet:

A) një rënie e tonit të humorit
B) një ide fikse që nuk do të largohet
C) një ide fikse që nuk arrijmë dot ta largojmë
D) bindja deliruese se jemi të ndjekur
E) një ekzaltim i tonit të humorit
PS)E

Pyetja 800 V)2

Hipotalamusi ndodhet mes:

A) ventrikulit të tretë dhe poshte talamusit
B) mes nukleusit kaudat dhe nukleusit lentikular
C) trurit të vogël dhe urës
D) urës dhe pedunkujve cerebralë
E) pons dhe cerebellum
PS)A

Pyetja 801 V)1

Kur shihet një i sëmurë me ethe për herë të parë gjykimi për të bazohet tek:

A) përshtypja-intuita
B) matja e temperaturës
C) anamnezë dhe ekzaminim objektiv

D) përvoja të mëparshme
E) studime të bëra më parë
PS)C

Pyetja 802 V)2

Cili prej medikamenteve të mëposhtme ka rezultuar më i nevojshëm në parandalimin e hemorragjisë digjestive nga çarja e variçeve të ezofagut?

A) Omeprazole
B) propanolol
C) nitroderivatë
D) anti-H2
E) ACE-frenues
PS)B

Pyetja 803 V)1

Cili prej këtyre medikamenteve rekomandohet për terapinë e artritit gotik?

A) penicilina
B) klofibrati
C) kolestiramina
D) kortizoni
E) alopurinoli
PS)E

Pyetja 804 V)2

Në lidhje me izoproterenolin cili prej indikacioneve të mëposhtëm është më pak i justifikuar në përdorimin e tij?

A) bradikardia me hipotension rezistente ndaj atropinës
B) mbidozë e betabllokuesve
C) bllokim AV në pritje të pacing
D) hipertension pulmonar
E) kapacitet i ulët me takikardi
PS)E

Pyetja 805 V)2

Në iskeminë cerebrale të kompartimentit të vaskularizuar nga karotidja e djathtë, rekomandohet terapia kirurgjikale (tromboendoarterektomia):

A) në mungesë të pllakave karotide
B) në prani të pllakave karotide të majta pavarësisht nga shkalla e stenozës
C) në prani të pllakave karotide të djathta pavarësisht nga shkalla e stenozës

D) në prani të pllakave karotide të djathta me stenozë <30%
E) në prani të pllakave karotide të djathta me stenozë >70%
PS)E

Pyetja 806 V)1

Refleksi i terheqjes vjen nga:

A) organet muskulore - tendina të Golxhit
B) tufat neuromuskolare
C) receptorë lëkurorë
D) receptorë artikularë
E) receptorë të Ruffinit
PS)B

Pyetja 807 V)2

Cila lloj e vjelle karakterizon stenozën hipertrofike të pilorit?

A) e vjellë biliare
B) e vjellë gastrike
C) e vjellë me presion biliare
D) e vjellë rastësore
E) e vjellë me presion jo biliare
PS)E

Pyetja 808 V)3

Epikondiliti :

A) është një tendinopati insertionale e muskujve fleksorë të parakrahut
B) është një komplikacion i frakturave të bërrylit
C) prek më shpesh femrat
D) rrallë shoqërohet me tendinopati polidistrektual.
E) është tendinopatia më e shpeshtë e bërrylit
PS)E

Pyetja 809 V)3

Goditja nga nxehtësia përcaktohet nga:

A) prania e erës
B) lagështira më e madhe se 60%
C) përdorimi i kafeinës
D) përdorimi i analeptikës
E) lagështira më e madhe se 30%
PS)B

Pyetja 810 V)2

Vazhdimi i një hemorragjie okulte kuptohet më shumë nga cili prej elementëve të mëposhtëm?

A) reduktimi progresiv i hematokritit
B) reduktimi progresiv i tensionit të gjakut
C) reduktimi i rruazave të kuqe
D) reduktimi i rruazave të bardha
E) reduktimi i hematokritit dhe i vlerave në përqinje të hemoglobinës
PS)E

Pyetja 811 V)1

Hapësira vizive (ose optike) ndodhet në lobin:

A) parietal
B) frontal
C) oksipital
D) temporal
E) limbik
PS)C

Pyetja 812 V)1

Parazitozat shkaktojnë:

A) një deficit të IgM-së
B) një deficit të IgG-së
C) një rritje të IgE-ve
D) një rritje të IgA-ve
E) një deficit të IgA-së
PS)C

Pyetja 813 V)2

Me spondilolistezë kuptojmë:

A) një ndërprerje të apofizës spinoze
B) një rrëshqitje anteriorisht të vertebrës
C) një ndërprerje të istmusit vertebral
D) një ndërprerje të trupit vertebral
E) një artrozë vertebrale
PS)B

Pyetja 814 V)2

Cili prej grupeve të mëposhtme të markuesve është tipik në periudhën e fillimit të një hepatiti B?

A) HBsAg; HBeAg; anti HBc-IgM
B) HBsAg; anti HBc-IgG
C) HBsAg; HBcAg; anti HBe
D) HBsAg; anti Hbe
E) anti HBs, anti HBc
PS)A

Pyetja 815 V)3

Karcinoma papilare e tiroidës nis shpesh me metastaza:

A) kockore
B) cerebrale
C) polmonare
D) limfonoidale
E) hepatike
PS)D

Pyetja 816 V)2

Një prej funksioneve kryesore të insulinës nga pikëpamja e metabolizmit energjitik konsiston në:

A) stimulimin e glukoneogjenezës hepatike
B) pengimin e sintezës së triacilgliceroleve
C) stimulimin e prodhimit hepatik të trupave ketonikë
D) pengimin e sintezës së glikogjenit
E) stimulimin e sintezës së glikogjenit dhe proteinës së mëlçisë
PS)E

Pyetja 817 V)2

Suksinilkolina sintetizohet nga:

A) kolinesteraza të vërteta
B) hidrilizë alkaline
C) pseudokolinesteraza
D) M.A.O
E) katalaza
PS)C

Pyetja 818 V)2

Sigla APUD është një akronim që tregon qeliza:

A) të afta të inkorporojnë amina biogjene dhe t'i dekarbosilojë ato
B) në gjendje të inkorporojë dhe dekarbosilojë prekursorët e aminave biogjene
C) në gjendje të inkorporojë dhe depolimerizojë prekursorët e aminave biogjene
D) në gjendje të krijojë osteosarkoma
E) në gjendje të krijojë lipoma
PS)B

Pyetja 819 V)1

Ethja është një mekanizëm që:

A) rrit prodhimin e nxehtësisë
B) redukton prodhimin e nxehtësisë
C) rrit shpërndarjen e nxehtësisë
D) redukton shpërndarjen e nxehtësisë
E) nuk ka asnje efekt mbi shpërndarjen e nxehtësisë
PS)A

Pyetja 820 V)1

Ekzaminimi ekografik i mamelës duhet të bëhet preferencialisht me sonda ekografike:

A) sonda lineare prej 3.5 MHz
B) sonda lineare prej 5 MHz
C) sonda convex prej 3.5 MHz
D) sonda lineare prej 10 MHz
E) sonda convex prej 5 MHz
PS)D

Pyetja 821 V)2

Cila mënyrë dhënieje e gjurmuesit(kontrastit) përdoret më shumë në mjekësinë bërthamore?

A) endovenoze
B) endoarterioze
C) intradermike
D) orale
E) intrakavitare
PS)A

Pyetja 822 V)2

Në Europë tërbimi pyjor sillet nga:

A) qentë
B) macet
C) lakuriqët e natës
D) vampirët
E) dhelprat
PS)E

Pyetja 823 V)2

Insuficenca renale akute funksionale mund të shkaktohet nga:

A) kalkuloza e rrugëve urinare
B) bllokimi i rrugëve urinare
C) abuzimi me aminoglikoksidet
D) ezaurimi i vëllimit ekstraqelizor
E) nekroza kortikale bilaterale
PS)D

Pyetja 824 V)2

Cili prej këtyre medikamenteve përfaqëson qasjen terapeutike më efikase për të reduktuar vdekjet e papritura tek pacientët e prekur nga kardiopati koronare të qëndrueshme me defiçit të funksionit ventrikular?

A) amplodipina
B) betabllokuesit
C) nitratet
D) diuretikët
E) digoksina
PS)B

Pyetja 825 V)2

Triptanet janë medikamente të përdorura për trajtimin simptomatik të:

A) migrenës
B) cefalesë së llojit intensive
C) migrenës krinike paroksicistike
D) cefalesë trafiktive akute idiopatike
E) nevralgjisë të trigeminit
PS)A

Pyetja 826 V)1

PH i gjakut rritet në cilën prej gjendjeve të mëposhtme?

A) të vjella

B) eklampsi
C) acidozë diabetike
D) polmonit
E) uremi
PS)A

Pyetja 827 V)3

Sindroma hipokinetike është:

A) reduktimi i kapacitetit të lëvizjes së trupit ose gjymtyrëve
B) reduktim i vizusit dhe i aftësisë për të lëvizur gjymtyrët
C) reduktim i vaskularizimit të gjymtyrëve të poshtme
D) reduktim i hapësirës së lëvizjeve artikulare
E) ankilozë në të paktën dy prej artikulacioneve
PS)A

Pyetja 828 V)2

Cili prej këtyre viruseve është një virus RNA?

A) herpesvirus
B) adenovirus
C) paramixovirus
D) papovavirus
E) poxvirus
PS)C

Pyetja 829 V)1

Divertikuli Meckel shkakton më shpesh:

A) disfagi
B) kolika abdominale
C) hemorragji rektale massive
D) gromësira acide
E) hernie umbilikale
PS)C

Pyetja 830 V)2

Një humbje e shpejtë e forcës tek gjymtyrët e poshtme dhe mungesë refleksesh osteo tendinale dhe pa shenja piramidale ka si shkaqe të mundshme

A) dëmtimin demielinizues spinal
B) tumorin palcor
C) sindromën Guillain - Barrè

D) siringomelinë
E) araknoidin spinal
PS)C

Pyetja 831 V)2

Tek pacientët e prekur nga sindroma Zollinger Ellison, niveli serik i cilit prej hormoneve të mëposhtëm është rritur?

A) gastrina
B) pancreatozimina
C) eritopoietina
D) insulina
E) glukagoni
PS)A

Pyetja 832 V)3

Tek pacientët e prekur nga karcinoma e ovarit:

A) dozimi i CA -125-ës është një test screening
B) ekspozimi ndaj jodit është një faktor risku
C) ekscizioni i plotë kirugjikal primar përmirëson mbijetesën
D) të gjitha pacientet duhet t'i nënshtrohen rikontrollit kirurgjikal pas kemioterapisë
E) trajtimi me kemioterapi siguron një përqindje të lartë të largimit të sëmundjes
PS)C

Pyetja 833 V)1

Shfryrja e pafajshme (zhurma funksionale) është tipike:

A) protomesosistolike
B) e vazhdueshme
C) mezotelesistolike
D) diastolike në pozicion në shpinë
E) e pranishme vetëm pas një sforcimi fizik
PS)A

Pyetja 834 V)2

Murtaja bubonike transmetohet nga:

A) një këpushë
B) një plesht
C) një mushkonjë
D) një morr
E) një mizë

PS)B

Pyetja 835 V)2

Antikorpet anti-nukleo karakterizojnë

A) konjuktivitin
B) fibromialgjinë.
C) enteritin.
D) polimialgjinë reumatike.
E) artritin rheumatoid.
PS)A

Pyetja 836 V)3

Një punëtor tridhjetëvjeçar gëlltit pa dashje, direkt nga shishja ku ishte hedhur një pikë shkrirësi i papërcaktuar dhe pas rreth 15-20 minutash vjen tek ne. Cilën prej procedurave të mëposhtme e shihni si më të mundshme?

A) induktim të të vjellave
B) t'i jepet qumësht
C) lavazh gastrik me qumësht
D) lavazh gastrik dhe më pas karbon vegjetal
E) katarsis me kripëra
PS)D

Pyetja 837 V)2

Një deficit koagulativ i fituar haset tek

A) cirroza hepatike.
B) insuficienca respiratore.
C) sindroma Marfan.
D) kalkuloza e kolecistit.
E) ulcera peptike.
PS)A

Pyetja 838 V)3

Frymëmarrja Cheyne-Stoke është një frymëmarrje që karakterizohet nga

A) alternimi i apnesë dhe hiperpnesë.
B) shtim i vëllimit për minutë të frymëmarrjes.
C) ulje e frekuencës të frymëmarrjes.
D) shtim i frekuencës të frymëmarrjes.
E) frymënxjerrje e sforcuar me glotis të mbyllur.
PS)A

Pyetja 839 V)2

A ndryshojnë gjatë embolisë pulmonare shkëmbimet e gazeve?

A) Shpesh, por jo gjithmonë, me hipoksiemi dhe hipokapni.
B) Po, vendoset vetëm dhe gjithmonë hiperkapnia.
C) Jo, sepse është një patologji me një përbërës të vetëm pulmonar.
D) Po, vendoset vetëm dhe gjithmonë hipoksiemia.
E) Vetëm kur pacienti është obez.
PS)A

Pyetja 840 V)1

Tek policitemia e vërtetë shfaqen të gjitha sa më poshtë, me përjashtim të:

A) eritropoetinës së lartë.
B) rritjes së viskozitetit të gjakut.
C) episodeve me trombocitopeni dhe hemorragji.
D) rritjes së rasteve të ulçerës peptike.
E) pruritit.
PS)A

Pyetja 841 V)1

Anafilatoksinat janë:

A) imunoglobina të rendit IgG.
B) imunoglobina të rendit IgE.
C) fragmente C3b, C3bi dhe C3d të sistemit të komplementit.
D) fragmente C3a dhe C5a të sistemit të komplementit.
E) substanca të prodhuara duke filluar nga acidi arakidonik nëpërmjet veprimit të enzimës ciklo-oksigjenazë 1 (COX -1).
PS)D

Pyetja 842 V)1

Terapia me digitalikë ka:

A) efekt inotrop dhe kronotrop negativ.
B) efekt inotrop dhe kronotrop pozitiv.
C) efekt inotrop negativ dhe kronotrop pozitiv.
D) efekt inotrop pozitiv dhe kronotrop negativ.
E) veprim diuretik të rëndësishëm.
PS)D

Pyetja 843 V)2

Cili prej medikamenteve të mëposhtëm është ai që ka efektin më të shprehur bronkodilatator?

A) kortikosteroidët në rrugë inhalatore
B) kortikosteroidët në rrugë orale
C) beta 2 imituesit
D) antistaminikët
E) teofilina
PS)C

Pyetja 844 V)2

Prania e trupave Auer në citoplazmën e qelizave të papjekura të çon në diagnostikimin e:

A) leucemisë akute ose subakute.
B) sëmundjes Vaquez.
C) leucemisë mieloide kronike.
D) leucemisë limfonoide kronike.
E) limfomës Hodkin.
PS)A

Pyetja 845 V)2

Cili prej burimeve të mëposhtëm është burimi më i rëndësishëm për formimin e estrogjeneve tek femrat me sindromën e vezores policistike?

A) sekretim mbiveshkor
B) aromatizim ekstragjëndror i DEA sulfat
C) aromatizim ekstragjëndror i DEA
D) aromatizim ekstragjëndror i androstenedionit
E) aromatizim ekstragjëndror i testosteronit
PS)D

Pyetja 846 V)2

Shfaqja e encefalopatisë hepatike përshpejtohet nga

A) ulje e debitit kardiak.
B) enfizemë pulmonare.
C) retinopati diabetike.
D) cefale tensive.
E) hemorragji e aparatit tretës.
PS)E

Pyetja 847 V)2

Kalimi nga epiteli cilindrik ciliar i pemës bronkiale tek epiteli me luspa pas dëmtimit nga duhani është shembull i:

A) hiperplazisë.
B) metaplazisë.
C) hipertrofisë.
D) atrofisë.
E) nekrozës.
PS)B

Pyetja 848 V)1

Medikamentet beta bllokuese (beta 1 selektive) të përdorura në terapi mund të çojnë në:

A) efekt kronotrop dhe inotrop pozitiv me pasojë rritjen e tensionit të gjakut.
B) efekt kronotrop dhe inotrop negativ me pasojë uljen e tensionit të gjakut.
C) aktivizim i receptorëve beta të pranishëm tek muskulatura e lëmuar bronkiale dhe bronkodilatacion pasues.
D) reduktim të tensionit të gjakut për shkak të veprimit direkt mbi receptorët e sistemit nervor qëndror.
E) haluçinacione dhe delir në rast pezullimi të papritur të terapisë.
PS)B

Pyetja 849 V)2

Në cilën prej sëmundjeve të mëposhtme ekziston një defiçit i qartë i clirensit mukociliar?

A) TBC
B) sindroma Kartagener
C) Granulomatoza Wegener
D) Sindroma Goodpasture
E) Sarkoidoza
PS)B

Pyetja 850 V)2

Shkaku më i shpeshtë i ambiguitetit gjenital tek fëmijët është:

A) mosndarja kromozomike.
B) disgjenezia e gonadeve.
C) sindroma adrenogjenitale.
D) mozaicizmi.
E) feminizimi testikular.
PS)C

Pyetja 851 V)2

Në cilin stad të jetës një person i shëndetshëm paraqet përqëndrim të lartë të CEA-së?

A) adoleshencë
B) pubertet
C) jetë fetale
D) mosha e tretë
E) fëmijëria
PS)C

Pyetja 852 V)1

Një nodul tiroidien shintigrafikisht i nxehtë mund të përkojë me:

A) strumë.
B) adenomën Plummer.
C) karcinomën e padiferencuar.
D) karcinomën oksifile.
E) adenomën embrionale.
PS)B

Pyetja 853 V)2

Indikacioni kryesor për ndërhyrje kirurgjikale në mitrën e dyfishtë është:

A) aborti i zakonshëm.
B) dizmenorea.
C) menometrorragjia.
D) dispareunia.
E) lindja e parakohshme .
PS)A

Pyetja 854 V)2

Cili prej trajtimeve të mëposhtëm ka rezultuar në gjendje të rrisë mbijetesën tek pacientët me BPCO?

A) bronkodilatatorë
B) oksigjen me afat të gjatë
C) antikolinergjik
D) ventilim mekanik
E) kortikosteroidë
PS)B

Pyetja 855 V)2

Cili prej pohimeve është i saktë? Sindroma Wolf - Parkinson - White (WPW) shkaktohet nga:

A) sklerozë koronare
B) receptivitet të shtuar të zemrës ndaj impulseve të vagusi
C) duhanpirje e tepruar
D) defekt në tejçimin mes atriumit dhe ventrikulit të djathtë
E) miokardit reumatizmal
PS)D

1.Fondi A
Pyetja 1 V)2

Një rast acidoze respiratore e dekompensuar paraqitet kur:

A) PaO2 është < 55 mmHg dhe pH është = 7.40
B) PaCO2 është = 45 mmHg dhe pH është = 7.40
C) PaCO2 është > 50 mmHg dhe pH është = 7.40
D) PaCO2 është > 50 mmHg dhe pH është = 7.25
E) PaO2 është < 55 mmHg dhe pH është = 7.55
PS)D

Pyetja 2 V)2

Një segment bronkopulmonar:

A) furnizohet në mënyrë të pavarur nga një segment bronkial dhe nga një degëzim terciar i arteries pulmonare.
B) është ndarja më e vogël e një lobi pulmonar.
C) është një segment piramidal prej parenkimës pulmonare me bazë në ileus dhe majë në sipërfaqen pleurike.
D) komunikon gjerësisht me parenkimën pulmonare aty pranë.
E) formohet nga një acinus pulmonar.
PS)A

Pyetja 3 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtëm nuk është i saktë?

A) Rruga e pentozo fosfateve është një proces mitokondrial.
B) Cikli i Krebsit ndodh tek matrica mitrokondriale.
C) Biosinteza "ex novo" e acideve yndydore është një proces citoplazmatik.
D) Formimi i trupave ketonikë ndodh në mitokondritë e mëlçisë.
E) Sinteza e kolesterolit ndodh në nivel citoplazmatik.
PS)A

Pyetja 4 V)1

Nuk i përket simptomatologjisë së glomerulonefritit akut të përhapur:

A) kolesterolemia e shtuar.
B) proteinuria e shtuar.
C) formimi i edemave.
D) hematuria.
E) kreatininemia e shtuar.
PS)A

Pyetja 5 V)2

Pjesa më e prekur nga metastazat e karcinomës bronkogjene është:

A) shpretka.
B) veshka.
C) fshikëza.
D) pankreasi.
E) indi kockor.
PS)E

Pyetja 6 V)1

Ekzaminimi më specifik në diagnozën e sëmundjes së Alzheimerit është:

A) CT-ja.
B) RM-ja.
C) angiografia cerebrale.
D) SPET.
E) ekografia.
PS)D

Pyetja 7 V)1

Ku nis vena azigos?

A) tek vena suklavia
B) tek duktus toracikus
C) tek vena kava e superior
D) tek sinusi venoz
E) tek venat bronkiale
PS)C

Pyetja 8 V)1

Drenazhi limfatik i kuadratit median të mamelës drenon:

A) kryesisht tek nyjet limfatike të dërrasës së kraharorit.
B) kryesisht tek nyjet limfatike aksilare.

C) kryesisht tek nyjet limfatike mbiklavikulare.
D) kryesisht tek nyjet limfatike çervikale të thella.
E) kryesisht tek nyjet limfatike preaortike.
PS)A

Pyetja 9 V)3

Trajtimi i zgjedhur për leuçeminë mieloide kronike të riakutizuar është:

A) radioterapia.
B) monokemioterapia.
C) polikemioterapia.
D) terapia me interferon.
E) trapianti i palcës kurrizore alogjenike.
PS)E

Pyetja 10 V)1

Cila prej vlerave të mëposhtme të kreatininemisë duhet konsideruar normale?

A) 0.1 mg/dl
B) 1 mg/dl
C) 1 mg/l
D) 2 mg/l
E) 3 mg/l
PS)B

Pyetja 11 V)1

Bakteret Gram-pozitive ndryshojnë nga bakteret Gram negative nga:

A) struktura e paretit qelizor.
B) organizimi nukleoid.
C) karakteristikat e membranës celulare.
D) prania e zgjatimeve.
E) prania e peptidoglikanit.
PS)A

Pyetja 12 V)2

Cili prej infeksioneve mund të jetë i pranishme si patologji e importuar?

A) leshmanioza viscerale
B) ethet e tifos
C) ethet botunoze
D) skistosomiaza
E) ethet Q

PS)D

Pyetja 13 V)1

Tek hiperlipidemitë brenda kujt limiti duhet mbajtur sigurimi i energjisë që çlirojnë gazet?

A) 20 %
B) < 0 = 25 %
C) < 0 = 30 %
D) 35 %
E) reduktimi maksimal i mundshëm
PS)C

Pyetja 14 V)2

Propiltiouracili:

A) pengon konnversionin periferik të T4 në T3.
B) stimulon formimin e hormonit tiroidien.
C) shkakton një reduktim të vëllimit të tiroides.
D) pengon transportin aktiv të jodit.
E) përcakton akumulimin e jodit tek tireoglobulina.
PS)A

Pyetja 15 V)2

Cili nga pohimet nuk lidhet me disa aspekte hematologjike gjatë shtatzënisë?

A) Përqindja e hemoglobinës ka tendencën që të ulet.
B) Masa hematike tenton të rritet.
C) Sedimenti tenton të ulet.
D) Përqëndrimi i faktorëve të ndtyshëm të koagulimit tenton të rritet.
E) Një përqindje leukocitesh prej 20x10^9/1 është relativisht normale pas lindjes.
PS)C

Pyetja 16 V)2

Funksioni i alteruar i muskujve papilarë shkakton :

A) stenozë mitrale.
B) insuficencë aortike.
C) stenozë subaortale.
D) insuficencë trikuspidale.
E) insuficencë mitrale.
PS)E

Pyetja 17 V)2

Kur flitet për Intususception kuptojmë:

A) një valvul gastrike.
B) një malrotacion të lindur.
C) invaginim intestinal.
D) një peritonit të tamponuar.
E) një pseudocist pankreatik.
PS)C

Pyetja 18 V)2

Diagnoza citologjike e kancerit të mushkërisë mund të përftohet me ekzaminimet e mëposhtme, përveç:

A) aspirim me age.
B) ekzaminimit të pështymës.
C) bronkografisë.
D) bronkoskopisë.
E) mediastinoskopisë.
PS)C

Pyetja 19 V)3

Çfarë është një trup psamomatoz?

A) një zonë e rrethuar nekroze
B) një sferë e vogël kalcike koncentrike
C) një vendosje lobulare folikulash
D) një vatër infiamatore granulomatoze
E) një kist
PS)B

Pyetja 20 V)2

Cfarë komplikacionesh mund të vijnë pas një frakture që të detyrojnë një pacient të qëndrojë pa lëvizur?

A) Nekrozë/ gangrene të këmbës
B) hematomë të pazgjidhshme të kofshës
C) koagulim ndervaskular të diseminuar
D) tromboemboli pulmonare
E) sarkomë të indeve të buta
PS)D

Pyetja 21 V)2

Dëmtimi histologjik karakteristik i glomerulonefritit progresiv i shpejtë është:

A) riprodhimi epitelial ekstrakapilar me formacione semilunare.
B) riprodhimi mezangial i përhapur.
C) prania e depozitimeve të dendura, tek ultrastruktura, në nivelin e membranës bazale glomerulare.
D) riprodhim mezangial i lidhur me depozitime subendoteliale.
E) sklerozë glomerulare fokale.
PS)A

Pyetja 22 V)2

Cila prej alternativave të mëposhtme është veçoria e shpërndarjes së tetraciklinave në organizëm?

A) Depozitohen në kocka dhe tek dhëmbët në rritje.
B) Përqëndrohen tek veshka dhe eliminohen kryesisht në rrugë urinare.
C) Penetrojnë lehtësisht tek indi nervor dhe tek likidet cerebrospinalë dhe sinovialë.
D) Shpërndahen në mënyrë uniforme në të gjithë lëngjet dhe indet.
E) Nuk kapërcejnë barrierën placentare
PS)A

Pyetja 23 V)1

Ruptura e legamentit të kryqëzuar anterior tek artikulacioni i gjurit diagnostikohet më lehtë nëpërmjet cilës prej teknikave të mëposhtme?

A) CT
B) radiograma direkte
C) ekotomografi
D) RM
E) fluoroskopi
PS)D

Pyetja 24 V)2

Cili prej patogjenëve të mëposhtëm është më shpesh përgjegjës për pielonefritin akut?

A) klebsiela
B) chlamydia
C) E. Coli
D) pseudomonas
E) candida
PS)C

Pyetja 25 V)1

Cili prej pohimeve në lidhje me sekretimin urinar të proteinave është i saktë?

A) është në proporcion me përqëndrimin e proteinave plazmatike
B) rritet pas stimulimit simpatik
C) rritet pas shtimit të tensionit të gjakut
D) rrjedh sidomos nga sekretimi tubular
E) rritet kur dëmtohet membrana bazë e kapilarëve glomerularë
PS)E

Pyetja 26 V)1

Pulmoniti "atipik" shkaktohet më shpesh nga:

A) baktere multi-rezistente.
B) patogjenë oportunistë tipikë të subjektit imunodepres.
C) Mycoplasma, Clamydia, Legionella.
D) E. Coli.
E) pseudomonas Aeruginosa.
PS)C

Pyetja 27 V)2

A mund të jenë shkak i abdomenit akut traumat abdominale ?

A) Po, gjithmonë.
B) Po, ndonjëherë.
C) Vetëm nëse lidhen me traumën kraniale.
D) Vetëm nëse lidhen me traumën e toraksit
E) Vetëm në prani të frakturave të gjymtyrëve të poshtme.
PS)B

Pyetja 28 V)1

Nga cili monomer formohet glikogjeni?

A) glukoza
B) fruktoza
C) glicina
D) galaktoza
E) adenina
PS)A

Pyetja 29 V)2

Lidhja trombozë arteriovenoze, trombocitopeni dhe pozitivitet i rremë për testet e sifilizit janë tregues të:

A) sindromës Churg - Strauss.
B) deficitit të faktorit VII.
C) sindromës nga antikorpe anti fosfolipide.
D) purpur trombotik trombocitopenik.
E) koagulimit intravaskular i përhapur
PS)C

Pyetja 30 V)2

Me ektropion kuptohet:

A) prania e një endometri në zonën ektopike
B) një dëmtim inflamator i cerviksit
C) një prolaps të mitrës
D) një shkatërrim të mukozës endoçervikale
E) një fistulë rekto-vaginale.
PS)D

Pyetja 31 V)1

Hapësira Douglas:

A) korrespondon me hapësirën rekto-uterine dhe përmban ansa ileale dhe jejunale.
B) korrespondon me hapësirën rekto-uterine dhe përmban ansa ileale.
C) korrespondon me hapësirën veziko-uterine dhe përmban ansa ileale.
D) arrihet në rrugë transvaginale nëpërmjet harkut anterior.
E) nuk arrihet në rrugë transvaginale.
PS)B

Pyetja 32 V)1

Kriza retikulocitare verifikohet në një

A) anemi hemolitike.
B) eritroleuçemi.
C) policitemi e vërtetë në trajtimin me hidrosiure.
D) trombozë intravaskulare e përhapur.
E) anemi pernicioze në trajtim me vitaminë B12.
PS)E

Pyetja 33 V)2

Tek pacientët astmatikë, medikamentet beta 2 antagonistë me kohëzgjatje të shkurtër veprimi që jepen në rrugë inalatore

A) nuk shfaqin efekte kardiake.
B) mund të rezultojnë bradikardi me stimulim vagal.

C) nuk kapërcejnë filtrin alveolar dhe si rrjedhim nuk japin efekte sistemike të rëndësishme.
D) mund të japin dridhje muskulare dhe mund të rezultojnë aritmogjenë në një përqindje që nuk mund të mos merret parasysh tek pacientët.
E) shfaqin toksicitet në nivel kardiak kur injektohen në rrugë endovenoze.
PS)D

Pyetja 34 V)1

Cili është shkaku më i shpeshtë i hipoparatiroidizimit?

A) karcinomë e paratiroideve
B) ablacion i paratiroideve gjatë një tiroidektomie
C) atrofi të paratiroideve nga invazion tumoral
D) atrofi primare e paratiroideve
E) inflamacion i organeve të qafës me përfshirje të paratiroideve
PS)B

Pyetja 35 V)1

Cili prej organeve të mëposhtëm preket më shpesh gjatë sarkoidozës?

A) zorra
B) stomaku
C) nyjet limfatike
D) sistemi nervor qëndror
E) palca e kurrizit
PS)C

Pyetja 36 V)2

Cila prej karakteristikave të mëposhtme objektive që rezultojnë gjatë eksplorimit digital të rektumit nuk është tipike e kancerit të prostatës?

A) humbja e simetrisë së gjendrës
B) ruajtje e sulkusit median interlobar
C) mosrrjedhshmëri e planeve të mësipërme
D) kufij dhe limite të papërcaktuara mirë
E) konsistencë e shtuar
PS)B

Pyetja 37 V)3

Një ulçerë e paretit të pasëm të bulbit duodenal mund të perforojë dhe të shkaktojë një hemorragji të rëndë të brendshme për shkak të erozionit të cilës enë gjaku?

A) arteries gastroepiploike të majtë

B) arteties lienale
C) arteries gastrike të majtë
D) arteries duodenale
E) arteries mezenterike superiore
PS)D

Pyetja 38 V)2

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme vërehen Feçet akolike?

A) stenozë inflamatore e sigmës
B) kolit ulçeroz
C) bllokim i rrugëve biliare
D) tifo abdominale
E) divertikulozë intestinale
PS)C

Pyetja 39 V)1

Cili mes ushqimeve është më i pasur në vitamina të grupit B?

A) djathi kaçkavall
B) oriz me gjalpë
C) lakra e kuqe
D) spageti me domate
E) birra
PS)E

Pyetja 40 V)3

Pacienti duhet të informohet për prognoza të rënda ose fatale:

A) në asnjë rast.
B) në çdo rast dhe plotësisht.
C) vetëm në prani të personave të tjerë.
D) gjithmonë me shkrim.
E) me kujdes, duke përdorur fjalë jo traumatizuese dhe pa përjashtuar elementët e shpresës.
PS)E

Pyetja 41 V)2

Edema në formë manteli dhe shtypja e venave të qafës janë shenja karakteristike të:

A) sindromës Claude-Bernard-Horner.
B) sindromës dispneike.
C) sindromës së venës cava superior.

D) sindromës nga sekretimi i papërshtatshëm i ADH-së.
E) fenomeni Raynaud.
PS)C

Pyetja 42 V)2

Cili prej faktorëve kontribuon më shumë në mekanizmin e stadit të tretë të dhimbjeve të lindjes?

A) nivelet e estrogjenit që bien me shpejtësi pas lindjes
B) heqja e vileve të ankorimit që shkaktohet nga kontraktimi i miometrit
C) kohëzgjatja e dy stadeve të parë të fazës së dhimbjeve
D) nivelet e prolaktinës që qarkullon të prodhuara nga placenta
E) rënia e PCO2 tek vena umbelikale
PS)B

Pyetja 43 V)2

Tek një simptomë restrictive:

A) kulmi i fluksit reduktohet dhe VR reduktohet.
B) kulmi i fluksit reduktohet dhe VR rritet.
C) kulmi i fluksit rritet dhe VR normalizohet.
D) zakonisht nuk ka alterime të kulmit të fluksit parametrik, e vetmja gjë që ndryshon është Vr-ja.
E) kulmi i fluksit dhe VR-ja rriten që të dyja.
PS)A

Pyetja 44 V)2

Ku veprojnë hormonet hipotalamike?

A) në hipotalamus
B) në adenohipofizë
C) në neurohipofizë
D) tek lënda e mesme
E) korteksi cerebral
PS)B

Pyetja 45 V)1

Përse dëmtimet e meniskut nuk riparohen në mënyrë spontane?

A) për shkak të pranisë së likuidit synovial
B) për shkak të mungesës së paqëndrueshmërisë
C) pasi menisku nuk është i vaskularizuar
D) për shkak të lëvizjes së vazhdueshme të gjurit

E) për shkak të lëvizjeve të meniskut
PS)C

Pyetja 46 V)2

Tek venat qëndrore trysnia normalisht është:

A) gjithmonë pozitive.
B) pozitive por mund të bëhet negative gjatë frymëmarrjes.
C) gjithmonë negative.
D) pozitive por mund të bëhet negative gjatë frymënxjerrjes.
E) gjithmonë nënatmosferike.
PS)B

Pyetja 47 V)1

Në cilin prej çifteve të mëposhtëm kromozomikë është i pranishëm kromozomi Philadelphia?

A) çifti 21
B) çifti 19
C) çifti 22
D) çifti 17
E) çifti 6
PS)C

Pyetja 48 V)1

Cili prej ekzaminimeve të mëposhtëm mund të përdoret për diagnozën e laboratorit të alfa-talasemisë?

A) dozimi i HbA
B) dozimi i HbA2
C) dozimi i hbH dhe Hb Bart
D) dozimi i HbF
E) dozimi i aktivitetit eritrocitar tek enzima piruvat kinazë
PS)C

Pyetja 49 V)2

Vendndodhja më e shpeshtë e divertikuleve intestinale është:

A) duodeni.
B) cekumi.
C) apendiksi cekal.
D) rektumi.
E) sigma.
PS)E

Pyetja 50 V)2

Të gjithë faktorët e mëposhtëm kontribuojnë në zhvillimin e një bronkiti kronik dhe të një emfizeme me përjashtim të:

A) tymit të cigares.
B) punës në një fabrikë pambuku.
C) infeksioneve kronike të apartit të frymëmarrjes.
D) mosfunksionimi i 1 alfa antitripsinës.
E) historiku i astmës në moshën infantile.
PS)E

Pyetja 51 V)2

Cili prej ekzaminimeve është më i vlefshëm për diagnozën e neoplazisë së bronkut kryesor të mushkërisë?

A) radiografia standarte e toraksit
B) shintigrafia pulmonare
C) stratigrafia
D) bronkoskopia
E) bronkografia
PS)D

Pyetja 52 V)3

Dismenorea primare konsiderohet se ka lindur nga kontraksionet e mitrës që shkaktojnë çlirimin e prostaglandinës nga endometri. Masat farmakologjike për të kontrolluar dhimbjen përfshijnë të gjitha medikamentet e mëposhtme, me përjashtim të:

A) ibuprofenit.
B) etil ekstradiol me noretridon.
C) bromokriptinës.
D) indometacinës.
E) acidit mefenamik.
PS)C

Pyetja 53 V)3

Të gjithë medikamentet e mëposhtëm lidhen me anomali fetale të lindura, me përjashtim të:

A) tetraciklinës.
B) talidomidit.
C) litiumit.
D) sulfonamidet.
E) kumarinës.

PS)D

Pyetja 54 V)1

Cili prej pohimeve në lidhje me kolesterolin nuk është i vërtetë?

A) Është nje prekursor i disa neurotransmetuesve.
B) Është një përbërës i membranës plazmatike.
C) Është një prekursor i hormoneve steroidalë.
D) Është një prekursor i vitaminës D.
E) Është një përbërës i lipoproteinave plazmatike.
PS)A

Pyetja 55 V)2

Pamundësia për të përthyer shputën e këmbës mund të shkaktohet nga dëmtim i:

A) nervit tibial.
B) nervit femoral.
C) nervit sakral.
D) nervit shiatik.
E) nervit okturator.
PS)A

Pyetja 56 V)3

Një sindromë e përbërë nga displazi kondilo-hipofizare, opacitet të kornesë, inteligjencë normale, hipoplazi të procesit odontoidal karakterizon cilën nga sëmundjet e mëposhtme?

A) sëmundjen Morquio
B) gargoilizmin
C) ostitin e Paget
D) osteopsatirozën e Lobstein
E) displazinë fibroze policistike Jaffe' - Lichtenstein
PS)A

Pyetja 57 V)2

Një infarkt miokardi paraqitet në shintigrafi miokardike me T1-201 si:

A) një zonë shumë përvetësuese.
B) një defekt i rekuperueshëm.
C) një defekt i parekuperueshëm.
D) një zonë normopërvetësuese, pasi T1-200 ka lidhje me iskeminë jo me nekrozën.
E) mungesë e vizualizimit të ventrikulit të majtë.
PS)C

Pyetja 58 V)2

Muskuli stapedius ndodhet:

A) në ndarjen e parë të ezofagut.
B) tel laringu.
C) tek rinofaringu.
D) tek veshi i brendshëm.
E) tek veshi i mesëm.
PS)E

Pyetja 59 V)1

Cili është bujtësi përfundimtar i Toxoplasma gondit?

A) dhelpra
B) njeriu
C) qeni
D) macja
E) delja
PS)D

Pyetja 60 V)3

Një vaskulit që ka prekur aortën dhe degëzimet kryesore aortike është më i shpeshtë tek femrat mes moshës 10 dhe 40 vjeç; paraqitet shpesh me simptoma sistemike si lodhje e shpejtë, ethe të lehta, rënie ponderale. Bëhet fjalë për:

A) arterit me qeliza gjigante.
B) sëmundjen Takayasu.
C) sëmundjen Kawasaki.
D) granulomatozën Wegener.
E) poliarteritin nodoz.
PS)B

Pyetja 61 V)1

Për të realizuar maturimin e mushkërisë në rast lindjeje të parakohshme përdoren:

A) kortizonikët.
B) antibiotikët.
C) surfaktant ekzogjen.
D) hormone tiroidiene.
E) Growth Factor
PS)A

Pyetja 62 V)2

Në mënyrë jokonvencionale janë quajtur kolagjenozë tipike në kuptimin e ngushtë të gjitha këto sëmundje me përjashtim të sëmundjes që quhet:

A) lupus eritematoz.
B) panarterit nodoz.
C) arterit tuberkular (Poncet).
D) dermatomiozit.
E) sklerodermi.
PS)C

Pyetja 63 V)2

Gjithë lidhjet e mëposhtme mes sëmundjeve dhe gold standart për diagnozën e tyre janë të sakta, me përjashtim të:

A) sifilizit primar: RPR ose VDRL.
B) infarktit akut të miokardit: izoenzima të kreatinës kinazë (CK - MB).
C) trombozës së venave të thella të këmbës: venografi.
D) kolelitiazës: ultratinguj.
E) embolisë pulmonare: angiografi pulmonare.
PS)A

Pyetja 64 V)2

Cili prej pohimeve është i saktë në malabsorbimin e gjeneralizuar?

A) Tek pankreatiti kronik, thithja difektoze e gjeneralizuar është një ngjarje i përcaktuar para kohe.
B) Zgavra e zorrës karakterizohet nga një vëllim i ulët fekal dhe një numër i lartë evakuimesh.
C) Steatorea është gjithmonë e pranishme.
D) Steatorea është gjithmonë elidhur me steatozën hepatike.
E) Feçet janë gjithmonë të ujshme.
PS)C

Pyetja 65 V)3

Me cilën prej neoplazive mund të lidhet acantosis nigricans si ngjarje paraneoplastike?

A) leuçemia akute mieloide
B) mastocitozë sistemike
C) neoplazi e aparatit gastroenterik
D) karcinomë e cerviksit të mitrës
E) sarkoma Ewing
PS)C

Pyetja 66 V)2

Faktori Hageman është:

A) faktori XII.
B) faktori X.
C) faktori i trombocitar III.
D) kalikrenia.
E) koofaktor ristocetinik.
PS)A

Pyetja 67 V)1

Sëmundja Dupuytren është:

A) një sëmundje muskulore e këmbës.
B) një sëmundje e tendinave të këmbës.
C) një sëmundje e lëkurës së dorës.
D) një sëmundje aponeurotike e dorës.
E) një sëmundje aponeurotike e këmbës.
PS)D

Pyetja 68 V)1

Kolestiramina ul kolesterolin plazmatik pasi:

A) redukton ripërthithjen e acideve biliare duke rritur kështu konvertimin e kolesterolit në acid biliar.
B) redukton një çlirim të acideve yndyrore nga indi adipoz.
C) shton kuotën e tiroxinës së lirë në plazëm.
D) redukton sintezën e kolesterolit në nivel hepatik.
E) stimulon transformimin e kolesterolit në karboidrate.
PS)A

Pyetja 69 V)2

Cili prej këtyre reaksioneve kompensuese ndodh gjatë kalimit nga klinostatizëm në aortostatizëm?

A) dilatacion venoz
B) reduktimi i frekuencës kardiake
C) aktivizimi i sistemit reninë- angiotensinë
D) reduktim i katekolaminës qarkulluese
E) reduktim i tensionit të gjakut
PS)C

Pyetja 70 V)2

Në rast alkaloze, veshka ndaj vlerave normale:

A) filtron një sasi më të madhe bikarbonati.
B) ripërthith një sasi më të vogël bikarbonati.
C) ripërthith një sasi më të madhe bikarbonati.
D) ripërthith të njëjtën sasi të bikarbonatit.
E) eliminon urinën alkaline.
PS)B

Pyetja 71 V)2

Stadi i hepatizimit të kuq në patologjinë pulmonare është tipik i:

A) pneumonise akut.
B) asbestozës.
C) karcinomës pulmonare.
D) bronkiolitit.
E) astmës bronkiale.
PS)A

Pyetja 72 V)2

Situata e ndryshueshme gjenetike luan një rol në zhvillimin e disa sëmundjeve kur:

A) sëmundja është shkaktuar nga një gen i vetëm i madh.
B) geni (et) luan (luajnë) një rol ende të panjohur në këto sëmundje.
C) një gen i madh dhe në radhë të dytë ambienti kanë një rol në zhvillimin e sëmundjes .
D) ambienti luan një rol dytësor në zhvillimin e këtyre sëmundjeve.
E) shumë gene dhe faktorë të shumtë ambientalë përcaktojnë shfaqjen e këtyre sëmundjeve.
PS)E

Pyetja 73 V)2

Shkaku më i shpeshtë i hemorragjisë digjestive të rëndë te një pacient me hipertension portal është:

A) gjakrrjedhja nga gastropatia hipertensive portale.
B) çarja e variçeve të ezofagut.
C) çarja e variçeve gastrike.
D) çarja e variçeve duodenale.
E) çarja e variçeve kronike.
PS)B

Pyetja 74 V)1

Ku vepron ACTH-ja?

A) tek qendra e gjendrës mbiveshkore
B) tek tiroidja
C) tek kortikalja e mbiveshkës
D) tek vezorja
E) tek hipofiza
PS)C

Pyetja 75 V)2

Cilat janë qelizat e implikuara kryesisht në patogjenezën e astmës bronkiale?

A) neutrofilet
B) limfocitet
C) eozinofilet
D) bazofilet
E) qelizat plazmatike
PS)C

Pyetja 76 V)1

Një Q-T e zgjatur shkakton:

A) aritmi kardiake.
B) flutter arterial.
C) bllokim AV të gradës së tretë.
D) gjysëmbllokim të majtë të përparmë.
E) bllokim të degëzimit të djathtë.
PS)A

Pyetja 77 V)1

Cila prej këtyre strukturave nuk ndodhet në mediastintin e pasëm?

A) azygos
B) trakea
C) ezofagu
D) duktusi i toraksit
E) aorta ashendente
PS)B

Pyetja 78 V)1

Metabolizmi i pasazhit të parë:

A) shton biodisponibilitetin e medikamentit.

B) ka një rëndësi të vogël metabolike.
C) rrit gjithmonë toksicitetin e medikamentit.
D) redukton biodisponibilitetin e medikamentit.
E) redukton gjithmonë toksicitetin e medikamentit.
PS)D

Pyetja 79 V)1

Një faktor risku për sindromën Down mund të jetë nga

A) mosha e madhe e nënës.
B) infeksione virale të tremujorit të parë të shtatëzanisë.
C) abuzim substancash.
D) rreziqe të parakohshme aborti.
E) papasterti e ambientin.
PS)A

Pyetja 80 V)1

Tek mbrojtja nga sëmundjet e transmetuara nga mushkonjat dhe mizat duhet që të:

A) të përdoren insekticide në shkallë të gjerë në ambientin e jashtëm.
B) të laget ambient.
C) të vendosen rrjeta kundër mushkonjave të lyera me piretoide.
D) të vaksinohet subjekti pritës për gjithë patogjenët.
E) të qëndrohet në ambiente të hapura.
PS)C

Pyetja 81 V)2

Cili prej radiacioneve të mëposhtme ka një efekt më të madh mutagjen?

A) UV -A
B) UV -b
C) grimcat alfa
D) rrezet gama
E) UV -C
PS)D

Pyetja 82 V)1

Gastriti kronik së bashku me infeksionin nga H.Pylori:

A) ka prirjen të prekë në fazën fillestare mukozën antrale.
B) karakterizohet nga një dëmtim i përhapur i mukozës në korpus - fundus me ndryshime të pakta qelizore .
C) ka prani mikroorganizmash sidomos në pjesën e zonave me metaplazi intestinale.

D) përcakton shfaqjen e polipeve gastrike.
E) është shkaku më i rëndësishëm i atrofisë së gjendrave gastrike.
PS)A

Pyetja 83 V)2

Tek subjektet me karcinomë medulare të tiroides vërehet:

A) aktivitet histaminik i reduktuar.
B) konstipacion i forte.
C) mungesë metastazash tek nyjet limfatike lokale.
D) kalcitoninë e lartë.
E) alterim i hormoneve qarkullues të tiroides .
PS)D

Pyetja 84 V)2

Toleranca e reduktuar ndaj glukozës tek sindroma insulino-rezistent përcaktohet kryesisht nga:

A) glikogjenezë e reduktuar dhe lipozë e reduktuar nga efekti i madh i hormoneve të kundërregullimit.
B) oksidim glucidik në nivel muskular i rritur.
C) rritje e përdorimit të trupave ketonikë dhe rritje e disponueshmërisë së acetil-CoA.
D) rritje e rezervave të substrateve neoglukogjenetikë.
E) ulje e sintezës së glikogjenit në nivel muskulo skelektrik, shtim i neoglukogjenezës hepatike dhe përdorim i reduktuar glucidik në nivel indi adipoz.
PS)E

Pyetja 85 V)1

Cili është shkaku më i shpeshtë i cor pulmonar akut?

A) pneumoni lobare
B) infarkt i paretit të pasëm të zemrës
C) bronkit astmatik
D) emboli pulmonare
E) hemorragji pulmonare
PS)D

Pyetja 86 V)2

Cila sëmundje nuk shoqëron steatorrenë ?

A) bllokim i duktusit të pankreasit
B) cirroza hepatike
C) pankreatiti kronik

D) fibroza pankreatike
E) bllokim neoplazik i papilës së Oddit
PS)B

Pyetja 87 V)2

Gjinekomastia e vërtetë shfaqet gjatë:

A) trizomisë 21.
B) sëmundjes Turner.
C) sindromës Klineferter.
D) sëmundjes Addison.
E) adenomës Plummer.
PS)C

Pyetja 88 V)1

Në çfarë rrethanash aktivizohen muskujt frymënxjerrës?

A) kur kanë nevojë për flukse frymënxjerrëse më të mëdha
B) kur kanë nevojë për flukse frymëthithëse më të mëdha
C) kur duhen ndihmuar muskujt frymënxjerrës gjatë frymëthithjes së radhës
D) për të pasur një vëllim të momentit sa më të lartë
E) për të pasur një kapacitet jetësor më të lartë
PS)A

Pyetja 89 V)1

Në cilat prej gjendjeve të mëposhtme rekomandohet dhënia kronike e jodit?

A) krizë tireotoksike
B) tiroiditi Hashimoto
C) sëmundja Graves
D) pregatitja e ekzaminimit shintigrafik të tiroides me jodin 131
E) strumë endemike
PS)E

Pyetja 90 V)3

Me cilin nga llojet e neoplazisë lidhen metastazat kockore osteodense?

A) zorrë e trashë - rectum
B) mielomë
C) fshikëz e urinës
D) mushkëri
E) prostatë
PS)E

Pyetja 91 V)2

Cili sistem apo strukturë preket nga SLA?

A) truri i vogël
B) palca kurrizore
C) motoneuroni inferior
D) motoneuroni I dhe II
E) sistem sensitiv
PS)D

Pyetja 92 V)1

Shumë patologji që shfaqen në moshë adulte si koronaropatitë dhe hipertensioni janë shumëfaktoriale. Kjo tregon që ato shkaktohen nga:

A) ndërveprimi mes faktorëve ambientalë dhe gjeneve të ndryshme.
B) ndërveprimi mes faktorëve ambientalë dhe një gjeni të vetëm.
C) faktorë të shumëfishtë ambientalë prenatalë.
D) faktorë të shumtë ambientalë pre dhe post-natalë.
E) mutacione të shumë geneve, pavarësisht nga ambienti.
PS)A

Pyetja 93 V)1

Një vështirësi për të lëvizur gjuhën të bën të mendosh për një shtypje të nervit:

A) aksesor.
B) facial.
C) hipoglos.
D) degëzimi i tretë i trigeminus.
E) vagus.
PS)C

Pyetja 94 V)2

Pacienti kandidat për një ndërhyrje kirurgjikale në rast se paraqet ethe paraoperatore duhet:

A) të shtyjë ndërhyrjen deri në zgjidhje të problemit.
B) të operohet me terapi antibiotike mbuluese.
C) të operohet duke përdorur medikamente antipiretikë.
D) të shtyhet ndërhyrja në rast se qëndrueshmëria e kuadrit klinik e lejon.
E) të operohet menjëherë pasi të ketë bërë analizat e kulturave.
PS)D

Pyetja 95 V)1

Infeksioni është:

A) kontakti i një bujtësi me një mikroorganizëm patogjen.
B) prodhimi i toksinave gjatë rritjes bakteriale.
C) përhapja e një agjenti patogjen në popullatë.
D) penetrimi dhe shumëfishimi i një mikroorganizmi tek një bujtës.
E) aftësia e një mikroorganizmi për të prodhuar një fakt patologjik.
PS)D

Pyetja 96 V)1

Antidoti që duhet dhënë në rast mbidoze te heparinës është:

A) vitaminë K.
B) sulfati i protaminës.
C) gjaku i freskët i plotë.
D) plazma.
E) kaliumi.
PS)B

Pyetja 97 V)2

Cila është metoda primare imazherike në studimin e qafës?

A) CT
B) RM
C) ekografia
D) angiografia
E) stratigrafia
PS)C

Pyetja 98 V)2

Në cilën gjendje nuk është i pranishëm hirsutismi?

A) hiperplazia mbiveshkore e lindur nga defiçit i 21 hidrolazës
B) sindroma Stein Leventhal
C) tumori i vezores androgjeno-sekretues
D) tumori mbiveshkor androgjeno-sekretues
E) sindroma Morris
PS)E

Pyetja 99 V)2

Frakturat e ekstremiteteve proksimale të femurit:

A) nuk kanë nevojë për terapi kirurgjike.
B) kanë të bëjnë sidomos me subjektet e moshuar.
C) shkaktohen më shpesh nga trauma të energjisë së lartë.
D) trajtohen me aparatura me allçi.
E) janë tipike të moshës së re.
PS)B

Pyetja 100 V)2

Në dyshimin e ndarjes intrakraniale të arteries vertebrale ekzaminimi diagnostik që bëhet si fillim është

A) ekokolor doppler i trungjeve supra aortikë.
B) ekokardio transezofageale.
C) punktsion lumbar.
D) angio RM intrakraniale.
E) RX kraniale.
PS)D

Pyetja 101 V)2

Papiloma ndërduktale paraqitet si:

A) lëkurë në formë lëkure portokalli.
B) gjakderdhje e kokës së gjoksit.
C) skuqje e lëkurës.
D) tërheqje e kokës së gjoksit .
E) stria lëkurore.
PS)B

Pyetja 102 V)3

Një i sapolindur që paraqet një të çarë akute shoqëruar nga irritim ekstrem, diarre dhe uri pa fund shpesh herë mund të na çojë drejt dyshimit klinik për:

A) një infeksion të sistemit nervor qëndror.
B) një infeksion të zorrës.
C) një infeksion të rrugëve urinare.
D) një sindromë neonatale nga heqja dorë nga droga prej nënës.
E) infeksion nga CMV.
PS)D

Pyetja 103 V)1

Tek epilepsitë e gjeneralizuara:

A) ka humbje të ndërgjegjies.

B) EEG-ja është e lateralizuar.
C) ndodhin kriza psikomotore.
D) etiopatogjeneza është gjithmonë dëmtuese.
E) etiopatogjeneza është gjithmonë idiopatike.
PS)A

Pyetja 104 V)1

Cilat janë shkaqet më të shpeshta të shfaqjes së epilepsisë tek të moshuarit?

A) traumat kraniale
B) encefalitet
C) problemet metabolike
D) tumoret cerebrale
E) sëmundjet cerebro-vaskulare
PS)E

Pyetja 105 V)2

Ndërveprimi mes antigjenit dhe IgE-së ndodh:

A) gjatë imunoreagimeve të llojit I.
B) gjatë imunoreagimeve të llojit II.
C) gjatë imunoreagimeve të llojit III.
D) gjatë imunoreagimeve të llojit IV.
E) gjatë imunoreagimeve të llojit V.
PS)A

Pyetja 106 V)2

Cili stacion limfonoidal përfshihet më shpesh tek limfoma Hodkin?

A) nyjet limfatike akselare
B) nyjet limfatike inguinale
C) nyjet limfatike laterocervikale
D) nyjet limfatike ileo-medistinike
E) nyjet limfatike lomboaortike
PS)C

Pyetja 107 V)1

Anemia megaloblastike varet nga:

A) mungesa e vitaminës B12 dhe acidit folik.
B) humbja e hekurit.
C) mungesë protoporfirinash eritrocitare.
D) mungesë vitamine C.

E) mungesë vitaminash PP.
PS)A

Pyetja 108 V)1

Testi Coombs për përcaktimin e antikorpeve anti - D kryhet:

A) tek rruazat e kuqe të nënës.
B) me serumin e gjakut të fetusit.
C) me serumin e gjakut të nënës.
D) me serumin e gjakut të të dyve.
E) tek rruazat e kuqe të fetusit.
PS)E

Pyetja 109 V)2

"Muaji i mjaltit" ose recesioni i simptomave të sëmundjes është tipik i:

A) diabetit të llojit 2.
B) insuficencës renale acute.
C) hipertiroidizmit.
D) diabetit të llojit 1.
E) leucemisë akute.
PS)D

Pyetja 110 V)1

Me termin Polakiuri kuptohet:

A) një numër i shtuar infeksionesh të rrugëve urinare.
B) një humbje e pavullnetshme e urinës.
C) një numër i shtuar i urinimeve gjatë ditës.
D) nevoja urgjentë për urinim.
E) leucemi akute .
PS)C

Pyetja 111 V)3

Cila nga komplikacionet e mëposhtme nuk mund të lidhet me një pancitopeni për dekompensim medular?

A) sepsis
B) gjendje e përgjithshme sëmundjeve
C) hemorragji të mishrave të dhëmbëve
D) trombozë
E) zbehje
PS)D

Pyetja 112 V)2

Cili është objektivi kryesor që duhet të ndjekë mjeku psikiater, për të pasur një marrëdhënie të mirë me pacientin me depresion?

A) të zgjidhë problemin që shkakton depresion
B) të fitojë besimin e tij
C) të nxisë personin që të kryejë aktivitetet normale të ditës
D) t'i japë psikomedikamente
E) të gjykoje rreth ambientit te pacientit me depresion
PS)B

Pyetja 113 V)1

Çfarë veçorish ka dhimbja nga neuralgjia e trigeminit?

A) rëndesë e vazhdueshme
B) pulsim i vazhdueshëm
C) pulsim në rritje
D) dhimbje akute paroksistike
E) rëndesë në rritje
PS)D

Pyetja 114 V)1

Cili nga pohimet në lidhje me endometrozën nuk është i vërtetë?

A) Transformimet malinje janë të rralla.
B) Diagnoza përcaktohet nëpërmjet historikut dhe ekzaminimit klinik.
C) Është më e shpeshtë në moshën pjellore sesa tek femrat në menopauze.
D) Femrat e prekura prej saj mund të paraqesin infertilitet.
E) Vendndodhja më e zakonshme është vezorja.
PS)B

Pyetja 115 V)2

Mes gjendjeve të mëposhtme që lidhen me hemorragjinë e traktit gastrointestinal të sipërm (afër Treitz) më i zakonshmi është :

A) ezofagiti.
B) ulçera peptike.
C) neoplazia.
D) çarja e enëve të ezofagut.
E) hemorragji pa një shkak të dukshëm.
PS)B

Pyetja 116 V)1

Humbja e vazhdimësisë indore në nivel kutan që nuk ka tendencë të shërohet quhet:

A) kore.
B) ulçer.
C) atrofi.
D) papulë.
E) likenizim.
PS)B

Pyetja 117 V)1

Artikulacionet ndahen në:

A) kondiloartroza dhe sutura.
B) qafë dhe diartrozë.
C) sinartrozë dhe diartrozë.
D) sinkondrozë dhe sinfiks.
E) artrodi dhe diartrozë.
PS)C

Pyetja 118 V)1

HDL-të, lipoproteina plazmatike me dendësi të lartë:

A) tranportojnë trigliceridet nga mëlçia tek indi adipoz.
B) transportojnë kolesterolin nga mëlçia tek indet periferike.
C) lidhen me enzimën LCAT që nxjerr kolesterolin.
D) dendësia e tyre e lartë shkaktohet nag numri i lartë i lipideve/proteinave.
E) në përqëndrime relativisht të larta janë tregues risku kardiovaskular.
PS)C

Pyetja 119 V)3

Terapia e tiroiditit subakut të De Quervain është me bazë :

A) antibiotikësh.
B) tiroksinë.
C) kortizonikësh.
D) antitiroidikësh.
E) sulfamidikësh
PS)C

Pyetja 120 V)2

Gjatë ekzaminimit objektiv të pikave limfonodale:

A) nyjet limfatike preken me palpacion me më shumë kujdes nëse mjeku ndodhet pas pacientit.
B) për të ekzaminuar sqetullën e majtë është më e saktë të përdoret dora e majtë.
C) është shumë e vështirë të përcaktohet nëse limfonodulat e vogla inguinale të prekshme janë patologjike.
D) edhe në prani të adenomegalisë konsistente nyjet limfatike paraaortike nuk mund të kuptohen me palpacion të abdomenit.
E) janë të vërteta pohimet e pikave A, C, D.
PS)E

Pyetja 121 V)1

Vitamina B12 përthithet:

A) në stomak.
B) në duoden.
C) në jejunum.
D) në ileum.
E) tek zorra e trashë .
PS)D

Pyetja 122 V)1

Hemoptizia është gjak që del nga:

A) dhëmbët.
B) goja.
C) bronket.
D) hunda.
E) faringu.
PS)C

Pyetja 123 V)2

Alterimet e sjelljes seksuale janë simptomë karakteristike e:

A) tumoreve infiltrues të trungut.
B) tumoreve temporalë.
C) dëmtimeve të hipotalamusit.
D) kisteve të ventrikulit III.
E) koresë degjenerative.
PS)C

Pyetja 124 V)1

Cili është muskuli me aktivitet frymëmarrës më i rëndësishëm?

A) muskujt interkostalë eksternë
B) diafragma
C) m.rektus i abdomenit
D) muskujt interkostalë internë
E) sternokleidomastoidi
PS)B

Pyetja 125 V)2

Cili është tumori më specifik për markerin në serumin e gjakut beta HCG?

A) tumori endodermal
B) tumori i gjendrës granuloze - tekë të vezores
C) cistoadenokarcinoma sieroze
D) tumori i qelizave Sertoli - Leydig
E) koriokarcinoma
PS)E

Pyetja 126 V)2

Sindroma Sheehan është një hipopituarizëm i shkaktuar nga:

A) procese infiltruese të zonës hipotalamo - hipofizare.
B) adenomë jo funksionale e hipofizës.
C) nekroza post-partum e hipofizës.
D) hipofizit limfocitik autoimun.
E) deficit i lindur i izoluar i gonadotropinës.
PS)C

Pyetja 127 V)3

Tek skizofrenia ekzaminimi EEG:

A) tregon një disritmi të lehtë me shkarkime të përkohshme.
B) tregon një disritmi frontale.
C) nuk tregon rezultate karakteristike.
D) tregon shpesh bashkime majë-valë pa një vendndodhje të saktë.
E) tregon një ngadalësim të përgjithshëm të gjurmës.
PS)C

Pyetja 128 V)1

Çfarë është artrodeza?

A) një ankilozë kirurgjikale
B) një frakturë e pakonsoliduar

C) një rezultat i një osteoartriti specifik
D) rezultati i një koksiti
E) rezultati i një perthes-i
PS)A

Pyetja 129 V)2

Vonesa në diagnostikim për tumoret e mushkërisë është më e madhe në rast:

A) lezionesh periferike.
B) lezionesh qëndrore.
C) të gjithë të mëparshmet.
D) asnjë prej të mëparshmeve.
E) lezionesh endobronkiale.
PS)A

Pyetja 130 V)1

Cila patologji është shkaku kryesor për insufiçencë renale kronike në vendet e industrializuara?

A) ndotja atmosferike
B) medikamentet
C) neoplazitë
D) diabeti mielit
E) kalkuloza
PS)D

Pyetja 131 V)1

Aneurizma cerebrale është:

A) tumor i zonës frontale.
B) dilatacion i një arterieje cerebrale.
C) malformim i sistemit ventricular.
D) grumbullim hematik intracerebral.
E) patologji e rrugëve optike.
PS)B

Pyetja 132 V)1

Cila prej këtyre enzimave është një indikator kolestaze?

A) aminotransferaza (AST dhe ALT)
B) fosfataza alkaline (ALP)
C) kreatin fosfokinaza (CPK)
D) glukozo 6 fosfat dehidrogjenaza (G6PD)

E) enolaza
PS)B

Pyetja 133 V)1
Karena ndodhet:
A) mes trakesë dhe bronkeve.
B) mes sinusit piriform dhe kordave zanore.
C) mes epiglotis dhe bazës së gjuhës.
D) mes ezofagut dhe faringut.
E) mes rinofaringut dhe orofaringut.
PS)A

Pyetja 134 V)1

Amilazemina rritet në një prej këtyre kushteve:

A) mononukleozë infektive.
B) divertikulozë të zorrës së trashë.
C) BPCO.
D) pankreatit.
E) infarkt miokardi.
PS)D

Pyetja 135 V)2

Cila është vendndodhja më e shpeshtë e tumoreve karcinoide?

A) mëlçia
B) kolecisti
C) rektumi
D) lëkura
E) zorra e hollë
PS)E

Pyetja 136 V)2

Tek një pacient me kolerë, terapia e parë mjekësore që duhet dhënë është:

A) antibiotikë në rrugë të përgjithshme.
B) dizinfektantë intestinalë.
C) kripëra purgante.
D) rehidratim të pacientit me solucione elektrolitike dhe ruajtja e hidratimit të tij.
E) edhe në mungesë të të vjellave të mbahet pacienti në mosngrënie absolute.
PS)D

Pyetja 137 V)1

Fenilketonuria është një sëmundje gjenetike shkaktuar nga defekte:

A) të katabolizmit të Triptofanit.
B) të katabolizmit të Alaninës.
C) të katabolizmit të Argininës.
D) të katabolizmit të Fenilalaninës.
E) të katabolizmit të Tirozinës.
PS)D

Pyetja 138 V)1

Vijat hemiklavikulare janë:

A) vija horizontale referimi.
B) vija kurrizore referimi.
C) vija e mesit ndaj vijave parasternale.
D) laterale në krahasim me vijat parasternale.
E) laterale në krahasim me vijat aksilare anteriore.
PS)D

Pyetja 139 V)2

Rënia në peshë, poliuria, polidipsia tek një fëmijë në moshë shkollore tregojnë zakonisht:

A) hipertiroidizëm.
B) diabet.
C) hiposurenalizëm.
D) tubulopati.
E) shqetësime të personalitetit.
PS)B

Pyetja 140 V)1

Sindroma Down shkaktohet nga:

A) trizomia e lirë e kromozomit 31.
B) trizomia nga zhvendoja e kromozomit 21.
C) gjendja e mozaicizmit 46/47, 21+.
D) defekt enzimatik.
E) prania e një kromozomi 21 mbinumër.
PS)E

Pyetja 141 V)1

Nga sa nën njësi formohen IgM-të?

A) 1

B) 3
C) 5
D) 7
E) 9
PS)C

Pyetja 142 V)2

Në rast pankreatiti kronik cila teknikë diagnostikimi me imazhe mund të dokumentojë më mirë se të tjerat kontekstin e saj?

A) Wirsungrafia retrograde
B) shintigrafia sekuenciale
C) TC me dhe pa kontrast
D) studimi radiografik direkt i abdomenit
E) angiografia selektive
PS)C

Pyetja 143 V)2

Cili prej pohimeve mbi barbiturikët është i saktë?

A) fenobarbitali ka veti analgjezike.
B) fenobarbitali nuk është klinikisht i vlefshëm në krizat e grand mal.
C) fenobarbitali çon në depresion respirator që fuqizohet nga etanoli.
D) tiopentali përdoret si antiepileptik.
E) fenobarbitali frenon sistemin mikrozomial hepatik.
PS)C

Pyetja 144 V)1

Cili prej parametrave nuk merret parasysh tek profili biofizik fetal?

A) lëvizjet respiratore fetale
B) vëllimi i lëngut amniotik
C) toni fetal
D) stress test
E) lëvizjet e fetusit
PS)D

Pyetja 145 V)3

Një djalë 15 vjeç paraqet tek skalpi i lëkurës një zonë rrumbullake pa flokë me lëkurë në pamje të parë normale. Cila është diagnoza më e mundshme?

A) tinea capitis mikrosporike
B) tinea capitis trikofitike

C) alopeci e kufizuar
D) lupus eritematos diskoid
E) lichen planus pilar
PS)C

Pyetja 146 V)1

Me cilin mekanizëm veprimi atropina prodhon takikardi?

A) duke bllokuar sistemin parasimpatik
B) duke stimuluar sistemin simpatik
C) duke stimuluar sistemin parasimpatik
D) duke bllokuar sistemin simpatik
E) me veprim të drejtpërdrejtë tek miokardi
PS)A

Pyetja 147 V)3

Një femër rreth të 50-ve me episode përsëritës të kolikave abdominale dhe ikter paraqet hiperbilirubinemi pothuajse totalisht e konjuguar. Për çfarë patologjie dyshoni?

A) cirrozë alkolike
B) sindroma Gilbert
C) sindroma Dubin - Jonson
D) hepatit viral
E) kalkulozë të koledokut
PS)E

Pyetja 148 V)2

Pneumotoraksi në formë valvule dallohet nga:

A) tingulli karakteristik .
B) rëndësia e veçantë klinike.
C) prania e enfizemës subkutane.
D) reduktimi i fremitus vocalis tachtilis.
E) prania e versamentit pleurik.
PS)B

Pyetja 149 V)2

Cila prej alternativave të mëposhtme nuk tregon një mekanizëm mbrojtjeje psikike?

A) projektimi
B) heqja
C) regresi
D) mohimi

E) konfabulimi
PS)E

Pyetja 150 V)2

Prania e hipoglicemisë tek një latant me katarakt dhe hepatomegali sugjeron cilën prej diagnozave të mëposhtme?

A) glikogjenozë të llojit I
B) galaktosemi
C) i sapolindur me nënë diabetike
D) sindroma Beckwith - Wiedemann
E) infeksion nga CMV
PS)B

Pyetja 151 V)3

Tek sindroma Reiter antigjeni që ka një vlerë diagnostikuese të konsiderueshme për përputhshmërinë mes indeve është:

A) HLA - DRW4.
B) HLA-B27.
C) HLA-BW6.
D) HLA-CW1.
E) HLA-DW1.
PS)B

Pyetja 152 V)1

Cila prej alternativave të mëposhtme nuk është simptomë me të cilën shfaqet stenoza e aortes?

A) palpitacion
B) dispne
C) anginë
D) sinkop
E) lipotimi
PS)A

Pyetja 153 V)1

Tek një pacient i dëmtuar me fraktura të brinjëve të majta dyshohet se mund të jetë dëmtuar edhe:

A) pankreasi.
B) shpretka.
C) mëlçia.

D) veshka.
E) fshikëza.
PS)B

Pyetja 154 V)2

Në rast kërkesash për shërbime që bien ndesh me ndërgjegjien e tij mjeku: (neni 19)

A) mund të refuzojë gjithsesi.
B) mund të refuzojë vetëm nëse pacienti i shoqëron këto kërkesa me një deklaratë me shkrim ku çliron mjekun nga çdo përgjegjësi.
C) mund te refuzojë vetëm nëse sjellja e tij nuk është shkak i një dëmtimi të rëndë dhe të menjëhershëm të personit të asistuar.
D) mund të refuzojë por duhet të informojë menjëherë Urdhrin e Mjekut.
E) mund të refuzojë por duhet të njoftojë menjëherë prokurorinë.
PS)C

Pyetja 155 V)1

Medikamentet nitroderivantë ulin punën e zemrës dhe si rrjedhim kërkesën për oksigjen nga ana e miokardit pasi:

A) reduktojnë frekuencën kardiake.
B) rrisin rezistencat vaskulare të shtratit koronar.
C) reduktojnë fluksin e gjakut tek organet periferike.
D) ulin kthimin e gjakut venoz në zemër.
E) reduktojnë forcën e kontraktimit të miokardit.
PS)D

Pyetja 156 V)1

Në cilin prej këtyre organeve ndodh shkatërrimi i pjesës më të madhe të trombociteve?

A) mëlçia
B) shpretka
C) palca kurrizore
D) nyjet limfatike
E) mushkëria
PS)B

Pyetja 157 V)2

Cila prej situatave të mëposhtme patologjike mund të shkaktojë dehidratim të pashoqëruar me humbje elektrolitesh?

A) diabeti insipid nefrogjen
B) hiperglicemia e rëndë me ketoacidozë

C) diarre e zgjatur
D) sepsis
E) ushqim me sondë nazogastrike për një pacient të moshuar me një formulë që përmban një tepri substancash të shkrira
PS)A

Pyetja 158 V)2

Cilët agjentë etiologjikë janë shpesh përgjegjës për infeksione të bronkitit kronik?

A) haemophylus influenzae
B) mycoplasma Pneumoniae
C) stafilococcus aureus
D) candida albicans
E) aspergillues fumigatus
PS)A

Pyetja 159 V)1

Në cilin infenksion bakterial nuk është e pranishme Leukopenia ?

A) tifo
B) paratifo
C) ethe rheumatizmale
D) malteze
E) tuberkulozë splenike
PS)C

Pyetja 160 V)2

Cila është piodermia më e shpeshtë në plazhe?

A) osteofolikuliti
B) sikoza
C) impetigo
D) puçrra
E) erizipela
PS)C

Pyetja 161 V)1

Cili formacion anatomik ndodhet në pjesen e majtë të zemrës, harku i II i majtë?

A) aorta
B) atriumi i majtë
C) arteria pulmonare
D) ventrikuli i majtë

E) atriumi i djathtë
PS)C

Pyetja 162 V)2

Cili prej trajtimeve të mëposhtëm duhet të përdoret si zgjedhje e parë në krizën e astmës tek fëmija?

A) B2- agonistë në rrugë orale
B) B2- agonistë në rrugë inhalatore shoqëruar edhe me teofilinë
C) B2- agonistë në rrugë inhalatore
D) antihistaminikë në rrugë orale
E) B2-agonistë në rrugë orale shoqëruar me disodium të kromoglikuar
PS)C

Pyetja 163 V)3

Në rastin e një të mituri, të paaftë për të vepruar, ose personi të cilit i është hequr e drejta për të vendosur, aprovimi për ndërhyrje diagnostikuese ose terapeutike(neni 13):

A) i kërkohet drejtorit sanitar.
B) shprehet nga përfaqësuesi ligjor.
C) duhet të propozohet nga kryetari i bashkisë së zonës së vendbanimit.
D) aprovimi jepet nga një komitet etik.
E) aprovimi është i vlershëm nëse është firmosur nga dy dëshmimtarë.
PS)B

Pyetja 164 V)1

Seroprofilaksia konsiston në dhënien e:

A) një vaksine që përmban virus të gjallë.
B) një vaksinë që përmban virus të dobesuar.
C) anatoksinë.
D) neutrofile që vijnë nga një pacient i shëruar.
E) serum gjaku hiperimun.
PS)E

Pyetja 165 V)1

Cili nga pohimet është i saktë?

A) Encefalopatia hepatike është një problem cerebral që sjell shtim të substancave neurofrenuese.
B) Aminoacidet aromatike janë: triptofani, fenilalanina, tirozina dhe metionina.
C) Alitoza aromatike e personit të prekur nga cirroza është dytësore pas hiperamoniemisë.
D) Merkaptanët rrjedhin nga metabolizmi intestinal i glutaminës.

E) Terapia diuretike përmirëson encefalopatinë hepatike.
PS)A

Pyetja 166 V)1

Në cilat prej këtyre kushteve SGOT është rritur në çdo rast?

A) pleurit esudativ
B) hemodializa të përsëritura
C) artrit gutik
D) infarkt miokardial akut
E) sindroma nefrotike
PS)D

Pyetja 167 V)1

Acidoza respiratore shkaktohet nga:

A) grumbullimi i acidit laktik.
B) hiperventilimi pulmonar.
C) hipoventilimi pulmonar.
D) sekretim i reduktuar acidesh.
E) sindroma Fanconi de Toni, Debre.
PS)C

Pyetja 168 V)2

Cila është terapia që zgjidhet e para tek një subjekt të prekur nga sëmundja e Parkinsonit 75 vjeç, dement me hipotension ortostatik?

A) selegilina
B) dopamino-agonistë
C) antikolinergjikë
D) levodopa + frenuesi i dopadekarbosilazës
E) amantadina
PS)D

Pyetja 169 V)2

Sindroma Zollinger-Ellison shkaktohet nga:

A) gastrinoma.
B) një karcinoid.
C) tumor i rektumit.
D) antikorpe anti mukozë gastrike.
E) antikorpe anti muskul i lëmuar i paretit gastric.
PS)A

Pyetja 170 V)1

Një tipar konsiderohet recesiv kur:

A) nuk shfaqet tek heterozigotët.
B) shfaqet tek heterozigotët.
C) shfaqet tek homozigotët dominantë.
D) kontrollohet nga një gjen i lokalizuar tek kromozomet seksuale.
E) kontrollohet nga një gjen i lokalizuar tek kromozomet autozomikë.
PS)A

Pyetja 171 V)2

Qelizat plazmatike:

A) janë të pranishme në gjak.
B) kanë një bërthamë të qartë, euromatike.
C) prodhojnë histamine.
D) rrjedhin nga megakariocitet.
E) sintetizojnë proteina.
PS)E

Pyetja 172 V)3

Një femër shtatzënë në javën e tridhjetë e gjashtë paraqet një gjakrrjedhje vaginale të pashoqëruar me simptoma të tjera. Cila nga procedurat e mëposhtme është më e rekomanduara?

A) kardiotokografia
B) ekografia
C) provokim i dhimbjeve të lindjes
D) amniorexi
E) kontroll vaginal
PS)B

Pyetja 173 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtëm në lidhje me krioglobulineminë është i saktë?

A) E dhëna klinike më e zakonshme është një rash vaskulitik.
B) Nëse krioglobulina përbëhet vetëm nga një gama-globulinë monoklonale në përgjithësi lidhet
me praniën e një neoplazie.
C) Kushti me të cilin lidhet më shumë është një infeksion nga virusi B i hepatitit.
D) Janë të sakta pohimet A dhe B
E) Janë të sakta pohimet A,B,C.

PS)D

Pyetja 174 V)2

Tek një pacient që ndodhet në koma dhe i shtrirë me kurriz bllokimi i rrugëve ajrore mund të korrigjohet me:

A) duke i flektuar kokën me 30 gradë.
B) duke i ngritur kokën 5 cm në krahasim me trupin.
C) duke i ngritur kokën 10 cm në krahasim me trupin.
D) duke e vendosur pacientin në pozicion ulur.
E) duke ekstenduar kokën ndaj qafës.
PS)E

Pyetja 175 V)3

Gazmendi, një ish kamionist 54 vjeç që tani është i papunë, pi shumë, shfaq një dhimbje të fortë të shpeshtë në pjesën epigastrike, që shpërndahet në formë rripi, sidomos pas vakteve, që i është shfaqur që prej disa muajsh dhe me tendencë përkeqësimi. Ga
A) steatohepatit alkolik.
B) pankreatit kronik.
C) sindroma e zorrës së trashë të irrituar.
D) ketoacidozë diabetike.
E) sëmundje e refluksit gastroezofageal.
PS)B

Pyetja 176 V)1

Spektri i qelizave shtazore që pësojnë modifikime nga një virus përcaktohet kryesisht nga:

A) ngjarje rastësore.
B) prania e receptorëve për atë virus në sipërfaqen qelizore.
C) enzima që përmbahen brenda qelizës bujtëse.
D) struktura e pjesëzës virale.
E) lloji i acidit nukleik viral.
PS)B

Pyetja 177 V)1

Mes përbërësve të mëposhtëm plazmatikë cili ka përmbajtjen më të madhe të kolesterolit?

A) kilomikronët
B) HDL
C) VLDL
D) LDL
E) albuminë
PS)D

Pyetja 178 V)1

Medikamentet më të përdorura në trajtimin parandalues të migrenës i përkasin kategorisë së:

A) kalcium anatagonistë dhe beta bllokues.
B) simpatikomimetikë dhe antistaminikë.
C) frenues selektivë te re-uptake të serotoninës (SSRI).
D) frenues të monoaminoksidazës (MAO).
E) dopaminë-agonistët.
PS)A

Pyetja 179 V)1

Meningeomat janë:

A) tumore të meningeve.
B) tumore të qelizave gliale.
C) degjenerim i meningeve.
D) inflamacion i meningeve.
E) grumbullim i gjakut tek hapësira meningeale.
PS)A

Pyetja 180 V)1

Me "makrohematuri" kuptohet:

A) prania e urinës që përmban gjak të dukshëm me sy të lire.
B) prania në urinë e qelizave të gjakut me përmasa më të mëdha se norma.
C) prania e sasive të mëdha të urinës hematike.
D) prania e të paktën 3 g/l e qelizave hematike në urine.
E) prania e urinës shumë të përqëndruar.
PS)A

Pyetja 181 V)1

Acidi acetilsalicilik dallohet nga anti inflamatorët e tjerë jo steroidë pasi:

A) është më pak ulcerogjen.
B) frenon cikloksigjenazën në mënyrë të pakthyeshme.
C) për aftësinë për të parandaluar kancerin e zorrës së trashë.
D) për të penguar në mënyrë selektive ciklooksigjenazën-2.
E) për të frenuar disa lipooksigjenaza.
PS)B

Pyetja 182 V)1

Cili nga medikamentet është efikas në infeksionet e rrugëve urinare?

A) norfloxacina
B) alopurinoli
C) amfotericina B
D) acidi salicilik
E) neomicina
PS)A

Pyetja 183 V)1

Degëzimet arterioze fundore të karotides eksterne janë:

A) temporale sipërfaqësore dhe e thellë.
B) maksilare e brendshme dhe maksilare e jashtme.
C) faringeale ngjitëse dhe maksilare e jashtme.
D) maksilare e jashtme dhe temporale sipërfaqësore.
E) maksilare e brendshme dhe tiroidale e sipërme.
PS)D

Pyetja 184 V)1

Nervi më i rëndësishëm motor për laringun është:

A) glosofaringeal.
B) degëzimi cervikal i nervit facial.
C) degëzimi i brendshëm i laringeus superior.
D) nervi laringeal rekurrens.
E) cervikal discendens.
PS)D

Pyetja 185 V)2

Sëmundja Hodgkin:

A) nuk prek asnjëherë lëkurën.
B) ekzaminimi histologjik karakterizohet nga qeliza Reed Stemberg.
C) shfaq hipereaksion ndaj tuberkolinës.
D) qeliza Reed- Stemberg është një eozinofil i shndërruar.
E) shërohet vetë pa asnjë terapi.
PS)B

Pyetja 186 V)2

Nëse një student gjatë periudhës që përgatitet për provime paraqet sistola të shumta premature atriale terapia më e mirë është:

A) me kalcium antagonist.
B) pushim.
C) eliminim të stimuluesve.
D) beta-bllokues.
E) digitalike.
PS)C

Pyetja 187 V)2

Proteozomet janë:

A) komplekse multimerike të përfshira në degradimin e proteinave.
B) të rrethuara nga membranë.
C) të shumta në numër në sipërfaqen e jashtme te qelizës.
D) të përfshira tek endocitoza e proteinave.
E) përgjegjëse për sintenzën proteike.
PS)A

Pyetja 188 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme mund të jetë një komplikacion nga terapia kirurgjikale e hernies inguinale të lindur tek fëmija?

A) atrofia testikulare iatrogjene
B) gastrektazia iatrogjene
C) mbajtja e urinës
D) një kist i duktusit tireo-glos
E) një infeksion i rrugëve urinare
PS)A

Pyetja 189 V)2

Sindroma Dressler është një:

A) polipozë intestinale.
B) peritonit adeziv.
C) perikardit post-traumatik.
D) një pneumoni intersticiale.
E) një pleuro-perikardit post-infarktit.
PS)E

Pyetja 190 V)1

Na cilat nerva bëhet inervimi sensitiv i dorës ?

A) vetëm ulnar
B) vetëm median

C) vetëm radial
D) ulnar+median
E) ulnar+median+radial
PS)E

Pyetja 191 V)2

Hemorragjitë e trungut encefalik verifikohen më shpesh:

A) tek pons.
B) tek mesencefalon.
C) tek cerebellum.
D) tel bulbi.
E) tek këmba e mesencefalon.
PS)A

Pyetja 192 V)2

Përthithja e natriumit dhe klorit në tubulin distal dhe në duktusin kolektor rritet nga:

A) renina.
B) angiotensina II.
C) forcat Starling të hapësirës peritubulare.
D) peptidi natriuretik atriale.
E) aldosteroni.
PS)E

Pyetja 193 V)3

Endokrinopatitë e mëposhtme mund të jenë të gjitha shkak i drejtpërdrejtë i një anemie hiporegjenerative me përjashtim të:

A) diabetit melit.
B) hipotiroidizmit.
C) hipopitutarizmit.
D) hiperparatiroidizmit.
E) hipogonadizmit.
PS)A

Pyetja 194 V)2

Cila prej simptomave të mëposhtme është tipike e feokromocitomës?

A) hipertensioni arterial
B) hipertensioni portal
C) hipertensioni endokranial
D) hipotensioni arterial

E) dhembje lumbare
PS)A

Pyetja 195 V)1

Ph hematik më i lartë se 7.40 është tregues i

A) acidozës.
B) alkalozës.
C) acidozës respiratore.
D) alkalozës metabolike.
E) alkalozës respiratore.
PS)B

Pyetja 196 V)1

Një alel që maskon efektin e një aleli tjetër të të njëjtit gjen quhet:

A) epistatik.
B) dominant.
C) recesiv.
D) pleiotropik.
E) letal.
PS)B

Pyetja 197 V)1

Tek pacientët me stenozë koronare të shprehur, mekanizmi kryesor që çon në shfaqjen e anginës nga sforcimi është:

A) ngushtimi i enëve të gjakut në zonën e sëmurë.
B) reduktimi i furnizimit me oksigjen i pjesës së paprekur nga stenoza koronare.
C) reduktim i furnizimit me oksigjen në pjesën e sëmurë.
D) rritje e kërkesës për oksigjen që nuk mund të përkojë me një rritje të furnizimit në pjesën e sëmurë.
E) reduktim i fluksit koronar të pjesës së sëmurë.
PS)D

Pyetja 198 V)1

Acidi vanilmandelik është produkti i katabolizmit të një prej këtyre hormoneve:

A) tiroxinës.
B) testosteronit.
C) hidrokortizonit.
D) noradrenalinës.
E) aldosteronit.

PS)D

Pyetja 199 V)1

Nëse një homozigot normal çiftohet me një homozigot me gjen recesiv, pasardhësit do të jenë:

A) të gjithë normalë.
B) të gjithë të sëmurë.
C) 50% normal.
D) 75% normal.
E) 25% normal.
PS)A

Pyetja 200 V)1

Me artrotomi kuptohet:

A) hapja e një artikulacioni.
B) hapja dhe drenazhi i një artikulacioni.
C) hapja e pjesshme e një artikulacioni.
D) levizja artikulare.
E) sutura e një çarjeje artikulare.
PS)A

Pyetja 201 V)1

Cili organ mban limfopoezën gjatë jetës embrionale dhe fetale?

A) placenta
B) mëlçia fetale
C) veshka fetale
D) shpretka fetale
E) palca e kurrizit
PS)B

Pyetja 202 V)1

Bërthama e kuqe ndodhet tek:

A) ponsi.
B) bulbi.
C) mesencefaloni.
D) medulla oblungata.
E) medulla spinalis.
PS)C

Pyetja 203 V)2

Tek një pacient me cirrozë hepatike si bëhet një program mbikëqyerjeje për diagnozën paraprake të hepatokarcinomës?

A) me TC trefazore spirale çdo vit
B) me kontrolle ekografie hepatike dhe alfa fetoproteina serike çdo 4-6 muaj
C) me kontrolle semestrale rezonance magnetike hepatike
D) me biopsi hepatike çdo 6-12 muaj
E) me kontrolle të transaminazave dhe alfa fetoproteniës serike çdo 3-4 muaj
PS)B

Pyetja 204 V)2

Tek sindroma Dubin - Johnson:

A) bilirubina është > se 20 mg/dl.
B) bilirubina serike është zakonisht jo e drejtpërdrejtë.
C) bilirubina serike është zakonisht e drejtpërdrejtë me vlera > se 20 mg/dl.
D) bilirubina serike është zakonisht e drejtpërdrejtë me vlera < se 6 mg/dl.
E) bilirubina serike është zakonisht jo e drejtpërdrejtë me vlera < 6 mg/dl.
PS)D

Pyetja 205 V)1

Cili prej treguesve mund të sinjalizojë për një dëmtim të rëndë hepatik?

A) hipogamaglobulinemia
B) alterimi i testeve të flokulacionit serokoloidalë
C) hipokolesterolemi e dukshme
D) hiperazotemi
E) eritrosedimenti i lartë
PS)C

Pyetja 206 V)3

Një fëmijë 3 vjeç shfaq temperaturë 39 gradë dhe rigiditet rakidien prej të paktën tre ditësh. Tek ekzaminimi objektiv vërehen hiperemi e faringut, nyje limfatike cervikale anteriore dhe posteriore të zmadhuara, me konsistencë të rritur dhe rezistencë të
A) punksion lumbar.
B) test për antikorpe dhe heterofilë.
C) tampon faringu dhe pinicilinë në rrugë orale për 7 ditë.
D) tampon faringu dhe pinicilinë në rrugë orale për 10 ditë.
E) tampon faring, matje të leukociteve dhe rivlerësim brenda 24 orësh.
PS)A

Pyetja 207 V)1

Nervi glosofaringeal vjen nga një berthamë që ndodhet në:

A) medulla oblongata.
B) deincefali.
C) pons.
D) mesencefalon.
E) medulla spinalis.
PS)A

Pyetja 208 V)1

Të gjitha gjendjet e mëposhtme lidhen me një rritje të niveleve qarkulluese të prolaktinës, përveç:

A) stresit.
B) hipotiroidizmit.
C) anoreksisë nervore.
D) akromegalisë.
E) shtatëzënisë.
PS)C

Pyetja 209 V)2

Disleksia është:

A) një vonesë e thjeshtë në mësimin e të lexuarit.
B) një problem specifik në mësimin e të lexuarit .
C) një shqetësim neurologjik nga dëmtim motor.
D) një shqetësim i lidhjes ndërfamiljare.
E) një psikozë.
PS)B

Pyetja 210 V)1

Cili prej këtyre pohimeve është i saktë?

A) Infeksioni nga HBV është shkaku kryesor i hepatit kronik.
B) Infeksioni nga HAV nuk shkakton asnjëherë hepatit të rrufeshëm.
C) Infeksioni nga HCV kalon vetë në 60% të rasteve.
D) Hepatitis kronik nga HCV lidhet me hipertransaminaseminë kostante.
E) HDV mund të shkaktojë si infeksion dhe superinfeksion.
PS)E

Pyetja 211 V)1

Skarlatina shkaktohet nga:

A) një toksinë stafilokoku.
B) një toksinë streptotoku.
C) një herpes virus.
D) një candida albicans.
E) një toxoplasma gondi.
PS)B

Pyetja 212 V)1

Cili mes dallimeve të mëposhtëm mes prokariotëve dhe eukariotëve nuk është i vërtetë?

A) Vetëm eukariotët ndahen me mitozë.
B) Vetëm eukariotët kanë bërthamë.
C) Vetëm eukariotet kanë ribosome.
D) Vetëm eukariotët kanë mitokondri.
E) Vetëm eukariotët kanë membranë bërthamore.
PS)C

Pyetja 213 V)1

Ovogjeneza:

A) fillon në pubertet.
B) vazhdon gjatë gjithë jetës.
C) ndodh vetëm në rast fekondimi.
D) ndodh tek mukoza e mitrës.
E) ka një fazë mitotike dhe një meiotike.
PS)E

Pyetja 214 V)1

Medikamentet e para që zgjidhen në trajtimin e brucelozës janë:

A) tetraciklinat.
B) antibiotikët glikopeptidikë.
C) cefalosporinat e gjeneratës II.
D) cefalosporinat e gjeneratës III.
E) metronidazol.
PS)A

Pyetja 215 V)1

Hiperparatiroidizmi sekondar tek insufiçenca renale kronike shkaktohet nga:

A) tumor beninj i paratiroideve.
B) tumor malinj i paratiroideve.

C) hipertiroidizmi.
D) hipotiroidizmi.
E) rritje e fosforemisë dhe ulje e kalçemisë.
PS)E

Pyetja 216 V)2

Cili prej tumoreve të sistemit nervor qëndror ka më shumë mundësi të jetë i shumëfishtë?

A) astrocytoma e llojit IV (glioblastoma)
B) medulloblastoma
C) limfoma primare e sistemi nervor qëndror
D) ependimoma
E) oligodendroglioma
PS)C

Pyetja 217 V)1

Cili është funksioni i kemoceptorëve qëndrorë?

A) stimulon qendrat respiratore për të realizuar frymëmarrjen
B) pengon qendrat respiratore në prani të acidozës së LEC
C) stimulon qendrat respiratore në prani të alkalozës LEC
D) stimulon qendrat respiratore për të bërë frymëmarrjen
E) stimulon qendrat nervore të degëzimeve të karotides
PS)A

Pyetja 218 V)1

Si paraqitet dispnea?

A) gjithmonë frymëmarrëse
B) gjithmonë frymënxjerrëse
C) gjithmonë frymëmarrëse dhe frymënxjerrëse
D) varet nga presioni në qarkullimin e vogël
E) mund të jetë frymëmarrëse dhe/ose frymënxjerrëse
PS)E

Pyetja 219 V)1

Duktusi pankreatik kryesor është:

A) Santorini.
B) Cistik.
C) Wirsung.
D) Stenone.
E) Valsava.

PS)C

Pyetja 220 V)2

Një pacient me nivele të larta FT3 dhe FT4, nivele të ulta TSH, nivele të reduktuara të tireoglobulinës dhe reduktim të kapjes së radiojodit ka më shumë të ngjarë që të ketë:

A) sëmundjen Basedov - Graves.
B) tiroidit subakut.
C) tireotoksikozë faktike.
D) toksikozë Hashimoto .
E) tiroide post partum.
PS)C

Pyetja 221 V)1

Cili prej mekanizmave të mëposhtëm të kompensimit realizohet në kushte e insufiçences respiratore akute?

A) rritje e hematokritit
B) ulje e diurezës
C) rritje e tensionit të gjakut
D) rritje e frekuencës kardiake
E) ripërthithje e bikarbonatëve në nivel renal
PS)E

Pyetja 222 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me hepatitin C nuk është i vërtetë?

A) Hepatiti C është përgjegjës në 90% të hepatiteve post transfuzionale.
B) Hepatiti kronik është një pasojë e zakonshme pas infeksionit me virusin C të hepatitit.
C) Pothuajse të gjithë pacientët kanë një histori ekspozimi farefisnor ndaj virusit
D) Një nivel shumë i lëkundshëm i transaminazave është karakteristik i hepatit C.
E) Pacientët me hepatit C kanë një risk të shtuar për të zhvilluar hepatokarcinomën.
PS)C

Pyetja 223 V)1

Me hidroksiadenit kuptohet:

A) një inflamacion supurativ të disa aparateve piloseborroike.
B) një inflamacion akut purulent të gishtave.
C) një inflamacion eksudativ purulent të përhapur tek indi lidhor.
D) një grumbullim qelbi në një kavitet të sapoformuar.
E) një inflamacion akut supurativ të gjendrave të djersës.
PS)E

Pyetja 224 V)1

Disodiokromoglikati rekomandohet në terapinë për:

A) bronkit akut bakterial.
B) bronkit akut viral.
C) sëmundje nga imunoreaksioni.
D) sklerodermi.
E) brucelozë.
PS)C

Pyetja 225 V)2

Bula është elementi semiologjik elementar i

A) urtikaries.
B) pemphigusit.
C) herpes simplex.
D) psoriazës.
E) lichen planus.
PS)B

Pyetja 226 V)2

Emri paralizë cerebrale infantile tregon

A) një problem motor akut.
B) një mungesë lëvizjeje në një ose disa pjesë muskulare.
C) një prapambetje të zhvillimit motor shkaktuar nga një dëmtim cerebral i parakohshëm.
D) një prapambetje motore shkaktuar nga një dëmtim gjatë moshës evolutive.
E) një paralizë periferike e lidhur me një patologji cerebrale.
PS)C

Pyetja 227 V)1

Polio, Coxachia dhe Echovirus transmetohen në rrugë:

A) parenterale.
B) në dukje parenterale .
C) oro-fekale.
D) seksuale.
E) respiratore.
PS)C

Pyetja 228 V)1

Acicloviri përdoret në terapinë e:

A) prostatitit bakterial.
B) uveitit parazitar.
C) encefalitit herpetik.
D) gripit.
E) hepatit B.
PS)C

Pyetja 229 V)1

Cili prej pohimeve në lidhje me hiperkalieminë nuk është i vërtetë?

A) mund të jetë sekondare pas acidozës metabolike
B) mund të jetë sekondare pas dhënies së tepërt të furosemidit
C) mund të jetë sekondare pas hemotransfuzioneve masive
D) mund të jetë shkak i aritmive të rënda kardiake
E) A+C
PS)B

Pyetja 230 V)1

Cili nerv encefalik përshkon kanalin e Fallopit?

A) trigemini
B) abducent
C) facial
D) troklear
E) hipoglos
PS)C

Pyetja 231 V)2

Tek uremia kronike kalçemia dhe fosfatemia janë në përgjithësi:

A) kalcemi e reduktuar dhe fosfatemi e rritur.
B) kalcemi e rritur dhe fosfatemi e reduktuar.
C) të dyja të reduktuara.
D) të dyja të rritura.
E) të dyja normale.
PS)A

Pyetja 232 V)1

Në çfarë konsiston roli i mushkërive për rregullimin e ekuilibrit acido-bazik?

A) duke rregulluar me ventilim përthithjen e O2-it

B) duke rregulluar me ventilim eliminimin e CO2-it
C) duke rregulluar me ventilim eliminimin e O2-it
D) duke rregulluar funksionin e purifikues mushkërisë
E) duke rregulluar funksionin e filtrit metabolik të mushkërisë
PS)B

Pyetja 233 V)2

Humbja e tepërt e natriumit tek insufiçenca renale shkaktohet nga:

A) rritja e ujit jashtëqelizor.
B) reduktimi i plazmaproteinave.
C) shtimi i volemisë.
D) reduktimi i viskozitetit hematik.
E) defiçit hormonesh glukokortikoidë dhe mineralkortikoidë.
PS)E

Pyetja 234 V)1

Përqëndrimi sierik i T4- është:

A) 0.6 - 2.0 mg/ml
B) 3.8 - 12.2 mcg/dl
C) 3 - 12 mg/ml
D) 20 - 30 mg/ml
E) 12 - 20 mg/ml
PS)B

Pyetja 235 V)1

Shkaqet e mëposhtme shkaktojnë kompensim kardiak, me përjashtim të:

A) futjes së një terapie me insulinë
B) anemizimit
C) marrjes së medikamenteve penguese të prostaglandinës (anti inflamatorë jo steroidë)
D) aritmi hiperkinetike
E) pneumonia
PS)A

Pyetja 236 V)2

Sasia e O2 që u jepet indeve zakonisht reduktohet në të gjitha kushtet e saj me përjashtim të:

A) raportit të reduktuar ventilim - perfuzion
B) anemi nga mungesë hekuri
C) hipoksi stacionare
D) hiperventilim gjatë ushtrimit fizik

E) hipoksi e hershme
PS)D

Pyetja 237 V)2

Të gjitha alterimet e mëposhtme patologjike janë karakteristike të Alzheimerit me përjashtim të:

A) trupave Hirano
B) pllakave senile
C) trupave Lewy
D) degjenerimit granulovakuolar të neurinomave
E) angiopati kongofile
PS)C

Pyetja 238 V)2

Cila është etiologjia më e shpeshtë tek insufiçenca kortikosurenale akute?

A) sindroma Sheehan
B) insufiçenca surenale sekondare që shfaqet pas një pezullimi të trajtimit me steroide
C) sindroma Schmidt
D) sindroma Waterhouse-Friderichsen
E) insufiçencë surenale primare me etiologji tuberkulare
PS)B

Pyetja 239 V)1

Cili prej medikamenteve të mëposhtëm përdoret për profilaksinë e sëmundjes së membranave hialine?

A) insulina
B) kortikosteroidët
C) hormone tiroidiene
D) androgjenët
E) beta 2 stimuluesit
PS)B

Pyetja 240 V)1

Një rruazë e kuqe e zhytur në një solucion të ujshëm fryhet dhe për pak kohë plas. Përfundimi është që bëhet fjalë për një substancë:

A) hipotonike.
B) isotonike.
C) hidrotonike.
D) izomorfe.

E) hipotermike
PS)A

Pyetja 241 V)1

Cili përbën kundraindikacion për pilulën kontraceptive?

A) endometrioza
B) mastopatia fibrocistike
C) kist vezoreje sieroze
D) karcinomë mamare e operuar që prej më shumë se 3 vjetësh
E) nullipariteti
PS)D

Pyetja 242 V)2

Cili element është i domosdoshëm për diagnozën e sëmundjes celiake?

A) radiologjia e zorrës së hollë
B) dy biopsi sekuenciale të mukozës duodenale
C) koprokultura
D) kërkimi i gjakut okult në feçe
E) analiza kimike fizike e feçeve
PS)B

Pyetja 243 V)1

Sinteza e ADN-së bëhet:

A) në fazën G2.
B) në fazën M.
C) në fazën S.
D) në fazën G1.
E) në fazën G0.
PS)C

Pyetja 244 V)2

Cili prej indikatorëve të mëposhtëm klinikë përbën rrezik më të madh për zhvillimin e një karcinome të mamelës?

A) menarka e parakohshme
B) familjaritet i shkallës së parë me karcinomën mamare
C) më pak se tre shtatëzani në term
D) më shumë se tre shtatëzani në term
E) mos realizimi i dhënies së gjirit fëmijës
PS)B

Pyetja 245 V)1

Gjatë ekzaminimit hemokromocitometrik, parametri MCHC:

A) është një matje e vëllimit eritrocitar total dhe përdoret për diagnostikimin e defekteve të sintezës së hemoglobinës.
B) është një matje e dispersionit të vëllimit të eritrociteve dhe përdoret për diagnozën e diferencuar të anemive.
C) është një matje e vëllimit eritrocitar total dhe përdoret për diagnozën diferenciale të anemisë.
D) tregon përqindjen e blastomieloideve në qarkullim.
E) është një matje e përmbajtjes së hemoglobinës mesatare të eritrociteve.
PS)E

Pyetja 246 V)2

Mes komplikacioneve të sëmundjeve hepatike kolestatike kronike përfshihen gjithë të mëposhtmet, me përjashtim të:

A) sëmundjes metabolike të kockës.
B) hiperkolesterolemisë.
C) steatorresë.
D) kardiomiopatisë dilatative.
E) deficit të vitaminave lipo-solubël.
PS)D

Pyetja 247 V)1

Të gjitha alternativat janë kundërindikacione për përdorimin e salicilateve, me përjashtim të:

A) problemeve të koagulimit.
B) funksionit auditiv të reduktuar.
C) sëmundjeve ulçeroze gastrike.
D) insufiçencës renale.
E) depresionit psikik.
PS)E

Pyetja 248 V)2

Me axhitim kuptohet:

A) një dridhje e pakontrollueshme.
B) një gjendje tensioni të fortë emotiv.
C) një gjendje shqetësimi psikologjik dhe motor.
D) një gjendje e lidhur me skizofreninë.

E) një gjendje e shkaktuar nga mania.
PS)C

Pyetja 249 V)1

Cili prej pohimeve mbi apendicitin akut nuk është i saktë?

A) Është i rrallë në 3 vitet e e parë të jetës.
B) Ekzaminimi më i rëndësishëm diagnostikues është klizma opake.
C) Nuk shkakton dhimbje abdominale të përsëritura.
D) Tek femrat në moshë puberteti nuk duhet ngatërruar me dhimbjet pre mestruale.
E) Shfaqet, në përgjithësi pa temperaturë ose me një temperaturë modeste (< 38°).
PS)B

Pyetja 250 V)2

Karcinoma in situ e cerviksit karakterizohet nga të gjitha pikat në vijim, me përjashtim të:

A) përfshirjes së trashësisë së plotë të epitelit skuamoz.
B) qeliza që ngjajnë me ato të karcinomës invazive.
C) evidencë invazioni stomal.
D) humbje e plotë e stratifikimit.
E) regres rastësor dhe zhdukje.
PS)C

Pyetja 251 V)1

Tek seksi femër shkaku më i shpeshtë i mungesës së hekurit përfaqësohet nga:

A) humbje të tepërta hematike menstruale.
B) gjakrrjedhje hemorroidale.
C) ulcerë grastroduodenale.
D) sëmundje intestinale.
E) epistaksis.
PS)A

Pyetja 252 V)2

Tek subjektet me precedent miopatie, frenuesit HMG - CoA reduktazë (statina)

A) nuk janë efikase në uljen e kolesterolit LDL.
B) nuk duhet të shoqërohen me derivate të acidit fibrik (klofibrat dhe kongenerë).
C) nuk duhen dhënë kurrë.
D) mund të shkaktojnë osteoporozë dhe dëmtime epiteliale.
E) nuk kanë asnjë efekt tek profili lipidik.
PS)B

Pyetja 253 V)2

Cila prej të dhënave të mëposhtme laboratorike NUK është karakteristike e purpurës trombocitopenike idiopatike?

A) numri i trombociteve është < se 50.000/mm³
B) Pt, PTT dhe TT (koha e trombinës) janë në normë
C) numër normal të rruazave të bardha
D) prani hiperplazie të vijës megakariocitare të palcës së kurrizit
E) pjesa periferike tregon që trombocitet e pakta të pranishme janë relativisht të vogla
PS)E

Pyetja 254 V)2

Të gjitha alternativat karakterizojnë kolangitin primitiv sklerotizues, me përjashtim të:

A) dëmtimeve që kanë të bëjnë vetëm me rrugët biliare extra-hepatike.
B) moshën e shfaqjes rreth të tridhjetave.
C) bashkëekzistencën e rektokolitit ulçeroz.
D) pozitivitetin për antikorpet anti - ANCA.
E) evolucion sistematik drejt insufiçencës hepatike.
PS)A

Pyetja 255 V)1

Në trajtimin e një stadi të sëmundjes astmatike cili është synimi kryesor që terapeuti duhet të ndjekë?

A) të korrigjojë bronkokonstriksionin
B) të korrigjojë hipokseminë
C) të korrigjojë gjendjen e inflamacionit
D) të korrigjojë hiperinflamacionin dinamik të rrugëve ajrore
E) të korrigjojë ndryshimet metabolike pasuese
PS)B

Pyetja 256 V)1

Cili prej këtyre hormoneve kortikosurenalë prodhohet në zonën fascikulare?

A) aldosteroni
B) kortizoli
C) dezoksikortikosteroni
D) aldosteroni
E) 11-hidrosiandrostenedioni
PS)B

Pyetja 257 V)1

Endoteli:

A) është në gjendje të prodhojë substanca me aktivitet ekskluzivisht vazokonstriktor.
B) është në gjendje të prodhojë substanca me aktivitet ekskluzivisht vazodilatator.
C) ka një rol të rëndësishëm tek fiziopatologjia e shumë sëmundjeve kardiovaskulare.
D) është në gjendje të prodhojë substanca me aktivitet vazokonstriktor.
dhe vazodilatator
E) C + D.
PS)E

Pyetja 258 V)1

Endometroza mund të shkaktojë:

A) inkontinencë.
B) amenorre.
C) leukorre.
D) dispareuni.
E) anemi.
PS)D

Pyetja 259 V)1

Cili nga pohimet mbi rënien në peshë gjatë ditëve të para të jetës nuk është i saktë?

A) Mund të jetë edhe në 15% tek pretermët.
B) Shkaktohet nga humbja në sasi e mekoniumit dhe lëngjeve.
C) Shkaktohet nga mungesa relative kalorike gjatë 2-3 ditëve të para.
D) Pesha e lindjes duhet të rekuperohet brënda ditës së pestë të jetës.
E) Konsiderohet normale një humbje deri në 10% të peshës së trupit në lindje.
PS)D

Pyetja 260 V)1

Cili prej elementëve vjen menjëherë pas mieloblastit, gjatë proçesit të diferencimit të palcës?

A) promielociti
B) megalociti
C) metamielociti
D) qeliza plazmatike
E) hemocitoblasti
PS)A

Pyetja 261 V)1

Cila prej gjendjeve nuk shkakton gjinekomasti?

A) trauma e lokalizuar torakale
B) cirroza hepatike
C) sindroma Turner
D) karcinoma e testikuli
E) tumori i qelizave Leyding të testikulit
PS)C

Pyetja 262 V)1

Në cilën prej gjendjeve rritet albumina në plazëm?

A) dehidrimi
B) plazmocitoma
C) hepatopatitë kronike
D) sindroma nefrotike
E) gjendje inflamatore kronike
PS)A

Pyetja 263 V)2

Fenomeni i Argyll-Robertson (rigiditet i pupilës në dritë me akomodim të ruajtur) është simptomë e shpeshtë e cilës prej gjendjeve të mëposhtme?

A) neurolue (Sifilizi me prekje SNC)
B) skleroza multiple
C) parkinsoni
D) meningiti
E) tumoret cerebrale
PS)A

Pyetja 264 V)2

Cili është komplikacioni më i shpeshtë i fruthit?

A) bronkopneumonia
B) hepatiti akut
C) absesi pulmonar
D) apendisiti
E) dermatomioziti
PS)A

Pyetja 265 V)2

Gjatë një ataku astmatik akut, cila metodikë diagnostike është më e vlershme për vlerësimin e gjendjes klinike dhe përgjigjen ndaj terapisë?

A) Rx toraksi
B) Hemogazanaliza
C) Vlerësimi i pulsit paradoksal
D) Observimi nëse përdoren muskujt respiratorë ndihmës
E) Matja e vëllimit të maksimal të ekspirimit në 1 sekondë (FEV 1)
PS)E

Pyetja 266 V)1

Cila prej alternativave nuk është e vërtetë për peptidin natriuretik atrial (ANP)?

A) stimulon natriurezën
B) shkakton kontraksion të muskulaturës së lëmuar
C) stimulon diurezën
D) inhibon prodhimin e reninës dhe aldosteronit
E) prodhohet kryesisht nga atriumet kardiake
PS)B

Pyetja 267 V)1

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme SGOT është gjithnjë e rritur?

A) infarkti akut i miokardit
B) pleuriti eksudativ
C) hemodializa e përsëritur
D) guta
E) sindroma nefrotike
PS)A

Pyetja 268 V)1

Dizanteria bacilare shkaktohet nga:

A) Shigella.
B) Entoameba histolytica.
C) Schistosoma.
D) Balantidium coli.
E) Enterocochet.
PS)A

Pyetja 269 V)1

Cila nga alternativat nuk përfaqëson një agjent shkaktar të obstruksionit të rrugëve ajrore tek asmatikët?

A) infeksionet respiratore virale
B) ajri i ftohtë

C) acidi salicilik
D) aktiviteti fizik
E) alergjenët në ajër
PS)C

Pyetja 270 V)2

Është e vërtetë se gjatë shtatzënisë me metabolizmin e karbohidrateve vërehet se:

A) gratë diabetike janë të mbrojtura nga keto-acidoza.

B) vërehet rezistencë ndaj insulinës.
C) kontrolli i rregullt i glicemisë nuk redukton anomalitë kongenitale të fëmijëve të lindur nga nëna diabetike.
D) nënave me nefropati diabetike duhet t'u ndalohet e drejta për të ngelur shtatzëna, për shkak të rrezikut ndaj të cilit janë të ekspozuar fetuset .
E) pacientet jo diabetike me hipoglicemi gjatë shtatzanisë kanë të njëjtin rrezik për të zhvilluar diabet krahasuar me pacientet që kanë tolerancë normale ndaj glukozes.
PS)B

Pyetja 271 V)2

Në cilën prej gjendjeve eozinofilet pothuajse mungojnë në gjak?

A) tifo abdominale
B) reaksioni nga plazma
C) echinonoccoza
D) astma bronkiale
E) panarteriti nodoz
PS)A

Pyetja 272 V)1

Karcinoma e ezofagut lokalizohet më shpesh në:

A) në një të tretën superiore.
B) në një të tretën e mesit.
C) në një të tretën inferiore.
D) në junksionin ezofago-gastrik.
E) në mënyrë të barabartë në të gjitha segmentet.
PS)B

Pyetja 273 V)1

Alkaloza respiratore shkaktohet nga:

A) ngadalësimi i fluksit ajror respirator.

B) ngadalësimi i difuzionit të gazeve në nivelin respirator.
C) përshpejtimi i shkëmbimeve respiratore.
D) hipopnea nga insufiçienca e muskujve.
E) hipopnea nga inhibimi i qëndrave respiratore
PS)C

Pyetja 274 V)2

Dora kthetër është tipike e cilës prej patologjive të mëposhtme?

A) artriti reumatoid
B) skleroza multiple
C) osteoartoza
D) tabis dorsale
E) skleroza laterale amiotrofike
PS)E

Pyetja 275 V)1

Diagnoza më e mundshme e një pacienti 50 vjeçar me pirozë retrosternale që theksohet në fleksion është:

A) ulçera peptike.
B) pankreatiti.
C) kolelitiaza.
D) karcinoma e ezofagut.
E) ezofagiti nga refluksi.
PS)E

Pyetja 276 V)1

Karakteristikat e polimialgjisë rheumatike shpesh herë shoqërohen me:

A) Sëmundjen e Takajasu
B) Sëmundjen e Wegener
C) Sëmundjen e Hortonit
D) Sëmundjen e Pompe
E) Morbusi Cushing
PS)C

Pyetja 277 V)1

Cili është agjenti etiologjik i pneumonisë atipike primare?

A) Virusi herpetik
B) Salmonela
C) Proteus mirabilis

D) Entamoeba hystolitica
E) Mycoplasma pneumoniae
PS)E

Pyetja 278 V)1

Ulçerat multiple të stomakut janë kryesisht:

A) me natyrë përgjithësisht malinje.
B) të bashkëshoqëruara me kolitin ulçeroz.
C) tregues i prodhimit të reduktuar të ptialinës.
D) me natyrë përgjithësisht beninje.
E) ekskluzivisht të fëmijërisë.
PS)D

Pyetja 279 V)2

Sindroma hepato-renale është komplikacion i cilës prej sëmundjeve të mëposhtme?

A) cirroza hepatike
B) nefrolitiaza
C) tuberkulozi renal
D) kolecistiti akut
E) pielonefriti kronik
PS)A

Pyetja 280 V)2

Cila prej anomalive mungon në kompleksin e Eisenmengerit?

A) aorta e shaluar.
B) difekti i septumit interventrikular
C) hipertrofia ventrikulare e djathtë
D) stenoza e pulmonares
E) harku i theksuar i pulmonares
PS)D

Pyetja 281 V)1

Në cilën prej gjendjeve auskultohen ronket, sibilancat dhe fishkëllimat?

A) alveoliti
B) pneumonia
C) astma bronkiale
D) edema pulmunare
E) bronkopneumonia
PS)C

Pyetja 282 V)1

Paraqitja me 'atrofi të muskulaturës interdigitale dhe devijim ulnar të gishtërinjve' është tipike e:

A) lupusit eritematoz sistemik.
B) reumatizmës artikulare akute.
C) artrozës me deformim.
D) artritit reumatoid.
E) guta kronike.
PS)D

Pyetja 283 V)2

Në pneumoninë atipike primare inflamacioni është:

A) kryesisht neutrofil intersticial.
B) kryesisht mononuklear alveolar.
C) kryesisht neutrofil alveolar.
D) kryesisht me pus .
E) kryesisht mononuklear intersticial.
PS)E

Pyetja 284 V)1

Në cilin nga rastet biopsia renale nuk ka indikacion?

A) hidronefroza
B) proteinuri me natyrë të panjohur
C) insufiçencë renale me natyrë të panjohur
D) mikrohematuri dhe proteinuri nga Lupusi eritematoz sistemik
E) dyshim për vaskulit renal
PS)A

Pyetja 285 V)1

Në cilën prej gjendjeve pH në gjak është i zvogëluar?

A) të vjella
B) uremi
C) polipne
D) okluzioni intestinal
E) gjendjet febrile
PS)B

Pyetja 286 V)1

Sinkopi verifikohet kryesisht në:

A) stenozën e aortës.
B) arrestin kardiak.
C) stenozën e mitrales.
D) hipertensionin pulmonar.
E) stenozën e trikuspidales.
PS)A

Pyetja 287 V)2

Në nefrolitiazën recidivuese mendohet para së gjithash për:

A) aplazinë renale.
B) difektin enzimatik të metabolizmit të vit. D.
C) adenomën e paratiroideve.
D) hiperkolesteroleminë.
E) pielonefritin kronik.
PS)C

Pyetja 288 V)1

Pas Streptococcut Pneumoniae cili është agjenti etiologjik më i shpeshtë i pneumonisë?

A) Legionella Pneumophila
B) Klebsiella P.
C) Mycoplasma
D) Stafilococcet
E) Enterococcet
PS)C

Pyetja 289 V)1

Cili është shkaku më i shpeshtë i vdekjes tek një pacient cirrotik që bën episode hemorragjike nga ruptura e variçeve të ezofagut?

A) sepsis
B) hemorragjia cerebrale
C) çekuilibrimi hidro-elektrolitik
D) sindroma okluzive
E) insufiçenca hepatike
PS)E

Pyetja 290 V)2

Antitrupat anti-centromere janë tipike të:

A) LES.
B) Konjuktivitet mikse.
C) Sindroma CREST.
D) Dermatomiozitet.
E) Artritit reumatoid.
PS)C

Pyetja 291 V)1

Shoku hipovolemik karakterizohet nga gjithë simptomat e mëposhtme, përveç:

A) bradikardisë.
B) presionit arterial sistolik < 90 mm Hg.
C) oligurisë.
D) alternimeve në qarkullimin cerebral.
E) ulja së temperaturës.
PS)A

Pyetja 292 V)2

Në brucelozën kronike tek adultët, trajtimi i përzgjedhur është:

A) tetraciklina 1 gr/ditë.
B) tetraciklina 0.5 gr/ditë.
C) Caf 61.5 gr/ ditë.
D) streptomicina 1 gr/ditë dhe Tetraciclina 2 gr/ditë.
E) Eritrocina 1 gr/ditë.
PS)D

Pyetja 293 V)2

Hiperparatiroidizmi mund të favorizojë shfaqjen e:

A) pielonefritit.
B) hipertiroidizmit.
C) hipokalcemisë.
D) kalkulozën renale.
E) cirrozën hepatike.
PS)D

Pyetja 294 V)1

Çfarë ndodh në hiperaldosteronizmin primar?

A) hipotension arterial

B) reduktim i prodhimit të insulinës
C) hiper-refleksi
D) hipoglicemi
E) hipokaliemi
PS)E

Pyetja 295 V)2

Cila prej patologjive (si rregull) nuk shkakton sindromë nefrotike?

A) nefropatia diabetike
B) tromboza e venës renale
C) nefropatia intersticiale
D) lupusi eritematoz
E) krioglobulinemia mikse esenciale
PS)C

Pyetja 296 V)1

Tek mbartësit e shëndetshëm të tifos, vend 'magazinimi' mund të jetë kryesisht:

A) kolecista.
B) stomaku.
C) ileusi.
D) koloni dhe apendixi.
E) koloni trasvers.
PS)A

Pyetja 297 V)2

Cili prej kritereve të mëposhtëm nuk është kriter madhor sipas Framingham në diagnozën e insuficiencës kardiake?

A) Dispnea paroksistike nokturne
B) Edema e gjymtyrëve
C) Edema pulmonare akute
D) Kardiomegalia
E) Ritmi i galopit
PS)B

Pyetja 298 V)1

Cila prej thënieve është e saktë? Në hernien hiatale zakonisht ka:

A) pirrozë.
B) hematemezë.
C) simptoma nga "keqabsorbimi".

D) të vjella.
E) obezitet.
PS)A

Pyetja 299 V)1

Në cilën nga patologjitë nuk vërehet rënie në peshë?

A) hipofunksioni i ovareve
B) hipertireoza
C) hiposurenalizmi kronik
D) anoreksia psikike
E) panhipopituitarizmi
PS)A

Pyetja 300 V)1

Nuk ndodh në sindromën nefrotike:

A) hiperlipidemia.
B) proteinuria.
C) lipiduria.
D) edemat e buta dhe pastoze.
E) hiperkalçiuria
PS)E

Pyetja 301 V)1

Cili prej mikroganizmave nuk transmetohet nëpërmjet ujit?

A) Clostridium tetani
B) Shigella
C) Vibrio cholerae
D) Salmonella typhi
E) Leptospira
PS)A

Pyetja 302 V)2

Në flebogramë, çfarë paraqet vala pozitive?

A) tkurrjen e ventrikulit të djathtë
B) fazën e kolapsit venoz
C) fazën e mbushjes së atriumit të djathtë
D) sistolat atriale
E) fazën e zbrazjes së atriumit të djathtë
PS)D

Pyetja 303 V)1

Cilat janë qelizat përgjegjese të imunitetit humoral?

A) Bazofilët
B) Monocitet
C) Limfocitet
D) Eozinofilet
E) Limfocitet- B
PS)E

Pyetja 304 V)1

Në cilën prej patologjive vihet re rënie në peshë?

A) Hiperinsulinizëm
B) M. Froelich
C) S. Pickwick
D) S. Sheehan
E) S. Cushing
PS)D

Pyetja 305 V)1

Mungesa e acidit klorhidrik në lëngun gastrik, mund të jetë shenjë e:

A) ezofagitit nga refluksi.
B) ulçerës duodenale.
C) hemokromatozës.
D) anemisë pernicioze.
E) hernies hiatale.
PS)D

Pyetja 306 V)2

Insufiçenca renale akute e shkaktuar nga nekroza e papilës renale, ndodh më shpesh tek:

A) hipertireoza.
B) tuberkulozi renal.
C) Morbusi Adison.
D) Diabet Mellitus.
E) Sëmundja e Cushing
PS)D

Pyetja 307 V)2

Në cilën prej gjendjeve vërehet dhimbje torakale e papritur, me polipne dhe hemoptizi?

A) infarkti pulmonar.
B) pleuriti hemorragjik.
C) perikarditi eksudativ
D) pakipleuriti
E) infarkti i miokardit
PS)A

Pyetja 308 V)1

Në rastin e meningitit tuberkular, cilat qeliza dominojnë në likidin cerebro-spinal?

A) mastocitet
B) granulocitet eozinofile
C) granulocitet neutrofile
D) limfocitet
E) qelizat e Langerhansit
PS)D

Pyetja 309 V)1

Timoma shoqërohet shpesh me:

A) sëmundje infektive.
B) neoplazi pulmonare.
C) S. Sjogren.
D) miasteni.
E) artrit reumatoid.
PS)D

Pyetja 310 V)1

Në feokromocitomë ka prodhim të shtuar të:

A) kortizolit.
B) tiroksinës.
C) aldosteronit.
D) ACTH.
E) adrenalinës dhe/ose noradrenalinë.
PS)E

Pyetja 311 V)1

Çfarë ndodh nëse individi rri gjatë pa ngrënë (esëll)?

A) rritet ketonemia

B) hiperproteinemi
C) hiperbikarbonatemi
D) hipervolemi
E) prirje për alkalozë
PS)A

Pyetja 312 V)2

Si është FV (fremitus vocalis) në atelektazën nga obstruksioni bronkial (si psh. neoplazia bronkiale)?

A) normal
B) i reduktuar
C) i reduktuar në mënyrë drastike
D) i rritur
E) nuk është i pranishëm
PS)E

Pyetja 313 V)2

Facies si maskë ose 'e qeshura sardonike' ndodh tek:

A) tërbimi
B) poliomieliti.
C) tetanozi.
D) difteria.
E) meningiti.
PS)C

Pyetja 314 V)2

Cila prej gjendjeve karakterizohet nga rritja e bilirubinës indirekte dhe direkte, urobilinurisë dhe feçe hipo/normokromike?

A) Ikteri Gilbert
B) S. Dubin-Johnson
C) Ikteri nga hepatiti akut
D) S. Rotorit
E) Ikteri hemoliktik
PS)C

Pyetja 315 V)3

Shfaqja histologjike e tumorit spino-qelizor është më e shpeshtë te:

A) Ca sferike periferike.
B) Ca infiltruese e ileusit

C) Kanceri lobar
D) Kanceri apikal
E) Metastazat pulmonare
PS)B

Pyetja 316 V)1

Nuk është simptomë e dehidrimit hipertonik:

A) apatia.
B) etja.
C) rritja e presionit arterial.
D) të vjellat.
E) takikardia.
PS)C

Pyetja 317 V)1

Acidi vanilmandelik është produkt i cilit prej hormoneve të mëposhtëm?

A) Noradrenalina
B) 5-hidroksitriptamina
C) Testosteroni
D) Hidrokortizoni
E) Aldosteroni
PS)A

Pyetja 318 V)1

Embolia pulmonare zhvillohet më shpesh:

A) nga kavitetet kardiake të djathta.
B) nga venat pelvike.
C) nga venat sipërfaqësore të gjymtyrëve inferiore.
D) nga venat e thella të këmbës.
E) nga venat e gjymtyrëve të sipërme.
PS)D

Pyetja 319 V)1

Në hipertensionin portal, hemorragjia që shfaqet më shpesh është:

A) hemoptoe.
B) epistaksi.
C) hematuri.
D) hematemeza.
E) menorragjia.

PS)D

Pyetja 320 V)1

Në cilën prej gjendjeve shfaqet shpesh makroglosia?

A) S. Cushing
B) anemia pernicioze
C) miksedema
D) panhipopituitarizëm
E) neoplazi e tiroides
PS)C

Pyetja 321 V)1

Në cilën prej litiazave janë karakteristike shfaqja e dhembjes në hypokondrin e djathtë, ikteri, temperatura (septike)?

A) Renale
B) Duktusit kistik
C) Kolecistës
D) Koledokut
E) Duktusit të Wirsung
PS)D

Pyetja 322 V)1

Çfarë ndodh në rastin e pankreatitit akut?

A) ulet amilazemia
B) amilazemia është normale
C) rritet amilazemia
D) ulet lipazemia
E) hiperkalcemi
PS)C

Pyetja 323 V)1

Shkaku më i shpeshtë i Cor pulmonar akut është:

A) pneumonia lobare.
B) infarkti murit posterior të miokardit.
C) gjendja astmatike.
D) infarkti i murit anterior të miokardit.
E) embolia pulmonare.
PS)E

Pyetja 324 V)1

Testi direkt i Coombsit përdoret për të:

A) vlerësuar nivelin e IgE.
B) matur sasi shumë të vogla të poleneve.
C) evidentuar antitrupat që kanë aderuar eritrocitet.
D) përcaktuar fenotipin qelizor.
E) evidentuar antitrupat anti-trombocite.
PS)C

Pyetja 325 V)1

Vërehet në sindromën hepato-renale:

A) rritja e ekskretimit të Na-së në urinë.
B) hipernatremi.
C) ascit refraktar.
D) poliuria.
E) hipoglicemi.
PS)C

Pyetja 326 V)2

Në cilën prej gjendjeve nuk ka ulje të nivelit të vit. K?

A) Hipertensioni arterial
B) Hepatokolangiti
C) Fistula biliare
D) Celiakia
E) Ikteri nga okluzioni
PS)A

Pyetja 327 V)2

Tromboflebiti rezistent ndaj antikoagulantëve të sugjeron për:

A) kolecistit akut .
B) ulçer të perforuar.
C) Ca e pankreasit.
D) gastrit akut.
E) cirrozë biliare.
PS)C

Pyetja 328 V)1

Në acidozën metabolike, si është përqëndrimi i bikarbonateve?

A) i rritur
B) i pandryshuar
C) i pa ndryshuar dhe me hiponatremi
D) i zvogëluar
E) i pa ndryshuar dhe me hipokaliemi
PS)D

Pyetja 329 V)1

Cila nga situatat e mëposhtme nuk ndodh në koagulimin intravaskular të diseminuar (KID) ?

A) zgjatet koha e protrombinës
B) zgjatet koha e hemorragjisë
C) retraksioni i vonuar i koagulit
D) konsumimi i protrombinës
E) fibrinogjeni i rritur
PS)E

Pyetja 330 V)2

Tek një pacient me dermatomiozit duhet të dyshohet për:

A) neoplazi okulte.
B) hipertension arterial
C) veset kardiake
D) inflamacion i rrugëve ajrore të sipërme
E) infeksion mykotik
PS)A

Pyetja 331 V)1

Kromozomi Philadelphia është karakteristik për:

A) aneminë ferriprive
B) leuceminë me qeliza me qime
C) policitemia vera
D) leucemia limfatike kronike
E) leucemia mieloide kronike.
PS)E

Pyetja 332 V)1

Virilizimi ndodh në cilën prej gjendjeve të mëposhtme?

A) hiperplazia e surrenales
B) miksedema

C) hipopituitarizmi
D) hipertireozë
E) Sindroma e Turner-it
PS)A

Pyetja 333 V)1

Në cilin nga rastet FV (fremitusi vocal) nuk është i ulur ?

A) infarkti i pulmonit
B) diafragma kongenitale e laringut
C) emfizema pulmonare
D) pleuriti eksudativ
E) hidrotoraksi
PS)A

Pyetja 334 V)1

Cila prej gjendjeve të mëposhtme favorizon më shumë formimin e ulçerës peptike ezofageale?

A) anemia ferriprive
B) variçet e ezofagut
C) akalazia
D) neoplazia e ezofagut
E) refluksi gastro-ezofageal
PS)E

Pyetja 335 V)1

Ka vlerë të rëndësishme diagnostikuese në rastin e abdomenit akut:

A) pulsimi i aortës abdominale.
B) reagimi mbrojtës gjatë palpimit të abdomenit.
C) pareti abdominal i dhimbshëm.
D) takipnea.
E) takikardi dhe dhimbje abdominale e përhapur.
PS)B

Pyetja 336 V)1

Pankreatiti akut shfaqet më shpesh tek personat:

A) < 45 vjeç.
B) me kolon të irritueshëm.
C) me intolerancë ndaj laktozës.
D) me kolelitiazë.
E) me M. Crohn.

PS)D

Pyetja 337 V)2

Cila prej patologjive të mëposhtme shoqërohet me hipergamaglobulinemi?

A) Djegiet e mëdha
B) Plazmocitoma
C) Cirroza hepatike
D) Sindroma nefrotike
E) Tireotoksikoza
PS)B

Pyetja 338 V)2

Në cilën prej gjendjeve vërehet cianoza me origjinë hematologjike?

A) sarkoidoza
B) anemia pernicioze
C) policitemia vera
D) emfizema pulmonare
E) sëmundja e Pickwick
PS)C

Pyetja 339 V)1

Komplekset imune që shkaktojnë lezione renale janë:

A) të patretshme.
B) me dominim të lehtë të antigeneve.
C) me prevalencë të antigeneve.
D) me prevalencë të antitrupave.
E) pak aftësi inflamatore.
PS)B

Pyetja 340 V)1

Edema angioneurotike shkaktohet nga:

A) alterime të pareteve kapilare.
B) rritja e presionit venoz.
C) ulja e presionit onkotik.
D) alterimi i metabolizmit hormonal.
E) alterimi i metabolizmit hidro-elektrolitik.
PS)A

Pyetja 341 V)2

Tipi më i shpeshtë i karcinomës infiltruese të mamelës është:

A) lobulare in situ.
B) duktale cirrotike (konsistencë e fortë).
C) medulare.
D) mukinoze.
E) lobulare infiltruese.
PS)B

Pyetja 342 V)1

Cili ekzaminim është më i përshtatshëm për të diagnostikuar sindromen hemofilike?

A) koha e protrombinës
B) koha e tromboplastinës parciale
C) koha e koagulimit
D) prova e llastikut
E) koha e rrjedhjes
PS)B

Pyetja 343 V)1

Glositi atrofik i Hunterit shfaqet në:

A) defiçitin e niacinës.
B) ariboflavinozën.
C) defiçitin e hekurit.
D) skarlatinë.
E) defiçitin i vit. B12
PS)E

Pyetja 344 V)2

Vala P e ndjekur nga kompleksi ventrikular me raportin 2:1; 3:1 etj është tregues i:

A) bllokut AV i gradës I.
B) bllokut AV i gradës III .
C) bllokut AV i gradës II.
D) hapëshënuesit i Pacemaker.
E) aritmi sinusale.
PS)C

Pyetja 345 V)1

Cila është vlera normale e pH në gjak?

A) 7,40 ± 0,02
B) 7,60 ± 0,02
C) 7.20 ± 0,02
D) 7,00 ± 0,02
E) 6,80 ± 0,02
PS)A

Pyetja 346 V)2

Midriaza evidentohet përgjithësisht në komën:

A) hipoglicemike.
B) hiperglicemike.
C) nga insufiçenca renale akute.
D) uremike.
E) miksedematoze.
PS)A

Pyetja 347 V)2

Në cilën prej gjendjeve shfaqet linja Ellis-Damoiseau?

A) hidropneumototaksi
B) pneumotoraksi
C) perikarditi
D) pleuriti eksudativ
E) pneumonia lobare
PS)D

Pyetja 348 V)1

Në cilën situatë shfaqet pulsi i shpejtë?

A) hipovolemi
B) infarkti i miokardit
C) shoku
D) perikarditi konstriktiv
E) tireoksikoza
PS)E

Pyetja 349 V)1

Cili prej alterimeve hematokimike ka vlerë prognostike në pankreatitin akut?

A) hiperkaliemia
B) hiperamilazemia

C) hipokalcemia
D) hiperinsulinemia
E) hiperglukagonemia
PS)C

Pyetja 350 V)2

Antitrupat antinuklearë (ANA) te skleroza sistemike progresive kanë në imunofluoreshencë aspekt te tille:

A) Homogjen
B) Periferik
C) Me pika (speckled)
D) Nukleolar
E) Jo homogjen
PS)C

Pyetja 351 V)3

Në sëmundjen e celiakisë ka efekt terapeutik:

A) dieta pa drithëra.
B) dieta pa oriz, grurë.
C) kortizoni.
D) laksativët.
E) anti-inflamatorët jo steroid.
PS)A

Pyetja 352 V)1

Nuk është simptomë e hipoglicemisë nga hiperinsulinemia:

A) takikardia dhe djersitja e ftohtë.
B) përgjumja.
C) tetania.
D) vertigo dhe diplopia.
E) konvulsionet.
PS)C

Pyetja 353 V)2

Puberteti i parakohshëm tek meshkujt mund të shkaktohet nga:

A) S. Laurence-Moon-Biedl
B) pinealoma.
C) miotonia distrofike.
D) S. Cushing.

E) S. West
PS)B

Pyetja 354 V)1

Çfarë është tragusi?

A) strukturë e veshit të brendshëm
B) strukturë e veshit të mesëm
C) strukturë e llapës së veshit (helix)
D) muskul intrinsek i laringut
E) një receptor i retinës
PS)C

Pyetja 355 V)2

Kur evidentohet porfiria (porphyria)?

A) uremi akute
B) hipotiroidizëm
C) intoksikim nga Plumbi
D) poliarteriti kronik primar
E) mieloma multiple
PS)C

Pyetja 356 V)2

Cila prej simptomave nuk paraqitet tek insufiçenca e aortës?

A) zbehja
B) rritja e diferencës së presionit arterial
C) puls që përhapet ngadalë
D) Pulsimi i arterieve
E) zhurmat e Flint-it
PS)C

Pyetja 357 V)3

Karcinoma gastrike prodhon metastaza të tipit 'tumori i Krukenberg' në:

A) ovare.
B) tru.
C) gjendra mbiveshkore.
D) mushkëri.
E) limfonodujt supraklavikularë
PS)A

Pyetja 358 V)2

Në cilën prej situatave nuk evidentohet pulsi i shpejtë?

A) duktusi Botall i hapur
B) hipertiroidizmi
C) stenoza e aortës
D) aneurizma të mëdha arterio-venoze
E) gjendje me temperaturë të lartë
PS)C

Pyetja 359 V)1

Feçet e ujshme janë karakteristikë e:

A) kolitit ulçeroz.
B) kolerës.
C) M. Crohn
D) Intoleranca nga laktoza (sprue)
E) e apendisitit akut
PS)B

Pyetja 360 V)1

Nuk është komplikacion i ulçerës gastrike kronike:

A) stomaku i stenozuar si klesidër (si ora me rërë).
B) hemorragjia.
C) degjenerimi malinj.
D) anemia pernicioze.
E) perforimi.
PS)D

Pyetja 361 V)1

Alkaloza metabolike e shoqëruar me të vjella të zgjatura shkaktohet nga humbja e:

A) natriumit.
B) kaliumit.
C) klorit.
D) bikarbonateve.
E) magnezit.
PS)C

Pyetja 362 V)2

Në cilën nga situatat, edema shkaktohet kryesisht nga ulja e presionit onkotik?

A) staza venoze
B) insufiçenca kardiake
C) cirroza hepatike
D) miksedema
E) edema e Quincke-s
PS)C

Pyetja 363 V)1

Në cilën prej patologjive evidentohet shpesh eritema palmare?

A) M. Adison
B) infarkti i miokardit
C) endokarditi
D) cirroza hepatike
E) uremia kronike
PS)D

Pyetja 364 V)1

Cili prej parazitëve nuk prek heparin?

A) Echinococcus
B) Trichinella spiralis
C) Fasciola e heparit
D) Schistosoma mansoni
E) Tripanosoma cruzii
PS)B

Pyetja 365 V)2

Në hepatitin akut fulminant vërehet ulja e:

A) amoniemisë.
B) bilirubinemisë totale.
C) urobilirubinurisë.
D) Gama-glutamiltranspeptidazës
E) protrombinemisë.
PS)E

Pyetja 366 V)2

Kliku mezosistolik është karakteristik i:

A) stenozës së aortës.
B) DIA (difekti i septumit interatrial).

C) insufiçenca trikuspidale.
D) tetralogjia e Fallot
E) prolapsit të mitrales.
PS)E

Pyetja 367 V)2

Xantomatoza palmare është aspekt që haset më shpesh te hiperlipoproteinemia e:

A) tipi 1° i klasifikimit të Frederickson
B) tipi 2° i klasifikimit të Frederickson
C) tipi 3° i klasifikimit të Frederickson
D) tipi 4° i klasifikimit të Frederickson
E) tipi 5 ° i klasifikimit të Frederickson
PS)C

Pyetja 368 V)3

Në sindromin Carcinoid ndodh:

A) rritje e prodhimit të acidit fenilpiruvik.
B) rritje e prodhimit të acidit vanil-mandelik.
C) rritje e prodhimit të acidit 5 hidroksindolacetik.
D) rritje e prodhimit të të tre metabolitëve.
E) ulje e prodhimit të të tre metabolitëve.
PS)C

Pyetja 369 V)2

Cila prej simptomave nuk është e pranishme në sindromën hemolitike-uremike?

A) trombocitopenia
B) oliguria, anuria
C) koagulimi intravaskular
D) produktet e e degradimit të fibrinës në plazëm
E) trombocitoza
PS)E

Pyetja 370 V)1

Cili prej medikamenteve vepron duke inhibuar enzimën e konversionit të reninë-angiotenzinës?

A) kaptoprili
B) alfa metildopa
C) propanololi
D) guanetidina

E) hidralazina
PS)A

Pyetja 371 V)2

Shfaqja limfoglandulare është tipike e toksoplazmës

A) kongenitale.
B) së fituar.
C) e të dy formave.
D) rrallë herë e kongenitales.
E) rrallë here e formës së fituar.
PS)B

Pyetja 372 V)2

Në cilën prej situatave evidentohen sasi të konsiderueshme të cilindrave me aspekt granular?

A) sindroma nefrotike
B) uretriti akut
C) litiaza e vezikës
D) glomerulonefriti akut
E) glomerulonefriti kronik
PS)A

Pyetja 373 V)2

Imazhi radiologjik i veshkës së vogël evidentohen te

A) glomerulonefriti kronik.
B) sindroma nefrotike.
C) nefropatia polikistike.
D) hidronefroza.
E) hipernefroma.
PS)A

Pyetja 374 V)2

Tek pacienti me hiperkortizolizëm nuk evidentohet

A) shërimi me vonesë i plagëve.
B) ekimoza nga vazat delikate.
C) tromboflebiti përsëritës.
D) rrisk i rritur për infeksione.
E) vonesa në ngjitjen e frakturave
PS)C

Pyetja 375 V)1

Është karakteristike e zhurmës sistolike nga regurgitimi

A) konfigurimi në formën e diamantit.
B) fillimi me tonin e parë.
C) e tipit rritës-zbritës.
D) mezosistolik.
E) fillimi pas tonit të parë.
PS)B

Pyetja 376 V)2

Cila prej sëmundjeve zakonisht nuk shoqërohet nga mungesa e oreksit?

A) insufiçenca renale kronike e përparuar
B) adenoma e ishujve të Langerhansit në pankreas
C) M. Adison
D) Gastriti kronik
E) Tuberkulozi
PS)B

Pyetja 377 V)1

Zakonisht në cilën nga situatat shfaqet tremori në qetësi, bradikinezia dhe ngurtësimi (rigiditeti) muskular?

A) M. Sturge-weber
B) S. Parkinson
C) skleroza laterale amiotrofike
D) siringomielia
E) skleroza multiple
PS)B

Pyetja 378 V)1

Në hiperaldosteronizmin primar karakteristika klinike më konstante ndër tyre është:

A) arefleksia.
B) kriza tetanike.
C) aritmitë kardiake.
D) hipertensioni arterial.
E) paraliza periodike.
PS)D

Pyetja 379 V)1

Cili është agjenti etiologjik i mykut të gojës?

A) Candida albicans
B) Histoplasma capsulatum
C) Blastomyces dermatidis
D) Cryptococcus neoformans
E) Trichophyton metagrophytes
PS)A

Pyetja 380 V)1

Nuk është kriter për diagnozën e artritit reumatoid:

A) ngurtësia artikulare e mëngjesit.
B) eritema nodoze.
C) prekja në mënyrë simetrike e artikulacioneve.
D) prania e faktorit reumatoid në serum.
E) Artrit i artikulacioneve të dorës.
PS)B

Pyetja 381 V)1

Pankreatiti akut nuk mund të shkaktohet nga:

A) etanoli.
B) hiperglicemia.
C) vakt i pasur me yndyrna.
D) kolika biliare.
E) medikamente
PS)B

Pyetja 382 V)1

Në cilin nga nga organet e mëposhtëm nuk lokalizohet M. Crohn ?

A) pankreasi
B) ezofagu
C) stomaku
D) rektumi
E) apendisiti
PS)A

Pyetja 383 V)2

Për cilin dëmtim funksional bëhet fjalë nëse kemi 80% të vlerës normale të kapacitetit vital dhe 50% të VEMS?

A) funksioni pulmonar normal lidhur me moshën geriartrike
B) dëmtim i ventilimit te tipit obstruktiv
C) dëmtim i ventilimit te tipit restriktiv
D) dëmtim i kombinuar restriktiv e obstruktiv
E) dëmtim i difuzionit alveolar
PS)B

Pyetja 384 V)3

Në cilën nga situatat evidentohet rritja kryesisht bilaterale e hijeve hilare, shoqëruar me lezione pulmonare simetrike?

A) tuberkuloza pulmunare primare
B) sarkoidoza
C) M. Hodgkin
D) Neoplazia bronkiale
E) Echinococcosa pulmunare
PS)B

Pyetja 385 V)2

Në cilën prej situatave prova Romberg rezulton pozitive si me sytë e mbyllur dhe të hapur?

A) adiadokinezia
B) strabizmi
C) ataksia cerebelare
D) ataksia tabetike (tabis dorsalis)
E) polineuriti
PS)C

Pyetja 386 V)1

Në cilën nga situatat është karakteristike antitrupi antimitokondrial?

A) cirroza biliare primitive
B) ikteri nga medikamentet
C) hepatiti kronik aktiv
D) ikteri okluziv
E) hepatopatia alkolike
PS)A

Pyetja 387 V)2

Cili është testi i zgjedhur për të diagnostikuar dermatomiozitin?

A) Antitrupat antinuklearë
B) Elektromiografia

C) PCR
D) Biopsia muskulo-kutane
E) Xiloksemia
PS)D

Pyetja 388 V)2

Imunokomplekset antigen-antitrup depozitohen lehtësisht në:

A) mukozën gastrike.
B) vezikë.
C) limfonodula.
D) glomerulën renale
E) Lien
PS)D

Pyetja 389 V)2

Cila nga zonat nuk pigmentohet nga hiperkarotenemia?

A) sklerat
B) fytyra
C) palmat e duarve
D) shputa e këmbëve
E) sipërfaqja e brendshme e gjymtyrëve
PS)A

Pyetja 390 V)2

Në cilën prej gjendjeve evidentohet Hipolipemia ?

A) sindroma nefrotike
B) hipertiroidizmi
C) hipotiroidizmi
D) diabeti Mellitus i dizekuilibruar
E) kolestaza
PS)B

Pyetja 391 V)1

Në cilën fazë evidentohet toni i IV kardiak ?

A) mezodiastolik
B) protodiastolik
C) telediastolik
D) telesistola
E) mezosistola

PS)C

Pyetja 392 V)1

Në cilën nga patologjitë shfaqet më shpesh zgjatja e P-R në EKG?

A) manifestimet akute të artritit reumatoid
B) osteoartroza ankilopoetike
C) ataku akut i gutës
D) manifestimet akute të sëmundjes reumatike
E) artriti akut gonocoksik
PS)D

Pyetja 393 V)2

Lezioni i kiazmës optike shkakton:

A) hemianopsi laterale omonime.
B) amaurozë omolaterale.
C) vizion makular.
D) hemianopsi bitemporale.
E) skotoma hemianopsike kontrolaterale omonime.
PS)D

Pyetja 394 V)1

Hiperventilimi alveolar shkaktohet nga:

A) obstruksioni i rrugëve ajrore
B) paraliza e qëndrave respiratore
C) acidoza metabolike
D) astma bronkiale
E) S. Pickwick
PS)C

Pyetja 395 V)1

Alkaloza respiratore shkaktohet më shpesh nga:

A) rritja e frekuencës respiratore.
B) ngadalësimi i fluksit ajror respirator.
C) ngadalësimi i difuzionit të gazeve në nivelin alveolar.
D) hipopnea nga insufiçenca muskulare/
E) Hipopnea nga inhibimi i qëndrave respiratore
PS)A

Pyetja 396 V)1

Erisipela është infeksion me natyrë:

A) virale.
B) dizmetabolike.
C) tuberkulare.
D) streptokoksike.
E) traumatike.
PS)D

Pyetja 397 V)2
Nodujt e Heberdenit hasen në:

A) artrozë.
B) artritin rheumatoid.
C) panarteritin nodoz.
D) reumatizmën artikulare acute.
E) Gutë.
PS)A

Pyetja 398 V)2

Midis simptomave të sindromit mediastinik shfaqet vonë në kohë:

A) disfagia.
B) dispnea.
C) kolla.
D) lemza.
E) fryrja e venave.
PS)A

Pyetja 399 V)3

Alopurinoli, përveç uljes së acidit urik në gjak (duke inhibuar enzimën e xantin-oksidazën)

A) ka edhe veprim urikozurik.
B) inhibon edhe kemiotazën e shtuar të leukociteve gjatë gutës .
C) inhibon edhe sintezën e purinave endogjene.
D) inhibon precipitimin e acidit urik në artikulacione
E) favorizon edhe ekskretimin e purinave ekzogjene.
PS)C

Pyetja 400 V)2

Cili prej testeve është i dobishëm në diagnozën e celiakisë?

A) ekzaminimi mikroskopik i feçeve (ngjyrosja me sudan IV)

B) prova e ngarkesës orale me Xilol
C) karotinemia
D) vlerësimi kimik i yndyrnave në feçe
E) biopsia e mukozës së jejunumit
PS)E

Pyetja 401 V)1

Cili prej faktorëve nuk shkakton edema?

A) ulja e presionit hidrostatik
B) përthithja natriumit e ujit
C) rritja e përshkueshmërisë kapilare
D) ulja e presionit onkotik
E) bllokimi drenazhit limfatik
PS)A

Pyetja 402 V)1

Shkaku më i shpeshtë i aneurizmës se aortës deshendente është:

A) kongenitale.
B) arterioskleroza.
C) sifilizi.
D) medio-nekroza kistike
E) tuberkuloza
PS)B

Pyetja 403 V)2

Tek një pacient me diarre dhe kriza të skuqjes në fytyrë, trung e gjymtyrë, mund të diagnostikohet :

A) sindromë nga karcinoidi.
B) rektokoliti ulçeroz.
C) Enteropatia me humbje të proteinave.
D) Fistula gastrokolike.
E) Fistula gastro-jejunum.
PS)A

Pyetja 404 V)1

Cila prej patologjive nuk komplikon klinikën e parotidit (shytat)?

A) orkiti
B) artriti simetrik
C) pankreatiti

D) meningiti aseptik
E) encefaliti
PS)B

Pyetja 405 V)2

Si përcaktohet zhurma e Graham-Steel?

A) sistolik pulmonar
B) diastolik nga stenoza mitrale
C) diastolik nga insufiçenca pulmonare sekondare
D) sistolik nga stenoza e aortës
E) pre-sistolik nga insufiçenca e aortës
PS)C

Pyetja 406 V)1

Në insufiçencën renale kronike ka:

A) poliuri
B) oliguri
C) anuri
D) urinim i shpeshtë
E) diurezë normale
PS)A

Pyetja 407 V)2

Carcinoidi nuk prodhon njërin prej elementëve të mëposhtëm. Cilin?

A) serotoninën
B) adrenalinën
C) histaminën
D) bradikininën
E) ACTH
PS)B

Pyetja 408 V)1

Cila prej situatave shoqërohet me rritje të kohës së protrombinës?

A) fibrinoliza
B) spondiloartroza
C) hipernatremia
D) koagulimi intravaskular i diseminuar (KID)
E) hipokloremia
PS)D

Pyetja 409 V)2

Ulçerat intestinale si BUTONAT E KËMISHËS janë karakteristike e:

A) kolitit pseudomembranoz.
B) kolerës.
C) amebiazës.
D) kolitit ulçeroz.
E) botulizmit.
PS)C

Pyetja 410 V)2

Cilat janë simptomat që të drejtojnë drejt leuçemisë akute limfatike dhe mieloide?

A) pruriti, dhimbja pas përdorimit të alkoolit dhe splenomegalia
B) zbehje, predispozitë për hemorragji dhe infeksione
C) anemi me sideremi të ulur
D) teleangjektazi, predispozitë për hemorragji dhe familjaritet
E) hepatosplenomegali
PS)B

Pyetja 411 V)1

Nuk është komplikancë e akalazisë ezofageale:

A) ezofagiti
B) Artriti
C) Hemorragjia
D) Infeksioni pulmunar
E) Degjenerimi malinj
PS)B

Pyetja 412 V)2

Në temperaturën tifoide, hemokultura është pozitive:

A) në javën e parë
B) në javën e dytë
C) në javën e tretë
D) në tri javët e para.
E) asnjëherë.
PS)A

Pyetja 413 V)1

Cili nga tumoret malinje ka incidencë të lartë tek të rinjtë?

A) Plazmocitoma
B) Carcinoma e stomakut
C) Sarkoma e Ewing
D) Karcinoma e prostatës
E) Leuçemia limfoide kronike
PS)C

Pyetja 414 V)2

Në cilën situatë mund të haset përgjithësisht një formacion homogjen difuz i tiroides?

A) M. Basedow
B) Struma koloidokistike
C) Adenoma kistike
D) Carcinoma e tiroides
E) Adenoma jo radiokaptuese
PS)A

Pyetja 415 V)1

Edema e Quincke është një:

A) edemë palpebrale nga sindroma nefrozike.
B) edemë maleolare me çrregullime trofike (të ushqyerjes).
C) edemë palpebrale nga dermatomioziti.
D) edemë e submukozës nga reaksioni alergjik ose pseudoalergjik.
E) edemë pretibiale nga tireoksikoza.
PS)D

Pyetja 416 V)2

Rotacioni lateral i kokës shkakton zhdukjen e pulsit radial homolateral në:

A) sindromën e vjedhjes së suklavias.
B) stenozën e istmusit të aortës.
C) stenozën e karotides omolaterale.
D) stenozën e a. vertebrale omolaterale
E) sindromën e 'ngushticës' torakale (thoracic outlet syndrome)
PS)E

Pyetja 417 V)1

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme është tipike shenja e Courvoisier dhe Terrier (tumefacion i palpueshëm i kolecistës në prani të ikerit obstruktiv)?

A) hidropi i kolecistës
B) kalkuloza e koledokut
C) kolelitiaza
D) Neoplazia e kokës së pankreasit
E) Neoplazia gastrike
PS)D

Pyetja 418 V)2

Në cilën nga situatat vërehet në mënyrë konstante rritja e transaminazave, lakatatdehidrogjenazës dhe kreatin-fosfokinazës?

A) hepatiti akut
B) hemoglobinuria parosistike
C) porfiria akute
D) sindroma post përplasje (rabdomioliza post-traumatike)
E) alkaptonuria
PS)D

Pyetja 419 V)1

Bakteruria konsiderohet pozitive për një sepsi urinare kur përqëndrimi i baktereve në urinë është:

A) > 10.000/mmc.
B) > 1.000/mmc.
C) > 50.000/mmc.
D) > 100.000/mmc.
E) > 150.000/mmc.
PS)D

Pyetja 420 V)2

Diagnoza diferenciale midis plazmocitomës dhe makroglobulinemisë nuk përcaktohet në mënyrë të qartë nga imunoelektroforeza ose imunofiksimi. Cili ekzaminim plotësues është i nevojshëm?

A) testi i Shilling-ut
B) përcaktimi i fosfatazës alkaline leukocitare
C) biopsia e palcës së kurrizit (Mielograma)
D) identifikimi i kromozomit Philadelphia
E) ekzaminimi i gjakut periferik
PS)C

Pyetja 421 V)2

Cili prej kemioterapeutëve mund të shkaktojë dëmtim të miokardit ?

A) Vincristina
B) Metotrexati
C) 5FU
D) Tamoxifeni
E) Adriamicina
PS)E

Pyetja 422 V)1

Në hipernefromën është e shpeshtë:

A) anemia ferriprive.
B) anemia hemolitike.
C) poliglobulia.
D) anemia nga eritropojeza e reduktuar.
E) eozinofilia
PS)C

Pyetja 423 V)2

Cili test është i nevojshëm për sarkoidozën?

A) testi i Nelson-it.
B) Testi i Lepremin-it.
C) Testi i Tzanck-ut.
D) Testi i Kveim-it.
E) Testi i Frey-t.
PS)D

Pyetja 424 V)1

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme ka poliglobuli?

A) hipertensioni arterial sistemik
B) mbingarkesa e ventrikulit të majtë
C) infarkti i miokardit
D) Cor pulmunar kronik
E) Miokardioskleroza koronarike
PS)D

Pyetja 425 V)2

Çfarë është karakteristike për sëmundjen e Von Willebrand?

A) cianoza
B) shkurtimi i kohës së hemorragjisë

C) trombocitopatia
D) trombocitopenia
E) rritja e faktorit VIII të koagulimit
PS)C

Pyetja 426 V)1

Cila nga alterimet e mëposhtme karakterizon palcën kurrizore të pacientëve me anemi hemolitike?

A) rritja e eritroblasteve
B) rritja e megakariociteve
C) ulja e limfociteve
D) ulja e qelizave plazmatike
E) prania e elementëve neoplazik
PS)A

Pyetja 427 V)1

Cili është pozicionimi i zakonshëm që bën një pacient me versament të likidit pleural në sasi të konsiderueshme?

A) indiferent
B) lateral nga ana e shëndetshme
C) shtrirë përmbys
D) ortopnoik
E) lateral nga ana e sëmurë
PS)E

Pyetja 428 V)1

Cili nga parametrat laboratorikë reduktohet në rastin e anemisë ferriprive?

A) bilirubinemia
B) ferritinemia
C) retikulociti
D) trombocitet
E) rezistenca globulare
PS)B

Pyetja 429 V)2

Cila nga metodikat është më sensibël për diagnostikim e embolisë pulmunare?

A) Shintigrafia pulmunare
B) Dozimi i enzimave në gjak
C) EKG

D) Spirometria
E) Rx toraksi
PS)A

Pyetja 430 V)2

Në pjesën më të madhe të rasteve me miksedemë tek adultët evidentohet:

A) Hipodizproteinemia
B) Ulja e kolesterolit
C) Rritja e kolesterolit
D) Rritja e uresë në plazëm
E) Ulja e uresë në plazëm
PS)C

Pyetja 431 V)2

Nëse likidi cerebro-spinale ka përqëndrim proteinik me 35 mg/dl, mund të themi se i përket një:

A) pacienti me meningit viral.
B) pacienti me meningit tuberkular
C) pacienti me meningit meningokoksik
D) individi të shëndetshëm
E) pacienti me trauma kraniale
PS)D

Pyetja 432 V)2

Pacientët me mielomë multiple të tipit IgG kanë tendencë të zhvillojnë infeksione bakteriale dhe shkaku kryesor është:

A) mungesa e IgH.
B) mungesa e IgA.
C) humbja e aftësisë për të zhvilluar përgjigje imune të tipit IgG.
D) prodhimi i pamjaftueshëm i interferonit.
E) rritja e aktivitetit hemolitik total nga ana e komplementit
PS)C

Pyetja 433 V)1

Cila prej situatave të mëposhtme shkakton më shpesh hemorragji gastro-intestinale?

A) variçet ezofageale
B) ulçera e duodenit
C) gastriti erroziv
D) ulçera gastrike

E) gastriti atrofik
PS)B

Pyetja 434 V)1

Cila është shenja klinike e mungesës së vit. A?

A) hemeralopia (humbja e vizusit krepuskolar)
B) rakitizmi
C) osteomalacia
D) stomatiti
E) pelagra
PS)A

Pyetja 435 V)2

Trupat Auer gjenden në:

A) leuceminë limfatike kronike.
B) leuceminë mieloide kronike.
C) leuceminë mieloblastike
D) leuceminë monocitike
E) leuceminë eozinofile
PS)C

Pyetja 436 V)1

Cili prej aspekteve fizikë nuk shfaqet tek emfizema pulmunare obstruktive?

A) zvogëlimi i hapësirave interkostale në Rx
B) tingulli hiperfonetik në perkusion
C) zvogëlim i murmurit vezikal
D) brinjët marrin pozicion horizontal
E) diafragma e sheshuar poshtë e palëvizshme gjatë respirimit
PS)A

Pyetja 437 V)1

Cili nga medikamentet e mëposhtëm nuk përdoret për trajtimin e hipertensionit kronik?

A) nitroglicerina
B) klortiazidi
C) metoprololi
D) klonidina
E) metildopa
PS)A

Pyetja 438 V)2

Në urinëne 24 orëve janë rritur katekolaminat si pasojë e:

A) hipertensionit renal.
B) stenozës së istmusit të aortës.
C) feokromocitomës
D) terapisë me mineralokortokoide
E) hipernefromës
PS)C

Pyetja 439 V)1

Në reumatizmin artikular akut, profilaksia e recidivave bëhet me:

A) preparate me bazë të kripërave të arit.
B) penicilinës.
C) fenilbutazonit.
D) kortikosteroidet.
E) streptomicinës.
PS)B

Pyetja 440 V)1

Cila është shfaqja më pak e shpeshtë në LES?

A) fotosensibiliteti
B) artralgjia/Mialgjia
C) anemia
D) rashi
E) fibrilacioni atrial paroksistik
PS)E

Pyetja 441 V)2

Pacientët me retinopati diabetike mund të humbin papritur e përkohësisht shikimin nga:

A) glaukoma
B) katarakta
C) hemorragjia e lëngut kristalor
D) iridocikliti
E) mikroaneurizma
PS)C

Pyetja 442 V)1

Në koagulopatinë intravaskulare të diseminuar (KID) vërehet:

A) rritje e trombociteve.
B) ulja e fibrinogjenit.
C) koha e protrombinës normale.
D) aktiviteti fibrinolitik i reduktuar.
E) D-dimeri negativ.
PS)B

Pyetja 443 V)2

Në cilën prej situatave mund të verifikohet hipoventilim alveolar?

A) acidoza metabolike
B) S. Pickëick
C) hipoksia në inde
D) anemia
E) helmimi nga CO
PS)B

Pyetja 444 V)2

Në cilën prej gjendjeve vërehet oliguri dhe urinë me peshë specifike të lartë?

A) insufiçencë kardiake
B) diabeti mellitus
C) insufiçenca renale kronike
D) diabeti insipidus
E) pielonefriti kronik
PS)A

Pyetja 445 V)1

Cili nga parametrat e mëposhtëm nuk rritet në infarktin e miokardit?

A) LDH
B) CPK
C) CK-MB
D) GOT, GPT
E) Fosfataza Alkaline
PS)E

Pyetja 446 V)2

Insufiçenca surrenale akute (sindroma e Waterhouse-Friderichsen) mund të shfaqet gjatë një:

A) hepatiti akut.
B) uremie kronike.

C) glomerulonefriti akut.
D) koliti ulçeroz.
E) infeksioni meningokoksik.
PS)E

Pyetja 447 V)3

Purpura trombotike trombocitopenike (S. Moschowitz) shkakton:

A) insufiçencë renale.
B) sindromë nefrozike.
C) tubulonefrozë
D) glomerulosklerozë
E) infarkt renal të gjerë
PS)A

Pyetja 448 V)1

Nuk është shenjë për një pacient me stenozë mitrale:

A) hemoptizia.
B) dispnea në sforco (dhe minimale).
C) tonet kardiake të theksuara.
D) hipertrofia e ventrikulit të majtë.
E) cianoza labiale.
PS)D

Pyetja 449 V)2

Cilin prej kampioneve të mëposhtme duhet të ekzaminojmë me teknika imunologjike në rastin e një mielome të mundshme?

A) likidin sinovial
B) pështymën
C) gjakun
D) lëngun gastrik
E) sekrecionet konjuktivale
PS)C

Pyetja 450 V)1

Cila prej simptomave nuk vërehet në hipotiroidizmin primitiv?

A) alterime psikike dhe apatia
B) enjtja subcutis e fytyrës
C) stipsi
D) teleangetaksia

E) lëkura e thatë dhe e plasaritur
PS)D

Pyetja 451 V)1

Dhimbja anginoze në mënyrë tipike lokalizohet në:

A) hemitoraksin e djathtë.
B) mezogastër.
C) retrosternale.
D) kuadratin abdominal iliak të majtë.
E) zonën lombo-sakrale
PS)C

Pyetja 452 V)2

Në cilën prej situatave rritet fosfataza acide në gjak?

A) osteomalacia
B) ikteri obstruktiv
C) karcinoma e prostatës
D) sarkoidoza
E) neoplazi të heparit
PS)C

Pyetja 453 V)2

Për diagnozën e akromegalisë, cili prej ekzaminimeve është më i vlershëm?

A) zgjerimi i selës turcike në Rx e kokës.
B) rritja e perimetrit të kokës
C) testi me tolbutamid
D) pamundësia e ngarkesës së glukozës për të ulur nivelin e HGH
E) testi me metopiron
PS)D

Pyetja 454 V)1

Cila prej situatave të mëposhtme nuk shkakton aneminë megaloblastike?

A) infektimi me Dyphyllobortium
B) mungesa e hekurit
C) S. Zollinger-Ellison
D) Celiakia
E) Gastrectomia totale
PS)B

Pyetja 455 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë për tumoret malinje të ezofagut?

A) Më shpesh lokalizohen në 1/3 inferiore.
B) Prek më shpesh femrat.
C) Disfagi progresive
D) Prodhon vonë në kohë metastaza në limfonodujt regjional
E) Dominon limfoma
PS)C

Pyetja 456 V)2

Cili është elementi qelizor karakteristik i granulomës së limfomës së Hodgkin?

A) qeliza plazmatike
B) mastociti
C) qeliza Sternberg
D) megakariociti
E) eritroblasti
PS)C

Pyetja 457 V)2

Në cilën prej situatave të mëposhtme vihen re gishtat si shkopa xhezi?

A) siringomielia
B) sëmundja e Raynaud
C) onikomikoza
D) bronkopneumopatia kronike
E) nënushqyerja kronike
PS)D

Pyetja 458 V)2

Në hemoglobinurinë paroksistike nokturne alterimi ndodh në:

A) membranën eritrocitare.
B) përgjigjen antikorpale.
C) komplementi.
D) ciklo-oksigjenazën.
E) leukotrienet.
PS)A

Pyetja 459 V)3

Sëmundja e Bornholm (mialgjia epidemike) shkaktohet nga:

A) viruset sinciciale.
B) polivirusi hominis.
C) virusi influenca.
D) virusi coxackie B.
E) viruset e ngadalta.
PS)D

Pyetja 460 V)1

Cila është zona ku normalisht auskultohet aorta?

A) hapësira e II interkostale e majtë në parasternalen
B) hapësira e III interkostale e majtë në parasternalen
C) hapësira e IV interkostale e majtë në parasternalen
D) hapësira e II interkostale e djathtë në parasternalen
E) hapësira e III interkostale e djathtë në hemiklavikularen
PS)D

Pyetja 461 V)1

Tetania dhe hipokalcemia shkaktohen nga heqja (rezeksioni) e:

A) surreneve.
B) timusit.
C) epifizës,
D) paratiroideve.
E) hipotalamusit.
PS)D

Pyetja 462 V)1

Zakonisht në fonokardiogramë, toni i I kardiak nuk shtohet:

A) në hipertireozën.
B) në insufiçencën mitrale.
C) tek pacientët e rinjm
D) në stenozën mitrale të gradës së II.
E) në hipertensionin arterial.
PS)B

Pyetja 463 V)2

Në sindromën e Zollinger-Ellison vërehet rritje e përqëndrimit në gjak të:

A) glukagonit.
B) gastrina.

C) insulina.
D) eritropoetina.
E) pankreozimina
PS)B

Pyetja 464 V)1

Cila prej simptomave nuk shfaqet në hipertensionin portal?

A) leukopenia
B) poliglobulia
C) splenomegalia
D) hemorroidet
E) Asciti
PS)B

Pyetja 465 V)1

Cila është zona në të cilën haset më shumë ulçera gastrike?

A) kurbatura e madhe
B) fundusi
C) pareti posterior
D) kurbatura e vogël
E) antrumi
PS)D

Pyetja 466 V)1

Cila është shenjë indirekte e hipertiroidizmit?

A) hipokolesterolemia
B) hiperkolesterolemia
C) hiperlipidemia
D) hipotermia
E) hipersensibiliteti ndaj të ftohtit
PS)A

Pyetja 467 V)2

Cila prej simptomave shfaqet në fillim te cirroza biliare primitive?

A) asteriksis (flapping tremors)
B) pruriti
C) variçet e ezofagut
D) splenomegalia
E) hemorragjia

PS)B

Pyetja 468 V)1

Hipertensioni primitiv i arteries pulmonare është më i shpeshtë te:

A) meshkujt e rinj.
B) femrat e reja.
C) të moshuarit.
D) pacientët me Ca të kokës së pankreasit
E) fëmijët.
PS)B

Pyetja 469 V)2

Mbas rezeksionit të 2/3 së stomakut nuk ndodh komplikacioni i:

A) ulçerës anastomike.
B) Dumpyng syndrome.
C) ulçerës peptike të jejunumit.
D) kolelitiazës.
E) gastritit i kalimit nga antrumi në duoden.
PS)D

Pyetja 470 V)2

Alfa-feto proteina rritet në rastin e shumë tumoreve, me përjashtim të:

A) karcinomës hepatoqelizore.
B) nekrozës hepatike.
C) karcinomës embrionale të testikulit.
D) karcinomës së ovarit.
E) seminomës.
PS)E

Pyetja 471 V)2

Cila prej situatave mund të shoqërohet me pulsim në epigastër?

A) hipertrofia e ventrikulit të majtë
B) perikarditi kronik
C) perikarditi eksudativ
D) hipertrofia e ventrikulit të djathtë
E) obeziteti
PS)D

Pyetja 472 V)2

Në sklerozën e aortës zhurma që auskultohet në zonën përkatëse është:

A) telesistolike
B) protodiastolike
C) telediastolike
D) mezodiastolike
E) Mezosistolike
PS)E

Pyetja 473 V)3

Lezioni që me radiologji shpesh herë mund të simuloj për një tumor kockor është:

A) sëmundja e Paget.
B) hiperparatiroidizmi.
C) plazmocitoma.
D) displazia fibrotike e kockës.
E) granuloma eozinofile.
PS)E

Pyetja 474 V)1

Cila është struktura anatomike që në imazhin radiografik të zemrës përcakton harkun e II majtas?

A) aorta
B) atriumi i majtë
C) ventrikuli i majtë
D) arteria pulmonare.
E) atriumi i djathtë
PS)D

Pyetja 475 V)2

Cila prej gjendjeve të mëposhtme nuk komplikohet me diabet?

A) M. Simmonds
B) Hemokromatoza
C) Akromegalia
D) M. Cushing
E) Feokromocitoma
PS)A

Pyetja 476 V)1

Për të trajtuar hemofilinë A përdoret/përdoren:

A) njësi gjaku të plota të konservuara
B) faktori VIII i përqëndruar
C) albumina humane
D) Sulfati i protaminës
E) Vitamina K
PS)B

Pyetja 477 V)1

Në cilën prej gjendjeve, diferenca e presionit arterial rritet?

A) insufiçenca mitrale
B) stenoza mitrale
C) stenoza pulmunare
D) hipertensioni nefrovaskular
E) insufiçenca e aortës
PS)E

Pyetja 478 V)2

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme evidentohet limfocitozë e rëndësishme?

A) pneumonia (fibrinoze)
B) mononukleoza
C) absesi hepatik
D) echinocokoza
E) leucemia akute mieloblastike
PS)B

Pyetja 479 V)2

Cila prej gjendjeve shkakton rritje të transparencës në fushat pulmunare?

A) atelektazia.
B) emfizema
C) infarkti pulmunar
D) bronkopneumonia
E) pneumopatia uremike
PS)B

Pyetja 480 V)2

Në sindromën e ansës qorre, steatorrea shkaktohet nga:

A) insufiçenca pankreatike.
B) dekonjugimi bakterial i acideve biliare.

C) eskretimi biliar i pamjaftueshëm.
D) rritja e motilitetit intestinal.
E) bllokimi limfatik.
PS)B

Pyetja 481 V)3

Disfagia sideropenike eshte karakteristike e:

A) Sindroma Plummer-Vinson
B) Sindroma Pancoast
C) Sindroma Mikulicz
D) Sindroma Zieve
E) Sindroma nefrozike
PS)A

Pyetja 482 V)2

Enteriti regjional, lokalizohet kryesisht në:

A) ileusin terminal.
B) duodenum
C) kalimin duoden-jejunum,
D) jejunum.
E) Sigma.
PS)A

Pyetja 483 V)1

Pacienti që ka kryer dializë duhet:

A) të përdorë shumë likide.
B) të reduktojë marrjen e likideve
C) të konsumojë shumë fruta, perime.
D) të përdorë dietë me pak karbohidrate
E) të përdorë dietë hiperproteinike
PS)B

Pyetja 484 V)2

Në cilën prej gjendjeve, fibrinogjeni në gjak ulet?

A) pneumonia
B) bronkopneumonia
C) infeksionet akute
D) sindroma nefrozike
E) cirroza hepatike

PS)E

Pyetja 485 V)1

Cila prej simptomave nuk shfaqet asnjë herë te migrena?

A) alterimet e shikimit
B) shenja e Kernig pozitive
C) skotomat
D) nauze
E) dhimbje pulsuese
PS)B

Pyetja 486 V)2

Në cilën prej gjendjeve mund të evidentohet nekroza papilare renale?

A) glomerulonefriti akut
B) hipogamaglobulinemia
C) tuberkuloza renale
D) litiaza renale
E) cistinuria
PS)C

Pyetja 487 V)1

Periudha mesatare e inkubimit të kolerës është:

A) 5 ditë
B) 10 ditë
C) 1 muaj
D) 15 ditë
E) 2 muaj
PS)A

Pyetja 488 V)1

Pigmentimi i verdhë i lëkurës, por pa pigmentim të sklerave shkaktohet nga:

A) karoteni.
B) melanina.
C) bilirubina.
D) hemoglobina e oksiduar.
E) sulfhemoglobina.
PS)A

Pyetja 489 V)2

Nëse në elektroforezë vërehet dominimi i imunoglobinave gama, atëherë mund të dyshohet për:

A) mielomë.
B) morbus Hodgkin.
C) leucemi akute.
D) hepatit akut.
E) leucemi kronike.
PS)A

Pyetja 490 V)1

Intensiteti i tonit të I-re në stenozën mitrale është:

A) normal.
B) i reduktuar,
C) i rritur.
D) i reduktuar në fazën fillestare.
E) i rritur në fazën fillestare.
PS)C

Pyetja 491 V)1

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme mund të reduktohet BUN (blood urea nitrogen)?

A) peritoniti
B) pneumonia
C) insufiçenca hepatike e rëndë
D) insufiçenca kortiko-surrenale
E) shoku
PS)C

Pyetja 492 V)2

Angina e abdomenit nga iskemia e mezenterit shfaqet:

A) pavarësisht përdorimit ose jo të ushqimeve.
B) si rezultat i infarktit të miokardit
C) mbas Claudicatio intermitent
D) mbas ngrënies së një vakti
E) përpara një infarkti renal.
PS)D

Pyetja 493 V)1

Në cilën nga gjendjet mund të haset hiperkolesterolemia?

A) M. Adison
B) Hepatiti kronik pa kolestazë
C) Koliti ulçeroz
D) Hipotiroidizmi
E) M. Crohn
PS)D

Pyetja 494 V)1

Natremia zakonisht është normale në:

A) dehidrimin hipertonik.
B) dehidrimin hipotonik.
C) hiperhidratimin hipotonik.
D) hiperhidratimin hipertonik.
E) dehidrimin izotonik.
PS)E

Pyetja 495 V)2

Me cilën prej patologjive të mëposhtme nuk shoqërohet Tiroiditi Hashimoto?

A) Artriti reumatoid
B) Sindroma Sjogren
C) Sklerodermia
D) LES
E) Pielonefriti
PS)E

Pyetja 496 V)1

Cili prej përkufizimeve është më i saktë? Insufiçenca kardiake është e pranishme atëherë kur:

A) zemra nuk është më në gjendje të përmbush nevojat periferike.
B) hedhja kardiake reduktohet.
C) hedhja sistolike është e pamjaftueshme pavarësisht stimulit nga sistemi simpatik.
D) ka stazë në qarkullimin e madh e atë të vogël.
E) ka hipertrofi dhe rritje të frekuencës kardiake.
PS)A

Pyetja 497 V)1

Retikulocitoza të bën të dyshosh për:

A) insufiçencë e palcës kurrizore.
B) rritje e aktivitetit të eritroblasteve.

C) rritje e aktivitetit të sistemit retikulo-histiocitar.
D) prania e mieloblasteve në gjakun periferik.
E) hipofunksioni i lienit.
PS)B

Pyetja 498 V)1

Në rastin e hemokromatozës, cila prej substancave depozitohet në hepar?

A) zinku
B) hekuri
C) bakri
D) amiloidi
E) glikogjeni atipik
PS)B

Pyetja 499 V)2

Cila zonë preket më shumë nga spodiliti ankilozant?

A) artikulacioni radio-karpal
B) kolona vertebrale e pjesa sakro-iliake
C) duart
D) artikulacioni tibio-tarsik
E) artikulacionit i gjurit
PS)B

Pyetja 500 V)1

Zhurma anforike është tipike e:

A) kavernave.
B) bronkiektazive.
C) emfizemës senile.
D) stenozës bronkiale.
E) astmës bronkiale.
PS)A

Pyetja 501 V)2

Me cilën prej patologjive shoqërohet më shpesh krioglobulinemia?

A) purpurën trombocitopenike
B) sëmundjen e Willebrand
C) cirrozë hepatike
D) M. Vaquez
E) M. Still

PS)C

Pyetja 502 V)3

Varianti histologjik me reduktim të limfociteve shfaqet në rastin e:

A) limfomës Hodgkin.
B) granulomës eozinofile.
C) plazmocitomës.
D) leucemisë mieloide kronike.
E) leucemisë mieloide akute
PS)A

Pyetja 503 V)1

Dispnea gjatë acidozës metabolike është:

A) psikogjene.
B) pulmonare.
C) kardiake.
D) mikse.
E) dizmetabolike
PS)E

Pyetja 504 V)1

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme, bilirubinogjeni në feçe nuk është i pranishëm?

A) ikteri hemolitik (nga anomali strukturale)
B) hemoliza post-transfuzion
C) koliti ulçeroz
D) obstruksioni biliar komplet
E) hepatiti akut
PS)D

Pyetja 505 V)2

Cila prej simptomave shfaqet në sindromën e Stein-Leventhal?

A) dobësia trupore
B) cikli menstrual i rregullt
C) 17 KS urinare të reduktuara
D) testosteronemia e reduktuar
E) hirsutizmi
PS)E

Pyetja 506 V)2

Në cilën prej gjendjeve nuk shfaqet koma metabolike?

A) uremia
B) meningiti
C) diabeti melitus
D) insufiçenca surrenale
E) cirroza hepatike
PS)B

Pyetja 507 V)1

Shkaku më i shpeshtë i obezitetit është:

A) marrja e ekzagjeruar e kalorive.
B) sëmundje endocrine.
C) infeksione kronike.
D) hiperprodhimi i TSH-së.
E) diabeti melitus.
PS)A

Pyetja 508 V)2

Sindroma Zollinger-Ellison karakterizohet nga:

A) hiperklorhidria gastrike.
B) cianoza
C) hipogastrinemia.
D) kriza nga hiperinsulinemia.
E) atrofia e mukozës gastrike
PS)A

Pyetja 509 V)1

Në cilën nga patologjitë, prekja e hiluseve pulmonare është më shpesh simetrike ?

A) tuberkuloza
B) sarkoidoza
C) hodgkin
D) Asbestoza
E) Antrakoza
PS)B

Pyetja 510 V)1

Në favizëm haset defiçiti i:

A) glukozës-6-fosfat-dehidrogjenaza.
B) piruvat kinaza.
C) gliceraldehidi 3-fosfat-dehidrogjenaza.
D) faktori intrisek.
E) faktori VIII.
PS)A

Pyetja 511 V)1

Në cilën prej patologjive evidentohet hipokolesterolemia?

A) kolelitiaza.
B) diabeti mellitus.
C) sprue (intoleranca nga laktoza)
D) sindroma Niemann-Pick
E) hipotiroidizmi
PS)C

Pyetja 512 V)2

Edema shkaktohet kryesisht nga rritja e presionit hidrostatik në rastin e:

A) Edema Quincke
B) Insufiçenca kardiake
C) Sindroma nefrozike
D) Sprue idiopatik
E) celiachia
PS)B

Pyetja 513 V)1

Nekroza papilare renale shkaktohet më shpesh nga:

A) penicilina
B) fenacetina
C) alopurinoli
D) meticilina
E) klorochina
PS)B

Pyetja 514 V)1

Vala P e ndjekur nga kompleksi ventrikular me raportin 2:1; 3:1 etj është tregues i:

A) bllokut AV i gradës së I.
B) bllokut AV i gradës së II
C) bllokut AV i gradës së III

D) hapshënuesit të pacemakerit.
E) aritmisë sinuzale.
PS)B

Pyetja 515 V)3

Në sëmundjen e Werlhof (purpura trombocitopenike idiopatike), nje nga te dhenat e meposhtme rezulton e gabuar. Cila?

A) trombocitopenia.
B) koha e hemorragjisë e zgjatur.
C) retraksioni i koagulit normal.
D) koha e koagulimit normale.
E) provat e dobësisë (fraxhiliteti) të vazave pozitive.
PS)C

Pyetja 516 V)1

Gjigandizmi mund të shoqërohet me:

A) kraniofaringeomë.
B) adenomë toksike të tiroides.
C) adenomë acidofile të adenohipofizës.
D) adenomë bazofile të adenohipofizës.
E) karcinomë pulmonare.
PS)C

Pyetja 517 V)2

Metoda më e mirë për të kryer screening të karcinomës së prostatës është:

A) strishio e mukozës së rektumit.
B) prova me benzidin.
C) përcaktimi kuantitativ i yndyrnave në feçe.
D) përcaktimi i alfa-fetoproteinës.
E) eksplorimi digital i rektumit.
PS)E

Pyetja 518 V)2

Simptoma që të drejton drejt tumoreve të aparatit urinar është:

A) hematuria.
B) stranguria.
C) polakiuria.
D) proteinuria.
E) dizuria.

PS)A

Pyetja 519 V)1

Në rastin e alergjive ushqimore duhet të ndërmerren masa si:

A) dieta hipokalorike.
B) dieta e eleminimit.
C) dieta hipokalorike.
D) imunoprecipitimi.
E) testi me Xiloks.
PS)B

Pyetja 520 V)1

Në cilin prej veseve valvulare evidentohet zhurmë sistolike nga regurgitimi?

A) stenoza pulmonares
B) insufiçenca mitrales
C) insufiçenca pulmonare
D) stenoza aortës.
E) insufiçenca aortës
PS)B

Pyetja 521 V)2

Toksoplazmoza është një:

A) mikozë difuze.
B) infeksion nga arbovirus.
C) sëmundje nga protozoarë.
D) infeksion nga citomegalovirus.
E) infeksion nga coxsacket.
PS)C

Pyetja 522 V)1

Piuria është karakteristikë pothuajse konstante e:

A) pielonefritit.
B) nefritit intersticial.
C) lomerulonefritit kronik.
D) tubulonefrozës.
E) absesit renal.
PS)A

Pyetja 523 V)1

Përgjigja humorale merr pjesë kryesisht në:

A) mbrojtjen nga qelizat e infektuara nga viruset.
B) mbrojtjen nga funget.
C) mbrojtjen nga infeksionet bakteriale.
D) mbrojtjen nga neoplazitë.
E) flakja në rast trasplanti.
PS)C

Pyetja 524 V)1

Cili artikulacion preket më shpesh nga artropatia gutoze?

A) gjuri
B) skapulo-humerus
C) talus
D) gishtat e dorës
E) gishti i madh i këmbës
PS)E

Pyetja 525 V)1

Cili është medikamenti më i përshtatshëm që duhet të përdoret tek një diabetik adult që është gjithashtu obez?

A) insulina
B) biguanidi
C) sulfanilurea
D) sulfanilure+ Biguanid
E) insulinë+ dieta
PS)B

Pyetja 526 V)1

Pozicioni ortopnoik vërehet në:

A) fazën fillestare të pleuritit.
B) versamentin pleural të spikatur.
C) krizën me dhembje abdominale.
D) insufiçencën kardiocirkulatore
E) kolikën renale.
PS)D

Pyetja 527 V)2

Në rastin e diagnozës së 'renit polikistik', cili është organi tjetër i cili duhet ekzaminuar?

A) pankreasi
B) zemra
C) hepari
D) truri
E) testikujt
PS)C

Pyetja 528 V)1

Cili është shkaktari më i shpeshtë i ulçerës duodenale?

A) hipogastrinemia
B) megaezofagu
C) diarrea
D) hipoekskretimi klorhidropeptike
E) hiperprodhimi klorhidropeptik
PS)E

Pyetja 529 V)1

Kur reduktohet glikorakia?

A) poliomieliti
B) encefaliti
C) meningiti tuberkular
D) neoplazia cerebrale
E) uremia kronike
PS)C

Pyetja 530 V)2

Nuk evidentohet zakonisht në cirrozën hepatike:

A) eritema palmare.
B) gjinekomastia.
C) hipoprotrombinemia.
D) spider nevus.
E) hiperkolesterolemia.
PS)E

Pyetja 531 V)2

Cili është shkaktari më i shpeshtë i një endokarditi bakterial subakut?

A) Streptococcus beta- hemolitik tipi 12
B) Streptococcus beta-hemolitik tipi 49

C) Streptococcus viridans
D) Stafilococcus aureus
E) Corynebacteri i difterisë
PS)C

Pyetja 532 V)1

Në ulçerën duodenale:

A) është i shpeshtë kancerizimi.
B) ndodh më shpesh në muajt e verës.
C) mungon Helicobacter pylori.
D) dhembja shfaqet normalisht esëll
E) helicobacter pylori është i pranishëm në mënyrë konstante
PS)D

Pyetja 533 V)2

Ndjenja e etjes është simptomë treguese e ndryshimeve të osmolaritetit në hapësirën jashtëqelizore. Është më e theksuar në:

A) dehidrimin hipotonik.
B) dehidrimin izotonik.
C) hiperhidratimin hipertonik
D) dehidrimin hipertonik.
E) hiperhidratimin hipotonik
PS)D

Pyetja 534 V)2

Shkaku kryesor i vdekjes në transplantin renal lidhet me:

A) ureminë.
B) flakja.
C) infeksione të mbivendosura/ të përsëritura
D) hemorragji.
E) nekroza papilare.
PS)C

Pyetja 535 V)1

Në stenozën mitrale, sindroma anginoze shfaqet:

A) herët në kohë.
B) në fazë të avancuar
C) në çfarëdo lloj momenti të dekursit
D) kur fillon fibrilacioni

E) asnjëherë.
PS)B

Pyetja 536 V)1

Në M. Adison përveç hiponatremisë evidentohet:

A) hiperkaliemi.
B) hipokaliemi.
C) hipekloremi.
D) hiperglicemi.
E) hiperbikarbonatemi.
PS)A

Pyetja 537 V)1

Vlera normale e filtrimit glomerular është:

A) 2 ml/min
B) 10 ml/min
C) 120 ml/min
D) 30 ml/min
E) 700 ml/min
PS)C

Pyetja 538 V)2

Diagnoza e M. Whipple konfirmohet nëpërmjet:

A) biopsisë së zorrës së hollë.
B) Rx i aparatit tretës.
C) strishios rektale.
D) biopsisë hepatike.
E) elektroferezës së proteinave.
PS)A

Pyetja 539 V)2

Nuk është e pranishme në rastin me ikterin hemolitik?

A) urobilinuria
B) bilirubinuria
C) ulja e hemoglobinës.
D) rritja e retikulocitit
E) ulja e mbijetesës eritrocitare
PS)B

Pyetja 540 V)1

Cili ton i shtuar mund të evidentohet në insufiçencën mitrale?

A) toni i III
B) toni i IV
C) zhurma e hapjes
D) kliku protosistolik
E) dyfishimi i tonit të II
PS)A

Pyetja 541 V)1

.2/3 e infeksioneve urinare të pa komplikuara të rrugëve urinare shkaktohen nga:

A) escherichia coli.
B) K lebsiella.
C) Proteus
D) Pseudomonas
E) Stafilococcu aureus
PS)A

Pyetja 542 V)2

Kur shfaqet temperatura me karakter ondulant?

A) bruceloza
B) pertusis
C) tifo abdominale
D) difteria
E) sepsi i lindjes (puerperal)
PS)A

Pyetja 543 V)1

Në ikterin obstruktiv nga litiaza e koledokut evidentohet rritja e:

A) albuminemisë.
B) trombociteve.
C) fosfatazës alkaline
D) urobilinurisë
E) aktiviteti i protrombinës.
PS)C

Pyetja 544 V)1

pH i rritur me pCO2 normal është tregues i:

A) alkalozës respiratore.
B) alkalozës metabolike.
C) acidozës metabolike
D) acidozës respiratore
E) acidozës metabolike të kompensuar.
PS)B

Pyetja 545 V)1

Në cilën nga gjendjet rritet shpesh natremia?

A) S. Cushing
B) diarrea
C) të vjellat
D) insufiçenca surrenales
E) prodhimi i pamjaftueshëm i ADH
PS)A

Pyetja 546 V)1

Në korin pulmonar kronik evidentohet:

A) zbehja.
B) ECG me shenja të mbingarkesës ventrikulare të majtë.
C) forcimi i tonit të II të aortës.
D) hepatomegali nga staza.
E) mungesa e refluksit hepato-jugular.
PS)D

Pyetja 547 V)2

Cila është karakteristika e bllokut AV i gradës II, tipi Mobitz I?

A) PQ > 0.20 sek
B) ritëm idioventrikular
C) zgjatja progresive e PR derisa një P nuk përcillet
D) arresti sinuzal
E) disocimi atrio-ventrikular
PS)C

Pyetja 548 V)2

Sindroma e Pancoast karakterizohet edhe nga:

A) pre-cordialgjia
B) tortikoli spastik

C) fenomene paralizuese të gjymtyrës së sipërme omolaterale
D) otalgji
E) zmadhimi i tiroides
PS)C

Pyetja 549 V)1

Në cilën prej patologjive, glicemia rritet?

A) M. Adison
B) insulinoma
C) glikogjenoza
D) feokromocitoma
E) hipotiroidizmi
PS)D

Pyetja 550 V)2

Cila është metodika terapeutike më e përshtatshme në rastin e tamponadës kardiake?

A) perikardiocenteza
B) salaso me rreth 500 ml
C) digitalizimi
D) diureza e sforcuar
E) hemotransfuzioni
PS)A

Pyetja 551 V)1

Fibrilacioni atrial shfaqet më shpesh tek pacientët me:

A) hipertiroidizëm.
B) akromegali.
C) M. Adison.
D) Miksedema
E) Diabet
PS)A

Pyetja 552 V)1

Cila prej simptomave evidentohet në enteropatinë me humbje të preteinave?

A) hiperproteinemia
B) edema
C) feçet hipokromike
D) albuminuria.
E) poliglobulia

PS)B

Pyetja 553 V)2

Cila nga vlerat e mëposhtme është frekuenca normale respiratore e një femije të moshës një vjeç?

A) 50-60/minutë
B) 40-50/minutë
C) 30-40/minutë
D) 20-30/minutë
E) 10-20/minutë
PS)D

Pyetja 554 V)2

Cili nga pohimet lidhur me terapinë për alergjinë ndaj proteinave të qumështit të lopës tek latanti nuk është i saktë?

A) Toleranca ndaj proteinave të qumështit rifitohet shumë shpesh pas vitit të parë të jetës.
B) Nuk këshillohet imunoterapi specifike.
C) Proteinat e qumështit të lopës duhen eleminuar nga dieta.
D) Zgjedhje e parë e terapisë është qumështi i dhisë ose i deles.
E) Mund të përdoren formula me bazë te kazeines së hidrolizuar dhe formula me bazë të proteinës të qumështit të lopës së hidrolizuar.
PS)D

Pyetja 555 V)2

Cili nga pohimet për bronkioloitin nga VRS (virusi respirator sinsicial) nuk është i vërtetë?

A) Piku i moshës së prekur është 5-6 muajsh.
B) Arrin maksimumin e rëndesës brenda 48-72 orsëh nga fillimi.
C) Zakonisht është më i rëndë sa më i vogël të jetë fëmija.
D) Terapia me bronkodilatatore jo gjithmone është efikase.
E) Shpesh çon në sëmundje pulmonare obstruktive kronike.
PS)E

Pyetja 556 V)3

Një fëmijë i moshës 5 vjeç pa histori të mëparshme për çrregullime të SNQ-ësë, ka patur sipas prindërve, shumë episode ' të humbjes së kontaktit' për periudha të shkurtra, por pa humbje të ndërgjegjies. Ata raportojne gjithashtu dhe lëvizje të buzëve d
A) të kërkohet një EEG në gjumë
B) të fillohet një terapi me fenobarbital.
C) të kërkohet një CT.
D) të kërkohet një Ro grafi e kokës.

E) të trajtohet me Etosuccimide.
PS)A

Pyetja 557 V)2

Cila nga shenjat e mëposhtme është karakteristike e Sindromës Morris?

A) humbje e kripërave dhe hipotension
B) vonesë psikomotore dhe mendore
C) shtat i shkurtër dhe pubertet i parakohshëm
D) zhvillim i gjinjve me mungesë të pilozitetit seksual
E) zhvillim i pilozitetit seksual me mungesë të gjinjve.
PS)D

Pyetja 558 V)2

Ekzaminim specifik për të vënë diagnozën diferenciale ndërmjet anemisë Sideropenike dhe betatalesamisë është:

A) ferritina.
B) gjak komplet.
C) elektroforeza e hemoglobinës.
D) sideremia.
E) rezistenca osmotike.
PS)C

Pyetja 559 V)3

Cila nga molekulat e histokompatibilitetit të klasës së dytë shoqërohet me një frekuence të madhe me celiakine?

A) DQ2
B) DQ8
C) të tjera DQ
D) B8
E) DQ1
PS)A

Pyetja 560 V)3

Të gjitha elementet e mëposhtëm janë të zakonshën në artritin juvenil kronik, përveç:

A) eritrosedimentit të rritur.
B) proteinës C reaktive prezente
C) leukocitozet
D) rritjes së imunoglobulinave.
E) hematurisë.

PS)A

Pyetja 561 V)3

Ka një lidhje të ngushtë midis sëmundjes neuromuskulare të ekstremiteteve dhe:

A) këmbës si kabëll.
B) këmbës së sheshtë.
C) metatersit të aduktuar
D) Hallux valgus
E) sëmundjes së Kohlerit
PS)A

Pyetja 562 V)2

Cila nga alternativat e mëposhtme paraqet komplikacionin me të shpeshtë të parotitit?

A) mastiti
B) tiroiditi
C) meningiti aseptik
D) shurdhimi
E) miokarditi
PS)C

Pyetja 563 V)3

Cila nga shenjat e mëposhtme është indikacion për përdorimin e antikorpeve monoklonale anti TNF alfa në trajtimin e morbus Crohn:

A) format e rënda, rezistente ndaj terapisë me kortizonike-imunosupresore dhe format fistulizuese.

B) atak i rëndë i kolitit, si trajtim i parë i zgjedhur.

C) në rastet steroidodipendente

D) në rastet steroidorezistente

E) në rastet rezistente ndaj sulfasalazinës.

PS)A

Pyetja 564 V)3

Tek një fëmijë i moshës 3 vjeç me një krize akute të astmës, cili nga parametrat e mëposhtëm është më shume tregues i gjendjes së rëndë?

A) frekuenca respiratore 40/minutë.
B) kollë e vazhdueshme.
C) dispne e rëndë me pamundësi për të folur.
D) saturimi i oksigjenit në ajrin e dhomës 93-94%.
E) PEF 70-80% e parashikimit.
PS)C

Pyetja 565 V)2

Përveç ekzantemës klasike, të gjitha shenjat e mëposhtme janë tipike shoqeruese të fruthit, me përjashtim të:

A) kollës.
B) temperaturës mesatarisht të lartë.
C) rinit.
D) konjuktivit.
E) Prurit.
PS)E

Pyetja 566 V)1

Një fëmijë 2 vjeç paraqitet me otit media akut. Dy shkaktarët më të zakonshëm janë:

A) Streptococco pyogene dhe Staphylococco aureus.
B) Haemophilus Influenzae dhe Streptococco Pneumonie.
C) Haemophilus Influenzae dhe Staphylococco aureus.
D) Streptococco Pneumonie dhe Staphylococco aureus
E) Moraxella catarralis dhe Staphylococco aureus.
PS)B

Pyetja 567 V)1

Diagnoza e anemisë hemolitike nga deficiti i glukozë -6-fosfat dehidrogjenazës mbështetet në:

A) dozimin e enzimës në urinë.
B) dozimin e enzimës në rruazat e kuqe pas një krize hemolitike.
C) dozimin e enzimës në rruazat e kuqe pas testit in vitro me ekstraktin e batheve.
D) dozimin e enzimës në rruazat e kuqe në distancë nga kriza hemolitike.
E) dozimin e enzimës në fibroblaste.
PS)D

Pyetja 568 V)2

Të gjithë faktorët e mëposhtëm ose agjentët kimikë mund të jene shkak i embriopatisë, përveç:

A) konsumit të alkoolit gjatë shtatëzënisë
B) fenilketonurisë së nënëa jo në trajtim dietetik.
C) marrjes së Talidomidit gjatë shtatëzënisë.
D) marrjes së substancave stupefacente (kokaine, heroinë) gjatë shtatëzënisë.
E) marrjes së acidit ascorbic gjatë shtatëzënisë.
PS)E

Pyetja 569 V)1

Testi që përdoret dendur në përcaktimin e diagnozës së 'skarlatinës' është:

A) hemokultura.
B) tamponi faringeal.
C) titri i antistreptolizinave.
D) serologjia per Ebstein Barr .
E) gjaku komplet.
PS)B

Pyetja 570 V)3

Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me defektet në ciklin e uresë, nuk është i saktë?

A) Defektet e ciklit të uresë mund të shkaktojnë dekompensim akut me letargji dhe komë.
B) Trajtimi i hiperamoniemisë në defektet e ciklit të uresë duhet vendosur menjeherë.
C) Pacientët me defekte të ciklit të uresë mund të paraqesin neveri ndaj ushqimeve të pasura me proteina.
D) Dieta për trajtimin e defekteve të ciklit të uresë është hiperproteinike dhe hipokalorike.
E) Një alterim i funksionit te ciklit të uresë mund të shkaktohet nga defekte te ndryshme enzimatike.
PS)D

Pyetja 571 V)1

Acidoza metabolike shoqërohet me të gjithë shkaqet e mëposhtëm, përveç:

A) ketoacidozës diabetike
B) diarresë.
C) dehidratimit.
D) stenozës pilorike
E) insuficiencës renale.
PS)D

Pyetja 572 V)2

Cila nga shfaqjet e mëposhtme klinike është një prej kritereve të diagnozës së neurofibromatozës?

A) njollat kutane "kafe-late"
B) iktioza
C) njolla kutane hipokromike
D) vonesë mendore
E) katarakt
PS)A

Pyetja 573 V)3

Nëna e një neonati dy ditësh është tepër e shqetësuar pasi ka zbuluar një zonë të pigmentuar të errët në zonën sakrale dhe prapanicave te bebit. Diagnoza me e mundshme është:

A) melanoma malinje.
B) eritema toksike.
C) njolla mongolike.
D) nevus flammus.
E) mielomeningocele.
PS)C

Pyetja 574 V)2

Shkaku më i shpeshtë i pubertetit të vonuar është:

A) hipotiroidizmi.
B) vonesa e rritjes dhe e zhvillimit.
C) disgjenezia gonadike.
D) hipogonadizem ose hipogonadotropizëm.
E) diabeti mellitus i keq kontrolluar.
PS)B

Pyetja 575 V)1

Cili nga agjentët e mëposhtëm është më shpesh përgjegjës për sepsisin e hershëm të neonatit?

A) Pseudomonas aeruginosa
B) Klebsiella pneumonie
C) Enterococcus faecalis
D) Streptokoku i grupit B
E) Listeria monocitogene
PS)D

Pyetja 576 V)1

Në cilën moshë është piku i incidencës së sindromës nefrotike në moshën pediatrike?

A) Rreth vitit të parë të jetës.

B) Ndërmjet moshës 2 dhe 5 vjeç.
C) Ndërmjet moshës 6 dhe 10 vjeç.
D) Në kohën e pubertetit.
E) Në pubertet.
PS)B

Pyetja 577 V)1

Cila nga patologjitë e mëposhtme nuk shoqerohet me trombocitopeni?

A) Sindroma uremike-hemolitike
B) Hemangioma gjigante
C) Purpura Schonlein -Henoch
D) Aplasia medulare
E) Hiperslenizmi
PS)C

Pyetja 578 V)1

Glomerulonefriti akut post streptokoksik karakterizohet nga të gjitha të dhënat e mëposhtme, përveç:

A) prognozës së mirë.
B) mikro dhe makrohematurisë.
C) hipokomplementemisë së shprehur
D) hiperlipidemisë.
E) hipertensionit.
PS)D

Pyetja 579 V)2

Të gjitha alterimet e mëposhtme të laboratorit janë të pranishme në rastin e koagulimit intravaskular të diseminuar, përveç:

A) trombocitopenisë.
B) zgjatjes së PTT-ësë.
C) rritjes së produkteve të degradimit te fibrinogenit.
D) rritjes së fibrinogenit.
E) alterimit mikroangiopatik të rruazave të kuqe në strishon periferike.
PS)D

Pyetja 580 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm per rakitin nga mungesa e vitamines D , nuk është i saktë?

A) Ndodh zakonisht në vitin e parë të jetës.
B) Craniotabes është gjetje fillestare.

C) Kalcemia është e ulët dhe fosfori është i rritur.
D) Fosfataza alkaline është si rregull e rritur.
E) Në shenjat klinike figura e 'byzylykut rakitik.
PS)C

Pyetja 581 V)2

Të gjitha patologjitë e mëposhtme janë komplikacione të fruthit, përveç:

A) otiti medias.
B) pneumonisë.
C) encefalitit.
D) parotitit.
E) laringotrakeitit.
PS)D

Pyetja 582 V)2

Cili nga ekzaminimet e mëposhtëm është më i ndjeshëm për të përcaktuar praninë e një fokusi pielonefritik?

A) Radiografia e abdomenit
B) Ekografia renale
C) Urografia
D) Shintigrafia me DMSA
E) Cistografia miksionale
PS)D

Pyetja 583 V)1

Janë simptoma të shpeshta të alergjisë nga proteinat e qumështit të lopës tek latanti të gjitha simptomat e mëposhtme, përveç:

A) të vjellave.
B) diarresë.
C) rritjes së dobët ponderale.
D) ekzemës.
E) afta orale recidivante.
PS)E

Pyetja 584 V)2

Të gjitha shenjat e mëposhtme janë karakteristike për tetralogjinë Fallot, përveç:

A) defektit të gjerë të septumit interventrikular.
B) aorta shaluese.
C) zmadhimit të atriumit të majtë.

D) stenozës pulmonare.
E) hipertrofisë së ventrikulit të djathtë.
PS)C

Pyetja 585 V)3

Dyshohet për vonesë psikomotore:

A) një latant që në moshën 5 muajsh nuk mban qendrimin ulur.
B) një latant që në moshën 12 muajsh nuk ecën vetëm.
C) një latant që në moshën 1 muajshe nuk i buzëqesh nënës.
D) një latant që në moshën 6 muajsh nuk ecën këmbadoras.
E) një fëmijë që në moshën 2 vjeç ka një fjalor rreth 10 fjalë dhe nuk formon fjali të plota.
PS)E

Pyetja 586 V)2

Cila nga sindromat e mëposhtme ka nje mekanizëm transmetimi të lidhur me kromozomin seksual?

A) Sindroma Marfan
B) Sindroma Bruton
C) Sindroma Prader - Willi
D) Sindroma Down
E) Trisomia 18
PS)B

Pyetja 587 V)1

Të gjitha simptomat e mëposhtme janë karakteristikë e fazes së hershme të hepatitit viral, përveç:

A) temperaturës.
B) lodhjes.
C) anoreksisë
D) Ikterit.
E) të përzierit dhe të vjellave.
PS)D

Pyetja 588 V)1

Cila nga metodat e mëposhtme nuk mund të përdoret për diagnozën e Helicobacter pylori (HP) tek fëmijët?

A) Histologjia e biopsisë gastrike.
B) Testi i uresë në frymëmarrje.
C) Testi i shpejtë i aktivitetit ureasik në biopsine gastrike.

D) Kultura e feçeve për HP-në.
E) Përcaktimi i antigenit të HP-së në feçe.
PS)D

Pyetja 589 V)2

Cili nga antibiotikët e mëposhtëm është më i përshtatshëm për të trajtuar një bronkopneumoni nga Clamydia Trachomatis?

A) Amoxicillina
B) Eritromicina
C) Penicillina
D) Trimetoprim-sulfametoksazoli
E) Cefuroxima
PS)B

Pyetja 590 V)2

Cila nga shenjat e mëposhtme klinike nuk shoqërohet me duplikacionin e traktit gastrointestinal?

A) masa abdominale
B) gjakderdhje rektale
C) obstruksion
D) Ikter
E) dhembje e tipit të kolikave
PS)D

Pyetja 591 V)1

Të gjitha simptomat/shenjat e mëposhtme janë zakonisht të pranishme në infeksionet urinare të latantit, përveç:

A) temperaturës deri në 40°C.
B) ndalimit të rritjes.
C) leukociturisë.
D) edemës periferike.
E) retensionit akut të urinës.
PS)D

Pyetja 592 V)2

Suksesi në trajtimin e dehidratimit hipernatremik varet nga:

A) përdorimi i solucioneve pa natrium.
B) përdorimi i solucioneve të glukozuara hipertonike.
C) përdorimi i solucioneve që përmbajnë ure.

D) korrigjimi i ngadalshëm i disekuilibrit elektrolitik.
E) përdorimi i manitolit.
PS)D

Pyetja 593 V)2

Në cilën nga patologjitë intestinale të mëposhtme është tipike gjetja e autoantikorpeve kundër citoplazmes së neutrofileve (ANCA)?

A) Celiachia
B) Gastroenteropatia eozinofilike
C) Morbus Crohn
D) Koliti ulceroz
E) Koliti alergjik
PS)D

Pyetja 594 V)1

Bebi i lindur në term në përgjithësi dyfishon peshën e lindjes:

A) në fund të muajit të parë.
B) në fund të muajit të katërt.
C) në fund të vitit të parë.
D) në fillim të muajit te shtate
E) në moshën 2 vjeçare.
PS)B

Pyetja 595 V)2

Cila nga situatat e mëposhtme duhet të bëjë të mendosh për diverticul Meckel?

A) Ileusi mekonial
B) Prolapsi rektal
C) Obstruksioni i duktusit comun biliar
D) Hepatoslenomegalia
E) Rektorragjia
PS)E

Pyetja 596 V)1

Cila nga dozat e mëposhtme është sasia ditore e këshillueshme e vitamins D për latantët?

A) 0.5 UI
B) 1 UI
C) 10 UI
D) 100 UI
E) 400 UI

PS)E

Pyetja 597 V)2

Cila nga shenjat e mëposhtme radiografike mund të konsiderohet më e thjeshta dhe në të njëjtën kohë e mjaftueshme për një korrigjim korrekt të moshës kockore tek një fëmijë në vitin e dytë ose të tretë?

A) radiografia e pjesës së pulsit
B) radiografia e dorës
C) radiografia e dorës dhe e pjesës së pulsit.
D) radiografia e këmbës.
E) radiografia e një artikulacioni superior ose inferior.
PS)C

Pyetja 598 V)2

Në cilën nga kardiopatitë e mëposhtme është tipike reperti auskultator i ndarjes fikse të tonit të dytë në vatrën pulmonare?

A) tetralogjia Fallot
B) difekti interatrial
C) stenoza aortike
D) stenoza pulmonare
E) koarktacioni i aortës
PS)B

Pyetja 599 V)3

Të gjitha shenjat e mëposhtme shoqërohen në përgjithësi me sindromën cri-du-chat, përveç:

A) mikrocefalisë.
B) fytyrës së rrumbullakët.
C) vonesës mendore.
D) peshës në lindje mbi normë.
E) veshëve të keqformuar dhe me vendosje të poshtme.
PS)D

Pyetja 600 V)1

Klirensi renal i një substance mund të llogaritet duke njohur:

A) përqëndrimin e saj urinar, peshën, moshën.
B) vetëm përqëndrimin e saj plazmatik.
C) përqëndrimin e saj ne plazëm dhe urinë dhe vëllimin urinar (ml/min).
D) vetëm përbërjen kimike të saj.
E) përqëndrimin plazmatik, gjininë, moshën.

PS)C

Pyetja 601 V)1

Cili nga testet laboratorike nuk përdoret për vlersimin e riskut kardiovaskular?

A) kolesteroli total
B) acidet yndyrore të lira
C) trigliceridet
D) kolesteroli HDL
E) kolesteroli LDL
PS)B

Pyetja 602 V)1

Matja e cilit prej këtyre përbërësve lipidike ndikohet më shumë nga marrja e gjakut jo esëll ?

A) kolesteroli total
B) kolesteroli i esterifikuar
C) trigliceridet
D) kolesteroli HDL
E) kolesteroli LDL
PS)C

Pyetja 603 V)1

Cili prej testeve laboratorikë është më specifiku për diagnozën e infaktit te miokardit?

A) mioglobina
B) aspartat transaminasa
C) troponina I
D) laktat dehidrogjenaza (aktiviteti total)
E) kreatine kinasa (aktiviteti total)
PS)C

Pyetja 604 V)1

Cila nga proteinat ose klasat e proteinave nuk është nga sinteza hepatike?

A) albumina
B) ceruloplasmina
C) transferina
D) immunoglobulina
E) haptoglobina
PS)D

Pyetja 605 V)1

Cili prej testeve laboratorikë është më i rëndësishëm për monitorimin afatgjatë të pacientit diabetik?

A) glukozuria
B) peptidi-C
C) fruktozamina
D) hemoglobina fetale
E) hemoglobina e glukozuar
PS)E

Pyetja 606 V)3

Cila prej teknikave të biologjisë molekulare ka ndjeshmërinë më të madhe analitike për identifikimin e qelizave leucemike të karakterizuara nga prania e gjenit hybrid BCR/ABL dhe përdoret për vlerësimin e sëmundjes minimale të mbetur?

A) Southern Blot
B) Western Blot
C) Northern Blot
D) RT-PCR
E) Northern Blot dhe Southern Blot
PS)D

Pyetja 607 V)2

Cili nga kampionet biologjikë nuk mund të perdoret për diagnozën e sëmundjeve genetike të trashëgueshme?

A) gjak + EDTA
B) vilet korialet
C) qeliza nga kampione biopsie
D) leukocitet nga gjaku periferik
E) eritrocitet
PS)E

Pyetja 608 V)1

Cila nga proteinat e matur në urinë edhe në përqëndrime të vogla (20-200 mg/L) është tregues i një nefropatie diabetike fillestare?

A) haptoglobina
B) IgE
C) albumina
D) transferina
E) ceruloplazmina
PS)C

Pyetja 609 V)2

Cili nga parametrat është shpesh i lartë në gjakun e një alkoolisti kronik?

A) vitamina D
B) proteina totale
C) GGT
D) proteina C reaktive
E) albumina
PS)C

Pyetja 610 V)2

Acidi tetrahidrofolik mund të ndërhyjë në reaksionin e:

A) racemizimit.
B) metilimit.
C) transaminimit.
D) oksidimit.
E) izomerizimit.
PS)B

Pyetja 611 V)1

Cili është pohimi i saktë në lidhje me glukozën?

A) Është një përbërës i sakarozës.
B) Vetëm izomeri -L transportohet në qelizat e gjitarëve
C) Paraqitet përgjithësisht në formën furanozike
D) Është një ketohekzozë
E) Karboni-2 i korrespondon atomit të karbonit anomerik
PS)A

Pyetja 612 V)1

Enzimat:

A) janë molekula me përmasa të vogla
B) ndikojnë në ekuilibrin e reaksionit
C) janë përgjithësisht rezistente ndaj nxehtësisë.
D) gjithmone inhibohen nga produkti i reaksionit që katalizojnë
E) modifikojnë shpejtësinë e një reaksioni.
PS)E

Pyetja 613 V)2

Cili nga pohimet është i saktë? Glikogjen sintetaza

A) Glikogjen sintetaza është veçanërisht aktive në formën e fosforiluar.
B) Glikogjen sintetaza aktivizohet nga glukagoni.
C) Glikogjen sintetaza nuk është një enzime e rregulluar.
D) Glikogjen sintetaza është veçanerisht aktive në formën e defosforiluar.
E) Glikogjen sintetaza përdor si substrat glukoze-1-P.
PS)D

Pyetja 614 V)2

Cili prej pohimeve në lidhje me hemoglobinën është i gabuar ?

A) Globina që e përbën ka një strukturë kuaternare.
B) Mënyra e ndërveprimit me oksigjenin është e tipit sigmoidal.
C) Ndërvepron me acidin 2,3-difosfoglicerik që zvogëlon afinitetin për oksigjenin.
D) Përmban hekur tre valent në strukturën e hemit.
E) Afiniteti i saj për oksigjenin zvogëlohet me uljen e pH-së.
PS)D

Pyetja 615 V)2

Në pankreatit cili prej aktiviteteve enzimatike pritet të jetë i rritur në serum?

A) fosfataza alkaline
B) LDH tip I
C) CPK
D) amilaza
E) fosfataza acide
PS)D

Pyetja 616 V)1

Gjate glikolizës, për çdo molekulë glukoze, formohen:

A) gjashtë mole fosfodioksiaceton.
B) dy mole NADH dhe katër GTP.
C) dy mole NADH dhe katër ATP.
D) një mol FADH2 dhe dy ATP.
E) një mol NADH dhe një FADH2.
PS)C

Pyetja 617 V)1

Ekuivalentët reduktues për sintezën e acideve yndyrore furnizohen nga:

A) acidi askorbik.

B) NAD+
C) acid lipoik.
D) FADH2.
E) NADPH + H+.
PS)E

Pyetja 618 V)3

Për sa kohë shterrojnë rezervat e fosfokreatinës gjatë një sforcimi përtej maksimales?

A) 4 minuta
B) 30 minuta
C) 4 orë
D) 4 sekonda
E) 4 ditë
PS)D

Pyetja 619 V)1

Hekuri në organizmin e njeriut:

A) depozitohet tek indet i lidhur me mioglobinën
B) lidhet me vështirësi me makromolekulat.
C) lidhet vetëm me hemoglobinën.
D) lidhet me proteinat vetëm nëse inkorporohet në protoporfirinën IX.
E) përfshihet në metabolizmin e oksigjenit.
PS)E

Pyetja 620 V)1

Tirozina përmban:

A) një grup aldehidik.
B) një varg alifatik që nuk përmban grupe polare.
C) një unazë benzeni.
D) një unaze piridinike.
E) një unazë purinike.
PS)C

Pyetja 621 V)2

Cili është pohimi i saktë?

A) Malonil-CoA është nj prekursor i sintezës së kolesterolit.
B) Malonil-CoA prodhohet nga deaminimi i acetil-CoA.
C) Malonil-CoA përftohet nga dekorboksilimi i acetoacetil-CoA.
D) Malonil-CoA formohet gjatë oksidimit të acideve yndyrore.

E) Malonil-CoA është një molekulë esenciale për sintezën ex novo të acideve yndyrore.
PS)E

Pyetja 622 V)3

Hyrja në gjak e GLUKAGONIT pasohet, përveç të tjerash, nga rritja e nivelit glicemik. Kjo rritje i detyrohet proceseve që vërehen në mëlçi dhe

A) aktivizimit të glukokinazës.
B) aktivizimit të c-AMP-fosfodiesterazës.
C) rritjes së nivelit të c-AMP-së.
D) inhibimit të adenilat ciklazës.
E) inhibimit të proteine-kinazës- cAMP-vartëse.
PS)C

Pyetja 623 V)1

Renina është:

A) e prodhuar vetëm nga qelizat e sistemit retikulo endotelial të mëlçisë.
B) një enzimë proteolitike që shndërron angiotenzinogjenin në angiotenzinë.
C) një protează që shndërron kazeinën solubule në kazeinë insolubile.
D) një peptid që rregullon kapacitetin e filtrimit të glomerulave.
E) një faktor hormonal që rregullon prodhimin e uresë.
PS)B

Pyetja 624 V)1

Laktat dehidrogjenaza e muskulit skelektik:

A) është një proteinë monomere.
B) është një enzimë alosterike.
C) është e lokalizuar në mitokondrite
D) është enzima që kufizon shpejtësinë e glikolizës.
E) është një izoenzimë.
PS)E

Pyetja 625 V)1

Porfobilinogjeni është një prekursor:

A) i sintezës së riboflavinës.
B) i sintezës së kolesterolit.
C) i sintezës së porfirinës
D) i sintezës së biliverdinës
E) i sintezes se acideve biliare
PS)C

Pyetja 626 V)1

Acidi glukuronik është:

A) një produkt i ndërmjetëm i glikolizës.
B) një aminoacid.
C) i përdorshëm në biosintezën e bazave pirimidinike.
D) i përdorshëm për konjugimin e bilirubinës
E) një produkt i ndërmjetëm i shuntit të hekzosë monofosfatit.
PS)D

Pyetja 627 V)2

Duke dashur të studiojmë fumarazën, cila nga fraksionet subqelizore është më e pershtatshme për t'u përdorur?

A) peroksizomet
B) lizozomet
C) mitokondrite
D) citozolin
E) mikrozomet
PS)C

Pyetja 628 V)1

Receptori për insulinën:

A) është një tetramer me dy nënnjësi alfa dhe dy beta.
B) është një receptor- kanali jonik.
C) përmban një sasi të rëndësishme lipidesh.
D) përmban një pjesë nukleotidike në pjesën ekstraqelizore.
E) përmban edhe një vend që lidh kalciumin.
PS)A

Pyetja 629 V)1

Kreatina:

A) gjendet tek rruazat e kuqe.
B) është një tripeptid që përmban glutamate.
C) është një protein e indit muscular.
D) transformohet në fosfokreatinë nëpërmjet reaksionit të kthyeshëm të katalizuar nga kreatine kinaza.
E) është veçanërisht e pranishme në mëlçi ku paraqet një rezervë energjie.
PS)D

Pyetja 630 V)1

Hormonet :

A) kalojnë të gjithë membranat qelizore.
B) Kanë një veprim direkt mbi reaksionet enzimatike.
C) janë një grup substancash kimikisht homogjene.
D) kanë gjithmonë receptorë në membranë.
E) mund të rrjedhin si nga aminoacidet dhe lipidet.
PS)E

Pyetja 631 V)1

Metabolizmi i kalciumit rregullohet në nivel hormonal nga :

A) vitamina D.
B) glukagoni.
C) kalmodulina.
D) insulina.
E) hormonet e tiroides.
PS)A

Pyetja 632 V)1

Absorbimi intestinal i glukozes kërkon ndërhyrjen e një transportuesi që vepron:

A) në drejtim të njëjtë me Na+.
B) në drejtim të kundërt me K+.
C) në drejtim të kundërt me Na+.
D) me anë të difuzionit të thjeshtë.
E) në drejtim të njëjtë me K+.
PS)A

Pyetja 633 V)2

Trupat ketonike:

A) përmbajnë energji të përdorshme për qëllime metabolike.
B) bëjnë pjesë në shtresën dyfishe lipidike të membranës.
C) përfaqësojnë një produkt mbetjesh të vështira për t'u përdorur.
D) përdoren nga qelizat për të sintetizuar glukozën.
E) kanë prirjen për ta kthyer pH e gjakut në bazik.
PS)A

Pyetja 634 V)2

Cili është pohimi i saktë? Hormoni i paratiroides rregullon përqëndrimin e joneve calcium në gjak

A) duke rritur perthithjen e kalciumit në intestin.
B) duke provokuar akumulimin e kalciumit në kocka.
C) duke rritur ekskretimin e kalciumit në veshka.
D) duke provokuar akumulimin e fosfatit në kocka.
E) duke rritur ekskretimin e fosfatit në veshka.
PS)E

Pyetja 635 V)1

Insulina është:

A) prodhuar nga ishujt glukosensibel të mbiveshkoreve.
B) një heterodimer i mbajtur nga dy ura bisulfide.
C) një glukoproteine e përmasave të mëdha.
D) edhe një nxitës i mobilizimit të acideve yndyrore nga indi dhjamor.
E) një polipeptid që përmban hydroxyprolinë dhe hydroxylysinë.
PS)B

Pyetja 636 V)1

Energjia për sintezën e ATP përftohet kryesisht

A) nga katabolizmi i proteinave
B) nga fosforilimi oksidativ
C) nga procesi i glikolizës
D) me anë të reaksionit të fosforilimit në nivel substrati
E) nga hidroliza e molekulave me përmbajtje të lartë energjie
PS)B

Pyetja 637 V)1

Peptidet:

A) kalojnë me lehtësi membranën plazmatike
B) formohen nga polimerizimi i amminoacideve.
C) janë pa aktivitet biologjik.
D) gjenden në brendësi të qelizave.
E) rrjedhin vetëm nga katabolizmi i proteinave.
PS)B

Pyetja 638 V)1

Sintesa e uresë tek njeriu:

A) ndodh në veshka.
B) përbën mekanizmin kryesor te ekskretimin të azotit.
C) kryhet pa pjesëmarrjen e enzimave.
D) lëshon amoniakun në veshka.
E) prodhon acidin urik.
PS)B

Pyetja 639 V)2

Oksidimi i plotë i sasisë së përbërjeve të treguara me më poshtë prodhon në gjitha rastet 18 CO_2. Nga cili përbërës një organizëm nxjerr më shumë energji?

A) nje mol acidi stearik (C 18)
B) 6 mole glicerol
C) 3 mole glukoze
D) 6 mole piruvat
E) 9 mole acetil-CoA, e cila është tashmë një molekulë e pasur në energji
PS)A

Pyetja 640 V)1

Çfarë kuptojmë me strukturë primare të proteinave?

A) sekuenca e aminoacideve që formojnë proteinën
B) numri i aminoacideve që përbëjnë proteinën
C) numri i nënnjësive të një proteine
D) struktura e proteinave
E) perqindja e aminoacideve te ndryshme
PS)A

Pyetja 641 V)2

Në fermentimin alkoolik, përveç etanolit, përftohet kryesisht:

A) acid acetik.
B) acid sucinik.
C) acid laktik.
D) glicerinë
E) dioksid karboni
PS)E

Pyetja 642 V)1

Cili nga përbërësit e mëposhtëm është prodhuar nga dekarboksilimi i një aminoacidi?

A) acidi guanidinacetik
B) glutamina

C) histamina
D) glutationi
E) spermidina
PS)C

Pyetja 643 V)2

Cili nga gjendjet hematologjike çon në trombozë?

A) ulja e trombinës
B) ulja e trombociteve
C) ulja e fibrinogjenit
D) rritja e albuminës
E) rritja e katekolaminave
PS)E

Pyetja 644 V)1

Acidi glutamik:

A) është një produkt i ndërmjetëm në ciklin e Krebsit.
B) është aminoacidi tipik lipogenetik.
C) nuk është substrati i transaminazave.
D) trasformohet në acidin alfa-ketoglutarik më anë të një deaminimi oksidativ
E) është një aminoacid esencial.
PS)D

Pyetja 645 V)1

Azoti i ardhur nga katabolizmi i proteinave, te gjitarët, eleminohet si:

A) amide biliare.
B) ure.
C) amoniak.
D) acid urik.
E) poliamina.
PS)B

Pyetja 646 V)1

Talasemia shkaktohet nga:

A) autoantikorpet qarkulluese.
B) përqëndrimi i ulët i hekurit në serum.
C) aplazia e palcës kockore.
D) deficenca e sintezës së vargut globinik alfa ose beta të hemoglobinës.
E) deficienca e vitaminës B12.

PS)D

Pyetja 647 V)2

Zhvendosja e joneve kalcium permes membranes ndodh:

A) me mekanizmin e transportit aktiv në drejtim të njëjtë(simport).
B) duke mbajtur jonin me të koncentruar në brendësi të qelizës.
C) pa konsumin e ATP-së.
D) në vijim të lidhjes të kompleksit kalcium-kalmoduline me transportuesin.
E) me mekanizmin e trasportit të ndërmjetësuar pasiv.
PS)D

Pyetja 648 V)1

Cilat janë limitet fiziologjike të pH të gjakut?

A) 7,35 - 7,45
B) 7,28 - 7,46
C) 7,38 - 7,50
D) 7,24 - 7,44
E) 7,30 - 7,40
PS)A

Pyetja 649 V)2

Sfingomielina është:

A) një glikolipid i indit nervor.
B) një fosfolipid veçanërisht i bollshëm tek VLDL.
C) glikoproteinë muskolare.
D) një proteolipid pa ngarkesë.
E) një fosfolipid që përmban kolinë dhe nje acid yndyror.
PS)E

Pyetja 650 V)1

Karboksihemoglobina:

A) formohet pas një procesi oksidativ te Fe 2 + me formimin e një joni superoksid.
B) rrjedh nga lidhja e hemoglobinës me monoksidin e karbonit .
C) rrjedh nga lidhja e hemoglobinës me dioksidin e karbonit.
D) mund të lidhë vetëm një molekulë oksigjen.
E) gjendet në mitokondrite e indit muskular.
PS)B

Pyetja 651 V)1

Nje element reduktohet kur:

A) merr protone.
B) humb protone.
C) merr elektrone.
D) numri i tij i oksidimit behet me pozitiv
E) leshon elektrone
PS)C

Pyetja 652 V)2

Lecitine-kolesterol acil transferaza (LCAT):

A) trasferon kolesterolin mbi lecitinën.
B) në qendër të HDL kondenson kolesterolin dhe lecitinën për të rritur hidrofobicitetin e saj.
C) shkëmben lecitinën dhe kolesterolin mes HDL dhe LDL .
D) trasferon metilet e lecitinës të kolesteroli.
E) në sipërfaqe të HDL konverton lecitinën dhe kolesterolin e lirë në lizolecitinë dhe kolesterol të esterifikuar.
PS)E

Pyetja 653 V)2

Citokromi c kalon nga gjendja e oksiduar në gjendje të reduktuar:

A) me anë të marrjes së një elektroni.
B) me anë të marrjes së një hidrogjeni.
C) me anë të marrjes së një joni H.
D) me anë të marrjes së një protoni.
E) me ane të marrjes së një molekule oksigjeni.
PS)A

Pyetja 654 V)2

Cili është pohimi i sakte per mineralkortikoidet ?

A) Mineralkortikoidet sintetizohen duke u nisur nga adrenalina.
B) Mineralkortikoidet sintetizohen duke u nisur nga ACTH.
C) Mineralkortikoidet sintetizohen duke u nisur nga kolesteroli.
D) Mineralkortikoidet sintetizohen duke u nisur nga metionina.
E) Mineralkortikoidet sintetizohen duke u nisur nga acidi palmitik.
PS)C

Pyetja 655 V)1

Cili nga këta acide është një acid yndyror esencial?

A) acidi palmitoleik
B) acidi stearik
C) acidi arachidonik
D) acidi palmitik
E) acidi oleik
PS)C

Pyetja 656 V)1

Ko-enzimat:

A) rrjedhin nga aminoacidet.
B) mund te lidhen me enzimat.
C) janë të natyrës inorganike .
D) janë veçanërisht rezistente ndaj nxehtësisë .
E) kanë funksion inhibimin e enzimave.
PS)B

Pyetja 657 V)1

Cilat qeliza përmbajnë sasi të mëdha heparinë dhe histaminë?

A) limfocitet
B) leukocitet polimorfonukleare
C) leukocitet eozinofile
D) monocitet
E) bazofilet dhe qelizat- mast(mast cells)
PS)E

Pyetja 658 V)2

Cili është pohimi i gabuar? Enzimat alosterike:

A) mund të kenë një koperativitet negativ dhe pozitiv.
B) kanë një kinetikë reaksioni që ndjek ekuacionin e Michaelis dhe Menten.
C) zakonisht kanë një strukturë kuaternare.
D) janë përgjithësisht proteina oligomerike.
E) në një grafik të shpejtësisë si një funksion i përqendrimit të substratit, kurba e aktivitetit ka, në përgjithësi, një prirje të tipit sigmoid
PS)B

Pyetja 659 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me ARN Messengere është i gabuar?

A) Është në gjendje të lidhet tek ribozomet

B) Përfundon gjithmonë në ekstremitetin '3', me sekuencën nukleotide CCA (citidinë, citidinë, adenine)
C) Sintetizohet në nivelin nuklear.
D) Zotëron"codon".
E) Përbëhet nga një varg i vetëm polinukleotidik
PS)B

Pyetja 660 V)2

Në përgjigje të uljes së vazhdueshme të presionit të pjesshëm të oksigjenit në ajër, në gjak vërehet:

A) rënie e përqendrimit të 2,3 difosfogliceratit.
B) rritje e përqendrimit të methemoglobinës.
C) rritje e numrit të eritrociteve qarkulluese.
D) ulje e afinitetit të 2,3 difosfogliceratit për hemoglobinën.
E) ulje e përqëndrimit të hekurit.
PS)C

Pyetja 661 V)2

Cili nga pohimet është i gabuar?

A) Enzima suksinat dehidrogjenaze bën pjësë në ciklin e Krebsit
B) Cikli i Krebsit ka lokalizim mitokondrial
C) Në ciklin e Krebsit prodhohen CO2 dhe ujë
D) GTP e formuar në ciklin e Krebsit mund të përdoret për fosforilimin e ADP ne ATP
E) Në ciklin e Krebsit prodhohen koenzima te reduktuara
PS)C

Pyetja 662 V)1

ATP prodhohet nga ADP + Pi:

A) me konsumin e energjisë së ardhur direkt nga glikoliza .
B) duke përdorur energjinë e prodhuar nga reaksionet e oksidimit në lizozome.
C) duke përdorur energjinë e gradientit elektrokimik të prodhuar nga vargu respirator.
D) pa konsum të veçantë të energjisë.
E) duke përdorur energjinë e pompës se natriumit.
PS)C

Pyetja 663 V)1

Cili nga pohimet në lidhje me 'citratin' është i saktë?

A) Është një aktivizues alosterik i fosfofruktokinazes.
B) Është një trup ketonik.

C) Përdoret në mitokondri per te formuar kolesterolin.
D) Shndërrohet në isocitrate në ciklin e Krebsit nëpërmjet një reaksioni oksidim-reduktimit.
E) Ndahet në citoplazmë në acetilCoA dhe oksaloacetat në prani të ATP-së.
PS)E

Pyetja 664 V)2

Cila nga enzimat apo sistemet enzimatikë e listuara më poshtë nuk është i përfshirë në Ciklin e Krebsit?

A) malat dehidrogjenaza
B) suksinat dehidrogjenaza
C) alpha-ketoglutarat dehidrogjenaza
D) piruvat dehidrogjenaza
E) fumarat hidrataza (fumaraza)
PS)D

Pyetja 665 V)3

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë në lidhje me amyloidozën?

A) Zonat e para të prekura janë ato perivaskulare.
B) Proteina e pranishme në amyloidozen sekondare është e lidhur me atë të amyloidozës primare.
C) Ngjyrosja me Sudan V është me e përdorshmja për diagnostikimin.
D) Amyloidoza primare është e përbërë nga grumbullime të proteinave globulare.
E) Proteina e pranishme në formën e amyloidit te lidhur me mielomën multiple është homologia e pjesës konstante të vargut të lehtë imunoglobulinave.
PS)A

Pyetja 666 V)2

Përmbajnë ceramid:

A) acidi sialik.
B) sfingolipidet.
C) fosfogliceridet.
D) acido N-acetilneuroamminik.
E) glikogjeni.
PS)B

Pyetja 667 V)1

Nga acidi pantotenik vjen:

A) metionina.
B) koenzima Q.

C) retinali dhe retinoli.
D) koenzima A.
E) glutationi.
PS)D

Pyetja 668 V)1

Heparina është:

A) një peptid i nevojshëm për të formuar koagulin.
B) një proteinë që rregullon prodhimin hepatik të biles .
C) një kromoproteinë.
D) një lipoproteina .
E) një proteoglikan.
PS)E

Pyetja 669 V)2

A mund të fusin lidhje dyfishe në molekulat e acideve yndyrore qelizat mamifere?

A) Po, por vetëm mbi C karboksilik
B) Po, por vëtëm në C9-C10.
C) Jo.
D) Po, por veç(tej) C 9
E) Po, në cdo lloj pozicioni.
PS)B

Pyetja 670 V)2

Leucina, isoleucina e valina:

A) janë aminoacide me varg të degëzuar dhe janë esenciale.
B) janë prekursorë të klasave të ndryshme të melaninës.
C) mund të sintetizohen por vetëm nga qelizat e SNC-së .
D) janë aminoacide aromatike.
E) janë veçanërisht të bollshme në lengun biliar.
PS)A

Pyetja 671 V)1

Cikli i uresë:

A) përdor karbamilfosfat që sintetizohet duke u nisur nga glutamina dhe CO_2.
B) prodhon ure, formula e së cilës është $NH_2\text{-}CH_2\text{-}NH_2$.
C) prodhon uren e mjaftueshme për sintezën e bazave purinike .
D) është një proces ciklik që sintetizon ure në veshka.
E) është një rrugë metabolike tipike hepatike.

PS)E

Pyetja 672 V)1

Tretja e niseshtes bëhet:

A) në lumenin intestinal me formimin e maltozës, maltotriozës dhe dekstrinës limite.
B) në brendësi të qelizave të mukozës intestinale.
C) me prodhimin e disaharideve që ndahen nga laktaza intestinale.
D) nga veprimi e alfa-amilazës e cila është një ekzonukleaze e prodhuar nga pankreasi.
E) në pH acid në nivelin e stomakut.
PS)A

Pyetja 673 V)2

Cili nga metabolitët nuk është një produkt i ndërmjetëm në rrugën e PENTOZE FOSFATIT?

A) ribuloze-5-fosfati
B) acido 6-fosfo-glukonik
C) acidi-1-fosfo glukoronik
D) ksiluloze-5-fosfati
E) 6-fosfoglukonolaktoni
PS)C

Pyetja 674 V)2

Janë produkte të katabolizmit të hemit:

A) hemosiderina
B) porfobilinogjeni
C) karboksihemoglobina
D) acidet biliare
E) bilirubina
PS)E

Pyetja 675 V)1

Inhibitoret konkurues të enzimave:

A) lidhen me substratin.
B) lidhen në një vend alosterik.
C) lidhen në kompleksin ES .
D) nuk lidhen me enzimat.
E) lidhen me qendrën aktive të enzimës.
PS)E

Pyetja 676 V)1

Në përgjithësi në një qelize numri i receptorëve të hormoneve funksionale të një lloji të caktuar:

A) është rastësor.
B) varet nga shpejtësia e metabolizmit bazal të individit.
C) është e para përcaktuar në lindje dhe nuk ndryshon gjatë jetës.
D) mund të rregullohet fiziologjikisht dhe të ndikohet nga sëmundje ose agjentë farmakologjikë
E) varet nga përqindja e kolesterolit të membranës qelizore, pra nga fluiditeti i saj, e cila kushtëzon qëndrueshmërinë.
PS)D

Pyetja 677 V)1

Cila enzimë nuk mer pjesë në formimin e uresë?

A) ornitine karbamiltransferasa
B) karbamilfosfat sintetaza
C) isocitrat deidrogenaza
D) arginaza
E) arginine suksinat liaza
PS)C

Pyetja 678 V)2

Fosfofruktokinaza, një nga enzimat që kryen rregullimin e glikolizës, është:

A) një enzimë që frenohet nga glukoze-1-P.
B) Një enzimë që nxitet nga fosfoenolpiruvati.
C) një enzimë alosterike që frenohet nga ATP dhe nxitet nga AMP-ja.
D) një enzimë që frenohet nga acidi laktik.
E) një enzimë që nxitet nga citrati.
PS)C

Pyetja 679 V)1

Cili nga hormonet e mëposhtme ndërvepron me një receptor membror?

A) progesteroni
B) trijodotironina
C) testosteroni
D) acidi retinoik
E) insulina
PS)E

Pyetja 680 V)2

Cili nga pohimet në lidhje me teorinë kemio-osmotike të fosforilimit oksidativ është i gabuar?

A) Rifutja e protoneve në matriks dhe sinteza e ATP ndërmjetësohen nga kompleksi i ATP sintetazës
B) Transporti i protoneve nëpër membranën e brendshme mitokondriale (MMI) e bën matriksi më acide se hapësira ndermembranore.
C) Gradienti elektrokimik përcaktohet nga 2 komponentë; ndryshimi i potencialit elektrik dhe diferenca e pH në të dy anët e MMI-së.
D) Energjia e lëshuar nga fluksi i elektroneve në vargun respirator është përdorur për të zhvendosur protonet nga matriksi mitokondrial në hapësiren ndërmembranore.
E) Fluksi i elektroneve shkakton një gradient elektrokimik nëpër MMI.
PS)B

Pyetja 681 V)2

Cili është pohimi i saktë? Beta-oksidimi i një acidi yndyror me numër tek atomesh karboni:

A) prodhon propionil CoA.
B) përdor vetëm acide yndyrore të pangopur.
C) ndodh në citozol.
D) prodhon malonil CoA.
E) prodhon vetem acetil CoA.
PS)A

Pyetja 682 V)1

Cilat nga grupimet e mëposhtme të aminoacideve përmban numrin më të madh të aminoacideve esenciale?

A) ac.glutamik, serina, alanina, ac.aspartik, triptofani
B) alanina, glicina, ac.aspartik, ac.glutamik, arginina
C) triptofano, alanina, prolina, ac.glutamik, ac.aspartik
D) fenilalanina, triptofano, metionina, lizina, ac.aspartik
E) tirosina, fenilalanina, glicina, serina, ac.aspartik
PS)D

Pyetja 683 V)1

Mitokondriet:

A) janë te papërshkueshme nga oksigjeni dhe dioksidi i karbonit.
B) janë gjithashtu të pranishëm edhe ne qelizat prokariote.
C) janë veçanërisht të depërtueshme ndaj metaboliteve dhe kofaktorëve.
D) janë të pranishme në të gjitha qelizat eukariote.
E) mund të ndryshojnë në numër në inde të ndryshme.
PS)E

Pyetja 684 V)2

Cila nga këto koenzima është ajo e laktatdehidrogjenazës?

A) Ubikinoni
B) NADPH +H+
C) NADH + H+
D) FAD
E) Acidi lipoik
PS)C

Pyetja 685 V)1

Cili është polisakaridi rezervë i pranishëm në indet e kafshëve?

A) amidoni
B) sakaroza
C) amiloza
D) glikogjeni
E) dekstrani
PS)D

Pyetja 686 V)1

Rregullimi i piruvat dehidrogjenazës varet nga:

A) disponueshmëria e oksalacetatit.
B) përqendrimi i joneve kalium.
C) aktiviteti i piruvat dehidrogjenazë kinazës.
D) disponueshmëria e propionil-CoA.
E) përqëndrimi i trupave ketonikë.
PS)C

Pyetja 687 V)1

Në diabetin melitus, ketoza provokohet nga:

A) një reduktim i glukoneogjenezës.
B) një renie e katabolizmit të glukozës .
C) një rënie e katabolizmit proteinik.
D) një rritje e liposintezës.
E) një rënie e glikogjenolizës.
PS)B

Pyetja 688 V)1

Laktoza që merret nga dieta:

A) thithet si e tillë dhe tranformohet në glukozë dhe galaktozë në nivel hepatik.
B) hidrolizohet në glukozë dhe galaktozë nga enzimat e membranës së pranishme në qelizat e mukozës intestinale.
C) tretet nga enzimat në lëng pankreatik.
D) duke paraqitur një lidhje beta glikozidike nuk mund të hidrolizohet
E) është sheqeri tipik i frutave.
PS)B

Pyetja 689 V)1

Tek indet e njeriut, cila nga enzimat mund të zbertheje glikogjenin?

A) laktaza
B) sakaroza
C) glikogjen oksidaza
D) glikogjen fosforilaza
E) glikogjen liaza
PS)D

Pyetja 690 V)1

Hekuri trasportohet në lëngjet e organizmit:

A) i lidhur me hemin
B) në formën ferrike
C) i lidhur me grupet SH të albuminës
D) i lidhur me imunoglobulinën
E) i lidhur me ferritinën
PS)B

Pyetja 691 V)2

Cila është diferenca mes reaksioneve të precipitimit dhe aglutinimit ?

A) në precipitim ndërhyn sistemi komplementar
B) në precipitim antigeni është i natyrës solubile
C) precipitimi realizohet në kohë më të gjatë
D) në precipitim antigeni është i natyrës korpuskulare
E) në precipitim immunoglobulinat që marrin pjësë në formimin e immno-komplekseve janë IgA
PS)B

Pyetja 692 V)1

Karnitina shërben për:

A) trasportin e acideve yndyrore të aktivizuara në brendësi të mitokondrive.
B) të prodhuar mioglobinën për të cilën është prekursor.
C) depozitimin e acidive yndyrore në indin dhjamor.
D) të fiksuar vargun në formim gjatë sintezës së acideve yndyrore.
E) depo energjie për indin muskular.
PS)A

Pyetja 693 V)2

Cili nga pohimet në lidhje me F0 - F1 ATP-azen nuk është i saktë?

A) redukton oksigjenin në ujë
B) formohet nga nën-njësi të ndryshme.
C) inhibohet nga oligomicina.
D) mund të katalizojë edhe reaksione të hidrolizës së ATP-së
E) lejon kalimin e protoneve nga ana citoplazmatike ne anen e matriksit.
PS)A

Pyetja 694 V)2

Acidi tetrahidrofolik është:

A) një trasportues i njësive me një atom karboni.
B) një vitaminë liposolubile.
C) një kofaktor i nevojshëm për funksionimin e disa kinazave .
D) një faktor koagulimi.
E) një agjent oksidant citoplasmatik.
PS)A

Pyetja 695 V)1

Molekula e ATP-së nuk përmban:

A) adenozinë
B) një lidhje anidridike
C) një lidhje N-glicosidike
D) një lidhje tioesteri
E) ribozë
PS)D

Pyetja 696 V)1

Një inhibitor i tipit konkurues:

A) mban kostant raportin Km/Vmax.
B) ka një strukturë shumë të ndryshme nga ajo e substratit.

C) ndërvepron me një vend alosterik të enzimës.
D) reagon duke ulur Vmax e reaksionit enzimatik.
E) krahasuar me raksionet pa inhibues bën të ndryshojë Km, por jo Vmax.
PS)E

Pyetja 697 V)1

Trasformimi i 7-dehidrokolesterolit në kolekalciferol ndodh:

A) në veshka.
B) në retikulocite.
C) në lëkurë.
D) në mushkëri .
E) në korne.
PS)C

Pyetja 698 V)1

Glukagoni është një hormon që:

A) ka natyrë steroide.
B) sekretohet pas një vakti të pasur me karbohidrate.
C) lirohet nga qelizat beta të pankreasit.
D) reagon në nivel të indit hepatik dhe indit dhjamor .
E) kalon me lehtësi membranën plazmatike.
PS)D

Pyetja 699 V)1

Histidina shndërrohet në histaminë me anë të një reaksioni:

A) metilimi.
B) hidroksilimi.
C) reduktimi me NADH .
D) dekarboksilimi.
E) transaminimi.
PS)D

Pyetja 700 V)3

Demenca, dermatiti dhe diarrea ndeshen në:

A) deficiencën e nikotinamidit.
B) deficiencën e vitaminës D .
C) deficiencën e tiaminës.
D) deficiencën e vitaminës B6.
E) deficiencën e vitaminës K.

PS)A

Pyetja 701 V)2

Tek eritrocitet mature, NADH +H+ e formuar në procesin glikolitik rioksidohen:

A) nga oksigjeni qe permban eritrociti.
B) nga glukoze-6-fosfat dehidrogjenaza.
C) nga nje enzime qe ka si substrat dihidroksiacetonfosfatin.
D) nga enzima laktat dehidrogjenaze.
E) direkt nga kompleksi 1° i vargut respirator mitokondrial.
PS)D

Pyetja 702 V)2

Cili nga pohimet në lidhje me 'inhibimin enzimatik' është i gabuar?

A) Inhibimi jo-konkuruese nuk largohet me rritjen e përqëndrimit të substratit .
B) Në inhibimin konkurues nuk ndryshon Vmax por rritet Km
C) Në inhibimin konkurues ka konkurencë mes frenuesit dhe substratit për vendin alosterik të enzimës.
D) Karakteristikë e inhibimit konkurues është kthyeshmëria e saj nga rritja përqendrimin e substratit.
E) Në inhimin jo-konkurues nuk e ndryshon Km por ulet Vmax
PS)C

Pyetja 703 V)1

Anemia megaloblastike shkaktohet nga:

A) deficienca e vitaminës B12.
B) antikorpet qarkulluese.
C) deficienca e sintezës së vargut globinik alfa ose beta të hemoglobinës.
D) përqëndrimi i ulet serik i hekurit.
E) aplazia e palcës së kockave.
PS)A

Pyetja 704 V)1

Nga piruvati mund të rrjedhin direkt:

A) malonati e glutamati.
B) laktoni me gjatësi të ndryshme.
C) citrati, propionil-CoA e suksinil-CoA .
D) laktati, acetil-CoA, oksalacetati, alanina .
E) dihidroksiacetoni dhe gliceraldehida.
PS)D

Pyetja 705 V)1

FETIL-KETONONURIA është një sëmundje e rëndë e shkaktuar nga:

A) një defekt gjenetik i enzimës që katalizon deaminimin oksidativ të fenilalaninës.
B) marrjet e ulëta me dietë të tirozinës.
C) marrjet e ulëta me dietë të fenilalaninës.
D) një defekt gjenetik i enzimës të përfshirë në thithjen intestinale të aminoacidit.
E) një defekt gjenetik i enzimës që shndërron fenilalaninen në tirozinë.
PS)E

Pyetja 706 V)2

Procesi i dekarboksilimit oksidativ të piruvatit kërkon gjithashtu ndërhyrjen e:

A) biotinës.
B) difosfotiaminës.
C) sarkozinës.
D) piridoksalfosfatit .
E) riboflavinës.
PS)B

Pyetja 707 V)2

Produkti i fundit i katabolizmit të purinave tek njeriu është:

A) acidi urik.
B) alantoina.
C) urea.
D) kreatinina.
E) amoniaku.
PS)A

Pyetja 708 V)1

Cili nga pohimet në lidhje me veprimin e insulinës, është i vërtetë?

A) Vepron tek qelizat dhjamore duke aktivizuar lipazën hormonosensibile intraqelizore.
B) Frenon sentezën e glikogjenit në muskuj dhe mëlçi.
C) Vepron mbi hepatocitet duke nxitur sintezën e glukokinazës.
D) Frenon glikolizën.
E) Frenon fosfodiesterazën dhe aktivizon adenilat ciklazën.
PS)C

Pyetja 709 V)1

Cikli i Krebsit lejon:

A) formimin e koenzimës NADP së reduktuar.
B) përdorimin e oksalacetatit për glukoneogjenezë.
C) transformimin e AcetilCoA në përbërje glucidike.
D) rioksidimin e koenzimave piridinike.
E) oksidimin e AcetilCoA në dioksid karbonit dhe uji.
PS)E

Pyetja 710 V)2

Cili është prekursori i menjëhershëm metabolik në sintezën e acetoacetatit?

A) acidi betahidroksibutirik
B) beta-hidroksi-beta-metilglutarilCoA
C) suksinilCoA
D) acetilCoA
E) acidi acetik
PS)B

Pyetja 711 V)2

Cili nga faktorët nuk ndikon, në përgjithësi, në shpejtësinë e 'migrimit elektroforetik'?

A) pesha molekulare
B) struktura e molekulës
C) aktiviteti enzimatik
D) pika izoelektrike
E) ngarkesa elektrike
PS)C

Pyetja 712 V)1

Një enzimë restriktive konsiderohet:

A) një endonukleazë që pret ADN me helikë të dyfishtë në sekuenca të veçanta .
B) një enzimë që ndërhyn gjatë sintezës së proteinave.
C) një endonukleazë që pret ADN në helika teke në sekuenca të veçanta.
D) një endonukleaze që eliminon gabimet e verfikuara gjatë sintezës së ADN.
E) një enzimë që ndërhyn në procesin e riparimit të ADN.
PS)A

Pyetja 713 V)1

Glukozë-6-P:

A) transportohet nga mëlçia për në të gjithë indet e tjerë.

B) akumulohet si e tillë në qeliza.
C) matabolizohet vetëm nëpërmjet glikolizës.
D) paraqet formen metabolikisht aktive të glukozës .
E) është një ester fosforik me energji të madhe.
PS)D

Pyetja 714 V)2

Spektrina është:

A) një lipoproteinë trasporti në plazëm.
B) një proteinë e membranës eritrocitare.
C) banda spektrale e aminoacideve aromatike të proteinave.
D) spektri i absorbimit të një proteine.
E) një glikolipid i membranës.
PS)B

Pyetja 715 V)3

Dy proteinat (A dhe B) duke iu nënshtruar elektroforezës për një kohë të përshtatshme duke përdorur një tampon në pH = 7.0. Çfarë tipi migrimi vërehet, duke e ditur se pika izoelektrike e proteinës A është 5.5, ndërsa e B është 8.5?

A) migrojnë të dyja drejt polit pozitiv (anodes)
B) proteina A migron drejt polit pozitiv (anodes) ndërsa proteina B nuk migron
C) proteina A migron drejt polit negativ (katodes) ndërsa proteina B drejt polit pozitiv (anodes)
D) migrojnë të dyja drejt katodës ose anodes në varësi të fuqisë jonike të mjedisit
E) proteina A migron drejt polit pozitiv (anodes) ndërsa proteina B drejt atij negativ (katodes)
PS)E

Pyetja 716 V)1

Tek njerëzit, është i mundur kthimi i:

A) fenilalaninës në tirozinë.
B) piruvatit në leucinë .
C) oksalacetatit në valinë.
D) acidit aspartik në izoleucinë .
E) argininës në lizinë.
PS)A

Pyetja 717 V)1

Piridoksal fosfati përmban:

A) një unazë piridinike.

B) një unaze benzene.
C) një strukturë jo aromatike.
D) një unazë purinike.
E) një lidhje anidride.
PS)A

Pyetja 718 V)2

Aminat biogjene formohen nga aminoacidet:

A) nga dekarboksilimi.
B) me anë të një reaksioni deaminimi oksidativ.
C) nga hidroliza.
D) me anë të një reaksioni transaminimi.
E) me anë të një reaksioni jo enzimatik.
PS)A

Pyetja 719 V)1

Për transportin korrekt të oksigjenit hekuri i hemoglobinës:

A) duhet të jetë në gjendje metalike
B) duhet të lidhë ujin
C) duhet të jetë 2 valent (forma ferroze)
D) duhet të lidhë më parë C02
E) duhet të jetë 3 valent(forma ferrike)
PS)C

Pyetja 720 V)1

Nga çfarë shkaktohet talasemia?

A) nga prania e metahemoglobinës
B) nga një zvogëlim i numrit të nën-njësive
C) nga një defekt në sintezën e hemoglobinës
D) nga prania e hemoglobinës së glukozuar
E) nga prania e hemoglobinës A2
PS)C

Pyetja 721 V)1

Cila është struktura kimike e prostaglandinave?

A) acide yndyrore të pangopur
B) acide yndyrore të ngopur
C) fosfolipide
D) acide yndyrore ciklike

E) proteinë
PS)D

Pyetja 722 V)2

Komplekset lipoproteike:

A) përmbajnë ekskluzivisht triacilglicerole dhe proteina.
B) transportojnë energjinë në formën e yndyrnave.
C) vijnë vetëm nga dieta ushqimore.
D) formohen vetëm në mëlçi.
E) përmbajnë kryesisht kolesterol.
PS)B

Pyetja 723 V)1

Cila nga përbërjet e mëposhtme nuk mund të përdoret për glukoneogjenezën?

A) acidi laktik
B) leucina
C) gliceroli
D) acidi glutamik
E) acidi fumarik
PS)B

Pyetja 724 V)2

Cili nga pohimet në lidhje me trupat ketonikë është i saktë?

A) Nëse formohen me tepricë, eliminonohen nga lizozomet.
B) Mund të sintetizohen duke u nisur nga HMGCoA citoplazmatike .
C) Formohen vetëm kur oksidimi i acideve yndyrore bllokohet.
D) Mund të sintetizohen komplet në citoplazëm
E) Nuk përdoren nga mëlçia për qëllime energjitike.
PS)E

Pyetja 725 V)3

Cila nga pohimet është i gabuar?

A) Transformimi i fruktozë-1,6-difosfatit në 3-fosfogliceraldehid dhe dihidroksiaceton fosfat katalizohet nga një fosfatazë.
B) Transformimi i fruktoze-1,6-difosfatit ne fruktoz-6-fosfat katalizohet nga një fosfatazë.
C) Formimi i kompleksit aminoacil-tARN-së katalizohet nga një sintetazë.
D) Transformimi i laktatit në piruvat katalizohet nga një dehidrogjenazë.
E) Transformimi i glicerolit në fosfoglicerol katalizohet nga një kinaze.
PS)A

Pyetja 726 V)2

Në ketoacidozën diabetike, indet ekstrahepatike metabolizojnë acidin acetoacetik duke formuar si metabolit të parë një nga përbërjet e meposhtme. Cilën?

A) acidin acetik
B) acetonin
C) kolesterolin
D) HMG-CoA (beta-idroksi-beta-metilglutarilCoA)
E) acetoacetil-CoA
PS)E

Pyetja 727 V)1

Insulina është edhe:

A) një stimuluese e proteinkinazës C .
B) një stimuluese e guanilat ciklazës.
C) një faktor që indukton një rritje të niveleve indore të c- AMP-së .
D) një stimuluese e lipazës adipolitike.
E) një inhibuese e fortë e lipolizës në mëlçi dhe në indin adipoz.
PS)E

Pyetja 728 V)1

Cili nga pohimet që i përkasin transferinës është i vërtetë?

A) Është një proteinë plazmatike e përfshirë në transportin jo specifik të metaleve.
B) Është një beta 1 glikoproteine e përfshirë në transportin e hekurit
C) Është një gamma-globuline e rëndësishme për transportin e hekurit
D) Është një proteinë oligomerike e përbërë nga një numër i madh nënnjësish.
E) Është një beta-globuline e rëndësishme në depozitimin e hekurit.
PS)B

Pyetja 729 V)2

Cili është pohimi i gabuar? Acidi arakidonik:

A) përdoret për sintezën e tromboksanit dhe leukotrienit
B) përmban katër lidhje dyfishe
C) hidrolizohet (çlirohet) nga fosfolipidet e membranës nëpërmjet një fosfolipaze.
D) është një prekursor në sintezën e prostaglandinave në një proces të stimuluar nga aspirina.
E) rrjedh nga acidi linoleik
PS)D

Pyetja 730 V)1

Cili nga aminoacidet mund të formohet nga një proces 'amino transferimi'i një metaboliti të ciklit të Krebsit?

A) serina
B) fenilalanina
C) alanina
D) glicina
E) acidi aspartik
PS)E

Pyetja 731 V)1

Cili është aminoacidi që përdoret kryesisht nga mëlçia për glukoneogjenezën?

A) histidina
B) alanina
C) fenilalanina
D) arginina
E) leucina
PS)B

Pyetja 732 V)2

Për cilën nga sindromat poliurike prova e etjes, që konsiston në ndërprerjen e marrjes së lëngjeve për disa orë, duhet të kryhet me shume kujdes (rrezik jete për të sëmurin)?

A) potomania
B) poliuri primare
C) diabet insipid i vërtetë
D) diabete mellitus
E) polidipsia primare
PS)C

Pyetja 733 V)2

Në trajtimin e sëmundjes së Parkinsonit me amonoacidin DOPA nuk duhet të merret një kompleks polivitaminik që përmban një vitaminë që rrit metabolizmin e DOPA. Cila është kjo vitaminë?

A) piridoksina
B) niacina
C) riboflavina
D) biotina
E) tiamina
PS)A

Pyetja 734 V)2

Cili pohim është i saktë? Glicerol kinaza:

A) është një enzimë me të cilën është i pasur indi adipoz.
B) është një enzimë glikolitike.
C) bën pjesë në mekanizmin që lejon absorbimin e trigliceridеve ushqimore.
D) transformon aldehidin 3-P-glicerike ne alfa- glicerol fosfat dhe anasjelltas.
E) është e rëndësishme për sintezën e trigliceridеve.
PS)E

Pyetja 735 V)2

Hidroliza e AMP ciklike katalizohet nga:

A) një fosfodiesterazë.
B) një AMP-azë.
C) një peroksidazë.
D) një defosforilazë.
E) një nukletid deciklaze.
PS)A

Pyetja 736 V)2

Cili nga pohimet në lidhje me ubikinonin është i saktë?

A) Është një molekulë liposolubile
B) Është transportuesi i elektroneve mes kompleksit III (citokrom c reduktaze) dhe kompleksit IV (citokrom oksidaze) të vargut respirator.
C) Përmban Fe.
D) Është një molekulë e matriksit mitokondrial.
E) Është një vitaminë.
PS)A

Pyetja 737 V)1

HDL:

A) mund të transformohen në kilomikrone duke marre trigliceride nga indi dhjamor.
B) në formën nashente prodhohen nga adipocitet.
C) formohen edhe në nivelin pankreatik.
D) mund të rrjedhin gjithashtu nga kilomikronet.
E) kanë të njëjtat proteina si të VLDL.
PS)D

Pyetja 738 V)2

Cilin efekt nuk e ka Kortizoli ?

A) aktivizon glukoneogjenezën
B) ushtron një efekt antinflamator
C) stimulon lëshimin e glicerolit dhe acideve yndyrore nga indi dhjamor
D) stimulon katabolizmin proteinik në muskul
E) aktivizon glikolizën
PS)E

Pyetja 739 V)2

Uji mund t'i shtohet nje lidhjeje të dyfishtë C = C (pa prishje të lidhjes C-C) me cilën prej enzimave?

A) katalaza
B) hidroliaza
C) esteraza
D) hidrolaza
E) oksidoreduktaza
PS)B

Pyetja 740 V)1

Molekulat që lidhen me qendrën alosterike të një enzime:

A) bëjnë që të ndryshojë konstantja e ekuilibrit të reaksionit.
B) rrrjedhin nga vitaminat liposolubili.
C) mund të ndryshojnë afinitetin e enzimës për substratin.
D) lidhen me lidhje kovalente.
E) kanë vetëm efektet inhibues të aktivitetit enzimatik.
PS)C

Pyetja 741 V)2

Cila nga gjendjet e mëposhtme rritet në nivel hepatik gjatë agjërimit të zgjatur?

A) glikoliza
B) sinteza ex-novo e acideve yndyrore
C) shunti hekzoze monofosfat
D) glukoneogjeneza
E) sinteza e kolesterolit
PS)D

Pyetja 742 V)1

Kolesteroli është:

A) prekursori i hormoneve steroide.
B) një substancë hidrosolubile.
C) nuk është i pranishëm në membranat qelizore.
D) një acid yndyror me 27 atome karboni.
E) një alkool ciklik i pangopur polienoik.
PS)A

Pyetja 743 V)2

Hidroliza e trigliceridеve në adipocitet:

A) Është vecanërisht aktive në stituatat post-prandiale.
B) Është aktive në prani të insulinës.
C) Prodhon acide yndyrore që transportohen nga kilomikronet në plazëm.
D) Katalizohet nga lipaza pankreatike.
E) Katalizohet nga një lipazë hormon-sensibile.
PS)E

Pyetja 744 V)2

Gjatë sintezës de novo të acideve yndyrore:

A) prodhohet NADH.
B) konsumohet NADPH.
C) konsumohet osigjen.
D) përdoret piridoksalfosfat
E) prodhohet acetil-CoA
PS)B

Pyetja 745 V)3

Kompleksi III i vargut respirator transferon elektronet nga:

A) FADH2 te koenzima Q.
B) suksinati te koenzima Q .
C) citokromi a te oksigjeni.
D) NADH + H+ te koenzima Q .
E) koenzima Q te citokromi C.
PS)E

Pyetja 746 V)1

Mëlçia i prodhon acidet biliare:

A) nga hemoglobina me anë të bilirubinës.
B) nga melanina.
C) ngai pigmentet e pranishme në ushqimet e marra.

D) nga hormonet steroide.
E) nga kolesteroli.
PS)E

Pyetja 747 V)1

Cila nga citimet për Mioglobinen eshte i gabuar?

A) Grupi i saj hem përmban një atom hekuri trivalent.
B) Nuk ka strukture kuaternare.
C) Ka një prirje (afinitet) më të madhe për oksigjen ne raport me hemoglobinen.
D) Lokalizohet në nivel muscular.
E) Nuk është në gjendje të bashkëveproje me 2,3 difosfogliceratin
PS)A

Pyetja 748 V)3

Në vargun respirator çdo citokrom trasporton:

A) një atom hidrogjeni
B) një jon hidruri
C) një proton
D) një dyshe elektronesh në të njëjtën kohë
E) një elektron në një kohë
PS)E

Pyetja 749 V)1

Hipersekretimi i hormonit somatotrop tek të rriturit:

A) varet nga rritja e sekretimit te somatostatinës
B) provokon bilanc negative të azotit
C) provokon gjigantizëm
D) provokon hipergonadizëm
E) modifikon kurben e ngarkesës së glukozës
PS)E

Pyetja 750 V)1

Heparina:

A) është me origjinë vegjetale.
B) rrjedh nga serotonina.
C) është një proteinë
D) është një glikozaminoglikan
E) sintetizohet në bërthamë
PS)D

Pyetja 751 V)2

Gjatë fazës së një ushqyerjeje të mirë:

A) glikogeni muskulor përdoret për të prodhuar glukozë që derdhet në gjak .
B) hormoni mbizotërues në qarkullim është glukagoni.
C) insulina favorizon përdorimin e glukozës së gjakut nga ana e indeve të mëlçisë, muskujve dhe indit dhjamor.
D) në mëlçi acetil-CoA që vjen nga shpërbërja e acideve yndyrore shndërrohet në trupa ketonike.
E) indi muskular i përdor aminoacidet për sintezen e glukozës që derdhet në gjak.
PS)C

Pyetja 752 V)2

Aktiviteti i disa faktorëve të koagulimit varet gjithashtu nga:

A) kushtet energjetike të eritrociteve që formojnë koagulin.
B) disponueshmëria e jonit kalcium.
C) niveli i metilkobalaminës.
D) disponueshmëria e vitaminës E .
E) disponueshmëria e vitaminës A.
PS)B

Pyetja 753 V)1

Cila nga këto proteina ka funksion transportues?

A) albumina
B) keratina
C) insulina
D) kollagjeni
E) fibrinogjeni
PS)A

Pyetja 754 V)2

Beta-oksidimi i acideve yndyrore:

A) parashikon tiolizën e lidhjes C alfa - C beta të betachetoacil CoA.
B) fillon gjithmonë nga fundi i ekstremitetit omega të acidit yndyror.
C) rrit aktivitetin e saj nëpërmjet fosforilimi të dehdrogjenazës FAD-vartëse.
D) mund të oksidojë vetëm acidet yndyrore me të gjatë se 20 C.
E) mund të oksidojë vetëm acidet yndyrore me te shkurter se 20 C .
PS)A

Pyetja 755 V)3

Adenomioza prek më shpesh:

A) gratë e grup moshës 30-40 vjeç.
B) gratë pluripare.
C) gratë e grup moshës 40-50 vjeç.
D) B+C.
E) A+B.
PS)D

Pyetja 756 V)3

Nga pikëpamja endokrinologjike, karcinoma e endometrit shoqërohet shpesh me një situatë:

A) hiperandrogjenizmi.
B) hipoestrogjenizmi.
C) hipoestrogjenizëm absolute.
D) hiperestrogjenizëm relative.
E) hipotiroidizëm.
PS)D

Pyetja 757 V)3

Zakonisht është i mundur identifikimi i pacienteve amenoreike, të cilat do të ovulojnë pas administrimit të klomifenit sepse:

A) menstruacionet fillojnë pas përdorimit të një progesteroniku.
B) paraqesin nivele të rritura të prolaktinës.
C) paraqesin nivele të rritura të fsh-së.
D) nuk menstruojnë pas administrimit të një progesteroniku.
E) kanë nivele të rritura të androgjenëve .

PS)A

Pyetja 758 V)2

Faza sekretore në nivel endometrial i dedikohet:

A) veprimit të estrogjenëve
B) veprimit të progesteronit mbi një endometër atrofik
C) veprimit të progesteronit mbi një endometër të pregatitur nga estrogjeni
D) veprimit të inhibinës dhe estrogjenëve
E) efekteve të faktorëve të rritjes endometriale
PS)C

Pyetja 759 V)1

Cili prej preparateve të mëposhtëm mund të shkaktojë hiperprolaktinemi?

A) paracetamoli
B) diazepami
C) ranitidina
D) metoklopramidi
E) fenobarbitali
PS)D

Pyetja 760 V)2

Cili nga citimet e mëposhtëm nuk është shkak i amenoresë?

A) hiperprolaktinemia
B) sindromi Turner
C) pseudociesis
D) diabeti mellitus
E) hiperplazia surenale kongenitale
PS)D

Pyetja 761 V)3

Karcinoma cervikale:

A) mund të ketë ekskluzivisht një pamje makroskopike polipoide.
B) në mbi 50% të rasteve është një adenokarcinomë.
C) në formën G3 shoqërohet me mbijetesë më të gjatë.
D) në stadin i (FIGO) është e kufizuar në kolum.
E) haset më shpesh gjatë shtatzënisë.
PS)D

Pyetja 762 V)1

Në prani të niveleve të rritura të prolaktinës këshillohet.

A) vijimi me terapi zëvendësuese.
B) trajtimi me agonistë të dopaminës.
C) realizimi i rezonancës magnetike të sella turcica.
D) stratigrafia e sella turcica.
E) praktikohet testi i stimulimit me GNRH.
PS)C

Pyetja 763 V)2

Midis simptomave të mëposhtme cila nuk është pjesë e sindromit të ovarit polikistik?

A) hirsutizmi
B) obeziteti
C) oligomenorea
D) aknet
E) pelvialgjia
PS)E

Pyetja 764 V)1

Cila nuk konsiderohet metodë për vlerësimin e endometrit?

A) biopsia endometriale
B) ekografia transvaginale
C) laparoskopia eksplorative
D) histeroskopia dhe biopsia
E) citologjia endometriale
PS)C

Pyetja 765 V)1

Pas plasjes së folikulit në momentin e ovulacionit:

A) formohet një folikul sekondar.
B) vijnë menstruacionet.
C) formohet corpus luteum.
D) folikuli i nënshtrohet atrezisë.
E) rritet frekuenca pulsatile e gnrh.
PS)C

Pyetja 766 V)3

Sindromi Kallmann:

A) është një formë e agenezisë gonadale.
B) është një formë e hipogonadizmit hipogonadotropik.
C) karakterizohet nga nivele të larta të gonadotropinave.
D) shoqërohet me ovare rezistente.
E) indikon heqjen e menjëhershme të donadave.
PS)B

Pyetja 767 V)1

Cikli menstrual zakonisht ndahet në fy faza që përkufizohen:

A) ovulatore dhe jo ovulatore.
B) folikulare dhe luteale.
C) menstruale dhe ovulatore.

D) luteale dhe sekretore.
E) folikulare dhe ovulatore.
PS)B

Pyetja 768 V)2

Karcinoma cervikale in situ është:

A) një lezion me karakteristika histologjike malinje e kufizuar vetëm në epitelin skuamoz.
B) një lezion me karakteristika histologjike që ka invaduar stromën jo më pak se 1 mm.
C) një lezion me karakteristika histologjike i kufizuar në epitelin skuamoz dhe në membranën bazale.
D) një lezion me karakteristika histologjike që ka invaduar stromën jo më shumë se 5 mm.
E) një lezion me karakteristika histologjike beninje.
PS)A

Pyetja 769 V)1

Norma e gjatësisë së kordonit umbilikal është rreth:

A) 25 cm.
B) 50 cm.
C) 90 cm.
D) 120 cm.
E) 15-20 cm.
PS)B

Pyetja 770 V)3

Çrregullime neurologjike, alterime të pamjes hidrocefali dhe kalçifikime cerebrale karakterizojnë formën kongjenitale të:

A) listeriosit
B) toksoplasmosisë.
C) sëmundje nga citomegalovirus.
D) sifilizi.
E) leishmanioza.
PS)B

Pyetja 771 V)2

Gn-RH është:

A) hormon që vendos refleksin e Ferguson.
B) një grup gjaku.
C) hormon me origjinë placentare.

D) hormon me origjinë hipotalamike.
E) një acid yndyror i pasaturuar .
PS)D

Pyetja 772 V)2

Shkaku më i shpeshtë i abortit spontan gjatë tremujorit të parë të shtatzënisë është:

A) pamjaftueshmëria hormonale (insuficienca hormonale).
B) hipotiroidismi.
C) anomali të zhvillimit të produktit të konceptimit (embrionit).
D) anomali uterine.
E) trauma abdominale.
PS)C

Pyetja 773 V)2

Koha mesatare e fazës së parë të aktivitetit (para fillimit të ekspulsionit) të lindjes tek primiparet është:

A) 18.
B) 12.
C) 6.
D) 2.
E) 4.
PS)B

Pyetja 774 V)3

Sindromi i ovarit rezistent karakterizohet nga:

A) ovare hipoplazike me mungesë të folikujve.
B) ovare hipoplazike me folikuj normale.
C) ovare vëllim mbi normë me kiste të shumtë dhe të vegjël.
D) ovare me aspekt shiritor.
E) ovare me ciste të mëdhenj.
PS)B

Pyetja 775 V)2

Normalisht, për sa kohë riprodhohet likidi amniotik i hequr gjatë proçedurës së amniocentezës?

A) një javë
B) dy javë
C) tre javë
D) 24 orë

E) 48 orë
PS)E

Pyetja 776 V)3

Në cilat nga këto kushte verifikohet Sindromi Morris?

A) Uterusi është i pranishëm, vagina është e shkurtër dhe karakteret seksuale janë mashkullore.
B) Janë të pranishme gonadet mashkullore dhe uterusi, karakteri seksual është femëror.
C) Janë të pranishme gonadet mashkullore, uterusi mungon karakteri seksual është femëror.
D) Janë të pranishme gonadet mashkullore dhe uterusi, karakteri seksual është mashkullor.
E) Janë të pranishme gonadet mashkullore dhe gonadet femërore, karakteri seksual ambig.
PS)C

Pyetja 777 V)2

Përkufizohet si plasja (çarje) e parakohshme e membranave

A) ndërmjet javës së 26-të dhe 36-të të shtatëzënisë.
B) ndërmjet javës së 37 dhe 40-të të shtatëzënisë.
C) para fillimit të aktivitetit të lindjes pavarësisht nga mosha e shtatzënisë
D) gjatë periudhës së dilatacionit, pavarësisht nga epoka e shtatzënisë
E) dilatacioni i plotë i kolumit uterin
PS)C

Pyetja 778 V)2

Nëse lihet të rrëshqasë mbi xham mukusi cervikal duket në ekzaminimin mikroskopik shihet fierizimi. Rritja e progesteronit do të bëjë:

A) shtim të "arborizimit" të mukusit.
B) zhdukje të një imazhi të tillë.
C) pakësim të 'arborizimit të mukusit'.
D) nuk vepron mbi mukusin cervical.
E) veprimi mbi mukusin cervikal varet nga prania ose jo e spermatozoidëve.
PS)B

Pyetja 779 V)2

E ashtuquajtura ndërhyrja "Manchester" konsiston në:

A) tamponim endouterin.
B) një teknikë e rrotullimit të fetusit.

C) korrigjimin e prolapsit uterin.
D) trajtimin e karcinomës cervikale.
E) korrigjimin e një laçeracioni të sfinkterit anal.
PS)C

Pyetja 780 V)2

Në fund të shtatzënisë, në gjakun fetal normalisht është i pranishëm:

A) 30% hemoglobin adulte.
B) vetëm hemoglobin fetale.
C) 80-85% hemoglobin fetale.
D) hemoglobinë adulte dhe fetale në sasi të barabartë.
E) 80-85% hemoglobin adulte
PS)E

Pyetja 781 V)2

Dozimi i ?-fetoproteinës kryhet midis:

A) ditëve 30-40 të shtatzënisë
B) javëve 26-30 të shtatzënisë
C) javëve 15-18 të shtatzënisë
D) javëve 20-24 të shtatzënisë
E) javëve 24-26 të shtatzënisë
PS)C

Pyetja 782 V)3

Një grua 25 vjet referon se ka prekur në gjirin e saj të majtë një nodus të vogël si dhe ka dhembje gjiri premenstruale. Diagnoza më e dyshuar është:

A) karcinoma encefaloide
B) mastopatia fibrocistike
C) karcinoma skiroza
D) karcinoma Paget
E) papiloma intraduktale
PS)B

Pyetja 783 V)2

Rritja e vëllimit dhe peshës uterine në shtatzëni i dedikohet

A) hiperplazisë së fibrave muskulare
B) hipertrofisë së fibrave muskulare
C) retensionit hidrik në indet uterine
D) hiperplazisë, hipertrofisë së fibrave muskulare dhe retensionit hidrin në indet uterine

E) hiperplazisë dhe hipertrofisë së fibrave muskulare
PS)D

Pyetja 784 V)2

Incidenca më e lartë e molës vezikulare haset në gratë e moshës

A) mbi 20 vjeç
B) nën 20 vjeç
C) midis 20-40 vjeç
D) mbi 45 vjeç
E) nën 20 vjeç dhe mbi 45 vjeç
PS)E

Pyetja 785 V)3

Trajtimi i zgjedhur për karcinomën vulvare është

A) terapia hormonale
B) kirurgjia radikale
C) kimioterapia
D) radioterapia
E) kimioterapia + radioterapia
PS)B

Pyetja 786 V)2

Në rast se pas daljes së placentës verifikohet inversioni uterin duhet të

A) procedohet me një tamponim vaginal
B) korrigjohet menjëherë inversioni me rrugë laparotomike
C) korrigjohet menjëherë inversioni me rrugë vaginale
D) abstenohet ndaj çdo manovre dhe të pritet rezolucioni spontan
E) të proçedohet me histerektomi vaginale brenda 6 orësh
PS)C

Pyetja 787 V)2

Në muajin e gjashtë të shtatzënisë cilët janë parametrat antropometrikë të fetusit?

A) gjatësia 25 cm, pesha 1800 gr
B) gjatësia 40 cm, pesha 1500 gr
C) gjatësia 33 cm, pesha 1000 gr
D) gjatësia 50 cm, pesha 1000 gr
E) varen nga parametrat e prindërve dhe nuk janë të parashikueshëm
PS)C

Pyetja 788 V)2

Në lidhje me "aneminë neonatale" duhet të konsiderohet patologjike një vlerë e hemoglobinës në funikulin inferior?

A) 10 g/100 ml
B) 10 mg/100 ml
C) 100 mg/100 ml
D) 14 g/100 ml
E) 14 g/ml
PS)D

Pyetja 789 V)3

Aplazia e vaginës me mungesë të uterusit ose prani të korneve rudimentarë uterinë, ovare dhe tuba normalë, me zhvillim normal të karakteristikave seksuale sekondare njihet si

A) Sindromi Morris
B) Sindromi Rokitanksi-Kuster
C) Sindromi Stevens-Johnson
D) Sindromi Klinefelter
E) Sindromi Stein-Leventhal
PS)B

Pyetja 790 V)2

Pfannenstiel (Faneshtil) ka lidhur emrin e tij me.

A) incizionin transversal të abdomenit.
B) rrotullimin fetal përmes manovrave interne dhe eksterne.
C) operacionin cezarean ekstraperitoneal.
D) embriotominë.
E) komprimimin uterin.
PS)A

Pyetja 791 V)2

Kordoni umbilikal përmban

A) dy vena dhe një arterie.
B) dy arterie dhe dy vena.
C) rrjet kapilar.
D) dy arterie dhe një venë.
E) një arterie dhe një venë.
PS)D

Pyetja 792 V)2

Sindromi di Chiari-Frommel konsiston në

A) bllokim bilateral të tubave të Fallopit
B) agenezi uterine
C) metastaza të një tumori ovarial
D) galaktorre dhe amenorre
E) amenore post pilulë EP
PS)D

Pyetja 793 V)2

Kalimi i spermatozoidëve nga testet në epididimus arrihet falë

A) kontraktimeve peristaltike të epididimit.
B) aksionit të cilëve të pranishme në duktuset eferentë.
C) lëvizshmërisë së spermatozoideve.
D) kontraksioneve peristaltike të epididimit dhe veprimit të cilieve të pranishme në duktuset eferentë.
E) kontraksioneve perisaltike të epididimit dhelëvizshmërisë së vetë spermatozoideve.
PS)D

Pyetja 794 V)2

Hematokolpos mund të shkaktohet nga

A) dispozitivi intrauterin që nuk tolerohet mirë
B) himen i paperforuar (i mbyllur, i paçarë)
C) sindromin nga fibrinoliza
D) ciste ovariale
E) adenomioza
PS)B

Pyetja 795 V)1

Në çfarë periudhë të shtatzënisë duket tek fetusi hemoglobina e tipit A?

A) java e 32-të e shtatzënisë
B) java e 28-të e shtatzënisë
C) java e 24-t e shtatzënisë
D) java e 16-të e shtatzënisë
E) pas lindjes
PS)C

Pyetja 796 V)2

Hiperplazia glandulare e endometriumit në vetvete është një simptomë e

A) hiperprogesteronemisë.
B) hiperestrogjenzmit.
C) hipoprogesteronemisë.
D) hipoestrogenizmit.
E) hiperprolaktinemisë.
PS)B

Pyetja 797 V)2

Në lidhje me Clostridium tetani, në një grua shtatzënë në javën e 20-të

A) është i nevojshëm vaksinimi antitetanik.
B) mund të aplikohen imunoglobulina humane antitetanike
C) është absolutisht e kundërindikuar aplikimi i imunoglobulinës humane antitetanike.
D) është i nevojshëm aplikimi i vaksinës antitetanike dhe mund të jepet imunoglobulina humane antitetanike.
E) është i nevojshëm aplikimi i vaksinës antitetanike dhe është absolutisht i kundërindikuar aplikimi i imunoglobulinës humane antitetanike.
PS)D

Pyetja 798 V)1

Harta kromozomike e sindromit Klinefelter është

A) XX/XO.
B) XY.
C) XXX.
D) XXY.
E) XYY.
PS)D

Pyetja 799 V)2

Gjatë histerektomisë abdominale lidhet gabimisht ureteri. Cilat janë pasojat?

A) hidronefrozë dhe dëmtim i funksionit renal të asaj ane
B) pionefrozë
C) ruptura e ureterëve
D) rupturë e veshkës
E) hipertension arterial
PS)A

Pyetja 800 V)2

Pjesa paraqitëse fetale quhet e angazhuar (impegnata) kur

A) cirkumferenca më e madhe e pjesës paraqitëse ka kaluar ngushticën e sipërme.
B) cirkumferenca më e madhe e pjesës paraqitëse ka kaluar ngushticën e mesme
C) cirkumferenca më e madhe e pjesës paraqitëse ka kaluarngushticën e poshtme
D) pjesa paraqitëse nuk mund të ngjitet sipër gjatë vizitës vaginale
E) pjesa paraqitëse përparon përgjatë kanalit të lindjes
PS)A

Pyetja 801 V)2

Pas sa kohësh i posalinduri rifiton peshën fillestare të lindjes?

A) 2-3 ditë
B) 40-50 ditë
C) 6-7 ditë
D) 15-20 ditë
E) pas rreth një muaji
PS)C

Pyetja 802 V)1

Reaksioni Galli-Mainini

A) është një test shtatzënie i realizuar në një bretkocë.
B) është një test shtatzënie i realizuar në një lepur.
C) është një test shtatzënie i realizuar jo mbi kafshë.
D) nuk është një test shtatzënie.
E) është një test imunologjik.
PS)A

Pyetja 803 V)3

Të gjitha patologjitë e mëposhtme mund të prekin fetusin nëna e të cilit është prekur nga rubeola në tremujorin e parë të shtatzënisë me përjashtim të

A) mikrocefalisë.
B) kataraktit.
C) megakolonit.
D) shurdhimit.
E) kardiopatitë.
PS)C

Pyetja 804 V)1

Quhet e zgjatur (serotine) çdo shtatzëni kohëzgjatja e të cilës është mbi

A) 42 javë
B) 41 javë

C) 45 javë
D) 40 javë
E) 38 javë
PS)A

Pyetja 805 V)2

Përsa i përket strishios vaginale mikrobike materiali merret nga

A) në forketën vaginale
B) në 1/3 e poshtme të vaginës
C) në forniks
D) në kolumin uterin
E) në paretin posterior
PS)C

Pyetja 806 V)2

"Cerviciti si luleshtrydhe"është një repert në

A) infeksionenga E.Coli
B) Infeksionenga viruse
C) infeksione nga Trichomonas
D) infeksione puerperale
E) infeksionenga gonokoku
PS)C

Pyetja 807 V)2

Aplikimi i forcepsit quhet oblik kur

A) dorezat e forcepsit duken pas aplikimit në gjatësi të ndryshme.
B) luga e forcepsit është paralel me diametrat transversalë të baçinit.
C) luga e forcepsit është paralel me dismetrat transversalë të kokës fetale.
D) luga e forcepsit është paralel me një nga diametrat oblikë të baçinit.
E) luga e forcepsit pozicionohet sipas njërit prej diametrave oblikë të kokës fetale.
PS)D

Pyetja 808 V)1

Në paraqitjet cefalike me çfarë incidence gjendet paraqitja me fytyrë

A) 1 rast në 3000 paraqitje cefalike normale.
B) 1 rast në 10.000 paraqitje cefalike normale.
C) 1 rast në 50 paraqitje cefalike normale.
D) 1 rast në 500 paraqitje cefalike normale.
E) 1 rast në 300 paraqitje cefalike normale.

PS)E

Pyetja 809 V)2

Medikamenti më i rëndësishëm në kemioterapinë e tumorin epitelial të ovarit është

A)) taxoli
B) platini
C) fluoro-uracili
D) izofosfamidi
E) adriamicina
PS)B

Pyetja 810 V)1

Gjatë shtatzënisë përqëndrimi i proteinave plazmatike

A) rritet pak
B) mbetet i pandryshuar
C) në përgjithësi ulet dhe ka nivele të barabarta për 2 fraksionet
D) në përgjithësi ulet me rritje relative të fraksionit të albuminës
E) në përgjithësi ulet me rritje relative të fraksionit të globulinës
PS)E

Pyetja 811 V)1

Në fillim të shtatzënisë anemia sideropenike trajtohet me terapi per os me

A) sulfat hekuri 200 mg x3/ditë.
B) sulfat hekuri 2 mg x3/ditë.
C) bromur hekuri 50 mg x3/ditë.
D) bromur hekuri 500 gamma x3/ditë.
E) iodur hekuri 300 gamma x3/ditë.
PS)A

Pyetja 812 V)2

Parametri është

A) endometër i modifikuar.
B) një ligament.
C) shtresa më e brendshme e uterusit.
D) muskulatura uterine.
E) seroza peritoneale që mbështjell uterusin.
PS)E

Pyetja 813 V)1

Gjatë shtatzënisë volumi plazmatik amtar

A) zvogëlohet
B) nuk ndryshon
C) rritet më shumë se 500 ml
D) rritet më shumë se 1000 ml
E) Dyfishohet
PS)D

Pyetja 814 V)3

Një paciente 54 vjeç me karcinomë të cerviksit me qeliza skuamoze stadi III, ka disa ditë që ka përfunduar trajtimin me radioterapi të jashtme dhe endokavitare. Aktualisht ankon për diarre (3-4 herë në ditë disa herë të shoqëruar me gjak), hemoglobina d
A) proktiti nga rrezatimi
B) metastaza të sigmës
C) fistul entero-enterike
D) ulcera nga stresi
E) diare psikogene
PS)A

Pyetja 815 V)1

TRH stimulon dhe prodhimin e

A) estrogjenit
B) progresteronit
C) prolaktinës
D) testosteronit të gruas
E) LH
PS)C

Pyetja 816 V)1

Në sindromën e feminizimit testikular kariotipi është

A) 46,XY
B) 47,XXY
C) 45,Y
D) 47,XXX
E) 46,YY
PS)A

Pyetja 817 V)1

Fiziologjikisht një ml ejakulati përmban

A) 1-5 milion spermatozoidë.
B) më shumë se 50 milion spermatozoidë.
C) 10.000-100.000 spermatozoidë.
D) rreth 1.000 spermatozoidë.
E) spermatozoidë të shumtë të lëvizshëm.
PS)B

Pyetja 818 V)1

Nga cila nga këto hormone nuk prodhohet nga placenta?

A) estrogjeni
B) progesterone
C) gonadotropina corionice
D) prolaktina
E) hormoni laktogjen placentar
PS)D

Pyetja 819 V)1

Gjatë ovulacionit temperatura bazale

A) rritet
B) zvogëlohet
C) qëndron e njëjta
D) rritet për rreth dy ditë
E) rritet vetëm nësë veza është e fekonduar
PS)A

Pyetja 820 V)2

Në rastet e gravidancës gemelare amniocenteza

A) është e kundërindikuar.
B) është e nevojshme.
C) duhet të kryhet në të dy kavitetet amniotike.
D) kryhet në anestezi gjenerale.
E) shkakton lindjen në 30% të rasteve.
PS)C

Pyetja 821 V)1

Trichomonas është

A) një bacil
B) një pseudomonas

C) një protozoar
D) një kërpudhë
E) një virus
PS)C

Pyetja 822 V)2

Sa janë në përgjithësi kotiledonet amëtare të placentës në fund të shtatzënisë?

A) 30-50
B) 180-200
C) 15-20
D) 80-100
E) 25-30
PS)C

Pyetja 823 V)2

Një lehonë që nuk ka laktacion ka ciklin menstrual pas rreth

A) 6 ditë nga lindja.
B) 10 ditë nga lindja.
C) 14 ditë nga lindja.
D) 3-4 javë nga lindja
E) 6-8 javë nga lindja.
PS)E

Pyetja 824 V)2

Në çfarë kushtesh kundërindikohet ventuza obstetrikale?

A) inercia uterine.
B) në sëmundjet debiltante amtare.
C) në rrotullime sakrale të oksipitit fetal.
D) në makrosoninë fetale.
E) tek pengesat mekanike të ecurisë të fetusit.
PS)E

Pyetja 825 V)2

Insufiçenca hipofizare sekondare totale përkufizohet dhe si 'sindroma e....'?

A) Simmonds.
B) Argonz-Del Castillo.
C) Sheehan.
D) Forbes-Albright.
E) Morris.

PS)C

Pyetja 826 V)2

Sa spermatozoidë me lëvizshmëri normale/ fushë duhet të ketë Testi Post- Koital që të quhet pozitiv ?

A) 10-20.
B) 50-70.
C) 100-150.
D) 2-5.
E) të paktën një.
PS)A

Pyetja 827 V)1

Sa kohë pas lindjes zhduket plotësisht 'hipotonia uretero-vezikale' ?

A) 3 ditësh.
B) 10 ditësh.
C) 1 muaji.
D) 6 muajsh.
E) 1 viti.
PS)C

Pyetja 828 V)1

Cili është shkaku më i shpeshtë për abortin spontan në tremujorin e dytë?

A) hipoplazia uterine.
B) insuficienza e corpo luteo.
C) inkompetenca cervico-istmike.
D) malformazionet uterine.
E) fibromioma submukozale.
PS)C

Pyetja 829 V)1

Në cilën nga këto situata është më i lartë rreziku i imunizimit amtaro-fetal nga fakori Rh?

A) nëna Rh+ dhe fetusi Rh+.
B) nëna Rh+ dhe babai Rh-.
C) nëna plurigravida Rh+ dhe fetusi Rh-.
D) nëna primagravida Rh- dhe fetusi Rh+.
E) nëna plurigravida Rh- dhe fetusi Rh+.
PS)E

Pyetja 830 V)1

Cili është hormoni që në mënyrë të veçantë ndikon në temperaturën bazale të femrës?

A) estroni.
B) estrioli
C) estradioli
D) tiroxina
E) progesteroni
PS)E

Pyetja 831 V)1

Gjatë shtatzënisë përqëndrimi i fibrinogjenit në gjakun amtar

A) zvogëlohet ndjeshëm
B) zvogëlohet në mënyrë të moderuar
C) nuk ndryshon
D) rritet në mënyrë të moderuar
E) rritet ndjeshëm
PS)E

Pyetja 832 V)2

Cila nga shenjat e mëposhtme nuk i përket syndromës së rosolia (rubeolës) kongenitale?

A) korioretiniti
B) micro-oftalmia
C) shurdhësi
D) prania e duktus botalli
E) hepatosplenomegalia
PS)A

Pyetja 833 V)1

Aborti quhet komplikacion i amniocentezës nëse ndodh pas sa ditësh?

A) 3 ditësh
B) 10 ditësh
C) 30 ditësh
D) 60 ditësh
E) gjithmonë
PS)B

Pyetja 834 V)1

Preparati i zgjedhur për hiperprolaktineminë është

A) citrati i klomifenit
B) ciklofenili
C) bromkriptina
D) HMG
E) ciproteron acetati
PS)C

Pyetja 835 V)2

Epooforon është

A) pjesa që rrethon orificiumin uterin ekstern
B) shtresa qelizore që vesh ovocitin
C) rezidua e mezonefronit
D) neoplazi ovariale
E) dega perineale e nervit femoro-kutan
PS)C

Pyetja 836 V)2

Palatoskiza është një patologji e lindur që prek një në ... të porsalindur gjallë

A) 100
B) 300
C) 800
D) 1.500
E) 6.000
PS)C

Pyetja 837 V)2

Për të realizuar një kyretazh diagnostik të kavitetit uterin pas eksplorimit vaginal dhe një dizinfektimi të kujdesshëm duhet

A) dilatuar kolumi.
B) proçeduar me histerometrinë.
C) realizuar kyretazhi i kavitetit endometrial.
D) realizuar kyretazhi endocervikal.
E) realizuar katatarizimi vezikal.
PS)B

Pyetja 838 V)2

Me ndërhyrjen e Schauta kuptojmë

A) Histerektomi abdominale radikale e zgjeruar

B) Kolpohisterectominë radikale
C) Kolpohisteroktominë radikale
D) Histeropeksinë
E) Plastikën tubare
PS)B

Pyetja 839 V)2

PIF është

A) tregues i pozicionit fetal.
B) një test për dozimin e prolaktinës.
C) një provë e ngarkesës hormonale.
D) një faktor frenues i sintezës së prolaktinës.
E) proteinë e kulloshtrës.
PS)D

Pyetja 840 V)2

Cili prej preparateve të mëposhtëm është më efikas në trajtimin e endometriozës?

A) Danazoli
B) Etinilestradioli
C) Ciproteron acetati
D) Mestranoli
E) Stilbestroli
PS)A

Pyetja 841 V)3

Prolapsi i kordonit umbilikal dallohet nga prokubitus i kordonit umbilikal sepse i pari diagnostikohet vetëm..

A) kur prezantimi është me verteks.
B) kur fillon aktiviteti i lindjes.
C) kur membranat janë të plasura.
D) kur membranat janë intakte.
E) kur prezantimi është podalik.
PS)C

Pyetja 842 V)1

Në kushte fiziologjike pH i gjakut fetal varion midis

A) 7,50 - 7,46
B) 7,45 - 7,41
C) 7,40 - 7,25

D) 7,24 - 7,20
E) 7,19 - 7,10
PS)C

Pyetja 843 V)2

Fillimi i rritjes folikulare koincidon me

A) pikun e LH-së.
B) rritjen e FSH-së.
C) rënien e FSH-së.
D) rënien e estrogjenit.
E) rritjen e progesteronit.
PS)B

Pyetja 844 V)1

Rekomandohet që amniocenteza të kryhet jo para javës ... të shtatzënisë:

A) 12
B) 16
C) 20
D) 24
E) 32
PS)B

Pyetja 845 V)1

Bashkimi i spermatozoidit me vezën realizohet në tuba në nivelin e

A) kanalit
B) fimbrieve
C) istmusit
D) ampulës
E) pjesës intramural
PS)D

Pyetja 846 V)2

Shkaku më i shpeshtë i hemorragjisë vaginale te një e porsalindur është

A) trauma nga lindja
B) privimi estrogjenik
C) alergji nga pampersat
D) anomali anatomike të vaginës
E) cerviko-karcinoma e lindur
PS)B

Pyetja 847 V)1

Korpus luteum arrin aktivitetin maksimal

A) 20 ditë pas ovulacionit
B) 15 ditë pas ovulacionit
C) një javë pas ovulacionit
D) një javë para ovulacionit
E) gjatë ovulacionit
PS)C

Pyetja 848 V)2

Cila prej patologjive të mëposhtme shoqëron shpesh pubertetin prekoks?

A) sëmundja e Gaucher
B) sëmundja Tay-Sachs
C) sëmundja Hand-Schuller-Christian
D) sëmundja Osgood-Schlatter
E) Sindromi Albright
PS)E

Pyetja 849 V)1

Faktori mashkullor është përgjegjës për infertilitetin

A) në më pak se 10% të çifteve sterilë
B) në 15-20% të çifteve sterilë
C) në 20-25% të çifteve sterilë
D) në 35-45% të çifteve sterilë
E) në mbi 50% të çifteve sterilë
PS)D

Pyetja 850 V)1

Organi që preket më shpesh nga endometrioza e jashtme është/janë

A) tubat obarialë
B) vagina
C) ovari
D) zorra
E) kolum uteri
PS)C

Pyetja 851 V)1

Aplikimi i acidit acetik në kolum praktikohet gjatë

A) histerosalpingografisë
B) inseminimit homolog
C) kolposkopisë
D) testit të fierizimit
E) testit post koital
PS)C

Pyetja 852 V)2

Ovulat e Nabothit janë

A) ovula trikomonialë
B) ciste të vegjël të epitelit të kolumit
C) kompresa garzash kirurgjikale
D) tamponë të vegjël të fiksuar në pincë
E) ovula kontraceptivë
PS)B

Pyetja 853 V)1

Metoda më e mirë për identifikimin e placenta previa është

A) ekografia
B) amniografia
C) ekzaminimi gjinekologjik
D) arteriografia
E) radiografia pelvike
PS)A

Pyetja 854 V)2

Cili prej hormoneve të mëposhtëm është tregues i hiperprodhimit të androgjenëve prej surenales?

A) testosteroni
B) dehidroepiandosteroni
C) estradioli
D) kortizoli
E) androstenedioni
PS)B

Pyetja 855 V)1

Strassmann lidh emrin e tij me

A) testin për diagnozën e ovulacionit.
B) testin për studimin e pH të gjakut fetal.
C) kolposkopinë.
D) ndërhyrjen e metroplastikës.
E) histerektominë radikale.
PS)D

Pyetja 856 V)3

Një grua 32 vjet në gjendje të përgjithshme të mirë drejtohet në ambulator për hemorragji në sasi të pakët të thithit të gjirit. Cili nga situatat e mëposhtme mund të jetë shkaku?

A) shtatzëni e hershme
B) papiloma intraduktale
C) fibroadenoma
D) abscesi i gjirit
E) galaktocela
PS)B

Pyetja 857 V)1

Në javën e 30-të të shtatzënisë prezantimi podalik haset në rreth

A) 15%
B) 25%
C) 35%
D) 50%
E) 8%
PS)B

Pyetja 858 V)1

Në periudhën ovulatore mukusi cervikal

A) shtohet ndjeshëm.
B) humb aftësinë filamentoze.
C) nuk kristalizohet.
D) bëhet opak.
E) nuk prodhohet.
PS)A

Pyetja 859 V)2

Kush është shenja ose simptoma e vetme tek një paciente me karcinomë cervikale

A) stipsi
B) dhimbja abdominale

C) hemorragjia nga genitalet eksterne
D) lumbalgjia
E) dispareunia
PS)C

Pyetja 860 V)2

Vaksinat e mëposhtme mund të aplikohen pa rrezik gjatë shtatzënisë, me përjashtim të

A) antipoliomeliti (tipi sabin)
B) antipoliomeliti (tipi salk)
C) antitetanik me anatoksinën ramon
D) antikolerik
E) antigrip
PS)A

Pyetja 861 V)1

Gjatë shtatzënisë aftësia e jodit për t`u lidhur me proteinat

A) rritet
B) ulet
C) nuk ndryshon
D) varet nga sëmundjet e fshehura latente
E) ulet dhe është pothuajse zero
PS)A

Pyetja 862 V)2

Sipas klasifikimit të Papanicolau, prania e disa qelizave atipike por me karakteristika të pamjaftueshme për të dyshuar malinjitet në një ekzaminim citologjik i korrespondon

A) Klasës I
B) Klasës II
C) Klasës III
D) Klasës IV
E) Klasës V
PS)C

Pyetja 863 V)2

Një karcinomë e kufizuar në kolum me limfonoduj negativë (stadi I) lejon mbijetesë 5-vjeçare në çfarë përqindje?

A) 40%
B) 60%
C) 10%

D) 100%
E) 80%
PS)E

Pyetja 864 V)2

Tek gratë e reja shkaku më i shpeshtë i amenoresë është

A) pamjaftueshmëria ovariale
B) hipertiroidizmi
C) hipotiroidizmi
D) psikopatik
E) shtatzënia
PS)E

Pyetja 865 V)1

Cila është përqindja e incidencës së sindromit turner tek të porsalindurit vajza?

A) 1/1.000
B) 1/100
C) 1/1.000.000
D) 1/10.000.000
E) 1/500.000
PS)A

Pyetja 866 V)2

Në rreth 5-10% të shtatzënave konstatohet bakteriuria asimptomatike. Cili është gram-i më i shpeshtë shkaktar?

A) Escherica Coli
B) Proteus
C) Streptococus fekal
D) Piocianeus
E) Aerobakteri
PS)A

Pyetja 867 V)1

Një grua në muajin e tretë të shtatzënisë diagnostikohet me një infeksion nga toxoplasma. Në këtë periudhë risku fetal është

A) shumë i lartë
B) minimal
C) mungon
D) vdekje intrauterine në 90% të rasteve

E) lindje parakohe në 80% të rasteve
PS)A

Pyetja 868 V)2

Në qoftë se menstruacionet vijnë më shpesh dhe kohëzgjatja e ciklit menstrual është më e shkurtër se 24 ditë, atëherë kemi të bejmë me

A) polimenorre.
B) oligomenorre.
C) takimenorre.
D) hipermenorre.
E) hipomenorre.
PS)A

Pyetja 869 V)1

Sindromi Meigs është

A) fibroma uterine + ascit + hidrotoraks
B) karcinoma e ovarit + ascit + hidrotoraks
C) cistoadenoma pseudo-mucinoze e ovarit + ascit
D) fibroma e ovarit + ascit + hidrotoraks
E) kiste endometriozike të ovarit
PS)D

Pyetja 870 V)2

Cili është komplikacioni që ndeshet më shpesh mbas kryerjes së amniocentezës?

A) lipotimia
B) hemoperitoneumi
C) emfizema e paretit abdominal
D) punksioni i ansave intestinale
E) punksioni i vezikës urinare
PS)A

Pyetja 871 V)1

Sindromi Sheehan karakterizohet nga:

A) oligomenorrea dhe galaktorrea
B) agenezia gonadike
C) feminizimi testikular
D) defiçiti funksional i lobit anterior të hipofizës
E) steriliteti dhe kretinizmi
PS)D

Pyetja 872 V)2

Fibromat uterine gjatë shtatzënisë kanë tendencë të:

A) zvogëlojnë përmasat
B) rritin përmasat
C) transformohen në mlinje
D) mos pësojnë ndryshimë
E) japin degjenerime nekrotike
PS)B

Pyetja 873 V)2

Preparati i zgjedhur për trajtimin e toksoplasmozës në shtatzëni është:

A) pirimetamina.
B) tetraciklina .
C) spiramicina.
D) sulfametosazoli.
E) chinidina .
PS)C

Pyetja 874 V)2

Tumori Brenner:

A) është beninj
B) është malinj
C) shfaqet në moshën pediatrike
D) është shumë i shpeshtë
E) është malinj dhe shfaqet në moshën pediatrike
PS)A

Pyetja 875 V)1

Aktiviteti kardiak fetal mund të shihet nëpërmjet ekzaminit ekografik duke filluar nga java e ..... e shtatzënisë

A) 7-8-të
B) 10-të
C) 12-të
D) 20-të
E) 24-ërt
PS)A

Pyetja 876 V)1

Cila është e vërtetë përsa i përket aktivitetit seksual gjatë muajit të tretë të shtatzënisë?

A) nuk këshillohen raportet seksuale
B) raportet seksuale mund të jenë të rregullta nëse nuk shkaktojnë diskomfort ose dhimbje
C) duhet të këshillohet "coitus interruptus"
D) duhet të këshillohet përdorimi i kondomit për të shmangur infeksionet ascendente.
E) raportet seksuale mund të jenë të rregullta nëse nuk shkaktojnë diskomfort ose dhimbje dhe duhet të këshillohet "coitus interruptus".
PS)B

Pyetja 877 V)2

Midis viteve 1949 dhe 1953 shtatzënitë me risk të lartë trajtoheshin me doza të larta dietilstilbestroli. Një pasojë e këtij e trajtimi ishte :

A) adenocarcinoma primare e vaginës së nënës.
B) adenocarcinoma parësore e vaginës së të porsalindurës.
C) feminizimi i të porsalindurit mashkull.
D) puberteti i vonshëm i të porsalindurës.
E) zgjatja e periudhës së amenorresë të paslindjes.
PS)B

Pyetja 878 V)1

Profilaksia për isoimunizimin Rh (D) duhet të bëhet:

A) brenda 6 orëve të para nga lindja
B) brenda 24 orëve të para nga lindja
C) brenda 12 orëve të para nga lindja
D) brenda 72 orëve të para nga lindja
E) në çdo moment pas lindjes
PS)D

Pyetja 879 V)2

Konjugata diagonale shkon:

A) nga harku subpubik deri në pikën e mesit të promontoriumit.
B) nga buza e sipërme e simfizës pubike deri në pikën e mesit të promontoriumit.
C) nga eminenca ileopectinea deri në artikulacionin sakro-koksigeal.
D) nga njëra eminencë ileopectinea tek tjetra.
E) nga njëri tuberozitet ischiadik tek tjetri.
PS)A

Pyetja 880 V)2

Në paraqitjen me shpatull cili është qëndrimi obstetrikal më i drejtë?

A) pritjen e lindjes natyrale, në rrugë vaginale
B) përshpejtimin e lindjes duke administruar oksitocinë
C) vendosja e forcepsit
D) vendosja e vakumit (ventuzës) obstetrikal
E) ndërhyrja kirurgjikale me operacion cezarian
PS)E

Pyetja 881 V)1

Cila nga patologjitë e mëposhtme është shkaku më i shpeshtë i amenorresë sekondare?

A) sindromi nga rrezatimi
B) sëmundjet inflamatore pelvike
C) insuficienca ovariale
D) keqvendosja uterine
E) marrja e zgjatur e progesteronëve
PS)C

Pyetja 882 V)1

Cila nga komplikacionet postoperatore është më e shpeshtë në interventin e histerektomisë vaginale?

A) bronkopneumonia akute
B) peritoniti
C) infeksioni i traktit urinar
D) hemorragjia
E) perforacioni intestinal
PS)C

Pyetja 883 V)2

Cili nga mikroorganizmat e mëposhtëm është shkaktari i vaginitit ku konstatohen në ekzaminimin mikroskopik "clue cells"?

A) trichomonas vaginalis
B) candida albicans
C) haemophilus vaginalis
D) neisseria gonorrea
E) mycoplasma hominis
PS)C

Pyetja 884 V)2

Frekuenca kardiake në ditët e para të periudhës puerperale është zakonisht:

A) e rritur
B) e ulur
C) e njëjtë me frekuencën gjatë shtatzënisë
D) dukshëm e rritur
E) e njëjtë me frekuencën përpara shtatzënisë
PS)B

Pyetja 885 V)1

Himeni është:

A) një membranë mukoze e përbërë nga indi lidhor dhe indi epitelial
B) vetëm indi epitelial
C) vetëm indi lidhor
D) ind glandular (gjëndror)
E) një pjesë e gjendrës së Bartolinit
PS)A

Pyetja 886 V)1

Dimensionet e ovocitit janë:

A) 1 cm
B) 0,5 cm
C) 100-150 ?
D) 2-3 ?
E) 40 ?
PS)C

Pyetja 887 V)1

Teknika më e përshtatshme për të induktuar abortin mbas javës së 14-të të shtatzënisë është:

A) histerotomia .
B) përdorimi i oksitocinës.
C) administrimi i prostaglandinave.
D) injektimi i solucionit salin hipertonik në likidin amnial .
E) revizionimi i kavitetit uterin.
PS)C

Pyetja 888 V)1

Stacioni i parë i drenimit limfatik të vulvës është:

A) limfonodujt inguinal superficial
B) limfonodujt inguinal profond
C) limfonodujt hipogastrik
D) limfonodujt iliac intern
E) limfonoduj iliak ekstern
PS)A

Pyetja 889 V)1

Numri i qelizave germinale në ovare, në muajin e 5-të të jetës intrauterine është:

A) 600.000
B) 200.000
C) 40.000
D) 1.000.000
E) deri në 7.000.000
PS)E

Pyetja 890 V)2

Në rastin e një mastiti akut i djathtë tek një lehonë e re që ushqen me gji foshnjën e saj, trajtimi konsiston në:

A) antibiotikoterapi dhe ushqyerja me gji vetëm nga gjiri i shëndoshë
B) ndërprerja e ushqyerjes me gji dhe ekscizioni i neoplazisë pas disa muajsh
C) antibiotikoterapi dhe ndërprerja e ushqyerjes me gji deri në remision
D) antibiotikoterapi
E) ndërprerja e ushqyerjes me gji dhe e antipiretikëve
PS)C

Pyetja 891 V)2

Cila është periudha më e mirë për të kryer një ekzaminim objektiv të saktë të gjirit?

A) gjatë ovulacionit
B) menjëherë përpara menstruacioneve
C) menjëherë mbas menstruacioneve
D) gjashtë ditë mbas ovulacionit
E) në çdo moment të ciklit menstrual
PS)C

Pyetja 892 V)2

Testi i Schiller-it konsiston në:

A) ekzaminimin e kolumit dhe mukozës së vaginës me dritë natyrale.

B) ekzaminimin mikroskopik të mukusit të marrë nga kolumi dhe të shtrirë në një lamë por pa e fiksuar.
C) ekzaminimin e kolumit dhe mukozës së vaginës mbas aplikimit të lugolit.
D) ekzaminimin mikroskopik të një preparati histologjik të marrë nëpërmjet biopsisë së drejtuar.
E) ekzaminimin e kolumit dhe mukozës së vaginës mbas aplikimit të acidit acetik 3% .
PS)C

Pyetja 893 V)2

Cila nga pikat e mëposhtme mund të jetë një indikacion për vilocentezë?

A) diabeti amtar
B) patologjitë e rënda renale amtare
C) dyshimi për beta-talasemi
D) soferenca fetale kronike
E) dyshimi për atrezi ezofageale fetale
PS)C

Pyetja 894 V)2

Kemioterapia e tumoreve ovarial recidivant konsiston në:

A) propozimin gjithmonë të terapisë së linjës së parë.
B) përdorimin gjithmonë të preparateve farmaceutikë të ndryshëm nga ata të linjës së parë të mjekimit.
C) propozimin e preparateve farmaceutikë të përdorura në linjën e parë, nëse intervali i lirë nga sëmundja është mbi 12 muaj.
D) propozimin e preparateve farmaceutikë të përdorura në linjën e parë, nëse intervali i lirë nga sëmundja është nën 12 muaj.
E) kemioterapia nuk luan rol në tumoret ovarial recidivant.
PS)C

Pyetja 895 V)1

Rritja e presionit intraabdominal gjatë aktivitetit të lindjes është rezultat i:

A) kontraksioneve uterine.
B) kontraktimeve të muskulturës të pavullnetshme.
C) kontraktimeve të muskulaturës të vullnetshme.
D) rritjes së presionit intrauterin.
E) uljes së presionit intrauterin.
PS)C

Pyetja 896 V)1

Mastiti është një nga infeksionet më të shpeshta të periudhës puerperale. Shkaktari etiologjik më i shpeshtë është:

A) streptococcus i grupit A.
B) staphylococcus aureus.
C) bakteri Coli.
D) pseudomonas aeruginosa.
E) streptococcus .
PS)B

Pyetja 897 V)1

Vlerësimi i pikëzimit APGAR mat të gjithë parametrat e mëposhtëm, përveç:

A) frekuencës kardiake.
B) ngjyrimit (kolorimit).
C) respiracionit.
D) temperaturës trupore.
E) tonusit muskular.
PS)D

Pyetja 898 V)2

Cili nga muskujt e mëposhtëm nuk bën pjesë në perineum?

A) m. transversus superficialis
B) m. transversus profondus
C) m. piramidalis
D) m. ischio-cavernosus
E) m. bulbo-cavernosus
PS)C

Pyetja 899 V)2

Sindromi Asherman mund të diagnostikohet nëpërmjet:

A) ekzaminimit të kolum uteri me spekulum
B) radiografisë direkte të pelvisit
C) histerosalpingografisë
D) kuldoskopisë
E) kolposkopisë
PS)C

Pyetja 900 V)2

Pamja karakteristike e kristalizimit si gjethe të vogla fieri e mukusit cervikal arrihet :

A) ndërmjet ditës së 21-të dhe ditës së 28-të të ciklit menstrual
B) në fazën ovulatore
C) ndërmjet ditës së 1-rë dhe ditës së 7-të të ciklit menstrual
D) në fazën menstruale
E) kur gruaja futet në menopauzë
PS)B

Pyetja 901 V)2

Enterocela është:

A) një instrument kirurgjikal që përdoret për hemostazë
B) torsioni uterin në aksin e tij
C) mbyllja kirurgjikale e tubave uterinë
D) zbritja e ansës intestinale që merr me vete përpara paretin vaginal posterior
E) një deformim të kolum uteri
PS)D

Pyetja 902 V)2

Në rastin e prolapsit ose prokubitusit të kordonit umbilikal, në përgjithësi:

A) aplikohet vendosja e forcepsit.
B) rifutet kordoni umbilikal në kavitetin uterin.
C) pritet me kujdes duke palpuar pulsimin e kordonit umbilikal (aktiviteti kardiak fetal).
D) kryhet operacioni cezarian.
E) pritet pjesa e prolabuar e kordonit umbilikal dhe bëhet anastomoza e dy fundeve të prera.
PS)D

Pyetja 903 V)2

Cili regjion i glandulës mamae preket më shumë nga karcinoma?

A) kuadrati extern-superior
B) kuadrati intern-superior
C) kuadrati intern-inferior
D) kuadrati extern-inferior
E) të gjithë kuadratet preken njësoj
PS)A

Pyetja 904 V)1

Frekuenca normale e rrahjeve të zemrës fetale është:

A) 180-220 rrahje/minutë
B) 30-60 rrahje/minutë

C) 60-90 rrahje/minutë
D) 120-160 rrahje/minutë
E) 90-120 rrahje/minutë
PS)D

Pyetja 905 V)1

Puberteti tek femrat fillon me aktivizimin e funksionit të:

A) ovareve
B) hipofizës
C) hipotalamusit
D) glandulave suprarenale
E) paratiroideve
PS)C

Pyetja 906 V)2

Cili diametër i kokës fetale merr kontakt ngushticën e sipërme të baçinit në paraqitjen me vertex?

A) mento-bregmatiku
B) mento-oksipitali
C) suboksipito-bregmatiku
D) submento-bregmatiku
E) oksipito-frontali
PS)C

Pyetja 907 V)1

Diametri më i madh i kokës fetale është:

A) suboksipito-bregmatiku
B) mento-oksipitali
C) biparietali
D) oksipito-frontali
E) bitemporali
PS)B

Pyetja 908 V)1

Kockat parietale bashkohen me kockën oksipitale nëpërmjet suturës:

A) frontale
B) lambdoidea
C) temporale
D) sagitale

E) biparietale
PS)B

Pyetja 909 V)1

Flitet për "amenorre primare" nëse nuk kanë ardhur menstruacionet mbas moshës:

A) 14 vjeçare.
B) 18 vjeçare.
C) 16 vjeçare.
D) 20 vjeçare.
E) 25 vjeçare.
PS)C

Pyetja 910 V)1

Aktiviteti kardiak fetal fillon të duket për herë të parë nga:

A) java e 9-10-të e shtatzënisë
B) java e 11-12-të e shtatzënisë
C) java e 13-14-të e shtatzënisë
D) java e 15-16-të e shtatzënisë
E) java e 5-6-të e shtatzënisë
PS)E

Pyetja 911 V)2

Shkaqet anatomike që mund të shkaktojnë varikocelë pelvike janë të gjitha citimet e mëposhtme, përveç:

A) retroversofleksioni uterin.
B) cistet ovariale.
C) fibromyomat uterine.
D) sëmundjet inflamatore pelvike.
E) cistocela
PS)E

Pyetja 912 V)1

Nga sa shtresa përbëhet muskulatura e trupit uterin?

A) 1 shtresë
B) 2 shtresa (mediane dhe submukoze)
C) 3 shtresa (subseroze, mediane dhe submukoze)
D) 4 shtresa (subseroze, intersticiale, mediane dhe submukoze)
E) 2 shtresa në formë spirale
PS)C

Pyetja 913 V)1

Arteria mamare interne e merr origjinën nga:

A) arteria subklavia.
B) arteria aksilare.
C) aorta discendente.
D) arteria carotide e jashtme.
E) arteriet interkostale.
PS)A

Pyetja 914 V)2

Paraqitja faciale është më e shpeshtë tek pacientët:

A) primigravide.
B) primipare atempate.
C) primipare nën 16 vjeç.
D) multipare.
E) obezë.
PS)D

Pyetja 915 V)2

Gjëndrat e kolum uteri janë:

A) gjëndra tubulare të thjeshta.
B) gjëndra tubulare të degëzuara.
C) gjëndra acinoze.
D) gjëndra tubulo-alveolare.
E) pseudogjëndra.
PS)E

Pyetja 916 V)3

Në terapinë e sindromit Rokitansky-Kuster-Hauser përdoret:

A) bromocriptina.
B) estrogjenët.
C) progesteronët.
D) estro-progesteronikët.
E) kirurgjia.
PS)E

Pyetja 917 V)1

Çfarë kuptojmë me moshë shtatzënie?

A) kohëzgjatjen e shtatzënisë të llogaritur nga dita e parë e menstruacioneve të fundit
B) kohëzgjatjen e shtatzënisë të llogaritur nga dita e ovulacionit
C) kohëzgjatjen e shtatzënisë të llogaritur nga testi i parë pozitiv i shtatzënisë
D) kohëzgjatjen e shtatzënisë të llogaritur nga dita e implantimit të blastocistit
E) kohëzgjatjen e shtatzënisë të llogaritur nga dita e fekondimit
PS)A

Pyetja 918 V)2

Risku i ndërprerjes së shtatzënisë mbas amniocentezës është:

A) 10%.
B) 20%.
C) 30%.
D) 40%.
E) 0,1-1,5%.
PS)E

Pyetja 919 V)1

Piku i sekretimit të FSH ndodh afërsisht në cilën ditë të një cikli 28 ditor?

A) 1
B) 7
C) 14
D) 21
E) 28
PS)C

Pyetja 920 V)1

Corpus albicans ose trupi i bardhë është:

A) mbetje embrionike
B) mbetje e involucionit të corpus luteum
C) folikul ovarial cistik
D) inkluzion citoplazmatik
E) ovar supranumerik (i tepërt) atrofik
PS)B

Pyetja 921 V)3

Stadifikimi në nëngrupe i karcinomës së kolum uteri, kur shtrihet përtej kolumit dhe infiltron endometrin, parametrin, 1/3 e sipërme të vaginës, pa prekur paretin pelvik, i përket stadit:

A) IIa
B) IIb
C) IIIb
D) IIIa
E) Iva
PS)B

Pyetja 922 V)1

Frekuenca kardiake fetale paraqet normalisht një variabilitet (oshilacione) në vlera:

A) 10-25 rrahje/min.
B) 5-10 rrahje/min.
C) më pak se 5 rrahje/min.
D) 30-50 rrahje/min.
E) nuk ka variabilitet në frekuencën kardiake fetale në gjëndje normale.
PS)A

Pyetja 923 V)2

Kur është momenti më i përshtatshëm për të marrë një biopsi endometriale nëse duam të sigurohemi për një cikël ovulator?

A) dita e 14-16 e ciklit
B) dita e 16-18 e ciklit
C) dita e 20-22 e ciklit
D) dita e 26-28 e ciklit
E) gjatë menstruacioneve
PS)C

Pyetja 924 V)2

"Mosshkolitje e placentes" është situata ku placenta mbetet plotësisht e aderuar me zonën e inserimit të saj për më shumë se:

A) 20 minuta.
B) 1 orë.
C) 2 orë.
D) 4 orë.
E) 10 minuta.
PS)B

Pyetja 925 V)3
Prania e vlerave të larta të alfa-fetoproteinës në likidin amniotik mund të jetë tregues për:
A) vuajtje fetale
B) keqformime gastroenterike
C) maturim pulmonar te fetusit

D) keqformime të tubit neural me ekspozim të trurit dhe meningjeve
E) nuk ka ndonjë domethënie të veçantë
PS)D

Pyetja 926 V)2

Adenomioza është:

A) një tumor i ovarit.
B) një tip i fibromës së uterusit.
C) prania e gjendrave në muskujt perineale.
D) endometrioze e ovarit.
E) prania e endometrit ne trashesine e miometrit.
PS)E

Pyetja 927 V)1

Paraqitja podalike përfaqëson përafersisht këtë përqindje të prezantimeve gjatë lindjes:

A) 10%
B) 20%
C) 30%
D) 35%
E) 3%
PS)E

Pyetja 928 V)2

"Ksantorrea" është:

A) sekrecione vaginale me ngjyrë të verdhë.
B) grumbullim i yndyrnave në likidin amniotic.
C) shtimi i salivacionit gjatë shtatzënisë.
D) urinimi i shpeshtë gjatë shtatzënisë.
E) prania e sekrecioneve mamare gjatë shtatzënisë.
PS)A

Pyetja 929 V)1

Cili nga muskujt e mëposhtëm bën pjesë në ngritësit e anusit?

A) piramidal
B) piriform
C) koksigeo-pubik
D) bulbo-kavernoz
E) transvers sipërfaqsor i perineumit
PS)C

Pyetja 930 V)2

Tuberkulat e Montgomerit gjenden në:

A) mons veneris.
B) aureolat mamare.
C) në labia major.
D) në sipërfaqen e jashtme të tubave.
E) në sipërfaqen e jashtme të ovareve.
PS)B

Pyetja 931 V)2

Manovra e Bracht kryhet në:

A) paraqitjet me shpatull
B) paraqitjet me fytyrë
C) paraqitjet podalike
D) asfiksite neonatale
E) në laçeracionet e gjera vaginale për të përftuar një hemostazë më të mirë
PS)C

Pyetja 932 V)1

Cili nga nga ekzaminimet e mëposhtëm është më i përshtatshëm për të diagnostikuar një kufizim të rritjes intrauterine?

A) kardiotokografia
B) amniocenteza
C) ekografia
D) dozimi i estriolit
E) dozimi i ?-fetoproteins
PS)C

Pyetja 933 V)2

Terapia në rast të rrezikut për abort bazohet zakonisht në përdorimin e të gjitha përshkrimeve të mëposhtme, përveç:

A) progesteronit.
B) ?-stimuluesit.
C) antispastikët.
D) antibiotikoterapisë.
E) regjimi të shtratit.
PS)D

Pyetja 934 V)2

Lezionet kockore traumatike të fetusit gjatë proçesit të lindjes nuk janë të rralla. Fraktura më e shpeshtë është:

A) e klavikulës
B) e femurit
C) e kraniumit
D) e humerusit
E) e vertebrave cervikale
PS)A

Pyetja 935 V)2

Bromkriptina mund të përdoret për të frenuar laktacionin. Në këtë rast doza e saj duhet të jetë:

A) 25 mg dy herë në ditë per os për 10 ditë.
B) 15 mg 4 herë në ditë per os per 20 ditë.
C) 15 mg 4 herë në ditë intramuskul për 3 ditë.
D) 2.5 mg dy herë në ditë per os për 14 ditë.
E) bromkriptina nuk duhet të përdoret asnjëherë për të frenuar laktacionin.
PS)D

Pyetja 936 V)1

Cili nga këto citime nuk paraqet një indikacion absolut për operacion cesarean?

A) placenta previa centrale
B) shtatzëni multiple (katërnjake)
C) prolaps i kordonit umbilikal
D) operacion cezarian i mëparshëm
E) paraqitje fetale transversale
PS)D

Pyetja 937 V)2

Corpus Rosenmuller quhet edhe:

A) paraoforon.
B) kanali Malpigi-Gartner.
C) epoophoron.
D) kordon genital.
E) Morgagni.
PS)C

Pyetja 938 V)1

Sa është gjatësia mesatare e një ovari normal?

A) 50-60 mm
B) 10 cm
C) 1cm
D) 2-4 cm
E) 7-8 cm
PS)D

Pyetja 939 V)2

Manovra e katërt e Leopoldit përcakton:

A) në qoftë se fetusi ndodhet ne pozicion longitudinal (gjatësor), transversal ose oblik.
B) në çfarë nivel ndodhet fundusi uterin.
C) nëse pjesa paraqitëse është angazhuar.
D) kush janë karakteristikat e pjesës paraqitëse.
E) në qoftë se kanali cervical ka filluar të dilatohet.
PS)C

Pyetja 940 V)2

Gratë që për shkaqe të ndryshme i janë nënshtruar ovarektomisë bilaterale para moshës 35 vjeçare, kanë risk për kancer gjiri:

A) më të lartë se 20%
B) më të lartë se mesatarja
C) të njejtë me gratë e tjera të së njejtës moshë
D) më të lartë se 50%
E) maksimalisht mbi 100%
PS)B

Pyetja 941 V)2

Karcinoma e gjirit normalisht:

A) nuk jep metastaza.
B) jep metastaza me rrugë hemo-limfatike.
C) jep metastaza per continuitatem.
D) jep metastaza të vonshme.
E) jep metastaza në raste të rralla.
PS)B

Pyetja 942 V)2

Cili është shkaku më i shpeshtë i Sindromës Sheehan?

A) hemorragjia e paslindjes
B) shoku endotoksik
C) trauma
D) tumoret
E) inflamacioni
PS)A

Pyetja 943 V)1

Pas sa kohësh paslindjes, uterusi arrin dimensionet e parashtatzënisë?

A) 4-6 ditë
B) 2 ditë
C) 2 javë
D) 6 javë
E) 12 javë
PS)D

Pyetja 944 V)1

Sipas OBSH-së kufijtë minimale të tolerueshëm të Hb te një grua shtatzënë janë:

A) 10g/100ml.
B) 15g/100ml.
C) 17g/100ml.
D) 8g/100ml.
E) 7g/100ml.
PS)A

Pyetja 945 V)1

Cila nga strukturat e mëposhme është ligament i ovarit?

A) ligament rotund
B) cardinal
C) Mackenrod
D) fascia endopelvike
E) ligamenti infundibulo-pelvik
PS)E

Pyetja 946 V)1

Termi " gjigandizëm fetal" përdoret për të treguar fetuset që kanë peshë në lindje të ? se:

A) 3500g
B) 4000g

C) 4500g
D) 5000g
E) 6000g
PS)D

Pyetja 947 V)1

Në fund të javës …, lëvizjet aktive fetale janë kaq të shprehura sa që ndjehen si nga nëna, ashtu edhe nga mjeku nëpërmjet palpacionit të murit abdominal.

A) 12
B) 14
C) 10
D) 20
E) 24
PS)D

Pyetja 948 V)2

"Minipilula" përbëhet nga:

A) estroprogestative me doza të ulta.
B) estrogjenë në doza bazë.
C) antiandrogjenike.
D) progestative.
E) ciklofenile.
PS)D

Pyetja 949 V)2

Me "Lichen sclerosus" nënkuptohet:

A) rënia e lëkurës pubike.
B) sekretim i një materiali me ngjyrë jeshile nga organet gjenitale.
C) patologji distrofike e vulvës.
D) vështirësia për të defekuar.
E) sinonim i dispareunisë.
PS)C

Pyetja 950 V)1

Gjatë shtatzënisë, fibrinogjeni:

A) rritet 100%.
B) rritet 50%.
C) rritet shumë pak.
D) mbetet i pandryshuar.

E) ulet.
PS)B

Pyetja 951 V)1

Cili prej tipeve histologjikë të mëposhtëm nuk është një tumor malinj?

A) cistadenoma seroze
B) karcinoma mucinoze
C) karcinoma endometrioide
D) karcinoma seroze
E) karcinoma e padiferencuar
PS)A

Pyetja 952 V)2

Hematuria është një manifestim karakteristik i cilit prej dëmtimeve të mëposhtme kontuzive të veshkës?

A) disinserzionit (zhvendosja nga vendi) e veshkës
Cili është ngjyrues acid që përdoret shpesh në citologji?

A) pironina
B) eozina
C) bluja e metilenit
D) bluja e toluidinës
E) tionina
PS)B

Pyetja 1167 V)1

Proteina e Bence-Jones vërehet në:

A) glomerulonefritin me lezione minimale
B) nekrozën tubulare akute
C) amiloidozën renale

D) sindromën nefrotike të shkaktuar nga mieloma
E) sindromën Goodpasture
PS)D

Pyetja 1168 V)2

Sëmundja Willebrand është një formë:

A) hemorragjike nga trombocitopenia
B) trombotike
C) hemorragjike nga deficienca koagulative
D) hemorragjike nga trombocitopatia
E) hemorragjike nga deficienca koagulative-trombocitare
PS)E

Pyetja 1169 V)1

Cili prej këtyre muskujve skeletikë e ngre krahun lart:

A) deltoidi
B) dorsalis major
C) tricepsi
D) bicepsi
E) pektoralis major
PS)A

Pyetja 1170 V)2

Ndërlikimet neurologjike më të shpeshta të alkoolizmit janë:

A) morbus Parkinson
B) polineuritet
C) strabizmi
D) miastenia
E) apraksia
PS)B

Pyetja 1171 V)1

Cilat janë pasojat e infeksionit nga HIV-1?

A) reduktimi i numrit të limfociteve B në qarkullim
B) reduktimi i numrit të limfociteve CD4 në qarkullim
C) splenomegalia persistente e gjeneralizuar
D) rritja e përgjigjes kutane ndaj tuberkulinës
E) aktivizimi spontan i qelizave NK
PS)B

Pyetja 1172 V)2

Ku përfundon rrjedhja e gjakut nga venat pulmonare?

A) në atriumin e djathtë
B) në ventrikulin e djathtë
C) në sinusin koronar
D) në ventrikulin e majtë
E) në asnjë prej të mësipërmëve
PS)E

Pyetja 1173 V)3

Lokalizimi elektiv i limfociteve B në limfonoduj janë:

A) strukturat perifolikulare
B) qendrat e zbehta të folikujve
C) strukturat parakortikale
D) strukturat limfoide periarteriolare të shpretkës
E) të gjitha këto struktura
PS)B

Pyetja 1174 V)2

Sinkopa nga arresti kardiak apo nga hedhja kardiake e papërshtatshme vërehet në:

A) vaskulopatinë okluzive cerebrale
B) vazodepresionin nga stimuli sino-carotidien
C) presionin e reduktuar të perfuzionit cerebral nga kollitja
D) krizën Morgagni-Adams-Stokes
E) hipoglicemi
PS)D

Pyetja 1175 V)3

Cila është artropati joinflamatore?

A) sindroma Reiter
B) artriti psoriatik
C) osteokondriti disekant
D) spondiliti ankilozant
E) artriti reumatoid
PS)C

Pyetja 1176 V)2

Ethja supurative është:

A) e vazhdueshme
B) remitente
C) nokturne
D) periodike
E) ondulante
PS)A

Pyetja 1177 V)3

Cila prej situatave të mëposhtme nuk ndërlikohet shpesh me anemi hemolitike autoimune?

A) leucemia limfatike kronike
B) morbus Hodgkin
C) infeksionet virale
D) anemia sideropenike
E) administrimi i alfa-metildopës
PS)D

Pyetja 1178 V)2

Presioni venoz qendror matet në:

A) venën aksilare
B) venën femurale
C) venën safena
D) venën azigos
E) atriumin e djathtë
PS)E

Pyetja 1179 V)3

Pepsinogjeni hematik është i reduktuar në:

A) tumoret hipotalamike
B) aneminë pernicioze
C) hiperfunksionin kortikosurrenalien
D) gastritin hipersekretues
E) gjendjet e "stresit"
PS)B

Pyetja 1180 V)3

Streptokoku beta-hemolitik që është shkaku më i shpeshtë i glomerulonefritit akut është:

A) tipi 12

B) tipi 49
C) tipi 3
D) tipi 1
E) tipi 4
PS)A

Pyetja 1181 V)2

Filtrimi glomerular kushtëzohet nga:

A) sasia e fluksit hematik renal
B) përqendrimi i lëndëve të tretura në plazmë
C) funksionaliteti tubular
D) ekskrecioni tubular i kreatininës
E) pH plazmatik
PS)A

Pyetja 1182 V)2

Acidi nikotinik ushtron veprim:

A) antiinflamator
B) antidiarreik
C) vazodilatator periferik
D) antianemik
E) antihemorragjik
PS)C

Pyetja 1183 V)2

Fluksi plazmatik renal normalisht është:

A) 100-300 ml/min/m2 1,73
B) 600-700 ml/min/m2 1,73
C) 1000-1500 ml/min/m2 1,73
D) 1500-1700 ml/min/m2 1,73
E) 1700-2000 ml/min/m2 1,73
PS)B

Pyetja 1184 V)3

Në kuadrin e sindromës Peutz-Jeghers, melanoza e buzëve dhe mukozave shoqërohet me:

A) ulçerë duodenale
B) kolit ulçeroz
C) hepatit kronik
D) polipozë të zorrës së hollë

E) ileokolit granulomatoz
PS)D

Pyetja 1185 V)3

Përgjithësisht, arteriet e drejta false të veshkave e marrin origjinën nga:

A) arteriola aferente
B) arteriola eferente
C) arteria arkuata
D) arteria lobulare
E) rrjeta arteriale subkapsulare
PS)B

Pyetja 1186 V)3

Iktusi apopleptik me hemiplegji dhe rrotullim të syve dhe të kokës në drejtim të lezionit shkaktohet nga:

A) hemorragjia kapsulare
B) hemorragjia lobare
C) hemorragjia cerebelare
D) hemorragjia bulbare
E) hemorragjia pontine
PS)A

Pyetja 1187 V)3

Në flebogramë, vala pozitive v shpreh:

A) sistolën atriale
B) kontraksionin ventrikular të majtë
C) mbushjen e atriumit të djathtë
D) fazën e kolapsit venoz
E) zbrazjen e atriumit të djathtë
PS)C

Pyetja 1188 V)2

Rritja e pCO_2 vërehet në:

A) alkalozën respiratore të kompensuar
B) alkalozën respiratore të pakompensuar
C) acidozën metabolike të kompensuar
D) acidozën respiratore të kompensuar
E) alkalozën metabolike të pakompensuar
PS)D

Pyetja 1189 V)3

Hipertensina II është:

A) dodekapeptid
B) dekapeptid
C) oktapeptid
D) heptapeptid
E) hekzapeptid
PS)C

Pyetja 1190 V)2

Mycoplasma pneumoniae mund të provokojë:

A) anemi megaloblastike
B) anemi hemolitike
C) pneumokoniozë
D) pleurit eksudativ
E) poliglobuli
PS)B

Pyetja 1191 V)1

Në formulën leukocitare, përqindja e bazofileve në gjakun e një individi të shëndetshëm është normalisht:

A) 0-3%
B) 5-10%
C) 5-15%
D) 0-20%
E) 0-30%
PS)A

Pyetja 1192 V)3

Në cilën situatë vërehet dhembje torakale e papritur, polipne dhe hemoptizi modeste?

A) pleurit hemorragjik
B) perikardit eksudativ
C) pakipleurit
D) infarkt pulmonar
E) infarkt i miokardit
PS)D

Pyetja 1193 V)2

Anemia hemolitike me gjenezë johereditare është:

A) anemi hemoglobinurike paroksistike nga i ftohti
B) anemia sferocitare
C) anemia elipsocitare
D) anemia stomatocitare
E) talasemia
PS)A

Pyetja 1194 V)2

Linea parabolike Ellis-Damoiseau me konveksitet superior, e cila ngjitet dhe kthehet drejt sqetullës homolaterale, vërehet gjatë:

A) pleuritit eksudativ
B) hidropneumotoraksit
C) pneumotoraksit
D) perikarditit
E) pleuro-perikarditit adeziv
PS)A

Pyetja 1195 V)2

Presioni mesatar në atriumin e majtë normalisht është:

A) 1-1,2 mmHg
B) 2,0-12,0 mmHg
C) 15-20 mmHg
D) 20-25 mmHg
E) 25-30 mmHg
PS)B

Pyetja 1196 V)3

Toni i dyfishtë i Traube në arterien femurale dëgjohet gjatë:

A) stenozën së valvulës mitrale
B) insuficiencës së valvulës mitrale
C) stenozës së valvulës mitrale
D) insuficiencës së aortës
E) stenozës së valvulës pulmonare
PS)D

Pyetja 1197 V)1

Hormoni i paratiroides favorizon:

A) reduktimin e përthithjes enterike të kalciumit
B) rritjen e riabsorbimit tubular të fosforit
C) reduktimin e riabsorbimit tubular të fosforit
D) fiksimin e kalciumit në nivel kockor
E) hipokalceminë
PS)C

Pyetja 1198 V)1

Cila molekulë nuk është pirogjene?

A) IL-1
B) TNF alfa
C) IL-6
D) EGF
E) interferoni
PS)D

Pyetja 1199 V)3

Në kompleksin Eisenmenger nuk vërehet kjo anomali:

A) aorta e shaluar
B) difekti i lartë në septumin interventikular
C) stenoza e pulmonares
D) hipertrofia ventrikulare e djathtë
E) harku prominent i pulmonares
PS)C

Pyetja 1200 V)3

Në sindromën e malabsorbimit vëllimi plazmatik qarkullues është i reduktuar. Ky reduktim shoqërohet me:

A) poliuri
B) diurezë osmotike
C) hiperbikarbonemi
D) reduktim të proteinave urinare
E) hipokalemi dhe hipokalcemi
PS)E

Pyetja 1201 V)2

Cila nuk mund të provokojë hemoglobinuri?

A) sferocitoza hereditare

B) favizmi (deficienca e G6PD)
C) morbus Moschowitz
D) pielonefriti akut
E) aksidentet transfuzionale
PS)D

Pyetja 1202 V)3

Glomerulonefriti akut post-streptokoksik nuk mund të ndodhë pas:

A) anginës së kuqe
B) rubeolës
C) skarlatinës
D) piodermitit
E) erizipelës
PS)B

Pyetja 1203 V)2

Zhurma Graham-Steel është zhurmë:

A) diastolike nga insuficienca pulmonare relative
B) sistolike pulmonare
C) diastolike nga stenoza e valvulës mitrale
D) sistolike nga stenoza e aortës
E) mesodiastolike nga hiperfluksi atrio-ventrikular
PS)A

Pyetja 1204 V)1

Takipnea është:

A) rritja e frekuencës së frymëmarrjes në minutë
B) rritja e "zhurmës" së frymëmarrjes
C) rritja e thellësisë së frymëmarrjes
D) sibilacionet inspiratore
E) ndjesia subjektive e frymëmarrjes së vështirë
PS)A

Pyetja 1205 V)2

Presioni fillestar i likuorit është i rritur në:

A) morbus Landry-Guillain-Barre'
B) sifiliz meningo-vaskular
C) poliomielit anterior akut
D) hemorragji subaraknoidale

E) sklerozë multiple
PS)D

Pyetja 1206 V)2

Hipokalcemia vërehet në:

A) osteomalaci me spazmofili
B) insuficiencë të ovarit
C) morbus Vaquez
D) leucemi mieloide
E) osteit fibrocistik
PS)A

Pyetja 1207 V)2

Në palpacion, impulsi kardiak që perceptohet në zonë parasternale të majtë dhe në zonën epigastrike shkon për:

A) hipertrofi ventrikulare të majtë
B) dilatim dhe hipertrofi ventrikulare të majtë
C) hipertrofi të atriumit të majtë
D) hipertrofi të ventrikulit të djathtë
E) aderencë pleuro-perikardike
PS)D

Pyetja 1208 V)1

Fletët semilunare të valvulës pulmonare emërtohen sipas pozicionit të tyre dhe quhen:

A) anteriore dhe inferiore
B) posteriore, e djathtë dhe e majtë
C) superiore, e djathtë dhe e majtë
D) anteriore, superiore dhe inferiore
E) anteriore, e djathtë dhe e majtë
PS)E

Pyetja 1209 V)2

Cila hepatopati karakterizohet gjithnjë nga rritja e gamaglobulinave?

A) nekroza hepatike akute
B) kolestaza nga obstruksioni biliar intrahepatik
C) kolestaza nga obstruksioni biliar ekstrahepatik
D) hepatiti toksik
E) hepatiti kronik agresiv
PS)E

Pyetja 1210 V)3

Rritja e nivelit plazmatik të transaminazave, laktikdehidrogjenazës dhe e creatin-fosfokinazës vërehet në mënyrë konstante gjatë:

A) hepatitit akut
B) sindromës së shtypjes (crush syndrome)
C) hemoglobinurisë paroksistike
D) porfirinurisë akute
E) alkaptonurisë
PS)B

Pyetja 1211 V)1

Vlerat normale të kreatininemisë serike janë:

A) 0,2-0,5 mg%
B) 0,5-0,7 mg%
C) 1,0-1,5 mg%
D) 2,0-2,5 mg%
E) 3,0-3,5 mg%
PS)C

Pyetja 1212 V)1

Kilomikronet përbëhen në një përqindje të lartë (rreth 80%) nga:

A) trigliceride
B) kolesterol
C) fosfolipide
D) proteina
E) azot proteinik
PS)A

Pyetja 1213 V)2

Imuniteti natyror përbëhet nga një sërë mekanizmash mbrojtjeje:

A) që aktivizohen në mënyrë specifike pas mbërritjes së një antigjeni të veçantë
B) që janë të varur nga mediatorë humoralë dhe qelizorë
C) që ekzaltohen pas kontaktit të dytë me të njëjtin antigjen
D) që bëjnë të mundur memorien imunologjike
E) që kanë karakteristikat e dy përgjigjeve të para (A dhe B)
PS)B

Pyetja 1214 V)2

Koaguli është i përbërë kryesisht nga:

A) kolagjeni i tipit IV
B) laminina
C) kolagjeni i tipi I
D) fibrina dhe fibronektina
E) heparina
PS)D

Pyetja 1215 V)1

Lipoproteinat me dendësi të ulët (LDL) përbëhen në përqindje të lartë (47%) nga:

A) kolesteroli
B) proteinat
C) trigliceridet
D) fosfolipidet
E) sfingomielinat
PS)A

Pyetja 1216 V)1

Hemoptizia është hemorragjia nga:

A) dhëmbët
B) goja
C) hunda
D) faringu
E) pema respiratore
PS)E

Pyetja 1217 V)1

Oliguria dhe poliuria janë të lidhura ngushtë me:

A) reduktimin e filtrimit glomerular
B) rritjen e filtrimit glomerular
C) reduktimin e riabsorbimit tubular hidrik
D) rritjen e riabsorbimit tubular hidrik
E) ndërveprime ndërmjet filtrimit glomerular dhe riabsorbimit tubular hidrik
PS)E

Pyetja 1218 V)2

Në bllokun atrio-ventrikular total nuk vërehet klinikisht:

A) percepsioni i mundshëm i tonit atrial
B) toni i parë në apeks, ndonjëherë i quajtur "gjuajtja e topit")
C) disociacioni ndërmjet pulsit arterial dhe pulsit jugular
D) frekuenca e pulsit e ndikuar nga stimulimi vagal (p.sh. komprimimi i bulbeve okulare)
E) frekuenca e pulsit e pandjeshme ndaj stimulimit vagal
PS)D

Pyetja 1219 V)2

Piuria acide është karakteristike për:

A) tuberkulozin renal
B) kalkulozën renale
C) hipertrofinë e prostatës
D) cistitin akut
E) neoplazinë renale
PS)A

Pyetja 1220 V)1

Atropina:

A) rrit sekretimin salivar
B) redukton presionin endokular
C) shkakton lëshimin e muskulaturës së lëmuar bronkiale
D) provokon miozë
E) stimulon sekretimin gastrik
PS)C

Pyetja 1221 V)2

Sindroma e QT të gjatë shkaktohet nga:

A) deficiti i simpatikut të djathtë
B) prevalenca e simpatikut të majtë
C) ablacioni i ganglionit stelat të djathtë
D) të gjitha këto shkaqe
E) A dhe B
PS)D

Pyetja 1222 V)1

Cilët muskuj inervohen nga nervi facial?

A) muskujt mastikatorë
B) muskujt mimikë dhe të qiellzës së butë
C) muskujt mimikë

D) muskujt genioglossus dhe stiloglossus
E) muskujt genioglossus dhe ioglossus
PS)C

Pyetja 1223 V)2

Krepitacioni pulmonar indox dhe redox vërehet gjatë:

A) pneumonitit krupoz
B) bronkitit astmatik
C) fibrozës pulmonare
D) pleuritit eksudativ
E) pleuritit të thatë
PS)A

Pyetja 1224 V)2

Cila prej simptomave të mëposhtme mungon në tumoret e kolonit?

A) dhembjet abdominale
B) modifikimet e feçeve
C) prania e gjakut në feçe
D) anemia progresiva
E) akolia e feçeve
PS)E

Pyetja 1225 V)2

Aneurizmat kongjenitale më të shpeshta ndodhin në:

A) vazat mezenterike
B) vazat endokraniale
C) vazat e gjymtyrëve të sipërme
D) venat pulmonare
E) arteriet iliake
PS)B

Pyetja 1226 V)1

Të gjitha mundësitë e mëposhtme mund të jenë shkaqe të mundshme të leucemisë limfatike kronike, me përjashtim të:

A) hemorragjive
B) hipersplenizmit
C) autoimunizimit
D) invazionit medular
E) mungesës së vitaminës B12

PS)E

Pyetja 1227 V)2

Në cilën prej këtyre patologjive pulmonare shfaqet më rrallë hemoptizia?

A) tuberkulozi pulmonar ekskavativ
B) hipertensioni pulmonar primar i rëndë
C) karcinoma metastatike pulmonare
D) trombembolia pulmonare
E) diateza hemorragjike
PS)C

Pyetja 1228 V)2

Adenoma hipofizare bazofile vërehet gjatë:

A) hiperprolaktinemisë
B) gjigandizmit
C) akromegalisë
D) morbus Cushing
E) sindroma Frohlich
PS)D

Pyetja 1229 V)2

Simptoma e parë e tumoreve të aparatit urogjenital është:

A) stranguria
B) polakiuria
C) proteinuria
D) hematuria
E) disuria
PS)D

Pyetja 1230 V)2

Në hiperaldosteronizmi primar është karakteristike:

A) rritja e TSH plazmatik
B) rritja e 17 ketosteroideve urinare
C) hiperkalcemia me hipofosforemi
D) rënia e kortizolit plazmatik
E) hipernatremia me hipokalemi
PS)E

Pyetja 1231 V)2

Cila prej këtyre shenjave kutane nuk vërehet gjatë insuficiencës kronike surrenaliene primare?

A) lëkura e hiperpigmentuar në zonat e fërkimit
B) melanodermia
C) vitiligo
D) hipertrikoza aksilare dhe pubike te femrat
E) linja abdominale alba e errët
PS)D

Pyetja 1232 V)2

Skrofulla është:

A) limfomë primare e qafës
B) metastazë e limfonodujve cervikalë nga neoplazitë e kavitetit oral
C) limfoadenit akut
D) limfoadenit tuberkular i qafës
E) obstruksion limfatik i qafës
PS)D

Pyetja 1233 V)2

Osmolariteti urinar përcaktohet nga:

A) pesha e çdo substance solubël në urinë
B) sasia e substancave të tretshme në urinë
C) numri i molekulave në urinë
D) pesha dhe sasia e substancave të tretshme në urinë
E) pesha dhe numri i molekulave në urinë
PS)C

Pyetja 1234 V)2

Nga pikëpamja histopatologjike, glomerulonefriti subakut ose progresiv i shpejtë është glomerulonefriti:

A) membranoz
B) proliferativ endokapilar
C) proliferativ mesangial
D) proliferativ endo-ekstrakapilar
E) proliferativ mesangiokapilar
PS)D

Pyetja 1235 V)2

Përmbajtja mesatare e natriumit në qumështin e lopës është:

A) 50 mg%
B) 70 mg%
C) 100 mg%
D) 120 mg%
E) 140 mg%
PS)A

Pyetja 1236 V)2

Kuadri akustik me gulçime, fishkëllima dhe sibilacione vërehet në:

A) alveolit
B) astmë bronkiale
C) pneumoni
D) edemë pulmonare
E) bronkopneumoni
PS)B

Pyetja 1237 V)3

Në prani të eozinofilisë së spikatur nuk duhet marrë parasysh prania e:

A) limfogranulomës
B) sindromës së qumështit dhe alkaleve
C) periartritit nodoz
D) helmintiazës
E) retikulozës Giffin-Cremer
PS)B

Pyetja 1238 V)2

Morbusi Paget është:

A) osteoporozë
B) osteit deformues
C) osteomalaci
D) osteopsatirozë idiopatike
E) osteit fibrocistik
PS)B

Pyetja 1239 V)2

Aritmia nga alterimi i përçimit të impulsit kardiak në nivel atrial vërehet në:

A) bradikardi sinusale
B) bllokun e degës së djathtë

C) pacemakerit endacak
D) disociacionit atrial ose bllokut interatrial
E) arrestit të aktivitetit të nyjes sinusale
PS)D

Pyetja 1240 V)3

Faza prodromike e hepatitit akut B karakterizohet ndonjëherë nga:

A) insuficienca renale akute
B) sëmundja e serumit
C) krizat epileptike sporadike
D) të gjitha të mësipërmet
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)E

Pyetja 1241 V)3

Ekspektorati i pacientëve me bronkektazi është i tipit:

A) shkumor,
B) mukoz,
C) shkumor, mukoz, purulent
D) shkumor, mukoz
E) purulent
PS)C

Pyetja 1242 V)2

Sindroma Ebstein është një:

A) pozicionim djathtas i aortës
B) komunikim interventrikular
C) stenozë e harkut të aortës
D) dislokim në drejtim poshtë i valvulës mitrale
E) dislokim në drejtim poshtë i valvulës trikuspidale
PS)E

Pyetja 1243 V)1

Kromatina ndodhet në:

A) citoplazmë
B) bërthamë
C) lizozomë
D) ribozomë
E) aparatin e Golgi-t

PS)B

Pyetja 1244 V)2

Hiperkeratoza folikulare vërehet si rrjedhojë e mungesës së vitaminës:

A) D
B) C
C) B12
D) B1
E) A
PS)E

Pyetja 1245 V)1

Papaverina ushtron veprim:

A) rritjeje të shpejtësisë së përçimit të stimulit kardiak
B) spazmolitik
C) analgjezik qendror
D) narkotik qendror
E) analeptik
PS)B

Pyetja 1246 V)2

Gjatë komës meningeale mund të vërehet shpesh:

A) respiracioni Biot
B) mioglobinuria
C) hiperamoniakemia
D) hiponatremia
E) hiperlipidemia
PS)A

Pyetja 1247 V)3

*25% e lipideve të membranës eritrocitare përbëhet nga:

A) acid fosfatidik
B) kolesterol
C) sfingomielina
D) fosfatidilserina
E) fosfatidilinozitol
PS)B

Pyetja 1248 V)2

Cila metodë përdoret për vlerësimin e IgE specifike për alergjenët e veçantë?

A) imunoelektroforeza
B) RIST
C) RAST
D) imunofluoreshenca
E) imunodifuzioni
PS)C

Pyetja 1249 V)2

Zbulimi i pH të rritur dhe pCO2 normal tregon:

A) alkalozë metabolike
B) alkalozë respiratore
C) acidozë metabolike
D) acidozë respiratore
E) acidozë metabolike kompensuese
PS)A

Pyetja 1250 V)2

Afazia motore ose e shprehjes është:

A) paaftësia për të folur
B) moskuptimi i fjalëve të dëgjuara
C) moskuptimi i fjalëve të shkruara
D) dëmtimi i pjesshëm i perceptimit të gjuhës së folur/shkruar
E) dëmtimi i pjesshëm i shprehjes së gjuhës së folur/shkruar
PS)A

Pyetja 1251 V)3

Në sindromën qumësht dhe alkale si rrjedhojë e konsumit të sasive shumë të mëdha të qumështit ose të antiacideve për shkaqe terapeutike (ulçerë gastrike, duodenale, etj.) niveli i bikarbonatit serik është:

A) normal
B) i reduktuar
C) i rritur
D) normal ose i reduktuar
E) i reduktuar në raport me hiperkaleminë
PS)C

Pyetja 1252 V)2

Melena nënkupton derdhjen e gjakut në lumenin enterik në sasi prej të paktën:

A) 10 ml
B) 20 ml
C) 30 ml
D) 50 ml
E) 100 ml
PS)D

Pyetja 1253 V)1

Edema nga presioni hidrostatik i rritur vërehet në:

A) kolit ulçeroz
B) sindromë nefrotike
C) sprue idiopatike
D) morbus Whipple
E) insuficiencë kronike kongjestive të qarkullimit
PS)E

Pyetja 1254 V)1

Elektroforeza e hemoglobinës në rastet me talasemi major tregon mbizotërim të hemoglobinës:

A) Hb A
B) Hb S
C) Hb F
D) Hb A2
E) Hb H
PS)C

Pyetja 1255 V)2

Litiaza nga acidi urik vërehet shpesh në:

A) cirrozë hepatike
B) tuberkuloz pulmonar
C) nefropati diabetike
D) sëmundje mieloproliferative
E) glomerulonefrit akut difuz
PS)D

Pyetja 1256 V)2

Limfocitet T "helper" (ndihmëse) :

A) nuk kanë aftësi të bashkëveprojnë me limfocitet B
B) janë të afta të prodhojnë antikorpe në mënyrë të drejtpërdrejtë
C) përgjithësisht reagojnë ndaj determinantëve proteinikë
D) përgjithësisht reagojnë ndaj determinantëve aptenikë
E) paraqesin të gjitha karakteristikat e mësipërme
PS)C

Pyetja 1257 V)3

Në 75% të rasteve me miksedemë te të rriturit vërehet:

A) hipodisprotidemi
B) kolesterolemi e rritur
C) kolesterolemi e reduktuar
D) urea plazmatike e rritur
E) urea plazmatike e reduktuar
PS)B

Pyetja 1258 V)2

Sindroma Morgagni-Adams-Stokes karakterizohet nga:

A) shfaqja vetëm në pozicion ortostatik
B) prania e aurës paralajmëruese
C) fillimi i papritur
D) të gjitha këto simptoma
E) asnjë prej këtyre simptomave
PS)C

Pyetja 1259 V)1

Depozitimi i imunokomplekseve në nivel të membranës glomerulare bazale nuk vërehet në:

A) glomerulonefrit me lezione minimale
B) glomerulonefrit proliferativ endokapilar
C) glomerulonefrit proliferativ mesangial
D) glomerulonefrit proliferativ endo-ekstrakapilar
E) glomerulonefrit proliferativ mesangiokapilar
PS)A

Pyetja 1260 V)1

Akolia e feçeve vërehet gjatë:

A) obstruksionit të plotë të rrugës biliare kryesore
B) hiperhemolizës
C) inflamacionit të sfinkterit të Oddi-t

D) pankreatitit akut
E) polipozës së kolonit
PS)A

Pyetja 1261 V)1

Pesha specifike urinare është shumë e ulët (1002-1004) në:

A) diabet të bronztë
B) diabet mellitus
C) diabet insipid
D) glomerulonefrit akut
E) sindromë nefrotike
PS)C

Pyetja 1262 V)1

Cili element ka peshë atomike 14,008?

A) oksigjeni
B) azoti
C) natriumi
D) karboni
E) kalciumi
PS)B

Pyetja 1263 V)2

Kalcemia mund të jetë e rritur në:

A) osteomalaci
B) periudhën terminale të shtatzënisë
C) hipoparatiroidizëm
D) hipertiroidizëm
E) celiaki
PS)D

Pyetja 1264 V)3

Imunoglobulinat me vis nefritogena më të lartë janë:

A) Ig D
B) Ig A
C) Ig E
D) Ig G
E) Ig M
PS)E

Pyetja 1265 V)2

Karakteristike për ozenën është:

A) atrofia e mukozës dhe e skeletit nazal
B) sinusiti
C) devijimi i septumit nazal
D) epistaksis
E) neuralgjia e nervit trigeminal
PS)A

Pyetja 1266 V)2

Herniet hiatale shoqërohen më shpesh me:

A) ulçerë gastrike
B) stenozë pilorike
C) kalkulozë të kolecistës dhe divertikulozë të kolonit
D) divertikuj faringoezofagealë
E) variçe ezofageale
PS)C

Pyetja 1267 V)2

Sindroma Crigler-Najjar karakterizohet nga rritja serike prevalente e:

A) bilirubinës direkte
B) bilirubinës indirekte
C) kripërave biliare
D) fosfatazës alkaline
E) gama-GT
PS)B

Pyetja 1268 V)3

Në djegiet e gradës së dytë dhe të tretë vërehet:

A) hiponatremi
B) hipokalemi
C) hipokloremi
D) rritja e proteinave serike
E) hipokarbonatemia
PS)E

Pyetja 1269 V)2

Përqendrimi i albuminës në plazmë rritet në:

A) tuberkuloz
B) eksikozë
C) hepatopati kronike
D) sindromë nefrosike
E) gjendje inflamatore kronike
PS)B

Pyetja 1270 V)2

Vlerat normale të acetonemisë janë:

A) 0,05-0,2 mg%
B) 0,3-2,0 mg%
C) 2,5-3,0 mg%
D) 3,5-4,0 mg%
E) 4,5-5,0 mg%
PS)B

Pyetja 1271 V)2

Gjatë hipertensionit portal, asciti shfaqet kur është e pranishme edhe:

A) hepatomegalia
B) splenomegalia
C) hepato-splenomegalia
D) hiponatremia
E) hipoalbuminemia
PS)E

Pyetja 1272 V)2

Në morbus Werlhof (purpura idiopatike trombocitopenike) nuk ndodh:

A) trombocitopenia
B) zgjatja e kohës së protrombinës
C) koha normale e koagulimit
D) retraksioni normal i koagulit
E) provat pozitive të brishtësisë vazale
PS)D

Pyetja 1273 V)1

Hemofilia B shkaktohet nga mungesa e:

A) AHG (faktori VIII)

B) PTC (faktori IX)
C) FSF (faktori XIII)
D) PTA (faktori XI)
E) faktori Hageman (faktori XII)
PS)B

Pyetja 1274 V)1

Masazhi i sinusit karotidien, komprimimi i bulbeve okulare ose manovra Valsalva mund të shkaktojnë:

A) zhdukjen e takikardisë ventrikulare
B) rritjen e takikardisë atriale paroksistike
C) transformimin e një flateri atrial në fibrilacion
D) reduktimin e takikardisë sinusale
E) rritjen e takikardisë sinusale
PS)D

Pyetja 1275 V)2

Rritja e dukshme e gama-globulinave vërehet shpesh gjatë:

A) infarktit të miokardit
B) tromboangioitit obliterant
C) uremisë
D) ulçerës duodenale
E) pneumokoniozës
PS)E

Pyetja 1276 V)2

Hipoglicemia vërehet në:

A) hemokromatozë
B) sindromë dumping
C) feokromocitomë
D) neoplazi glukagon-sekretuese
E) sindromë Cushing
PS)B

Pyetja 1277 V)2

Në reaksionin imunitar të tipit I, ndërmjetësues i reaksionit është:

A) fraksioni C3a i komplementit
B) fraksioni C5 i komplementit
C) fraksioni C6 i komplementit

D) fraksioni C7 i komplementit
E) prostaglandinat
PS)E

Pyetja 1278 V)3

Përdorimi i tiopentalit (Pentotal) është rreptësisht i kundraindikuar në:

A) litiazë renale
B) litiazë hepatike
C) personat bronkektazikë
D) porfiri
E) ulçerë gastrike
PS)D

Pyetja 1279 V)2

Reaksioni Ghedini-Weinberg është i dobishëm për diagnostikimin e:

A) teniazës
B) malaries
C) trikinozës
D) abscesit amebik
E) kisteve nga ekinokoku
PS)E

Pyetja 1280 V)2

Cila prej karakteristikave të mëposhtme është e vërtetë për qelizat natural killer?

A) mungesë e shprehjes së receptorëve për fraksionin konstant të imunoglobulinave
B) shprehje kostitucionale e receptorit për IL-2 me afinitet të ulët
C) shprehje e induktueshme të molekulave MHC të klasës I
D) shprehje e receptorëve për molekulat MHC të klasës I me veprim inhibitor
E) shprehje e receptorëve për C3a
PS)D

Pyetja 1281 V)3

Ku mbështetet pareti inferior i zemrës?

A) mbi mushkërinë e majtë
B) mbi sternum
C) mbi pilastrin e majtë të diafragmës
D) mbi qendrën frenike të diafragmës
E) të gjitha të mësipërmet
PS)D

Pyetja 1282 V)2

Simptoma më konstante në morbus Hodgkin gjatë fazës fillestare është:

A) zmadhimet limfoglandulare
B) limfopenia
C) temperatura
D) anemia
E) rritja e shpejtësisë së eritrosedimentimit
PS)A

Pyetja 1283 V)1

Organi më i rëndësishëm për prodhimin e kalcitoninës është:

A) hipofiza
B) tiroidja
C) mbiveshkorja
D) pankreasi
E) hepari
PS)B

Pyetja 1284 V)2

Cila prej sëmundjeve të mëposhtme është shkaku më i rrallë i insuficiencës renale kronike?

A) pielonefriti obstruktiv
B) nefropatia gravidare
C) reni polikistik
D) tuberkulozi renal
E) pielonefriti joobstruktiv
PS)B

Pyetja 1285 V)3

Asinkronia e të gjitha pulseve periferike me rrahjen e apeksit kardiak vërehet në aneurizmat e:

A) aortës ascendente
B) harkut të aortës
C) trungut brakio-cefalik
D) aortës torakale
E) aortës abdominale
PS)A

Pyetja 1286 V)2

Në hernien e hiatusit ezofageal të pandërlikuar me ulçerime, stenozë apo flogozë, dhembja:

A) rrezatohet në zonën restrosternale drejt jugulares
B) rrezatohet drejt fosës klavikulare të majtë
C) rrezatohet drejt sqetullës së majtë
D) rrezatohet drejt hipokondrit të majtë
E) nuk rrezatohet
PS)E

Pyetja 1287 V)2

Cila prej këtyre të dhënave laboratorike rezulton qartësisht i rritur në fazat e aktivitetit të limfogranulomës Hodgkin?

A) kupremia
B) trombocitemia
C) sideremia
D) albuminemia
E) azotemia
PS)A

Pyetja 1288 V)2

Cila simptomë subjektive e mëposhtme mungon në hipertiroidizëm?

A) rënia në peshë
B) hipersensibiliteti ndaj të ftohtit
C) astenia
D) të dridhurat
E) etja
PS)B

Pyetja 1289 V)2

Acid laktik dehidrogjenaza është e rritur në:

A) osteopatitë osteoblastike
B) aterosklerozë
C) anemi megaloblastike
D) obezitet
E) artrozë
PS)C

Pyetja 1290 V)2

Hepatomegalia e karakterizuar nga mëlçia e butë dhe e dhembshme vërehet në terren të:

A) stazës cirkulatore akute
B) stazës cirkulatore kronike
C) perikarditit kronik
D) ikterit hemolitik
E) heparit leucemik
PS)A

Pyetja 1291 V)3

Këndi Louis ndodhet në inserimin e:

A) brinjës I në sternum
B) brinjës II në sternum
C) brinjës III në sternum
D) ksifoidit me sternumin
E) diafragmës në kolonën vertebrale
PS)B

Pyetja 1292 V)3

Cila është acidozë tubulare renale distale primare?

A) sindroma Rodriguez-Soriano-Edelmann
B) sindroma Lightwood-Albright
C) sindroma Wilson
D) sindroma Lowe
E) sindroma De Toni-Debré-Fanconi
PS)B

Pyetja 1293 V)2

Mungesa e vitaminës K manifestohet me:

A) osteomalaci
B) gjuhë si hartë
C) hemorragji
D) palpebrit angolar
E) vaskularizim korneal
PS)C

Pyetja 1294 V)2

Deliriumi i kthjellët vërehet në:

A) sindromën konfuzionale me gjenezë emotive
B) sindromën konfuzionale me origjinë toksike
C) sindromën konfuzionale me origjinë infektive

D) psikozën e persekutimit
E) të gjitha këto patologji
PS)D

Pyetja 1295 V)2

Ku rrjedhin orificiumet ureterale?

A) në këndet posteriore të fshikëzës urinare
B) në apeksin e fshikëzës urinare
C) në fundin e fshikëzës urinare
D) të gjitha të mësipërmet
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)A

Pyetja 1296 V)3

Në sindromën Schonlein-Henoch, IgG në plazmë janë:

A) në nivel normal
B) në nivel të reduktuar
C) në nivel të rritur
D) të denatyruara
E) mungojnë
PS)A

Pyetja 1297 V)2

Polipeptidet përbëhen nga:

A) një numër i kufizuar aminoacidesh
B) një numër i kufizuar glucidesh
C) tre molekula trigliceridesh
D) sfingosinë, acide yndyrore dhe një monosaharid
E) glicerol, acid fosforik, acide yndyrore
PS)A

Pyetja 1298 V)2

Në seroaglutinimin e Wright, antitrupat përbëhen kryesisht nga imunoglobulina të klasës:

A) Ig G
B) Ig M
C) Ig A
D) Ig E
E) Ig D
PS)B

Pyetja 1299 V)3

Lezionet e sistemit nervor qendror janë gjithnjë të pranishme në:

A) sklerodermi
B) sindromën Moschcowitz (purpura trombocitare trombocitopenike)
C) morbus Paget
D) dermatopolimiozit
E) artrit reumatoid
PS)B

Pyetja 1300 V)1

Në mitozën qelizore, kromozomet ngjeshen përgjatë ekuatorit të qelizës gjatë:

A) interfazës
B) profazës I
C) profazës II
D) metafazës
E) anafazës I
PS)D

Pyetja 1301 V)1

Cila arterie nuk bën pjesë në cirkulin Willis?

A) arteriet cerebrale anteriore
B) arteria komunikuese anteriore
C) arteria bazilare
D) arteria komunikante posteriore
E) arteriet cerebrale posteriore
PS)C

Pyetja 1302 V)3

Kolecistokolangiografia rezulton zakonisht inefikase te:

A) pacientët e moshuar
B) pacientët nën 5 vjeç
C) pacientët ikterikë
D) të gjithë këta pacientë
E) asnjë nga këta pacientë
PS)C

Pyetja 1303 V)1

Numri normal i trombociteve është:

A) 120.000 - 450.000
B) 150.000 - 250.000
C) 200.000 - 400.000
D) 150.000 - 450.000
E) 150.000 - 600.000
PS)D

Pyetja 1304 V)1

Dizenteria bacilare është një sëmundje e karakterizuar nga të vjella, diarre, etj., e cila shkaktohet nga:

A) shigelat
B) entoameba histolitike
C) skistosomat
D) balantidium coli
E) arbovirusi i grupit B
PS)A

Pyetja 1305 V)3

Glikoprotidemia është e rritur në:

A) sëmundjen reumatike klinikisht inaktive
B) artropatinë uratike inaktive
C) osteoartrozën e lokalizuar
D) spondilitin ankilopoietik
E) osteoblastomë
PS)D

Pyetja 1306 V)2

Djegia e gradës II karakterizohet nga:

A) eritema
B) ulçerat
C) cikatricet
D) fshikëzat
E) ekzantema
PS)D

Pyetja 1307 V)1

Anemia pernicioze Biermer shkaktohet nga:

A) mungesa e hekurit
B) deficiti primar i faktorit intrinsik
C) rritja e konsumit të vitaminës B12 në lumenin intestinal
D) alterimi i absorbimit intestinal të kompleksit vitaminë B12 + faktor intrinsik
E) insuficienca pankreatike
PS)B

Pyetja 1308 V)2

Fenomeni i Wenckebach vërehet në:

A) bllokun sino-atrial të plotë
B) bllokun sino-atrial progresiv
C) bllokun e degës së djathtë
D) bllokun e degës së majtë
E) hemibllokun anterior të majtë
PS)B

Pyetja 1309 V)2

Prania e aftozës bukale dhe gjenitale recidivante të shoqëruar me shqetësime okulare sugjeron:

A) riketsiozën akute
B) sifilizin terciar
C) panarteritin nodoz
D) sëmundjen Behcet
E) aktinomikozën
PS)D

Pyetja 1310 V)2

Pareti i ventrikulit të djathtë:

A) është më i trashë se sa pareti i ventrikulit të majtë
B) është më i hollë se sa pareti i ventrikulit të majtë
C) ka të njëjtën trashësi me paretin e ventrikulit të majtë
D) është më i trashë se sa septumi
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)B

Pyetja 1311 V)1

Shenja Romberg manifestohet me sy të mbyllur dhe me sy të hapur në:

A) adiadokokinezi
B) strabizëm divergjent

C) ataksi tabetike
D) ataksi labirintike
E) ataksi cerebelare
PS)E

Pyetja 1312 V)2

Ndër donatorët e mëposhtëm, cili ka mundësinë më të madhe për të pasur të njëjtët antigjenë të histokompatibilitetit me marrësin e transplantit?

A) babai
B) nëna
C) vëllai
D) asnjëri
E) gjyshi
PS)C

Pyetja 1313 V)1

Koha e hemorragjisë është e zgjatur në rast:

A) trombocitopenie të rëndë
B) hemofilie
C) trombocitopenie modeste (trombocitet > 100.000)
D) deficiti të rëndë të protrombinës
E) difekti të faktorëve V dhe VIII
PS)A

Pyetja 1314 V)2

Cili prej këtyre faktorëve ka funksion inhibues për defekimin?

A) kontraksioni i muskujve abdominalë
B) kontraksioni i diafragmës
C) kontraksioni i muskulit elevator ani
D) lëshimi i pareteve të rektumit
E) të gjithë këta faktorë
PS)D

Pyetja 1315 V)1

Në dehidratimin hipertonik, përqendrimi i eritrociteve është:

A) normal
B) i rritur
C) i reduktuar
D) shumë i reduktuar

E) normal ose i reduktuar
PS)B

Pyetja 1316 V)3

Diateza hemorragjike nga alterimet vazale është:

A) purpura hiperglobulinemike
B) purpura Schonlein-Henoch
C) koagulimi intravaskular i diseminuar
D) morbus von Willebrand
E) trombopatia uremike
PS)B

Pyetja 1317 V)2

Në cor pulmonar akut vërehet zakonisht:

A) prevalencë ventrikulare e majtë
B) hematokrit i reduktuar
C) cianozë modeste
D) poliglobuli
E) fuqizim i tonit aortik II
PS)D

Pyetja 1318 V)1

Cili hormon nuk sekretohet nga korteksi surrenalien?

A) mineralkortikoidet
B) estrogjenet
C) androgjenet
D) progesteroni
E) katekolaminat
PS)E

Pyetja 1319 V)1

Në pankreatitin akut, simptoma më e shpeshtë është:

A) dhembja
B) diarrea
C) poliuria
D) tenezma rektale
E) konstipacioni
PS)A

Pyetja 1320 V)2

Në ciklin kardiak të EKG, periudha vulnerabël në të cilën mund të ndodhë një rrahje premature e atillë sa të shkaktojë takikardi apo fibrilacion ventrikular, është:

A) segmenti P-Q
B) vala Q
C) segmenti ascendent i valës R
D) segmenti ascendent pranë apeksit të valët T
E) segmenti T-P
PS)D

Pyetja 1321 V)3

Hiperfosfatemia, hiperkalcemia, hiperprotidemia dhe proteinuria shfaqen gjatë:

A) cirrozës hepatike
B) limfogranulomës Hodgkin
C) mielomës multiple
D) leucemisë mieloide kronike
E) leucemisë limfatike akute
PS)C

Pyetja 1322 V)3

Hipogonadizmi primar i fituar është:

A) sindroma Del Castillo
B) sindroma Steinert ose distrofia miotonike
C) sindroma Kleinefelter
D) sindroma Reifenstein
E) sindroma vanishing testes
PS)B

Pyetja 1323 V)3

Cila simptomë nuk vërehet në intoksikimin nga taliumi, qoftë medikamentoz apo helmim?

A) rënia e flokëve
B) kolikat abdominale
C) mialgjitë
D) artralgjitë, veçanërisht në gjymtyrët e poshtme
E) kufiri gingival ngjyrë gri
PS)E

Pyetja 1324 V)1

Cila konditë është e domosdoshme për të pasur një reaksion të tipit alergjik?

A) aktivizimi masiv i qelizave natural killer
B) aktivizimi masiv i limfociteve T citotoksike
C) aktivizimi masiv i trombociteve
D) degranulimi i neutrofileve dhe eozinofileve
E) prodhimi i IgE dhe degranulimi i bazofileve dhe mastociteve
PS)E

Pyetja 1325 V)2

Splenomegalia modeste vërehet në:

A) poliglobuli idiopatike ose morbus Vaquez
B) leucemi akute
C) leishmaniozë
D) morbus Gaucher
E) leucemi mieloide kronike
PS)B

Pyetja 1326 V)2

Në shumicën e rasteve, versamenti pleurik në insuficiencën kronike kongjestive paraqet një prej karakteristikave të mëposhtme:

A) lokalizohet në të djathtë
B) lokalizohet në të majtë
C) lokalizohet nga të dy anët
D) ka karakter eksudativ
E) fillon me dhembje torakale akute
PS)A

Pyetja 1327 V)1

Në hiperhidratimin izotonik, hematokriti është:

A) ndonjëherë i rritur, ndonjëherë i reduktuar
B) shumë i rritur
C) i rritur
D) normal
E) i reduktuar
PS)E

Pyetja 1328 V)3

Zmadhimi limfoglandular i lokalizuar (pra i kufizuar në një stacion të vetëm limfoglandular) vërehet në:

A) sarkoidozë
B) toksoplasmozë
C) brucelozë
D) tularemi
E) poliartrit kronik primar
PS)B

Pyetja 1329 V)1

Streptokokët:

A) janë gram negativë
B) nuk kanë cilie
C) janë sporigjenë
D) ushtrojnë aktivitet katalasik
E) nuk kanë asnjë prej këtyre karakteristikave
PS)B

Pyetja 1330 V)2

Stenoza e pilorit nga ulçera gastrike karakterizohet nga këto simptoma me përjashtim të:

A) dhembjes shumë intense në gjendje esëll
B) tensionit post-prandial
C) llokoçitjes gastrike
D) dehidratimit
E) mungesës së oreksit
PS)A

Pyetja 1331 V)3

Testi i nxitjes së histaminës kryhet në rast:

A) hipertiroidizmi
B) hipotiroidizmi
C) morbus Addison
D) hiperaldosteronizmi
E) feokromocitoma
PS)E

Pyetja 1332 V)3

Cili prej këtyre çiftesh substancash ka veprim bronkodilatator?

A) PGF2 dhe PGI2
B) PGE dhe PGI2

C) PGF2 dhe tromboksani A2
D) PGE dhe tromboksani A2
E) PGI2 dhe tromboksani A2
PS)B

Pyetja 1333 V)3

Sindroma e konsumit të tepërt të jamballës manifestohet me shenja:

A) pseudohipotiroidizmi
B) pseudohipertiroidizmi
C) pseudohiperaldosteronizmi
D) insuficience renale akute
E) edeme cerebrale
PS)C

Pyetja 1334 V)1

Një person i shëndetshëm në kondita normale eleminon në 24 orë nëpërmjet ekspirimit dhe perspiratio insensibilis një sasi uji mesatarisht:

A) 1000 - 2000 ml
B) 800 - 1000 ml
C) 400 - 800 ml
D) 200 - 400 ml
E) 100 - 200 ml
PS)B

Pyetja 1335 V)1

Medikamenti i përzgjedhur për terapinë e atakut akut të gutës është:

A) acidi izobutilfenilacetik
B) acidi acetilsalicilik
C) kolkicina
D) aminofenazoni
E) fenacetina
PS)C

Pyetja 1336 V)2

Natremia është e redukturar në:

A) sindromën Cushing
B) hiperaldosteronizëm
C) ulçerën duodenale
D) sindromën Schwartz-Bartter

E) glomerulonefritin akut difuz
PS)D

Pyetja 1337 V)3

Antigjenët sarkolemikë vërehen në 50% të rasteve me:

A) miasteni
B) artrit reumatoid
C) glomerulonefrit akut
D) sëmundjen Hashimoto
E) miksedemë
PS)A

Pyetja 1338 V)2

Në sindromën mediastinale anteriore nuk vërehet:

A) dhembja retrosternale
B) kompromet imi trakeal
C) kompromet imi i simpatikut
D) kompromet imi i trungut brakiocefalik
E) pleuriti
PS)C

Pyetja 1339 V)1

Abscesi është një:

A) grumbullim serumi
B) grumbullim pusi
C) grumbullim gjaku
D) granulomë inflamatore
E) tumor beninj
PS)B

Pyetja 1340 V)3

Në sindromën e ansës së verbër, steatorrea shkaktohet nga:

A) prodhimi insuficient i lëngut pankreatik
B) ekskretimi insuficient i lëngut pankreatik
C) dekonjunigimi bakterial i acideve biliare
D) obstruksioni i rrugëve biliare
E) inflamacioni i koledokut
PS)C

Pyetja 1341 V)2

Fjala e rrokëzuar dhe e ndërprerë është karakteristike për:

A) paralizën progresive
B) sëmundjen Parkinson
C) miksedemën
D) akromegalinë
E) sklerozën me pllaka
PS)E

Pyetja 1342 V)1

Në polenoza, reaksioni imunitar është i tipit:

A) I
B) II
C) III
D) IV
E) tjetër tip
PS)A

Pyetja 1343 V)1

Morbusi Werlhof është:

A) trombocitozë nga splenektomia
B) diatezë hemorragjike nga alterimet vazale
C) purpurë senile
D) purpurë nga mungesa e vitaminës C
E) purpurë idiopatike trombocitopenike
PS)E

Pyetja 1344 V)2

Cila prej këtyre sëmundjeve ka periudhë të shkurtër inkubimi, zakonisht 2-4 ditë:

A) bruceloza
B) parotiti epidemik
C) tifo abdominale
D) meningiti meningokoksik
E) pertusis
PS)D

Pyetja 1345 V)1

Cili prej këtyre baktereve është pak i ndjeshëm ndaj penicilinës?

A) streptokoku hemolitik
B) gonokoku
C) pneumokoku
D) meningokoku
E) pseudomonas aeruginosa
PS)E

Pyetja 1346 V)1

Cila është forma më e thjeshtë e jetës së organizuar?

A) bakteriofagu
B) bakteri
C) treponema
D) riketsia
E) protozoarët
PS)A

Pyetja 1347 V)2

Aritmia e varur nga modaliteti i formimit të impulsit kardiak në atrium vërehet në:

A) bllok sino-atrial progresiv me fenomen Wenckebach
B) bllok sino-atrial komun
C) bllok sino-atrial i plotë
D) aritmi sinusale
E) disociacion atrial
PS)D

Pyetja 1348 V)1

Dega cirkumflekse e merr origjinën nga:

A) arteria koronare e djathtë
B) arteria interventrikulare anteriore
C) arteria koronare e majtë
D) arteria interventrikulare posteriore
E) arteria marginale e majtë
PS)C

Pyetja 1349 V)1

Rozetat E (eritrocitet e dashit) janë një test për receptorët e:

A) limfocitet B
B) limfocitet T

C) makrofagët
D) të gjitha këto qeliza
E) asnjë nga këto qeliza
PS)B

Pyetja 1350 V)1

Në hiperhidratimin hipertonik, numri i eritrociteve për mm kub është:

A) gjithmonë i reduktuar
B) shpesh i reduktuar
C) normal
D) shpesh i rritur
E) gjithmonë i rritur
PS)A

Pyetja 1351 V)1

Nën ekzaminim mikroskopik të feçeve, acidet yndyrore paraqesin struktura të përbëra nga:

A) pikëza të rrumbullakëta me ngjyrë të kuqe të ndezur (me ngjyrim Sudan III)
B) kristale në formë agesh me ngjyrë në të verdhë (me ngjyrim Sudan)
C) cilindroide të verdha (me ngjyrim Lugol)
D) granula bojëqielli dhe/ose vjollcë (me ngjyrim Lugol)
E) kristale romboide Charcot-Leyden
PS)B

Pyetja 1352 V)1

Arteriti me qeliza gjigande prek në mënyrë veçanërisht të shpeshtë arterien:

A) suklavia
B) karotide
C) vertebrale
D) temporale
E) oftalmike
PS)D

Pyetja 1353 V)1
Cili prej këtyre qetësuesëve ushtron veprim antipsikotik?

A) klorpromazina
B) meprobramati
C) klordiazeposidi
D) mefenezina
E) të gjithë të mësipërmit
PS)A

Pyetja 1354 V)1

Zhurma sistolike e regurgitimit:

A) ka formë grafike si diamant
B) është e tipit crescendo-decrescendo
C) është mezosistolike
D) fillon pas tonit I
E) fillon me tonin I
PS)E

Pyetja 1355 V)1

Ekstrasistola atriale nuk paraqet:

A) pauzë ekstrasistolike
B) ritëm normal në krahasim me ritmin e rrahjeve të mëpasshme
C) ritëm të alteruar në krahasim me ritmin e rrahjeve të mëpasshme
D) morfologji të ndryshme të valës P
E) prani të kompleksit ventrikular
PS)B

Pyetja 1356 V)1

Në koagulopatinë nga konsumi si pasojë e aktivizimit prevalent të sistemit të koagulimit vërehet:

A) hiperfibrinogjemi
B) hipertrombocitemi
C) reduktim i kohës së protrombinës
D) prani e produkteve të degradimit të fibrinogjenit
E) aktivitet fibrinolitik i reduktuar
PS)D

Pyetja 1357 V)2

Rënie në peshë e pa-shkaktuar nga nenushqyerja vërehet në:

A) anoreksi nervore
B) anoreksi senile
C) sindromën Kwashiorkor
D) neoplazi gastrike me stenozë të pilorit
E) hipertiroidizëm
PS)E

Pyetja 1358 V)1

Qelizat e glias janë:

A) qeliza nervore
B) qeliza të epitelit tubular renal
C) qeliza jonervore
D) qeliza të palcës së kockave
E) qeliza splenike
PS)C

Pyetja 1359 V)2

Mastocitoza nuk karakterizohet nga:

A) ekzantema makulopapulare
B) temperatura
C) algjitë abdominale
D) të vjella, nauze, rënie në peshë
E) hipoheparinemia
PS)E

Pyetja 1360 V)1

Veprimi "helper" i limfociteve T ushtrohet mbi:

A) limfocitet B
B) qelizat epiteliale
C) qelizat endoteliale
D) eritrocitet
E) trombocitet
PS)A

Pyetja 1361 V)2

Defekt valvular kongjenital vërehet në:

A) sindromën Dressler
B) sindromën Ebstein
C) insuficiencën aortale aterosklerotike
D) steno-insuficiencën mitrale
E) sindromën Hamman-Rich
PS)B

Pyetja 1362 V)2

ARN-t (acidi ribonukleik transfer) përbëhet mesatarisht nga:

A) 10 - 20 nukleotide
B) 20 - 40 nukleotide
C) 70 - 80 nukleotide
D) 100 - 200 nukleotide
E) 400 - 500 nukleotide
PS)C

Pyetja 1363 V)1

A perceptohen infratingujt nga njeriu?

A) jo
B) vetëm nga femrat
C) po
D) deri në 12 Hertz
E) infratingujt nuk ekzistojnë
PS)A

Pyetja 1364 V)2

Gjatë morbusit Basedow, në aparatin kardiovaskular vërehet:

A) bradikardi
B) takikardi
C) versament perikardiak
D) zgjatje e sistolës mekanike
E) zgjatje e kohës së qarkullimit
PS)B

Pyetja 1365 V)1

Shkaku më i shpeshtë i epistaksisit te të rriturit është:

A) hipertensioni arterial
B) bronkopneuonia
C) otiti
D) stenoza mitrale
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)A

Pyetja 1366 V)2

Glicemia është shpesh e rritur në komën:

A) hepatike
B) hipoglicemike
C) apoplektike

D) uremike
E) nga intoksikimi ekzogjen
PS)A

Pyetja 1367 V)2

Blloku atrio-ventrikular i gradës II i tipit MOBITZ I karakterizohet nga:

A) PQ > 0,20 sekonda
B) zgjatje progresive e PR derisa një P nuk përçohet
C) ritëm idioventrikular
D) arrest sinusal
E) disociacion atrio-ventrikular
PS)B

Pyetja 1368 V)2

Selektiviteti i proteinurisë është mesatar në:

A) litiazë renale
B) prostatit akut
C) glomerulonefrozë me lezione minimale
D) sklerozë glomerulare fokale
E) glomerulonefrozë membranoze-proliferative
PS)D

Pyetja 1369 V)2

Morbus Cooley është një:

A) leucemi
B) anemi megaloblastike
C) beta talasemi homozigote
D) beta talasemi heterozigote
E) makroglobulinemi
PS)C

Pyetja 1370 V)1

Cili prej këtyre acideve yndyrore është i pasaturuar?

A) acidi palmitik
B) acidi oleik
C) acidi laurik
D) acidi miristik
E) acidi arakidik
PS)B

Pyetja 1371 V)2

Cila molekulë gjendet normalisht në plazmë në sasi 3-7 mg%?

A) alkooli metilik
B) azoti ureik
C) acidi urik
D) acidi askorbik
E) sulfonamidi
PS)C

Pyetja 1372 V)1

Vena hemiazigos inferior rrjedh në:

A) venën hemiazigos superior
B) venën azigos
C) venën kava superior
D) venën kava inferior
E) venën porta
PS)B

Pyetja 1373 V)2

Në cilën nga leukocitozat akute të mëposhtme shpretka ka gjithmonë vëllim të rritur?

A) leucemi limfatike
B) leucemi mieloide akute
C) leucemi paramieloblastike
D) leucemi me qeliza me qime
E) leucemi promielocitare
PS)D

Pyetja 1374 V)1

Hidrartria është:

A) grumbullimi i qelbit në artikulacion
B) grumbullimi i gjakut në artikulacion
C) grumbullimi i limfës në artikulacion
D) grumbullimi i transudatit në artikulacion
E) grumbullimi i ajrit në artikulacion
PS)D

Pyetja 1375 V)3

Glomerulonefriti akut hemorragjik ndodh shpesh në:

A) poliartritin reumatizmal
B) amiloidozë renale
C) trombozë të venave renale
D) nefropati diabetike
E) tumore renale
PS)A

Pyetja 1376 V)2

Cili pohim është i gabuar?

A) antigjenet e sistemit AB0 janë polisaharide
B) antitrupat anti-AB0 janë të pranishme edhe tek individët që nuk kanë marrë kurrë transfuzione
C) antitrupat anti-AB0 fiksojnë komplementin
D) antitrupat anti-AB0 shkaktojnë eritroblastozën fetale
E) antitrupat anti-AB0 janë përgjegjës për reaksionet transfuzionale
PS)D

Pyetja 1377 V)1

Flateri është aktivitet atrial ektopik krejtësisht i rregullt me frekuencë:

A) 75 rrahje/minutë
B) 100 rrahje/minutë
C) 125 rrahje/minutë
D) 150 rrahje/minutë
E) 300 rrahje/minutë
PS)E

Pyetja 1378 V)3

Niveli më i lartë i antitrupave antibërthamorë vërehet në:

A) hepatopati alkoolike
B) ikter medikamentoz
C) cirrozë biliare primare
D) hepatit kronik agresiv
E) ikter okluziv
PS)D

Pyetja 1379 V)2

Skotoma hemianopsike kontrolaterale homonime vërehet në:

A) lezionin kiazmatik
B) lezionin e një nervi optik
C) lezionin e fibrave mediale të projektimeve optike
D) lezionin selektiv të apeksit të lobit oksipital
E) lezionin e projektimeve optike të lobit parietal
PS)D

Pyetja 1380 V)2

Glomerulonefriti proliferativ endokapilar manifestohet klinikisht si:

A) glomerulonefrit akut difuz
B) sindromë nefrozike
C) glomerulonefrit kronik
D) glomerulonefrit subakut
E) glomerulonefrit me progresion të shpejtë
PS)A

Pyetja 1381 V)3

Fosfataza acide është e rritur në:

A) hiperparatiroidizëm
B) morbus Gaucher
C) kolestazë intrahepatike
D) kolestazë ekstrahepatike
E) rakitizëm
PS)B

Pyetja 1382 V)2

Standardi i artë për diagnostikimi e infeksionit kolerik kryhet duke kërkuar bakterin në:

A) koprokulturë
B) mielokulturë
C) hemokulturë
D) urinokulturë
E) të gjitha të mësipërmet
PS)A

Pyetja 1383 V)2

Poliuria mund të ndodh si rrjedhojë e:

A) djersitjes profuze
B) të vjellave
C) nefropatisë polikistike

D) diarresë persistente
E) transfuzionit të gjakut inkompatibël
PS)C

Pyetja 1384 V)1

Në pozicion shtrirë në kurriz, presioni arterial maksimal normal i arteries poplite është më i lartë se sa presioni arterial normal i arterier humerale. Sa është diferenca?

A) 5 - 10 mmHg
B) 10 - 15 mmHg
C) 15 - 20 mmHg
D) 20 - 40 mmHg
E) 40 - 80 mmHg
PS)D

Pyetja 1385 V)3

Alkaptonuria është anomali kongjenitale e karakterizuar nga:

A) blloku enzimatik i transformimit hepatik të fenilalaninës në tirozinë
B) mungesa e acid homogentizinik oksidazës
C) kapaciteti insuficient i melanociteve për të transformuar tirozinën në dopa
D) blloku i konvertimit të acidit parahidroksifenilpiruvik në acid homogentizinik
E) mungesa e histidazës
PS)B

Pyetja 1386 V)2

Në diabetin insipid, humbja e H2O është:

A) më e ulët në krahasim me humbjen e Na
B) e barabartë me humbjen e Na
C) më e lartë në krahasim me humbjen e Na
D) e barabartë me humbjen e glukozës
E) më e lartë në krahasim me humbjen e glukozës
PS)C

Pyetja 1387 V)3

Në fistulat biliare dhe pankreatike post-intervent me humbje të sasive të mëdha të likideve ndodh:

A) hiperbikarbonatemia
B) rritja e pCO2
C) reduktimi i hidrogjenioneve serike
D) hipokloremia

E) reduktimi i pH plazmatik
PS)E

Pyetja 1388 V)2

Viruset përbëhen nga:

A) tre aminoacide
B) pesë aminoacide
C) dhjetë aminoacide
D) vetëm ADN ose vetëm ARN
E) ADN dhe ARN
PS)D

Pyetja 1389 V)2

Shenja Murphy është e pranishme në:

A) kalkulozë të koledokut
B) kalkulozë ureteral
C) kolecistopati
D) hepatit akut
E) cirrozë hepatike
PS)C

Pyetja 1390 V)1

Antitrupat antibërthamorë (DNA) janë vënë re në:

A) lupus eritematoz sistemik
B) hepatit kronik aktiv
C) artrit reumatoid
D) glomerulonefrit membranoz-proliferativ
E) anemi hemolitike autoimune
PS)A

Pyetja 1391 V)2

Purpura Schonlein-Henoch është:

A) diatezë hemorragjike nga alterimi i hemokoagulimit
B) diatezë hemorragjike nga alterimet vazale
C) diatezë hemorragjikë nga alterimet trombocitare
D) trombopati nga makroglobulinat
E) teleangiektazi hereditare hemorragjike
PS)B

Pyetja 1392 V)2

Oliguria me urinë me densitet të lartë ndodh në:

A) tubulonefrozë kolemike
B) insuficiencë renale kronike
C) diabet insipid
D) pielonefrit kronik
E) insuficiencë kongjestive të qarkullimit
PS)E

Pyetja 1393 V)1

Tumoret malinje të ezofagut janë më shpesh:

A) adenokarcinoma
B) karcinoma me qeliza skuamoze
C) leiomiosarkoma
D) mezotelioma
E) fibrosarkoma
PS)B

Pyetja 1394 V)1

Kloruret në serum (Cl) normalisht janë të pranishme në nivel:

A) 80 - 85 m Eq/l
B) 98 - 106 m Eq/l
C) 120 - 150 m Eq/l
D) 170 - 200 m Eq/l
E) 210 - 250 m Eq/l
PS)B

Pyetja 1395 V)2

Hipertensioni arterial shfaq incidencë të lartë në:

A) nefritin intersticial akut
B) hidronefrozë
C) sindromën Bartter
D) sindromën Hamman-Rich
E) alterimet vaskulare renale primare monolaterale
PS)E

Pyetja 1396 V)3

Amilnitriti duhet të jepet me kujdes të veçantë te personat me:

A) hepatopati kronike
B) hipertension arterial
C) glaukomë
D) astmë bronkiale
E) hipertonus të rrugëve biliare
PS)C

Pyetja 1397 V)3

Sëmundja e zinxhirëve të rëndë, që karakterizohet nga proteinuria e mundshme e Bence-Jones, vërehet në:

A) morbus Franklin (zinxhiri i rëndë gama)
B) morbus Seligmann
C) morbus i zinxhirit të rëndë alfa
D) morbus i zinxhirit të rëndë mi
E) mielomë multiple
PS)D

Pyetja 1398 V)1

Cianoza është tregues i:

A) tensionit të ulët të oksigjenit në gjak
B) tensionit të ulët të CO2 në gjak
C) hiperkapnisë
D) acidozës respiratore
E) nivelit të lartë të hemoglobinës së reduktuar
PS)E

Pyetja 1399 V)2

Gumëzhima venoze cervikale karakterizohet nga:

A) pavazhdueshmëria e zhurmës
B) reduktohet gjatë inspirimit
C) theksohet pas manovrës Valsalva
D) zhduket pas komprimimit digital të venës jugulare interne
E) theksohet pas komprimimit të bulbeve okulare
PS)D

Pyetja 1400 V)1

Cili është virusi përgjegjës për rubeolën?

A) poxvirus

B) togavirus
C) koronavirus
D) pikornavirus
E) papovavirus
PS)B

Pyetja 1401 V)1

Stimulimi i vagusit nuk provokon:

A) bronkospazmë
B) bllok atrio-ventrikular
C) të vjella
D) diarre
E) takikardi
PS)E

Pyetja 1402 V)2

Cilët agjentë mund të stimulojnë një reaksion të tipit granulomatoz?

A) bakteret gram-pozitive
B) mikobakteret
B) vazopresina
C) ACTH
D) TSH
E) gonadotropina folikostimuluese
PS)B

Pyetja 169 V)1

Cila prej thënieve është përcaktimi korrekt i termit 'alel'?

A) Regjioni i ADN-së që sjell informacion për një ARN.
B) Forma alternative e një geni.
C) Tërësia e geneve të një qelize ose organizmi.
D) Gen me mutacion.
E) Pozicioni i një geni mbi kromozom.
PS)B

Pyetja 170 V)1

Çrregullimet e perceptimit

A) përfshijnë ndryshimet e intensitetit dhe të cilësisë së perceptimit.
B) i referohen vetëm perceptimeve false.
C) nuk përfshijnë haluçinacionet.
D) nuk përfshijnë iluzionet.
E) nuk përfshijnë pseudohaluçinacionet.
PS)A

Pyetja 171 V)1

'Shpërthimi' i folikulit të ovareve prej cilit hormon është i induktuar?

A) Prolaktina
B) FSH
C) GH
D) Estradiol
E) LH
PS)E

Pyetja 172 V)1

Cila prej këtyre gjendjeve nuk shoqërohet me formimin e granulomave?

A) lebra
B) pulmoniti atipik primar
C) sifiliz
D) sarkoidoza
E) berilioza
PS)B

Pyetja 173 V)1

Një ulçer është

A) një humbje e kufizuar e substancës, të një indi apo një organi, që përmban ind të vdekur dhe qeliza të inflamacionit.

B) një përzierje difuze e qelizave të vdekura të mukozës, baktereve dhe eksudatit inflamator mbi sipërfaqet mukoze.
C) një humbje e substancës në formë sferike, duke përmbajtur ind të vdekur dhe leukocite.
D) një humbje e substancës në një sipërfaqe epiteliale.
E) fryrje e paretit (ose mureve) të një vene.
PS)A

Pyetja 174 V)2

Fenomeni LE është

A) rëndim i lupusit pas ekspozimit në një rrezatim UV.
B) fagocitoza e bërthamave qelizore nga ana e neutrofileve polimorfonuklear.
C) gjetja e fals pozitivitetit për testin jo treponemik të sifilizit.
D) shfaqja e takikardisë dhe hipotensionit pas terapisë me penicilinë në pacientët me lupus.
E) një rash eritematoz në regjionin zigomatik.
PS)B

Pyetja 175 V)2

Diuretikët frenues të anidrazës karbonike

A) janë kryesisht të përdorur për të reduktuar presionin intraokular në glaukomë me kënd të gjerë.
B) shkaktojnë acidozë duke ulur eliminimin e bikarbonateve.
C) frenojnë anidrazën karbonike në tubujt veshkor por jo atë prezente në zona të tjera.
D) frenojnë anidrazën karbonike të stomakut dhe për këtë arsye kanë një efekt antisekretiv gastrik me interes .terapeutik.
E) manifestojnë efektin e tyre diuretik kur frenojnë 10-20% të anidrazës karbonike tubulare.
PS)A

Pyetja 176 V)1

Eliminimi mesatar i urinës në 24 orë kombinon normalisht me

A) 800 cc.
B) 1000 cc.
C) 1200 cc.
D) 1500 cc.
E) 1800 cc.
PS)C

Pyetja 177 V)3

Cilën nga patologjitë e mëposhtme mund të ketë një fëmijë 12 muajsh që paraqet temperaturë të lartë për tre ditë, që rrëzohet prej një krize në ditën e katërt me shfaqjen e një egzanteme makulo-papulare në shpinë?

A) fruthin
B) reaksion alergjik ndaj paracetamolit
C) egzantemën kritike
D) sëmundjen e pestë
E) sëmundjen e Dukes Filatow
PS)C

Pyetja 178 V)3

Cili tip i antikorpeve prodhohen në përgjigjen primare kundrejt një agjenti infektiv?

A) IgG
B) IgA
C) IgM
D) IgE
E) IgG + IgE
PS)C

Pyetja 179 V)1

Mediatori kimik i pllakës neuromuskulare është

A) adrenalina.
B) noradrenalina.
C) dopamina.
D) serotonina.
E) acetilkolina.
PS)E

Pyetja 180 V)1

Hemoftizia mund të vijë prej

A) ulçerës peptike.
B) variçeve ezofageale.
C) bronkiektazisë.
D) variçet e bazës së gjuhës.
E) fibroangioma e rinofaringut.
PS)C

Pyetja 181 V)1

Tek një grua shtatzënë, diagnoza e hepatitit mund të konfirmohet nga prania e një rritje të:

A) sedimentit.
B) fosfatazës alkaline.
C) numrit të leukociteve.
D) SGOT.
E) uremisë.
PS)D

Pyetja 182 V)1

Çfarë është anizokoria?

A) Ndryshimi i anëve (ose periferisë) së pupilës jo perfekt në formë rrethore.
B) Diferenca midis diametrave të të dy pupilave.
C) Ndryshimet e reaktivitetit pupilar ndaj dritës.
D) Ndryshimet e reaktivitetit pupilar ndaj përshtatjes(ose akomodimit).
E) Mungesa e reaktivitetit pupilar.
PS)B

Pyetja 183 V)2

Një mashkull 32 vjeç paraqet kollë të thatë, temperaturë, asteni dhe humbje progresive të peshës. Qelizat T CD4 + rezultuan të jenë 150/mm3. Simptomat dhe të dhënat janë të përputhshme me një diagnozë paraprake të

A) gripit.
B) pneumocistozës tek subjektet HIV pozitiv.
C) pulmonit nga Mikoplazma pneumonia.
D) bronkopneumonia nga streptokoku pneumonia.
E) infeksionit nga virusi respirator sincicial.
PS)B

Pyetja 184 V)1

Pesha mesatare e një të porsalinduri në fund të shtatzënisë është

A) 2000 gr.
B) 3300 gr.
C) 2500 gr.
D) 4000 gr.
E) 2800 gr.
PS)B

Pyetja 185 V)2

Presioni pleural normal është rreth

A) -10 cm H2O.
B) midis -2 dhe -5 cm H2O.
C) i barabartë me atë atmosferik.
D) midis +2 dhe +5 cm H2O.
E) + 10 cm H2O.
PS)B

Pyetja 186 V)3

Cila nga aktivitetet e mëposhtme NUK kryhet nga qelizat e Sertolit?

A) sinteza e inibinës
B) sinteza e proteinave të lidhura me androgenët
C) fagocitoza e qelizave germinale të dëmtuara
D) aromatizimi i testosteronit në estradiol
E) sinteza e testosteronit
PS)E

Pyetja 187 V)2

Cili nga shkaqet e mëposhtëm NUK është shkak i mundshëm i hemoftizisë ?

A) murtaja
B) abcesi pulmonar
C) tuberkulozi miliar
D) bronkoektazia
E) pulmonit stafilokoksik
PS)C

Pyetja 188 V)1

Cili nga citimet e mëposhtëm në lidhje me emfizemën pulmonare panacinare NUK është i vërtetë?

A) Simptomat kryesore mund të mos jenë ato bronkitike.
B) Nuk kemi cianozë.
C) Në fazat fillestare është karakteristik dekompensimi kardiak.
D) Shpesh pacientët që vuajnë nga emfizema të tilla janë të dobët.
E) Shpesh shoqërohet me emfizemën centrolobulare.
PS)C

Pyetja 189 V)1

Fossa cranica media përmban

A) foro oksipitale.
B) fontanelën bregmatike.

C) foro spinoz, foro lacero, foramen rotond, foro oval dhe fisura orbitale superiore.
D) foramen cieko dhe foro optik.
E) foramen magnum dhe crista galli.
PS)C

Pyetja 190 V)2

Cilat nga neoplazitë e mëposhtme i jep origjinë më shpesh metastazave osteoblastike?

A) karcinoma e veshkës
B) karcinoma e prostatës
C) karcinoma e tiroides
D) karcinoma e stomakut
E) neuroblastoma
PS)B

Pyetja 191 V)2

Termi semundja e Hodgkin përfshin

A) formën klasike të pasur në limfocite dhe sklerozën nodulare.
B) vetëm sklerozën nodulare.
C) sklerozën nodulare, qeliza të përziera dhe rënie e theksuar e limfociteve.
D) forma klasike me prevalencë limfocitare, skleroza nodulare, qeliza të përziera dhe rënie e theksuar e limfociteve.
E) qeliza të përziera dhe rënia e theksuar e limfociteve.
PS)D

Pyetja 192 V)2

Cilat janë enzimat e përdorura në diagnostikën klinike?

A) transaminazat GOT dhe GPT; izoenzimat e LDH; izoenzimat e CPK; OCT; GGT; fosfatazës acide dhe alkaline
B) citokromozidazë, suksinatdehidrogjenazë; CPH; enolazë dhe fosfatazë
C) fosfatazë; enzimat e ciklit te Krebsit; fosforilazë
D) izocitrat dehidrogjenazë; glikogjensintetazë; aminoacid dekarboksilazë
E) acid yndyror sintetazë; glutaminsintetazë; piruvatkarboksilazë; glicerolfosfatdehidrogjenaza
PS)A

Pyetja 193 V)2

Në paranojë hasim

A) delirium të kthjellët.
B) asnjë delirium.
C) një përzierje midis deliriumit të kthjellët dhe konfuz.

D) delirium i mërzisë.
E) delirium nga varfëria.
PS)A

Pyetja 194 V)2

Empiema pleurale është më e shpeshtë prej

A) traumës së toraksit.
B) infeksioneve bronkopulmonare.
C) komplikacioneve kirurgjikale.
D) fistulës bronko-pleurike.
E) përhapjes së infeksioneve abdominale.
PS)B

Pyetja 195 V)1

Cili nga organet e mëposhtëm është i vendosur në mediastinin posterior?

A) timusi
B) nervi frenik
C) ezofagu
D) zemra
E) arteria pulmonare
PS)C

Pyetja 196 V)2

Kilomikronet

A) janë hormone të sekretuara nga mukoza duodenale.
B) janë një klasë lipoproteinash me sintezë hepatike.
C) janë një klasë lipoproteinash me sintezë në zorrë.
D) janë një klasë proteinash të vargut respirator mitokondriale.
E) janë një klasë proteinash e sintetizuar nga qelizat plazmatike.
PS)C

Pyetja 197 V)2

Në cilin limfonod metastazon kryesisht karcinoma e junksionit rekto-sigmoidal?

A) hipogastrik
B) mezenterial inferior
C) inguinal
D) mezenterial superior
E) celiak
PS)B

Pyetja 198 V)2

Sekrecioni i shtuar gastrik dhe ulçerat peptidike periodike vihen re në

A) hipoparatiroidizëm.
B) sindromën Zollinger-Ellison.
C) sindromën e Mallory-Weiss.
D) dumping sindrom.
E) sindroma Verner Morrison.
PS)B

Pyetja 199 V)1

Në qarkullimin fetal gjaku i oksigjenuar arrin në fetus nëpërmjet

A) arteries umbilikale.
B) venës umbilikale.
C) arterieve umbilikale.
D) arterieve viteline.
E) enët alantoide.
PS)B

Pyetja 200 V)1

Specificiteti i një testi diagnostik është aftësia qe të

A) mos të japi fals pozitiv.
B) mos të japi fals negativ.
C) mos të japi fals negativ dhe fals pozitiv
D) japë të njëjtin rezultat në kampione të ndryshëm.
E) jetë specifik për këtë tip ekzaminimi (ose studimi).
PS)A

Pyetja 201 V)3

Cila nga gjendjet e mëposhtme mund të ndërhyjë duke maskuar rritjen e amilazës në pankreatitin akut?

A) hipertrigliceridemia
B) hiperglicemia
C) hipokalçemia
D) hiperamonemia
E) hiperkolesterolemia
PS)A

Pyetja 202 V)3

Sëmundja e Creutzfeldt-Jakob

A) është një encefalopati që vjen nga avitaminoza B1.
B) është një encefalit viral paraneoplastik.
C) është një encefalopati dismetabolike në kuadër të diabetit.
D) është një encefalopati nga mielinoza pontina (e urës), ne kuadër te alkoolizmit.
E) është një encefalit infektiv nga prionet.
PS)E

Pyetja 203 V)1

Tek një pacient në koma, të cilit nuk mund t'i kryesh anamnezën, përcaktimi i parë që duhet bëre është

A) përcaktimi i glicemisë.
B) kryerja e një punksioni lumbar.
C) bërja e një EEG.
D) marrja e naloxone.
E) bërja e ECG.
PS)A

Pyetja 204 V)1

Cila nga thëniet e mëposhtme është e saktë?

A) Qelizat metastatike janë gjithmonë identike me ato të tumorit parësor.
B) Tumori metastatik është në përgjithësi i karakterizuar nga malinjitet më i vogël krahasuar me tumorin e origjinës.
C) Edhe tumoret me dimensione të vogla mund të japin metastaza.
D) Shtimi i qelizave metastatike varet nga sinjalet kimike që prodhohen nga tumori parësor.
E) Tumori metastatik nuk mund të gjenerojë nga ana e tij të tjera metastaza.
PS)C

Pyetja 205 V)2

Neuronet e ganglioneve spinal janë

A) multipolar.
B) të rrethuar nga astrocitet.
C) motor.
D) pseudounipolar.
E) apolar.
PS)D

Pyetja 206 V)2

Shoku anafilaktik është i karakterizuar nga

A) hipotension, bradikardi, PVC i ulur.
B) hipotension, bradikardi, PVC(presioni venoz qendror) i rritur.
C) hipotension, takikardi, PVC e ulur.
D) hipotension, bradikardi, PVC e rritur.
E) hipotension, bradikardi, oligoanuri.
PS)C

Pyetja 207 V)2

Cila nga gjendjet e mëposhtme është më pak e mundshme të shoqërohet me një hipereozinofili?

A) sindroma hipereozinofilike
B) leukoza mieloide kronike
C) infeksionet parazitare
D) infeksionet nga stafilokoku aureus
E) astma
PS)D

Pyetja 208 V)1

Cilat struktura janë të dukshme në radiografinë e toraksit në subjektet e shëndoshë?

A) intersticium
B) rrethi bronkial
C) rrethi limfatik
D) rrugët termianle të ajrit (ose alveolat)
E) rrethi pulmonar
PS)E

Pyetja 209 V)1

Cila nga këto simptoma nuk është karakteristik i torsionit të funikulit spermatik?

A) mbajtja e urinës
B) ngritja e testikujve
C) nauzea(të përziera)
D) zmadhimi i testikujve
E) dhimbja
PS)A

Pyetja 210 V)1

Tek një pacient obez të prekur nga diabeti mielit cili është medikamenti i zgjedhur?

A) insulina
B) biguanidi
C) sulfanilure
D) insulina + biguanidi
E) insulina + sulfanilure
PS)B

Pyetja 211 V)1

Një dëmtim i lëkurës i zbuluar, me përmbajtje likidi transparente, me aspekt tejdukshëm dhe diametër më të vogël se 1 cm, është përcaktuar si

A) makul.
B) papul.
C) pemfigo.
D) vezikul.
E) flluskë.
PS)D

Pyetja 212 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me insufiçiencën respiratore është e gabuar?

A) Raporti ventilim-perfuzion është i dëmtuar në bronkopneumoni dhe në emfizemë.
B) Hipoksia është gjithmonë prezente.
C) Kapaciteti jetësor është i pakësuar në insufiçiencën e tipit restriktiv.
D) Hiperkapnia nuk është gjithmonë e pranishme.
E) Difuzioni alveolar i oksigjenit është më i madh se ai i CO2.
PS)E

Pyetja 213 V)2

Prania e krioglobulinave është e shpeshtë në

A) pulmonitin nga mikoplazma.
B) lokalizimin pulmonar të mielomës multiple.
C) tuberkulozin.
D) fibrozën cistike.
E) sëmundjen nga ftohja.
PS)A

Pyetja 214 V)1

Një nga kërkimet më të rëndësishme në diagnozën e cirrozës biliare parësore është

A) CEA.
B) alfafetoproteina.

C) antikorpet antimitokondrial.
D) fosfataza alkaline.
E) CPC
PS)C

Pyetja 215 V)1

Cilin nga drithrat e mëposhtëm mund të marrë një fëmijë me sëmundje celiake?

A) elbi
B) tërshërë
C) orizi
D) thekra
E) grurë
PS)C

Pyetja 216 V)2

Çfarë duhet të bëjmë në prani të mikrohematurisë të izoluar të tipit glomerular?

A) të kryesh një biopsi të veshkës
B) të mos kryesh një biopsi të veshkës
C) të kryesh klirensin e kreatininës
D) të matësh presionin arterial
E) të kontrollosh pacientin në kohë
PS)E

Pyetja 217 V)3

Në cilën nga këto kardiopati në auskultacion vlerësohet një "klik" mezo-telesistolik?

A) insufiçienca mitrale
B) prolapsi i valvolës mitrale
C) kardiopatia infarktuale
D) aneurizmi j aortës
E) difekti interventrikular
PS)B

Pyetja 218 V)2

Tifo ekzantematike ose dermotifo shkaktohet nga

A) salmonela typho.
B) rikecia provazeki.
C) salmonela tifo murium.
D) klostridium perfrigens.
E) shigela flexneri.

PS)B

Pyetja 219 V)3

Arteriet e zgjedhura më të interesuara në sëmundjen Horton janë

A) arteriet renale.
B) arteriet popliteale.
C) arteriet kraniale.
D) arteriet mezenterike.
E) arteriet iliake.
PS)C

Pyetja 220 V)3

Terapia e pulmonitit të fituar në komunitet

A) është pothuajse gjithmonë empirike.
B) nuk drejtohet nga një diagnozë etiologjike.
C) është gjithmonë e drejtuar nga një diagnozë etiologjike.
D) është gjithmonë e drejtuar nga një diagnozë radiologjike.
E) është gjithmonë e drejtuar nga një diagnozë anatomo-patologjike.
PS)A

Pyetja 221 V)1

Ku janë sjellë deri në maturim pararendësit e limfociteve B?

A) në qarkullim
B) në palcën e kockave
C) në limfonoduj
D) në shpretkë
E) në timus
PS)B

Pyetja 222 V)2

Simptoma fillestare e sindromës nefrozike është normalisht

A) edema.
B) hipertensioni.
C) hematuria.
D) stranguria.
E) oliguria.
PS)A

Pyetja 223 V)2

Klirensi i inulinës mat

A) filtrimin glomerular.
B) fluksin hematik veshkor.
C) vëllimin.
D) debitin kardiak .
E) prurja e rrithithjes tubulare të natriumit.
PS)A

Pyetja 224 V)2

Një prej preparateve të kimioterapisë është aktiv në infeksionet e mikobakterium të tuberkulozit por mund të japë dhe një frekuencë të lartë ototoksiciteti. Cila është ky preparat?

A) vankomicina
B) viomicina
C) etambutol
D) etionamid
E) pirazinamid
PS)B

Pyetja 225 V)1

Hormoni që ul nivelin serik të kalçiumit është

A) Kalcitonina.
B) Parathormon.
C) Kortizon
D) TSH.
E) MSH.
PS)A

Pyetja 226 V)3

Oksitocina është një medikament i përdorur shpesh në obsterikë. Të gjitha gjendjet e mëposhtme mund të jenë efekte kolaterale, përveç

A) reaksioneve anafilaktike.
B) tetania uterine.
C) intoksikimit i ujit.
D) placenta previa.
E) vuajtjes së fetusit(ose asfiksi fetale)
PS)D

Pyetja 227 V)2

Sindroma Claude Bernard-Horner karakterizohet nga

A) enoftalmi, miozë, ptozë palpebrale dhe anidrozë homolaterale.
B) dhembje në shpatull dhe në krahë përgjatë zonës së inervimit të nervit ulnar.
C) strie në nivelin abdominal, "gunga e buallit" dhe facies lunar.
D) edema mantelinë dhe fryrja e jugulareve.
E) egzolftalmi, miozë, ptozë palpebrale dhe anidrozë kontrolaterale.
PS)A

Pyetja 228 V)3

Në hiperplazinë e lindur të mbiveshkores dy prej formave që shoqërohen me hypertension janë:

A) defiçit i 20-22 desmolazave dhe 3 holo dehidrogjenazës.
B) defiçiti i 3 holo dehidrogjenazës dhe 21 dehidrogjenazës.
C) defiçit i 21 dehidrogjenazës dhe 11-oksidazës.
D) defiçiti i 11- hidroksilazës dhe 17 hidroksilazës.
E) defiçiti i 15-hidroksilazës.
PS)D

Pyetja 229 V)3

Tek një i rritur 60 kg, të shëndetshëm dhe në qetësi, debiti kardiak (ne L/min) është përafërsisht

A) 1.2
B) 2.9
C) 5
D) 8
E) 12
PS)C

Pyetja 230 V)3

Disekacioni i aortës ndodh kryesisht në personat me

A) sindromin Down.
B) sindromin Leriche.
C) sindromin Marfan.
D) sindromin Turner.
E) sindromin post-flebitik.
PS)C

Pyetja 231 V)1

Komplikacioni më i zakonshëm gjatë terapisë me heparinë është

A) tromboza.
B) embolia.
C) okluzioni intestinal.
D) hemorragjia.
E) variçet.
PS)D

Pyetja 232 V)1

Meningitet janë proçese inflamatore

A) që interesojnë parenkimën cerebrale.
B) interesojnë dura mater.
C) interesojnë leptomeninget.
D) interesojnë vetëm bazën e kraniumit.
E) interesojnë vetëm pjesën e përparme të kraniumit.
PS)C

Pyetja 233 V)2

Cila nga neoplazitë e mëposhtme i jep origjinë më shpesh një metastaze kockore

A) karcinoma e veshkës
B) karcinoma e prostatës
C) karcinoma e tiroides
D) karcinoma e stomakut
E) neuroblastoma
PS)B

Pyetja 234 V)3

Manifestimi më i zakonshëm i neuropatisë sensitive kronike është shpërndarja

A) proksimale asimetrike.
B) proksimale simetrike.
C) lokalizimi në abdomen.
D) lokalizimi në artikulacionet e vogla.
E) distalisht në mënyrë simetrike si "çorape" ose "dorashkat".
PS)E

Pyetja 235 V)3

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me AMP-ciklike(AMPc), është e saktë?

A) Transformohet në AMP nga veprimi i një fosfodiesteraze.

B) Është aktivues i proteinfosfatazës.
C) Në nivel muskular formohet nga veprimi i një miocinaze.
D) Lidhet me kalmodulinën duke e aktivizuar e me këte mekanizëm, aktivizon glikogjenolizën muskulare.
E) Është frenues allosterik i protein kinazës.
PS)A

Pyetja 236 V)1

Cili nga ekzaminimet vlerëson më herët praninë e metastazave kockore?

A) radiografia tradicionale e segmenteve skeletike
B) ekografia
C) termografia
D) mieloshintigrafia
E) shintigrafia e kockore
PS)E

Pyetja 237 V)2

Embolia pulmonare është e shoqëruar më shpesh me

A) trombet ventrikulare post-infarktit.
B) shokun septik.
C) trombozën venoze të anësive të poshtme.
D) kalimin në qarkullim të likidit amniotik.
E) endokardit bakterial.
PS)C

Pyetja 238 V)1

Diabeti insipid është karakterizuar nga

A) mungesa e insulinës.
B) mungesa e hormonit antidiuretik.
C) mungesa e sekrecioneve prostatike.
D) mungesa e hormonit të rritjes.
E) mungesa e faktorit aktivizues të trombociteve.
PS)B

Pyetja 239 V)2

Cili është shkaku më i mundshëm i vdekjes së papritur në një subjekt të seksit mashkull në moshë rreth 40 vjeç?

A) kardiopatia ishemike, infarkti i miokardit
B) kardiomiopatia aritmogene e ventrikulit të djathtë

C) çarja e zemrës post infarktuale
D) disekacioni i aortës
E) hemorragjia cerebrale
PS)A

Pyetja 240 V)2

Cila nga karakteristikat e mëposhtme është më pak e shpeshtë në anoreksinë nervore?

A) abuzimi me laksativë
B) aktiviteti fizik i pakët
C) shtrembërimi i imazhit të trupit
D) rënia e dëshirës seksuale
E) episode të bulimisë të ndjekura nga të vjellat
PS)B

Pyetja 241 V)2

Cilat janë shkaqet më të shpeshta të perikarditit?

A) virale e idiopatike
B) mikozat
C) neoplazitë
D) medikamentet
E) tuberkulozi
PS)A

Pyetja 242 V)3

Cili nga genet e mëposhtëm është i nxitur nga hipoksia?

A) kalretikulina
B) vimentina
C) endonukleaza
D) eritropoetina
E) transferrina
PS)D

Pyetja 243 V)1

Pulsi arterial që preferohet të palpohet në proçedurën e dhënies së ndihmës së shpejtë është

A) radial.
B) popliteal.
C) brakial.
D) temporal.
E) karotid.

PS)E

Pyetja 244 V)1

Cila nga teknikat e mëposhtme është më e zgjedhura në studimin e tubave uterin?

A) ekzaminimi radiografik direkt
B) ekografia
C) TC
D) histerosalpingografia
E) RM
PS)D

Pyetja 245 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me Mikobakterium tuberkulozis është e saktë?

A) Transmetohet nëpërmjet rrugës oro-fekale.
B) Infekton vetëm personat me imunitet të ulur.
C) Përcakton infeksion primar që zakonisht nuk zhvillohet në sëmundje.
D) Është gjithmonë i ndjeshëm ndaj antibiotikëve të zakonshëm.
E) Diagnostikohet ekskluzivisht me kërkimin e antikorpeve specifik.
PS)C

Pyetja 246 V)3

Korrigjimi pa ndërhyrje kirurgjikale i një skolioze pas përfundimit të rritjes kockore

A) është i mundur gjithmonë.
B) në disa raste të zgjedhura.
C) nuk është kurrë i mundur.
D) është e mundur deri 30 vjeç.
E) është e mundur por pjesërisht.
PS)C

Pyetja 247 V)2

Në tumorin e gjirit

A) mamografia është egzaminim me rëndësi të shkallës së dytë.
B) mamografia ndjek mamoshintigrafinë dhe ekografinë në proçesin diagnostik.
C) mamografia dhe mamoshintigrafia janë egzaminime rutinë.
D) mamoshintigrafia është egzaminim i shkallës së dytë pas mamografisë dhe eventualisht edhe pas ekografisë mamare.
E) kërkimi i limfonodujve të afërt(psh, aksilar) është egzaminimi i rutinës në stadifikimin e tumorit mamar.
PS)D

Pyetja 248 V)2

Është agjent i zakonshëm shkaktar i endokarditit

A) meningokoku.
B) gonokoku.
C) streptokoku viridans.
D) mikobakteri tuberkular.
E) viruset ECHO.
PS)C

Pyetja 249 V)3

Ka një bllok atrio-ventrikular të shkallës së pare kur në ECG, segmenti P-Q është

A) > 0,20 sek
B) > 0,15 sek .
C) > 0,25 sek.
D) > 0,10 sek.
E) > 0,30 sek.
PS)A

Pyetja 250 V)1

Me sa shtypje/min kryhet masazhi kardiak i jashtëm në një të rritur?

A) 110-120 shtypje/min.
B) 140 shtypje/min.
C) 60-100 shtypje/min,
D) 120 shtypje/min.
E) me frekuencën më të madhe të mundshme.
PS)C

Pyetja 251 V)3

Një grua 52 vjeç paraqet një psoriazë të gjeneralizuar. Me këtë mund të shoqërohen të gjitha patologjitë e mëposhtme, përveç

A) uveitit anterior.
B) artritit.
C) pleuritit.
D) hiperuricemisë.
E) thonjtë me rrudhosje vertikale.
PS)C

Pyetja 252 V)2

Cili nga faktorët e mëposhtëm është thelbësor për të ndërmarrë një fushatë skriningu?

A) ndjeshmëria e rritur e testit
B) specificiteti i rritur i testit
C) mundësia e ndërhyrjes efikase mbi sëmundjen në fazën e hershme
D) vlera prediktive e rritur e testit
E) shpenzimet e ulta për test
PS)C

Pyetja 253 V)3

Cila nga konsideratat e mëposhtme në lidhje me galaktozeminë është e saktë?

A) I dedikohet mungesës së enzimës që katalizon formimin e UDP-galaktozës duke u nisur nga UDP-glukoza dhe galaktozë-1-fosfati
B) Provokohet nga një konsum i rritur i galaktozës
C) Është për shkak të një shndërrimi të rritur të glukozës në galaktozë.
D) Është për shkak të mungesës së enzimës laktazë.
E) Përfshin pamundësinë për të marrë galaktozën për gjithë jetën.
PS)A

Pyetja 254 V)2

Anemia progresive e shoqëruar me gjak okult ne feçe është zakonisht e para shenjë e një karcinome të

A) kolonit transvers.
B) sigmës.
C) cekum-kolon ashendent.
D) kolon i majtë(nga kolon transvers distal deri në sigma).
E) rektum.
PS)C

Pyetja 255 V)3

Gjuri i varur është përcaktuar si një deviacion i aksit të gjymtyrëve të poshtme të tillë që midis femurit dhe tibias formohet

A) një kënd i hapur lateralisht.
B) një kënd i hapur medialisht.
C) një kënd i hapur anteriorisht.
D) asnjë nga këto gjendje
E) një kënd i hapur posteriorisht.
PS)B

Pyetja 256 V)1

Cili nga hormonet e mëposhtëm merr pjesë në rregullimin e metabolizmit kalçik

A) acetilkolina
B) parathormon
C) prolaktina
D) insulina
E) testosteron
PS)B

Pyetja 257 V)3

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me sindromin Turner është e gabuar?

A) Në lindje është prezente edema e kurrizit të dorës dhe këmbës.
B) Kariotipi më i zakonshëm është 47, XXY.
C) Shoqërohet me staturë të ulët.
D) Shoqërohet me amenorre primare.
E) Mund të jetë i pranishëm koartacioni i aortës.
PS)B

Pyetja 258 V)3

HCO3- plazmatik rezultojn i ulur në

A) acidozën respiratore të kompensuar.
B) alkalozën metabolike të dekompensuar.
C) alkalozën metabolike të kompensuar.
D) acidozën metabolike të dekompensuar.
E) alkalozën e përzier të dekompensuar.
PS)D

Pyetja 259 V)3

Nje ulje e natremisë

A) në fazën fillestare mund të provokoj një rritje të eksitabilitetit nervor.
B) shoqërohet me edema.
C) mund të nxitet nga insufiçienca kortikale e mbiveshkores.
D) mund të kompensohet duke marrë hormonin antidiuretik.
E) karakterizohet nga shfaqja e tetanisë.
PS)C

Pyetja 260 V)3

Eksperimentimi klinik është

A) një aktivitet i nevojshëm për të studiuar efektet e shkaktuara nga medikamentet e marra me qëllim terapeutik ose diagnostik.
B) një aktivitet i nevojshëm për të studiuar metabolizmin e substancave të prodhuara nga organizmi.
C) një aktivitet i nevojshëm për të studiuar efektet e shkaktuara nga drogat.
D) një degë e mjekësisë interne.
E) një disipline që studion marredhëniet shkakësore të ngjarjeve natyrale.
PS)A

Pyetja 261 V)2

Në lidhje me urtikarien, cila nga thëniet e mëposhtme është e saktë?

A) Ka gjithmonë ecuri akute.
B) Mund të shoqërohet me angiodemë.
C) Ka gjithmonë një patogenezë alergjike.
D) Mekanizmi imunologjik është i tipit qelizor-ndërmjetës.
E) Parazitoza e zorrës nuk shkakton asnjëherë urtikarie.
PS)B

Pyetja 262 V)1

Në cilën familje të laksativëve hyn sulfati i magneziumit?

A) laksativët stimolant ose të kontaktit
B) laksativët osmotik
C) laksativ lubrifikant
D) mucilagenët
E) laksativët detergent
PS)B

Pyetja 263 V)3

Cila nga proçedurat e mëposhtme është e nevojshme për fillimin e një eksperimentimi të fazës III?

A) aprovimi i komitetit etik lokal
B) autorizimi i Ministrisë së Shëndetësisë
C) transmetimi në Ministrinë e Shëndetësisë për aprovimin e protokollit eksperimental
D) rinjohje e përshtatshmërisë nga ana e shërbimit parësor
PS)A

Pyetja 264 V)2

Debiti sistolik rritet nga këto faktorë përveç

A) stimulimit simpatik.

B) zgjatjen e fijeve muskulare kardiake.
C) pakësimit të presionit sistemik të gjakut.
D) pakësimit e kthimit venoz.
E) pakësimit e aktivitetit vagal.
PS)D

Pyetja 265 V)1

Kush duhet ta bëjë një raport?

A) çdo mjek
B) mjeku kurues
C) mjeku i spitalit
D) çdo ushtrues i profesionit sanitar
E) oficerët e policisë gjyqësore
PS)D

Pyetja 266 V)1

Në spitalet psikiatrike të mjekësisë ligjore shtrohen

A) të sëmurët mendorë për të cilët është gjetur një gjendje rrezikshmërie shoqërore.
B) të gjithë të sëmurët mendorë agresiv.
C) të gjithë të sëmurët mendorë.
D) të gjithë të sëmurët mendor ëtë nënshtruar një trajtimi sanitar të detyrueshëm.
E) të gjithë skizofrenët.
PS)A

Pyetja 267 V)2

Cili tip i aktivitetit fizik është më i indikuar në parandalimin, kurimin dhe reabilitimin e sëmundjeve kardiovaskulare?

A) anaerobik
B) aerobik
C) izokinetik
D) ushtrime fizike të forcës
E) ushtrime të fuqisë fizike
PS)B

Pyetja 268 V)3

Pompa e natriumit (Na/K ATPasi) vendoset

A) në retikulin sarkoplazmatik.
B) në membranën plazmatike.
C) në membranën mitokondriale të brendshme.

D) në membranën mitokondriale të jashtme.
E) në membranën lizozomale.
PS)B

Pyetja 269 V)3

Në dietën e një diabetiku përqindja e karbohidrateve, proteinave dhe yndyrnave duhet të jetë

A) 33% - 33% - 33%.
B) 40% - 40% - 20%.
C) 50% - 20% - 30%.
D) 25% - 35% - 40%.
E) nuk është i rëndësishëm.
PS)C

Pyetja 270 V)2

Pseudopolipoza shoqërurohet më shpesh me

A) crohn.
B) kolitin amebik.
C) kolitin ishemik.
D) kolitin ulçeroz.
E) apendisitin kronik.
PS)D

Pyetja 271 V)2

Cilin nga aktivitetet biologjik të mëposhtëm frenon somatostatina?

A) sekretimin e insulinës
B) sekretimin e insulinës dhe glukagonit
C) sekretimin e pështymës
D) sekretimin e CNRH
E) prodhimin e limosinës
PS)B

Pyetja 272 V)1

Kemi shfaqje më të shpeshtë të mezoteliomës së pleurës në

A) tuberkuloz.
B) sarkoidozë.
C) azbestozë.
D) karcinoma bronkiale.
E) silikozë.
PS)C

Pyetja 273 V)1

Në nivelin veshkor, aldosteroni

A) vepron mbi të gjitha në tubujt proksimal.
B) stimulon prodhimin e reninës.
C) rrit rithithjen e natriumit dhe sekretimin e kaliumit.
D) ndikon në rithithjen e kalçiumit dhe ekskretimin e fosfateve.
E) rrit rrithithjen e kaliumit.
PS)C

Pyetja 274 V)3

Midis substancave që kontribojnë për të përcaktuar osmolaritetin e plazmës bëjnë pjesë të gjitha të mëposhtmet, përveç

A) globulinave.
B) natriumit.
C) hemoglobinës.
D) klorit.
E) albuminës.
PS)C

Pyetja 275 V)1

Një refleks prej stimulimit vagal manifestohet me

A) bradikardinë dhe hipertensionin arterial.
B) takikardinë dhe hipertensionin arterial.
C) takikardinë dhe hipotensionin arterial.
D) bradikardinë dhe hipotensionin arterial.
E) takikardinë dhe rritjen e presionit venoz.
PS)D

Pyetja 276 V)2

Në cilën nga sëmundjet e mëposhtme biopsia e zorrëve nuk ka vlerë diagnostike?

A) defiçiti i folateve
B) sëmundja Whipple
C) abetalipoproteinemia
D) agamaglobulinemia
E) kompleksi Mikobakterium avium
PS)A

Pyetja 277 V)2

Cila nga gjendjet e mëposhtme mund të vijë nga një ushqyerje hiperkalorike?

A) fibroza hepatike
B) steatonekroza e pankreasit
C) degjenerimi yndyror i miokardit
D) hipertrofia e adipociteve
E) metaplazia yndyrore e indit muscular
PS)D

Pyetja 278 V)1

Miastenia grave është për shkak të

A) dëmtimeve të funksionalitetit të sinapseve neuromuskulore.
B) fenomeneve degjenerative të muskulit.
C) dëmtimeve të rrugëve piramidale.
D) dëmtimeve ekstrapiramidale.
E) çrregullimeve të qarkullimit të gjakut të gjymtyrëve.
PS)A

Pyetja 279 V)3

Një paciente 70 vjeçare, prekur nga karcinoma epidermoide centro-parenkimale e pulmoneve me tregues funksional normal

A) duhet të bëjë rrezeterapi.
B) duhet të bëjë terapi citostatike dhe kobalt terapi.
C) mund t'i nënshtrohet heqjes së një mushkërie.
D) duhet të bëjë çfarëdolloj terapie, me përjashtim të asaj kirurgjikale.
E) duhet të bëjë cikle të imunoterapisë.
PS)C

Pyetja 280 V)2

Cila midis thënieve të mëposhtme është e saktë?

A) Mezotelioma pleurike malinje është fuqishëm e lidhur me një ekspozim të zgjatur ndaj fibrave të azbestit.
B) Mezotelioma pleurike malinje është tumor me lokalizim pulmonar më shumë i lidhur me duhanpirjen.
C) Mezotelioma pleurike malinje është neoplazia pulmonare më e shpeshtë te gratë dhe tek jo duhanpirësit.
D) Mezotelioma pleurike malinje është forma e neoplazisë pulmonare më shpesh e shoqëruar me prodhimin e hormoneve ektopikë.
E) Mezotelioma pleurike malinje paraqitet si një masë polipoide që zgjatet në lumenin bronkial dhe është e mbuluar në përgjithësi, nga mukoza bronkiale e paprekur.

PS)A

Pyetja 281 V)2

Mashkull 62 vjeç me stranguri. Gjatë cistoskopisë vihet re një zonë lehtësisht eritematoze me diametër 1 cm. Kryhet biopsia e kësaj zone dhe mikroskopikisht epiteli paraqet qeliza me hiperkromi të theksuar dhe raport të rritur bërthamë/citoplazëm duke in
A) metaplazi.
B) dsplazi e lehtë.
C) mikroinvazion.
D) hiperplazi.
E) karcinoma in situ .
PS)E

Pyetja 282 V)1

Prevalenza në epidemiologji mat

A) numrin e rasteve të një sëmundje që egziston në një moment të dhënë në një popullatë.
B) simptomat më të zakonshme të një sëmundjeje.
C) sëmundja me frekuencën më të lartë.
D) etnocentrizmi dhe trajtimi i një sëmundjeje të dhënë.
E) grupmoshat më të rrezikuara.
PS)A

Pyetja 283 V)2

Cili nga subjektet e mëposhtëm duhet të jetë në kushtet e një BILANCI AZOTIK pozitiv?

A) një fëmijë i shëndetshëm
B) një i rrtur i shëndetshëm
C) një subjekt i sëmurë
D) një femër e rritur e shëndetshme
E) një subjekt në dietë hipoproteinike
PS)A

Pyetja 284 V)2

Tek një pacient me infeksionin HIV, shkaku më i shpeshtë i infiltrimit pulmonar intersticial është

A) pneumocistis karini.
B) mikobakterium tuberkulozis.
C) sarkoma e Kaposi.
D) kandida albikans.
E) citomegalovirus.
PS)A

Pyetja 285 V)3

Lokalizimi më i shpeshtë i bacilit Koch në aparatin osteoartikular është

A) femuri.
B) kolona vertebrale.
C) gjuri.
D) shpatulla.
E) humerusi.
PS)B

Pyetja 286 V)1

Galaktocela është

A) një cist që ka përmbajtje qumështi.
B) një granulomë lipofagike.
C) nje zgjerim i kanaleve.
D) një formë e mastitit kronik.
E) një nekrozë e gjëndrës së gjirit.
PS)A

Pyetja 287 V)1

Faktori më i rëndësishëm në rritjen e fluksit të gjakut në muskul gjatë ushtrimeve është

A) një rritje e vazodilatacionit.
B) një rritje e frekuencës kardiake.
C) një rritje e temperaturës trupore.
D) një rritje e presionit arterial.
E) një pakësim i vazodilatacionit.
PS)A

Pyetja 288 V)2

Cila nga klasat e imunoglobulinave është e interesuar më shumë në patogjenezën e astmës bronkiale?

A) IgG
B) IgA
C) IgD
D) IgE
E) IgM
PS)D

Pyetja 289 V)3

Cili është përcaktimi i saktë i metaplazisë?

A) Shkalla e ngjashmërisë midis qelizave parenkimale neoplastike dhe qelizave normale, si nga pikpamja morfologjike ashtu dhe funksionale,
B) Humbja e uniformitetit të qelizës, shoqëruar me orientim strukturor apo arkitektonik të pakësuar.
C) Ndryshime të kthyeshme në të cilën një qelizë e rritur(epiteliale ose mezenkimale) zëvendësohet nga një qelizë e rritur të tipit të ndryshëm.
D) Kapaciteti i tumorit për të dhënë metastaza.
E) Shkalla e diferencimit të një tumori malinj.
PS)C

Pyetja 290 V)3

Displazia karakterizohet nga aspektet e mëposhtme, përveç

A) humbjes së polaritetit epitelial.
B) atipisë qelizore.
C) rritjes së numrit të mitozave.
D) rritjes së volumit të bërthamës.
E) hipokromisë.
PS)E

Pyetja 291 V)3

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me dekompensimin kardiak është e gabuar?

A) Fibrilacioni atrial pakëson në mënyrë të dukshme debitin kardiak.
B) Diuretikët përdoren gjithmonë (vetëm nëse nuk kanë kundraindikacione specifike).
C) Beta-bllokantët janë gjithnjë të kundërindikuar sepse janë medikamente inotrop negativ.
D) Duhet gjithmonë kërkuar për të zgjidhur versamentin (apo grumbullimet) pleural.
E) Medikamentet frenues të sistemit renin-angiotenzin-aldosteron veprojnë në nivel veshkor, kardiak dhe vaskular periferik.
PS)C

Pyetja 292 V)2

Në cilin nga rastet e mëposhtme ulet kalçemia?

A) nefrozë
B) atrofia e kockës
C) mieloma multiple
D) hiperparatiroidizmi primar
E) hipervitaminoza D
PS)A

Pyetja 293 V)2

Çfarë i korrespondon një pseudoaluçinacioni?

A) dëgjojnë se çdo gjë që egziston jashtë vjen nga brenda
B) dëgjojnë se nga brenda nuk mund të vijë asgjë
C) dëgjojnë zëra që vijnë nga brenda
D) dëgjojnë që gjithçka që është falso është një aluçinacion
E) dëgjojnë zëra që vijnë nga persona të njohur por që nuk janë të pranishëm
PS)C

Pyetja 294 V)1

Cila prej enzimave serike mund të jetë normale në hepatitin akut?

A) Fosfataza alkaline
B) SGPT
C) SGOT
D) CPK
E) LDH
PS)A

Pyetja 295 V)3

Cila nga thëniet e mëposhtme është e gabuar në lidhje me dikumarinikët?

A) Frenojnë sintezën hepatike të faktorit VII.
B) Janë antagonistë të vitaminës K.
C) Veprimi zgjat për ditë pas marrjes së fundit.
D) Antagonizojnë veprimin me marrjen e vitaminës C me doza të larta.
E) Frenojnë sintezën e proteinës C dhe S.
PS)D

Pyetja 296 V)1

Vezikulat sinaptike mund të përmbajnë

A) mielinën.
B) lipofuscina.
C) kolinesteraza.
D) noradrenalinë.
E) kreatinina.
PS)D

Pyetja 297 V)2

Telomerët janë

A) nën-njësi që përmbajnë proteina komplekse.
B) fraksione molekulare të vendosura në pjesën apikale të polimerit.
C) porcioni fundor i kromozomit.
D) proteina specifike të qelizave neoplastike.
E) faktorë të transkriptimit.
PS)C

Pyetja 298 V)2

Agjentët shkaktarë më të shpeshtë të pneumonive të komunitetit janë

A) mikoplazma pneumonia.
B) hemofilus influenza.
C) legionela pneumofila.
D) klostridium difficile.
E) streptokokus pneumonia.
PS)E

Pyetja 299 V)2

Diateza hemorragjike nga mungesa e protrombinës presupozon një

A) splenomegali
B) hipergamaglobulinemi.
C) insufiçiencë hepatike.
D) mungesë të vitaminës C.
E) hipokalcemi.
PS)C

Pyetja 300 V)1

Në rast të çrregullimeve respiratore të një fëmijë, ekzaminimi më i indikuar është

A) hemogramë.
B) analiza e gazeve në gjak.
C) egzaminimi i espektoratit.
D) ECG.
E) radiografi e toraksit.
PS)E

Pyetja 301 V)1

Në pacientët me akalazi, disfagia zakonisht është

A) me shpejtësi progresive.
B) vetëm për ushqimet e forta.

C) vetëm për lëngjet.
D) shoqërohet me anemi.
E) si për ushqimet e forta ashtu dhe për lëngjet.
PS)E

Pyetja 302 V)1

Qelizat e palcës së kockës janë më shumë të ndjeshme ndaj rrezatimit sepse

A) arrihen lehtësisht nga rrezatimi.
B) janë qeliza të qëndrueshme.
C) mungesa e mekanizmave për riparimin e dëmtimeve të ADN-së.
D) dimensioni i tyre është shume heterogjen.
E) dyfishohen në mënyrë të vazhdueshme.
PS)E

Pyetja 303 V)1

Apatia

A) nuk është kurrë e pranishme tek skizofrenët.
B) nuk është kurrë e pranishme tek ata me depresion.
C) karakterizohet nga shkëputja dhe indiferenca afektive.
D) është gjithmonë e pranishme në eksitimin maniakal.
E) është një insufiçiencë hepatike.
PS)C

Pyetja 304 V)2

Cili nga bakteret e mëposhtëm patogen mund të transmetohet nga nëna tek fetusi nëpërmjet rrugës transplacentare?

A) enterokoku fekal
B) stafilokoku aureus
C) treponema pallidum
D) streptokoku piogen
E) korinobakterium difterie
PS)C

Pyetja 305 V)1

Terapia antiagregante është e përdorur në

A) atak ishemik tranzitor
B) demenca multiinfarktuale
C) hemorragji subaraknoide
D) trombozë karotide interne

E) hemorragji cerebrale
PS)A

Pyetja 306 V)1

Cili nga neurotransmetuesit e mëposhtëm është i përfshirë kryesisht në patogjenezën e sëmundjes së Parkinsonit?

A) serotonina
B) adrenalina
C) acetilkolina
D) GABA
E) dopamina
PS)E

Pyetja 307 V)2

Trajtimi më i përshtatshëm i empiemës pleurale është me

A) antibiotikët.
B) antibiotik dhe torakoçentezë.
C) antibiotik dhe drenimi i mbyllur.
D) antibiotik dhe drenimi i hapur.
E) dekortikacion të herët.
PS)C

Pyetja 308 V)1

Cila nga substancat e mëposhtme ka si efekt kryesor uljen e insulinorezistencën?

A) sulfanilure
B) antibiotikët
C) kimioterapia
D) biguanidet
E) antagonistët e kalçiumit
PS)D

Pyetja 309 V)1

Nevralgjia e trigeminit lokalizohet në mënyrë preferenciale

A) në nivelin e degës I të trigeminit.
B) në nivelin e degës së II dhe III të trigeminit.
C) në nivelin fronto-okular.
D) në nivel oksipital.
E) në nivel temporo-parietal.
PS)B

Pyetja 310 V)2

Cili është treguesi më i mirë i kontrollit metabolik për një periudhe disa mujore në një subjekt diabetik?

A) Glukozuria e 24h
B) përqëndrimi i HbA1c
C) glicemia në mesditë e përsëritur gjatë javëve
D) përqëndrimi i fruktozaminës
E) përqëndrimi i peptidit C bazal dhe pas marrjes së glukagonit
PS)B

Pyetja 311 V)2

Një anemi kronike tek një pacient me gjak okult në feçe duhet të na çojë si kriter diagnostikues, në hipotezë të parë, përkundrejt identifikimit të një karcinome të

A) sigmës.
B) cekum-kolon ascendent.
C) kolon discendens.
D) rektumit.
E) stomakut.
PS)B

Pyetja 312 V)1

Cila nga kërpudhat e mëposhme është agjenti shkaktar i mugetos ?

A) kandida albikans
B) histoplazma kapsulatum
C) blastomices dermatiditis
D) kriptokokus neoformans
E) trikofiton mentagrofitis
PS)A

Pyetja 313 V)1

Otorrea është sinonim i:

A) daljes së gjakut nga tubujt.
B) daljes së qelbit nga kanali i brendshëm i dëgjimit.
C) daljes së likuorit nga kanali i jashtëm i dëgjimit.
D) daljen e qelbit nga vestibuli nazal.
E) dalja e qelbit nga sinusi kavernoz.
PS)C

Pyetja 314 V)1

Çfarë nënkuptojmë me "modë" në statistikë?

A) e mesmja aritmetike e vlerave
B) vlera që gjendet në mes
C) vlera që haset më shpesh
D) rrënjës së produktit n....vlerash
E) rrënjës e variancës
PS)C

Pyetja 315 V)1

Me termin hipertrofi nënkuptojmë

A) rritjen e volumit të një indi për shkak të rritjes volumetrike të elementëve qelizor përbërës.
B) transformimin e një indi në një tjetër.
C) shtimin e volumit të një indi nga rritja numerike e elementëve qelizor përbërës.
D) një proliferim qelizor që paraqet karakteristika të atipisë.
E) degjenerimi neoplastik i një indi.
PS)A

Pyetja 316 V)2

Cila nga manifestimet e mëposhtme mund të të bëjë të mendosh për një anemi kronike?

A) cikatrizimi i ngadaltë i një plage
B) temperatura
C) bradikardia
D) haluçinacioni
E) djersitja gjatë natës
PS)A

Pyetja 317 V)3

Manifestimi kryesor klinik i brucelozës akute-subakute është

A) temperatura me luhatje.
B) temperaturë që shkon duke u rritur.
C) temperaturë normale .
D) ethe kuintana.
E) ethe terzana.
PS)A

Pyetja 318 V)1

Adenina është

A) një purinë.
B) një pirimidinë.
C) një derivat imidazolik.
D) një derivat i furano.
E) një derivat i tiofenit.
PS)A

Pyetja 319 V)1

Origjina aortike e arteries mezenterike superiore është e lokalizuar

A) mbi shpretkën.
B) pas pankreasit.
C) mbi trungun celiak.
D) në omentumin e vogël.
E) në mezokolonin trasvers.
PS)B

Pyetja 320 V)3

Cila nga thëniet e mëposhtme është e saktë lidhur me ndryshimin midis Alkalozës respiratore nga ajo metabolike ?

A) Urina ka reaksion alkalin.
B) Niveli i bikarbonateve plazmatik është normal ose i pakësuar.
C) Fluksi i gjakut në tru tenton të rritet.
D) Nuk ka rrezik për tetani.
E) Kemi një pakësim të eksitabilitetit neuromuskular.
PS)B

Pyetja 321 V)2

Zëvendësimi i një rrahjeje të rregullt të zemrës me një rrahje të parakohshme vihet re në

A) pulsin dikrot .
B) pulsin e fortë.
C) pulsin alternant.
D) pulsin bigemin.
E) pulsin paradoksal.
PS)D

Pyetja 322 V)2

Në insufiçiencën kardiake kongjestive cila prej simptomave nuk është e pranishme?

A) cianoza

B) hipotensioni arterial
C) rritja e kompliancës pulmonare
D) hepatomegalia
E) pakësimi i kompliancës pulmonare
PS)C

Pyetja 323 V)2

Cila nga sëmundjet e mëposhtme të tiroides nuk prodhon noduj?

A) tiroiditi
B) adenoma
C) karcinoma anaplastike
D) karcinoma folikulare
E) sëmundja Graves
PS)E

Pyetja 324 V)3

Gjetja e proteinurisë të matshme (>3.5 g/ditë) dhe cilindruria është patognomonike e një

A) sindromi nefritik.
B) sindromi nefrozik.
C) hipertensionit arterial.
D) insufiçiencës renale akute ishemike.
E) pielonefriti akut.
PS)B

Pyetja 325 V)3

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me patogjenezën e dekompensimit kardiak është e gabuar?

A) Tensioni i rritur i pareteve i shkaktuar nga dilatacioni i dhomave ventrikulare përkeqëson furnizimin me oksigjen.
B) Rritja e tonit adrenergjik reflektuar në dekompensimin kardiak përbën një fenomen të substancialisht pozitiv.
C) Stimulimi i sistemit rninë-angiotenzinë-aldosteron mund të përkeqësoj fibrozën kardiake.
D) Receptorët alfa adrenergjik janë vazokonstriktor mbi arteriet dhe mbi venat.
E) Mbajtja e ujit shton ngarkesën mbi zemër.
PS)B

Pyetja 326 V)2

Diureza ulet në të gjitha rastet e mëposhtme, me përjashtim të

A) rritjes së sekrecionit të hormonit antidiuretik.

B) rritjes së presionit në arterien renale.
C) rritjes së stimulimit simpatik.
D) uljes së shpejtësisë të filtrimit glomerular).
E) rrit djersitjen.
PS)B

Pyetja 327 V)3

Cili nga treguesit e mëposhtëm në terapinë e një flebotromboze të thellë te një grua shtatzënë është i saktë?

A) heparina me peshë molekulare të vogël kundërindikohet në semestrin e III-të të shtatzanisë
B) terapia me warfarin është e kundërindikuar vetëm në semestrin I të shtatzanisë
C) terapia me warfarin është e kundërindikuar gjatë gjithë gravidancës, por jo gjatë laktacionit
D) terapia me warfarin është e kundërindikuar si në periudhën para-lindjes ashtu dhe pas-lindjes
E) të gjitha masat terapeutike të aplikuara te një grua jo shtatzënë janë të përdorshme dhe te ato shtatzëna
PS)C

Pyetja 328 V)2

Zhurmat sistolike nga regurgitimi janë ato që vinë nga

A) stenoza valvolare.
B) difekti i septumit ventrikular.
C) rritja e debitit sistolik.
D) dilatacioni post-valvolar.
E) zhurma nga fluksi prej stenozave relative.
PS)B

Pyetja 329 V)2

Midis shkaqeve të hiperglicemisë diabetike nuk bën pjesë

A) transporti i ulur i glukozës në brendësi të qelizës në indin dhjamor.
B) transporti i ulur i glukozës në brendësi të qelizës në indin muskular.
C) rritja e sintezës endogjene të glukozës (neoglukogeneza).
D) rritja e glikogjenosintezës.
E) ulja e katabolizmit të glukozës.
PS)D

Pyetja 330 V)3

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me prostaglandinat është e saktë?

A) Vijnë nga metabolizmi i acideve yndyror të pangopur.

B) Janë përbërës ekskluzivisht në prostatë.
C) Vijnë nga metabolizmi i acideve yndyror të ngopur me numër çift atomesh karboni.
D) Vijnë nga metabolizmi i acideve yndyror të ngopur me numër tek atomesh karboni.
E) Janë glikoproteina me origjinë trombotike.
PS)A

Pyetja 331 V)1

Cilat janë bakteriet piogene më të zakonshëm në lëkurë?

A) diplokoku
B) stafilokoku dhe streptokoku
C) enterokoku
D) streptobacili
E) spirokete
PS)B

Pyetja 332 V)1

Cila nga të mëposhtmet nuk konsiderohet si shenjë alarmi në një pacient që paraqitet me dispne?

A) anemia
B) rënie e peshës pa arsye
C) diarrea kronike
D) disfagia
E) fillimi i vonshëm i simptomave me një ecuri të shpejtë duke u rënduar
PS)C

Pyetja 333 V)1

Empiema pulmonare karakterizohet nga

A) fibroza e shtrirë e pleurës.
B) abces pulmonar i drenuar.
C) prezenca e likidit të përzier me gaz në kavitetin pleural.
D) prezenca e gjakut të koaguluar në kavitetin pleural.
E) prezenca e qelbit në kavitetin pleural.
PS)E

Pyetja 334 V)2

Splenomegalia shfaqet veçanërisht në patologjinë e

A) tifos.
B) amiloidozës sekondare.
C) hipertensionit portal.

D) leukozës mieloide kronike.
E) mononukleozë infektive.
PS)D

Pyetja 335 V)2

Përqëndrimi në gjak i kujt prej treguesve biokimikë të mëposhtëm është më i përshtatshëm për të vlerësuar citonekrozën hepatike?

A) bilirubina
B) amilaza
C) alanin transaminaza
D) fosfataza alkaline
E) albumina
PS)C

Pyetja 336 V)3

Të gjitha manifestimet e mëposhtme marrin pjesë në kuadrin e pankreatitit kronik, përveç

A) dhimbjeve epigastrike të përhapura në shpinë.
B) kapsllëk të fortë.
C) humbjes së peshës.
D) kalçifikimit në regjionin pankreatik.
E) diabetit melit.
PS)B

Pyetja 337 V)3

Cila nga gjendjet e mëposhtme është tipike e shoqëruar me sindromin e lizës tumorale?

A) ulja e kaliumit në gjak
B) hiperuricemia
C) hipertrigliceridemia
D) hipokalçemia
E) hipofosforemia
PS)B

Pyetja 338 V)3

Kromozomi Philadelphia është

A) një kromozom mbi numrin e kromozomeve
B) rezultat i një translokacioni kromozomik
C) rezultat i një delecioni
D) një kromozom që mungon në krahun e shkurtër
E) një modifikim i një kromozomi seksual

PS)B

Pyetja 339 V)2

Nga çfarë karakterizohet një respiracion i tipit Cheyne-Stokes?

A) një pauzë respiratore në inspiracion të thellë
B) një respiracion i pakordinuar
C) një rritje progresive e frekuencës dhe thellësisë së akteve respirator të cilët ndjekin një pauzë respiratore
D) një bradipne e shprehur
E) një takipne e shprehur
PS)C

Pyetja 340 V)3

Statinat janë efikase në pakësimin e rriskut kardiovaskular sepse

A) pakësojnë HDL-C.
B) frenojnë lipoproteinlipazën.
C) pakësojnë sintezën e VLDL si mekanizëm predominues.
D) pakësojnë vlerat e kolesterolit total, LDL dhe trigliceridеve, rrisin HDL-C si dhe për efekte plejotropike të mundshme.
E) pakësojnë vlerat e kolesterolit vetëm në hiperkolesteroleminë primare dhe jo në atë sekondare.
PS)D

Pyetja 341 V)3

Cila nga gjendjet e mëposhtme është shkak i hipertensionit nefrovaskular?

A) nefroangioskleroza
B) veshka policistike
C) glomerulonefriti membranoz
D) sindromi Goodpasture
E) stenoza e arteries renale
PS)E

Pyetja 342 V)2

Cili nga elementët e mëposhtëm nuk futet në llogaritjen e Child-Pugh, tregues i rëndësishëm prognostik në cirrozë?

A) vlera e albuminemisë
B) vlera e natriumit plazmatik
C) vlera e bilirubinemisë
D) prania si entitet e versamentit ascitik

E) prania si entitet e encefalopatisë portosistemike
PS)B

Pyetja 343 V)1

Mbijetesa e eritrociteve në qarkullim është

A) 40 ditë.
B) 60 ditë.
C) 120 ditë.
D) 215 ditë.
E) 300 ditë.
PS)C

Pyetja 344 V)1

Në kushte normale thithja e liquori cerebrospinal ndodh në pjesën më të madhe nga

A) vilet araknoid kranial dhe spinal.
B) në plekset korioid.
C) në ependimën ventrikulare.
D) në venulat kortiko-piale encefalike.
E) në sipërfaqen e hapësirës lepto-meningeale.
PS)A

Pyetja 345 V)1

Tek femrat shkaku më i shpeshtë i mungesave të hekurit paraqitet nga

A) gjakrrjedhja prej hemorroideve.
B) humbjet e shprehura të gjakut nga menstruacionet.
C) ulçera gastroduodenale.
D) sëmundjet e zorreve.
E) epistaksis.
PS)B

Pyetja 346 V)2

Naloxoni është një medikament

A) antiinflamator josteroid.
B) kortizonik.
C) antipiretik.
D) antagonist i morfinës.
E) analgjezik.
PS)D

Pyetja 347 V)2

Në një radiografi antero-posteriore të toraksit, buza e majtë e hijes kardiake përbëhet nga këto formacione, përveç

A) venës cava superiore.
B) arteria pulmonare.
C) harkut të aortës.
D) ventrikulit të majtë.
E) atriumit të majtë.
PS)A

Pyetja 348 V)1

Terapia antikoagulante është zgjedhja e parë

A) në të gjithë iktuset ishemik.
B) në iktusin ishemik sekondar pas një fibrilacioni atrial.
C) në iktusin ishemik sekondar nga ateromatoza karotidea.
D) në iktusin hemorragjik.
E) në iktusin kriptogenetik.
PS)B

Pyetja 349 V)3

Variantet e mëposhtme janë shkaqe të ascitit të pashoqëruara me sëmundje peritoneale, me përjashtim të

A) insuefiçencës kardiake kongjestiva.
B) perikarditit kostriktiv.
C) sindromës Budd-Chiari.
D) sindromi Meigs.
E) histoplasmozës.
PS)E

Pyetja 350 V)3

Ku është i lokalizuar geni përgjegjës për fibrozën cistike?

A) kromozomi 5
B) kromozomi 13
C) kromozomi 7
D) kromozomi 11
E) kromozomi 3
PS)C

Pyetja 351 V)2

Cila nga situatat e mëposhtme bën të detyrueshme një thellim diagnostik, nëse haset te një i porsalindur prej katër ditësh

A) prania e zhurmës në zemër.
B) frekuenca kardiake 150/min.
C) akrocianoza (cianoza e majave të gishtave) periferike gjatë qarjes.
D) frekuenca respiratore në qetësi 40/min.
E) vlerat e bilirubinës indirekte 6 mg/dL.
PS)A

Pyetja 352 V)2

Një medikament thuhet që ka efekte inotrope negative kur

A) rrit kontraktilitetin e miokardit.
B) zvogëlon shpejtësinë e përçueshmërisë së ngacmimit.
C) rrit frekuencën kardiake.
D) zvogëlon forcën e kontraksionit të miokardit.
E) zvogëlon eksitabilitetin e elementëve të miokardit.
PS)D

Pyetja 353 V)1

Cikli ovarian ka fillim

A) në javën e IV të jetës embrionale.
B) në muajin III-V të jetës fetale.
C) në lindje.
D) në fekondim.
E) në pubertet.
PS)E

Pyetja 354 V)2

Midis simptomave të hipertensionit intra kranial mund të jenë

A) takikardia.
B) temperatura.
C) hipertensioni.
D) bradikardia.
E) çrregullimet e ritmit kardiak.
PS)D

Pyetja 355 V)1

Ovulacioni normalisht ndodh

A) gjatë fazës folikulare të ciklit.
B) para pikut të estradiolit.
C) pak para fillimit te pikut të LH.
D) pak pas pikut të LH.
E) gjatë fazës luteale të ciklit.
PS)D

Pyetja 356 V)2

Kontrolli i terapisë heparinike kryhet me

A) vlerësimin e trombociteve në gjak.
B) kohën e hemorragjisë.
C) prova e zhgutit.
D) koha e tromboplastinës parciale .
E) dozimi i fibrinogenit.
PS)D

Pyetja 357 V)3

Fryrja e membranës në një qelizë të ekspozuar ndaj hipoksisë akute është pasojë e

A) rritjes së përqëndrimit të Ca++.
B) funksionim difektoz të transportuesve të Ca++.
C) funksionim difektoz i pompës Na+/K+ në membranë.
D) rritje të transportit të joneve Cl-.
E) rritje të transportit pasiv të pentozave.
PS)C

Pyetja 358 V)1

Në rast se dyshohet për një takikardi ventrikulare duhet të:

A) administrohet lidokainë dhe në rast të paefektshmërisë të praktikohet kardioversioni elektrik.
B) të administrohet digital.
C) të praktikohet masazhi i sinusit karotid.
D) të administrohet propafenon.
E) të administrohen ?-bllokues.
PS)A

Pyetja 550 V)2

Cili tip i emfizemës pulmonare i detyrohet mungesës së alfa-1-antitripsinës?

A) centrolobulare
B) paraseptale
C) panlobulare
D) intersticiale
E) e çrregullt
PS)C

Pyetja 551 V)2

Shkaku më i shpeshtë i sindromit nefrotik në moshë pediatrike është:

A) glomerulopatia proliferative ekstrakapilare.
B) glomerulopatia me lezione minimale.
C) glomerulopatia membranose.
D) glomerulopatia proliferative mesangiale.
E) glomerulopatia post-infektive.
PS)B

Pyetja 552 V)2

Cili është hormoni tipik i trofoblastit?

A) Gonadotropina corionike
B) Progesteroni
C) Estrioli
D) Laktogeni placentar
E) Relaxina
PS)A

Pyetja 553 V)2

Karcinoma bronkogjene:

A) mund të lidhet me defekte të perfuzionit dhe ventilacionit pulmonar.
B) nuk jep kurrë alterime të perfuzionit të ventilimit pulmonar.
C) nuk jep kurrë alterime të perfuzionit pulmonar.
D) nuk jep kurrë alterime të ventilimit pulmonar.
E) mund të shkaktojë defekte të perfuzionit që nuk lidhen kurrë me parregullsi ventilatore.
PS)A

Pyetja 554 V)2

Pjesa më e madhe e medikamenteve antineoplazike japin si efekt anësor tipik:

A) limfocitopeni dhe granulocitopeni.
B) cistit hemorragjik.
C) ethe.
D) dobësi muskulare.
E) ikter hepatoqelizor.
PS)A

Pyetja 555 V)2

Në sëmundjen e divertikulit të kolonit, të tilla lezione nuk formohen kurrë në:

A) cecum.
B) colon ascendent.
C) fleksura hepatike e splenike.
D) rectum.
E) mund te formohen kudo .
PS)D

Pyetja 556 V)2

Fibrat parasimpatike preganglionare për zorrën e hollë vijnë nga:

A) corno laterale të mielomerëve C1-C8.
B) corno laterale të mielomerëve C8-T3.
C) corno laterale të mielomerëve T10-T12.
D) nukleusi motor dorsal i vagusit.
E) nukleusi ambigus.
PS)D

Pyetja 557 V)2

Cili nga pohimet mbi Divertikulin e Zenker është i saktë?

A) zakonisht është subjekt i degjenerimit malinj.
B) merr origjinën nga hipofarinksi.
C) rrallëherë kërkon ndërhyrje kirurgjikale.
D) është një divertikul tipik nga tërheqja.
E) është një divertikul tipik epifrenik.
PS)B

Pyetja 558 V)1

Bilirubinemia indirekte rritet në gjendjet e mëposhtëme, me përjashtim të:

A) anemisë refraktare.
B) anemisë megaloblastike.
C) anemisë aplastike.
D) anemisë hemolitike.
E) anemisë saturnine.
PS)C

Pyetja 559 V)2

Manifestimet kutane të rektokolitit ulceroz përfshijnë cilin nga alternativat e mëposhtme?

A) dermatit herpetik
B) acantoza nigricans

C) fistula perianale
D) pyoderma gangrenoze
E) teleangectasia e fytyrës dhe flushing
PS)D

Pyetja 560 V)1

Psoriaza është një dermatit:

A) eritemato-squamoz.
B) eritemato-pomfoid.
C) eritemato-edemato-vezikular.
D) nodular.
E) papuloz.
PS)A

Pyetja 561 V)1

Cili nga mikroorganizmat shkakton një meningit purulent?

A) Virusi Epstein Barr
B) Mycobacterium tuberculosis
C) Leptospira pomona
D) Neisseria meningitides
E) Brucella mellitensis
PS)D

Pyetja 562 V)1

Cila prej karakteristikave të mëposhtme, bëjnë që nyja sino-atriale të jetë pacemaker normal i zemrës krahasuar me nyjen atrio-ventrikulare?

A) pozicioni i saj
B) kapaciteti i saj për të gjeneruar në mënyrë spontane potencialin e veprimit
C) inervimin e saj
D) frekuenca e saj intrinseke
E) amplituda e potencialit të veprimit
PS)D

Pyetja 563 V)2

Metastazat osteolitike vërehet më shumë në:

A) Karcinomën e ovarit.
B) Sarkomën Ewing.
C) Karcinomën e mamelës.
D) Karcinomën e prostatës.

E) Seminomën.
PS)C

Pyetja 564 V)3

Tek një grua që referon në anamnezë një vdekje fetale endouterine, glicemia pas ngarkesës orale me 50mg glukoze është 140mg/dl. Cili është menaxhimi klinik korrekt për këtë paciente?

A) asnjë ekzaminim tjetër
B) një dietë me 2200 kalori
C) një test standart i tolerancës ndaj glukozës me 100 g glukozë
D) vlerësimi i glukozurisë në kushte shtëpie
E) glicemia postprondiale pas 2 orësh
PS)C

Pyetja 565 V)1

Cila është terapia e përzgjedhur në Sëmundjen Parkinson?

A) L-dopa
B) dopamina
C) barbituratë
D) neuroleptikë
E) tiroksinë
PS)A

Pyetja 566 V)1

Mund të vërehet hipoglicemi postprondiale:

A) në sëmundjen celiake.
B) pas gastrorezeksionit subtotal.
C) për shkak të një fistule gastro-kolike.
D) për shkak të vjelljes së ushqimit.
E) ulçerës duodenale.
PS)B

Pyetja 567 V)1

Vlera normale e hematokritit përfshihet midis:

A) 20% dhe 30%.
B) 10 % dhe 20%.
C) 40% dhe 50%.
D) 60% dhe 70%.
E) 70% dhe 75%.
PS)C

Pyetja 568 V)2

Kërkimi për imunoglobulina IgE specifike në serum nëpërmjet Testit Radio Allergo Absorbent (RAST) indikohet në rastet e:

A) polenozave.
B) reaksioneve të flakjes së transplantit.
C) anemive hemolitike.
D) sëmundjes së serumit.
E) dermatitit të kontaktit.
PS)A

Pyetja 569 V)2

Osteoni është:

A) një përbërës i kartilagove në rritje.
B) një përbërës i perikondrit.
C) njësia bazë e kockës kompakte.
D) njësia bazë e kockës spongioze.
E) një element i palcës së kockave.
PS)C

Pyetja 570 V)1

Shintigrafia kockore në vlerësimin e metastazave skeletike:

A) është me e ndjeshme se radiologjia tradicionale.
B) indikohet vetëm në përcaktimin e stadit.
C) indikohet vetëm në follow-up.
D) nuk indikohet për vlerësimin pas radioterapisë.
E) kryhet gjithmonë me teknikë tomografike.
PS)A

Pyetja 571 V)1

Bronkoektazitë primitive mund të shkaktohen nga:

A) sëmundjet alergjike.
B) infeksione të mëparshme.
C) malformacione bronkiale.
D) trauma.
E) obstruksion bronchial.
PS)C

Pyetja 572 V)1

Propabiliteti që një vajzë e një pacienti me hemofili B të rëndë mund të jetë një bartëse e hemofilisë është:

A) 0%.
B) 25%.
C) 50%.
D) 75%.
E) 100%.
PS)E

Pyetja 573 V)2

Rruga metabolike e stimuluar në diabetin insulino-vartës të pakontrolluar është:

A) gluconeogjeneza.
B) sinteza e hemit.
C) glicogjenosinteza.
D) glikogjenoliza.
E) urogjeneza.
PS)A

Pyetja 574 V)2

Prania e artritit reumatoid, splenomegalisë, neutropenisë është karakteristike gjatë:

A) një konjuktiviti mix.
B) sindromës Felty.
C) sindromës Goodpasture.
D) sëmundjes Chediak-Higashi.
E) LES
PS)B

Pyetja 575 V)2

Në medulën spinale ekzistojnë:

A) motoneuronë alfa dhe gamma.
B) motoneuronë alfa.
C) motoneuronë alfa fazike dhe gamma fazike.
D) motoneuronë alfa fazike dhe alfatonike, gamma fazike dhe gamma tonike.
E) motoneuronë gamma.
PS)D

Pyetja 576 V)1

Gjatë shtatzënisë shpejtësia e filtrimit glomerular mund të rritet me:

A) 10%.
B) 25%.
C) 50%.
D) 75%.
E) 100%.
PS)C

Pyetja 577 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është një vaskulit?

A) granulomatoza Wegener
B) sindroma Churg-Strauss
C) arteriti Takayasu
D) arteriti Horton
E) condrocalcinosi
PS)E

Pyetja 578 V)2

Cila nga këto shenja radiologjike nuk është tregues i osteoporozës vertebrale?

A) hipertransparenca e trupave vertebrale me rritje të vizibilitetit të korteksit të tyre
B) aspekt konkav i buzëve të trupave të vertebrave
C) deformim në formë cuneiforme të trupave
D) shtim i trashësisë kortikale
E) pakësim i imazhit trabelkular i kockës spongiose
PS)D

Pyetja 579 V)2

Cili komplikim/evolucion i pankreatitit akut duhet të konsiderohet më pak i rëndë?

A) abses hepatik
B) pseudocist
C) fistul e colonit
D) flegmonë e pankreasit
E) gastropati hemorragjike
PS)B

Pyetja 580 V)2

Një dobësim i theksuar trupor vërehet zakonisht në të gjitha gjendjet e mëposhtme me përjashtim të:

A) hipoalimentaciomit kronik

B) diabetit pankreatik të rëndë.
C) sëmundjes Addison.
D) hipotiroidizmit.
E) steatoreve nga malabsorbimi.
PS)D

Pyetja 581 V)2

Cila prej këtyre strukturave të bakterit goditet në mënyrë selektive nga penicilinat?

A) kapsula
B) membrana
C) muri qelizor
D) nukleusi
E) ribozomet
PS)C

Pyetja 582 V)1

Cili nga përkufizimet është i saktë për dermatitin alergjik të kontaktit?

A) Është një dermatit eritemato-pustuloz.
B) Është një dermatit eritemato-edemato-vesicular.
C) Është një dermatit nodular.
D) Është një dermatit ulcerativ.
E) Është një dermatit papulo-pustuloz.
PS)B

Pyetja 583 V)2

Cila nga qasjet e mëposhtme terapeutike konsiderohet aktualisht si e përzgjedhur tek një pacient që paraqitet në fazat fillestare te Artriti reumatoid?

A) FANS
B) prednisone 40mg/ditë + minocicline (100 mg/bid)
C) methotrexate (10 mg/jave) + FANS + kortikosteroide eventualisht me doze te ulët
D) FANS + minociclinë (100mg/bid)
E) paracetamol sipas nevojës
PS)C

Pyetja 584 V)2

Cila simptomatologji shoqërohet me shpesh me fobinë shkollore?

A) belbëzimi
B) tiket
C) krizat konvulsive febrile

D) simptomat psikosomatike
E) çrregullimet e të mësuarit
PS)D

Pyetja 585 V)2

Shenjat radiologjike të një neoplazie të stomakut janë:

A) defekt në rimbushje.
B) lezion ulceroz.
C) rigiditet i pareteve.
D) të treja këto simptoma.
E) akinezia gastrike.
PS)D

Pyetja 586 V)1

"Anisocitosa" eritrocitare përfaqëson:

A) eritrocite të mëdha.
B) eritrocite të vogla.
C) eritrocite me përbërje të mangët në Hb.
D) eritrocite të dimensionëve të ndryshme.
E) eritrocitet " target cell".
PS)D

Pyetja 587 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm paraqet një diagnozë përfundimtare të Diabetit Mellitus të Tipit II?

A) simptoma e diabetit plus një glicemi rastësore në vlerat 160 mg/dl
B) nivele të hemoglobinës A1C prej 7% ose më e madhe
C) një glicemi esëll në vlerën 126mg/dl ose më e madhe në dy matje të njëpasnjëshme
D) një glicemi pas dy orësh me e lartë se 150mg/dl gjatë një testi të tolerancës orale ndaj glukozës
E) kombinimi i moshës nën 30 vjeç, anamnezë familjare pozitive për diabetin, dhe një glicemi esëll më të lartë se 150mg/dl
PS)C

Pyetja 588 V)2

Peritoniti bakterial spontan përfaqëson një komplikim të cilës prej patologjive të mëposhtme?

A) apendisit akut
B) divertikul të kolonit
C) cirrozë hepatike

D) sëmundjen Crohn
E) kolecistit
PS)C

Pyetja 589 V)1

Cili është manifestimi hemorragjik me i shpeshtë në hemofilinë A?

A) purpura cutane
B) purpura mucosale
C) hematomat subcutane
D) hemartrozë
E) epistaxis
PS)D

Pyetja 590 V)2

Në gjendjet e shokut hiperdinamik ulja e papritur e hedhjes kardiake e shoqëruar me ulje të presionit venoz qëndror është tregues i:

A) mbingarkesës së qarkullimit të vogël.
B) shokut hipodinamik për shkak të reduktimit të masës qarkulluese.
C) hapjes së shunteve arterio-venoze.
D) paralizës vasale së arteriolave.
E) insuficiencës kontraktuese të miokardit.
PS)B

Pyetja 591 V)1

Norma e pCO2 në gjak është:

A) = 40 mm Hg.
B) < 20 mm Hg.
C) < 30 mm Hg.
D) > 50 mm Hg.
E) > 60 mm Hg.
PS)A

Pyetja 592 V)2

Defekti më i zakonshëm në sindromën adrenogenitale është:

A) idiopatik.
B) deficit i 11-hidroksilazës.
C) deficit i 17-hidroksilazës.
D) deficit i 21-hidroksilazës.
E) deficit i 3beta-hidroksi-dehidrogenazës.

PS)D

Pyetja 593 V)2

Dëmtimet më të mëdha të vetëdijes takohen në:

A) poliomielit.
B) encefalit.
C) poliradikulit Guillain-Barre.
D) paraliza të tipit Laundry.
E) lezion medular transvers.
PS)B

Pyetja 594 V)2

Cilët janë komponentët e sistemit mekanik të mbrojtjes pulmonare?

A) sistemi mukorregullues, epiteli kubik me cilie vibruese, ndarja dikotomike e bronkeve.
B) arkitektura anatomike dikotomike, hipersekrecioni i mukusit, epiteli prizmatik me cilie vibruese.
C) arkitektura anatomike dikotomike, sistem mukorregullues, epiteli prizmatik me cilie vibruese
D) arkitektura anatomike dikotomike, sistem mukorregullues, epiteli kubik
E) arkitektura anatomike dikotomike, hipersekrecioni i mukusit, epiteli kubik
PS)C

Pyetja 595 V)2

Gjatë tifos abdominale testi i seroaglutinimit VIDAL, më së pari është pozitiv:

A) për shkak të shfaqjes së antitrupave anti B.
B) për shkak të shfaqjes së antitrupave anti O.
C) për shkak të shfaqjes së hershme dhe të njëkohëshme të antitrupave anti-H e anti VI.
D) për shkak të shfaqjes së antitrupave anti VI.
E) për shkak të shfaqjes së antitrupave anti C.
PS)B

Pyetja 596 V)2

Në gjëndjen esëll substrati metabolik kryesor për miokardin përfaqësohet nga:

A) aminoacidet.
B) glukoza.
C) glikogjeni.
D) acidet yndyrore.
E) laktatet.
PS)D

Pyetja 597 V)1

Cili prej elementëve nuk absorbohet në sëmundjen celiake?

A) kosi
B) kërpudhat
C) mishi
D) orizi
E) buka e grurit
PS)E

Pyetja 598 V)2

Pankreatiti akut mund të shfaqët me shpesh tek subjekte:

A) nën 45 vjec.
B) të seksit mashkull
C) alkoolistët kronikë.
D) me kalkulozë biliare.
E) të prekur nga sëmundja Crohn.
PS)D

Pyetja 599 V)1

Mediatori periferik i shumë prej veprimeve të GH -së është:

A) insulina.
B) GHRH.
C) somatostatina.
D) IGF-1.
E) prolaktina.
PS)D

Pyetja 600 V)2

Zhurma Diastolike me frekuencë mesatare të ulët takohet në:

A) stenozën e valvulës pulmonare.
B) insuficiencën e valvulës mitrale.
C) sklerozën aortike.
D) insuficiencën e valvulës pulmonare.
E) stenozën e valvulës aortal.
PS)D

Pyetja 601 V)1

Me termin metaplazi kuptojmë:

A) rritjen e volumit te një indi për shkak të rritjes volumetrike të elementëve përbërës qelizorë.
B) transformimin e një indi në një tjetër, në kuadër të të njëjtit izotip.
C) rritjen e volumit të një indi për shkak të rritjes numerike të elementëve përbërës qelizorë
D) një proliferim qelizor që paraqet një karakter atipik.
E) degjenerimin neoplazik te një indi.
PS)B

Pyetja 602 V)2

Cila prej situatave të mëposhtme nuk kontribuon në formimin e edemës pulmonare?

A) infuzioni i tepruar i salinës
B) bllokimi i drenazhit limfatik në një zonë të pulmonit
C) pamjaftueshmëria ventrikulare e majtë
D) përqëndrimi i lartë i proteinave plasmatike
E) hipertensioni pulmonar
PS)D

Pyetja 603 V)2

Terapia me elektroshok bëhet për:

A) të përmirësuar perfuzionin kardiak.
B) të rritur kontraksionin kardiak.
C) asistolinë.
D) të eliminuar fibrilacionin ventrikular.
E) të ndërprërë një bllok A-V nga digitali.
PS)D

Pyetja 604 V)2

Diagnoza e endometriozës vendoset në bazë të:

A) anamnezës.
B) ekzaminimit objektiv.
C) historisë së infertilitetit.
D) dozimit serik të CA 125.
E) vizualizimit direkt të lezioneve endometriale dhe biopsisë.
PS)E

Pyetja 605 V)1

Cili nga pohimet për splenomegalinë nuk është i saktë?

A) Mund të jetë asimptomatike.
B) Mund të shkaktojë çrregullime të gjumit, në rast të fjetjes i kthyer në krahun e majtë.
C) Mund të shkaktojë shenja të ngopjes së hershme.
D) Mund të shkaktojë dhembje në rast infarkti.
E) Mund të shkaktojë dhembje muskulare.
PS)E

Pyetja 606 V)2

Gjendjet e mëposhtme mund të lidhen me hipernatreminë me përjashtim të:

A) hipocorticosurrenalismit.
B) diabetit insipid.
C) diuretikës osmotike.
D) ushqyerjes me sondë.
E) alterimit të ndjenjës së etjes tek të moshuarit.
PS)A

Pyetja 607 V)2

Cili prej agjentëve infektive të mëposhtëm nuk është shkak malformacioni embrio-fetal?

A) Virusi i rubeolës
B) Herpes virusi
C) Toxoplasmosa gondii
D) Gardnerella vaginalis
E) Citomegalovirusi
PS)D

Pyetja 608 V)3

Në hiperkolesterolemínë esenciale vërehet përgjithësisht:

A) hiperglicemi.
B) ulje e uricemisë.
C) hiperkalemi.
D) incidencë e lartë e koronaropative.
E) lipuri.
PS)D

Pyetja 609 V)2

Cilat janë rrugët metabolike kryesore të vendosura në mitokondrie?

A) hidroliza lisosomiale
B) sinteza e steroideve
C) sinteza proteinike

D) vetëm zinxhiri i transportit të elektroneve
E) zinxhiri i transportit të elektroneve dhe cikli i acidit trikarboksilik
PS)E

Pyetja 610 V)1

Depolarizimi miokardiak ventrikular provokon:

A) kontraksion atrial.
B) dekontraksion atrial.
C) arrest kardiak.
D) dekontraksion ventrikular.
E) kontraksion ventrikular.
PS)E

Pyetja 611 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtëme që lidhen me lipoproteinat me densitet të ulët (LDL) është i gabuar?

A) Ekziston një receptor specific për LDL.
B) LDL nuk janë aterogjenë.
C) Përqëndrimi plazmatik i LDL është i përcaktueshëm me një formulë matematike nëse trigliceridet janë më të ulëta se 400 mg/dl.
D) LDL nuk përmbajnë apoproteinë A1.
E) LDL plazmatike kanë përqëndrim më të lartë se HDL.
PS)B

Pyetja 612 V)2

Në studimet klinike të kontrolluara, randomizimi është një proçedurë në gjëndje të garantojë që:

A) futja e një pacienti në një grup trajtimi merr parasysh opinionin e eksperimentuesit për trajtimin më të përshtatshëm për atë pacient.
B) futja e një pacienti në një grup trajtimi merr parasysh opinionin e pacientit.
C) efekti placebo i një medikamenti eleminohet.
D) nuk kemi bias që i detyrohen sjelljes së ndryshme të intervistuesve ndaj përfaqësuesve të ndryshëm të grupeve të ndryshme të trajtimit.
E) futja e një pacienti në një grup trajtimi bëhet në mënyrë rastësore në mënyrë që të minimizohet influenca e faktorëve të mundshëm konfondues.
PS)E

Pyetja 613 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtme që lidhen me interesismin renal gjatë ecurisë së një LED (Lupus Eritematoz i Diseminuar) është i saktë?

A) Një sëmundje renale me sinjifikancë klinike paraqitet në 90% të pacientëve me LED.
B) Nefriti është një rezultat i rrallë i biopsisë renale.
C) Biopsia renale mund të mos jetë e nëvojshme tek pacientët me sediment aktiv dhe me përkeqësim progresiv te funksionalitetit renal.
D) Interesimi renal është i rrallë tek pacientët me titër të lartë të antikorpeve anti-ADN me helike të dyfishtë.
E) Ekzaminimi i urinës në LED zakonisht zbulon proteinuri por jo hematuri apo të tjera alterime të sedimentit.
PS)C

Pyetja 614 V)1

Substrati energjik që përdoret në mënyrë preferenciale nga truri është:

A) acidi laktik.
B) glukoza.
C) acidet yndyrore.
D) aminoacidet.
E) oksigjeni.
PS)B

Pyetja 615 V)2

Në pankreas, ishujt Langerhans janë:

A) të shpërndara në mënyrë uniforme.
B) më të shumta në kokë.
C) më të shumta në qafë.
D) më të shumta në bisht.
E) më të shumta në procesin unkinat.
PS)D

Pyetja 616 V)1

Në edemën pulmonare akute kuadri klinik karakterizohet nga këto shenja dhe simptoma, me përjashtim të:

A) hematurisë.
B) dispnesë së rëndë.
C) rale krepitante.
D) ekspektorat me shkumë me stria gjaku.
E) ndjenjës së vdekjes së pashmangshme.
PS)A

Pyetja 617 V)2

HDL:

A) transportojnë kolesterolin nga periferia në hepar.
B) transportojnë kolesterolin nga hepari në indin adipoz.
C) çlirojnë kolesterolin në arterie.
D) transportojnë trigliceridet nga hepari në indin adipoz.
E) transportojnë glicolipidet nga hepari në intestin
PS)A

Pyetja 618 V)1

Venulat:

A) janë një vend i rëndësishëm për rregullimin e rezistencës ndaj fluksit.
B) janë një rezervë aktive e gjakut.
C) janë impermeabël për molekulat e mëdha dhe të vogla.
D) kanë diameter të njëjtë me arteriolat.
E) nuk janë të inervuara.
PS)B

Pyetja 619 V)2

Në rastin e hemofilisë mungon:

A) faktori VIII.
B) faktori VI.
C) faktori VII.
D) faktori IX.
E) faktori V.
PS)A

Pyetja 620 V)2
Me cilën etiologji është i pajtueshëm ekzaminimi i mëposhtëm i likuorit cerebrospinal; 250 limfocite/ml, rritje të nivelit të proteinave (protidorrachia) dhe ulje të nivelit të glukozës (glikorrachia)?
A) Ameba
B) Meningokoku
C) H.influenzae
D) Herpes virus simplex
E) Tbc
PS)E

Pyetja 621 V)2

Duke mos pasur në dispozicion një antibiogramë, cilin prej antibiotikëve të mëposhtëm do të zgjidhje si më aktivin ndaj stafilokokëve?

A) ceftazidimë
B) piperacilinë
C) amoxilillina +ac.clavulanic
D) claritromicina
E) metronidazol
PS)C

Pyetja 622 V)1

Në shokun septik, në ndryshim nga shoku kardiogjen dhe shoku hemorragjik, paraqiten të gjitha gjendjet e mëposhtme, me përjashtim të njërës prej tyre. Cila është ajo?

A) diureza mbahet më gjatë për shkak të vasodilatacionit renal
B) lëkura është shumë shpesh e ngrohtë
C) lëkura është shumë shpesh e ftohtë
D) paraqitet shpesh si komplikacion Koagulimi Intravazal i Diseminuar
E) pulmoni tipik i shokut
PS)C

Pyetja 623 V)2

Frekuenca e prezantimit podalik është:

A) 1-2%.
B) 3-4%.
C) 5-6%.
D) 7-8%.
E) 9-10%.
PS)B

Pyetja 624 V)2

Një shfaqje tranzitore e papulave eritematoze mund të manifestohet në:

A) difteri.
B) mononukleozë infektive.
C) sëmundja Hodgkin.
D) sëmundja Still.
E) sëmundja Felty.
PS)D

Pyetja 625 V)1

Në miksedemë tek adulti mund të evidentohet në aparatin kardiovaskular:

A) takikardi.
B) tone kardiake vibruese.

C) shkurtim i sistolës mekanike.
D) versament perikardial.
E) kontraksion miokardial hiperdinamik.
PS)D

Pyetja 626 V)1

Apendisiti akut tek fëmijët është shkaku më i shpeshtë i abdomenit akut?

A) Vetëm tek latanti.
B) Po.
C) Jo.
D) Vetëm tek fëmijët nën një vjeç.
E) Vetëm tek fëmijët në moshën e pubertetit.
PS)B

Pyetja 627 V)1

Enzima konvertuese e angiotenzinës gjëndet shpesh e rritur:

A) në sarcoidozë.
B) në insuficiencë hepatike.
C) në hipertension arterial.
D) në insuficiencë renale.
E) në tuberkuloz.
PS)A

Pyetja 628 V)2

Cilat kategori gjenesh mund të përfshihen në zhvillimin e një neoplazie?

A) onkogjene dhe antionkogjene
B) vetëm onkogjene
C) vetëm antionkogjene
D) gjene që kodojnë proteinë mitokondriale
E) antigene
PS)A

Pyetja 629 V)2

Në prani të versamentit pleural masiv, cilën situatë objektive presim të takojmë?

A) fremitus vocalis i rritur në palpim.
B) tingull i qartë gjatë përkusionit të toraksit.
C) fremitus vocalis i zbutur në palpim.
D) zhurmë vezikulare e përforcuar.
E) zhurmë vezikulare normale.

PS)C

Pyetja 630 V)2

Në gradimin e statusit të performancës sipas Eastern Cooperative Oncology Group (ECOG) grada 5 korrespondon me:

A) pacient fizikisht aktiv, në gjendje për të zhvilluar pa kufizime aktivitetin normal preterapeutik.
B) pacient të vdekur.
C) pacient në gjendje të kujdeset për veten, por i paaftë të zhvillojë aktivitet normal pune.
D) pacient që ka nevojë për shtrim në spital.
E) mosekzistencën e gradës së 5-të.
PS)B

Pyetja 631 V)2

Kur ekzistojnë gjëndje të urgjencës dhe në rast rreziku për jetën për një person që nuk mundet për momentin të shprehë vullnetin e tij, mjeku:

A) duhet të japë asistencën dhe mjekimin e domosdoshëm.
B) duhet të konsultohet paraprakisht me mjekun kurues.
C) duhet të delegojë asistencën dhe mjekimin në strukturat e ndërhyrjes shëndetësore urgjente.
D) duhet të kërkojë konsensin e të afërmëve dhe vetëm në rast se e merr këtë të japë asistencën e mjekimin.
E) duhet të kërkojë mendimin e Autoriteteve Juridike.
PS)A

Pyetja 632 V)1

Tek disa pacientë të prekur nga skleroza multiple vërehet një titër antikorpal i rritur ndaj cilit prej këtyre viruseve:

A) Herpes simplex
B) Virusi i fruthit
C) Virusi i rubeoles
D) Virusi i coriomeningitit
E) Citomegalovirus
PS)B

Pyetja 633 V)2

Njësia anatomo-funksionale e tiroides quhet:

A) lobul.
B) acinus.

C) folikul.
D) operkulum.
E) alveolë.
PS)C

Pyetja 634 V)1

Shprehja "revolving door" kujt i referohet?

A) përdorues i institucionalizuar prej një kohe të gjatë.
B) përdorues që nuk praktikojnë shtrime të shpeshta dhe të shkurtra.
C) përdorues me aftësi të kufizuara të rënda në fushën e kompetencave sociale.
D) pacientë me shtrime të shpeshta.
E) pacientë që shtrohen për periudha të shkurtra.
PS)D

Pyetja 635 V)1

Niveli normal i Shpejtesisë së Eritro Sedimentimit është:

A) 0-15mm/orë në meshkujt; 0-20 tek femra.
B) 50-100mm/min.
C) edhe variacione të mëdha nga niveli i normales nuk janë domethënëse.
D) 0-50mm/orë në meshkujt, 0-60 në femrat
E) llogaritet sipas formulës: moshë ± 10
PS)A

Pyetja 636 V)2

Cila prej gjëndjeve të mëposhtme rezulton e lidhur me sëmundjen nga refluksi gastroesofageal?

A) infeksioni nga H.pylori
B) prolaps i valvulës mitrale
C) stenozë laringeale
D) kancer i laringut
E) astma kardiake
PS)A

Pyetja 637 V)2

Anhidraza karbonike në nivel të qelizave të tubulave renale vërehet të jetë e lidhur me përthithjen:

A) aminoacide.
B) acid laktik.
C) ujë.

D) bikarbonate.
E) karbohidrate.
PS)D

Pyetja 638 V)1

Mitokondriet e qelizave steroidosintetizuese janë:

A) të ngjashme me mitikondriet e gjithë qelizave.
B) paraqesin cresta të quajtura vesiculare.
C) nuk paraqesin cresta.
D) paraqesin struktura të kalcifikuara në membranën eksterne.
E) gjithmonë të kondensuara.
PS)B

Pyetja 639 V)2

Octopamina është:

A) një hormon.
B) një lipid.
C) një neurotransmetues i dobët.
D) një sheqer.
E) një proteinë.
PS)C

Pyetja 640 V)1

Kur shfaqet dhimbja abdominale në isheminë celiac-mesenterike kronike?

A) pas pak sekondash nga marrja e ushqimit
B) pas afro 2 orësh nga marrja e ushqimit
C) nuk është e lidhur me marrjen e ushqimit
D) pas 15-40 minutash nga marrja e ushqimit
E) në kohë të ndryshme nga marrja e ushqimit sipas llojit të ushqimit të marrë
PS)D

Pyetja 641 V)1

Cili tip sëmundjeje koronare është më i shpeshtë?

A) sëmundja e traktit të parë të trungut koronar kryesor
B) sëmundja që përfshin traktin e parë të arterieve koronare dhe venave kardiake
C) sëmundja distale difuse
D) sëmundja e arterieve nga përcjellshmëria dhe resistenza
E) sëmundja e arterieve marginale
PS)A

Pyetja 642 V)1

Çfarë janë prionet?

A) entitete proteinike
B) qeliza prokariotike
C) qeliza eukariotike
D) protozoare
E) metazoare
PS)A

Pyetja 643 V)1

Zgjatja mesatare e ciklit menstrual është:

A) 22 ditë.
B) 25 ditë.
C) 28 ditë.
D) 35 ditë.
E) 38 ditë.
PS)C

Pyetja 644 V)1

Cili prej diuretikëve të mëposhtme konsiderohet si ruajtës i kaliumit?

A) acidi etacrinic
B) clortalidoni
C) amiloridi
D) furosemidi
E) hidroklortiazidi
PS)C

Pyetja 645 V)2

Skorbuti paraqet një gjendje:

A) kequshqyerje proteinike-energjike.
B) kequshqyerje proteinike.
C) mungesë të vitaminës C.
D) mungesë e vitaminës D.
E) defiçit i folateve.
PS)C

Pyetja 646 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtëm është i gabuar?

A) Angiotensina II shkakton vasokonstriksion për shkak të një veprimi direkt në arteriolat prekapilare.
B) Angiotensina II antagonizon efektet e aldosteronit.
C) Angiotenzina II shkakton hipertrofi dhe rimodelim të strukturave kardiovasulare.
D) Receptori AT1 i angiotenzinës II bashkohet me një proteinë G.
E) Lidhja e angiotenzinës II me receptorin AT2 frenohet në mënyrë specifike nga sartanët
PS)B

Pyetja 647 V)2

Komplementemia reduktohet në cilin prej glomerulopative të mëposhtëm?

A) nefropatia diabetike
B) glomerulonefriti postinfektiv
C) glomerulonefriti membranoz
D) nefropatia gjatë amiloidozes
E) glomerulonefriti me lezione minimale
PS)B

Pyetja 648 V)1

Metaplazia skuamoze e epitelit bronkial, hipertrofia e gjëndrave mucipare dhe reduktimi i klirensit muko-ciliare sugjerojnë:

A) pneumoni virale.
B) pneumoni lobare.
C) pneumoconioze.
D) bronkit kronik.
E) ARDS.
PS)D

Pyetja 649 V)2

Disqet intervertebrale formohen nga:

A) kartilago hialine.
B) kartilago fibroze.
C) ind kockor spongioz.
D) ind kockor kompakt.
E) ind lidhor dens.
PS)B

Pyetja 650 V)2

Një deficit i forcës muskulare të ekstremiteteve, kryesisht distale me defiçit të ndjeshmerisë me shpërndarje "si çorape" dhe/ose "si dorezë" me reflekse osteotendinale të ulura, të bën të dyshosh për:

A) interesim primar të muskujve.
B) një lezion të motoneuronit primar.
C) një interesim simetrik e bilateral të nervave periferike, veçanërisht të trungjeve me të gjata.
D) lezion kordonal të fascies spino-talamike dhe kortiko-spinale.
E) lezion të kordonëve posteriore.
PS)C

Pyetja 651 V)1

Pacienti me Leucemi Limfoide Kronike mund të vdes për arsye të:

A) aplazisë medulare.
B) krizës blastike.
C) shkaqeve infektive ose hemorragjike.
D) rupturës së lienit.
E) insuficiencës kardiorespiratore.
PS)C

Pyetja 652 V)1

Shenja klinike tipike e sindromit nefrotik është:

A) cianoza.
B) takicardia.
C) arefleksia OT.
D) cefale "cluster".
E) edema përiferike.
PS)E

Pyetja 653 V)2

Hormonet e mëposhtme kanë të gjithë strukturë steroide, me përjashtim të:

A) glucagonit.
B) kortisolit.
C) estradiolit.
D) testosteronit.
E) aldosteronit.
PS)A

Pyetja 654 V)1

Trupat e Negrit janë të pranishme në:

A) ethen e verdhë.
B) hepatit viral.
C) rabies.
D) toksoplasmozë.
E) malarie.
PS)C

Pyetja 655 V)1

Cila metodë është më e mirë për të vlerësuar një steatorre ?

A) Testi i sakarozës
B) Testi me xilosës
C) Dozimi kripërave biliare
D) Dozimi i yndyrnave fekale
E) Biopsi e intestinit
PS)D

Pyetja 656 V)1

Cila është neoplazia kutane më malinje midis këtyre?

A) karcinoma skuamocelulare
B) melanoma
C) karcinoma basoqelizore
D) cheratoacantoma
E) fibroma
PS)B

Pyetja 657 V)2

Cili prej elementëve të mëposhtëm nuk është një neurotrasmetues?

A) acetilcolina
B) noradrenalina
C) penicilina
D) dopamina
E) 5-hidroxitriptamina
PS)C

Pyetja 658 V)1

Në cilën prej gjëndjeve është e rrallë të takohet një reduktim i C3?

A) gromerulonefriti akut post-streptokoksik
B) nefropatia me depozitime mesangiale të IgA (sëmundja Berger)

C) nefriti lupus
D) nefriti i lidhur me hepatitin B
E) nefriti nga shunti i infektuar ventrikulo-atrial
PS)B

Pyetja 659 V)2

Aura:

A) është një simptomë e depresionit.
B) paraprin një krizë epileptike.
C) është një simptomë e skizofrenisë.
D) është një ide obsesive.
E) është një delir melankolik.
PS)B

Pyetja 660 V)2

Më poshtë renditën efektet anësore të medikamenteve antinflamatore jo steroide, me përjashtim të:

A) intolerancës gastro-intestinale
B) frenimit të agregimit trombocitar
C) rritjes të motilitetit uterin
D) nefrotoksicitetit
E) reaksionit të hipersensibilitetit.
PS)C

Pyetja 661 V)1

Cili është efekti i padëshërueshem më i rëndë i closapinës?

A) diskinezia e vonshme
B) konstipacion
C) shenja ekstrapiramidale
D) agranulocitosa
E) hipotensioni
PS)D

Pyetja 662 V)1

Bilirubina prodhohet nga:

A) katabolizmi i bilës.
B) lidhja e albuminës me hemoglobinën.
C) katabolizmi i transferinës.
D) degradimi i hemit.

E) sinteza e vitaminës B12.
PS)D

Pyetja 663 V)2

Patologjia nodulare e tiroides studiohet më së pari me:

A) Rx te qafës për indet e buta.
B) Stratigrafia.
C) Tomografi të kompiuterizuar (CT scaner).
D) Rezonacë magnetike MRI.
E) Ekografia .
PS)E

Pyetja 664 V)2

Stimulimi i receptorëve të trupit të arteries karotide në trup të shkaktuar nga një hipoksi jep:

A) rritje të ventilimit pulmonar.
B) reduktim të presionit arterial.
C) nuk e modifikon presionin dhe volumin e gjakut.
D) reduktim të frekuencës respiratore.
E) reduktim të ventilimit pulmonar.
PS)A

Pyetja 665 V)2

Në sindromin obstruktiv pulmonar kronik të tipit emfisematos (pink-puffer) takohet shpesh:

A) dispne e fortë.
B) cianozë e rëndë.
C) plethora.
D) diametra të rritur kardiake.
E) hematokrit mbi 60%.
PS)A

Pyetja 666 V)2

Janë shkaqe të shpeshta të etheve, fillimisht të interpretuara si ethe me shkaqe të panjohura, gjendjet e mëposhtme me përjashtim të:

A) tiroidit subakut.
B) limfoma Hodgkin.
C) granulomatosa Wegener.
D) SIDA.
E) hipotiroidismit.
PS)E

Pyetja 667 V)1

Purpura trombocitopenike idiopatike kronike jo simptomatike trajtohet kur vlerat e trombociteve janë:

A) ndërmjet 20 dhe 30 x 10 3 / microL.
B) nën 20 x 10 3 / microL.
C) ndërmjet 30 dhe 50 x 10 3/ microL.
D) ndërmjet 50 dhe 100 x 10 3/ microL.
E) midis 100 dhe 150 x 10 3/ microL.
PS)B

Pyetja 668 V)1

Kolesteroli:

A) influencon fluiditetin e membranave.
B) është pa grupe polare.
C) qarkullon në gjak pa ndërhyrjen e lipoproteinave.
D) sintetizohet ekskluzivisht.
E) derivon nga hormone steroide.
PS)A

Pyetja 669 V)2

Acidi hialuronik:

A) është një proteoglikan.
B) është një glukozaminoglikan.
C) është një molekulë e sulfuruar e matriksit ekstraqelizor.
D) është një proteinë e matriksit ekstraqelizor.
E) është një glikoproteinë.
PS)B

Pyetja 670 V)1

Kuadri klinik që përfshin takipne, frymemarrje sibilante, dispne kryesisht ekspiratore mund të jetë e pajtueshme me:

A) pneumoni nga virusi respirator sincizial.
B) sarkoidozë.
C) tuberkuloz.
D) atak astmatik.
E) edemë pulmonare .
PS)D

Pyetja 671 V)1

Rruga kryesore e administrimit të amfotericinës B për trajtimin e infeksionit sistemik është:

A) endovenoze.
B) rektale.
C) orale.
D) intramuskulare.
E) subkutane.
PS)A

Pyetja 672 V)1

Leucoplachia është:

A) një formë metaplazie.
B) një formë candidozë e kavitetit oral.
C) ulja e numrit të leukociteve qarkulluese.
D) një infeksion i rrugëve urinare.
E) një depigmentim i kufizuar i lëkurës ose i flokëve.
PS)A

Pyetja 673 V)1

Përcaktime të përseritura të kohës së protrombinës janë të nevojshme kur përdoret:

A) heparina.
B) dikumarolët.
C) diuretikët.
D) antihistaminikët.
E) dekstrani.
PS)B

Pyetja 674 V)1

Cili nga indikacionet e mëposhtme të albuminës humane nuk është i saktë?

A) për të përshpejtuar shërimin e plagëve
B) djegie
C) plasmafereza terapeutike
D) sindromi Lyell
E) hipoalbuminemia grave e neonatit
PS)A

Pyetja 675 V)1

Zgjerimi i hijes mediastinale në radiografinë e toraxit, orienton drejt një diagnozë për:

A) infarkt miokardi.
B) diseksion aorte.
C) stenozë mitrale.
D) insuficencë mitrale.
E) insuficencë tricuspidale.
PS)B

Pyetja 676 V)1

Çfarë është piopneumotoraxi?

A) Mbledhje gazi në kavitetin pleural me versament purulent.
B) Mbledhje gazi në kavitetin pleural me versament serik.
C) Mbledhje gazi në kavitetin pleural me versament hematik.
D) Versament purulent
E) Versament me origjinë tuberkulare.
PS)A

Pyetja 677 V)2

Kanabis administrohet zakonisht me rrugë:

A) intramuskulare.
B) endovenoze.
C) rektale.
D) inhalatore.
E) me nuhatje.
PS)D

Pyetja 678 V)2

Një 34 vjeçar, punonjës banke, ka sipas gjykimit tuaj një sëmundje tipike nga refluksi gastro-esofageal. Në se ai ju kerkon të jepni një përgjigje mbi evolucionin e mundshëm të patologjise së tij, ju do të shpreheshit se ai do të ketë:

A) një shërim të plotë e të qëndrueshem spontan.
B) një shërim të plotë e të qëndrueshem pas trajtimit me omeprazol.
C) një ecuri kronike, recidivante.
D) një përmirësim të ndjeshëm klinik pas çrrënjosjes së Helicobacter pylori.
E) një evolucion të pashmangshëm drej kancerit të laringut.
PS)C

Pyetja 679 V)1

Distimia është

A) një çrregullim i humorit.
B) një sëmundje e timusit.
C) një formë skicofrenie.
D) një ndërlikim i vaksinimit.
E) një sëmundje ekzantematike.
PS)A

Pyetja 680 V)2

Ndërlikimet e hipertensionit nuk përfshijnë

A) hipertrofi të miokardit dhe dekompensim kardiak.
B) hemorragji cerebrale.
C) hepatosplenomegali.
D) diseksion aorte.
E) nefrosklerozë dhe insuficencë renale.
PS)C

Pyetja 681 V)2

Sindromi i Adams-Stokes karakterizohet nga

A) sinkope si pasojë e bllokut AV të gradës III.
B) paralizë rekurente e facialit.
C) hematuri me proteinuri.
D) pneumoni rekurente.
E) fistul arterio-venoze.
PS)A

Pyetja 682 V)1

Cila nga neoplazitë malinje është e lidhur me ekspozimin ndaj amiantit:

A) karcinoma bronkogjene
B) karcinoma e ezofagut
C) limfoma Hodgkin
D) mesotelioma pleurale
E) sarcoma Kaposi
PS)D

Pyetja 683 V)1

Çfarë funksioni ka distrofina muskulare?

A) të lidhë actinën me miozinën
B) të inhibojë troponinën
C) të aktivizojë tropomiozinën

D) të lidhë kalciumin citoplazmatik
E) të lidhë aktinën me komplekset proteinike të membranës citoplazmatike
PS)E

Pyetja 684 V)1

Presioni sistolik i arteries pulmonare të një adulti normal është:

A) 25 mm Hg.
B) 75 mm Hg.
C) 50 mm Hg.
D) 5 mm Hg.
E) 120 mm Hg.
PS)A

Pyetja 685 V)2

Karcinoma hepatike është neoplazia me frekuente tek subjektet me:

A) cirrozë hepatike.
B) bronkopneumoni obstruktive kronike.
C) fibrozë pulmonare.
D) diatezë alergjike.
E) sëmundje Crohn.
PS)A

Pyetja 686 V)1

Medikamentet e mëposhtme përdoren në trajtimin e hipertiroidizmit, me përjashtim të:

A) metimazolit.
B) propiltiouracilit.
C) carbamazepinës.
D) carbimazolit.
E) jodit.
PS)C

Pyetja 687 V)1

Astrupograma është një ekzaminim i domosdoshëm për vendosjen e diagnozës së:

A) bronkitit kronik.
B) bronkopneumopatisë kronike obstruktive.
C) insuficencës respiratore.
D) fibrozës pulmonare.
E) astmës bronkiale.
PS)C

Pyetja 688 V)2

Medikamentet më efikase për uljen e përqëndrimit plazmatik të triglicerideve janë:

A) statinat.
B) probucoli.
C) fibratët.
D) rezinat sekuestruese të acideve biliare.
E) inhibitoret e lipazës pankreatike.
PS)C

Pyetja 689 V)2

Tek një pacient me deficit të Glukozë-6-Fosfat-Dehidrogenazës (G-6-PD), duhet të shamngë të gjitha të mëposhtmet, me përjashtim të:

A) cefalotinës.
B) chininës.
C) clorochinës.
D) bathëve.
E) sulfamidikëve.
PS)A

Pyetja 690 V)1

Cili nuk është një test i zakonshëm skrinues në një shtatëzani fillestare pa ndërlikime?

A) dozimi serik i hCG
B) hemoglobina
C) testi i rubeolës
D) Pap-test
E) grupi i gjakut dhe faktori Rh
PS)A

Pyetja 691 V)1

Koncepti i delirit konsiston:

A) në mospërshtatjen me rregullat e bashkëjetësës sociale.
B) në një gabim gjykimi.
C) në alterim të vetëdijes për domethënien.
D) në rezistencë për të pranuar opinionet e zakonshme.
E) në këmbënguljen për bindjet e veta.
PS)C

Pyetja 692 V)2

Cili pohim është i saktë lidhur me mitokondriet?

A) Janë të pranishme në të gjitha qelizat prokariotike.
B) Nuk nderhyjnë në respiracionin qelizor.
C) Përmbajnë sasi të konsiderueshme mioglobine.
D) Përmbajnë ADN e Ribozome.
E) Akumolojnë perokside.
PS)D

Pyetja 693 V)2

Çfarë janë krizat "Grand mal"?

A) Kriza epileptike që zgjasin më shumë se 2 minuta.
B) Kriza konvulsive toniko-klonike.
C) Vetëm krizat që kanë një gjeneralizim sekondar.
D) Vetëm krizat shumë afër njëra tjetrës që paraprijnë gjendjen mal.
E) Vetëm krizat që shoqërohen me incontinencë sfinkterike.
PS)B

Pyetja 694 V)1

Kalemia rritet në cilën prej këtyre gjëndjeve ?

A) sëmundja Addison
B) diarre
C) dehidrim
D) të vjella
E) sindromi Conn
PS)A

Pyetja 695 V)1

Një apendisit retro-cecal shoqërohet shpesh:

A) me volvulus gastrik.
B) me dhembje të tipit kolik të referuar në hipokondrin e majtë.
C) me dhembje që përkeqësohet të referuar në nivel të shpatullës së majtë.
D) me dhembje therëse në nivel testikular.
E) me dhembje në ijen e djathtë
PS)E

Pyetja 696 V)1

Cili nuk është një indikacion për fibrobronkoskopinë?

A) vlerësim i mukozave bronkiale
B) heqje e tapave të dendura të mukusit
C) biopsia e neoplazive endobronkiale
D) trajtim i hematemezës
E) diagnoza e neoplazive bronkiale
PS)D

Pyetja 697 V)1

Pneumocystis carinii është përgjegjës për:

A) gastroenteritin neonatal.
B) infeksionin materno-fetal.
C) meningoencefalitin në SIDA.
D) pneumoninë në immunodefiçiensë.
E) limfogranuloma veneriane.
PS)D

Pyetja 698 V)1

Alterimi i parë glomerular që shfaqet në diabetin mellitus është:

A) trashja e membranës bazale.
B) glomerulosklerozа fokale.
C) humbja e pediceleve dhe podociteve
D) depozitimi i fibrinës.
E) glomerulonefriti fokal
PS)A

Pyetja 699 V)2

Aldosteroni:

A) rrit sekretimin urinar të kaliumit.
B) rrit sekretimin urinar të kaliumit tek pacientë në të cilët enzima konvertuese e angiotenzinës është e inhibuar në mënyrë farmakologjike.
C) përqëndrimi plazmatik i tij rritet në rast të hipokalemisë.
D) redukton sekretimin urinar të kaliumit.
E) nuk është në gjendje të influencojë kaliurinë.
PS)A

Pyetja 700 V)2

Hipoventilimi që shoqëron depresionin e qendrës së frymëmarrjes, jep:

A) hipoksi dhe hipokapni.
B) hipoksi dhe hiperkapni.

C) pO2 normal dhe hiperkapni.
D) reduktim të saturimit të hemoglobinës.
E) rritje të eksesit të bazave.
PS)B

Pyetja 701 V)1

Cili prej ekzaminimeve të mëposhtme është më i indikuari në studimin e një pacienti me sklerozë multiple?

A) tomografia aksiale e kompjuterizuar
B) rezonanca magnetike nukleare
C) angiografia e vazave të qafës
D) schitigrafia cerebrale
E) angiografia digitale me subtraksion
PS)B

Pyetja 702 V)1

Në traumat splenike cili prej ekzaminimeve diagnostike mund të përdoret:

A) cistografia.
B) urografia.
C) ekografia abdominale.
D) tomografia e komjuterizuar (CT scan) cerebrale.
E) klizma opake.
PS)C

Pyetja 703 V)2

Çfarë është hiposmia?

A) ulja e nuhatjes
B) humbja e nuhatjes
C) mungesa e acidit osmik
D) mungesa oksigjenit në gjak
E) ulje e osmolaritetit hematik
PS)A

Pyetja 704 V)1

Cila nga të mëposhtmet nuk është pasojë e mundshme e diabetit në gravidancë?

A) aborti në trimestrin e parë
B) vonesë në rritjen intrauterinë
C) polyhidramnios
D) placenta previa

E) macrosomia fetale
PS)D

Pyetja 705 V)1

Çfarë është frymëmarrja Kussmaul?

A) një dispne me stridor laringeal
B) një respiracion me bronkospazëm
C) një respiracion më i thellë dhe më i shpeshtë se ai normal
D) një respiracion gërhitës me rale krepitante në baza
E) një respirim gërhitës pa rale krepitante në baza
PS)C

Pyetja 706 V)2

Diferencimi i limfociteve T CD4+ në limfocite TH2 vjen në përgjigje të:

A) baktereve intraqelizore.
B) viruseve.
C) helmintëve dhe alergenëve.
D) fungeve.
E) superantigenëve
PS)C

Pyetja 707 V)2

Cili prej neurotransmetuesve më poshtë është një polipeptid?

A) endorfina
B) histamina
C) acetilkolina
D) dopamina
E) serotonina
PS)A

Pyetja 708 V)2

Për diagnozën e anemisë falciforme zgjidh testin më të mirë të skrinimit gjenetik për individualizimin e saj:

A) Kulturë e qelizave te likidit amniotik
B) Kampione të gjakut fetal
C) alfa-fetoproteina e likidit amniotik
D) Përqëndrimi kimik i urinës materne
E) Ekografia
PS)B

Pyetja 709 V)1

Episodi depresiv më shpesh është:

A) një formë autizmi infantil i hershëm.
B) një formë skizofrenie.
C) një simptomë e alkoolizmit kronik.
D) një çrregullim i humorit.
E) një sindromë abstinence nga abuzimi me analgjezike.
PS)D

Pyetja 710 V)2

Pruriti i gjeneralizuar pa manifestime të një dermopatie vërehet me frekuencë të lartë në cilën nga këto gjendje?

A) hiperparatiroidizëm
B) ulcera gastro-duodenale
C) Limfoma Hodgkin
D) pertusis
E) hepatiti joikterik
PS)C

Pyetja 711 V)2

Rezonanca magnetike nuk mund të praktikohet:

A) tek latantët.
B) tek klaustrofobikët.
C) tek mbajtësit e një pacemaker.
D) tek pacientët e operuar.
E) tek pacientët me transplant organesh.
PS)C

Pyetja 712 V)1

Një zhurmë e idiopatike karakterizohet kryesisht nga cila prej këtyre gjendjeve?

A) tip sistolik > se grada IV e shkallës së Levine
B) difuzion i gjerë
C) fremitus - dridhje
D) tip diastolik
E) tip sistolik, i shkurtër me frekuencë uniforme
PS)E

Pyetja 713 V)2

Shkaku me i shpeshtë i atelektazës pulmonare lobare është:

A) infarkti pulmonar.
B) pneumoni pneumokoksike.
C) pneumoni virale.
D) inhalim i materialit alimentar.
E) bronkektazia.
PS)B

Pyetja 714 V)2

Cili është shkaku kryesor i edemës në insuficencën kardiake?

A) oksigjenim i reduktuar i indeve
B) rritja e presionit venoz
C) reduktim i presionit koloido-osmotik
D) alterim i funksionit renal
E) alterim i funksionit hepatik
PS)B

Pyetja 715 V)1

Në sindromin restriktiv kemi në përgjithësi një frekuencë respiratore të rritur, për shkak se:

A) rezistencat e rrugëve ajrore janë të reduktuara.
B) rezulton më pak e lodhshme lëvizja e një volumi të ulët për çdo akt respirator.
C) rezistenca e rrugëve ajrore nuk rritet me frekuencën e frymëmarrjes.
D) tensioni sipërfaqësor i alveolave mbetet i ulët në volume të ulëta.
E) në inspiracion të thellë presioni intrapleural ka negativitet normal.
PS)B

Pyetja 716 V)2

Ekzistojnë dy tipe të palcës së kockave ajo e kuqe dhe ajo e verdhë. Cili prej pohimeve mbi vetitë që i dallojnë ato është i vërtetë?

A) Palca e verdhë është hemopoetikisht më aktive se e kuqja.
B) Palca e verdhë përmban më shumë adipocite.
C) Në neonatët gjëndet vetëm palcë e verdhë.
D) Në kraniumin e adultit gjëndet vetëm palcë e kuqe.
E) Komponentët fibrozë të stromës së dy tipeve të palcës janë të ndryshme.
PS)B

Pyetja 717 V)1

Cili nga pohimet mbi infeksionin primar nga HIV (sindroma retrovirale akute) është i vërtetë?

A) Manifestimet klinike përfshijnë ethe, cefale, limfadenopati.
B) Niveli viremik është shumë i lartë.
C) Mund të kemi një ulje të ndjeshme të nivelit të CD4 edhe nën 200/mm3.
D) Mund të përjashtohet me anë të diagnozës diferenciale nëse testi për kërkimin e antitrupave anti-HIV që kryhet 1 javë pas shfaqjes së simptomave rezulton negativ.
E) Janë të pranishme simptomat neurologjike
PS)D

Pyetja 718 V)2

Cila prej karakteristikave mbi IgM është e gabuar?

A) Janë pentamere.
B) Fiksojnë komplementin.
C) Janë Ig e para të prodhuara në përgjigje të infeksioneve.
D) Nuk janë të pranishme në sekrecione.
E) Kalojnë placentën.
PS)E

Pyetja 719 V)2

Cili prej subjekteve nuk mund të pranohet si dhurues gjaku ?

A) I transfuzuar me dy njësi të gjakut autolog gjatë një ndërhyrje kirurgjikale të kryer dy vjet më parë.
B) Referon një raport seksual me pagesë, të pambrojtur shumë vite më parë
C) Ka marrë imunoglobulinën anti-hepatit tre vjet më parë
D) Ka kryer një lindje një vit më parë
E) Një i ri që ka kryer një tatuazh së fundmi
PS)E

Pyetja 720 V)1

Cila nga anomalitë imunologjike nuk lidhet me infeksionin nga HIV?

A) numri i reduktur i qelizave T4 (helper) në qarkullim
B) raport i qelizave T4 dhe T8 (suppressore) > 1
C) anergji kutane ndaj antigjenëve të zakonshëm në testet kutane
D) funksion i ulur i qelizave T-citotoksike
E) funksion i shtuar i beta2-mikroglobulinave
PS)B

Pyetja 721 V)2

Vasa chilifere e pranishme në vilet intestinale ka funksionin e:

A) përthithjes së proteinave.
B) kontributit në motilitetin e vileve.
C) përthithjes së karbohidrateve.
D) përthithjes së yndyrnave.
E) rritjes së sipërfaqes së përthithjes.
PS)D

Pyetja 722 V)2

Receptorët adrenergjik alfa:

A) nuk janë të përfshirë në tkurrjen e arteriolave kutane.
B) janë të përfshirë në shtimin e frekuencës kardiake të induktuar nga noradrenalina.
C) stimulohen nga noradrenalina dhe adrenalina.
D) mund të dallohen me mikroskop elektronik nga receptorët beta.
E) janë të pandjeshme ndaj efekteve të medikamenteve
PS)C

Pyetja 723 V)2

Në cilat prej gjëndjeve të mëposhtme nuk indikohet përdorimi i opiateve?

A) diarrea
B) kolla
C) dhimbje me origjinë tumorale
D) astma bronkiale
E) edemë pulmonare
PS)D

Pyetja 724 V)1

Në stenozën subaortike hipertrofike idiopatike, cili nga pohimet e mëposhtme është i gabuar?

A) Është një hipertrofi asimetrike e septit IV që pengon daljen e fluksit nga ventrikuli i majtë.
B) Rritja e kontraktimit është një faktor rëndues.
C) Reduktimi i volumit ventrikular është një faktor agravues.
D) Reduktimi i pasngarkeses së majtë përmireson situatën.
E) Reduktimi i frekuencës përmirëson situatën.
PS)D

Pyetja 725 V)3

Karditi në ethen reumatizmale akute në mënyrë tipike prek:

A) endokardin, miokardin dhe perikardin.
B) vetëm endokardin.
C) vetëm valvulat.

D) vetëm perikardin.
E) vetëm miokardin.
PS)A

Pyetja 726 V)2

Një izotop i hekurit përkufizohet si:

A) një atom me të njëjtin numër protonesh dhe numër të ndryshëm elektronesh.
B) një atom me të njëjtin numër protonesh dhe numër të ndryshëm neutronesh.
C) një atom me të njëjtin numër elektronesh dhe numër të ndryshëm protonesh.
D) një atom me numër të ndryshëm lidhjesh kovalente.
E) një atom me të njëjtin numër protonesh e neutronesh, por numër të ndryshëm elektronesh.
PS)B

Pyetja 727 V)1

Një pacient 58 vjeçar, me një histori 5 vjeçare të angina pectoris dhe një infakt miokardi recent, shtrohet në spital për një gjendje emergjence serioze hipertensive. Cili nga këta medikamente do të ishte më i miri për t'u përdorur në kete pacient?

A) diazoxidi
B) nifedipina
C) minoxidili
D) labetaloli
E) hidralazina
PS)D

Pyetja 728 V)1

Një lezion i nukleusëve bazale mund të shkaktojë shenjat e mëposhtme me përjashtim të:

A) lëvizjeve jo të vullnetshme.
B) rigiditët.
C) tremor.
D) paralizë flakside.
E) humbje e lëvizjeve automatike shoqëruese.
PS)D

Pyetja 729 V)1

Terapia me beta bllokues është e kundërindikuar në rastin e:

A) hipertensionit të lehtë dhe/ose të moderuar.
B) aritmisë.
C) hipertensionit të rëndë.

D) astmës.
E) gastritit.
PS)D

Pyetja 730 V)2

Kalcitonina:

A) është një hormon steroid.
B) sintetizohet në qelizat C të paratiroides.
C) është një hormon hiperkalcemizues.
D) sekretohet në rast hiperkalcemie.
E) sekretohet në rats hipokalcemia.
PS)D

Pyetja 731 V)1

Shunti arterio-venoz shkakton:

A) dekompensim kardiak me hedhje të ulët.
B) rritje të rezistencave periferike.
C) rritje të rezistencave pulmonare.
D) dekompensim kardiak me hedhje të lartë.
E) pakësim të kontraktimit.
PS)D

Pyetja 732 V)1

Toni kardiak mund të jetë i mbytur në të gjitha situatat e mëposhtme, me përjashtim të:

A) versamentit perikardial.
B) miokardiosklerozës.
C) stenozës mitrale.
D) emfizemës pulmonare.
E) obezitetit.
PS)C

Pyetja 733 V)1

Mediatori kimik më i rëndësishëm i sindromës urtikarie - angioedemë është:

A) heparina.
B) serotonina.
C) histamina.
D) faktori aktivizues i trombociteve.
E) Slow Reacting Substances of Anaphilaxis (SRS-A).
PS)C

Pyetja 734 V)2

Cili nga ekzaminimet këshillohet gjatë dyshimeve për patologji inflamatore të sinuseve kraniale?

A) Tomografia e Compjuterizuar
B) Rezonanca Magnetike
C) Rx craniale
D) Ortopantomografia
E) Stratigrafia
PS)C

Pyetja 735 V)2

Shkaku më i shpeshtë i bronkiolitit tek fëmijët është:

A) Virusi parainfluezal 1-2-3.
B) Adenovirusi.
C) Virusi respirator sincizial.
D) Coxackie virus.
E) Echovirus.
PS)C

Pyetja 736 V)2

Tomografia e Compjuterizuar (CT-scan) është një ekzaminim më i ndjeshëm se Rezonanca Magnetike (RMN) për cilën nga gjendjet e mëposhtme?

A) një tumor i fosës posteriore
B) një meningeomë parasagitale e kalcifikuar
C) sklerozën multiple
D) sklerozën media temporale
E) sëmundjen Binswanger
PS)B

Pyetja 737 V)1

Në cilën prej hemopative të mëposhtme është më evidente Adenomegalia dhe Splenomegalia?

A) leukemia akute megaloblastike
B) policitemia vera
C) leukemia limfatike kronike
D) leukemia akute promielocitare
E) trombocitopenia primare
PS)C

Pyetja 738 V)2

Hiperplazia glandulare cistike e endometrit i detyrohet:

A) një stimulimi të zgjatur me estrogjen
B) një stimulimi të zgjatur me progesteron
C) një endometriti
D) një endometriozë
E) një karcinome të qafës së uterusit
PS)A

Pyetja 739 V)1

Cili prej indikatorëve të mëposhtëm laboratorike është tipik për osteomalacinë?

A) hiperkalcemia
B) hiperfosforemia
C) hiperkalciuria
D) hiperfosforemia
E) rritja e fosfatazës alkaline serike
PS)E

Pyetja 740 V)2

Cili nuk është shkaku i njohur i pankreatitit akut?

A) kolelitiaza
B) alkooli
C) kolangiopancreatografia retrograde me endoskopi
D) kirurgjia laparotomike
E) infeksioni nga virusi i parotitit
PS)D

Pyetja 741 V)1

Tek pacientin anurik, rreziku i pashmangshëm për jetën është:

A) depletimi i natriumit.
B) hiponatremia.
C) hipoproteinemia.
D) hiperkalemia.
E) hipertensioni.
PS)D

Pyetja 742 V)1

Në një skoliozë lumbare me konveksitet djathtas gjatë ekzaminimit me Rx shihen fusha me formë trekëndëshi:

A) të pandryshueshme.
B) të zvogëluara në anën e djathtë.
C) të zvogëluar në anën e majtë.
D) të zvogëluara të dyja.
E) të zhdukura të dyja.
PS)B

Pyetja 743 V)1

Çfarë janë pedikulozat?

A) Sëmundje kutane bakteriale
B) Sëmundje kutane parazitare
C) Sëmundje kutane protozoare
D) Sëmundje kutane nga funget
E) Sëmundje kutane nga arbovirus
PS)B

Pyetja 744 V)1

Krizat tireotoksike mund të kerkojnë trajtim me:

A) digital.
B) betabllokues.
C) A+B+D.
D) propiltiouracil.
E) tiroxina.
PS)C

Pyetja 745 V)1

Krisma e hapjes (snap opening) është një e dhënë nga auskultacioni, që flet për:

A) insufiçiensë pulmonare.
B) stenozë aortale.
C) stenozë trikuspidale.
D) stenozë mitrale.
E) insufiçiensë aortale.
PS)D

Pyetja 746 V)1

Rritja fiziologjike e VES (shpejtësia e eritrosedimentimit) në shtatzani i detyrohet:

A) uljes së gamaglobulinave.
B) rritjes së betaglobulinave.
C) rritjes së fibrinogjenit plazmatik.
D) rritjes së transferinës.
E) rritjes së prolaktinës.
PS)C

Pyetja 747 V)2

Kurba e presionit-volumit të aparatit respirator të lejon të masësh:

A) pajtueshmërinë (kompliancën) torako-pulmonare.
B) rezistencën e rrugëve ajrore.
C) kapacitetin vital.
D) kapacitetin funksional rezidual.
E) volumin e mbylljes.
PS)A

Pyetja 748 V)2

Antitrupat janë:

A) proteina.
B) nukleotide.
C) polisaharide.
D) aminoacide.
E) nukleoproteina.
PS)A

Pyetja 749 V)1

Një element i domosdoshëm në historikun e pacientëve që diagnostikohen për sëmundjen Behcet është prania e:

A) simptomave të koronaropatisë.
B) paralizave të nervit cranial, të mëparshme ose aktuale.
C) eritemës nodoze.
D) ulcerave orale.
E) fenomenit Reynaud me nekroza të ekstremiteteve.
PS)D

Pyetja 750 V)1

Cila prej karakteristikave të mëposhtme është indikatori më i mirë i malinjitetit të një neoplazie?

A) Pleomorfizmi

B) Atipia
C) Invazioni lokal
D) Rritja e volumit nukleo/citoplazmik
E) Nekroza
PS)C

Pyetja 751 V)2

Në një kompresion (shtypje) diskale, shenja më e hershme zakonisht është:

A) dhembja.
B) parestezia.
C) paraliza.
D) inkontinenca.
E) anestezia perineale.
PS)A

Pyetja 752 V)2

Prova e Perthes shërben për të verifikuar:

A) qartësinë e aksit venoz të thellë dhe përmbajtjen e venave perforante.
B) ekzistencën e një aneurizme.
C) qartësinë e aksit venoz superficial.
D) ekzistencën e një fistule arterio-venoze.
E) përmbajtjen e valvulës safeno-femorale.
PS)A

Pyetja 753 V)1

Sindromi i hiperviskozitetit vërehet me shpesh gjatë:

A) anemisë hemolitike autoimune.
B) leukemisë limfoide kronike.
C) insufiçiensës respiratore kronike.
D) sëmundjes Waldenstrom.
E) hemoglobinopatisë.
PS)D

Pyetja 754 V)2

IQ (Intelligence Quotient) në epilepsitë esenciale është:

A) gjithmonë me i ulët se mesatarja e normës.
B) gjithmonë shumë më i ulët se mesatarja e normës.
C) përgjithësisht më i ulët se mesatarja e normës.
D) përgjithësisht më i lartë se mesatarja e normës.

E) përgjithësisht normal.
PS)E

Pyetja 755 V)1

Cili nga citimet në lidhje me pirozën (djegjen retrosternale) nuk është i saktë?

A) Ka vendosje retrosternale.
B) Shpesh përhapet në grykë
C) Është e lidhur me veprimin e lëngjeve acide ose bilës në mukozën esofageale.
D) Koha tipike e shfaqjes është në distancë 5-6 ore nga vakti.
E) Përmirësohet me përdorimin e anti-acideve.
PS)D

Pyetja 756 V)2

Një limfonodul i fortë, jo dolent gjatë presionit, i vendosur në këndin e mandibulës, lidhet shpesh me një metastazë nga neoplazia:

A) gastrike.
B) esofageale.
C) bronkiale.
D) tiroidjane.
E) linguale.
PS)E

Pyetja 757 V)2

Cilat hormone prodhohen nga qelizat Delta të pankreasit?

A) Gastrina e somatostatina
B) Insulina
C) Glucagoni
D) Insulina e glucagoni
E) Gastrina e glucagoni
PS)A

Pyetja 758 V)2

Cili nga këto ushqime mund të përdoret nga pacienti i prekur nga Celiachia, sepse nuk përmban gluten?

A) grurë
B) oriz
C) elb
D) tërsherë
E) triticale (hibrid i bashkimit të grurit me thekrën)

PS)B

Pyetja 759 V)1

Një prej elementëve të mëposhtëm nuk hyn në kuadrin klinik të hemorragjisë?

A) Zbehje e lëkurës dhe e mukozave
B) Ftohje e ektremiteteve
C) Hipertension arterial
D) Djersë të ftohta
E) Ndjenjë etje
PS)C

Pyetja 760 V)2

Në sindromën hepato-renale:

A) urina është shpesh hematurike.
B) kolesterolemia është e rritur.
C) diureza i kalon 1500 ml/ditë.
D) diureza është më e ulët se 300ml/ditë.
E) glukozuria është e qëndrueshme.
PS)D

Pyetja 761 V)3

Shenjat e hipertensionit portal janë:

A) rritja e kalibrit të vena porta.
B) hipoalbuminemi.
C) dispne.
D) hipertrigliceridemi.
E) steatozë hepatike.
PS)A

Pyetja 762 V)1

Tek pacientët me emfizemë pulmonare nga Bronkopneumopatia Ostruktive Kronike (BPCO) vërehen alterimet e mëposhtme me përjashtim të:

A) rritjes së kapacitetit pulmonar total.
B) reduktimit të FEV1 (forced expiratory volume).
C) rritjes të volumit residual.
D) rritjes të kapacitetit vital.
E) difuzionit të gazeve të mbetura.
PS)D

Pyetja 763 V)2

Një simptomatologji e karakterizuar për të paktën tre muaj nga dhembje abdominale që lehtësohet nga defekimi dhe/ose e shoqëruar me modifikim të frekuencës së evakuacionit dhe/ose modifikim të konsistencës së feçeve sugjeron cilën diagnozë?

A) Celiachia
B) Crohn
C) Rektokolit ulceroz
D) Sindromi i zorrës së irrituar
E) Ulçera duodenale
PS)D

Pyetja 764 V)1

ECG (Electrokardiografia) në hipertensionin pulmonar paraqet

A) hipertrofi të ventrikulit sinister.
B) bllok i degës sinister.
C) BAV (bllok atrio-ventrikular) i gradës II.
D) hipertrofi e ventrikulit dexter.
E) ulçerës duodenale.
PS)D

Pyetja 765 V)2

Cila nga teknikat diagnostike imazherike, nuk është e dobishme në diagnozën e stenozës së arteries renale?

A) angiografia
B) eco-color-doppler
C) angiografia dhe rezonanca magnetike
D) pielografia retrograde ascendente
E) shintigrafia renale
PS)D

Pyetja 766 V)1

Mbijetesa trombocitare mesatare është:

A) 10 ditë.
B) 20 ditë.
C) 5 ditë.
D) 120 ditë.
E) 15 ditë.
PS)A

Pyetja 767 V)1

Haluçinacionet organike:

A) prekin vetveten dhe janë të pozicionuara brenda trupit.
B) janë shprehje e një patologjie organike dhe janë të kritikuara nga pacienti.
C) verëhen më shpesh në lezionet parietale.
D) përcaktojnë ndjenja të largimit nga vetja dhe nga ambienti.
E) konsiderohen një simptomë neurologjike.
PS)B

Pyetja 768 V)1

Macula është:

A) vendi i visionit të qartë (clear vision) dhe ku fotoreceptorët përfaqësohen nga qelizat e koneve.
B) vendi i visionit të qartë dhe ku fotoreceptorët përfaqësohen nga qelizat e shkopinjve.
C) zona ku kalojnë fibrat nervore të neuronëve multipolare që përbëjnë nervin optik.
D) zonë pa fotoreceptorë e quajtur edhe "pika e verbër e retinës."
E) zona që shënon buzën anteriore të pjesës optike të retinës.
PS)A

Pyetja 769 V)1

Medikamentet psikotropike mund të japin efekte anësore ?

A) Gjithmonë pavarësisht nga tipi dhe doza.
B) Pothuajse kurrë.
C) Jo, po shpesh këto shenja formohen nga vetë pacientët
D) Po.
E) Jo.
PS)D

Pyetja 770 V)2

Placenta lejon kalimin nga qarkullimi matern dhe atij fetal të:

A) IgG.
B) IgM.
C) IgA.
D) të gjithë isotipet antikorpale.
E) asnjë isotip antikorpal.
PS)A

Pyetja 771 V)1

Çfarë kuptojmë me frekuencë të tingullit?

A) timbrin
B) dallimin dëgjimor
C) numrin e toneve të pastra
D) pragun e degjueshmërisë
E) numrin e oshilacioneve në sekond (Hz)

PS)E

Pyetja 772 V)2

Cila prej gjëndjeve të mëposhtëme materne nuk lidhet me polihidramnios?

A) Izoimunizimi Rh

B) Hipertiroidizmi

C) Preeclampsia

D) Nefropatia

E) Diabeti mellitus

PS)B

Pyetja 773 V)1

Cili është shkaku më i shpeshtë i embolisë arteriale?

A) prania e një aneurizme aortale

B) fibrilacioni atrial

C) prania e disa pllakave ateromatoze të ulçeruara

D) administrimi i medikamenteve kemioterapeutike

E) prania e një sindromi nga anitrupa antifosfolipidike

PS)B

Pyetja 774 V)2

Autizmi infantil hyn në çrregullimet:

A) e përhapura të zhvillimit (pervasive developmental disorder).

B) të ankthit.
C) të humorit.
D) psikike.
E) të personalitetit.
PS)A

Pyetja 775 V)1

Cila nga përberjet nuk ka aktivitet antioksidant?

A) vitamina A
B) vitamina C
C) vitamina E
D) vitamina K
E) glutationi
PS)D

Pyetja 776 V)2

Vendi i prodhimit më të madh të kalcitoninës në gjitarët është:

A) stomaku.
B) pankreasi.
C) tiroidja.
D) surrenalja.
E) hipofiza.
PS)C

Pyetja 777 V)2

Nuk konsiderohet si faktor risku në sëmundjet kardiovaskulare:

A) hipertensioni arterial.
B) dislipidemite.
C) jeta sedentare.
D) diabeti mellitus.
E) fenilketonuria.
PS)E

Pyetja 778 V)2

Në osteoporozë kuadri radiologjik tregon:

A) ulje të transparencës së kockes në Rx.
B) rritje të transparencës së kockës në Rx.
C) aspekt i pandryshuar i kockës.
D) aspekt i kolonës si druri i bambusë.

E) sklerozë e kortikaleve.
PS)B

Pyetja 779 V)2

Cili prej lezioneve të mëposhtme mund të takohet në scabbien humane?

A) pika të zeza
B) tunele
C) njolla vitiligoje
D) purpur
E) scutulae
PS)B

Pyetja 780 V)2

Antileukotrienët indikohen në trajtimin e Bronkopneumopatisë Obstruktive Kronike?

A) Jo.
B) Po, të shoqëruar me antikolinergjike.
C) Po, të shoqëruar me kortikosteroide me rrugë inhalatore.
D) Po, vetëm në prani të riakutizimit të sëmundjes.
E) Po, vetëm në fazë stabilizimi të sëmundjes.
PS)A

Pyetja 781 V)1

Cilët janë medikamentet kryesore të përdorura në kontrollin e bronokonstriksionit në pacientët me astmë kronike?

A) beta 2 antagonistët me veprim të shkurtër
B) beta 2 antagonistët me veprim të gjatë
C) teofilinat
D) kortikosteroide me rrugë inhalatore
E) kortikosteroide me rrugë sistemike
PS)B

Pyetja 782 V)1

Sindroma Budd-Cjiari shkaktohet nga:

A) obstruksion i arteries hepatike.
B) obstruksion i venave suprahepatike.
C) obstruksion i venës porta.
D) një neoplazi e duktusit hepatik comun.
E) deficienca e vitaminës A.
PS)B

Pyetja 783 V)1

Cili pohim mbi tetraciklinën është i saktë?

A) Konsiderohet si e sigurtë për t'u përdorur në shtatzëni.
B) Rekomandohet për t'u përdorur tek fëmijët.
C) Duhet të administrohet I shoqëruar me antiacide.
D) Janë të dobishme për trajtimin e infeksioneve nga Rickettsie
E) Nuk prodhojnë rezistencë bakteriale.
PS)D

Pyetja 784 V)2

Fibroza cistike transmetohet me karakter:

A) autosomal reçesiv.
B) autosomal dominant.
C) e lidhur me kromozomin X.
D) e lidhur me kromozomin Y.
E) kodominante.
PS)A

Pyetja 785 V)1

Medikamentet psikotrope:

A) mundësojnë shërimin definitiv të sëmundjes mendore.
B) lejojnë mosmarrjen parasysh të aspekteve psicosociale të pacientit.
C) përfaqësojnë një terapi simptomatike të çrregullimeve psikike.
D) janë të padobishme në trajtimin e skizofrenisë.
E) janë analgjezike.
PS)C

Pyetja 786 V)1

Në cilën prej gjëndjeve feçet kanë ngjyrë të çelët dhe aspekt me shkumë?

A) gastrit me Helicobacter pylori pozitiv
B) colit ulceroz
C) hepatit akut
D) divertikul i colonit
E) insufiçiensë pankreatike
PS)E

Pyetja 787 V)1

Në artritin reumatoid është i pranishëm

A) spina bifida.
B) pectum carinatum.
C) noduli Heberden.
D) dora reumatoide.
E) nyje rakitike (rachitic rosary).
PS)D

Pyetja 788 V)2

Ku derdhen venat pulmonare?

A) në atriumin e djathtë
B) në venën jugulare
C) në atriumin e majtë
D) në ventrikulin e djathtë
E) në venën cava superior
PS)C

Pyetja 789 V)2

Edemat nefrotike varen nga:

A) reduktimi i presionit onkotik dhe hiperaldosteronizmi sekondar.
B) rritja e presionit venoz.
C) rritja e fluksit limfatik.
D) rritja e aktivitetit të reninës plazmatike.
E) rritja e katekolaminave qarkulluese.
PS)A

Pyetja 790 V)1

Defektet e mbylljes së tubit neural përcaktojnë:

A) keqformime të harqeve vertebrale dhe të Sistemit Nervor Qendror.
B) megakolon kongenital (sëmundja hirschprung).
C) formimin e fistulave onfalomesenterike.
D) qartësinë e kanalit neuroenterik.
E) hipoplazi medulare.
PS)A

Pyetja 791 V)2

Një e dhënë thelbësore në vlerësimin klinik të një gjendjeje të kequshqyerjes është:

A) anamneza alimentare.

B) prania e diarresë.
C) proteinemia totale dhe elektroforeza.
D) ekzaminimi sasior i feceve.
E) Rx i intestinit.
PS)A

Pyetja 792 V)2

Cila prej neoplazive të sferes genitale femërore ka incidencë më të madhe?

A) kanceri i cervixit
B) kanceri i endometrit
C) karcinoma e vulvës
D) karcinoma e vaginës
E) tumori i ovarit
PS)B

Pyetja 793 V)2

Poliglobulia mund të provokohet nga:

A) hepatiti viral.
B) sëmundja e Cooley.
C) hipoksia indore.
D) hemoglobinuria paroksistike.
E) terapia me vitaminë B12.
PS)C

Pyetja 794 V)1

Cila nga sëmundjet e mëposhtme gjenetike shoqërohet me dislipidemi të fenotipit IIA?

A) disbetalipoproteinemia
B) hiperkolesterolemia familjare
C) hipobetalipoproteinemia
D) hipertrigliceridemia familjare
E) hipertrigliceridemia mikse
PS)B

Pyetja 795 V)1

Sinkopi karakterizohet nga:

A) një defiçit neurologjik focal tranzitor.
B) një defiçit neurologjik focal permanent.
C) kontraksione toniko-klonike.
D) humbje e papritur e vetëdijes.

E) konfuzion mental
PS)D

Pyetja 796 V)2

Cila nga gjendjet e mëposhtme nuk shoqërohet me një zgjatje të kohës së hemorragjisë?

A) uremia
B) trombocitopenia grave
C) cirroza hepatike me tromboctopeni
D) hemofilia
E) sëmundja von Willebrand
PS)D

Pyetja 797 V)2

Efektet e oksitoksinës:

A) në uterus nuk janë të dokumentuara.
B) në mamelë konsistojnë në një veprim stimulues për prodhimin e qumështit
C) në mamelë konsistojnë në një zhvillim të shtuar te duktuseve dhe të alveolave.
D) në uterus potencohen nga estrogjenët.
E) konsistojnë në një veprim të hormonit në membranën qelizore duke modifikuar permeabilitetin ndaj joneve të klorit.
PS)D

Pyetja 798 V)1

Shkakton bllok të receptorëve alfa-adrenergjike postsinaptike dhe redukton presionin arterial:

A) chinidina.
B) mazindoli.
C) noradrenalina.
D) prazosina.
E) fenilefrina.
PS)D

Pyetja 799 V)2

Manifestimet e mëposhtme klinike te një anemie nga mungesa e Vitaminës B12 janë te gjitha të rikthyeshme me marrjen e Vitaminës B12, me përjashtim të:

A) dëmtimit të medulës spinale.
B) anemisë.
C) neutropenisë.
D) neuropatisë periferike.
E) trombocitopenisë.

PS)A

Pyetja 800 V)1

Në onkologji, terapia Adiuvante:

A) administrohet për te përmiresuar cilësinë e jetës së pacientit onkologjik.
B) përdoret për të reduktuar toksicitetin e terapisë onkologjike.
C) përdoret për të reduktuar nauzenë që i detyrohet kemioterapisë.
D) administrohet pas trajtimit loco-regional për te reduktuar riskun për metastaza.
E) përdoret për të reduktuar masën tumorale.
PS)D

Pyetja 801 V)1

Çfarë është hidrocefalia?

A) akumulim i likidit në sistemin ventrikular
B) shtim i masës cerebrale
C) shtim i likidit extraqelizor
D) mungesë zhvillimi e hemisferave cerebrale
E) defekt i mbylljes së tubit neural
PS)A

Pyetja 802 V)1

Amiloridi është:

A) një diuretik i ansës.
B) një kursyes/ruajtes i kaliumit.
C) një diuretik tiazidik.
D) një inhibitor i anhidrazës karbonike.
E) një diuretik osmotik.
PS)B

Pyetja 803 V)2

Somatostatina:

A) është një peptid linear.
B) është aktiv në hemorragjinë nga variçet e ezofagut.
C) inhibon çlirimin e histaminës por jo të gastrinës.
D) nuk ka veprime direkte në qelizat parietale.
E) ka efekt proaritmik.
PS)B

Pyetja 804 V)1

Cila nga pohimet nuk është i saktë?

A) Karcinoma hepatoqelizore është më e zakonshme në pjesen jug-lindore të Azisë.
B) Karcinoma hepatoqelizore është më e zakonshme tek femrat.
C) Karcinoma hepatoqelizore lidhet shpesh me nivelin e lartë serik te alfa-fetoproteinës.
D) Karcinoma hepatoqelizore shoqërohet me cirrozë.
E) Karcinoma hepatoqelizore infiltron shpesh venën porta.
PS)B

Pyetja 805 V)2

Një rekuperim i ngadaltë drejt vlerave në qetësi të frekuencës kardiake pas një sforcimi fizik të fortë:

A) përfaqëson një përgjigje normale fiziologjike te organizmit.
B) është tregues se kemi të bëjmë me një individ te pa stërvitur.
C) pasqyron një patologji kardiake.
D) pasqyron një patologji të sistemit nervor autonom.
E) është tregues se kemi të bëjmë me një individ te stërvitur mirë.
PS)B

Pyetja 806 V)1

Tek një pacient me sindrom nefrotik:

A) incidenca e infeksioneve është e rritur
B) gjejmë hipokolesterolemi.
C) shfaqet diabeti mellitus.
D) përfitimi nga infuzionet e albuminës është i rëndësishëm
E) përgjithësisht gjejmë hiponatremi.
PS)A

Pyetja 807 V)1

Cili prej këtyre fungeve është shkaku më i shpeshtë i pneumonisë intersticiale në hostin me sindromën e imunodefiçiensës së fituar?

A) Candida albicans
B) Pneumocystis carinii
C) Cryptococcus neoformans
D) Aspergillus fumigatus
E) Histoplasma capsulatum
PS)B

Pyetja 808 V)2

Çfarë funksioni ka aparati juxtaglomerular?

A) kontrollon sekrecionin renal te fosfateve
B) sekreton reninën
C) sekreton angiotenzinën
D) përgjigjet ndaj rritjeve të kalemisë
E) rregullon permeabilitetin glomerular
PS)B

Pyetja 809 V)2

Cila nga gjendjet nuk lidhet me praninë e krioglobulinave serike?

A) mieloma multiple
B) tiroiditi autoimun
C) glomerulonefriti
D) cirroza alkoolike
E) sindroma Cushing
PS)E

Pyetja 810 V)1

Sasia më e madhe e energjisë përftohet në formën e ATP-së nga metabolizmi i:

A) karbohidrateve.
B) acideve yndyrore.
C) proteinave.
D) etanolit.
E) kolesterolit.
PS)B

Pyetja 811 V)1

Dizenteria bacilare është një infeksion i karakterizuar kryesisht nga të vjella dhe diarre. Cili është agjenti etiologjik?

A) Shigella
B) Entoameba hystolitica
C) Schistostomi
D) Rinovirusi
E) Arbovirusi grupi B
PS)A

Pyetja 812 V)1

Cili është shkaku me i shpeshtë i një ikteri obstruktiv?

A) kompresioni "ab extrinsec"(i jashtëm)
B) lezioni jatrogjen
C) neoplazia jatrogjene
D) neoplazia e kokës së pankreasit
E) inflamacioni i rrugëve biliare ekstrahepatike
PS)A

Pyetja 813 V)2

Cili prej proçeseve të mëposhtme metabolike nuk ndodh në eritrocite?

A) fosforilimi oksidativ
B) glicoliza
C) cikli i pentoze fosfatit
D) prodhimi i glutationit te reduktuar
E) prodhimi i laktatit
PS)A

Pyetja 814 V)2

Është Diabeti një faktor risku për vaskulopatitë cerebrale?

A) Po.
B) Vetëm në se është i dekompensuar.
C) Jo.
D) Po, kur pacienti përdor insulinë.
E) Po, kur pacienti merr hipoglicemiant oral.
PS)A

Pyetja 815 V)2

Në kancerin e pulmonit "jo me qeliza te vogla", cili prej stadeve paraqet prognozën më të keqe për 5 vjet?

A) T1 N0 M0
B) T2 N0 M0
C) T1 N1 M0
D) T1 N2 M0
E) T3 N0 M0
PS)D

Pyetja 816 V)2

Cili test rezulton pozitiv në aneminë hemolitike autoimune ?

A) testi i Coombs Direkt
B) testi me helmin e nepërkës Russel

C) autohemoliza
D) testi Ham
E) testi Pearls
PS)A

Pyetja 817 V)2

Shenja Gower (shenja e ngjitjes) gjatë kalimit në pozicion të drejtë, takohet në:

A) miasteni.
B) sindromin Guillain Barre.
C) distrofia muskulare Duchene.
D) polineuropatia kronike familjare.
E) distonia
PS)C

Pyetja 818 V)1

Demenca micromultinfarktuale:

A) është një demencë sekondare e një alterimi progresiv të pemës arteriale cerebrale.
B) është një demencë sekondare e një procesi encefalitik viral.
C) është një demencë sekondare e një procesi infektiv sifilitik.
D) është një demencë sekondare e një procesi septicemik.
E) është një demencë sekondare e një procesi traumatik multipël.
PS)A

Pyetja 819 V)2

Cili prej pohimeve është i gabuar? Në një atak Adams-Stokes vihet re:

A) zhdukje për disa minuta e toneve kardiake.
B) cianoze progresive.
C) aura që paraprin atakun.
D) konvulsione.
E) humbje e vetëdijes me fiksim të pupilave.
PS)C

Pyetja 820 V)1

TRH (thyrotropin releasing hormon) është një hormon që rregullon sintezën e:

A) insulinës.
B) TSH (thyroid stimulating hormon).
C) kortisol.
D) ACTH (adrenocorticotropic hormon).
E) parathormon.

PS)B

Pyetja 821 V)3

Cila është shtrirja e dendësimit pulmonar në pneumoninë pneumokoksike?

A) panlobulare
B) bilaterale
C) lobare ose sublobare
D) intersticiale
E) apikale
PS)C

Pyetja 822 V)3

Forma biologjikisht aktive e vitaminës D është:

A) kolecalciferoli.
B) 24-hidroksicolecalciferoli.
C) 25-hidroksicolecalciferoli.
D) 1,25-dihidroksicolecalciferoli.
E) 24,25 dihidroksicolecalciferoli.
PS)D

Pyetja 823 V)2

Një tregtar lëkurësh, 53 vjeç, ankon një dhembje të papritur shumë të fortë abdominale, fillimisht në epigaster, më tej të shpërndarë dhe të shoqëruar me takikardi, djersitje, hipotension. Pas rreth 30 min, edhe pse dhimbja persiston, duket te jetë më pa
A) ulçer peptike e perforuar.
B) infarkt intestinal.
C) apendisit akut.
D) kolecistit akut.
E) pankreatit akut.
PS)A

Pyetja 824 V)1

Çfarë qëndrimi duhet të mbajë një mjek përpara një pacienti 70 vjec, me risk te lartë, mbartës të një aneurizme të aortës abdominale me diameter 4 cm?

A) ta adresojë në çdo rast tek kirurgu.
B) të ndjekë evolucionin duke përsëritur arteriografinë cdo 6 muaj
C) të ndjekë evolucionin me metoda jo invasive
D) të qetësoje pacientin duke përjashtuar ekzaminimet mjekësore
E) të praktikojë terapinë me antikoagulante për gjithë jetën
PS)C

Pyetja 825 V)2

Rezistenca që i bën një enë gjaku fluksit hematik:

A) zvogëlohet me 1/8 e vlerës së saj bazë kur rrezja e vazës (r) dyfishohet.
B) varet nga trashësia e pareteve vazale (t).
C) zvogëlohet me rritjen e viskozitetit hematik (n).
D) është direkt proporcionale me gjatësinë e vazës (l).
E) është proporcionale me presionin e ushtruar nga jashte vazës.
PS)D

Pyetja 826 V)1

Në anamnezën e pacientëve kaukazjanë me pankreatit kronik cili nga elementët është ai që ndeshet më shpesh?

A) episode multiple te përsëritura te pankreatitit akut
B) familjariteti
C) fibroza cistike
D) konsum i shtuar i etanolit për më shumë se 10 vjet
E) konsum i shumtë i frutave
PS)D

Pyetja 827 V)2

Hepatokarcinoma nuk mund të shkaktojë:

A) produksion të bilës.
B) produksion të alfa-fetoproteinës.
C) metastazë pulmonare.
D) prodhim të mukusit.
E) hemoperitoneum.
PS)D

Pyetja 828 V)2

Cili është sot ekzaminimi më i dobishëm për diagnozën dhe trajtimin e kalkulozës së koledokut?

A) colangio- RMN (Resonanca Magnetike)
B) ecotomografia e abdomenit superior
C) colangiografia e.v
D) tomografi e kompiuterizuar (CT-Scaner)
E) kolangiopankreatografi endoskopike retrograde.
PS)E

Pyetja 829 V)2

Tek një person i moshuar një anësi e poshtme e shkurtuar, extrarotuar dhe abduktuar, të bën të mendosh

A) për një luxacion të artikulcionit koksofemoral.
B) për një frakturë të qafës së femurit.
C) për një metastazë në nivel të femurit.
D) për një artrozë të artikulacionit koksofemoral.
E) për një distorsion të koksofemoralit.
PS)B

Pyetja 830 V)2

Eritema nodoze është një manifestim karakteristik i:

A) pneumonisë streptokoksike.
B) sklerozës multiple.
C) sarkoidozës.
D) sklerodermisë.
E) fruthit.
PS)C

Pyetja 831 V)2

Cili medikament duhet t'i administrohet i pari pacientit me hiperkalemi dhe komplekse QRS të zgjatura në ECG?

A) kalcium glukonat
B) kayexalat
C) digoksinë
D) furosemid
E) bikarbonat natriumi
PS)A

Pyetja 832 V)3

Frakturat kostale mund të provokojnë komplikimet e mëposhtëm me përjashtim të

A) kontuzionit pulmonar.
B) pneumotoraksit.
C) hemotoraksit
D) hematemezës.
E) hemopneumotoraksit.
PS)D

Pyetja 833 V)2

Tek duhanpiresit e mbi 20 cigareve/ditë risku i zhvillimit të një kanceri pulmonar është e i lartë në krahasim me jo duhanpiresit

A) 5 herë
B) 12 herë
C) 30 herë
D) 50 herë
E) 2 herë
PS)C

Pyetja 834 V)2

Diseminimi (metastatizimi) cerebro-spinal vërehet me një propabilitet më të lartë në cilin tumor tipik për moshën e re?

A) medulloblastoma
B) adenoma hipofizare
C) astrocitoma tip IV (glioblastoma multiforme)
D) oligodendroglioma
E) kraniofaringeoma
PS)A

Pyetja 835 V)1

Në aneminë nga mungesa e hekurit, cili është ekzaminimi i vetëm që jep një vlerësim të sakte të rezervave të hekurit?

A) transferina serike
B) MCV
C) hemoglobina corpuscular media
D) hemoglobina
E) ferritina serike
PS)E

Pyetja 836 V)1

Çdonjëri nga medikamentet e mëposhtme mund te indikohet në trajtimin e angina pectoris me përjashtim të njërit:

A) isoproterenol
B) nitroderivate
C) clorotiazide
D) propranolol
E) kalçi-antagonistët
PS)A

Pyetja 837 V)1

Retikulociti:

A) është qeliza retikulare progenitore e hemopoezës.
B) është një eritrocit që akoma nuk ka flakur bërthamën.
C) është një eritrocit i ri me poliribozome
D) është një eritroblast i pranishëm në medulë.
E) është një eritrocit i plakur.
PS)C

Pyetja 838 V)1

Cila nga gjendjet e mëposhtme nuk jep cianozë?

A) shunt sinistro-dexter
B) lartësia
C) matahemoglobinemi
D) hipoventilim alveolar
E) difuzion i alteruar i oksigjenit
PS)A

Pyetja 839 V)1

Çfarë kuptohet me spasticitet?

A) një dobësi muskulare, mbi të gjitha distale, me origjinë nervore qëndrore
B) një rritje e tonusit muskular me hiperefleksi të thellë
C) një defekt i koordinimit muskular
D) një status kontraktimi tonik me spazma
E) një çrregullim i ecjes që përkeqësohet me mbylljen e syve
PS)B

Pyetja 840 V)1

Mikrorganizmat në urinë marrin një rol etiologjik për infeksion kur:

A) paraqesin një karakter të veçantë virulence
B) kalojnë një ngarkesë të caktuar për ml në urinë
C) janë antibiotiko-rezistente
D) janë Gram negative
E) janë prodhues të ureazës
PS)B

Pyetja 841 V)2

Cili prej këtyre medikamenteve nxit ovulacion në sindromën anovulatore?

A) nuk ekzistojnë medikamente që nxisin ovulacionin
B) ciproteroni
C) prednisolone
D) clomifene
E) estro-progestina
PS)D

Pyetja 842 V)2

Determinanti më i rëndësishëm i konsumit të O2 miokardial është:

A) presioni arterial sistolik
B) presioni arterial diastolik
C) kontraktiliteti miokardial
D) frekuenca kardiake
E) volumi ventrikular telediastolik
PS)D

Pyetja 843 V)3

Në një rast të dyshuar osteomieliti, rruga diagnostike më e përshtatshme për vendosjen e një diagnoze korrekte është:

A) radiografia standarte e segmentit kockor, shintigrafia kockore trifazike, shintigrafia me radiomedikamente specifike për infeksionin.
B) shintigrafia me radiomedikamente specifike për infeksionin
C) shintigrafi me (Tc-99m)-HMPAO
D) shintigrafi me radiokoloide
E) radiografi standarte e segmentit kockor
PS)A

Pyetja 844 V)1

Në hiperaldosteronizmin primar, cila është simptoma klinike më konstante midis këtyre?

A) arefleksia
B) hipertensioni arterial
C) krizat tetanike
D) aritmitë kardiake
E) paralizat periodike
PS)B

Pyetja 845 V)1

Mamaja e Anës, fëmijë 3 vjeç, ju sjell për të parë analizat që ka bërë për vajzën, në kuadër të një kontrolli rutinë: Hb 12; MCV 75; VES (eritrosedimenti) 10; Leukocite 10900; Neutrofile 37%, Limfocite 48%, Trombocite 200 000. Çfarë mendoni?

A) ka një infeksion të mundshëm viral.
B) ka një anemi mikrocitare.
C) ka një leukemi akute limfoblastike.
D) ka vlera hematologjike në nivele normale për moshën.
E) ka një infeksion të mundshëm bakterial.
PS)D

Pyetja 846 V)2

Kobalti është përbërës esencial:

A) i vitaminës B12.
B) i tiaminës.
C) i vitaminës B6.
D) i glukoze 6 fosfat dehidrogenazës.
E) i acidit folik.
PS)A

Pyetja 847 V)1

Klasa e imunoglobulinave e pranishme në sasi më të madhe në kulloshtër (qumështi i parë), përbëhet nga:

A) IgG
B) IgM
C) IgA
D) IgD
E) IgF
PS)A

Pyetja 848 V)2

Cili është antibiotiku i përzgjedhur për t'u përdorur në një subjekt alergjik ndaj penicilinës, i cili paraqitet me infeksion streptokoksik të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes?

A) eritromicina
B) tetraciklina
C) lincomicina
D) rifampicina
E) cefalosporina
PS)A

Pyetja 849 V)2

Cila substancë sekretohet nga qelizat beta të pankreasit?

A) insulina
B) glucagoni
C) somatostatina
D) VIP (vasoactiv intestinal polypeptide)
E) gastrina
PS)A

Pyetja 850 V)2

Amiloidoza mund të jetë një ndërlikim i:

A) fibromialgisë.
B) artrozës.
C) periartritit të shpatullës.
D) artritit reumatoid,
E) hernies diskale.
PS)D

Pyetja 851 V)3

Administrimi i përsëritur i furosemidit mund të çojë në efektet e mëposhtme anësore, me përjashtim të:

A) hiperkalcemi
B) hiperuricemi
C) hipokalemi
D) ototoksicitet
E) alkalozë
PS)A

Pyetja 852 V)2

Në një pacient me terapi me simvastatinë marrja e njëkohëshme e claritromicinës mund të shkaktojë:

A) gastralgi
B) shfaqje të miopatisë dhe rhabdomiolizës
C) çrregullime të akomodimit
D) cefale
E) vertigo
PS)B

Pyetja 853 V)2

Pasi është identifikuar një fetus në risk për një gravidancë që e ka kaluar afatin, menaxhimi me korrekt i situatës është:

A) amniocenteza për te vlerësuar pjekurinë pulmonare
B) lindje pamvarësisht nga kushtet e cervixit
C) kontroll i variacionit të pH duke testuar skalpin fetal
D) matje e somatomammotropinës korionike humane
E) përsëritje e një vlerësimi të mirëqënies fetale pas një jave
PS)B

Pyetja 854 V)2

Në cilën prej patologjive të mëposhtme kemi një kuadër histologjik te quajtur "qiell me yje":

A) leukemia limfoide akute
B) limfoma e padiferencuar
C) limfoma Hodgkin
D) limfoma Burkitt
E) limfosarcoma
PS)D

Pyetja 855 V)1

Cila prej gjendjeve mund të verifikohet në respiracionin qelizor?

A) elektronet sillen në një nivel te lartë energjitik nga rrezatimet diellore
B) formohet një gradient protonesh përgjatë membranës mitokondriale interne
C) elektronët migrojnë nga agjenti oksidues tek materiali i djegur
D) ulje e ngarkesës energjike të qelizës
E) sintetizohet anhidriti karbonik dhe uji
PS)B

Pyetja 856 V)2

Një prej enzimave te mëposhtme përdoret si indeks i lezionit muskular:

A) ATPaza
B) LDH
C) koenzima DPN
D) acetil CoA
E) CPK
PS)E

Pyetja 857 V)2

Limfocitet:

A) kanë veprim fagozitar
B) përbejnë rreth 20-40% të leukociteve
C) nuk janë të afta të lëvizin
D) nuk mund të transformohen në qeliza plazmatike
E) përbëjnë 1-2% te leukociteve
PS)B

Pyetja 858 V)2

Cili prej pohimeve mbi parandalimin e meningiteve bakteriale është i vërtetë?

A) Është disponibël një vaksinë antimeningokoksike kundër gjithë shtameve qarkullues.
B) Është disponibël një vaksinë e konjuguar kundër meningokokut C.
C) Vaksina antipneumokoksike 23-valente është shume efikase kur përdoret në fëmijët nën 3 vjeç
D) Është disponibël një vaksinë kunder meningokokut B.
E) Është disponibël një vaksinë e konjuguar kundër 13 shtameve të Pneumokokut.
PS)B

Pyetja 859 V)2

Për një vaginit nga moniliasis, cili është medikamenti më i përshtatshëm për trajtim:

A) gentamicina
B) miconazoli
C) dienestroli
D) sulfisoksasoli
E) deoksiciklina
PS)B

Pyetja 860 V)2

Paraliza faciale mund t'i detyrohet virusit:

A) të parotitit.
B) të herpes zoster.
C) të poliomielitit.
D) adenovirusit.
E) rubeolas.
PS)B

Pyetja 861 V)2

Degjenerimi hepato-lentikular i detyrohet:

A) rritjes së lipofuscinës në hepatocite
B) sintezës se reduktuar hepatocitare të ceruloplazminës

C) defekt i alfa-1-antitripsinës
D) shkatërrim të duktuseve biliare intrahepatike
E) intolerancë ndaj fruktozës
PS)B

Pyetja 862 V)2

Cila është simptoma më e zakonshme e endometriozës?

A) dhimbje pelvike
B) dhimbje retrosternale
C) cefale
D) temperaturë > 38?.
E) të vjella
PS)A

Pyetja 863 V)1

Risku Relativ (RR) është një matje epidemiologjike që përdoret për të vlerësuar:

A) incidencën e sëmundjeve në të ekspozuarit ndaj një faktori risku
B) incidencën e sëmundjeve në të paekspozuarit ndaj një faktori risku
C) prevalenca e sëmundjeve te të ekspozuarit ndaj një faktori risku
D) risku më i madh i sëmundjes në të ekspozuarit përkundrejt te paekspozuarve ndaj një faktori risku
E) raporti i fëmijëve të vdekur në vitin e parë te jetës ndaj totalit të fëmijëve të lindur gjallë
PS)D

Pyetja 864 V)1

Një prej medikamenteve të mëposhtme është aktiv në infeksionët nga Pseudomonas aeruginosa, por mund të japë ototoksicitet dhe nefrotoksicitet. Cili?

A) gentamicina
B) carbenicillina
C) cloramfenikoli
D) rifampicina
E) eritromicina
PS)A

Pyetja 865 V)2

Cianoza është e shpeshtë në të gjitha gjëndjet e mëposhtme me përjashtim të njëres:

A) poliglobulia
B) embolia pulmonare e shtrirë
C) metahemoglobinemia

D) ekzpozim i zgjatur në lartësi
E) anemia grave
PS)E

Pyetja 866 V)1

Antitrupat bashkohen me antigenin nëpërmjet:

A) regjionit të ndryshueshëm
B) fragmentit të kristalizueshëm
C) zinxhirit të rëndë
D) zinxhiri i lehtë
E) regionit cardin
PS)A

Pyetja 867 V)1

Nga se karakterizohet sindromi Mallory-Weiss

A) rupturë e esofagut
B) stenozë e esofagut
C) shoqërim të divertikulit esofageal dhe acalazisë
D) spazëm esofageale difuze
E) rupturë të mukozës esofageale
PS)E

Pyetja 868 V)2

Prania e indit endometrial jashtë kavitetit të uterusit quhet:

A) endometriozë
B) endoscopi
C) miomatoze
D) mola vesiculare
E) ovarioze
PS)A

Pyetja 869 V)2

Evolucioni i skoliozës tek adultët:

A) ndodh gjithmonë
B) nuk ndodh kurrë
C) verifikohet vetëm në format më të rënda
D) verifikohet vetëm në gratë gjatë gravidancës
E) vetëm tek të moshuarit
PS)C

Pyetja 870 V)3

EMG me age jep informacion rreth:

A) rrugëve piramidale
B) potencialit të njësive motore
C) shpejtësinë e përcjelljes nervore sensitive
D) shpejtësinë e përcjelljes nervore motore
E) gjendjen somatosensoriale
PS)B

Pyetja 871 V)3

Cilët faktorë NUK e rregullojnë sintezën e IgE-ve në një subjekt atopik:

A) limfocitet TH2
B) trashëgimia
C) natyra e antigenit
D) limfocitet TH1
E) histori natyrale e ekspozimit ndaj antigenit
PS)D

Pyetja 872 V)3

Antitrupat specifikë janë të kapshme në serumin e një individi në vijim të një kontakti me antigenin, më së pari pas:

A) 10 minutash
B) 1 ore
C) 5-7 ditësh
D) 4-5 javesh
E) pas një kontakti me antigenin
PS)C

Pyetja 873 V)2

Një grua 52 vjeç, alkoliste prej vitesh, referon në muajt e fundit dhimbje abdominale te përsëritura; një CT-scaner abdomeni demonstron një masë cistike me diametër 7-8 cm në nivel të bishtit të pankreasit. Cila është diagnoza më e mundshme?

A) pankreatit akut
B) pseudocist pankreasi
C) adenokarcinomë pankreasi
D) karcinoma metastatike
E) adenomë insulare
PS)B

Pyetja 874 V)2

Një pacient astenik, anemik, me dhimbje në epigaster dhe meteorizem postprondial të shoqëruar me ulje të oreksit. Në momentin e parë mendohet për një neoplazi gastrike. Cili është ekzaminimi më i përshtatshem në këtë rast për të konfirmuar diagnozën?

A) gastroscopi me ekzaminim
B) kërkim i gjakut okult në feçe
C) tomografi e kompjuterizuar në abdomenin superior
D) radiografi me kontrast e traktit digjestiv me sulfat bariumi radioopak
E) ekografi hepato-biliare dhe pankreatike
PS)A

Pyetja 875 V)1

Kolapsi pulmonar i plotë mund të shihet në të gjitha situatat e mëposhtme me përjashtim të:

A) pneumotoraksit
B) plagëve pulmonare
C) obstruksionit të bronkut intermediar
D) plagë të paretit torakal nga shtypja
E) hemotoraks dexter
PS)C

Pyetja 876 V)3

Nyjet subkutane janë një manifestim ekstra-artikular tipik i:

A) sklerozes sistemike
B) fibromialgjisë
C) gonartrozës
D) artritit rheumatoid
E) polimiozitit
PS)D

Pyetja 877 V)1

Në rast të rektorragjisë në një burrë 60 vjeç, ekzaminimi diagnostik më i indikuar është:

A) urografia
B) kultura e feçeve
C) citologjia e feçeve
D) sigmoidoskopia
E) klizma opake
PS)D

Pyetja 878 V)1

Në Crush Syndrome (Rhabdomioliza post-traumatike) cila nga enzimat e mëposhtme rritet:

A) GOT
B) GPT
C) CPK
D) amilaza
E) lipaza
PS)C

Pyetja 879 V)1

Nëpërmjet cilit mekanizëm një organ i transplantuar (graft), njihet si i huaj nga qelizat T të marrësit:

A) prezantimit të allopeptidit MHC të graftit nga qelizat antigen paraqitëse të marrësit
B) njohja direkte e allopeptideve MHC të huaja të pranishme në qelizat e graftit
C) shprehje e molekulave të adezionit në endotelin e graftit
D) çlirim i citokinave me veprim inflamator pas riperfuzionit
E) aktivizim klonal i qelizave specifike T supresore
PS)A

Pyetja 880 V)2

Në pankretitin kronik:

A) testi sekretin-pankreozimin është i alteruar
B) ulet sideremia
C) biposia intestinale mund të japë të dhëna patologjike
D) koha e protrombinës është normale
E) është normal ekskretimi i yndyrnave në fece
PS)A

Pyetja 881 V)2

Cilët janë faktorët që përcaktojnë përqëndrimin plazmatik fillestar të një medikamenti që administrohet me dozë ngarkese në rrugë endovenoze?

A) doza dhe clearance
B) doza dhe vëllimi i shpërndarjes
C) vëllimi i shpërndarjes dhe clerance
D) clearance dhe gjysmejeta
E) gjysmë jeta dhe doza
PS)B

Pyetja 882 V)1

Cila nga karakteristikat e mëposhtme individuale nuk konsiderohet faktor risku për kardiopatitë ishemike:

A) nivel i lartë i kolesterolit total
B) duhan pirja
C) hipertensioni arterial
D) nivel i lartë i lipoproteinave LDL
E) marrja e sasive modeste te alkoolit
PS)E

Pyetja 883 V)1

Në cilat nga sëmundjet e mëposhtme Fenomeni Raynaud përbën shpesh manifestimin e shfaqjes së sëmundjes?

A) artriti reumatoid
B) skleroza sistemike
C) artriti psoriatic
D) spondiliti ankilozant
E) artroze
PS)B

Pyetja 884 V)1

Nefroni përbëhet nga:

A) corpusculi renal dhe tubuli contort proksimal.
B) corpusculi renal (ose i Malpighit), tubuli contort proksimal, hansa e Henle dhe tubuli contort distal.
C) corpusculi renal, ansa henle dhe tubuli colector.
D) tubuli kontort proksimal, ansa Henle dhe tubuli distal.
E) corpusculi renal, tubuli contort proksimal, ansa Henle, tubuli contort distal, kanalet papilare
PS)B

Pyetja 885 V)2

Hipokolesterolemia vërehet në një nga këto gjendje:

A) sindrom nefrotik
B) hipertiroidizmi
C) hipotiroidizëm
D) diabet mellitus i dekompensuar
E) ikter kolostatik
PS)B

Pyetja 886 V)2

Vasodilatatori më i fuqishëm cerebral është:

A) tiopental
B) diazepam
C) droperidol
D) hipercapni
E) hipocapni
PS)D

Pyetja 887 V)1

Cila prej simptomave ose shenjave nuk takohet në sindromën kolestatike?

A) prurit
B) spider naevi
C) ikter
D) fece akolike
E) urinë hiperkromike
PS)B

Pyetja 888 V)2

Karcinoma e laringut përfaqësohet në pjesen me te madhe te rasteve nga një:

A) karcinomë basocellulare
B) karcinomë verrucose
C) adenocarcinomë
D) karcinomë spinocellualare
E) karcinomë me qeliza gjigande
PS)D

Pyetja 889 V)1

Tingull perkusioni i qartë hiperfonik timpanik dëgjohet në toraks në njërën prej këtyre gjendjeve:

A) empiema
B) infarkt pulmonar
C) pneumotoraks
D) hidrotoraks
E) pneumoni
PS)C

Pyetja 890 V)2

Tireoglobulina (Tg) është:

A) proteina vektor e hormoneve tiroidienë
B) pjesë integrale e tiroxinës
C) pjesë integrale e trijodotironinës
D) një enzimë e tiroides
E) një proteinë e depozituar në koloiden tiroidienë në të cilën ndodh sinteza e hormoneve të tiroides
PS)E

Pyetja 891 V)1

Sapo diagnostikohet një takikardi ventrikulare pa puls:

A) duhet te sillemi si në rastin e një fibrilacioni ventrikular
B) bëhet masazh i sinusit karotid
C) administrohet lidokaina 10 mg/kg e.v me bolus
D) vendoset një kanjulë në një venë me kalibër te madh
E) administrohet lidokainë 1.5mg/kg e.v me bolus
PS)A

Pyetja 892 V)2

Cila është shenja me e zakonshme e ndërlikimit të një plage kirurgjikale?

A) drenazh seroz
B) drenazh gjaku
C) drenazh sero-hemorragjik
D) dhimbje abdominale pa drenazh
E) prani e përbërjes abdominale në plagë
PS)C

Pyetja 893 V)2

Në një subjekt në gjendje qetësie në cilin prej organeve të mëposhtme verifikohet prodhimi më i madh termik?

A) zemër
B) mushkëri
C) lëkurë
D) muskulaturë skeletike
E) veshka
PS)D

Pyetja 894 V)1

Indikacioni për trajtim kirurgjikal të bronkoektazive përcaktohet nga të gjitha indikacionet e mëposhtme, me përjashtim të:

A) prodhim ditor sekrecionesh, të eleminuara me sputum mbi 50cc në ditë
B) hemoptizi te përsëritura
C) risk për transformacion neoplastik
D) pneumoni te përsëritura, pamvarësisht terapisë
E) bronkoektasi të kufizuara vetëm në një lob
PS)C

Pyetja 895 V)1

Në cilën prej parazitozave te mëposhtme mund të verifikohet si komplikim shoku anafilaktik?

A) toxoplasmose
B) malarie
C) echinococosat
D) leishmaniozat
E) criptosporidosi
PS)C

Pyetja 896 V)1

Një rritje e përqëndrimit të adrenalinës qarkulluese provokon:

A) reduktim të hedhjes sistolike
B) reduktim të frekuencës kardiake
C) rritje të hedhjes kardiake
D) reduktim të kontraktilitetit kardiak
E) reduktim të presionit arterial
PS)C

Pyetja 897 V)2

Cila prej formulave te mëposhtme kromozomike është e saktë për sindromën Turner

A) 47, XY + 21
B) 47, XY + 13
C) 47,XXX
D) 45,X0
E) 47, XXY
PS)D

Pyetja 898 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtme që ka lidhje me palcën e kuqe të kockave është i gabuar?

A) përmban qeliza adipose
B) rrjedh nga mesenkima

C) mund të bëhet në mënyrë reversibel palcë e verdhë
D) në adultët është e pranishme vetëm në kockat e gjata
E) është vendi kryesor i hemopoezës
PS)D

Pyetja 899 V)2

Në hiperaldosteronizmin sekondar përveç rritjes së aldosteronit vërehet edhe:

A) ulje të aktivitetit të reninës së plazmës
B) aktivitet normal të reninës së plazmës
C) rritje te aktivitetit të reninës së plazmës
D) hipersekrecion të tiroxinës
E) hiposekrecion të kolecistokininës
PS)C

Pyetja 900 V)1

Nekroza kazeoze është specifike në granulomën e pranishme në:

A) bronkopneumopatinë kronike obstruktive
B) lupus eritematoz
C) granulomatoza Wegenër
D) tuberculoz
E) sarcoidoze
PS)D

Pyetja 901 V)1

Condyloma acuminatum:

A) janë lesione infektive me origjinë fungale
B) janë lezione infektive me origjinë bakteriale
C) janë lezione infektive me origjinë virale
D) lokalizohen kryesisht në zona të ekspozuara ndaj dritës
E) quhen zakonisht verruche vulgaris
PS)C

Pyetja 902 V)2

Kur ekzistencës së ovareve i shtohet prania e genitaleve ambigues pak a shumë të diferencuara në anën mashkullore flasim për:

A) pseudohermafroditizem femeror
B) dysgeneze gonadale me fenotip mashkullor
C) pseudohermafroditizem mashkullor
D) hermafroditizem vera

E) dysgeneze gonadale me fenotip femeror
PS)A

Pyetja 903 V)2

Në cilën nga gjendjet e mëposhtme takohet një rritje sinjifikative e antigjenit karcinoembryonic (CEA)?

A) ikter obstruktiv
B) tumore malinjë
C) hemopati
D) hepatit viral
E) mucoviscidoze
PS)B

Pyetja 904 V)1

Shkaku më i shpeshtë i vdekjes në Crush Syndrome është:

A) një insuficencë renale akute
B) hipoalbuminemi
C) hemorragji
D) infeksion
E) infarkt miokardi
PS)A

Pyetja 905 V)2

Një studim klinik i kontrolluar quhet DOUBLE BLINDED kur:

A) as statisticieni që përpunon të dhënat, as eksperimuntuesi nuk njohin tipin e trajtimit te kryer
B) as pacienti as statisticieni që përpunon te dhenat nuk njohin tipin e trajtimit te kryer
C) as pacienti as te afërmit e tij nuk janë në dijeni te tipit te trajtimit te kryer
D) as pacienti as eksperimentuesi nuk janë në dijeni te tipit te trajtimit te kryer
E) janë dy grupe kontrolli
PS)D

Pyetja 906 V)2

Të gjitha të mëposhtmet janë shkaqe për encefalopatinë me përjashtim të njërit:

A) hemorragjia digjestive
B) dieta hiperproteinike
C) dieta hiperkalorike
D) infeksionet
E) marrje benzodiazepinash

PS)C

Pyetja 907 V)2

Cila prej substancave te marra nga nëna gjatë shtatzanisë, është e lidhur me anomali fetale dhe neonatale që korrelojnë me disgregacionin vaskular?

A) duhan
B) alkool
C) anksiolitike
D) amfetamina
E) kokaina
PS)E

Pyetja 908 V)2

Osteosinteza është

A) një teknike kirurgjikale.
B) një çrregullim i ontogjenezes skeletike.
C) një sëmundje e trashëguar.
D) një ndërlikim i frakturave.
E) një sëmundje dismetabolike e kockave.
PS)A

Pyetja 909 V)2

Është një gjendje amenorre primare e shoqëruar me hipogonadizëm hipogonadotrop dhe anosmi:

A) sindromi Turner
B) sindromi Kallman
C) sindromi Rokitansky
D) sindromi Morris
E) sindromi Klinefelter
PS)B

Pyetja 910 V)2

Një motoneuron somatik:

A) stimulon receptorët muskarinikë të fibrës muskulare
B) mund të nxisë fibrat muskulare skeletike, por jo neuronët e tjera
C) zakonisht inervon më shumë se një fibër muskulare
D) inervon njëkohësisht fibra muskulare të ngadalta dhe të shpejta
E) mund të prodhojë inhibitorë postsinaptikë në qelizën muskulare skeletike
PS)C

1.Fondi B
Pyetja 1 V)1

Në parandalimin primar e sekondar të sëmundjeve kardiovaskulare, aktiviteti i rregullt fizik :

A) luan një rol te rendesishem se bashku me trajtimin e faktoreve te tjere te riskut
B) luan një rol te parendesishem në krahasim me faktoret e tjere te riskut
C) nuk është e rekomanduar
D) nuk është akoma i njohur roli i saj
E) është e kundërindikuar në pacientët kardiopate edhe pse në gjendje klinike te qëndrueshme
PS)A

Pyetja 2 V)2

Cili prej pohimeve që kanë lidhje me adenokarcinomën e pankreasit është i gabuar?

A) Simptoma fillestare me e shpeshtë është ikteri obstruktiv.
B) Pjesa më e madhe e tumorëve lokalizohet në kokën e pankreasit.
C) Mosha mesatare e të prekurve është midis 60 dhe 70 vjeç.
D) Mbijetesa mbi dy vjet nga diagnoza është e rrallë
E) Pjesa më e madhe e pacientëve ka një masë tumorale të trajtueshme me kirurgji .
PS)E

Pyetja 3 V)1

Alterimi okular karakteristik për sindromën Sjogren është

A) katarakti.
B) rritja e presionit endokular.
C) atrofia e nervit optik.
D) cheratokonjuktiviti i thatë.
E) iridocikliti.
PS)D

Pyetja 4 V)1

Terapia hormonale në menopauzë bëhet me

A) estrogjenë.
B) progestative.
C) estro-progestative.
D) antiandrogenë.
E) bromokriptina.
PS)C

Pyetja 5 V)2

Në diseksionin e aortës e dhëna semeiologjike më e rëndësishme është:

A) mungesë ose hiposfigmi e pulseve arteriale.
B) hipokratizem digital.
C) cianozë.
D) bllok të degës dexter.
E) pectus excavatum.
PS)A

Pyetja 6 V)1

Legionella Pneumophila është një organizëm:

A) gram pozitiv
B) gram negativ
C) saprofit.
D) sporigen.
E) i kapsuluar.
PS)B

Pyetja 7 V)1

Ethja reumatike është një sequele (patologji pasojë e një sëmundje të mëparshme) e një infeksioni nga

A) staphilococcus aureus.
B) streptococcus pyogenes.
C) haemophylus influenza.
D) streptococus agalactiae.
E) candida albicans.
PS)B

Pyetja 8 V)2

Cili prej hormoneve nuk rrjedh nga sinteza apo prodhimi placentar?

A) gonadotropina corionice humane
B) hormoni laktogjen placentar
C) prolaktina
D) progesteroni
E) estrioli
PS)C

Pyetja 9 V)2

Cila është dega e parë intradurale e arteries carotide interne?

A) arteria oftalmike
B) arteria cerebrale media
C) arteria comunicante posteriore
D) arteria corioide anteriore
E) arteria cerebrale anteriore
PS)A

Pyetja 10 V)2

Kokaina ka efekte të tipit

A) simpaticolitiche.
B) miorelaksuese.
C) parasimpaticomimetike.
D) anestetik lokal.
E) spasmolitik.
PS)D

Pyetja 11 V)2

Cila është struktura kryesore për prodhimin e endolimfës?

A) membrana basilare
B) membrana tectoria
C) stria vasculare
D) sistemi spiral
E) sacusi endolimfatik
PS)C

Pyetja 12 V)2

Cili prej këtyre ekzaminimeve të mëposhtme skrinuese ka patur impaktin më të madh në reduktimin e mortalitetit nga kanceri tek femrat?

A) radiografia e toraksit
B) ekzaminimi i feçeve
C) PAP-testi
D) dozimi hormonal
E) analiza e urinës
PS)C

Pyetja 13 V)1

Një i ri që ka renë nga motori ankohet për një dhimbje akute në anën e majtë. Ekzaminimi radiologjik evidenton një frakture të brinjëve 11 dhe 12 sinister. Cili organ abdominal duhet te jetë lezionuar propabilisht?

A) hepari
B) lieni
C) pankreasi
D) aorta abdominale
E) intestini
PS)B

Pyetja 14 V)2

Endokarditët me hemokultura negative shkaktohen nga cilët prej baktereve të mëposhtëm?

A) stafilokokë
B) pneumokokë
C) HACEK
D) enterobaktere
E) streptokoku viridans
PS)C

Pyetja 15 V)2

Cila prej alternativave të mëposhtme nuk është një indikacion për laparoskopinë e urgjencës ?

A) ruptura e cistit te ovarit
B) kolecistit acut
C) perforacion intestinal
D) ileus mekanik post-aderencial
E) peritonit i gjeneralizuar me shok septik
PS)E

Pyetja 16 V)1

Cila prej këtyre ekzaminimeve instrumentale është më e dobishmja për të vendosur diagnozën e një colecistiti acut?

A) ecografia
B) tomografia e kompjuterizuar (CT scan)
C) radiografia e abdomenit
D) colangiografia retrograde
E) gastroscopia
PS)A

Pyetja 17 V)3

Në se VCO2 është 200ml/min dhe hedhja kardiake është rreth 10 l/min, diferenca arteriovenoze e CO2 është e barabarte me:

A) 1ml/dl
B) 2ml/dl
C) 3ml/dl
D) 4ml/dl
E) 5ml/dl
PS)B

Pyetja 18 V)2

Ketoacidoza është ndërlikim akut më i shpeshtë në

A) diabetin e tipit 2.
B) diabetin gestacional.
C) diabetin e tipit 1.
D) osteoartroza.
E) guta.
PS)C

Pyetja 19 V)2

Cila nga të dhënat e mëposhtme të lejon të përcaktosh me siguri vdekjen?

A) ulje e tempëratures se trupit
B) mungese e pulsit arterial
C) mungesë e refleksit pupilar
D) mungesë e reflekseve osteo-tendinale
E) EKG isoelektrike për me shume se 20 minuta në vijimësi
PS)E

Pyetja 20 V)2

Koncepti i bioequivalenzës konsiston në atë që dy medikamente

A) kanë të njëjtin çmim.
B) nuk ndryshojnë në mënyrë domethënëse për sa i takon AUC, Cmax, Tmax.
C) kanë te njëjtin emërtim komercial.
D) nuk kanë një indikator të reduktuar terapeutik.
E) administrohen me rrugë endovenoze
PS)B

Pyetja 21 V)2

Hemorragjia digjestive (enterorragjia) në divertikulin Meckel provokohet nga

A) inflamacioni i divertikulit.
B) oklusion intestinal të provokuar nga divertikuli.
C) ulçër peptike me ishuj heterotopike të mukozës gastrike.
D) prani e divertikulit në sakusin hernia.
E) invaginimin e divertikulit.
PS)C

Pyetja 22 V)2

Cili nga pohimet është i saktë për shtresën corneale të epidermës?

A) Mungon në nivel të mukozës.
B) Është e pranishme vetëm në nivel të mukozës.
C) Është e pranishme vetëm në nivel të thonjve.
D) Mungon në nivel të thonjve.
E) Është e pranishme vetëm në skalp.
PS)A

Pyetja 23 V)2

Kolesteroli ka një rol thelbësor për funksionimin e membranave biologjike sepse

A) rregullon fluiditetin e membranës.
B) përshkon spesorin e shtresës lipidike të dyfishtë.
C) nuk mund të sintetizohet nga gjitarët.
D) është përgjegjës për levizjen flip-flop te lipideve nga njëra anë e membranës në tjetrën.
E) kontribuon në mbajtjen e statusit parakristalin.
PS)A

Pyetja 24 V)2

Cila nga prekjet e mëposhtme kardiovasculare duhet të konsiderohet si me risk më te lartë për embolinë cerebrale?

A) persistencë e PATEN FORAMEN OVALE
B) ateromat e harkut aortik < 4mm
C) prolaps i mitrales
D) fibrozë e unazës mitrale
E) fibrilacion atrial reumatik ose valvular
PS)E

Pyetja 25 V)1

HIV i takon familjes së

A) reiviridae.
B) picornaviridae.

C) retroviridae.
D) adenoviridae.
E) flaviviridae
PS)C

Pyetja 26 V)2

Ekzaminimi citologjik i ekspektoratit demonstron spirale të Curshman, kristale Charcot-Leyden, qeliza të inflamacionit akut dhe mucus abondant; shumë prej qelizave inflamatore janë eosinofile. Për cilën nga sëmundjet e mëposhtme obstruktive të pulmonit m
A) bronkoectasi
B) aspirim i një trupi te huaj
C) astmë atopike
D) emfizeme centrolobulare
E) bronkit kronik
PS)C

Pyetja 27 V)1

Cilët janë mikrobet që në djegie më shpesh çojnë në sepsis?

A) streptokoku
B) stafilokoku
C) proteus
D) pseudomonas aeruginosa
E) diplococu pneumoniae
PS)D

Pyetja 28 V)2

Tek një pacient të gastroresekuar shfaqja pas ngrënies së vaktit e hipersudoracionit , ndjenjës së nxehtësise, nauzesë, lipotimisë, cefalesë duhet të bëjë të mendosh për

A) pankreatit akut.
B) dumping syndrome.
C) stenozë pylorike.
D) degjenerim neoplastik.
E) ulçër.
PS)B

Pyetja 29 V)2

Cili nga kuadret simptomatologjike më poshtë nuk është karakteristik për hernien hiatale?

A) dispepsia-disfagia-tachicardia
B) hematemeze-melena
C) djegie epigastrike dhe retrosternale

D) dhimbje hipogastrike
E) aerofagi
PS)B

Pyetja 30 V)1

Cilat janë qelizat hematike që ndërhyjnë në vendin e inflamacionit akut?

A) monocite
B) limfocite
C) granulocite neutrofile
D) granulocite eosinofile
E) granulocite basofile
PS)C

Pyetja 31 V)1

Ku ndodh kryesisht këmbimi gazos intrapulmonar

A) në nivel alveolar
B) në nivel të bronkiolave terminale
C) në nivel të bronkiolave respiratore
D) në nivel të bronkeve kryesore
E) në nivel të hapësirës së vdekur
PS)A

Pyetja 32 V)2

Me një përgjigje të tipit Th2 kuptojmë

A) një reaksion të karakterizuar nga çlirimi i substancave si histamina dhe bradikinina.
B) një proçes inflamator të lidhur me njohjen e antigenëve bakteriale si tuberkulina.
C) faktin që qelizat T helpër lëshojnë në mënyrë predominante citochinat si IL-4 dhe IL-10.
D) kalimin nga një përgjigje e tipit IgM në një përgjigje të tipit IgG pas riekspozimit ndaj një antigeni.
E) sintezën dhe çlirimin në qarkullim të substancave që rrjedhin nga hepari, si proteina C reaktive.
PS)C

Pyetja 33 V)1

Vendi i ulçerës peptike është

A) stomaku e duodeni.
B) coloni.
C) stomaku, esofagu, coloni.
D) stomaku e faringu.

E) faringu e esofagu.
PS)A

Pyetja 34 V)2

Cili nga këto nivele glukoze është diagnostik për hipoglicеminë?

A) 50mg/dl
B) 40mg/dl
C) 60mg/dl
D) 70mg/dl
E) 80mg/dl
PS)B

Pyetja 35 V)2

Agranulocitoza provokon lezione të mukozës

A) genitale
B) orofaringeale
C) esofageale
D) auriculare
E) rektale
PS)B

Pyetja 36 V)2

Cili indikator i kontraktilitetit kardiak në fazën e ejeksionit, llogaritet normalisht?

A) frekuenca kardiake
B) fraksioni i ejeksionit
C) presioni arterial media
D) puna ventrikulare
E) rendimenti kardiak
PS)B

Pyetja 37 V)2

Cili pohim nuk është i vërtetë? Veshi i mesëm duhet për

A) të identifikuar frekuencen e tingullit.
B) transmetuar tingullin përmes zinxhirit të kockave.
C) të transmetuar stimulin nga timpani në finestrën ovale.
D) të lejuar transmetimin e tingullit nëpërmjet malleus, incus e stapes.
E) të amplifikuar intensitetin e tingujve.
PS)A

Pyetja 38 V)3

Tek një pacient me episode sinkopale, bllok atro-iventrikular te plotë, dhe kriza frekuente tachikardie atriale është e nëvojshme

A) te administrohet amniodaroni
B) administrohen beta-bllokues
C) të administrohet verapamil
D) të implantohet një pace-maker bicameral
E) implantohet një pace-maker ventricular
PS)E

Pyetja 39 V)2

Indikacioni kryesor për scintigrafinë miocardiale të perfuzionit është

A) diagnoza e kardiopatisë ishemike
B) prognoza e kardiopatisë ishemike
C) vlerësim i vitalitetit miokardial
D) diagnozë e prognozë e kardiopatisë ishemike e vlerësim i vitalitetit miokardial
E) diagnozë e infarktit të miokardit
PS)D

Pyetja 40 V)3

Një shqetësim somatoform karakterizohet nga

A) simptoma fizike në mungesë te një gjendje mjekësore të përgjithshme.
B) një gjendje mjekësore e përgjithshme e lidhur me një çrregullim psikiatrik.
C) faktorë psikologjikë që influencojnë gjendjet mjekësore të përgjithshme.
D) simulimi i simptomave fizike.
E) simptoma fizike të zhvilluara me qëllim nga pacienti.
PS)A

Pyetja 41 V)3

Adiadococinesia është një shenjë

A) cerebelare.
B) sensitive.
C) ekstrapiramidale.
D) piramidale.
E) medulare
PS)A

Pyetja 42 V)2

Koriokarcinoma prodhon

A) AFP.
B) CA 125.
C) CA 19-9.
D) CEA.
E) HCG.
PS)E

Pyetja 43 V)2

Si manifestohet sot më shpesh tumori renal?

A) masë e palpueshme
B) hematuri
C) kolikë renale
D) diagnoza është aksidentale
E) oliguri
PS)D

Pyetja 44 V)2

Heqja e cilit prej prej organeve të mëposhtme mund të shkaktojë tetani dhe hipokalcemi?

A) paratiroide
B) surrenale
C) timus
D) hipofizë
E) hipotalam
PS)A

Pyetja 45 V)3

Vendet më të shpeshta në të cilat manifestohet psoriaza janë

A) bërrylat dhe gjunjët.
B) hapsira e gojës dhe bërrylat.
C) skalpi dhe regioni sacral.
D) bërrylat e gjunjët dhe hapësira e gojës e gjunjët.
E) bërrylat e gjunjët dhe skalpi e regjioni sakral.
PS)E

Pyetja 46 V)2

Mbaresat nervore sensitive të lira kutane vijnë nga

A) niveli i hipodermës.

B) niveli i dermës se thellë.
C) porcioni proksimal i epidermës.
D) shtresa korneale kompakte.
E) shtresa korneale dissoluta
PS)C

Pyetja 47 V)2

Cili nga viruset e mëposhtme është shkaku më i mundshëm i sarkomës Kaposi?

A) virus T-limfotropik
B) herpesvirus human 6
C) herpesvirus human 8
D) citomegalovirus
E) echo-virus
PS)C

Pyetja 48 V)3

Nekroza hepatocelulare mund të ndodhë përmes shumë mekanizmave. Cili nga mekanizmat e mëposhtëm nuk është direkt përgjegjës për dëmin hepatoqelizor?

A) dëm hipoksiko-anoksik
B) dëm nga hiperamoniemia
C) dëm nga akumulimi i metalit
D) dëm nga alterimi i proceseve metabolike
E) dëm nga lipoperoksidimi i membranës plazmatike
PS)B

Pyetja 49 V)1

Labirintozat janë

A) patologji akute të veshit të jashtëm.
B) patologji inflamatore të labirintit.
C) ndërlikime të labirintit nga otomastoidi purulent akut.
D) lezione permanente që i detyrohen ndërhyrjeve të labirintectomisë.
E) manifestime degjenerative të epiteliumit të labirintit membranoz.
PS)E

Pyetja 50 V)2

Në cilën prej ketyre patologjive është e shpeshtë një dhimbje lumbare?

A) glomerulonefrit akut me evolucion të shpejtë
B) nekrozë tubular akute nga aminoglikoside
C) insufçienca renale kronike

D) litiaza renale
E) nefroangioskleroza
PS)D

Pyetja 51 V)3

Nuk i administrohet pacientëve me astmë

A) salbuterol.
B) digoksinë.
C) propranolol.
D) bretilium.
E) lidokainë.
PS)C

Pyetja 52 V)3

Simptomat pozitive të skizofrenisë përfshijnë

A) delir dhe halucinacion.
B) ambivalencë dhe mungesë afeksioni.
C) amnezi dhe njohje të gabuara.
D) takipsikizëm dhe arratisje nga idetë.
E) depresion dhe ankth.
PS)A

Pyetja 53 V)1

Sëmundja Raynaud manifestohet me

A) të vjella.
B) dispne.
C) lemzë.
D) poliuri.
E) atake zbehje dhe cianozë në gishta.
PS)E

Pyetja 54 V)3

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me sëmundjen Parkinson nuk është i vërtetë ?

A) Tremori është me frekuence të shpejtë te barabartë me 10-12 Hz.
B) Sëmundja shkaktohet nga një defiçit i dopaminës.
C) Paqëndrueshmëria posturale është një shkak i rëndësishëm i paaftësisë.
D) Sëmundja mund të trajtohet me amantadinë.
E) Ka hipertoni.
PS)A

Pyetja 55 V)2

Cili nga faktorët e mëposhtëm është faktori më i rëndësishëm neonatal predispozues për infeksione?

A) ikteri
B) postmaturiteti
C) seksi femër
D) asfiksia feto/neonatale
E) prematuriteti ose pesha e ulët në lindje
PS)E

Pyetja 56 V)2

Cila nga këto shenja nuk është e pranishme në glomerulonefritin membranoz tipik ?

A) oxaluria
B) proteinuria
C) hipoprotidemia
D) hiperkolesterolemia
E) edema
PS)A

Pyetja 57 V)2

Cili nga hormonet sekretohet nga qelizat alfa të pankreasit?

A) insulina
B) somatostatina
C) polipeptidet pancreatike
D) glucagoni
E) peptidi C
PS)D

Pyetja 58 V)2

Në tumoret metastatike me vendndodhje primare të panjohur

A) është e nëvojshme të sqarohet vendndodhja e tumorit primar.
B) tumori primar identifikohet në 15% të rasteve.
C) janë gjithmonë të pranishme metastazat hepatike.
D) tumori primar është gjithmonë një karcinomë.
E) prognoza ndryshon në se identifikohet tumori primar.
PS)B

Pyetja 59 V)3

Në sëmundjen Osler hemorragjitë me frekuente ndodhin

A) në retinë.
B) në artikulacione.
C) në traktin gastrointestinal.
D) në vezikë.
E) në hundë.
PS)E

Pyetja 60 V)3

Cila nga shenjat e mëposhtme mungon në rastin e intoksikacionit nga monoksidi i karbonit?

A) krizë stenokardike
B) cianozë
C) nauze dhe të vjella
D) cefale
E) konvulsioni
PS)B

Pyetja 61 V)2

Një "Krize Aplastike" e lidhur me një infeksion viral në një pacient me anemi hemolitike i detyrohet përgjithësisht një infeksioni nga

A) virusi i Varicella Zoster.
B) parvovirus.
C) virus i Hepatitit C.
D) citomegalovirus.
E) virusi Epstein-Barr.
PS)B

Pyetja 62 V)2

Cli është ekzaminimi i parë në vleresimin e tendinopative të inserimit të tendinit të Akilit?

A) ekografia
B) rx me rreze te buta
C) resonance magnetike
D) tomografi e kompjuterizuar
E) serografia
PS)A

Pyetja 63 V)2

Cili prej artikulacioneve nuk preket në artritin reumatoid ?

A) kavilia
B) kyçi i dorës
C) shpatulla
D) bërryli
E) sacroiliak
PS)E

Pyetja 64 V)1

Kilotoraksi është një patologji që e merr origjinën nga

A) fistula trakeo-bronkiale.
B) lezioni i diafragmës.
C) lezioni i pleurës viscerale.
D) neoplasia pulmonare.
E) lezione të duktusit torakal.
PS)E

Pyetja 65 V)1

Në një ekografi përdoren

A) ultratinguj.
B) rreze X.
C) rreze laser.
D) rreze gamma.
E) valë elektromagnetike.
PS)A

Pyetja 66 V)2

Cila prej substancave të mëposhtme ka rëndësinë më të madhe në gjenezën e encefalopatisë hepatike?

A) acide yndyrore me zinxhir të shkurtër
B) neurotransmetuesit false
C) fenolet
D) acidet nukleike
E) amoniaku
PS)E

Pyetja 67 V)2

Veprimi i kalcitoninës është

A) hiperkalcemik.

B) hipokalcemik.
C) hiperfosforemik.
D) hiperkalcemik dhe hipërfosforemik.
E) hiperkalcemik dhe hipofosforemik.
PS)B

Pyetja 68 V)2

Poliglobulia është e pranishme tek subjektet me

A) bronkit kronik te thjeshtë.
B) bronkit kronik obstruktiv.
C) insuficiencë respiratore kronike.
D) astme bronkiale.
E) tromboemboli pulmonare.
PS)C

Pyetja 69 V)3

Amfetamina është një aminë

A) parasimpatikomimetike.
B) analgjezike.
C) narkoleptike.
D) vazodilatatore topike.
E) simpatikomimetike.
PS)E

Pyetja 70 V)2

Etiologjia e anoreksisë nervore konsiton në

A) reduktim të nivelit të LH-RH.
B) reduktim të nivelit të GH.
C) reduktim të nivelit të IGF-I (somatomedina C).
D) reduktim të funksionalitetit tiroidien.
E) çrregullim i sjelljes me ushyerjen me bazë psikike.
PS)E

Pyetja 71 V)3

Të gjitha gjendjet e mëposhtme mund të shoqërohen me anemi, me përjashtim të

A) hipotiroidizmit.
B) sindromit Cushing.
C) hipogonadizmit.
D) hipertiroidizmit.

E) hiposideremisë.
PS)B

Pyetja 72 V)2

Cilin nga ngushtimet e mëposhtëm fiziologjikë paraqet Ezofagu?

A) tiroidien, pleural e diafragmatik
B) cricoid, sternal e diafragmatik
C) tiroidien, bronko-aortal e diafragmatik
D) cricoid, pleurale diafragmatik
E) cricoid, bronko-aortal e diafragmatik
PS)E

Pyetja 73 V)2

Testi i etjes në një diabet insipid hipofizar përcakton

A) reduktim të poliurisë dhe osmolaritetit urinar me 50%.
B) kontraktim të diurezës dhe rritje të osmolaritetit urinar.
C) rritje të diurezës dhe të osmolaritetit urinar.
D) mosmodifikim të diurezës, mosmodifikim të osmolaritetit urinar.
E) reduktim të poliurisë dhe rritje të osmolaritetit urinar me 50%.
PS)D

Pyetja 74 V)1

Dhembje therëse e papritur e lokalizuar në hemitoraks dhe dispne në një të ri deri tani pa simptomatologji, janë të dhëna që sugjerojnë diagnozën për

A) pneumoni lobare.
B) pneumotoraks spontan.
C) infarkt miokardi.
D) emboli pulmonare.
E) aneurizëm disekante.
PS)B

Pyetja 75 V)2

Cili nga parametrat nuk rritet në infarktin e miokardit ?

A) LDH
B) CPK
C) CPK-MB
D) GOT dhe GPT
E) fosfataza alkaline
PS)E

Pyetja 76 V)3

Çrregullimi i adaptimit manifestohet me shfaqjen e çrregullimeve emotive dhe/ose të sjelljes si përgjigje ndaj faktorëve stresante. Cila nga këto simptoma nuk është e pranishme në këtë çrregullim?

A) humor depres
B) ankth
C) alterim të sjelljes
D) delir
E) shqetësim
PS)D

Pyetja 77 V)2

Chlamidia trachomatis është shpesh përgjegjëse e

A) pneumonisë alveolare te neonatit.
B) pneumonisë intersticiale tek adulti.
C) infeksionit genital.
D) gastroenteritit.
E) infeksionit urinar.
PS)C

Pyetja 78 V)3

Ku ndodh zhvillimi antigen indipendent i limfocitit B?

A) në qendrat embrionale, në folikulat sekondare të limfonodulit
B) në kordat medulare të limfonodulit
C) në shpretkë
D) në timus
E) në palcën e kockave
PS)E

Pyetja 79 V)3

Në sindromën Conn indikohet terapia me

A) diuretikë tiazidikë.
B) spironolakton.
C) diuretikë të ansës.
D) rezerpina.
E) alfametildopa.
PS)B

Pyetja 80 V)3

Acidi Arachidonik është prekursori i cilëve përbërës të rëndësishëm në inflamacion?

A) PAF (Platelet Acivating Factor)
B) fosfatidilinositolo-3P
C) leukotriene
D) inositoltrifosfat
E) histamina
PS)C

Pyetja 81 V)2

Cila nga substancat e mëposhtme përdoret në terapinë e miastenia gravis?

A) lorazepam
B) succinilcolina
C) piridostigmina
D) etosuccimide
E) amitriptilina
PS)C

Pyetja 82 V)1

Një shkak i zakonshëm i reaksioneve anafilaktike akute nga medikamentet është

A) administrimi intramuskular i benzilpenicilinës.
B) administrimi oral i ampicilinës.
C) administrimi intramuskular i imipraminës.
D) administrimi oral i sulfamidikëve.
E) administrimi endovenoz i morfinës.
PS)A

Pyetja 83 V)2

Astma bronkiale, nga një këndvështrim anatomo-patologjik nuk karakterizohet nga

A) spazma e e muskulaturës së lëmuar.
B) rritja e sekrecioneve.
C) shkatërrimi i fibrave elastike parenkimale.
D) inflamacion.
E) rimodelim i rrugëve ajrore.
PS)C

Pyetja 84 V)2

Cili nga këto lezione të hapësirës orale është një prekancerose e detyrueshme?

A) akumulim i pllakës
B) eritroplachi
C) papilomë
D) kandidose
E) fibromë nga trauma
PS)B

Pyetja 85 V)2

Kundërindikacione absolute për bronkoskopinë është/janë

A) kolla.
B) fistul e dyshuar tracheoezofageale.
C) akses pulmonar refraktar.
D) gjendje kardiovaskulare e paqëndrueshme dhe aritmi kardiake.
E) versament pleural.
PS)D

Pyetja 86 V)2

Në cilin prej individeve të mëposhtëm është e përshtatshme të kryhet testi dhe të trajtohet infeksioni nga Helicobacter pylori?

A) një burrë 50 vjeç asimptomatik
B) një grua 42 vjeç me një anamnëze familjare pozitive për karcinomen gastriche
C) një pacient 38 vjeç me dhimbje abdominale pa ulcera (dispepsi jo ulceroze)
D) një pacient 62 vjeç me sëmundje nga refluks gastro-esofageal
E) një grua 45 vjeç me ulcer peptike
PS)E

Pyetja 87 V)2

Parangarkesa është sinonim i

A) sistolave.
B) diastolave.
C) kontraktimit.
D) presion i perfuzionit pulmonar.
E) funksionalitetit tiroidien.
PS)B

Pyetja 88 V)1

Një vajzë 14 vjeç ka një diarre prej 9 muajsh, dhimbje abdominale, ethe dhe humbje peshe. Disa herë ka bërë feçe të ngjyrosura me gjak. Cila është diagnoza me e mundshme?

A) apendisit kronik
B) pankreatit kronik
C) sëmundje Crohn
D) bulimi
E) kalkulozë biliare
PS)C

Pyetja 89 V)2

Anemia hemolitike e fituar është ajo që vërehet në

A) sferocitozë.
B) hemoglobinuri paroksistike nokturne.
C) eliptocytoza e trashëguar.
D) porfiria eritropoetike.
E) talasemi.
PS)B

Pyetja 90 V)1

Diagnoza e laboratorit të malaries vendoset

A) përmes kultivimit të plasmodiumit në agar gjak.
B) përmes reaksionit të hemaglutinimit.
C) përmes observimit mikroskopik të strishos së gjakut periferik.
D) përmes imunoelektroosmoforezës.
E) i nokulimit në mi të porsalindur.
PS)C

Pyetja 91 V)2

Cila nga alternativat është një funksion fiziologjik i acideve biliare?

A) favorizim i ekskretimit të substancave toksike
B) favorizim I absorbimit të vitaminës B12
C) mbajtje e një pH intestinal të përshtatshëm
D) favorizim i përthithjes së yndyrnave
E) favorizim të përthithjes së aminoacideve
PS)D

Pyetja 92 V)1

Gjuha si mjedër (me ngjyrë të kuqe të fortë dhe me papila të dukshme qartë) vërehet në

A) sindromën Sjogren.
B) insufiçencën kronike kardiake kongjestive.
C) sëmundjen celiake.

D) anemia pernicioze.
E) skarlatina.
PS)E

Pyetja 93 V)2

Nitratet mund të përdoren në insufiçencën kardiake për

A) të rritur hedhjen kardiake.
B) të ulur parangarkesën.
C) të ulur pasngarkesën.
D) të rritur presionin arterial.
E) të reduktuar takikardinë.
PS)B

Pyetja 94 V)1

Cila është selia më e shpeshtë e implantimit të embrionin në shtatzaninë ektopike

A) ovare
B) fundusi uterin
C) peritoneumi
D) tubat
E) cerviksi uterin
PS)D

Pyetja 95 V)1

Imuniteti pasiv ndaj infeksioneve është ai që fitohet

A) nga nëna.
B) pasi një përson është infektuar por nuk ka manifestuar shenja të dukshme.
C) pasi një përson është infektuar dhe ka rezultuar në sëmundje me shërim të mëtejshëm.
D) pasi një përson është infektuar dhe ka rezultuar në sëmundje pavarësisht nga rezultati klinik.
E) pas vaksinimit për atë infeksion.
PS)A

Pyetja 96 V)2

Kriter indikativ për diagnozën e krizës blastike në leukeminë mieloide kronike është prania e

A) blasteve medulare mbi 30%.
B) hiperuricemisë.
C) reduktim të numrit të rruazave të kuqe.
D) limfoblastozës medulare.
E) limfocitozës periferike.

PS)A

Pyetja 97 V)2

Me luksacion kuptojmë

A) humbjen permanente të raporteve normale midis pjesëve përbërëse të artikulacionit.
B) lezionin e kapsulës artikulare.
C) një frakturë me prerje të shtrirë në kokat artikulare.
D) ruptura e kapsulës artikulare.
E) ruptura e ligamentit artikular.
PS)A

Pyetja 98 V)2

Cila nga alternativat paraqet një modifikim fiziologjik në shtatëzëni?

A) shtim të motilitetit intestinal
B) shtim të filtrimit glomerular
C) ulje të sekretimit të prolaktinës
D) reduktim të volumit plazmatik
E) reduktim të frekuencës kardiake
PS)B

Pyetja 99 V)2

Në cilën prej sëmundjeve mund të ndeshet shoqërimi i makroglosisë, insufiçencës kardiake me takikardi sinusale me voltazh të ulët të QRS, hepatosplenomegali,edemë të fytyrës e të palpebrave.

A) amiloidozë
B) hipertiroidizëm
C) hipotiroidizëm
D) kardiomiopati hipertrofike
E) perikardit konstriktiv
PS)A

Pyetja 100 V)2

Tek një adult i shëndoshë në qetësi hedhja kardiake (në l/min) është afërsisht?

A) 1.2
B) 2.9
C) 5
D) 8
E) 12
PS)C

Pyetja 101 V)1

Cili nga lëngjet e mëposhtme biologjike transmeton HIV?

A) djersë
B) salivë
C) lotë
D) urinë
E) gjak
PS)E

Pyetja 102 V)1

Granuloma është një:

A) reaksion inflamator kronik me predominancë të qelizave të serisë makrofage.
B) inflamacion akut specifik.
C) gjendje neoplazike.
D) sëmundje e majës pulmonare.
E) reaksion inflamator kronik me mungesë të qelizave të serisë makrofage.
PS)A

Pyetja 103 V)1

Cili është ekzaminimi laboratorik më specifik për diagnozën e pankreatitit akut?

A) kalcemia
B) proteina C reaktive
C) amilazemi + lipazemi
D) VES (shpejtesia e eritrosedimentimit)
E) LDH
PS)C

Pyetja 104 V)3

Zona Broka gjendet:

A) në pjesën e poshtme te girusit frontal inferior.
B) në pjesën e sipërme te girusit frontal inferior.
C) në gjithë girusin frontal inferior.
D) në pjesën e poshtme të girusit frontal të mesëm.
E) në pjesën e poshtme të girusit frontal superior.
PS)A

Pyetja 105 V)3

Molekulat e klasës I të sistemit madhor të histokompatibilitetit ndodhen në qelizat e mëposhtme:

A) të gjitha qelizat e nukleuara
B) qelizat renale
C) limfocite B
D) limfocite T
E) eritrocite
PS)A

Pyetja 106 V)3

Cila nga Lipoproteinat e mëposhtme nuk është normalisht e kapshme në plazmën e një subjekti i cili ka te paktën 7 orë që është esëll?

A) kilomikrone
B) VLDL
C) LDL
D) HDL
E) IDL
PS)A

Pyetja 107 V)3

Çdonjëra nga alternativat është një mbrojtje e rëndësishme që makroorganizmi ka kundër meningitit bakterial, me përjashtim të:

A) IgA sekretore.
B) aktivitet ciliar.
C) epitel mukozal.
D) komplement.
E) IgM
PS)E

Pyetja 108 V)3

Në sëmundjen pulmonare obstruktive të pastër:

A) vlera e FEV1 është në mënyrë tipike me e ulët së kapaciteti vital i forcuar.
B) rezulton e reduktuar FEV1, pa ndryshim të kapacitetit vital të forcuar.
C) FEV1 dhe FVC rezultojnë në mënyrë të përpjestueshme të reduktuar.
D) raporti FEV1/FVC është normal.
E) komponenti që varet nga sforcimi fizik në grafikun fluks-volum ndjek spirografinë normale.
PS)A

Pyetja 109 V)3

Të gjithë elementët e mëposhtëm mund të konsiderohen se bejnë pjesë në kuadrin klinik të hemokromatozës hereditare, me përjashtim të

A) prezantimit klinik pas moshës 40 vjeç.
B) pigmentim kutan bronz.
C) diabetit mellitus.
D) hepatokarcinomës
E) unazës korneale Kayser-Fleischer.
PS)E

Pyetja 110 V)2

Pseudoartroza është:

A) një formë artroze e moshave të reja.
B) artroze që prek artikulacionin e kyçit.
C) kuadri klinik, radiografik dhe anatomo-patologjik i një frakture jo të konsoliduar.
D) një ndërhyrje kirurgjikale e veçantë.
E) një tumor beninj.
PS)C

Pyetja 111 V)2

Si shenjë Babinski përkufizohet

A) një refleks plantar në fleksion.
B) një refleks plantar indifferent
C) një refleks plantar në ekstension.
D) një klonus i këmbës.
E) mungesë e refleksit faringeal.
PS)C

Pyetja 112 V)2

Hiperprotidemia mund të konstatohet në cilën nga këto gjendje?

A) djegie të gjerë
B) cirrozë hepatike
C) sindrom nefrotik
D) plazmocitomë
E) tireotoksikozë
PS)D

Pyetja 113 V)2

Cila strukturë përfshihet në sindromën e tunelit carpal?

A) nervi ulnar
B) nervi median
C) arteria radiale
D) nervi radial
E) tendini ektensor ulnar i karpit
PS)B

Pyetja 114 V)1

Osteoporoza është një faktor risku për

A) artrozë.
B) infeksione.
C) tumor kockor.
D) fraktura.
E) insuficiencë renale.
PS)D

Pyetja 115 V)2

Hipertensioni arterial në insufiçencën renale kronike i detyrohet

A) stenozës së arteries renale të një veshkë.
B) stenozë e arteries renale të të dy veshkave.
C) ekspansionit të volumit ekstraqelizor nga retensioni i natriumit.
D) hiperaldosteronizem primar.
E) sindromi Barter.
PS)C

Pyetja 116 V)2

Toksiciteti i nitrofurantoninës përgjithësisht rritet

A) tek pacientët me insufiçencë renale.
B) tek pacientët me insufiçencë respiratore kronike.
C) tek administrimi i njëkohshëm me medikamente që alkalinizojnë urinën.
D) tek pacientë me infeksione kronike të rrugëve urinare.
E) tek administrimi i njëkohshëm me medikamente që acidifikojnë urinën.
PS)A

Pyetja 117 V)1

Menjëhere pas një dëmtimi të plotë të medulës, ka më shumë të ngjarë të kemi

A) inkontinencë urinare.
B) retension urinar.
C) paraplegji spastike.

D) hiporefleksi.
E) hiporefleksi të rëndë.
PS)B

Pyetja 118 V)1

Për cilin nga kuadret klinike më poshtë nuk është karakteristike hemoptysia?

A) fibroza pulmonare idiopatike
B) embolia pulmonare
C) tuberkulozi
D) karcinoma pulmonare
E) pneumoni bakteriale
PS)A

Pyetja 119 V)2

Cila nga këto gjetje objektive nuk është karakteristike për oklusionin intestinal?

A) abdomen i fryrë
B) kontrakturë e pareteve
C) diskomfort abdominal me dhimbje
D) peristaltike metalike
E) kanal i mbyllur për feçe e gas
PS)B

Pyetja 120 V)1

Si përkufizohet mbledhja e likidit limfatik në hapësiren pleurale?

A) hidropneumotoraks
B) chilotoraks
C) hemotoraks
D) empiemë
E) hidrotoraks
PS)B

Pyetja 121 V)2

Cila simptomë mund të jetë karakteristikë e një pacienti mashkull me adenomë hipofizare prolaktinë-sekretuese?

A) reduktim të libidos
B) priapizëm
C) hiperhidrozë
D) mungëse ejakulacioni
E) orchit

PS)A

Pyetja 122 V)2

Cili është agjenti etiologjik i ethes Q"

A) clamidia
B) legionella
C) streptococcus
D) h.influenzae
E) coxiella burneti
PS)E

Pyetja 123 V)1

Çfarë është hematokriti (HCT)?

A) Volumi në përqindje i komponentit qelizor përkundrejt volumit total të gjakut të marrë.
B) Sasia totale e gjakut të marrë nga pacienti për ekzaminim laboratorik.
C) Raporti midis volumit corpuscular media (MCV) dhe përqëndrimit mesatar corpuscular të hemoglobinës (MCHC).
D) Raporti midis përqëndrimit të hemoglobinës (HGB) dhe numrit te qelizave të kuq (R
E) Raporti midis numrit te qelizave të kuqë (RBC) dhe numrit të qelizave të bardha (WBC).
PS)A

Pyetja 124 V)2

Terapia në hipotiroidizmin e lindur fillohet:

A) sa më shpejt të jetë e mundur.
B) pas tre muajve te pare te jetës.
C) pas gjashtë muajve të parë të jetës.
D) pas vitit të parë të jetës.
E) në pubertet.
PS)A

Pyetja 125 V)1

Nervi vagus:

A) shton kontraktilitetin ventrikular.
B) përmban vetëm fibra efferente.
C) përmban vetëm fibra parasimpatike pregangliare.
D) inhibon sekrecionin gastrik.
E) nxit relaksimin e sfinkterave në traktin gastrointestinal.
PS)E

Pyetja 126 V)1

Dhimbja migrenës tipikisht është:

A) therëse.
B) shtypëse.
C) shtrënguese.
D) pulsuese.
E) shpuese.
PS)D

Pyetja 127 V)1

Cila nga simptomat është më e zakonshme në mononukleozën infektive?

A) anoreksia
B) faringalgia
C) mialgia
D) nausea
E) kollë
PS)B

Pyetja 128 V)2

Spermatozoidet e gjitareve janë të aftë të fekondojnë:

A) në dalje të tubulit seminifer.
B) në dalje të epididimit.
C) në dalje të vezikulave seminale.
D) në eiaculacion.
E) pasi të jenë vendosur në rrugët genitale femërore.
PS)E

Pyetja 129 V)2

Thuhet që një neonat është një "floppy infant":

A) kur është shume hipertonik.
B) kur është shume hipotonik.
C) kur ka shume tremor.
D) kur ka devijacionë frekuente të vështrimit.
E) kur ka një nga prindërit nga vende anglisht folëse.
PS)B

Pyetja 130 V)1

Sfinkteri vezikal ekstern përbëhet nga:

A) muskulatura striata.
B) muskulatura e lëmuar.
C) muskulature mixe.
D) ind fibroz.
E) ind fibroadipoz.
PS)A

Pyetja 131 V)2

Kur mund të përkufizohet si aneurizmatike aorta abdominal?

A) kur trakti subrenal është > 1.5cm
B) kur trakti subrenal është > 5cm
C) kur raporti midis aortës subrenale me suprarenale është 1.5:1/2:1
D) nëse është i pranishëm një tromb parietal
E) nëse ka të pranishme kalcifikacione parietale
PS)C

Pyetja 132 V)2

Cila nga selitë e mëposhtme preket në mënyrë tipike nga frakturat në osteoporozën e tipit II?

A) vertebra lumbare
B) vertebra dorsale
C) radiusi
D) vertebra cervikale
E) qafa e femurit
PS)E

Pyetja 133 V)1

Nëpërmjet cilës rrugë transmetohet fruthi e tuberkulozi?

A) oro-fecale
B) nga kafshët (zoonozat)
C) rrugë ajrore
D) nga artropodet
E) me rrugë seksuale
PS)C

Pyetja 134 V)3

Diuretiket tiazidike kanë një mekanizëm veprimi

A) të panjohur.
B) inhibojnë Na/K ATP-azen në tubulin contort proksimal.

C) inhibojnë një co-transpotues Na/Cl në tubulin distal.
D) inhibojnë çlirimin e reninës.
E) inhibojnë përthithjen e ujit.
PS)C

Pyetja 135 V)2

Cila ekzaminime indikohen në diagnozën e hershme të nefropatisë diabetike?

A) ekografi renale
B) azotemi
C) kreatininemi
D) microalbuminuria
E) rezonancë magnetike e veshkës
PS)D

Pyetja 136 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me vitaminën B12 (Cobalamina) nuk është i vërtetë?

A) Sintetizohet në baktere.
B) Përmban kobalt në grupin prostetik.
C) Mungesa e saj jep aneminë pernicioze.
D) Është thelbësore për aktivitetin e enzimave të përfshira në rirregullimet molekulare.
E) Sintetizohet tek njeriu.
PS)E

Pyetja 137 V)2

Cili është shkaku me i shpështë i stroke ishemik?

A) diabeti
B) hipertension
C) tromboembolia
D) aneurizma
E) anemia
PS)C

Pyetja 138 V)3

Në PETIT MAL mioklonike :

A) nuk jepet terapi.
B) përdoren corticosteroide.
C) është më mirë të përdoret valproati.
D) është më mirë të përdoret difenilhidantoina.
E) është më mirë të përdoren benzodiazepinat.

PS)C

Pyetja 139 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtme mbi diuretiket është korrekt?

A) Kanë një rol terapeutik fondamental në edemat kardiake, në ascitin, në insuficencën renale kronike dhe në sindromin nefrotik.
B) Nuk gjejnë përdorim në dekompensimin ventrikular të majtë akut.
C) Janë efikase vetëm në se përdoren me rrugë parenterale.
D) Duhet të administrohen me rrugë parenterale për të mbajtur efektin diuretik kur ndaj tyre shfaqet rezistencë.
E) Kur administrohen me rrugë orale në doza të larta luftojnë në mënyrë efikase edemën pulmonare nga dekompensimi ventricular akut sinister
PS)A

Pyetja 140 V)1

Karcinoma prostatike është:

A) një neoplazi e rrallë.
B) një neoplazi e shpeshtë në moshë të re.
C) e lidhur gjithmonë me prostatitën.
D) një nga neoplazitë me frekuente të seksit mashkullor.
E) e lidhur me rritjen e alfa-fetoproteinës.
PS)D

Pyetja 141 V)2

Feçet CRETACEE (akolike) observohen tek cila nga nga gjendjet e mëposhtme?

A) hepatit kronik
B) ileit rajonal
C) obstruksion I rrugëve biliare
D) tifo abdominale
E) divertikuloze intestinale
PS)C

Pyetja 142 V)1

Infeksionet e traktit urinar inferior interesojnë:

A) uretrën e prostatën.
B) uretrën, prostatën e vezikën.
C) vezikën e prostatën.
D) vezikën.
E) uretrën.

PS)B

Pyetja 143 V)3

PO2 alveolar është normalisht i barabartë me:

A) PO2 arterial +10 mmHg.
B) PaCO2/R.
C) P barometrik -PN2.
D) PO2 arteriale - 10mmHg.
E) P barometrike + PH2O.
PS)A

Pyetja 144 V)3

Cili nga këto teste përdoret për diagnostikimin e hipotiroidizmit hipotalamik?

A) hipoglicemia insulinike
B) TRH
C) administrimi i L-tiroxinës
D) glukagon endovenoz
E) infuzion te argininës
PS)B

Pyetja 145 V)3

Konsiderohet si një çrregullim i mendimit:

A) amnezia.
B) obsesioni.
C) fobia.
D) deliri.
E) perceptime të gabuara.
PS)D

Pyetja 146 V)3

Defiçiti i alfa-1 antitripsinës:

A) shkakton emfizemë në moshë relativisht të re, veçanërisht tek duhanpirësit.
B) provokon bronkit kronik në gjithë bartësit.
C) nuk përcaktohet gjenetikisht.
D) është i zakonshëm tek heterozigotët për genin Z.
E) intereson veçanërisht apekset.
PS)A

Pyetja 147 V)2

Në rast të mungesës së glukozës në gjak, cili nga mekanizmat e mëposhtme aktivizohet?

A) hepari heq rezervat e glikogjenit dhe çliron glukozë në gjak
B) muskuli heq rezervat e glikogjenit dhe çliron glukozën në gjak
C) hepari çliron acide yndyrore në gjak
D) indi dhjamor heq rezervat e glikogjenit dhe çliron glukozë në gjak
E) truri nxit sintezën e acideve yndyrore
PS)A

Pyetja 148 V)3

Cili nga alterimet e mëposhtme të studimit elektrofiziologjik të konduksionit nervor janë karakteristike për neuropatitë demielinizuese?

A) amplitudë të ulët të potencialit sensitiv
B) ulje të stimulit të përsëritur
C) reduktim të shpejtësisë së konduksionit motor e sensitiv
D) prezencë e fibrilacionit në ekzaminimin me elektrodë gjilpëre koaksiale të muskulit
E) rritje të shpejtësisë së konduksionit
PS)C

Pyetja 149 V)2

Në cilën periudhë të shtatzënisë arrihet maksimumi i volumit të likidit amniotik?

A) 32-34 javë
B) 34-36 javë
C) 36-38 javë
D) 38-40 javë
E) 40-42 javë
PS)C

Pyetja 150 V)1

Simptomat klasike të diabetit janë :

A) poliuria-polidipsia-dobësimi.
B) obezitet-polifagi-vertigo.
C) hipertension-depresion-nauze.
D) dispne-oliguri-edema.
E) temperaturë-kollë-ekspectorat mukopurulent.
PS)A

Pyetja 151 V)2

Në alveolat pulmonare :

A) epiteli paraqet katër tipa qelizorë dhe është aderent me qelizat endoteliale të kapilarëve.
B) surfaktanti prodhohet nga qelizat alveolare (pneumocitet) e tipit të dytë.
C) surfaktanti përdoret nga makrofagët alveolarë.
D) paretet e kapilarëve janë në kontakt direkt me ajrin atmosferik.
E) septumi interalveolar nuk ka fibra elastike.
PS)B

Pyetja 152 V)2

Shkaku më i shpeshtë i COR PULMONARE acute është :

A) pneumonia lobare.
B) infarkti i paretit posterior.
C) gjendja asmatike.
D) embolia pulmonare.
E) infarkti i paretit anterior.
PS)D

Pyetja 153 V)2

Në hemokromatozë akumulimi i hekurit prek kryesisht:

A) hipofizën.
B) pulmonin.
C) pankreasin.
D) testikujt.
E) kristalinën.
PS)C

Pyetja 154 V)2

Në popullatën e shëndoshë midis meshkujve, manifestimi i parë i sëmundjeve koronare është më shpesh:

A) angina kronike e qëndrueshme.
B) infarkti.
C) vdekja e papritur koronarike.
D) angina e paqëndrueshme.
E) insuficienca kardiake post-iscemike.
PS)B

Pyetja 155 V)3

Cila nga teknikat e mëposhtme nuk lejon përcaktimin e antitrupave?

A) testi i aglutinimit

B) western blot
C) fiksimi i komplementit
D) southern blot
E) ELISA
PS)D

Pyetja 156 V)3

Cili është standardi i artë i diagnozës së sëmundjes Hirschprung:

A) biopsia rektale.
B) manometria anorektale.
C) klisma opake.
D) ekografia abdominale.
E) Ph-metria.
PS)A

Pyetja 157 V)2

Rubeola predispozon për një frekuencë më të lartë të defekteve congenitale kur infeksioni merretV

A) në çdo periudhë të gravidancës.
B) pas lindjes.
C) në trimestrin e parë të shtatzënisë.
D) në trimestrin e dytë të shtatzënisë.
E) në trimestrin e tretë të shtatzënisë
PS)C

Pyetja 158 V)1

Cila prej karakteristikave të mëposhtme është tipike e konvulsioneve febrile të thjeshta?

A) Kriza e gjeneralizuar në rast të rritjes së temperaturës trupore tek fëmijet e çfarëdo moshe.
B) Kriza parciale pa humbje të vetëdijes.
C) Kriza të gjeneralizuara tek femijët me defiçite neurologjike të njohura,gjatë një gjendje me rritje temperature.
D) Kriza toniko-klonike te gjeneralizuara në rast të episodeve febrile tek fëmijët e moshës 6 muaj deri në 5 vjeç.
E) Risk i lartë (>50%) për të zhvilluar epilepsi në vitet e mëvonshme.
PS)D

Pyetja 159 V)2

Në cilën gjendje ndeshen: Gishtat me një formë tipike si gungat e devesë ?

A) broncopatia kronike emfizematoze

B) reumatizem artikular akut
C) artrit rheumatoid
D) guta
E) kardipati cianogenë me shunt dexter-sinister
PS)C

Pyetja 160 V)2

Një bashkim midis një individi homozigot dominant (DD) me një homozigot receziv (dd) do të prodhojë:

A) gjithë individet DD.
B) individe DD, Dd, dhe dd në raportin 1.2:1.
C) të gjithë individe Dd.
D) individë Dd dhe DD në raportin 3:1.
E) individë DD, Dd, dhe dd në raportin 2:1:1.
PS)C

Pyetja 161 V)3

Përgjigja kardiovaskulare (me frekuencë kardiake dhe presion arterial) ndaj ushtrimeve fizike muskulare:

A) varet nga dimensioni i masës muskulare të përfshira në ushtrim.
B) varet nga intensiteti i ushtrimeve.
C) tipi i ushtrimeve.
D) varet nga nga dimensioni masës muskulare të përfshirë, nga intensiteti i ushtrimeve dhe nga tipi i ushtrimeve.
E) është e pavarur nga dimensioni i masës muskulare të përfshira në ushtrim.
PS)D

Pyetja 162 V)1

Cilit prej organeve i shkon në kushte normale pjesa më e madhe e hedhjes kardiake?

A) kocka
B) muskuj
C) lëkure
D) tru
E) veshka
PS)E

Pyetja 163 V)3

Kalmodulina është :

A) një anksiolitik.

B) një antidepresiv.
C) një proteinë që aktivizon metabolizmin e hekurit.
D) një proteinë lidhëse e kalciumit.
E) një antipiretik.
PS)D

Pyetja 164 V)3

Koefiçienti i difuzionit të oksigjenit është:

A) më i madh se koefiçienti i difuzionit të anhidridit karbonik.
B) më i vogël se koefiçienti i difuzionit të anhidridit karbonik.
C) i barabarte me koefiçientin e difuzionit të anhidridit karbonik.
D) varet nga temperatura trupore.
E) varet nga volumi pulmonar.
PS)B

Pyetja 165 V)1

Gjatë mononukleozës infektive ekzaminimi i gjakut komplet jep:

A) limfopeni.
B) neutrofili relative.
C) eozinofili.
D) limfocitozë me prani të limfociteve të aktivizuara.
E) policitemi.
PS)D

Pyetja 166 V)2

Shkaku më i zakonshëm i cianozës së ekstremiteteve është:

A) defekt i septumit interatrial.
B) defekt i septumit interventrikular.
C) temperaturë e ulur ambientale.
D) livedo reticularis.
E) sindromi Raynaud.
PS)C

Pyetja 167 V)1

Një tingull perkusioni i qartë hiperfonetik timpanik takohet në toraks në cilën prej gjendjeve?

A) empiema
B) infarkt pulmonar
C) pneumotoraks
D) hidrotoraks

E) simfizë pleurale
PS)C

Pyetja 168 V)2

Në labirint kanalet semicirkulare janë te vendosura

A) pa ndonjë rregull të caktuar.
B) paralel.
C) në seri.
D) në një plan të vetëm.
E) sipas planeve të hapësirës.
PS)E

Pyetja 169 V)2

Për cilën nga neoplazitë nuk ka një procedurë skrinimi të vlefshme?

A) karcinoma e prostatës
B) karcinoma e mamellës
C) karcinoma e pulmonit
D) karcinoma e cerviksit uterin
E) karcinoma e rektumit
PS)C

Pyetja 170 V)2

Rruga më e zakonshme e difuzionit të neoplazive ovariale përfaqësohet nga:

A) venat ovariale
B) limfatike të venës ovariane
C) limfatike pelvike
D) ekstension lokal
E) diseminim endoperitoneal
PS)E

Pyetja 171 V)2

Në nekrosën tubulare akute fillimi më shpesh përcaktohet nga

A) reduktimi i fluksit plazmatik renal ose ekspozim ndaj medikamenteve nefrotoksike.
B) tonsilit streptokoksik.
C) amiloidoze
D) transplant renal recent
E) komplikim septik i interventit kirurgjikal
PS)A

Pyetja 172 V)2

Gjëndra mamare është një gjëndër:

A) olokrine
B) mikse
C) endokrine
D) mesokrine
E) apokrine
PS)E

Pyetja 173 V)3

Në fazën depresive të psikozës maniako-depresive gjëndet më shpesh

A) një delir i fajësimit.
B) një delir për fundin e botës.
C) një delir madhështie.
D) një delir xhelozie.
E) konfabulacion.
PS)A

Pyetja 174 V)2

Litiaza pigmentare në cilën nga gjendjet e mëposhtme ndeshet më shpesh?

A) anemia hemolitike
B) diabeti
C) hiperkolesterolemia
D) ateroskleroza
E) insuficienca renale kronike
PS)A

Pyetja 175 V)3

Në korenë Huntington kemi degjenerim të

A) vermis cerebelar dhe nucleus dentate.
B) hipocampi dhe corpus callos.
C) nukleusi i kuq dhe nukleusi olivar.
D) caudato e putamen.
E) amigdala dhe n.subtalamic.
PS)D

Pyetja 176 V)2

Antitrupat antimitokondriale takohen në sasi të konsiderueshme në cilën prej gjendjeve?

A) ikter nga medikamentet
B) cirrozë biliare primare
C) hepatit kronik agresiv
D) ikter okluziv
E) hepatopati alcoolike
PS)B

Pyetja 177 V)2

Cila nga gjendjet e mëposhtme është shkak për hemoptizi?

A) pertusis
B) sindromi i Goodpasture
C) empiema
D) pleuriti eksudativ
E) aneurizma aortale
PS)B

Pyetja 178 V)1

Gjate shtatzënisë, si rregull:

A) eritrocitet fetale kalojnë në qarkullimin matern.
B) eritrocitet materne kalojnë në qarkullimin fetal.
C) imunoglobulinat M fetale kalojnë në qarkullimin matern.
D) imunoglobulinat G materne kalojnë në qarkullimin fetal.
E) imunoglobulinat M materne kalojnë në qarkullimin fetal.
PS)D

Pyetja 179 V)2

Flora bakteriale normale e pranishme në organizëm

A) është e rëndësishme sepse ka funksione protektive.
B) prania e saj tregon që një subjekt është i sëmurë.
C) është e pranishme vetëm në subjektet e imunosupresuar (SIDA, neoplazi, transplante).
D) është e pranishme vetëm në subjektet që janë shëruar nga një sëmundje infektive.
E) është e pranishme vetëm në subjektet me patologji infektive kronike.
PS)A

Pyetja 180 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtme që kanë lidhje me rifampicinën është i saktë?

A) Është aktive ndaj mycobacterium tuberculosis.
B) Eleminohet kryesisht me rrugë renale.

C) Nuk absorbohet me administrim oral.
D) Nuk është aktive ndaj micobaktereve "atipike".
E) Mekanizmi i veprimit konsiston në një inhibim të sintezës së paretit qelizor.
PS)A

Pyetja 181 V)2

Cila është neoplazia solide më e shpeshtë midis meshkujve 20-35 vjec:

A) tumor me qeliza germinale
B) sarcoma Ewing
C) melanoma
D) karcinoide
E) glioblastoma
PS)A

Pyetja 182 V)2

Në remisionin e plotë të leuçemisë acute numri i blasteve medulare nuk duhet të jetë më i lartë se

A) 5%.
B) 20%.
C) 30%.
D) 40%.
E) 50%.
PS)A

Pyetja 183 V)2

Punksioni lumbar indikohet në vënien e diagnozës për

A) cefale vasomotore.
B) iscemi cerebrale.
C) demencë multi-infarktuale.
D) hemorragji subaracniodale.
E) trombozë e karotides.
PS)D

Pyetja 184 V)2

Shenja e fluctuimit (balotimit) abdominal është pozitive në një nga këto gjëndje:

A) versament ascitik
B) megakolon
C) veshkë e lëvizshme dhe e palpueshme
D) ansa e dilatuar suprastenotike

E) meteorizëm kolik difuz
PS)A

Pyetja 185 V)2

Në sëmundjen nga refluksi gastro-esofageal pervec djegjes ka edhe një simptomë që konsiderohet tipike:

A) dhimbje epigastrike
B) të vjella të përseritura
C) disfoni
D) astma
E) kollë kronike
PS)A

Pyetja 186 V)2

Cili nga të mëposhtmit është shkak i edemës mantel?

A) insuficienca e valvules pulmonare
B) insuficienca e valvulës aortale
C) hipotiroidizmi
D) kompresion i venës cava superiore
E) sindromi scalenus anterior
PS)D

Pyetja 187 V)3

Cili nga faktorët e mëposhtëm provokon vazokonstriksion të arteriolave kutane

A) ulja e presionit arterial
B) rritja e metabolizmit indor
C) rritje e përqëndrimit të CO2 në gjak
D) ulja e përqëndrimit të CO2 në gjak
E) rritje e adrenalinës qarkulluese
PS)E

Pyetja 188 V)2

Një cistit hemorragjik mund të realizoje efektin anësor të një terapie me :

A) triamcinolon
B) prednisolon
C) betametason
D) ciclofosfamid
E) ciprofloxacin
PS)D

Pyetja 189 V)2

Cili nga të mëposhtmit është një funksion metabolik i pulmonit?

A) prodhim i ACTH
B) prodhim i glukagonit
C) prodhim i PTH
D) sekrecion i eritropoetinës
E) konversion i angiotenzinës
PS)E

Pyetja 190 V)1

Kur tensioni arterial matet me auskultim:

A) presioni diastolik mund të perceptohet duke mbështetur fonendoskopin në sipërfaqen precordiale të toraxit
B) zhurmat e perceptuara janë pasojë e vibracionit të ajrit që ndodhet në fashetën e fryrë
C) nuk është e nevojshme të përdoret një fashetë më e vogel se ajo standard për fëmijët
D) vlera e presionit sistolik korrespondon me zhurmën e parë të dëgjuar ndërkohë që presioni në fashetë vjen duke u ulur
E) vlera në auscultim e presionit arterial korrespondon ekzaktësisht me atë të kapur me palpacion
PS)D

Pyetja 191 V)3

Në katatoni vërehet shpesh

A) kriza konvulsive.
B) rite.
C) stereotip motor.
D) depresion.
E) rënie intelektuale.
PS)C

Pyetja 192 V)3

Cili nga pohimet këtu me poshtë lejon diferencimin e dermatitit seborrheik nga dermatiti atopik tek latanti?

A) lezionet janë pruriginose
B) skuamat janë të yndyrshme dhe të verdha
C) lezionet lokalizohen ekskluzivisht në scalp
D) lezionet shfaqen në muajt 4-6 të jetës
E) manifestimet recidivojnë për vite

PS)B

Pyetja 193 V)2

Acidet biliare që prodhohen nga metabolizmi i kolesterolit pësojnë pjesërisht një

A) aminim reduktues.
B) konjugim në nivel hepatik
C) dekarboksilim në nivel hepatik.
D) dekarboksilim në nivel intestinal.
E) konjugim në nivel renal.
PS)B

Pyetja 194 V)2

Kur flasim për medikamentet diuretike (apo medikamente të aftë të negativizojë bilancin hidroelektrolitik), cili mund të konsiderohet si indeks direkt i aktivitetit të tij?

A) reduktim i presionit arterial
B) reduktim i edemës
C) reduktim i incidences së infarktit të miokardit
D) reduktim i mortalitetit
E) rritje e sekretimit të natriumit
PS)E

Pyetja 195 V)2

Cili nga proceset aktivizohet herët gjatë një gjëndje esëll?

A) anabolizmi proteinik
B) katabolozmi proteinik
C) glikogenoliza
D) ketogjenëza
E) oksidimi cerebral i trupave ketonike
PS)C

Pyetja 196 V)2

Në arrestin kardiak janë gjithmonë të pranishme shenjat e mëposhtme ,me përjashtim të

A) mungesës së pulsit periferik.
B) mungesë së pulsit qendror.
C) gjendjes së komës.
D) hipertensionit.
E) mungesës së frymëmarrjes.
PS)D

Pyetja 197 V)2

Qelizat HAIRY (si flokë) kanë karakteristikat e

A) limfociteve T.
B) limfociteve B.
C) limfociteve "null".
D) monociteve.
E) granulociteve.
PS)B

Pyetja 198 V)1

Uterusi është i vendosur

A) midis simfizës pubike dhe vezikës urinare.
B) pas rektumit.
C) në anën e majtë të rektumit.
D) në të djathtë te vezikës urinare .
E) në pelvisin e vogël midis vesikës urinare dhe rektumit.
PS)E

Pyetja 199 V)3

Çfarë kuptojmë me sëmundjen Dupuytren?

A) tenosynovit stenozant i mbeshtjellës së fleksoreve të gishtave
B) sinostozë e lindur radioulnare
C) tërheqje e aponeurozës palmare
D) nekrozë aseptike e scafoidit
E) pseudoartroze e scafoidit
PS)C

Pyetja 200 V)2

Cili nga të mëposhtmit është indeks i nivelit të filtrimit glomerular?

A) kreatininemia
B) azotemia
C) uricemia
D) fosforemia
E) glicemia
PS)A

Pyetja 201 V)2

Markuesit tumorale janë

A) indikatorë, pak a shumë specifike të pranisë së një neoplazie.
B) indikatorë prognostike tek neoplazitë.
C) faktorë parashikues të përgjigjes ndaj kemioterapisë.
D) indikatorë të aktivitetit proliferativ.
E) indikatorë të masës tumorale.
PS)A

Pyetja 202 V)3

Esofagu Barret është

A) një lezion esofageal distal i karakterizuar nga metaplazia gastrike dhe intestinale.
B) një lezion i sfinkterit esofageal inferior me alterim të motilitetit.
C) një laceracion i paretit esofageal me hemorragji.
D) një divertikul i ezofagut cervical.
E) një fistul kongenitale ezofago-trakeale.
PS)A

Pyetja 203 V)2

Për kolesterolin mund të pohojmë se

A) nuk sintetizohet tek njeriu por duhet të merret me dietë.
B) është i tretshëm në plazëm në prani të natriumit.
C) përfaqëson prekursorin e hormoneve steroidë dhe të acideve biliare.
D) është një metabolit i testosteronit.
E) sekretohet nga veshka.
PS)C

Pyetja 204 V)2

Kur është e indikuar të fillohet ablaktacioni?

A) në muajin e dytë të jetës
B) në muajin e katërt të jetës
C) në muajin e gjashtë të jetës
D) në muajin e tetë të jetës
E) në muajin e dhjetë të jetës
PS)C

Pyetja 205 V)2

Cila vlerë prag të glicemisë duhet për shfaqjen e glukozurisë?

A) 160-180mg/dL
B) 90 g/dL

C) 70-105mg/dL
D) 5.5mmol/L
E) 5.5nmol/L
PS)A

Pyetja 206 V)2

Prekja limfonodulare e sifilisit sekondar është e tipit

A) paketë limfonodulash inguinale.
B) mikropoliadenopatia.
C) vetëm limfonodula pelvike.
D) vetëm limfonodula hilare.
E) të gjitha limfonodulat abdominale.
PS)B

Pyetja 207 V)2

Cilat hormone gjenden në mbaresat nervore gangliare ?

A) ACTH
B) katekolamina
C) glikokortikoide
D) kortison
E) aldosteron
PS)B

Pyetja 208 V)2

Cila është neoplazia pulmonare më shumë e lidhur me ekspozimin profesional?

A) adenokarcinoma
B) microcitoma
C) ca spinocellular
D) mesotelioma pleurale
E) carcinoide
PS)D

Pyetja 209 V)2

Cili nga çrregullimet e mëposhtme elektrolitike çon në zgjatjen e QT dhe të një vale U në EKG?

A) hipokalemia
B) alkaloza
C) hipercalcemia
D) hiperkalemia
E) hiponatremia

PS)A

Pyetja 210 V)2

Një hernie diskale L3-L4 dexter postero-laterale mund të japë

A) lumbocruralgi dexter.
B) lumbosciatalgi dexter.
C) lumbocruralgi bilaterale.
D) lumbocruralgi dhe lumbosciatalgi dexter.
E) lumbocruralgi dhe lumbosciatalgi bilaterale.
PS)A

Pyetja 211 V)1

Manovra Lasegue është pozitive

A) në vuajtjet e nervit shiatik.
B) në neoplazitë e kolonës vertebrale.
C) në poliomielit.
D) në miopatitë.
E) në distorsionet vertebrale.
PS)A

Pyetja 212 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtme është i saktë kur flasim për diagnozën prenatale të uropative keqformuese?

A) e mundshme vetëm pas javës 38 të shtatzanisë
B) e mundshme dhe në shume raste jo shume komplekse
C) e mundshme por gjithmonë e vështire
D) e pamundur
E) e mundshme vetëm në rast shtatzanie gemelare
PS)B

Pyetja 213 V)1

Çfarë tip sekrecioni është karakteristik për rinitin alergjik?

A) seroz
B) mukoz
C) muco-purulent
D) purulent
E) mungesë të sekrecioneve
PS)A

Pyetja 214 V)3

Mund të flitet për të vonuar mendor, sipas DSM IV (Diagnostic and Statistical Manual of Mental Disorders, 4-th edition) dhe ICD 10 (10-th revision of International Statistical Classification of Diseases and Related Health Problems) kur IQ (koeficienti in
A) 85
B) 70
C) 75
D) 100
E) 50
PS)B

Pyetja 215 V)1

Dispne do të thotë

A) nevoje për të marre frymë me gojë hapur.
B) nevojë për të marrë frymë me trungun drejt.
C) ndjenjë e mungesës së ajrit.
D) frymëmarrje e zhurmshme.
E) rritje e frekuencës respiratore.
PS)C

Pyetja 216 V)2

Veshka merr pjesë në rregullimin e ekuilibrit acido-bazik

A) duke stabilizuar përqëndrimin e bikarbonatit në plazëm dhe eleminuar jonet e hidrogjenit.
B) duke filtruar amoniakun.
C) duke këmbyer jonet e hidrogjenit me jonet e klorit.
D) duke përthithur aminoacidet.
E) duke eleminuar ujin e tepërt.
PS)A

Pyetja 217 V)2

Cili ekzaminim laboratorik kryhet për diagnozën e tinea corporis?

A) prova Tzank
B) teste epikutane
C) intradermoreaksione me antigenë bakterialë
D) ekzaminim mikroskopik i materialit të freskët
E) ekzaminim histologjik
PS)D

Pyetja 218 V)2

Në prani të një pancitopenie periferike, palca e kockave është hipocelulare në rast të

A) limfomës jo-Hodgkin.
B) mielomës.
C) anemisë aplastike.
D) osteomielitit.
E) sëmundjes Hodgkin.
PS)C

Pyetja 219 V)2

Sëmundja Raynaud është

A) një tromboflebit.
B) një tip aterosklerose e lokalizuar në anësitë e poshtme.
C) sinonim i një nuropatie diabetike.
D) një çrregullim qarkullues simetrik i duarve e këmbëve.
E) një sindrom neurovascular nga kompresioni I arteries subklavia.
PS)D

Pyetja 220 V)3

Çfarë kuptojmë me Sëmundje të De Quervain?

A) tenosinovit kronik stenosant të mbështjellës sinoviale të përbashkët të muskujve ; të shkurtër ekstensor dhe të gjatë abduktor të gishtit te madh.
B) tenosinovit reumatik transitor i mbështjellës sinoviale të fleksoreve e ekstensoreve të gishtave të dorës
C) nekroze aseptike e skafoidit
D) flegmonë e thellë sub-aponeurotike që prek mbështjellën sinoviale të muskujve fleksorë të gishtave
E) sinostozë e lindur midis kockave te pjeses së parë të karpeve.
PS)A

Pyetja 221 V)2

Cila nga sëmundjet e mëposhtme infektive nuk transmetohet me kontakt direkt me të sëmurin?

A) varicella
B) hepatit viral A
C) ethe tifoide
D) brucelozë
E) poliomielit
PS)D

Pyetja 222 V)2

Autozome janë kromozome

A) gjigande.
B) metacentrike.
C) telocentrike.
D) me unazë
E) që nuk kontribuojnë në përcaktimin e seksit.
PS)E

Pyetja 223 V)2

Cila patologji duhet të dyshohet në prani të cilindrave hematike në sedimentin urinar?

A) glomerulonefrit
B) kalculoze renale
C) pspilome vescicale
D) tuberculos renal
E) karcinomë renalë
PS)A

Pyetja 224 V)3

Duktusi peritoneo-vaginal është normalisht i kalueshëm në:

A) 10% e pacientëve
B) 94% e pacientëve
C) 94% e adultëve
D) 94% e femijëve në moshë shkollore
E) 10% e femijëve në moshë shkollore
PS)B

Pyetja 225 V)2

Në vlerësimin e një limfadenopatie retroperitoneale, cila nga teknikat e mëposhtme imazherike është më e përshtatshmja?

A) ekografia endokavitare
B) PET
C) CT
D) SPECT
E) angiografi
PS)C

Pyetja 226 V)3

Hipertensioni arterial në adenomën surrenale aldosteron sekretuese hetohet më mirë me

A) dozimin në pozicion supin i aldosteronit plazmatik.
B) dozimin e thjeshtë të kalemisë.
C) dozimin plazmatik te aldosteronit dhe aktivitetit të reninës në pozicion supin dhe ortostatik
.
D) testin e suprimimit me dexamethason në dozën 2 mg për 2 ditë.
E) dozimin e kortikosteronit gjatë kateterizimit venoz selektiv.
PS)C

Pyetja 227 V)2

Perikarditi mund të shfaqet gjatë

A) diabetit mellitus.
B) sëmundje të indit lidhor.
C) hypertension arterial.
D) bronkit kronik obstruktiv.
E) hiperkolesterolemi.
PS)B

Pyetja 228 V)2

Cili prej markuesve të mëposhtëm serologjike shfaqet përpara gjatë përiudhës së inkubacionit të hepatitit B?

A) anti-HBeAg
B) anti-HBcAg IgM
C) HBcAg
D) anti-HBcAg
E) HbsAg
PS)E

Pyetja 229 V)2

Me cilën nga gjendjet e mëposhtme janë të lidhura antitrupat anti-citoplazmike të neutrofileve (ANCA)?

A) cirrozë biliare primare
B) hepatit autoimun i tipit I
C) hepatit autoimun i tipit II
D) kolangit sclerosant primar
E) hepatokarçinoma
PS)D

Pyetja 230 V)2

Shenjat klinike te tireotoksikozës janë

A) intolerancë ndaj të ftohtit.
B) rënie të oreksit.
C) rënie në peshë.
D) onikofagia.
E) insuficencë renale.
PS)C

Pyetja 231 V)2

Cila nga gjendjet lidhet më shpesh me adenokarcinomën e ezofagut?

A) acalasia
B) alkoolizmi
C) tylosis
D) esofagu Barret
E) duhani
PS)D

Pyetja 232 V)2

Në gjendjen esëll; cilet janë komponentet rezervë që përdoren?

A) cerumen
B) cellulosa
C) acide nukleike
D) glikogjen dhe lipide
E) protein
PS)D

Pyetja 233 V)2

Glukagoni stimulon:

A) degradimin e glikogenit dhe çlirimin e glukozës nga hepari.
B) glikolizën.
C) sintezën e glikogenit në hepar.
D) sintezën e glikogenit në muskul.
E) sintezën e bazave purinike.
PS)A

Pyetja 234 V)2

Cila nga gjendjet nuk mund të provokojë një anemi megaloblastike?

A) mungesa e hekurit
B) celiachia

C) gastrectomia totale
D) mungesa e vitaminë B12
E) sindromi Zollinger-Ellison
PS)A

Pyetja 235 V)1

Shenja Murphy tregon një reaksion të dhimbshem me origjinë:

A) viscerale.
B) të referuar.
C) nga projeksioni.
D) peritoneale.
E) somatike sipërfaqësore.
PS)A

Pyetja 236 V)3

Cila nga karakteristikat e mëposhtme indikon një urgjencë neurologjike-neurokirurgjikale tek një fëmijë me cefale akute?

Kushërinjtë e parë janë të afërm të

A) gradës së parë.
B) gradës së dytë.
C) gradës së tretë.
D) gradës së katërt.
E) gradës së pestë.
PS)C

Pyetja 105 V)2

Terapia me statina është e dobishme në reduktimin sinjifikativ të eventeve tek subjektet me risk të moderuar?

A) Po.
B) Jo.
C) Po, por vetëm tek pacientët me nivele të lartë të Proteines C reaktive.
D) Po, por vetëm tek pacientt diabetikë.
E) Nuk mund të përgjigjemi për momentin sepse nuk ka trials klinike disponibël që të kenë përfshirë pacientë me risk të moderuar.
PS)A

Pyetja 106 V)3

Barnat me të përdorshëm në trajtimin e hiperkalemisë janë

A) digitali.
B) antagonistët e Kalçiumit.
C) glukonati i Kalçiumit endovenoz.
D) magnezi endovenoz.
E) solucioni fiziologjik endovenoz
PS)C

Pyetja 107 V)3

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk eshte nje komplikacion i aneurizmes së aortës abdominale?

A) ruptura
B) embolia
C) shtypje e strukturave fqinje

D) tromboza
E) insufiçenca renale kronike
PS)E

Pyetja 108 V)3

Cila nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë e kardiomiopatisë dilatatore?

A) galopi me ton të tretë
B) ralet pulmonare
C) impulsi ventrikular i majtë i dislokuar medialisht, difuz
D) regurgitimi i valvulës mitrale
E) galopi me ton të katërt
PS)C

Pyetja 109 V)2

Me vartësi ndaj nje substance kuptohet

A) nevoja për të rritur dozën e substancës, për të marrë të njëjtat efekte.
B) një shkak i abstinencës.
C) një sensacion psikik i qartë i sjelljes ndaj faktorëve stresues.
D) e kundërta e tolerancës.
E) një sinonim i varësisë.
PS)A

Pyetja 110 V)1

Në aktin e gëlltitjes faza e vullnetshme është ajo

A) orale.
B) faringeale.
C) ezofageale.
D) gastrike.
E) laringeale.
PS)A

Pyetja 111 V)2

Në prani të hipoventilimit diferenca alveolo-arteriale e Presionit parcial te O2 është

A) normale.
B) e reduktuar.
C) e rritur.
D) e dyfishuar.
E) të paktën e trefishuar.
PS)A

Pyetja 112 V)1

Përkufizohet transplant

A) transferimi i një indi me pedunkulin e tij vaskular nga një pjesë e trupit në një tjetër.
B) transferimi i nje indi të privuar nga mbështetja vaskulare nga një vend donator në një marrës, pa anastomoze mikrokirurgjikale.
C) transferimi i nje indi nga një pozicion i trupit në një tjetër.
D) transferimi i një indi të privuar nga mbështetja vaskulare nga një zonë donatore në një zonë pritëse me anastomozë mikrokirurgjikale.
E) transferimi i një indi nga një vend i trupit në një tjetër pavarësisht vaskularizimit.
PS)B

Pyetja 113 V)3

Cilat efekte kolaterale janë karakteristike të ACE- inhibitorëve?

A) bradikardia
B) pruriti
C) edema e anësive të poshtme
D) kollashpëthyese/ e zgjatur dhe intense
E) retension urinar
PS)D

Pyetja 114 V)2

Cili bakter është i përfshirë në 90% të mediastiniteve deshendente nekrotizuese?

A) streptokoku beta hemolitik
B) pneumocisti carini
C) streptococu piogen
D) streptococus pneumonie
E) pseudomonas aeruginosa
PS)A

Pyetja 115 V)3

Veshka polikistike është

A) një sëmundje infektive.
B) një formë e pielonefritit pseudokistik.
C) një sëmundje jatrogjene.
D) një sëmundje autosomike dominante monolaterale.
E) një sëmundje autosomale dominante .
PS)E

Pyetja 116 V)2

Indikacionet e mëposhtme për kolecistektomine janë të sakta, përveç

A) dhimbjes së dobët abdominale, meteorizëm.
B) kolikës biliare.
C) kolecistit akut.
D) kalçifikimit të kolecistës (koleçista si porcelan).
E) pankreatitit akut idiopatik.
PS)A

Pyetja 117 V)1

Cila nga barnat e mëposhtëm është një fibrat?

A) kolestiramina
B) atorvastatina
C) fenofibrati
D) amlodipina
E) fenfluoramina
PS)C

Pyetja 118 V)1

Terapia e atakut akut të podagrës bazohet në përdorimin e

A) AIJS.
B) kortizonikëve.
C) allopurinolit.
D) hidroksiklorokines.
E) olkicinës.
PS)A

Pyetja 119 V)1

Trajtimi i zgjedhur për intoksikimin e rëndë nga litiumi (Litiumemia?3.5mEq/L) është

A) hemodializa.
B) karboni aktiv me sonde nazo-gastrike.
C) Infuzion i solucionit fiziologjik.
D) infuzion i solucionit fiziologjik dhe furosemid.
E) bikarbonat i sodiumit endovenoz.
PS)A

Pyetja 120 V)2

Përqindja e embolive pulmonare të diagnostikuara tek pacientët e gjallë në raport me ato të diagnostikuara në autopsi është

A) 10%.
B) 50-60%.
C) 80-90%.
D) 20-30%.
E) e panjohur.
PS)D

Pyetja 121 V)2

Cila nga të mëposhtmet nuk është gjetje e zakonshme në diagnozën e mielomës multiple?

A) hiperkalçemia
B) piku M ne serum
C) plazmocite në palcën e kockës mbi 10%
D) lezionet osteolitike
E) piku i M në urinë
PS)A

Pyetja 122 V)1

Cili nga pohimet në lidhje me përthithjen nuk është i vërtetë?

A) kryesisht në duoden
B) vitamina B12 përthithet në ileum
C) përthithja më e madhe e yndyrnave ndodh në jejunumin proksimal
D) yndyrnat me zinxhir të shkurtër kalojnë në limfën intestinale
E) Rreth 85% e aminoacideve përthithet në jejunum
PS)D

Pyetja 123 V)1

Anemia makrocitare nuk shkaktohet nga

A) retikulocitoza.
B) deficit i vitaminës B12.
C) deficit i folateve.
D) sindroma mielodisplazike.
E) anemia sideroblastike.
PS)E

Pyetja 124 V)3

Nje grua 22 vjeçare që vuan prej diabetit qe prej 6 vitesh, tani dëshiron një fëmijë. Pacientja merr 32 unitete insulinë NPH (ordinere/ normale) çdo mëngjes dhe eleminimi urinar i glukozes (matur dy herë në ditë) shënon "gjurmë 1+". Sasia e hemoglobin

A) tani është e nevojshme të monitorojë gliceminë në shtëpi e t`i nënshtrohet çdo dite injeksioneve subkutane multiple të insulines me veprim te shpejte (rapid).

B) kontraceptivët oralë mund të induktojnë rritje të niveleve të HbA1C.

C) mund të pritet një kontroll më i mirë i diabetit deri në fillim të një shtatzënësie.

D) skema aktuale e terapisë insulinike do të jetë e përshtatshme probabilisht deri në trimestrin e parë të shtatzënësisë.

E) mund të jetë e nevojshme të hospitalizohet gjatë shtatzënësise për të garantuar një lindje dhe një periudhë perinatale të rregullt.

PS)A

Pyetja 125 V)2

Shkaku me i shpeshtë i angioedemës së izoluar tek i rrituri aktualisht pranohet të jetë

A) deficit i inhibitorit C1.

B) defiçit i funksionit fagocitar.

C) defiçit i IgA.

D) terapia me ACE inhibitorë.

E) terapia me betabllokues

PS)D

Pyetja 126 V)1

Cila është vlera e dëshirueshme e LDL kolesterolit për një individ me risk të lartë kardiovaskular?

A) e barabartë ose më e vogël se 100mg/dL

B) në intervalin 100-130 mg/dL

C) në intervalin 130-160 mg/dL

D) varet nga shkaqet e hiperkolesterolemisë

E) nuk ekziston nje vlerë e dëshirueshme

PS)A

Pyetja 127 V)2

Çrregullim metabolik që nuk shoqërohet me sëmundje të depozitimit të pirofosfatit të kalçiumit është

A) hipotiroidizmi.

B) hemocromatosa.

C) hiperoksaluria primitive.

D) hiperparatiroidizmi.

E) podagra.

PS)C

Pyetja 128 V)1

Nuk përjashton diagnozën e disekacionit të aortës

A) aortografia.
B) CT-skan.
C) RMN.
D) ekokardiografia transezofageale.
E) ekokardiografia transtorakale.
PS)E

Pyetja 129 V)1

Nuk është faktor risku i hemorragjisë gastrointestinale në një njësi të terapisë intensive

A) trauma kraniale.
B) ventilimi mekanik.
C) koagulopatia.
D) ileusi.
E) insufiçenca renale.
PS)D

Pyetja 130 V)2

Prania e leukociteve në një kampion feçesh ose mukusi rektal mund të shkaktohet prej secilës, përveç:

A) campyobacter jejuni.
B) shigella Sonni.
C) giardia lambia.
D) kolitit ulçeroz.
E) entamoeba histolitika.
PS)C

Pyetja 131 V)3

ARDS (Acute respiratory distress syndrome) karakterizohet nga:

A) hipoksia dhe hiperkapnia.
B) hipoksia e pakorrigjueshme nga oksigjenoterapia.
C) hipoksia e korrigjueshme nga oksigjenoterapia.
D) hipoksia e lehtë dhe hiperkapnia e rëndë.
E) hiperkapnia e rëndë.
PS)B

Pyetja 132 V)1

Ushqyerja me gjak e mushkërisë bëhet nga

A) arteria pulmonare.
B) arteriet mamare interne.
C) arteriet intercostale.
D) aorta torakale.
E) venat pulmonare.
PS)D

Pyetja 133 V)2

Kushërinjtë e parë kanë të përbashkët

A) ½ e gjenomës.
B) ¼ e gjenomës.
C) 1/8 e gjenomës.
D) 1/16 e gjenomës.
E) 1/32 e gjenomës.
PS)C

Pyetja 134 V)2

Çfarë janë LDL-të e vogla dhe dense?

A) një nënklasë e LDL-ve veçanërisht aterogjenike
B) në nënklasë e LDL-ve që janë më të pasura në kilomikrone
C) një nenklasë e LDL-ve që migrojnë në elektroforezë me HDL
D) një nënklasë e LDL-ve që janë prezente në limfë
E) një nenklasë e LDL-ve që formohet gjatë tretjes
PS)A

Pyetja 135 V)2

Presioni neto i ultrafiltrimit glomerular është

A) 100-120 mmHg.
B) 75-100 mmHg.
C) 50-75 mmHg.
D) 30-50 mmHg.
E) 10-20 mmHg.
PS)E

Pyetja 136 V)2

Në cilën prej alternativave hasen më shpesh gurët e bilirubinatit?

A) Gilbert
B) purpura Trombocitopenike
C) Hodgkin
D) sferocitoza hereditare
E) leucemia
PS)D

Pyetja 137 V)3

Qarkullimi pulmonar është nje sistem që karakterizohet nga

A) presion i ulët dhe fluks i lartë.
B) presion i lartë dhe fluksi i ulët.
C) presion i lartë dhe fluks i lartë.
D) presion i ulët dhe fluks i ulët.
E) rezistencë e lartë ndaj fluksit.
PS)A

Pyetja 138 V)1

Rregullatori më i rëndesishëm i përqendrimit te 1-25 OH vitamines D është

A) kalçemia.
B) magnezemia.
C) 25-OH vitamina D serike.
D) PTH (parathormon)
E) prolaktina
PS)D

Pyetja 139 V)1

Tek pacientët e prekur nga hiperlipidemia familjare e kombinuar risku kardiovakular

A) rritet.
B) ulet.
C) mbetet i njëjtë me atë të hipertrigliceridemisë familjare.
D) mbetet i pandryshuar dhe varet nga faktorë të tjerë risku.
E) nuk dihet.
PS)A

Pyetja 140 V)2

Shfaqja e dhimbjes unilaterare dhe trizmës tek një pacient me tonsilit akut sugjeron për

A) tonsilit kronik.
B) karcinomë të tonsilës.
C) dyshim mbi komplikacion neurologjik të tonsilitit akut.

D) abces peritonsilar.
E) flegmonë latero faringeale.
PS)D

Pyetja 141 V)2

Koartacioni i aortës mund të shoqërohet me gjithë të mëposhtmet ,përveç

A) aneurizmës së ciklit të Ëillis.
B) cianozës centrale.
C) hipertensionit.
D) shenjës kostale.
E) valvulës aortike bikuspidale.
PS)B

Pyetja 142 V)1

Cili nga të mëposhtmit nuk është faktor risku për kancerin skuamoz të ezofagut?

A) duhani.
B) gëlltija e substancave alkaline.
C) akalazia.
D) alkooli.
E) papiloma skuamoze.
PS)E

Pyetja 143 V)1

Lepirudina është një

A) antiviral.
B) tip i ri interferoni.
C) inhibitor IIbIIIa.
D) antikoagulant alternativ per pacientet me trombocitopeni te induktuar nga heparin.a
E) antibiotik
PS)D

Pyetja 144 V)1

Të gjithë janë faktorë risku për adenokarcinomën gastrike, përveç

A) ulçerës peptike.
B) polipozës adenomatoze të stomakut
C) nitrozaminës në ushqime
D) imunodefiçencës komune variabile.
E) intervenit të mëparshëm kirurgjikal për ulçer peptike.
PS)A

Pyetja 145 V)2

Defiçit vitaminik i nënës që shton riskun për defekte të tubit neural tek fëmija është

A) riboflavina.
B) niacina.
C) calciferolo.
D) acidi retinoik.
E) acidi folik.
PS)E

Pyetja 146 V)3

Në terapinë e astmës bronkiale, cili nga medikamentet e mëposhtme është më pak i indikuar?

A) agonsitët beta-adrenergjikë
B) steroidet sistemike
C) antihistaminikët
D) steroidet topike
E) metilksantinat
PS)C

Pyetja 147 V)1

Përkufizohet implant

A) një zëvendësim indor i marrë nga një specie tjetër.
B) transferimi i njëlemboje nga një individ në tjetrin.
C) një material i përdorur brenda organizmit, por i huaj për të.
D) sinonimi i protezës mamare prej silikoni.
E) çfarëdolloj materiali biologjik.
PS)C

Pyetja 148 V)3

Cili është simptomi më i shpeshtë në një lezion të meniskut?

A) bllokimi i artikulacionit
B) këputja e gjurit
C) krepitacioni
D) dhembja
E) versamenti
PS)D

Pyetja 149 V)1

Cila thënie mbi patologjitë kardiovaskulare nuk është e vërtetë?

A) Shkaku i parë i vdekshmërisë në Amerikë.
B) 500.000 amerikanë vdesin çdo vit nga infarkti akut i miokardit.
C) Pjesa më e madhe e vdekjeve prej infarktit të miokardit verifikohet pas mbërritjes në spital.
D) Pjesa më e madhe e vdekjeve prej infarktit te miokardit jane te papritura.
E) Përqindja e vdekjeve nga infarkti i miokardit sipas moshes është reduktuar në SHBA prej vitit 1950.
PS)C

Pyetja 150 V)1

Cila nga thëniet e mëposhtme mbi trapiantin kardiak nuk është e vërtetë:

A) Në SHBA indikacioni më i shpeshtëështë kardiopatia ishemike e ndjekur nga kardiopatia idiopatike.
B) Aktualisht vetëm 10-20% e donatorëve potencialë të zemrës përdoren.
C) Mbi 30% e pacientëve vdes duke qenë në liste pritjeje për trapiant.
D) Imunosupresioni kronik rutinë përfshin prednizone, azatioprine e ciklosporinë.
E) Hipertensioni është efekt i rrallë kolateral i ciklosporinës.
PS)E

Pyetja 151 V)3

Lezioni glomerular intrinsek (primitiv) më i zakonshëm është

A) glomerulonefriti nga antikorpet kundër membranës bazale glomerulare.
B) glomerulonefriti idiopatik membranoproliferativ.
C) amiloidoza.
D) nefropatia nga IgA.
E) glomeruloskleroza fokale e segmentare idiopatike.
PS)D

Pyetja 152 V)1

Cila nga manifestimet e meposhtme haset ne sindromen Sj?gren?

A) eritema malare
B) uveiti
C) eritema nodoze
D) cefalea
E) xeroftalmia
PS)E

Pyetja 153 V)3

Pacientët me rrahje ventrikulare premature trajtohen më mire me

A) propafenon.
B) moricizine.
C) amiodaron.
D) mexiletine.
E) sqarim për natyrën e tyre beninje.
PS)E

Pyetja 154 V)3

Ikteri në sindromën e Crigler-Najar shkaktohet nga

A) alterimi i konjugimit te bilirubinës.
B) rritja e prodhimit të bilirubinës.
C) defiçiti i transportit të bilirubinës.
D) alterimi i ekskretimit të bilirubinës.
E) obstruksioni i duktuseve biliare intrahepatike.
PS)A

Pyetja 155 V)3

Të gjitha këto gjetje shoqërohen me sindromën e Kallman, përveç

A) anosmisë ose hipoosmisë.
B) testosteronit të reduktuar me LH e FSH te rritur.
C) akromatopsisë (verbërimit për ngjyrat) .
D) metakarpit të katërt të shkurtër.
E) normoprolaktinemisë.
PS)B

Pyetja 156 V)3

Sindromat nga diskinezia ciliare, përfshirë sindromën e Kartagener, nuk japin

A) bronkiektazi.
B) pulmonit.
C) bronkite rekurrente.
D) fibrozë pulmonare intersticiale.
E) sterilitet.
PS)E

Pyetja 157 V)3

Një burrë 40 vjeçar paraqitet në repartin e urgjencës duke u ankuar për dhembje epigastrike, melena e nauze. EGDS (esofago-gastro-duodenoskopia) evidenton një ulçër duodenale 2cm dhe biopsitë antrale janë pozitive për Helicobacter Pylori. Cila është ar
A) reduktimi i riskut të kancerit të stomakut

B) shërimi i ulçerës duodenale
C) shërimi i ulçerës duodenale dhe reduktimi i riskut për recidivë të ulçerës
D) parandalimi i nje MALTome
E) parandalimi i transmetimit të Helicobacter Pilori tek familjarët
PS)C

Pyetja 158 V)2

Depozitimi i vargjeve të lehta monoklonale në veshkë mund të percaktojë secilin nga lezionet e mposhtme, përveç

A) cilindrave në lumenin tubular.
B) amiloidozën primare.
C) depozitimet granulare me dëmtim granular.
D) vaskulitin.
E) nekrozën tubulare akute.
PS)D

Pyetja 159 V)3

Cila nga thëniet e mëpshtme mbi poliarteritin nodoz është e vërtetë?

A) Të dhëna anatomopatologjike tipike për vaskulitin leukocitoklasik me detrite nukleare.
B) Lezionet prekin arteriet me kalibër të mesëm e të vogël veçanërisht në pikat e bifurkimit.
C) Është e shpeshtë eozinofilia me interesim te mushkërisë.
D) Është tipike hipokomplementemia.
E) Evidentohen zakonisht noduj subkutan.
PS)B

Pyetja 160 V)3

Cili nga faktorët e mëposhtëm është një faktor prognostik negativ i rekuperimit funksional pas fraktures së femurit?

A) fraktura nën trokanter
B) fraktura pre-trokanter
C) mosha e re
D) histori me rënie te konjiticionit
E) rikthim në banesë pas daljes nga spitali
PS)D

Pyetja 161 V)2

Cili nga ekzaminimet instrumentale është më i besueshëm në diagnozën e një karcinome papilifere të tiroides?

A) biopsia me age

B) shintigrafia
C) ekografia
D) ekzaminimiet bio-humorale
E) CT-skan
PS)A

Pyetja 162 V)3

Cila nga shenjat e sistemit të monitorimit tregon isheminë e organeve tek pacientët me sepsis?

A) kateteri i Svan Ganz
B) tonometri gastrik
C) kateteri arterioz
D) balloni ezofageal
E) oksmietri dixhital
PS)B

Pyetja 163 V)2

Janë të gjitha komplikime potenciale te pankreatitit, përveç

A) ascitit.
B) absesit pankreatik.
C) pseudocistit pankreatik.
D) hiperkalçemisë.
E) insufiçencës renale akute.
PS)D

Pyetja 164 V)3

Është një sëmundje nga mutacioni i gjenomës mitokondriale

A) talasemia.
B) fibroza cistike.
C) distrofia e Duchenne.
D) neuropatia optike e Leber.
E) adrenoleukodistrofia.
PS)D

Pyetja 165 V)1

Gjithë të mëposhtmet shkaktojnë ose rëndojnë hipertensionin, përveç

A) ciklosporinës.
B) likuiricies.
C) suplementeve të kalçiumit.

D) eritropoetinës.
E) AIJS
PS)C

Pyetja 166 V)3

Cili nga pohimet mbi disekacionin e aortës nuk është i vërtetë?

A) Aorta abdominale është lokalizimi më i shpeshtë.
B) Është prezent regurgitimi në valvulën e aortës.
C) Aneurizmë torakale që shpesh komplikohet nga tromboza dhe embolia.
D) Aneurizmat abdominale më të mëdha se 5 cm që shpesh duhen operuar.
E) Simptoma më e shpesht është dhimbja.
PS)C

Pyetja 167 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme mbi AIJS nuk është e vërtetë?

A) Nuk kanë efekte të rëndësishme mbi proçeset patologjike bazë.
B) Shkaktojnë irritim gastrik dhe rëndojne ulçerat peptike.
C) Suprimojnë funksionet vazodilatatore të prostaglandinave renale.
D) Rrisin pragun e perceptimit të dhembjes.
E) Pjesa më e madhe thithet shpejt pas administrimit për os.
PS)D

Pyetja 168 V)3

Tek cilët pacientë këshillohet determinimi i Proteines C Reaktive (PCR) ?

A) tek pacientët me risk te lartë
B) tek të gjithë pacientët me hiperkolesterolemi
C) tek të gjithë pacientët ku duam të bëjmë parandalimin primar te sëmundjeve kardiovaskulare
D) tek pacientët me infarkt të miokardit
E) tek pacientët me risk kardiovaskular mesatarisht të lartë
PS)E

Pyetja 169 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme mbi prolapsin mitral nuk është e vërtetë?

A) Prek 5% të popullatës.
B) Predominon tek femrat.
C) Jane të zakonshme dhembja torakale dhe palpitacionet.
D) Palpitacionet duhet të trajtohen me antiaritmike të klasës IA.
E) Ruptura e kordave tendine shkakton edemën pulmonare akute.

PS)D

Pyetja 170 V)3

Biopsia endomiokardiake mund të sigurojë diagnozën përfundimtare në të gjitha rastet e mëposhtme, përveç

A) amiloidozës.
B) sarkoidozës.
C) kardiomiopatisë hipertrofike.
D) hemokromatozës.
E) miokarditit.
PS)C

Pyetja 171 V)2

Është tregues i distrofisë muskulare

A) rritja e GGT në serum.
B) rritja e fosfatazes acide.
C) ritja e glicemisë.
D) rritja e fosfatazës alkaline.
E) rritja e kreatin fosfo kinazës.
PS)E

Pyetja 172 V)3

Nuk është tregues që parashikon tromboembolizmin tek pacientët me fibrilacion atrial

A) tromboembolia e mëparshme.
B) hipertensioni në histori.
C) disfunksionimi global i ventrikulit të majtë.
D) stenoza mitrale.
E) mosha nën 40 vjeç.
PS)E

Pyetja 173 V)2

Cilat nga thëniet e mëposhtme mbi disekimin e aortes nuk është e vërtetë?

A) Tipi I fillon në aorten ashendente dhe përfshin harkun e aortes dhe aortën dishendente (zbritese).
B) Tipi II përfshin vetëm aortën ashendente.
C) Tipi II fillon në aortën dishendente.
D) Shkaku më i shpeshtëështë sindroma Marfan.
E) Simptoma më e shpeshtë është dhembja.
PS)D

Pyetja 174 V)2

Nekroza tubulare është një

A) sëmundje renale kronike nga medikamentet nefrotoksike.
B) glomerulonefrit akut.
C) formë e acidozës tubulare.
D) infarkt renal.
E) formë e insufiçencës renale akute me patogjenezë toksiko-ishemike.
PS)E

Pyetja 175 V)3

Limfadenopatia difuze është tipike e të gjithë patologjive të mëposhtme, përveç

A) timfomës jo Hodgkin.
B) AIDS.
C) terapisë me Dilantinë.
D) sëmundjes Hodgkin.
E) limfomës angioimunoblastike.
PS)D

Pyetja 176 V)1

Shenja radiologjike klasike e pneumotoraksit është

A) hiperdiafania.
B) perdja e hemitoraksit.
C) opacizimi me nivele.
D) opacizimi i hemitorakit.
E) përforcim i kontureve pulmonare.
PS)A

Pyetja 177 V)1

Cili është risku kardiovaskular tek një pacient i prekur nga diabeti tip 2?

A) mbi 2%
B) midis 5-10%
C) mbi 10%
D) i njëjtë me riskun e një pacienti me sëmundje koronare
E) i ndryshëm, në varësi të faktorëve të tjerë të riskut
PS)C

Pyetja 178 V)2

Sindroma e Marfan transmetohet si tipar

A) i lidhur me X reçesiv.
B) autozomik reçesiv.
C) i lidhur me X dominant.
D) multifaktorial.
E) autozomiko-dominant.
PS)E

Pyetja 179 V)2

Defektet e lindura kardiake në të cilët pritet korrigjimi deri në moshën e rritur përfshijnë gjithë të mëposhtmet, përveç:

A) valvulës aortike bikuspidale.
B) defekti i septumit tip ostium secundum.
C) defekti i septumit interventrikular.
D) anomalia e Ebstein
E) atrezia e valvulës trikuspidale.
PS)E

Pyetja 180 V)3

Hiperkalcemia është një komplikim i shpeshtë në

A) tumoret pulmonare.
B) tumoret gastrike.
C) tumoret intestinale.
D) tumoret cerebrale.
E) limfomat.
PS)A

Pyetja 181 V)2

Anemia e lehtë mikrocitare dhe vlera e lartë e HbA2 sugjerojnë:

A) alfa talasemi.
B) anemi falçiforme.
C) beta talasemi.
D) sferocitozë hereditare.
E) persistencë hereditare e Hb fetale.
PS)C

Pyetja 182 V)3

Kardiomiopatia restriktive mund të shkaktohet nga situatat e mëposhtme, përveç

A) defiçit i Karnitinës.
B) defiçit i tiaminës.
C) sëmundje e akumulimit të glikogjenit.
D) mbingarkesë e hekurit.
E) amiloidozë.
PS)B

Pyetja 183 V)2

Mosha gestacionale më e përshtatshme për një preliev të vileve koriale është

A) 3 javë.
B) 11 javë.
C) 16 javë.
D) 20 javë.
E) 22 javë.
PS)B

Pyetja 184 V)3

Mjekimi hipolipeminat është në gjendje të reduktojë riskun koronar tek pacientët diabetikë?

A) niacina
B) cerivastatina
C) të gjitha statinat
D) gemfibrozi
E) gjithë fibratet
PS)C

Pyetja 185 V)2

Cila është përqindja e mbijetesës në 5 vjet të tumoreve pulmonarë?

A) 9 %
B) 19 %
C) 15 %
D) 25 %
E) 5 %
PS)C

Pyetja 186 V)1

Është një sëmundje nga prionet:

A) adrenoleukodsitrofi.
B) temperatura e lartë familjare fatale.
C) alzheimer.

D) huntington.
E) sëmundja e Jacob.
PS)E

Pyetja 187 V)3

Cilat nga defiçitet enzimatike mund të jetë shkaku i një emfizeme?

A) G6PD
B) ekzokinazi
C) ruktoza
D) alfa-1 antitripsina
E) antitrombina-3
PS)D

Pyetja 188 V)1

Indikoni cilat prej mjekimeve të mëposhtme mund të demtojë stomakun?

A) salmeteroli
B) indometacina
C) ondansetron
D) terfenadina
E) aminofillina
PS)B

Pyetja 189 V)3

Cili nga alterimet e mëposhtme nuk shoqërohet me rritjen e riskut të trombozës venoze?

A) defiçiti i antitrombines III
B) defiçit i proteinës S
C) defiçiti i proteinës C
D) defiçit i alfa 2 antiplazminës
E) defiçiti i koofaktorit 2 të heparinës
PS)D

Pyetja 190 V)2

Cili nga kortikosteroidet në vazhdim ka një gjysmë-jetë biologjike më të gjatë se 36 orë?

A) kortizoli
B) deksametazoni
C) prednizoni
D) kortizoni
E) flutikazoni
PS)B

Pyetja 191 V)2

Në kushte fiziologjike tek adulti përqendrimi i sodiumit në urinë është

A) më i vogël se 100 mEq/L.
B) më i madh se 1000 mEq/L.
C) 200-1000 meq/L.
D) më i madh se 500mEq/L.
E) 1000-1500 mEq/L.
PS)A

Pyetja 192 V)3

Të gjitha patologjitë e mëposhtme prekin artikulacionet interfalangeale distale përveç:

A) retikuloistiocitozës multicentrike
B) osteoartritit eroziv
C) psoriazës së shoqëruar me dëmtime të thonjve
D) artritit kronik juvenil.
E) artritit reumatoid.
PS)E

Pyetja 193 V)2

Enzima e konversionit të angiotensinës ose kinazi II inaktivizon

A) angiotensinën II.
B) kalidinën.
C) leu-encefalinën.
D) neurokininën.
E) angiotensinogjenin.
PS)B

Pyetja 194 V)2

Gjatë cilit prej intoksikacioneve të mëposhtme realizohet blloku i zinxhirit respirator qelizor?

A) intoksikimi nga monoksidi i karbonit
B) intoksikimi nga cianuri
C) intoksikimi nga pesticidet
D) intoksikimi nga avujt e klorit
E) intoksikimi nga piretoidet
PS)B

Pyetja 195 V)2

Cili është receptori ku veprojnë Antiinflamatoret Josteroide (AIJS)?

A) 5-lipooksigjenaza
B) ciklooksigjenaza
C) fosfolipaza A2
D) citokrom P450 reduktaza
E) oksid nitrik sintetaza
PS)B

Pyetja 196 V)3

Fluksi koronar i majtë

A) rritet në kushtet e alkalozës.
B) rritet në kushtet e hipoksisë.
C) rritet gjatë sistolave.
D) është gjithmonë maksimal.
E) rritet me hiperventilimin.
PS)B

Pyetja 197 V)2

Cila nga këto medikamente bllokon riabsorbimin e kockës?

A) bifosfonatet
B) TSH
C) paraT homoni
D) glukokortikoidet
E) vitamina E
PS)A

Pyetja 198 V)2

Cili nga mjekimet që vijojnë nuk gjen përdorim në delirium tremens?

A) klordiazepoksidi
B) fenobarbitali
C) diazepami
D) disulfirami
E) gamma hidroksi butirati
PS)D

Pyetja 199 V)3

Trajtimet për takikarditë me origjinë të papërcaktuar me QRS të gjerë përfshijnë gjithë të mëposhtmet, përveç

A) lidokainës endovenoze.
B) kardioversionit.
C) verapamilit endovenoz.
D) prokainamidi endovenoz.
E) masazhit të sinusit karotid.
PS)C

Pyetja 200 V)2

Cili nga këto kushte nuk shoqërohet me hipogonadizmin hipogonadotrop?

A) hiperprolaktinemia
B) anoreksia nervoze
C) një maratoniste profesioniste që përshkon 15-20 km në ditë për t'u stërvitur
D) sindroma e Turner
E) sindroma e Kallman
PS)D

Pyetja 201 V)3

Risku i trisomise 21 te fëmijët e një mbartësi të translokacionit të balancuar Robertsonian 14;21 është më i madh

A) kur fragmenti i translokuar është i madh.
B) nëse mbartësi është i ati.
C) nëse mbartësja është nëna.
D) nëse kromozomi 21 i lirë i mbartësit është inaktiv.
E) nëse translokacioni te prindi ka ndodhur de novo.
PS)C

Pyetja 202 V)2

Nga cilat prej këtyre strukturave nuk origjinon mezotelioma malinje?

A) pleura
B) meningjet
C) perikardi
D) peritoneumi
E) tunika vaginale e testikulit
PS)B

Pyetja 203 V)2

Tumoret cerebrale më të shpeshta janë

A) gliomat.
B) meningeomat.

C) metastazat.
D) pinealomat.
E) ependimomat.
PS)C

Pyetja 204 V)3

Një grua e re 29 vjeç referon ulçer peptike recidivante. Shtruar tri herë në spital për ulçer duodeni. Aktualisht nën trajtim me inhibitorët e pompës protonike dy herë në ditë dhe ankon për cefale, diarre e simptoma të refluksit gastro-ezofageal. Ekzamin
A) para T hormoni serik.
B) prolaktinemia.
C) gastrinemia.
D) acidi 5-hidroksiindolacetik.
E) ekzaminimet per Giardia.
PS)C

Pyetja 205 V)2

Gjenoma mitokondriale ka rreth:

A) 1500 çifte bazash.
B) 15 000 çifte bazash.
C) 150 000 çifte bazash.
D) 1,5 Mb çifte bazash.
E) 1,5 GB çifte bazash.
PS)B

Pyetja 206 V)2

Cilët nga kortikosteroidet në vazhdim përdoren gjerësisht në astmën alergjike me rrugë inhalatore

A) hidrokortizoni
B) metilprednizoloni
C) flutikazon proprionati
D) deksametazoni
E) triamkinoloni
PS)C

Pyetja 207 V)3

Nje grua 25 vjeç paraqitet në konsultë me dhimbje barku dhe diarre. Simptomat të pranishme prej rreth 5 vitesh. Simptomat e saj jane ato të një sindrome të zorres së irrituar dhe ekzaminimi objektiv është negativ.Pacientja kërkon të dijë çfare shkakton
A) risk të lartë për kancer të kolonit
B) do të duhet më në fund një ndërhyrje për kolonektomi.

C) rënie në peshe dhe malabsorbim.
D) një çrregullim kronik pak të ndjeshëm ndaj terapisë.
E) rrit riskun për komplikime gjatë shtatzënësisë.
PS)D

Pyetja 208 V)3

Një pacient me artrit reumatoid paraqitet për simptoma tërënda dhe alterime të theksuara radiografike ne fiankun e majte. Trajtimi i kështilluar është:

A) sinoviektomia e fiankut
B) osteotomia valginizuese e berrylit
C) proteza totale
D) artrodeza e bërrylit
E) perforimi kokës së femurit
PS)C

Pyetja 209 V)2

Nga të mëposhtmet, cila është sëmundja hemorragjike e trashëguar më e zakonshme?

A) hemofilia A
B) difekti i agregimit te piastrinave
C) sindroma e Rendu Osler
D) hemofilia B
E) sëmundja e von Ëillebrand
PS)E

Pyetja 210 V)2

Çrregullimi më i zakonshëm i shoqëruar me zhvillimin e sindromës nga distresi respirator i adultit

A) është embolia gazoze
B) është pankreatiti
C) është pulmoniti
D) është sepsisi
E) janë djegiet e rënda.
PS)D

Pyetja 211 V)2

Përkufizohet një hipomagnezemi e rënde një përqendrim serik i magneziumit

A) më i lartë se 2 mg/dl.
B) përfshiëe midis 2 e 3.5 mg/dl.
C) më i ulët se 1 mg/dl.

D) midis 1 e 3 mg/dl.
E) më i lartë se 4 ng/l.
PS)C

Pyetja 212 V)2

Subjekti i prekur nga hipokondria është më i prirur të

A) të përdorë simptoma fizike për të dalë nga problemet.
B) të eksperimentojë "belle indifference".
C) të ekzagjerojë simptomat fizike prezente.
D) të manifestojë një humbje të funksioneve fizike.
E) të ketë kriza të të qarit.
PS)C

Pyetja 213 V)3

Stadifikimi i qartë kliniko-radiologjik është i rëndësishëm me qëllim terapeutik e prognostik në

A) mieloma multiple.
B) leukemia Mieloide Akute.
C) limfoma jo Hodgkiniane.
D) semundja e Hodgkin.
E) leukemia me qeliza me qime.
PS)D

Pyetja 214 V)1

Analiza më e mirë për të diagnostikuar një defekt të tubit neural është

A) dozimi i alfafetoproteinës.
B) dozimi i gonadotropinës korionike.
C) amniocenteza.
D) vilocenteza.
E) ekografia.
PS)E

Pyetja 215 V)2

Cili është ekzaminimi i zgjedhur diagnostik në dyshmin për stenozë të carotides?

A) angiografia
B) angio Rezonanca Magnetike
C) ekokolordoppler
D) angio CT
E) Doppler CW (Continues way doppler)
PS)C

Pyetja 216 V)2

Splenektomia terapeutike nuk indikohet në

A) leuçemine Mieloide Kronike.
B) sferocitozën hereditare.
C) purpurën trombocitopenike .
D) sëmundja e Gaucher.
E) ruptura traumatike e shpretkës.
PS)A

Pyetja 217 V)3

Të gjitha patologjitë e mëposhtme shkaktojnë aneurizmën e aortës ,përveç

A) aterosklerozës.
B) traumës.
C) arteritit Takayasu.
D) poliartritit nodoz.
E) arteritit temporal.
PS)D

Pyetja 218 V)3

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është tipike për Policitemina Vera?

A) splenomegalia
B) komplikimi trombotik-hemorragjik në më shumë se gjysmën e pacientëve
C) piku i incidencës rreth 60 vjeç
D) transformimi në leuçemi në më shumë se 50% të rasteve
E) flebotomia është terapia fillestare kryesore
PS)D

Pyetja 219 V)2

Antikorpet e paevidentuara tek pacientët me infeksion nga HIV

A) antinukleare (ANA).
B) antikardiolipina.
C) krioglobulina.
D) antilimfocitare.
E) antiproteina G.
PS)E

Pyetja 220 V)2

Të gjithë medikamentet e mëposhtëm indikohen në trajtimin fillestar të anginës së paqëndrueshme, përveç

A) nifedipinës.
B) heparinës endovenoze.
C) aspirinës.
D) nitratit.
E) metoprololit.
PS)A

Pyetja 221 V)3

Nje grua 45 vjeç, e prekur nga sëmundja e Parkinson referon disfagi prej rreth një muaji, vështirësi në fillimin e degluticioni dhe kollitet shpesh kur pi dhe ndonjehere uji i del nga hunda. Cili duhet të jetë hapi i mëtejshëm diagnostik?

A) vlerësim ORL
B) ezofago-duodeno-gastro skopia (EDGS)
C) manometria ezofageale
D) videofluoroskopia e gëlltitjes
E) CT e qafës
PS)D

Pyetja 222 V)3

Stimulimi simpatik i zemrës përcakton gjithë variacionet në vijim, përveç

A) shtimit të forcës kontraktuese të muskulit ventrikular.
B) shtimit të shpejtësisë së konduksionit përmes nodusit atrio-ventrikular.
C) shtimit të shpejtësise së lëshimit tëmuskulit ventrikular.
D) reduktimit të fazës IV të depolarizimit të nodusit të sinusit me rrjedhojë rritjen e frekuencës kardiake.
E) rritje të shpejtësisë së kontraksionit në muskulin ventrikular.
PS)D

Pyetja 223 V)3

Shfaqje jo tipike e polimialgjisë reumatike është

A) inflamacion i lehtë artikular.
B) rigiditet i rrethit pelvik e skapular.
C) dobësim i rrethit pelvik e skapular.
D) rritje e shpejtësise së eritrosedimentit .
E) anemia normocitare e normokromike.
PS)C

Pyetja 224 V)1

Hemokromatoza shkaktohet nga një anomali e metabolizmit të

A) hekurit.
B) bakrit.
C) nikelit.
D) plumbit.
E) magnezit.
PS)A

Pyetja 225 V)3

Diferencimi final i eozinofileve nxitet nga

A) G-CSF.
B) eritropoetina.
C) GM-CSF.
D) IL-5.
E) IL-7.
PS)D

Pyetja 226 V)1

Profilaksia me antibiotikë nuk rekomandohet në procedurat dentare tek pacientët me

A) stenozë të aortës.
B) insufiçencë të aortës
C) prolaps i mitrales pa refluks.
D) insufiçenca e valvulës mitrale.
E) stenoza e valvulës mitrale.
PS)C

Pyetja 227 V)1

Gjenet strukturale në gjenomën humane janë rreth

A) 3000.
B) 30.000.
C) 300.000.
D) 3.000.000.
E) 30.000.000.
PS)B

Pyetja 228 V)2

Të gjithë medikamentet e mëposhtëm rrisin nivelin e ciklosporinës, përveç

A) fenobarbitalit.
B) diltiazemit.
C) eritromicinës.
D) ketokonazolit.
E) flukonazolit.
PS)A

Pyetja 229 V)3

Aktivizimi i kimioreceptorëve retronodale gjatë një infarkti të paretit inferior të miokardit, mund të ketë gjithë rrjedhojat e mëposhtme, përveç

A) hipotensionit
B) djerësitjes,
C) takikardisë,
D) nauzesë,
E) salivacionit,
PS)C

Pyetja 230 V)2

Në aneminë mikrocitare testi më i mirë për të dalluar aneminë sideropenike nga anemia në patologjinë kronike është

A) ferritina serike.
B) numerimi i retikulociteve.
C) sideremia.
D) % e saturimit të transferinës.
E) rezerva e hekurit në palcën e kockave.
PS)A

Pyetja 231 V)3

Situatë e hasur ne KID (koagulimi intravaskular i diseminuar) por jo në purpurën trombotike trombocitopenike është

A) anemia.
B) hemoliza.
C) reduktimi i fibrinogjenit.
D) shistocite në gjakun komplet
E) tromboza mikrovaskulore.
PS)C

Pyetja 232 V)2

Cila nga këto enzima transformon acidin arakidonik në LTA4 ?

A) 5-lipooksigenase activating protein (FLAP)
B) ciclooksigjenza
C) fosfolipaza A2
D) 5 lipooksigenasi e aktivizuar nga FLAP
E) kininazi I
PS)D

Pyetja 233 V)3

Anemia mikrocitike dhe anemia nga sëmundja kronike kanë të përbashkët

A) mikrocitozën.
B) reduktimin e hekurit ne eritrocitet e palcës së kockave.
C) reduktimin e sideremisë.
D) rritje e transferinës sierike
E) reduktim i saturimit të transferrinës.
PS)D

Pyetja 234 V)3

Shkaku më i mundshëm i anoreksisë nervoze është/janë

A) nivele të ulura të hormonit nxitës të hormonit luteinizant (LHRH).
B) nivele te ulura të hormonit të rritjes.
C) nivele të ulura të faktorit të rritjes të ngjajshëm me insulinën (IGF-1).
D) nivele të ulëta të tiroksines serike.
E) sëmundja psikiatrike.
PS)E

Pyetja 235 V)1

Cilin spektër të frekuencave arrin të perceptojë veshi i njeriut?

A) 1.000-100.000 Hz.
B) 1.000-20.000 Hz.
C) 2.000-20.000 Hz.
D) 20-20.000 Hz.
E) 20-10.000 Hz.
PS)D

Pyetja 236 V)2

Flebotomia e përsëritur në hemokromatozë provokon:

A) hiperpigmentim të lëkures.
B) përmiresimin e funksionit kardiak.
C) rikthimin e karakteristikave seksuale sekondare.

D) zvogëlimin e dhimbjes artikulare.
E) asnjë modifikim të shkalles së mbijetesës në 5 vjet.
PS)B

Pyetja 237 V)3

Cili nga beta-bllokuesit e mëposhtëm ka aktivitet intrinsek simptomatik?

A) atenololi
B) metoprololi
C) nadololi
D) propanololi
E) acebutololi
PS)E

Pyetja 238 V)3

Cili prej pohimeve mbi infarktin akut të miokardit nuk është i vërtetë?

A) Rreth 65% e vdekjeve ndodhin në orën e parë.
B) Pjesa më e madhe shkaktohet prej fibrilacionit ventrikular.
C) Tromboliza koronare është terapia kryesore nëse nuk është e kundërindikuar.
D) Me terapinë trombolitike rritet incidenca e iktusit.
E) Angioplastika primare është forma e pranuar e terapisë së riperfuzionit.
PS)D

Pyetja 239 V)3

Në cilat nga gjendjet e mëposhtme nuk vërehen feokromocitoma familjare?

A) Multiple Endocrine Neoplasia (MEN) I
B) Sindroma e von Hippel Lindau
C) MEN II A
D) Neurofibromatoza e trasheguar (Semundja e von Recklinghausen)
E) MEN IIB
PS)A

Pyetja 240 V)2

Me cilën nga anomalitë e mëposhtme kromozomike të trashëgueshme një subjekt ka probabilitet të arrijë moshën adulte?

A) trisominë 18
B) trisomië 13
C) 47 XXY
D) trizominë 21
E) 47 XO

PS)D

Pyetja 241 V)2

Prania e kristaleve të Charcot-Leyden sugjeron praninë e

A) limfomës Hodgkin.
B) diskrazisë plazmocelulare.
C) sindromës hipereozinofilike.
D) sëmundjes nga hemoglobina SC.
E) hemokromatozës.
PS)C

Pyetja 242 V)2

Faktorët që predispozojnë për ateroskleroze nuk përfshijnë

A) hipertensionin.
B) duhanpirjen.
C) diabetin mellitus.
D) disfunksinin e receptorëve për lipoproteinat me densitet të ulët (LDL).
E) raportin e ulur LDL/ HDL-kolesterol.
PS)E

Pyetja 243 V)2

Nuk është karakteristike e dhimbjes torakale në perikardit

A) përkeqësimi me inspirim të thellë.
B) përmirësimi në pozicion supin, përkeqësimi në pozicionin ulur.
C) rrezatimi drejt bordit të trapezit te djathtë.
D) mund të jetë akute ose e tipit rendues.
E) mund të lokalizohet në anën e majtë të toraksit duke sugjeruar një pleurit.
PS)B

Pyetja 244 V)1

Cili nga keto medikamente nuk përdoret në detoksikimin nga heroina?

A) buprenorfina
B) metadoni
C) flunitrazepami
D) klonidina
E) I-acetilmetadoli
PS)C

Pyetja 245 V)3

Të gjitha janë manifestime oftalmologjike të artritit reumatoid ,përveç

A) sindromës së Sjögren sekondare, shoqëruar me kompleksin e sindromës së thatë.
B) skleritit.
C) episkleritit.
D) fuzionet korneale.
E) atrofia ishemike e nervit optik.
PS)E

Pyetja 246 V)1

Timbri vokal përcaktohet në fonacion nga kalimi i ajrit të ekspiruar

A) përmes kaviteteve të rezonancës.
B) përmes kordave vokale.
C) përmes buzëve.
D) përmes bronkeve.
E) përmes trakesë.
PS)A

Pyetja 247 V)1

Shoku septik, komplikim i rëndë i sepsisit nga bakteret gram negative, shkaktohet si pasojë e lirimit të sasive të mëdha të

A) histaminës.
B) IL-10.
C) TNF-alfa.
D) IL-4.
E) IFN-gama.
PS)C

Pyetja 248 V)1

Cila nga analizat e mëposhtme është më e ndjeshme për identifikimin e nefropatisë diabetike?

A) kreatininemia
B) klirensi i kreatinines
C) albuminuria
D) testi i tolerancës ndaj glukozës
E) ultrasonografia
PS)C

Pyetja 249 V)2

Gjithë shkaqet e mëposhtëm janë shkaqe të diabetit nefrogjen insipid, përveç

A) demeklociklinës.
B) litiumit.
C) ciklofosfamidit.
D) metoksifluranit.
E) sarkoidozës.
PS)C

Pyetja 250 V)2

Sa është reduktimi i riskut koronar absolut të observuar në trials të prevenimit me statina?

A) më pak se 30 %, pavaresisht riskut përpara fillimit të trajtimit
B) rreth 30% në të gjitha kategoritë e pacientëve
C) mbi 50%, por vetëm tek pacientët që në fillim të trajtimit ishin me risk të lartë
D) reduktimi i riskut absolut eshte po aq i lartë sa ishte rritja e riskut absolut përpara fillimit te trajtimit
E) nuk është e mundur të indikohet një vlerë.
PS)D

Pyetja 251 V)2

Në momentin e diagnostikimit pjesa më e madhe e pacientëve me trombocitemi esenciale

A) paraqesin splenomegali.
B) paraqesin trombozë.
C) paraqesin hemorragji.
D) paraqesin eritromelalgjia.
E) janë asimptomatikë.
PS)E

Pyetja 252 V)1

Gjithë patologjitë e mëposhtme shkaktojnë disfunksion diastolik ,përveç

A) morbus Paget.
B) hipertensionit.
C) kardiomiopatisë hipertrofike.
D) ishemisë së miokardit.
E) kardiomiopatisë infiltrative.
PS)A

Pyetja 253 V)1

Cila nga këto substanca mund të rrisë absorbimin e hekurit në traktin gastro-intestinal?

A) çaji

B) drithërat
C) antiacidet
D) vitamina C
E) tetracikilina
PS)D

Pyetja 254 V)1

Forma e hipertensionit arterial më karakteristike për subjektet e moshuar është

A) hipertensioni borderline.
B) hipertensioni malinj.
C) hipertensioni diastolik.
D) hipertensioni sistolik i izoluar.
E) hipertensioni sistolik i asociuar.
PS)D

Pyetja 255 V)1

Një depresion imunitar mbi neoplazitë

A) ka veprim favorizues.
B) ka veprim pengues.
C) ka veprim eleminues.
D) nuk vepron
E) vepron vetëm në neoplazitë hematologjike.
PS)A

Pyetja 256 V)2

Tek një subjekt 60 kg me bikarbonatemi 16 mEq/L, defiçiti i bikarbonatit është

A) 30 mEq
B) 60 mEq
C) 90mEq
D) 150 mEq
E) 300 mEq
PS)E

Pyetja 257 V)1

Cilat janë nivelet optimale të LDL-kolesterolit në pacientin me diabet mellitus tip 2?

A) 130-100 mg/dl
B) më të ulëta se 100 mg/dl
C) nuk ekziston një nivel optimal, ky varet nga risku global i pacientit
D) nuk ekziston një nivel optimal, ky varet nga karakteristikat klinike të pacientit

E) nuk ekziston një nivel optimal
PS)B

Pyetja 258 V)3

Në terapinë kirurgjikale të melanomave

A) është e rëndësishme gjerësia por jo thellësia e heqjes.
B) bëhet gjithmonë një limfadenektomielektive.
C) janë të rëndësishme si gjerësia dhe thellësia e ekcizionit.
D) duhet kryer ekcizion në thellësi, përtej planit të fascies.
E) kërkimi i limfonodujve sentinelë duhet kryer gjithmonë.
PS)C

Pyetja 259 V)2

Në Arteritin me Qeliza Gjigande shpejtësia e eritrosedimentazionit është përgjithësisht

A) normale.
B) e rritur 20-30 mm në orën e parë.
C) e rritur 30-400 mm në orën e parë.
D) e rritur deri në 80-100 mm në orën e parë.
E) e reduktuar.
PS)D

Pyetja 260 V)1

Në shtatzënësi filtrati glomerular

A) nuk ndryshon.
B) zvogëlohet me 40%.
C) rritet me 40%.
D) rritet me 200%.
E) ulët me rritjen e filtratit glomerular fetal.
PS)C

Pyetja 261 V)2

Cila nga këto statina ka gjysmëjetë plazmatike më të gjatë?

A) atorvastatina
B) simvastatina
C) pravastatina
D) fluvastatina
E) është për të gjitha njëlloj
PS)A

Pyetja 262 V)2

Prania e një edeme me shenjën e shtypjes në anësitë inferiore në një pacient mbi 70 kg me sindromë nefrotike indikon një rritje te volumit extraqelizor

A) prej ½ L.
B) prej 5 L .
C) prej 1 L.
D) prej 2L.
E) prej 2,5L.
PS)A

Pyetja 263 V)2

Popullata limfocitare më e madhe në numër në gjakun periferik tek një i rritur në kushte fiziologjike është ajo:

A) T limforcitare.
B) granulocitare bazofile.
C) granulocitare neutrofile.
D) granulocitare neutrofile.
E) B limfocitare.
PS)C

Pyetja 264 V)1

Cili nga betabllokuesit e mëposhtëm nuk është kardioselektiv?

A) atenololi
B) metaprololi
C) betaxololi
D) propanololi
E) acetobutololi
PS)D

Pyetja 265 V)1

Cili nga faktorët inhibon sekretimin e hormonit të rritjes nga hipofiza anteriore?

A) somatostatina
B) GHRH (Hormoni stimulanti hormonit te rritjes)
C) hipoglicemia
D) arginina
E) serotonina
PS)A

Pyetja 266 V)1

Cili nga elementët në ciklin e maturimit medular ndjek menjëhere mieloblastin?

A) megalociti
B) metamielociti
C) promielociti
D) plazmociti
E) hemocitoblasti
PS)C

Pyetja 267 V)2

HDL-të ndërtohen kryesisht nga

A) trigliceridet dhe Albumina.
B) kolesteroli dhe Albumina.
C) trigliceridet dhe ApoLipoproteina B-100.
D) acidet yndyrore dhe Albumina.
E) kolesteroli, Fosfolipidet dhe Apolipoproteinat.
PS)E

Pyetja 268 V)1

Cili nga mjekimet e mëposhtëm përdoret në terapinë e edemës pulmonare akute?

A) steroidet
B) bronkodilatatoret
C) antibiotiket
D) kaliumi
E) morfina
PS)E

Pyetja 269 V)2

Në spondilitin ankilozant cila pjesë e skeletit dëmtohet më shumë?

A) kolona cervikale
B) kolona lumbare
C) pulsi
D) duart
E) artikulacionet sakro-iliake
PS)E

Pyetja 270 V)1

Sa faza ka tifo?

A) 1
B) 2
C) 3
D) 4
E) 5
PS)D

Pyetja 271 V)3

Çfarë është degjenerimi Walerian?

A) Një sëmundje sistemike e nervave periferikë.
B) Degjenerimi i substancës së bardhë në atrofinë cerebrale senile.
C) Zona malacike që rrethojnë tumoret cerebrale.
D) Proçesi degjenerativ i segmentit distal të një nervi periferik të lezionuar.
E) Degjenerimi i substancës medulare ngjyrë gri.
PS)D

Pyetja 272 V)2

Me cilën nga neoplazitë e mëposhtme është gjetur i shoqëuar Virusi herpetik i Epstein-Barr?

A) limfomën mamare
B) karcinomën bronkogjene
C) kancerin e zorrës së trashë
D) melanomën
E) karcinomën mamare
PS)A

Pyetja 273 V)1

Kompleksi tuberkular primar përfshin kryesisht

A) lobet pulmonare inferiore dhe limfonodujt parahilarë.
B) lobet pulmonare superiore dhe limfonodujt parhilare.
C) pleurën.
D) trakenë.
E) bronkiolet distal.
PS)B

Pyetja 274 V)3

Duke ditur që aspirina është një acid i dobët, cila nga shprehjet e mëposhtme është korrekte?

A) Përthithja gastrike favorizohet nga prania e ushqimit.
B) Në ambient acid predominon forma e disociuar.
C) Eleminimi renal favorizohet nga alkalinizimi i urinës.

D) Acidifikimi i urinës redukton gjysmejetën plazmatike.
E) Alkalinizimi i lumenit gastrik rrit gjysme-jetën në këtë nivel.
PS)C

Pyetja 275 V)3

Dieta hiposodike jepet

A) tek të gjithë pacientët me insufiçencë renale kronike nën terapi konservative.
B) vetëm tek pacientët me insufiçencë renale kronike që janë hipertensivë ose edematozë.
C) vetëm tek pacientët me insufiçencë renale kronike sekondare nga glomerulonefriti.
D) vetëm tek pacientët me insufiçencë renale kronike sekondare nga pielonefriti.
E) vetëm tek pacientët uremikë nenterapi me dializë.
PS)B

Pyetja 276 V)1

Çfare jane proteinat e Bence Jones?

A) fragmente te Laktoferrinës
B) zinxhirë të lehtë të lirë të imunoglobulinave
C) antigjene HLA të tretshëm
D) IgM
E) proteina qe lidhin ADN
PS)B

Pyetja 277 V)3

Në terapine e krizës astmatike të lehtë/moderuar, cilat nga këto ndërhyrje terapeutike janë më të rekomanduarat?

A) shoqërimi i salbutamolit me inhalim me steroide me inhalim ose per os
B) shoqërimi i salbutamolit per os me steroidet per os
C) beta 2 stimulant endovenoz e pastaj me rrugë inhalatore
D) mukolitikët e qetësuesit e kollës
E) antihistaminikët e mukolitikët
PS)A

Pyetja 278 V)2

Dermatofagoidet janë

A) agjentët etiologjikë të sëmundjes së Kawasakit.
B) alergenët kryesorë në pluhurin e shtëpisë.
C) përgjegjësit kryesorë të temperaturës nga bari.
D) kërpudha alergjizuese.
E) qeliza të pajisuara me aktivitet fagocitar për përbërësit e dermës.

PS)B

Pyetja 279 V)1

Pjesa që zë uji në organizëm, e shprehur si % e peshës së trupit është

A) intraqelizor 40%, intersticial 15%, plazmatik 5%.
B) intraqelizor 20%, intersticial 25%, plazmatik 7%.
C) intraqelizor 20%, intersticial 35%, plazmatik 5%.
D) intraqelizor 40%, intersticial 40%, plazmatik 10%.
E) intraqelizor 25%, intersticial 25%, plazmatik 10%.
PS)A

Pyetja 280 V)3

Një grua 28 vjeçare, me anamnezë pozitive për abuzim me alkoolin prej 15 vitesh, vlerësohet për dhimbje intense të barkut që përkeqësohen nga ushqimi. Ekaminimi radiologjik direkt i abdomenit vë në dukje praninë e kalçifikimeve difuze në nivel të regjon
A) kolelitiaza
B) nefrolitiaza
C) koliti ishemik
D) divertikuliti
E) pankreatiti akut dhe kronik
PS)E

Pyetja 281 V)1

Shkaku më i zakonshëm i infarktit akut të miokardit është

A) spazma kardiake.
B) tromboza koronare.
C) embolia koronare.
D) miokarditi.
E) anomali në origjinë të koronareve.
PS)B

Pyetja 282 V)1

Patogjeneza ne anemine e Kwasharkior lidhet me:

A) mungesën e bakrit.
B) mungesën e hekurit.
C) mungesën e proteinave.
D) gjakrrjedhjen e vazhdueshme.
E) zëvendesimin medular nga invazioni metastatik.
PS)C

Pyetja 283 V)2

Në qarkullimin e një fëmije dy muajsh të ushqyer me gji, cili izotip antikorpesh matern është i pranishem?

A) të gjithë izotipat
B) IgD
C) IgE
D) IgG
E) IgM
PS)D

Pyetja 284 V)3

Një burrë 60 vjeç, hipertensiv, paraqet papritur disfagi, parestezi peripubikale dizekuilibër, që zgjasin 15 minuta. Bëhet fjalë për

A) pousee të Sklerozës Multiple.
B) TIA në territor të arteries vertebro bazilare.
C) TIA në territor të arteries karotide.
D) infarkti lakunar kapsular.
E) krizë epileptike.
PS)B

Pyetja 285 V)2

Në një test screening në të cilin specificiteti i testit është 90%, përqindja e fals pozitivëve

A) është 5%.
B) është 90%.
C) është 10%.
D) është 20%.
E) nuk është e mundur të llogaritet .
PS)C

Pyetja 286 V)2

Është një karakteristikë histologjike e tiroidit te Hashimotos

A) infiltrimi limfocitar.
B) depozitimi i amiloidit.
C) pania e qelizave gjigande multinukleare.
D) prania e mikrokalçifikimeve.
E) hiperplazia e qelizave parafolikulare.
PS)A

Pyetja 287 V)2

Diabeti gestacional shfaqet

A) disa muaj përpara shtazënësisë.
B) menjëhere pas lindjes.
C) gjatë shtatzënësisë në gratë jo diabetike.
D) tek gratë me DM tip 1.
E) tek gratë me DM tip 2.
PS)C

Pyetja 288 V)2

Gjithë të mëposhtmet mund të shkaktojnë rënie të mbrojtjes imune përveç

A) terapisë me rrezatim.
B) infeksionit nga HIV.
C) vaksinimit me toksinën tetanike.
D) kequshqyerjes.
E) terapisë së zgjatur me antibiotikë.
PS)C

Pyetja 289 V)1

Cili nga këta hormone nuk prodhohet në lobin anterior të hipofizës?

A) prolaktina
B) vazopresina
C) ACTH
D) TSH
E) FSH
PS)B

Pyetja 290 V)1

Simptomatologjia e hematomës ekstradurale shfaqet më shpesh

A) menjëherë pas traumas.
B) pas një kohe të shkurtër me ndërgjegje të qartë.
C) pas 48 orësh.
D) në fazën kronike (në distancë kohe).
E) pavarësisht nga të mësipërmet.
PS)B

Pyetja 291 V)3

Një sipërmarrës 53 vjeç shfaq malarien pas kthimit nga qëndrimi në Afrikën Qendrore. Për cilën lloj malarie bëhet fjalë?

A) P. malariae
B) P. falciparum
C) P. vivax
D) P. ovale
E) P. africanum
PS)B

Pyetja 292 V)3

Cila nga këto kushte nuk ka lidhje me pozitivitetin nga HbsAg

A) cirroza biliare primitive
B) urtikaria
C) krioglobulinemia
D) hepatokarcinoma
E) panarteriti nodoz
PS)A

Pyetja 293 V)2

Në rastin e mosngrenies se zgjatur cilat janë molekulat që truri përdor për të marrë energji?

A) glikogjeni
B) lipidet
C) trupat ketonikë
D) aminoacidet
E) kolesteroli
PS)C

Pyetja 294 V)2

Në rastin e meningitit nga Streptokoku Pneumonie, cili nga antibiotikët e mëposhtëm është më i indikuari?

A) oksitetraciklina
B) fosfomicina
C) gentamicina
D) cefotaksima
E) clindamicina
PS)D

Pyetja 295 V)3

Nje grua 27 vjeç është diagnostikuar me një depresion të lehtë endogjen. Psikiatri këshillon psikoterapinë e farmakoterapinë. Cilët nga mjekimet në vijim mund të jetë më pak i zgjedhur për raportin e disfavorshëm midis efektit terapeutik dhe efekteve sek

A) amitriptilina
B) citalopram
C) sertralina
D) paroksetina
E) fluoksetina
PS)A

Pyetja 296 V)2

Pulmoniti atipik primar shkaktohet nga:

A) virusi herpetik
B) Mycoplasma Pneumonie nga disa viruse
C) Histoplazma Capsulatum
D) Proteus Mirabilis
E) Coxiella Burneti
PS)B

Pyetja 297 V)1

Që të jesh i dënueshëm kërkohet

A) aftësi per të gjykuar dhe vepruar
B) paaftësi për të kuptuar dhe vepruar.
C) të mos jesh i dënuar më parë (nga ligji).
D) të kesh mbushur 21 vjeç.
E) të mos kesh vuajtur nga çrregullime psikotike.
PS)A

Pyetja 298 V)3

Gjithë të mëposhtmit mund të jenë faktorë shpërthyes të lupusit, përveç

A) ekspozimit ndaj dritës së diellit dhe formave të tjera të rrezatimit UV.
B) infeksioneve.
C) dietës vegjetariane.
D) kirurgjisë.
E) shtatzënësisë (veçanërisht pas-lindjes) .
PS)C

Pyetja 299 V)2

Hija renale e vogël në ekzaminimin radiografik vihet re në

A) sindromën nefrotike.
B) nefropatinë polikistike.
C) glomerulonefritin kronik.

D) hidronefrozën.
E) hipernefromën (Renal cell carcinoma).
PS)C

Pyetja 300 V)1

Cilin ekzaminim do të përdornit për të vlerësuar presionin endoluminal në ezofag?

A) ezofagoskopinë
B) pH-metrinë
C) manometrinë
D) sonden gastrike
E) ezofagografine
PS)C

Pyetja 301 V)1

Tumori më i shpeshtë beninj i mamelës është

A) papiloma intradurale.
B) tumori filloid.
C) fibroadenoma.
D) adenoma e "thithës së gjirit".
E) mioepitelioma
PS)C

Pyetja 302 V)2

Cilët nga testet e mëposhtme është parashikues i riskut të rritur në mënyrë domethënëse në sëmundjet kardiovaskulare?

A) rritja e LDH2 (laktatdehidrogjenazes 2)
B) rritja domethënëse e nëntipit 2° e 2b të HDL.
C) rritja e kolesterolemisë dhe LDL.
D) zvogëlim i rëndësishëm i albumines plazmatike.
E) vlerat e ulura të ACE (Angitensine Convertin Enzyme).
PS)C

Pyetja 303 V)1

Cila është zona e lokalizimit më të shpeshtë të verrukeve të zakonshme?

A) kurrizi i dorës
B) kurrizi i këmbës
C) qafa
D) toraksi
E) krahët

PS)A

Pyetja 304 V)2

Filtrati glomerular matet me klirensin (clearence) e

A) të PAI (Plasminogen Activator Inhibitor)
B) të uresë
C) të inulinës
D) të acidit urik
E) të urobilinogjenit
PS)C

Pyetja 305 V)1

Përkufizimi i saktë i pranuar i anginës TIPIKE është

A) dhimbje karakteristike për nga karakteri dhe kohëzgjatja + stres fizik ose emocinal shpërthyes + lehtësim nga shplodhja dhe /ose trinitroglicerina.
B) dhimbje karakteristike për nga karakteri dhe kohëzgjatja dhe stres fizik ose emocional shpërthyes.
C) dhimbje karakteristike për nga karakteri dhe kohëzgjatja + të vjella.
D) dhimbje karakteristike për nga karakteri dhe kohëzgjatja + lehtësim nga qetësia e/ose trinitroglicerina.
E) dhimbje karakteristike për nga karakteri dhe kohëzgjatja+ te vjella+ lehtësim nga qetësia e/ose trinitroglicerina.
PS)A

Pyetja 306 V)2

Indiferenca është simptomë e shkaktuar nga

A) tumoret frontale.
B) tumore te nukleuseve bazalë (berthamave te bazës).
C) sëmundja e Schilder.
D) encefalopatia uremike.
E) adenoma e hipofizës.
PS)A

Pyetja 307 V)1

Cila nga sëmundjet që vijojnë nuk hyn në shkaqet e cirrozës?

A) defiçit i alfa-1 antitripsines
B) skistosomiaza
C) semundja e Gaucher
D) hepatiti nga virusi C

E) hepatiti nga virusi A
PS)E

Pyetja 308 V)1

Katekolaminat nuk janë shkak i

A) rritjes së debitit kardiak.
B) rritjes së frekuencës kardiake.
C) rritjes së reninës.
D) hipoglicemisë.
E) dilatacionit bronkial.
PS)D

Pyetja 309 V)2

Cili nga komplikimet e mëposhtëm nuk është komplikim metabolik i pankreatitit akut?

A) hiperkalçemia
B) hiperglicemia
C) acidoza
D) hipokalçemia
E) encefalopatia
PS)A

Pyetja 310 V)2

Cila nga siptomat ose shenjat e mëposhtme mund të na bëjë të dyshojmë për emboli pulmonare?

A) dispnea nga aktivitetit fizik
B) angina nga aktivitetit fizik
C) oliguria
D) badikardia
E) dispnea në pacientët me trombozë të venave të thella
PS)E

Pyetja 311 V)1

NGF është

A) një element i berthamës së qelizave gliale.
B) një proteinë që stimulon rritjen neuronale.
C) një hormon i hipotalamusit.
D) një proteinë jo e glikosuar e membranës.
E) një faktor që stimulon rritjen e neuroneve vetëm ne kultura.
PS)B

Pyetja 312 V)3

Tek një pacient me deficit funksional të rëndë të heparit raporti albumin/glubulina në krahasim me vlerat normale rezulton

A) i pandryshuar (1,2 - 1,7).
B) i rritur (më i lartë se 1.7).
C) shume i rritur (më i lartë se 3).
D) i zvogëluar (me i ulët se 1.2).
E) i rritur ose i ulur në funksion të etiologjisë së dëmit hepatik.
PS)D

Pyetja 313 V)2

Cila nga alternativat nuk është e vërtetë për faktorin endotelial EDRF?

A) shkakton vasodilatim falë rritjes së GMP-ciklike në muskulaturën vaskulare të lëmuar
B) në dekompensimin kardiak çlirimi i EDRF është thellësisht i rënë
C) EDRF korrespondon me oksidin nitrik (NO)
D) EDRF nuk ekziston
E) tek diabetikët prodhohet më pak NO
PS)D

Pyetja 314 V)2

Në cilin rast kreatininemia rritet?

A) në gastritin hipoklorhidrik
B) në aneminë hipokromike
C) në astmën bronkiale
D) në sëmundjen e miastenisë
E) në insufiçencën renale
PS)E

Pyetja 315 V)3

Në terapinë e perikarditit idopatik indikohen

A) antikoagulantët.
B) izoniazidi, rifampicina, etambutoli.
C) kortikosteroidet.
D) antibiotikët.
E) diuretikët.
PS)C

Pyetja 316 V)2

Për izolimin dhe kultivimin e një virusi përdoren

A) terrene solide.
B) terrene selektive.
C) terrene elektive.
D) përzjerje tampone.
E) kultura qelizore.
PS)E

Pyetja 317 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtëm është i gabuar në lidhje me arterien vertebrale?

A) shtrihet në një sulkus të harkut posterior të atlasit
B) kalon përmes foraminave intertrasversare
C) origjinon nga pjesa e parë e arteries subclavia
D) hyn në bazën e kafkës përmes forame jugulare
E) i jep origjinë arteries spinale posteriore
PS)D

Pyetja 318 V)1

Në pjesën më të madhe të individëve, fashikuli atrio-ventrikular vaskularizohet:

A) nga degët e thella të arteries circonflessa
B) nga degët e thella të arteries coronare të djathtë
C) nga degët septale të arteries interventrikulare posteriore
D) nga degët septale të arteries dishendente anteriore
E) nga degët e arteries bronkiale
PS)D

Pyetja 319 V)1

Cila nga shembujt e mëposhtëm është shembull i imunitetit të aktivizuar?

A) imunizimi me një mikroorganizëm të ngordhur
B) imunizimi me antikorpe anti-tetanike
C) transferimi i antitrupave përmes ushqimit matern
D) transferimi i antikorpeve të nënes nga nëna te fetusi përmes placentës
E) transferimi i limfociteve B nga një donator i imunizuar
PS)A

Pyetja 320 V)2

Të gjitha alternativat e mëposhtmë janë elemente në favor të diagnozës së osteoartozës më shumë se të artritit reumatoid, përveç

A) prekjes poliartikulare.
B) VES dhe PCR normale.
C) pranisë e nodujve të Heberden.
D) pranisë e osteofiteve në gju.
E) rigiditetit mëngjesor për më pak se 30 min.
PS)A

Pyetja 321 V)1

Sa është koha e inkubimit te Gonorresë?

A) 20-25 ditë
B) 2-5 muaj
C) 2-5 ditë
D) 2-5 orë
E) 7-15 ditë
PS)C

Pyetja 322 V)2

Kriza epileptike është një manifestim neurologjik akut

A) si pasojë e një shkarkimi neuronal hipersinkron
B) që pason nje depresion të papritur funksional të neuroneve në një qendër kortikale ose nënkortikale.
C) për diagnozën e së cilës është gjithmonë i domosdoshëm ekzaminimi elektroencefalografik.
D) që shoqërohet në mënyrë konstante nga humbja e ndërgjegjes.
E) që shoqërohet në mënyrë konstante nga manifestime motore te pavullnetshme të tipit të gjeneralizuar apo segmentar.
PS)A

Pyetja 323 V)2

Nuk është efekt kolateral i trajtimit neuroleptik

A) akinesia.
B) distonia akute.
C) diskinezia tardive.
D) apraksia.
E) pseudoparkinsoni.
PS)D

Pyetja 324 V)3

Mund të shkaktojë verbëri

A) infarkti i miokardit.
B) arteriopatia obliterante e gjymtyrëve të poshtme.
C) arteriti i Horton.
D) koliti ulçeroz.
E) hernia Hiatale.
PS)C

Pyetja 325 V)1

Proçesi i diagnostikimit

A) ka finalitet mjeko-ligjor.
B) ka finalitet thelbësisht mjekësore.
C) duhet të kërkohet nga familjarët.
D) duhet të kërkohet nga autoritetet gjyqesore.
E) kërkohet nga ana e policisë së spitalit.
PS)B

Pyetja 326 V)3

Stimuli per hiperventilimin në lartësi të mëdha vjen nga

A) pH i ulët.
B) presion parcial i ulët i oksigjenit.
C) ulja e bikarbonat në gjak.
D) përqëndrimi i reduktuar i hidrogjenimit në gjak.
E) presioni i lartë parcial i oksigjenit.
PS)B

Pyetja 327 V)1

Bilirubina bëhet e tretshme dhe e eleminueshme në bilë falë konjugimit me acidin:

A) glikozilik.
B) oksalacetik.
C) glutamik.
D) glukuronik.
E) folik.
PS)D

Pyetja 328 V)1

Aguesia është:

A) mungesae nuhatjes.
B) mungesa e shijes.

C) mungesa e dëgjimit.
D) mungesa e ekuilibrit.
E) zhurmë në vesh.
PS)B

Pyetja 329 V)1

Ndërprerja e vullnetshme e shtatzënësisë brenda 90 ditëve mund të kërkohet nga

A) gruaja.
B) bashkëshorti.
C) mjeku.
D) mjeku gjinekolog.
E) mjeku psikiatër.
PS)A

Pyetja 330 V)1

Medikamenti më efikas kundër edemës peritumorale është

A) fenobarbitali.
B) deksametazoni.
C) vazopresina.
D) karbamazepina.
E) acidi acetilsalicilik .
PS)B

Pyetja 331 V)1

Insulina është një

A) hormon peptidik që vepron duke aktivizuar një receptor tirozinë kinase.
B) hormon peptidik që aktivizon disa receptorë me 7 helika transmembranore.
C) proteinë që lidhet me glukozën.
D) metabolit i inulinës.
E) hormon hipofizar
PS)A

Pyetja 332 V)2

Ndërprerja e fibrave nervore nga dëmtimi i një nervi

A) nuk mund të riparohet.
B) mund të riparohet nga shkrirja e dy cungjeve të fibrës.
C) mund të riparohet me rritjen e cungut proksimal të fibrës.
D) sjell një kontraktim të menjëhershëm të muskulaturës së inervuarnga fibrat e ndërprera.

E) nuk shkakton çrregullime të fibrës në zonën distalisht lezionit.
PS)C

Pyetja 333 V)2

Shenja më e zakonshme e embolisë pulmonare pa infarkt pulmonar është

A) dispnea me takipne.
B) aritmia kardiake.
C) fortësimi i tonusit të II pulmonar.
D) vallëzimi i karotideve.
E) pulsi alterant (i ndryshueshëm) .
PS)A

Pyetja 334 V)1

Kalemia në subjektin normal është e barabartë me

A) 2,5-3 mEq/L.
B) 3.5-5 mEq/L.
C) 7-8 mEq/L.
D) 8,5-9 mEq/L.
E) 11mEq/L.
PS)B

Pyetja 335 V)1

Cila është pamja ekografike e një cisti?

A) echo të brendshme të pakëta
B) echo te brendshme të shumta
C) boshllëk akustik me riforcim te paretit posterior
D) echo të shpërndara në mënyre unforme
E) echo të shpërndara në mënyrë jo të rregullt
PS)C

Pyetja 336 V)2

Hiperelasticiteti i lëkurës i shoqëruar me hiper shtrirje të artikulacioneve sugjeron

A) sklerodermi.
B) dermatomiozit
C) neurofibromatoze
D) diskeratozë të lindur
E) sindromën e Ehler Danlos.
PS)E

Pyetja 337 V)1

Infeksionet nga protozoarët janë

A) impetiginët.
B) lupusi vulgar.
C) leishmanioza.
D) aktinomikoza.
E) verruket vulgare.
PS)C

Pyetja 338 V)3

Stadifikimi i tumorit të pulmonit

A) nuk mund të përcaktohet nga vlerësimi i markuesve tumorale.
B) kërkon laparotomi dhe është nje proces kompleks.
C) indikohet vetëm tek pacientët duhanpirës.
D) kërkon shpesh CT scan dhe bronkoskopi.
E) nuk përfshin shintigrafinë kockore.
PS)D

Pyetja 339 V)2

Në cilën nga situatat e mëposhtme nuk vihet re zakonisht një rritje domethënëse e transaminazave serike?

A) hepatiti viral akut
B) insufiçenca kardiake kongjestive
C) temperatura tifoide
D) mononukleoza infektive
E) toksoplasmoza
PS)E

Pyetja 340 V)2

Terapia më e suksesshme për takikardinë atriale paroksistike, për sa kohë nuk ekziston një patologji kardiake e manifestuar, është

A) administrimi i simpatomimetikëve.
B) stimulimi vagal.
C) kardioversioni elektrik.
D) instalimi i një pace-maker artificial.
E) masazhe kardiake të përsëritura.
PS)B

Pyetja 341 V)1

Neoplazia më e shpeshtë në AIDS është:

A) sarkoma e Kaposit.
B) adenokarcinoma e laringut.
C) leucemia limfatike kronike.
D) adenokarcinoma gastrike.
E) adenokarcinoma pulmonare.
PS)A

Pyetja 342 V)3

Komplikimet më të shpeshta tek të lindurit nga nënat me diabet gestacional janë

A) mikrocefalia.
B) spina bifida.
C) hipertiroidizmi.
D) makrosomia fetale- hipoglicemia neonatale.
E) kardiopatia ishemike.
PS)D

Pyetja 343 V)1

Testi i ELISA është metodë investigimi

A) radioimunologjike.
B) imunoenzimatike.
C) imunoprecipitimi.
D) imunofluoreshenca.
E) devijimi i komplementit.
PS)B

Pyetja 344 V)2

Në glomerulonefritin post streptokoksik nuk haset

A) mikrohematuria.
B) proteinuria.
C) hiperkalçuria.
D) cilindruria.
E) leukocituria.
PS)C

Pyetja 345 V)2

Kaliumi ushqimor përthithet në nivel të

A) fundusit të stomakut.
B) antrumit gastric.
C) zorrës së hollë.
D) cekumit.
E) kolonit dishendent (zbritës).
PS)C

Pyetja 346 V)2

Fibroza cistike është

A) një sëmundje autosomike recesive.
B) një sëmundje autozomike dominante me defiçit të surfaktantit.
C) një sëmundje e fituar që shoqërohet me pankreatit kronik dhe emfizemë pulmonare.
D) një sëmundje autozomike reçesive me alterime të kanaleve të klorit dhe transport anormal të elektroliteve në qelizat epiteliale.
E) një sëmundje autozomike recesive me deficit të alfa-1 anti tripsinës.
PS)D

Pyetja 347 V)1

Burimet kryesore të vitaminës E janë

A) yndyrnat shtazore.
B) qumështi dhe derivatet e tij.
C) mishi i kuq.
D) farërat e drithërave dhe vajrat.
E) flora bakteriale intestinale.
PS)D

Pyetja 348 V)1

Episodet kryesore të cefalesë klaster kanë një kohëzgjatje prej

A) pak sekondash.
B) fraksionesh të sekondës.
C) 15-180 min.
D) 4-24 orë.
E) 24-72 orë.
PS)C

Pyetja 349 V)1

Antidepresivët triciklikë ushtrojnë veprimin e tyre duke provokuar

A) inhibimin e përthithjes së dopaminës.
B) inhibimin e riasorbimit të noradrenalinës dhe serotoninës.

C) inhibimin e riasorbimit të serotoninës.
D) inhibimin e riasorbimit të noradrenalinës.
E) rritjen e ri-uptake të serotoninës.
PS)B

Pyetja 350 V)1

Një nulipare 25 vjeçare ka një gravidancë molare 12 javore ne anamnezë. Cili nga veprimet e mëposhtme mund të jetë i përshtatshëm për pacienten?

A) monokimioterapia
B) dozimi serik i beta-hCG
C) histerektoma
D) laparohisterektomia me ruajtje te anekseve
E) studimi i funksionit te tiroides
PS)B

Pyetja 351 V)2

Leukoplakia mund të konsiderohet

A) një alterim pulmonar.
B) gjendje prekanceroze.
C) një çrregullim i funksionit olfaktor.
D) një çrregullim i funksionit gustativ.
E) një çrregullim i funksionit respirator.
PS)B

Pyetja 352 V)3

Një pacient i trajtuar me penicilinë G që manifeston në distancë 7-12 ditësh urtikarie, temperaturë, edema artikulare, artralgji, limfoadenopati, edema në fytyrë dhe në qafë është shumë e mundur të jetë prekur nga

A) agranulocitoza.
B) shoku anafilaktik.
C) sëmundja e serumit.
D) lupusi eritematoz.
E) glomerulonefriti akut.
PS)C

Pyetja 353 V)1

Gjatë anestezisë gjenerale hiperventilimi i zgjatur mund të shkaktojë

A) vasodilatim cerebral.
B) hipokapni.

C) hiperkapni.
D) acidozë respiratore.
E) hipertermi malinje.
PS)B

Pyetja 354 V)1

Matja e një kurbe të skoliozës realizohet me anë të përcaktimit të

A) këndit të lakimit.
B) indeksit te Pavlov.
C) indeksit te Risser.
D) këndit te Cobb.
E) distancës së spina iliaca anterosuperiore nga maleoli medial.
PS)D

Pyetja 355 V)1

Kocka sfenoidale

A) është kocka më e madhe ne fossa crani posterior.
B) përbëhet nga squama dhe dy pjesë laterale.
C) është kocka ku kalon kanali i hipoglosit.
D) paraqet kondilet për artikolacionin oksipito-atlantoid
E) përbën fossa crani media dhe një pjesë të vogël të fossa crani anterior.
PS)E

Pyetja 356 V)1

Hipokalemia shoqërohet me

A) rritje të peristaltikës intestinale.
B) acidozë.
C) rritje të gjerësisë së valës T.
D) nauze.
E) shfaqje të valëve U.
PS)E

Pyetja 357 V)1

Sëmundja e gjumit është shprehja e fundit e

A) leishmaniozës viscerale.
B) hidatidozës.
C) tripanozomiazes afrikane.
D) cisticerozës.
E) koksidiozës.

PS)C

Pyetja 358 V)1

Cili është testi diagnostikues më i rëndësisshëm për diagnozën e arteriopatisë periferike?

A) termometria
B) arteriografia
C) testi i djersës
D) pletismografia
E) ultratingujt
PS)B

Pyetja 359 V)1

Cili është përkufizimi i empiemës pleurale?

A) akumulim i limfës në hapsirën pleurale
B) akumulim i koagulave në hapsirën pleurale si pasojë e pneumoektomisë
C) akumulim i materialit purulent në hapësirën plerurale
D) akumulim ajri dhe gjaku në hapsirën pleurale
E) akumulim serumi në hapsirën pleurale
PS)C

Pyetja 360 V)1

Qelizat atipike të pranishme në gjakun periferik të pacientëve të prekur nga mononukleoza infektive quhen

A) qelizat e Reed Stenberg.
B) eozinofile të aktivizuara.
C) polimorfonukleate neutrofile të aktivizuar.
D) qeliza të Dawney.
E) polimorfonukleate bazofile të aktivizuar.
PS)D

Pyetja 361 V)3

Në dekompensimin, insuficiencen kardiake akute të majtë

A) presioni i qarkullimit pulmonar zvogëlohet.
B) debiti kardiak rritet në mënyrë konstante.
C) fraksioni i ejeksionit nuk ndryshon.
D) rezistencat vaskulare periferike zvogëlohen.
E) frekuenca kardiake rritet.
PS)E

Pyetja 362 V)2

Shenja më e shpeshtë dhe domethënëse që haset në disfunksionin cerebelar është

A) instabilitet në ecje.
B) lëkundje të mëdha kur sytë mbahen mbyllur.
C) nistagmus.
D) hiposteni.
E) dridhje.
PS)A

Pyetja 363 V)2

Cili është përbërësi kryesor i gurëve biliar radiotransparent?

A) bilirubina
B) kripërat biliare
C) urobilina
D) kolesteroli
E) lecitina
PS)D

Pyetja 364 V)1

Kanceri i ezofagut në përgjithësi shfaqet me

A) disfagi.
B) pirozë.
C) regurgitim.
D) disfoni.
E) anoreksi.
PS)A

Pyetja 365 V)3

Në lodhjen muskulare

A) nervi motor përcjell në mënyre jonormale impulsin nervor.
B) stimujt bllokohen në nivel të pllakës neuromuskulare.
C) aktiviteti mekanik i fibres muskulare qëndron i pandryshuar.
D) potenciali i veprimit të muskulit zvogëlohet.
E) proçeset metabolike që çojnë në prodhimin e energjisë janë të pamjaftueshme për të kënaqur nevojat e muskulit.
PS)E

Pyetja 366 V)2

Reaksion leukemoid është

A) një leuçemi akute sekondare.
B) një leuçemi në fazën fillestare.
C) leukocitoza e theksuar e tipit reaktiv.
D) prania e qelizave neoplazike në palcën e kockës
E) një sindromë mielodisplazike.
PS)C

Pyetja 367 V)2

Në lidhje më seminomën e testikulit, cili prej pohimeve është i saktë?

A) është radio-kimio sensibile
B) është e ndjeshme ndaj radioterapisë por jo ndaj kemioterapisë
C) është e ndjeshme ndaj kemioterapise por jo ndaj radioterapise
D) është i nevojshëm përcaktimi histologjik përpara se të kryhet inguinotomia
E) shumë shpesh shpreh markues tumoral
PS)A

Pyetja 368 V)1

Në perforimin nga ulçera peptike ndërhyhet me

A) acide.
B) sukralfat.
C) inhibitor të pepsins.
D) karbenoksolone.
E) kirurgji.
PS)E

Pyetja 369 V)2

Hepatiti kronik aktiv në profil histologjik karakterizohet nga

A) steatonekroza fokale multiple.
B) fokuse granulomatoze.
C) nekroza e lamina limitante (piecemeal necrosis).
D) infiltrate eozinofile.
E) nekroza masive e hepatociteve.
PS)C

Pyetja 370 V)1

Cili prej pohimeve të mëposhtëm është i saktë?

A) Receptorët adrenergjikë bronkialë janë të tipit beta2.

B) Receptorët adrenergjikë bronkialë janë të tipit beta1.
C) Receptorët adrenergjikë bronkialë janë të tipit beta3.
D) Receptorët adrenergjikë bronkialë janë të tipit alfa1.
E) Receptorët adrenergjikë bronkialë janë të tipit alfa2.
PS)A

Pyetja 371 V)2

Limfocitoza e një entiteti të shprehur vërehet në fazën akute të

A) Pneumonise krupoze.
B) abcesit hepatik nga piogjenet.
C) ekinokokozës.
D) mononukleozës infektive.
E) ankilostomiazës.
PS)D

Pyetja 372 V)2

Lezioni më tipik i kockave gjatë LES nën trajtim me glukokortikoid është

A) fraktura spontane.
B) osteoporoza me njolla.
C) osteoskleroza.
D) nekroza aseptike.
E) osteomieliti akut.
PS)D

Pyetja 373 V)1

Në limfomën e Hodgkin, indi granulomatoz karakterizohet nga këta elementë citologjikë

A) qelizat e Sternberg.
B) plazmocitet.
C) mastocitet.
D) megacariocitet.
E) eritrocitet.
PS)A

Pyetja 374 V)2

Heparina sodike mund të jepet me rrugë

A) endovenoze.
B) intrarterioze.
C) subkutane.
D) endovenoze dhe intrarterioze.

E) intramuskulare.
PS)D

Pyetja 375 V)2

Cila prej patologjive të mëposhtme shoqërohet me feçe me shkumë?

A) sëmundja e Crohn
B) defiçit i sakarazës
C) fistula gastro-kolike
D) rektokoliti ulceroz
E) tumori i kolonit
PS)B

Pyetja 376 V)1

Jeni të pranishëm në zhvillimin e një krize epileptike të një subjekti adult për të cilin dini që është epileptik dhe ju është bërë e njohur terapia specifike që ai zakonisht merr. Si do të silleni?

A) E shtrini në tokë ose në një krevat duke i vendosur diçka të butë poshtë qafës për të shmangur lëndimet
B) E ulni në një karrige duke i mbajtur kokën lartë.
C) I vendosni një shami ose diçka tjetër në gojë në mënyrë që të mos dëmtojë gjuhën .
D) E bëni të gëlltisë një tabletë anti-epileptiku që i gjendet në xhep.
E) Prisni që kriza të mbarojë dhe përpiqeni të mos lejoni që pacienti si pasojë e krizës të pësojë trauma dhe bllokim të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes.
PS)E

Pyetja 377 V)2

Përfshirja e zonës sakro-iliake është tipike në

A) polimialgjine reumatike.
B) dermatomiostin.
C) lupusin eritematoz sistemik.
D) spondilitin ankilozant.
E) fibromialgjinë.
PS)D

Pyetja 378 V)1

Një medikament xhenerik është

A) një molekulë e përdorur për terapinë e shumë sëmundjeve.
B) një përzjerje molekulash.
C) një bar i përdorur për terapine homeopatike.

D) një bar që mund të merret pa përshkrimin e mjekut.
E) një bar të cilit i ka skaduar patenta.
PS)E

Pyetja 379 V)2

Cirroza hepatike në Europë dhe në USA është më shpesh e shkaktuar nga

A) hepatiti viral.
B) sëmundja biliare.
C) abuzimi me alkoolin.
D) sëmundjet autoimune.
E) sëmundjet metabolike.
PS)C

Pyetja 380 V)1

Cili prej muskujve të mëposhtëm bën pjesë në grupin e muskujve rrotullues të krahut?

A) m. Pektoral i madh
B) m. Subklav
C) m. Pronator rotondus
D) m. Dorsal i madh
E) m. Infraspinat
PS)E

Pyetja 381 V)2

Një burrë 50 vjeçar vlerësohet për faktorët e riskut kardiovakular pasi i ati ka kaluar infarkt të miokardit në moshën 52 vjeçare. Presionin arterial e ka 120/80 mmhg dhe indeksin e peshës së trupit (BMI) e ka 28. Veç dozimit të lipoproteinave, cili ësht
A) Matja e perimetrit të belit
B) Dozimi i lipoproteinës (a) të serumit
C) Dozimi i glicemisë esëll
D) Dozimi i proteinës C reaktive
E) Dozimi i homocisteinemisë
PS)C

Pyetja 382 V)1

Cili prej ekzaminimeve të mëposhtme ndihmon në diagnostikimin përfundimtar të polipeve gastrike?

A) Shintigrafia
B) CT-skaner
C) Radiografia e rrugëve respiratore të sipërme me dopio kontrast
D) Gastroskopia

E) Ekografia
PS)D

Pyetja 383 V)1

Sistemi i venës porta formohet nga derdhja e këtyre venave:

A) Gastrike, hepatike, splenike.
B) Mezenterike, ezofageale dhe pankreatike.
C) Pankreatike, lienale dhe mezenterike.
D) Hepatike, pankreatike dhe ezofageale.
E) Mezenterike superiore, mezenterike inferiore dhe lienale.
PS)E

Pyetja 384 V)1

Shtypja e palcës së shtyllës kurrizore është:

A) Shtypja e palcës së kockës
B) Shtypja e palcës spinale
C) Një komplikim i trajtimeve kimioterapeutike
D) Një efekt jatrogjen i terapisë hormonale
E) E shpeshtë në leuçeminë akute
PS)B

Pyetja 385 V)2

Termi "dizanteri" përdoret për të treguar:

A) Konstipacionin rebel.
B) Alterim të konstipacionit dhe diarresë.
C) Diarrenë si pure bizelesh.
D) Feçet si lëng orizi.
E) Diarrenë me mukus dhe gjak.
PS)E

Pyetja 386 V)1

Agjenti etiologjik i encefalitit spongiform bovin është:

A) Një virus
B) Një protozoar
C) Një toksinë
D) Një prion
E) Një rikecie
PS)D

Pyetja 387 V)1

Shkaku më i shpeshtë i stenozës së aortës është:

A) Sëmundja e lindur
B) Sëmundja reumatike
C) Degjenerimi fibrokalçik senil
D) Degjenerimi fibrokalçik i një valvule aortike bikuspidale
E) Endokarditi infektiv
PS)C

Pyetja 388 V)1

Inhibimi inzimatik:

A) Kërkon një kontakt të përsëritur ose të zgjatur të substancës farmakologjike me enzimën
B) Është një fenomen me interes toksikologjik, por jo terapeutik
C) Është një fenomen pa interes praktik
D) Përcakton efektet farmakologjike e terapeutike të shumë medikamenteve
E) Është gjithmonë i parikthyeshëm
PS)D

Pyetja 389 V)1

Cila nga gjetjet e mëposhtme nuk bën pjesë në kuadrin tipik të një pacienti me astmë bronkiale?

A) Bronkospazma
B) Eozinofilia
C) Hiperkolesterolemia
D) Dispnea
E) Sibilancatt respiratore
PS)C

Pyetja 390 V)2

Tromboxanët kanë kryesisht aktivitet:

A) Antiagregant trombocitar
B) Vazokonstriktor
C) Antikoagulant
D) Kimiotaktik
E) Bronkokonstriktor
PS)B

Pyetja 391 V)1

Inhibitorët e pompës protonike:

A) Janë pro-barna që aktivizohen në nivelin hepatik.
B) Janë inhibitorët e parikthyeshëm të enzimës H+/K+ ATP-azë.
C) Kanë një gjysmëjetë të gjatë plazmatike dhe kohë të gjatë veprimi.
D) Inhibojnë izoformat e ndryshme të citokromit P450.
E) Absorbohen mirë në nivel të stomakut.
PS)B

Pyetja 392 V)1

Vena ovarike e djathtë derdhet në venën:

A) Renale të djathtë
B) Mezenterike inferiore
C) Cava inferior
D) Iliaca comune dexter
E) Hypogatrica dexter
PS)C

Pyetja 393 V)2

Cili prej faktorëve të mëposhtëm nuk është faktor risku konstitucional për Bronko-Pneumopatinë Obstruktive Kronike?

A) Defiçit i anti-AT
B) Atopia
C) Hiper-reaktiviteti bronkial
D) Ekspozimi në punë ndaj asbestit
E) Peshë defiçitare në lindje
PS)D

Pyetja 394 V)2

Fraktura e Colles është më frekuente:

A) Tek fëmijet
B) Tek të rinjtë
C) Tek meshkujt e moshuar
D) Tek femrat e moshuara
E) Tek femrat shtatëzëna
PS)D

Pyetja 395 V)2

Cili prej tipeve të mëposhtme të distrofisë muskulare tregon fenomenin e anticipimit gjenetik?

A) Distrofia fascio-scapulo-humerale
B) Distrofia muskulare e Emery-Dreifuss
C) Distrofia e cingulit tipi 2
D) Distrofia muskulare miotonike
E) Distrofia muskulare e lindur nga defiçite të alfa-2-lamininës
PS)D

Pyetja 396 V)1

Cila prej gjendjeve nuk perben një indikacion klinik specifik i benzodiazepinave?

A) Konvulsionet
B) Ataket e panikut
C) Pagjumësia
D) Depresioni
E) Ankthi
PS)D

Pyetja 397 V)2

Cili e karakterizon gravitetin e një ishemie akute periferike?

A) Vendndodhja e obstruksionit arterioz
B) Koha e ishemisë
C) Presioni arterial
D) Vendi dhe koha e ishemisë
E) Prania e variçeve
PS)D

Pyetja 398 V)1

Transferina është:

A) Një enzimë që përdor hekurin për të transferuar protonet
B) Një formë e hemoglobinës
C) Një proteinë plazmatike që trasporton hekurin
D) Një proteinë intraqelizore që lidh hekurin
E) Një enzimë detoksifikuese
PS)C

Pyetja 399 V)3

Shoqërimi i hiposideremisë dhe hipotransferinemisë me ferritinën normale ose të shtuar, cilën nga patologjitë ne vijim do të evokonte?

A) Aneminë sideropenike

B) Aneminë e shoqëruar me inflamacion kronik
C) Aneminë megaloblastike
D) Hepatopatinë kronike
E) Hemokromatozën
PS)B

Pyetja 400 V)1

Cilin ekzaminim do propozonim tek një pacient që paraqet hematemeza?

A) Bronkoskopinë
B) Rö-grafinë e aparatit tretës
C) Ezofago-gastro-duodeno-skopinë
D) Rö-grafinë direkte të abdomenit
E) Klizmën opake
PS)C

Pyetja 401 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtme është i gabuar:

A) Karcinomat pulmonare me qeliza te vogla operohen rrallë sepse japin metastaza të parakohshme.
B) Shumë karcinoma skuamoze në stadin fillestar shpesh operohen me sukses.
C) Adenokarcinomat janë të operueshme sepse lokalizohen në periferi.
D) Mezoteliomat janë të operueshme sepse lokalizohen në pleurë.
E) Një hamartomë pulmonare është shpesh e operueshme.
PS)D

Pyetja 402 V)2

Cili është vendi më i shpeshtë i lokalizimit të pllakës aterosklerotike?

A) Aorta torakale
B) Aorta abdominale
C) Karotidja komune
D) Iliakja komune
E) Tripodi celiak
PS)B

Pyetja 403 V)2

Çfarë nënkuptohet me impenjim (ngecie) të pjesës së prezantuar?

A) Koha gjatë së cilës koka e fetusit kalon planin e ngushticës superiore
B) Kalimi nga ana e pjesës së prezantuar i ngushticës superiore

C) Koha në të cilën ndodh kalimi i pjesës së cirkumferencës më të madhe të pjesës së prezantuar përtej planit të ngushticës superiore
D) Kalimi i kokës përtej planit të ngushticës superiore
E) Tejkalimi nga pjesa e prezantuar i ngushtimit inferior
PS)C

Pyetja 404 V)2

Ne akalazi, radiografia me barium e ezofagut mund të evidentojë aspektet e mëposhtme, përveç:

A) Dilatimit të trupit të ezofagut
B) Cardia në formën e bishtit të miut
C) Ngadalësim të tranzitit ezofageal
D) Mungesë e zgjerimit të trupit të ezofagut dhe mbetje ushqimore në ezofag
E) Cardia inkontinente
PS)E

Pyetja 405 V)1

Pacientët e prekur nga sindroma Kleinefelter paraqesin:

A) Azoospermi
B) Oligozoospermi
C) Astenozoospermi
D) Teratozoospermi
E) Aspermi
PS)A

Pyetja 406 V)1

Tumori kardiak më i shpeshtë është:

A) Rabdomiosarkoma
B) Fibroelastoma papilare
C) Mixoma
D) Angiosarkoma
E) Mezotelioma e perikardit
PS)C

Pyetja 407 V)2

Ekzoftalmusi është i pranishëm në:

A) Sëmundjen e Basedow
B) Sëmundjen e Plummer
C) Të dyja patologjitë e mësipërme

D) Tiroiditin subakut
E) Hipotiroidizmin primitiv
PS)A

Pyetja 408 V)1

Cili nga këta mekanizma fiziopatologjikë nuk është përgjegjës për hipokseminë arteriale?

A) Hipoventilimi alveolar
B) Limitacionet e shkëmbimit gazoz në nivel të membranës alveolo-kapilare
C) Shunt Dx-Sin
D) Alterime të raportit ventilim-perfuzion
E) Aktivizimi i sistemit nervor jo-adrenergjik jo-kolinergjik
PS)E

Pyetja 409 V)2

Telarka është:

A) Zhvillimi i gjirit
B) Dalja e qimeve
C) Zhvillimi i të gjithë shenjave sekondare
D) Shfaqja e fluksit të parë menstrual
E) Zhvillimi i gjirit dhe dalja e qimeve
PS)A

Pyetja 410 V)1

Në vlerësimin diagnostik të refluksit gastro-ezofageal teknika më pak e përdorur është:

A) Marrja e bariumit per os
B) Manometria ezofageale
C) Ph metria ezofageale
D) Ezofago-Gastro-Duodeno-Skopia
E) Breath test me ure
PS)E

Pyetja 411 V)1

Pleksi brakial formohet nga degët primare anteriore të cilave radikse?

A) C5-Th1
B) C3-Th1
C) C5-Th2
D) C2-C7
E) C4-Th1
PS)A

Pyetja 412 V)1

Në perkusionin e toraksit, cila nga gjëndjet e mëposhtme shoqërohet me tingull të mbyllur?

A) Emfizema pulmonare
B) Fibrotoraksi
C) Pneumotoraksi
D) Astma bronkiale
E) Neoplazia mediastinale
PS)B

Pyetja 413 V)2

Një rritje e presionit kapilar me 5 mmhg mund të:

A) rrisë volumin plazmatik me 5%
B) shkaktojë një ripërthithje te volumit plazmatik me 5%
C) shkaktojë një ripërthithje të ujit nga hapësira intersticiale në atë kapilar
D) të reduktojë hematokritin me 25%
E) të rrisë kalimin neto të ujit nga kapilari në hapësirën intersticiale
PS)E

Pyetja 414 V)2

Torakotomia e urgjencës indikohet në rast:

A) Kontuzioni pulmonar
B) Versamenti pleural bilateral
C) Hemotoraksi aktiv
D) Pneumotoraksi me valvul
E) Empiema
PS)C

Pyetja 415 V)2

Formula e Friedwald për llogaritjen e kolesterol LDL-së është:

A) Kolesteroli - (triglyceride/5)
B) VLDL/HDL-kolesterol total ldlc=trigliceride-kolesterol total (HDL kolesteroli/3)
C) Ldlc= kolesterol total - (triglyceride + HDL kolesterol)
D) Ldlc= HDL kolesteroli + triglyceride)x5/ kolesterol total
E) Ldlc=kolesterol total - HDL
PS)D

Pyetja 416 V)2

Cila është zona më e prekur nga gonorrhea tek gruaja:

A) Qafa e uterusit
B) Buzët e mëdha
C) Buzët e vogla
D) Vestibulumi
E) Klitorisi
PS)A

Pyetja 417 V)3

Një paciente 65 vjeçare paraqet lumbalgi, anemi (Hb 8g/dl), shtim të VES (120mm/h), hiperkalçemi dhe komponentë monoklonalë igg-Kappa prej 6 g/dl. Cili nga pohimet e meposhtme është i sakte?

A) Është e rëndësishme të përjashtohet një hernie diskale me rezonance magnetike.
B) Makroglobulinemia e Waldenström është një diagnozë e mundshme.
C) Ekzaminimi morfologjik i palcës së kockës është thelbësor për diagnozën.
D) Matja e antigjenit prostatik (PSA) është thelbësor për diagnozën.
E) Është i nevojshëm fillimi i trajtimit me alendronat.
PS)C

Pyetja 418 V)2

Cila nga gjendjet e mëposhtme evoluon më shpesh në cirrozë?

A) Hepatiti akut nga virusi A
B) Hepatiti akut nga virusi B
C) Hepatiti kronik aktiv
D) Hepatiti akut nga virusi D e delta
E) Hepatiti supurativ
PS)C

Pyetja 419 V)1

Cilat janë vlerat e presionit mesatar në arterien pulmonare në një subjekt të shëndetshëm?

A) 1-5 mmhg
B) 5-10 mmhg
C) 10-20 mmhg
D) 30-50 mmhg
E) 50-100 mmhg
PS)C

Pyetja 420 V)2

Helmimi nga monoksidi i karbonit i detyrohet lidhjes së CO me:

A) Hekurin të hemit në formën ferrike
B) Hekurin të hemit në formën ferroze
C) Hekurin të hemit si në formën ferrike dhe në formën ferroze
D) Zinxhirët lamda që zëvendesojne CO2
E) Grupet e lirë aminikë të lizinës të zinxhirëve globinikë
PS)B

Pyetja 421 V)1

Barriera hematoencefalike:

A) Është e pranishme në mënyrë uniforme në të gjithë trurin.
B) Është më e përshkueshme ndaj substancave liposolubile sesa atyre hidrosolubile.
C) Është më e përshkueshme te adulti se te neonati.
D) Nuk ka mekanizma të transportit aktiv
E) Bllokon difuzionin e lirë të CO2.
PS)B

Pyetja 422 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme mbi sindromën Raynaud është e gabuar?

A) Elementi thelbësor i trajtimit konsiston në evitimin e ekspozimit të ekstremiteteve ndaj të ftohtit
B) Simpatikektomia i rekomandohet pacientëve me lezione trofike
C) Një trajtim me beta bllokues është i nevojshëm sa herë që eleminimi i ekspozimit në të ftohtë nuk zgjidh simptomatologjinë
D) Nuk janë të pranishme stenoza të venave të mëdha arterioze
E) Ekzaminimi klinik i pacientit duhet të përfshijë investigimet laboratorike që lejojnë të identifikohet kolagjenopatia vaskulare
PS)C

Pyetja 423 V)2

Të gjitha simptomat e mëposhtme mund të jenë simptoma të depresionit, përveç:

A) Ndryshimeve domethënëse të oreksit dhe peshës
B) Shtimit të energjisë
C) Ndryshimeve të ritmit të gjumit
D) Rënies së përqendrimit
E) Idesë vetëvrasëse
PS)B

Pyetja 424 V)2

Cila nga patologjitë e mëposhtme të SNQ -së ka një shkak pothuaj vetëm iatrogjen?

A) Meningiti koriolimfocitar
B) Leukoencefalopatia subkortikale
C) Mielinoliza pontine centrale
D) Sëmundja e Devic
E) Sëmundja e Machiafava-Bignani
PS)C

Pyetja 425 V)2

Në insufiçencën kronike kongjestive të qarkullimit:

A) Volumi sistolik zvogëlohet
B) Shpejtësia e kontraksionit ventrikular është e shtuar
C) Forca e kontraksionit ventrikular është e shtuar
D) Presioni ventrikular telediastolik është i zvogëluar
E) Volumi ventrikular telediastolik është i zvogëluar
PS)A

Pyetja 426 V)2

Zona e Vernicke-s:

A) Preket në "afazinë anomike"
B) Ndodhet në lobin frontal të hemisferës jo-dominante
C) Ndodhet në lobin temporal të hemisferës dominante
D) Bën pjesë në qendrat e të parit
E) Është gjerësisht e prekur në meningeomën olfaktore
PS)C

Pyetja 427 V)2

Pacientët me akromegali kanë pritshmëri jete (life-expectancy) më të vogël. Arsyeja kryesore është:

A) Shtrirja e tumorit hipofizar
B) Manifestimi i diabetit mellitus
C) Incidenca më e madhe e sëmundjeve kardio-vaskulare
D) Osteo-artro-patia akromegalike
E) Manifestimi i neoplazive
PS)C

Pyetja 428 V)3

Në lartësi të mëdha, presioni atmosferik reduktohet në krahasim me nivelin e detit. Leshimi i oksigjenit nga hemoglobina bëhet më i lehtësuar. Kjo realizohet nga rritja në gjak e:

A) Trinitrotoluenit
B) Trinitroglicerinës
C) Bifosfogliceratit
D) CO2
E) NH3
PS)C

Pyetja 429 V)1

Parimi bazë i marrëdhënies mjek-pacient ndërtohet nga:

A) vlerësimi, ndjenja e mirë dhe simpatia reciproke
B) karta e shërbimeve të rrethit përkatës
C) zgjedhja e lirë e mjekut dhe vendi i kurimit
D) vendet e lira për t'u regjistruar në sistemin e shërbimit shëndetësor shtetëror
E) disponibiliteti i mjekut për të kryer vizita shtëpie
PS)C

Pyetja 430 V)1

Cili ekzaminim përdoret në klinikë për monitorimin e funksionit renal?

A) Klirensi i insulinës
B) Gjaku komplet
C) Acidi urik plazmatik
D) Proteinuria
E) Kreatinina plazmatike
PS)E

Pyetja 431 V)1

Cila imunoglobulinë ka gjysmëjetën më të gjatë në serum?

A) Iga
B) Igg
C) Igm
D) Igd
E) Ige
PS)B

Pyetja 432 V)2

Sindroma retrovirale akute karakterizohet nga:

A) Kuadri simil-pneumonitik.
B) Kuadri simil-nefritik.
C) Kuadri simil-infarktual.

D) Kuadri simil-gastroenterik.
E) Kuadri simil-mononukleozik.
PS)E

Pyetja 433 V)2

Cili nga të mëposhtmit përbën një faktor patogjenetik për një neoplazi në zorrën e trashë?

A) Tymi i duhanit
B) Diabeti
C) Alkoolizmi
D) Anamneza familjare
E) Hipertensioni portal
PS)D

Pyetja 434 V)3

Mund të pohohet që reaksionet në kaskade të koagulimit

A) përfshijnë një sërë serin proteazash
B) varen nga kalçiumi
C) kërkojnë praninë e hekurit të tretshëm
D) pengojnë agregimin piastrinik
E) përfshijnë një seri të kinazave rregulluese
PS)A

Pyetja 435 V)2

Pruriti mund të shoqërojë të gjithë gjendjet e mëposhtme, përveç:

A) feomocitomës
B) policitemisë rubra vera
C) cirroza biliare primare
D) dermatiti atopik
E) uremia
PS)A

Pyetja 436 V)2

Tregoni se cili nga pohimet në lidhje me përdorimin e enzimave plazmatike në diagnostikën laboratorike është e gabuar:

A) në plazmë, në kushte fiziologjike, janë vetëm enzimat plazmë-specifike
B) disa enzima me origjinë qelizore janë të dozueshme në plazmë edhe në kushte fiziologjike
C) përqëndrimi plazmatik i enzimave që vijnë nga organet dhe indet rritet në mënyrë të konsiderueshme në lezionet e këtyre indeve apo organeve

D) për diagnostikimin e një patologjie të caktuar mund te jetë i dobishëm dozimi i më shumë se një enzimave (kuadri enzimatik)
E) ekzistojnë një sërë izoenzimash organo- ose ind specifike, dozimi i të cilave në plazmë është shumë i dobishëm për diagnozën diferenciale
PS)A

Pyetja 437 V)1

Vlera normale e fraksionit te ejeksionit te ventrikulit te majtë në qetësi është:

A) më i madh se 90%
B) midis 70% e 90%
C) midis 50% e 70%
D) midis 30% e 50%
E) nën 30%
PS)C

Pyetja 438 V)2

Krizat e "petit mal" janë:

A) manifestime jo epileptike
B) epilepsi parciale
C) epilepsi te vitit të parë të jetës
D) epilepsi të gjeneralizuara simptomatike
E) epilepsi të gjeneralizuara idiopatike
PS)E

Pyetja 439 V)1

Cili nga proceset ndodh gjatë fekondimit?

A) formimi i trofoblastit
B) formimi i vileve primare
C) implantimi i embrionit
D) përcaktimi i seksit
E) formimi i zonës pellucide
PS)D

Pyetja 440 V)1

Me gjysmëjetë fizike kuptohet intervali i kohës në fund të të cilit një sasi fillestare e atomeve radioaktive:

A) dyfishohet
B) përgjysmohet
C) reduktohet në ¼

D) reduktohet në ½
E) trefishohet
PS)B

Pyetja 441 V)2

Marrja e gjakut për të përftuar plazmë për ekzaminimet e koagulimit bëhet duke përdorur epruveta që kanë:

A) EDTA bipotasik
B) citrat trisodik
C) ndarës të serumit
D) antiglikolitik
E) asnjë solucion shtesë
PS)B

Pyetja 442 V)1

Vendi i auskultimit të aortës në kushte normale ndodhet në:

A) hapësirën interkostale II majtas mbi linjën parasternale
B) hapësirën interkostale III e majtë mbi linjën parasternale
C) hapësirën interkostale IV majtas mbi linjën parasternale
D) hapësirën interkostale II djathtas mbi linjën parasternale
E) hapësirën interkostale III djathas mbi linjën hemiklavikulare
PS)D

Pyetja 443 V)2

Marrja e tetraciklinës mund të shkaktojë:

A) hemorragji gastrike
B) kandidozë orale ose vaginale
C) insufiçencë pankreatike
D) kapsllëk
E) aritmi kardiake
PS)B

Pyetja 444 V)2

Oksigjenoterapia nuk sjell asnjëhere riskun e:

A) ulçerimit korneal
B) edemës pulmonare lezionale
C) fibrodisplazisë retrolentikulare
D) irritimit të mukozës së rrugëve ajrore
E) depresionin respirator në bronkopneumopatët kronike

PS)A

Pyetja 445 V)1

Në lidhje me cirrozën biliare primare, cili nga pohimet që vijojnë nuk është korrekt?

A) Shoqërohet shpesh me prurit
B) Në një përqindje të pacientëve haset prania e antikorpeve antimitokondriale
C) Dhënia e acideve biliare mund të jetë e dobishme në kontrollin e simptomave
D) Është më e shpeshtë në seksin femër
E) Trajtimi më efikas përfaqësohet nga D-penicilina
PS)E

Pyetja 446 V)2

Katatonia mund të prezantohet nga:

A) Deliri i fajit
B) Flexibilitas cerea (fleksibilitet dylli)
C) Paaftësia për të kujtuar fakte të fundit
D) Hipersensibiliteti ndaj leximit të argumentave mjekësore-psikologjike
E) Tendencë për të mbajtur fjalime publike
PS)B

Pyetja 447 V)2

Cili nga elementët auskultatore që vijojnë është më probabilisht i shoqëruar me insufiçencën e valvulës aortike?

A) Zhurma sistolike e ashpër në bazë
B) Zhurma sistolike goditëse
C) Zhurma sistolike me intensitet maksimal mbi fokusin aksesor aortik (pikën Erb), shoqëruar nga zhurmë sistolike ejeksioni në bazë
D) Murmurimi diastolik në majë
E) Zhurmë e vazhduar në bazë
PS)C

Pyetja 448 V)1

Korea e Huntington është:

A) Një sëmundje neurodegjenerative autosomike dominante
B) Një sëmundje neurodegjenerative autosomike recesive
C) Një manifestim i sëmundjes reumatizmale
D) Një formë e paralizës cerebrale infantile
E) Një çrregullim i koordinimit të lëvizjes me origjinë cerebelare
PS)A

Pyetja 449 V)1

Sa degë të nervit trigeminal dalin nga ganglioni i Gasser?

A) Një
B) Dy
C) Tre
D) Katër
E) Pesë
PS)C

Pyetja 450 V)1

Në pulmonet normale:

A) Kalimi i oksigjenit nga alveolat në kapilarë bëhet me transport aktiv
B) Në pozicionin drejt në këmbë raporti ventilim/perfuzion zvogëlohet nga baza në majën e pulmonit
C) Kalimi i oksigjenit nga alveolat në kapilaret bëhet me difuzion pasiv
D) Raporti ventilim/perfuzion nuk ndryshon nga baza në majën e pulmonit
E) Volumi i ajrit që hyn efektivisht në alveola gjatë inspirimit është i njëjtë me kapacitetin pulmonar total
PS)C

Pyetja 451 V)1

Antigjeni i sipërfaqes CD-4 shprehet:

A) Nga limfocitet T induktore
B) Nga limfocitet T supresore/citotoksike
C) Nga limfocitet B
D) Nga granulocitet
E) Nga trombocitet
PS)A

Pyetja 452 V)2

Tek pacientët e moshuar cila është terapia e zgjedhur e frakturave mediale të qafës së femurit?

A) Trajtimi me allçi
B) Osteosinteza
C) Zëvendësimi me protezë
D) Asnjë trajtim
E) Heqje e kokës femorale
PS)C

Pyetja 453 V)2

Agjentët patogjene përkufizohen oportunistike nëse:

A) Nuk janë asnjeherë patogjene
B) Kanë aftesinë të provokojnë gjithmonë e sidoqoftë një sëmundje
C) Kundërshtojnë kapacitetin patogjen të agjentëve të tjerë mikrobike
D) Rrisin kapacitetin e agjentëve të tjerë mikrobike për të provokuar një sëmundje
E) Provokojnë një semundje vetëm në kushte të caktuara
PS)E

Pyetja 454 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me një çift alelesh që kontrollojnë një karakter të vetëm është korrekt?

A) të dy alelet vijnë nga babai
B) të dy alelet vijnë nga nëna
C) një alel vjen nga nënë dhe një nga babai
D) transmetohen në çifte ose nga nëna ose nga babai
E) të dy janë rezultati direkt i mutacioneve që verifikohen njëkohësisht te nëna dhe babai
PS)C

Pyetja 455 V)1

Haluçinacionet përkufizohen si:

A) Bindje të pavërteta që mund të eleminohen nga gjykimi kritik
B) Bindje të pavërteta që nuk mund të eleminohen nga gjykimi kritik
C) Perceptime sensoriale të pavërteta të bazuara në stimulimin natyral të receptorëve
D) Perceptime sensoriale të pavërteta të pabazuara në stimulimin natyral të receptorëve
E) çdo ndjesi jonormale e lidhur me një lezion neurologjik
PS)D

Pyetja 456 V)2

Cili nga organizmat e mëposhtëm haset më shpesh si shkak i meningitit bakterik ose absesit cerebral në subjektin e imunokompromentuar?

A) pseudomonas aeruginoza
B) stafilokoku aureus
C) hemofilus influenze
D) baktroides fragilis
E) nocardia specie
PS)A

Pyetja 457 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm nuk është i saktë?

A) Në insufiçencën kardiake kongjestive digoksina rrit forcën e kontraktimit kardiak pa rritur konsumin e oksigjenit
B) Glukozidet kardioaktive induktojnë invertimin e valës T, zgjatjen e intervalit P-R, reduktimin e intervalit Q-T
C) Digoksina eleminohet me rrugë renale
D) Mëlçia është organi kryesor i perfshirë në elminimin e digitoksinës
E) Në fibrilacionin atrial glikozidet kardioaktive ngadalësojnë frekuencen mesatare ventrikulare të zgjatur në periudhen refraktare të nodusit atrio-ventrikular
PS)A

Pyetja 458 V)2

Cili nga këto grup simptomash është evokues për polineuropatinë?

A) krampet, hiper-refleksia miotaktike, hipostenia distale
B) parestezitë distale, clonusi akilien, inkontinenca e sfinkterave
C) hipostenia distale, arefleksia miotaktike, Babinski bilateral
D) parestezitë distale, hipostenia distale, arefleksia miotaktike
E) tetraparezë flakside, hiporefleksia, vezika neurologjike
PS)D

Pyetja 459 V)3

E qeshura 'sardonike' haset në:

A) meningite
B) difteri
C) poliomielit
D) tetanus
E) tërbim
PS)D

Pyetja 460 V)2

Cili nga këto ushqime është më i pasur me aminoacide esenciale?

A) veza
B) elbi
C) thjerrëzat
D) orizi
E) karrotat
PS)A

Pyetja 461 V)2

Në formulimin e një hipoteze diagnostike komplekse, etika i takon mbi të gjitha:

A) impenjimit për të ndjekur kërkesat e pacientit mbi rrugën diagnostike që pacienti e mendon si më të mirën e mundshme
B) zgjedhjes së ekzaminimeve të domosdoshme, duke evituar teprimin diagnostik
C) zgjedhjes së ekzaminimeve teknologjikisht më të avancuara të bindur se marrim informacionet më të besueshme
D) zgjedhjes së ekzaminimeve më të reja për të evituar hetimet e realizuara më parë
E) zgjedhjes së ekzaminimeve më ekonomike për një shfrytezim më të mirë të burimeve
PS)B

Pyetja 462 V)2

Qelizat në nodusin sino-atrial karakterizohen nga:

A) një potencial i pandryshuar i membranës
B) mungesa e sensibilitetit ndaj stimulimit parasimpatik
C) një potencial veprimi që varet nga jonet kalçium
D) një potencial veprimi me fazen e platosë të theksuar
E) një përshkueshmëri më e madhe ndaj K+
PS)C

Pyetja 463 V)2

Paralizat cerebrale infantile i detyrohen:

A) encefalopative degjenerative
B) encefalopative gjenetike
C) patologjive të njësisë muskulore
D) encefalopative të verifikuara në periudhat e hershme të zhvillimit
E) traumave psikologjike të hershme
PS)D

Pyetja 464 V)2

Cila është karakterisitike klinike e AIDS?

A) ndjeshmëri më e lartë ndaj infeksioneve oportunistike
B) predispozim për sëmundje metabolike
C) plakje e parakohshme / çrregullime të rritjes
D) shfaqja e çrregullimeve kardiovaskulare
E) dalja në pah e disekuilibrave hormonale
PS)A

Pyetja 465 V)2

Cila nga të mëposhtmet vërehet në fazën e hershme të nefropatisë diabetike?

A) mikroalbuminuria
B) reduktimi i dimensionit të veshkave
C) reduktimi i filtrimit glomerular
D) sindroma nefrotike
E) shtimi i azotemisë
PS)A

Pyetja 466 V)1

Kreatinin kinaza është një enzimë:

A) e sekretuar nga mëlçia në plazmë
B) e liruar në plazmë si pasojë e nekrozës
C) e sekretuar nga veshka në plazmë
D) e lëshur normalisht nga zemra në qetësi
E) e përfshirë në metabolizmin oksidativ
PS)B

Pyetja 467 V)3

Një pacient 30 vjeçar ankon dhimbje therëse që irradohen nga regjoni lumbar në gjenitalet e jashtme. Ka shumë mundësi që ai vuan nga:

A) cistiti akut
B) nefrolitiaza
C) epididimiti
D) glomerulonefriti akut
E) pielonefriti akut
PS)B

Pyetja 468 V)1

Pas sa kohësh nga infeksioni primar testi i tuberkulinës bëhet pozitiv?

A) pas 10 ditësh
B) pas 1 jave
C) pas 5 javësh
D) pas 10 javësh
E) pas 6 muajsh
PS)C

Pyetja 469 V)2

Skizofrenia në moshën e rritjes:

A) mund të shfaqet përpara moshës tre vjeç
B) është më e shpeshtë në adoleshencë
C) nuk ekziston
D) paraqet shumë analogji me sëmundjen e të rriturit
E) është tipike e moshës së latencës
PS)B

Pyetja 470 V)1

Përkufizimi arbitrar i anurisë është "një volum urinar më i vogël se":

A) 10 ml/ 24 orë
B) 100 ml/ 24 orë
C) 250 ml /24 orë
D) 400 ml/ 24 orë
E) 500 ml / 24 orë
PS)B

Pyetja 471 V)1

Në pacientin cirrotik, asciti i pa komplikuar karakterizohet gjithmonë nga:

A) mungesë totale e qelizave inflamatore
B) albuminemi më e vogël se 3 g/dl
C) ph më i vogël se 7
D) pamje e turbullt
E) 250 polimorfonukleate/mm3
PS)B

Pyetja 472 V)2

Cili nga lezionet elementare të mëposhtme nuk mbështet diagnostikimin me epidermit?

A) macula
B) vezikula
C) skuama
D) pustula
E) krusta
PS)A

Pyetja 473 V)1

Çfarë përmban eksudati në inflamacionin akut?

A) vetëm qeliza mononukleare

B) leukocite e proteina edhe me peshë të madhe molekulare sipas tipit të eksudatit
C) eozinofile dhe proteina vetëm me peshë të ulët molekulare
D) fibrinogjeni dhe qelizat gjigande multinukleare
E) plazmocite dhe fibroblaste
PS)B

Pyetja 474 V)1

Ulçera duodenale nuk komplikohet me:

A) hemorragji
B) perforim
C) penetrim
D) stenoze
E) kancerizim
PS)E

Pyetja 475 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë. Subjektet me grup gjaku AB kanë në serum:

A) antikorpe natyrale anti-A.
B) antikorpe natyrale anti-B.
C) antikorpe natyrale anti-A e anti-B.
D) as antikorpe, anti-A e as antikorpe anti-B.
E) antikorpe natyrale anti-Rh.
PS)D

Pyetja 476 V)2

Cili nga nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me farmakogjenomikën është i vërtetë?

A) Konsiston në studimin e tipareve të trashëgueshme dhe të variabilitetit nga një individ tek tjetri
B) Konsiston në studimin e përgjigjes ndaj medikamenteve në lloje të ndryshme etnike
C) Konsiston në studimin e gjenomes (DNA) dhe të produkteve të saj (ARN)
D) Konsiston në studimin e faktorëve gjenetike të trashëgueshëm që influencojnë në përgjigjen individuale ndaj barnave (efikasiteti dhe toleranca) duke krijuar diferenca midis nje individi dhe një tjetri
E) Konsiston në prodhimin e barnave të reja me teknika të inxhinierisë gjenetike
PS)D

Pyetja 477 V)2

Sekretimi i LHRH-së në vazat portale hipofizare vjen në mënyrë:

A) të vazhdueshme

B) pulsatile çdo 60-90 min
C) pulsatile vetëm pas vakteve
D) pulsatile vetëm gjatë natës
E) pulsatile vetëm gjatë pubertetit
PS)B

Pyetja 478 V)2

Sindroma nga privimi sensorial:

A) është një sindromë nga asbtinenca prej opiateve
B) shfaqet fiziologjikisht gjatë vitit të tretë të jetës së fëmijës
C) është një lezion i retinës nga ekspozimi ndaj stimujve të dritës me intensitet të lartë
D) verifikohet në subjektet e ekspozuar për periudhë të gjatë në një ambient thuajse i gjithi i privuar nga stimujte ndryshem
E) nuk ekziston
PS)D

Pyetja 479 V)2

Në cilin nga rastet e mëposhtëm nuk indikohet profilaksia anti-meningokoksike në personat që kanë patur kontakt me pacientin e diagnostikuar me meningit meningokoksik?

A) Kontaktet familjare të pacientit
B) Kontaktet në kopshte e shkolla që pacienti ka patur në 7 ditët e fundit
C) Subjektet e ekspozuara direkt ndaj sekrecioneve te pacientit përmes salivës ose përdorimit të objekteve të përbashkëta
D) Personeli sanitar që nuk është ekspozuar direkt ndaj pacientit
E) Subjektet që kanë fjetur ose ngrënë me pacientin
PS)D

Pyetja 480 V)3

Cilat nga çiftet e mëposhtme të sëmundjeve konsiderohen patogjenetikisht të lidhura dhe pjesë të një spektri të vetëm patologjik?

A) Sindroma e Alport dhe nefropatia nga iga
B) Sindroma e Alport dhe nefropatia diabetike
C) Purpura e Schonlein-Henoch e nefropatia nga iga
D) Purpura e Schonlein-Henoch e sindroma e Alport
E) Purpura e Schonlein-Henoch dhe nefroskleroza malinje
PS)C

Pyetja 481 V)1

Hiperpigmentimi i plikave palmare, të mukozës orale, të linjës alba, e të skrotumit mund të jetë shenjë e:

A) Insufiçencës surenale
B) Purpurës së Schoenlein-Henoch
C) Skleroza tuberose
D) Skorbutit
E) Sifilizit
PS)A

Pyetja 482 V)1

Cili është shkaku kryesor i bronkopneumopatise kronike obstruktive?

A) Duhanpirja
B) Ekspozimi ndaj asbestit
C) Ekspozimi ndaj silicit
D) Ekspozimi ndaj akarieneve
E) Ekspozimi ndaj graminaceve
PS)A

Pyetja 483 V)1

Ultratingujt përdoren në mjekësi për:

A) Të përftuar elemente radioaktive
B) Në terapinë pë r shkë putjen e retinës
C) Për studimin e hipoakuzive
D) Për të kryer një ekografi
E) Për të sterilizuar instrumentet kirurgjikale
PS)D

Pyetja 484 V)1

Në onkologji përkufizohet "neoadjuvant" një trajtim antiblastik

A) Post-operator
B) Pre-operator
C) Zëvendësues i interventit operator
D) I shoqëruar me radioterapi
E) Me mjekime eksperimentale
PS)B

Pyetja 485 V)3

Në insufiçencën respiratore tek nje pacient obez:

A) Alterimi funksional predominon gjatë fazës inspiratore
B) Alterimi funksional predominon gjatë fazës ekspiratore

C) Të dyja fazat e ventilimit janë të dëmtuara
D) Alterohet shkëmbimi alveolo-kapilar i gazeve
E) Rritet volumi rezidual
PS)C

Pyetja 486 V)1

Në cilën nga këto kushte edema shaktohet kryesisht nga zvogëlimi i presionit onkotik?

A) Staza venoze
B) Insufiçenca kardiake
C) Miksedema
D) Edema Quincke
E) Cirroza hepatike
PS)E

Pyetja 487 V)2

Një prej simptomave të mëposhtme bën pjese në sindromën e abstinencës ndaj sedativo-hipnotikëve. Cili?

A) Ankthi i theksuar
B) Hiporefleksia
C) Hipotensioni ortostatik
D) Ulja e temperaturës së trupit
E) Ulje e theksuar e motilitetit intestinal
PS)A

Pyetja 488 V)1

Astrocitoma e gradës IV është sinonim i:

A) Meduloblastomës
B) Ependimomës
C) Oligodendrogliomës
D) Glioblastomës Multiforme
E) Angiosarkomës
PS)D

Pyetja 489 V)1

Cila nga anemitë e më poshtme ka mundësitë më të mëdha për t'iu përgjigjur trajtimit me eritropoetinë?

A) Anemia sideropenike
B) Anemia pernicioze
C) Anemia sideroblastike

D) Anemia hemolitike autoimune
E) Anemia nga insufiçenca renale
PS)E

Pyetja 490 V)2

Hormonet tiroidiene qarkullojnë të lidhur me proteinat e transportit në masën:

A) < 10%
B) 10-50%
C) 51-70%
D) 71-99%
E) > 99%
PS)E

Pyetja 491 V)3

Cilat janë karakteristikat e hiperpireksisë të sëmundjes së Still?

A) Ethet e mbrëmjes
B) Temperaturë e lartë, intermitente, shpesh e shoqëruar nga një rash kutan fugax
C) Temperaturë e lartë, remitente
D) Temperaturë ondulante
E) Temperaturë e vazhdueshme
PS)B

Pyetja 492 V)2

Prania e niveleve hidro-ajrore në radiografinë direkte të abdomenit në pozicionin në këmbë është shenjë e:

A) Perforimit intestinal
B) Hemorragjise intestinale
C) Okluzionit intestinal
D) Pankreatopatisë kronike
E) Divertikulozë s së kolonit
PS)C

Pyetja 493 V)2

Cili është ekzaminimi funksional respirator që bën të mundur diferencimin e astmës bronkiale nga Bronkopneumopatia Kronike Obstruktive?

A) Spirometria e thjeshtë
B) Bodypletismografia
C) Testi i difuzionit të CO
D) Testi i bronko-reversibilitetit

E) Testi i sforcimit fizik
PS)D

Pyetja 494 V)1

Cili nga vlerësimet e mëposhtme ka prioritet te pacienti i politraumatizuar?

A) Kontrolli i gjendjes së vetëdijes
B) Kontrolli i respirimit
C) Kontrolli i kalueshmërisë së rrugëve ajrore
D) Kontrolli i aktivitetit kardio-cirkulator
E) Kontrolli i presionit arterial
PS)C

Pyetja 495 V)2

Cila nga sëmundjet infektive që vijojnë transmetohet me rrugë oro-fekale?

A) Difteria
B) Malaria
C) Rubeola
D) Sifilizi
E) Tifo
PS)E

Pyetja 496 V)2

Cilat nga shenjat e mëposhtme nuk bën pjesë në shenjat ekstrapiramidale?

A) Hiperkinezitë
B) Tremori
C) Arefleksia
D) Rigiditeti
E) Distonia
PS)C

Pyetja 497 V)2

Sarkoidoza prek më rrallë:

A) Parotiden
B) Zemrën
C) Tiroiden
D) Syrin
E) Lëkurën
PS)C

Pyetja 498 V)3

Cili nga pohimet e mëposhtme mbi peritonitin akut dytësor të gjeneralizuar nuk është i vërtetë?

A) Mund të jetë kimik ose bakterial
B) Është më shpesh polimikrobik
C) Mund të shkaktohet nga infeksione ose perforacione te organeve kavitare, çarje e abcesit hepatik ose splenik, infarktit intestinal, traumës penetruese ose të mbyllur, prishje e suturave ose anastomozave të organeve kavitare
D) Nuk kërkon trajtim me antibiotikë
E) Kërkon trajtim kirurgjikal në urgjencë
PS)D

Pyetja 499 V)1

Flebotomet transmetojnë:

A) Filariazën
B) Toxoplasmozën
C) Leishmaniozën
D) Amebiazën
E) Schistosomiazën
PS)C

Pyetja 500 V)2

Cili është shkaku më i mundshëm i gjakrrjedhjes "okulte" në aparatin tretës?

A) Angiodisplazia kolike
B) Divertikuloza e kolonit
C) Rektokoliti ulçeroz
D) Karcinoma e cekumit
E) Divertikuli i Zenker
PS)D

Pyetja 501 V)1

Kur observohet kariotipi 47, XY+21?

A) Sindroma e X fragil
B) Sindroma e Turner
C) Sindroma e Noonan
D) Sindroma Down
E) Sindroma Kleinfelter
PS)D

Pyetja 502 V)2

Nitroglicerina përcakton direkt ose me rrugë reflekse të gjithë efektet që vijojnë, përveç:

A) Takikardisë
B) Uljes së forcës kardiake
C) Rritjes së kapacitetit venoz
D) Uljes së kërkesës së miokardit për oksigjen
E) Uljes së parangarkesës
PS)B

Pyetja 503 V)3

Në fibrozën pulmonare idiopatike, cili alterim histologjik nuk gjendet asnjëherë?

A) Prania e lezioneve karakteristike
B) Ganuloma me nekrozë kazeoze
C) Ndonjëherë eksudat qelizor endo-alveolar
D) Rritje e kolagjenit në hapësirat intersticiale
E) Infiltrat limfoqelizor në nivel alveolar
PS)B

Pyetja 504 V)2

Cili nga këto pohime është i saktë?

A) Hiperplazia prostatike ka dy pike të incidencës: 25-35 vjeç dhe70-80 vjeç
B) Shkaku i hiperplazisë prostatike është i pavarur nga veprimi androgjeneve
C) Prostata me hiperplazi është e reduktuar në volum
D) Nuk ka korrelacion mes hiperplazise së prostatës dhe çrregullimeve të urinës
E) Hiperplazia e prostatës karakterizohet nga noduse të gjera kryesisht të lokalizuar në regjonin prostatik periuretral
PS)E

Pyetja 505 V)1

Cili komplikacion klinik NUK haset në Insufiçencen Renale Kronike terminale?

A) Neuropatia periferike
B) Artriti
C) Perikarditi
D) Anemia
E) Osteodistrofia
PS)B

Pyetja 506 V)1

Për një pacient në komë, ushqimi më i indikuar është zakonisht:

A) Parenteral periferik
B) Parenteral central
C) Enteral me sondë
D) Semisolid, nga goja
E) Hidrik, nga goja
PS)C

Pyetja 507 V)2

Në dekompensimin diastolik çrregullohet:

A) Kontraktimi ventrikular
B) Relaksimi ventrikular
C) Hedhja ventrikulare
D) Rezistenca e qarkullimit periferik
E) Rezistencat pulmonare
PS)B

Pyetja 508 V)3

Cilat nga qelizat e mëposhtme hipofizare përfaqësojnë përqindjen më të lartë të qelizave që prodhojnë hormone?

A) Qelizat laktotrope
B) Qelizat somatotrope
C) Qelizat gonadotrope
D) Qelizat tireotrope
E) Qelizat kortikotrope
PS)B

Pyetja 509 V)2

Cili nga indekset ndryshon kryesisht me rezistencat e rrugëve ajrore?

A) VEMS (Volumi ekspirator maksimal ne sekondë)
B) Kapaciteti vital
C) Komplianca statistikore
D) Kapaciteti pulmonar total
E) Volumi rezidual
PS)A

Pyetja 510 V)1

Cili prej këtyre kushteve nuk lidhet me shpërthimin e një krize epileptike?

A) Abuzimi me alkoolin
B) Privimi nga gjumi i natës
C) Temperaturë e rritur
D) Dehidrim ose hiponatremi e rëndë
E) Duhanpirja
PS)E

Pyetja 511 V)1

Ku gjendet eminentia hipotenare?

A) Në nivel të tarseve
B) Në nivel tibial
C) Në anën ulnare të karpeve
D) Në anën radiale të karpeve
E) Në nivel të akromionit
PS)C

Pyetja 512 V)1

Nuk evokon një sinkop:

A) Fytyra e zbehtë
B) Humbje e shkurtër e ndërgjegjes
C) Pupila të dilatuara
D) Fillim i menjëhershëm
E) Aura
PS)E

Pyetja 513 V)3

Nekroza papilare renale mund të gjendet në:

A) Diabetin mellitus.
B) Glomerulonefritin akut.
C) Hipo-gammaglobulinemia.
D) Litiazën renale.
E) Cistinurinë
PS)A

Pyetja 514 V)1

Cila nga simptomat e mëposhtme nuk është simptomë e vdekjes intrauterine fetale?

A) Mungesa e perceptimit nga ana e nënës e lëvizjeve fetale aktive
B) Mos-shtim i volumit të uterusit
C) Rritje e peshës së nënës

D) Regres i simptomave të shtatzënësisë
E) Mungesë e rrahjeve të zemrës fetale në ekografi
PS)C

Pyetja 515 V)3

Infiltrimi intersticial pulmonar, diabeti insipid dhe lezionet kockore osteolitike evokojne:

A) LES (lupus eritematoz sistemik)
B) Hemokromatozë
C) Sindromën e Goodpasture
D) Hand-Schuller-Christian
E) Sklerozën sistemike progresive
PS)D

Pyetja 516 V)2

Në nivelin renal, kreatinina:

A) Filtrohet e gjitha dhe absorbohet e gjitha
B) Filtrohet duke mbajtur vlerën e përqendrimit plazmatik dhe sekretohet e tëra
C) Filtrohet duke mbajtur vlerën e përqendrimit plazmatik dhe as nuk riansorbohet as nuk sekretohet
D) Eleminohet komplet me ultrafiltratin në nivel të glomerulit
E) Nuk filtrohet
PS)C

Pyetja 517 V)2

Cili është kriteri aktual i klasifikimit të Bronkopneurmopatise kronike obstruktive?

A) Kliniko-funksional
B) Radiologjik
C) Ekskluzivisht funksional
D) Anatomopatologjik
E) Radiologjik-funksional
PS)A

Pyetja 518 V)1

Cili është komplikacioni më i rëndë i stenozes mitrale?

A) Fibrilacioni ventrikular
B) Infarkti pulmonar
C) Infarkti i miokardit
D) Embolia sistemike
E) Asistolia

PS)D

Pyetja 519 V)2

Me cilën prej alternativave të mëposhtme shoqërohet shpesh sindroma e Reye?

A) Diabetin
B) Brucelozën
C) Marrjen e acidit acetil-salicilik
D) Hemokromatozën
E) Marrjen e heparinës
PS)C

Pyetja 520 V)2

Në cilën sëmundje ka splenomegali më të spikatur?

A) Sëmundja e Hodgkin
B) Leuçeminë Mieloide Kronike
C) Leuçeminë Mieloide Akute
D) Tiroiditin Hashimoto
E) Aneminë sideropenike
PS)B

Pyetja 521 V)2

Përbën kunder-indikacion në terapinë me digital:

A) Hipokalemia
B) Hemiblloku anterior i majtë
C) Hipertiroidizmi
D) Terapia kortikosteroide
E) Terapia me spironolakton
PS)A

Pyetja 522 V)2

Një adenopati aksilare shoqërohet shumë shpesh me eozinofili në cilën prej këtyre Gjendjeve?

A) Neoplazinë e gjuhës
B) Neoplazinë e ezofagut
C) Neoplazinë gastrike
D) Sëmundjen nga gërvishtja e maces
E) Fruthin
PS)D

Pyetja 523 V)2

Në malformacionin Arnold-Chiari:

A) Kuadri mund të imitojë një tumor të fossa posterior, por jo një Sklerozë Multiple
B) Manifestohet me shenja e simptoma nga lezione cerebelare, bulbare dhe të nervave kraniale
C) Kuadri mund të imitojë një siringomieli, por jo platibazia
D) Simptomat nuk manifestohen deri në moshën e rritur
E) Shfaqja e hidrocefalisë nuk është e zakonshme
PS)B

Pyetja 524 V)2

Prania e ajrit në formë drapëri midis heparit dhe diafragmës është karakteristikë e:

A) Perforacionit intestinal
B) Interpozimit të kolonit mes heparit dhe diafragmës
C) Çarjes së kisteve me ajër të pulmonit
D) Kisteve nga ekinokoku
E) Pneumotoraksit
PS)A

Pyetja 525 V)1

Mutacioni i Leiden nënkupton:

A) Një anomali të proteinës C, që përshpejton katabolizmin
B) Një anomali te faktorit V, që vonon katabolizmin
C) Një anomali të faktorit VII, që përshpejton aktivizimin
D) Një anomali të faktorit VIII, që përshpejton aktivizimin
E) Një anomali të faktorit XII
PS)B

Pyetja 526 V)2

Si quhet një term i ri i krijuar në raport me një ide delirante?

A) Pseudologjizëm
B) Parafazi
C) Neologjizëm
D) Logopedi
E) Pseudonim banal
PS)C

Pyetja 527 V)2

Në cilën rrethanë vihet re radiologjikisht hije e vogël renale?

A) Sindromën nefrotike
B) Nefropatinë polikistike
C) Glomerulonefritin kronik
D) Hidronefrozeën
E) Hipernefromën
PS)C

Pyetja 528 V)2

Rritja e parangarkesës do të përcaktojë:

A) Reduktim të presionit ventrikular në fund të diastoles
B) Reduktim të pikut të tensionit të muskulit
C) Reduktim të shpejtësisë fillestare të tkurrjes
D) Reduktim të kohës së kërkuar nga muskuli për të arritur pikun e tensionit
E) Rritje të tensionit të paretit ventrikular
PS)E

Pyetja 529 V)1

Në brucelozen akute sa është titri minimal për vënien e diagnozës?

A) 1:20
B) 1:50
C) 1:200
D) 1:400
E) 1:800
PS)C

Pyetja 530 V)2

Në bazë të cilave shenja vendoset diagnoza e sindromës okluzive intestinale?

A) Dhembjeve abdominale
B) Të vjellave
C) Melenave
D) Rektorragjisë
E) Dhembjeve abdominale, të vjellave, meteorizmit, mostranzitit të feçeve e gazrave
PS)E

Pyetja 531 V)2

Hemofilia C shkaktohet nga:

A) Mungesa e faktorit II

B) Mungesa e faktorit V
C) Mungesa e faktorit VIII
D) Mungesa e faktorit IX
E) Mungesa e faktorit XI
PS)E

Pyetja 532 V)2

Cilat nga funksionet që pasojnë kryhet falë aktivizimit të kaskadës së komplementit?

A) Kimiotaktizmi i neutrofileve
B) Rritja e sintezës proteinike në nivel hepatik
C) Rritja e shpejtësisë së eritrosedimentit(VES)
D) Ulje e fagocitozës
E) Apoptoza e makrofagëve
PS)A

Pyetja 533 V)2

Në cilin rast cilindrat leukocitarë janë tipikë?

A) Glomerulonefrit
B) Sindromë nefrotike
C) Pielonefrit
D) Nefropatia diabetike
E) Infeksioni i rrugëve urinare
PS)C

Pyetja 534 V)1

Cila nga këto patologji endokrine mund të japë hipoglicemi?

A) Morbus Cushing
B) Akromegalia
C) Morbus Conn
D) Hiperprolaktinemia
E) Morbus Addison
PS)E

Pyetja 535 V)2

Pneumocistoza është

A) Pulmoniti intersticial
B) Hepatiti
C) Nefriti
D) Encefaliti

E) Koliti.
PS)A

Pyetja 536 V)2

Haluçinacioni është:

A) Një perceptim në mungesë të një objekti për t'u perceptuar
B) Një çrregullim i vëmendjes
C) Gjitmonë i lidhur me dëgjimin
D) Karakteristikë e çrregullimit obsesiv-kompulsiv
E) Një çrregullim i sjelljes
PS)A

Pyetja 537 V)2

Çfarë duhet të alarmojë kryesisht mjekun në vlerësimin e një nevusi melanocitar?

A) Gjakrrjedhja pas një traume
B) Trumatizmat e shpeshta
C) Humbja e simetrisë
D) Prania e pruritit
E) Ngjyra e zezë
PS)C

Pyetja 538 V)2

Çfarë indikon termi 'uremi'?

A) Rritja persistente e acidit urik në gjak
B) Sindromë e korreluar me bllokimin e rrugëve urinare
C) Sindromë e korreluar me insuficencën renale kronike
D) Rritje, edhe pse tranzitore, e uresë në gjak
E) Prani e uresë në urinë
PS)C

Pyetja 539 V)2

Trajtimet aktuale të sëmundjeve gjenetike monofaktoriale përfshijnë të gjitha të mëposhtmet, me përjashtim të:

A) Zëvendesimit të gjenit mutant në të gjitha qelizat e organizmit
B) Kufizimit të marrjes së një substrati që ndodhet në dietë
C) Trajtimit simptomatik të pacientit
D) Inhibimit të funksionit të një metaboliti të dëmshëm
E) Dhënies së një proteine që mungon
PS)A

Pyetja 540 V)1

Infeksionet nozokomiale më të shpeshta janë:

A) Ato të aparatit respirator
B) Faringitet dhe pulmonitet
C) Infeksionet urinare
D) Infeksionet kirurgjikale
E) Otitet
PS)C

Pyetja 541 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm lidhur me funksionin renal dhe ekuilibrin acido-bazik nuk është i vërtetë?

A) Gjaku venoz është më acid se ai arterioz
B) Normalisht absorbohet thuajse gjithë uji që kalon në ultrafiltratin glomerular
C) Kur glicemia pason një vlerë prag (pragu renal) glukoza shfaqet në urinë
D) Përthithja e ujit në veshka varet ekskluzivisht nga ripërthithja e Na+
E) Veshkat ndërhyjnë në rregullimin e ph në plazmë
PS)D

Pyetja 542 V)2

Një rritje e CA-125 shoqërohet më shpesh me:

A) Karcinomën e kavumit oral
B) Neoplazinë beninje e prostatës
C) Neoplazinë e ovarit
D) Patologjinë inflamatore gastro-enterike
E) Karcinomën e zorrës së trashë
PS)C

Pyetja 543 V)2

Cila nga ekzaminimet e urinës është më i indikuar në monitorimin e diabetit të sheqerit?

A) Ketonuria
B) Proteinuria
C) Mikrohematuria
D) Leukocituria
E) Glukozuria
PS)E

Pyetja 544 V)2

Sindroma e Gilbert është:

A) Një ikter i fituar me hiperbilirubunemi kryesisht indirekte
B) Një ikter i fituar me hiperbilirubunemi kryesisht direkte
C) Një ikter i lindur me hiperbilirubunemi kryesisht direkte
D) Nje ikter i lindur me hiperbilirubinemi kryesisht indirekte i intensifikuar nga uria dhe nga stresi
E) Një ikter i lindur me hiperbilirubinemi kryesisht indirekte e përmirësuar nga uria dhe stresi
PS)D

Pyetja 545 V)2

Cili është elementi themelor në diagnozën e pneumokoniozës?

A) Anamneza
B) Ekzaminimi funksional
C) Lavazhi bronkoalveolar
D) Radiografia e toraksit
E) A+D
PS)E

Pyetja 546 V)1

Cili nga të mëposhtmit është indikacion për mediastinoskopinë?

A) Biopsia trakeale
B) Biopsia tiroidiene
C) Biopsia e linfonodujve pretrakealë
D) Biopsia e paretit torakal
E) Biopsia pleurike
PS)C

Pyetja 547 V)2

Karcinoma e ezofagut ka incidencë më të lartë tek subjektet e prekura nga:

A) Cirroza hepatike
B) Alkoolizmi kronik
C) Mieloma multiple
D) Sarkoidoza.
E) Spondiliti anchilopoetik
PS)B

Pyetja 548 V)1

Sëmundja reumatike manifestohet pergjithësisht

A) Pas një infeksioni stafilokoksik
B) Pas muajsh nga një infeksioni të fruthit
C) Menjëherë pas një infeksioni nga micoplazma
D) Pas difterisë
E) Disa javë pasnjë infeksioni streptokoksik
PS)E

Pyetja 549 V)2

Tumoret malinje te epiteleve gjendrorë mund të jenë:

A) Adenoma
B) Adenocarcinoma
C) Fibroadenoma papilifere
D) Epitelioma
E) Sarkoma
PS)B

Pyetja 550 V)1

Përbën shkakun e poliglobulisë sekondare:

A) Hemofilia
B) Insufiçenca respiratore kronike
C) Hemorragjia kronike
D) Leukemia mieloide kronike
E) Policitemia vera
PS)B

Pyetja 551 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme është një qelizë e sistemit imunitar kutan?

A) Qeliza e Langerhans
B) Melanociti
C) Corneociti
D) Fibroblasti
E) Fibra e muskulaturës së lëmuar
PS)A

Pyetja 552 V)2

Cili nga këto pohime në lidhje me diagnozën biokimiko-klinike të diabetit është i vërtetë?

A) Një vlerë e glicemisë esëll ?126 mg/dl, konfirmuar në një analizë të dytë, është e mjaftueshme për të vendosur diagnozën e diabetit mellitus (DM)
B) Mungesa e glukozurisë në një kampion të urinës përjashton me siguri praninë e DM-së
C) Matja e antitrupave anti-insulinë është një test skreening për diagnozën e diabetit mellitus
D) Në ngarkesën orale të glukozës standart (subjekte adulte, jo në gravidancë) jepen 100 gram glukozë
E) Për monitorimin e pacientit diabetik këshillohet përcaktimi i hemoglobinës së glukozuar çdo 15 ditë
PS)A

Pyetja 553 V)2

Në cilat kushte përdoret lidokaina si medikamenti i zgjedhur?

A) Takikardia paroksistike supraventrikulare me hipotension të rëndë
B) Takikardia ventrikulare me prani të pulsit
C) Takikardia ventrikulare me torsion të majës
D) Blloku AV i gradës III
E) Flateri atrial
PS)B

Pyetja 554 V)1

Në fibrilacionin atrial vala P:

A) Mungon
B) Është e pranishme
C) Gjendet e inseruar pas QRS
D) Gjendet e inseruar në QRS
E) Është bifazike
PS)A

Pyetja 555 V)2

Faktorët e rritjes janë:

A) Proteina të nevojshme për proliferimin qelizor
B) Substanca vitaminoze
C) Faktorë të nevojshëm për rritjen e vargjeve polipeptidikë
D) Kushtet ambientale që favorizojnë rritjen e një popullate qelizore
E) Faktorë të nevojshëm për maturimin e molekulës se ARN m
PS)A

Pyetja 556 V)2

Cili është shkaku kryesor i tumoreve pulmonare?

A) Tymi i duhanit
B) Ekspozimi ndaj asbestit
C) Ekspozimi ndaj silicit
D) Ekspozimi ndaj akareve
E) Ekspozimi ndaj graminaceve
PS)A

Pyetja 557 V)3

Një burrë 70 vjeç, me një nodus prostatik ne palpacion rektal: nese biopsia e prostatës e këtij lezioni evidenton mikroskopikisht praninë e gjendrave të vogla të dendura që përmbajnë qeliza me nukleola prominente, diagnoza është:

A) Adenokarcinomë e prostatës
B) Hiperplazi e prostatës
C) Prostatiti kronik
D) Karcinoma e qelizave tranzicionale metastatike
E) Infarkt të vonshëm të prostatës
PS)A

Pyetja 558 V)1

Anhidriti karbonik transportohet në gjak:

A) Lidhur me hemin e molekulave të hemoglobinës
B) Në pjesën kryesore i tretur fizikisht në plazmë
C) Lidhur me proteinat plazmatike
D) Në pjesën më të madhe si jone bicarbonate në eritrocite
E) Vetëm nën formën e acidit karbonik
PS)D

Pyetja 559 V)2

Cila nga karakteristikat e mëposhtme në CT skaner orientojnë drejt një lezioni malinj?

A) Kufij të qartë
B) Kalçifikime
C) Dimensione< 1 cm
D) Vaskularizim i rritur
E) Densitet homogjen
PS)D

Pyetja 560 V)2

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është shkak i embolive sistemike?

A) Insuficenca e trikuspidales
B) Stenoza e mitrales
C) Fibrilacioni atrial
D) Mixoma atriale e majte
E) Defekt i septumit interatrial
PS)A

Pyetja 561 V)2

Furunkuli i tubit auditiv ekstern është i shpeshtë te:

A) Pacientët diabetikë
B) Pacientët me sindrome nefritike
C) Pacientët kardiopatë
D) Pacientët me sindromë nefrotike
E) Pacientët me problem në qarkullimin limfatik
PS)A

Pyetja 562 V)1

Shkaku më i zakonshëm i hiperparatiroidizmit është:

A) Hiperplazia
B) Adenoma
C) Karcinoma
D) Hiperplazia - Adenoma
E) Hiper kortiko surrenalizmi
PS)B

Pyetja 563 V)2

Shoku septik nga bakteret Gram negativ shkaktohet nga:

A) Peptidoglikanët
B) Ekzotoksinat
C) Endotoksinat
D) Proteina M
E) Fosfolipidet
PS)C

Pyetja 564 V)2

Shkaku më i zakonshëm i hipotiroidizmit spontan tek adulti është:

A) Hipotiroidizmi nga mungesa e Jodit
B) Tiroiditi kronik autoimun (Hashimoto)
C) Tiroiditi akut

D) Tiroiditi i Riedel
E) Tumori i tiroides
PS)B

Pyetja 565 V)1

Në uretrën prostatike hapen:

A) Gjëndrat bulbo-uretrale.
B) Duktuset deferente.
C) Kanali i epididimës.
D) Kanalet eiakulatore, gjendrat prostatike dhe utrikuli.
E) Vezikulat seminale.
PS)D

Pyetja 566 V)1

Cila është triada simptomatologjike karakteristike në embolinë pulmonare?

A) Dhembja torakale, cianoza, ritmi i galopit
B) Dhembje torakale, dispnea, hemoptizia
C) Takikardia, hipertensioni arterial, djersitja
D) Dhembje, bradikardi, djersitje
E) Palpitacione, hipotension, ikter
PS)B

Pyetja 567 V)2

Shenja shintigrafike patognomonike e embolisë pulmonare është

A) Defekt i perfuzionit segmentar me ventilim normal
B) Defekt i perfuzionit segmentar me ventilim të alteruar
C) Defekt i ventilimit segmentar me perfuzion normal
D) Defekt i perfuzionit jo segmentar me ventilim normal
E) Defekti i perfuzionitjo segmentar me ventilim të alteruar
PS)A

Pyetja 568 V)1

Cilës familje laksativësh i takon manitoli?

A) Mucilagjenëve
B) Osmotikëve
C) Stimulatorëve
D) Detergjentëve
E) Lubrifikantëve
PS)B

Pyetja 569 V)3

Sindroma e karakterizuar nga zbehje, akrocianozë në duar dhe në shputat e këmbës si dhe në majën e hundës dhe në vesh, nga anemia hemolitike kronike është:

A) Sindroma e Raynaud
B) Insufiçenca kronike kongjestive e qarkullimit
C) Panarteriti nodoz
D) Sëmundja nga aglutininat e ftohta
E) Porfiria akute intermitente
PS)D

Pyetja 570 V)2

Cili nga observimet e mëposhtme dëshmon për evidencën e fortë në favor të një komponenti gjenetik në diabetin mellitus tip I (IDDM)?

A) Prani e shpeshtë e autoantitrupave anti - qeliza beta pankreatike
B) Rreth 10 % e të prekurve kanë gjithashtu një vëlla të prekur
C) Shfaqja e semundjes ndodh përgjithësisht në fëmijëri
D) Konkordanca në binjakët monozigotëështë rreth 30%
E) Konkordanca tek binjakët monozigot është rreth pesë herë më e madhe se nëbinjakët dizigotikë
PS)E

Pyetja 571 V)2

Qelizat e Reed-Sternberg janë patognomonike të;

A) Limfomës se Burkitt
B) Limfomës se Hodgkin
C) Melanomës
D) Karcinomës bazoqelizore
E) Limfoma B e tipit imunoblastik
PS)B

Pyetja 572 V)3

Djalë 12 vjeç me ngjyrë cianotike dhe formë jo normale të gishtave. Mjeku e viziton, dëgjon nje fëshfërimë kardiake dhe në pritje të ekokardiografisë i bën një Radiografi të toraksit që vë në evidencë një zemër ne formë këpuce dhe fusha pulmonare hipope
A) Defekti interarterial
B) Defekti interventrikular
C) Përshkueshmëri e duktusit arterial
D) Tetralogjia e Fallot
E) Rikthim anormal i venave pulmonare ne atriumin e djathtë

PS)D

Pyetja 573 V)3

Kërkesa për oksigjen e muskulit gjatë sforcimit muskular indukton prodhimin e energjisë përmes katabolizmit anaerobik të glukozës. Rezulton prodhimi i një acidi laktik të shtuar që largohet nga muskuli falë ciklit të:

A) Alaninës
B) Glutaminës
C) Cori-t
D) Acidit citrik
E) Uresë
PS)C

Pyetja 574 V)1

Tek një grua me cikle të rregullta 28 ditore, periudha e fekondimit është:

A) Ditën 2-5.
B) Ditën 7-11.
C) Ditën10-16 .
D) Ditën 18-26.
E) Ditën 20-29
PS)C

Pyetja 575 V)1

Vitamina E ka një rol të rrëndësishëm:

A) Antiinflamator
B) Antioksidant
C) Në oksido-reduktimin mitokondrial
D) Në transportin plazmatik të kolesterolit
E) Në absorbimin intestinal të hekurit
PS)B

Pyetja 576 V)1

Atopia karakterizohet nga:

A) Shtim i prodhimit të të gjitha Ig qarkulluese
B) Shtim i prodhimit të prodhimit të ige
C) Shtim i prodhimit të prodhimit të igm
D) Shtim i prodhimit të prodhimit të igg
E) Shtim i prodhimit të prodhimit të iga
PS)B

Pyetja 577 V)2

Hipotiroidizmi indukton:

A) Pagjumësi
B) Hiperhidrozë
C) Hirsutizëm
D) Takikardi
E) Hipotermi
PS)E

Pyetja 578 V)2

Në rastin e infeksioneve nga Neisseria Meningitis mikroorganizmi mund të izolohet nga:

A) Lëkura, Gjaku, Lengu cerebrospinal(LCS)
B) Rinofaringu, gjaku, LCS
C) Urina, gjaku, LCS
D) Fecet, gjaku, LCS
E) Feçet, urina, aspiracioni bronkial
PS)B

Pyetja 579 V)1

Eritrocitet në formë drapëri në aneminë drepanocitare shkaktohen nga:

A) Sintezë sasiore difektoze e hemoglobinës
B) Çrregullimet elektrolitike
C) Antikorpet
D) Çrregullimet e membranës
E) Çrregullime kualitative të hemoglobinës
PS)E

Pyetja 580 V)1

Në cilin nga gjendjet e mëposhtme është më pak e mundshme cianoza?

A) Komunikim i gjerë inter-atrial
B) Fistula arterio-venoze pulmonare
C) Komunikim i gjerë interventrikular
D) Ventrikuli unik
E) Persistenca e një vene kava superiore të majtë me derdhje në atriumin e majtë
PS)A

Pyetja 581 V)1

Prezenca e helikobakter Pilori në mukozën gastrike shoqërohet shpesh me :

A) Divertikulitin e kolonit
B) Neoplazia gastrike
C) Ulçera duodenale
D) Ezofagiti nga refluksi
E) Ileiti terminal
PS)C

Pyetja 582 V)2

Cili nga medikamentet e mëposhtme është një preparat i zgjedhur në rastin e meningiteve nga hemofilus influenze prodhues i beta-laktamazës?

A) Kloramfenikoli
B) Ampicilina
C) Cefalesina
D) Kanamicina
E) Piperacilina
PS)A

Pyetja 583 V)3

Në cilën nga sëmundjet e mëposhtme haset leukoplakia orale me qime?

A) Alopecia universale
B) Stomatiti nga proteza të papërshtatshme
C) AIDS
D) Diabeti
E) Stomatiti infektiv
PS)C

Pyetja 584 V)1

Kromozomi Philadelfia haset në:

A) Spondilitin ankilozant
B) Diabetin juvenile
C) Leukemine Mieloide Kronike
D) Koartazioni i aortës
E) Pankreatiti kronik
PS)C

Pyetja 585 V)2

Efektet biologjike të rrezatimit mund të jenë:

A) Vetëm somatike
B) Vetëm somatike për pak kohë
C) Vetëm somatike për një kohë të gjatë
D) Si somatike ashtu edhe gjenetike
E) As somatike, as gjenetike
PS)D

Pyetja 586 V)1

Hormonet e tiroides rritin:

A) Rezistencat periferike
B) Kohën e latencës së reflekseve tendinoze
C) Konsumin e oksigjenit në tru
D) Rezervat e glikogjenit në hepar
E) Energjinë e shpenzuar për të kryer një sasi të caktuar pune
PS)E

Pyetja 587 V)1

Agjenti etiologjik më i shpeshtë i osteomielitit akut është:

A) Haemofilus influenze
B) Klebsiella
C) Pseudomonas aeruginoza
D) Streptokoku
E) Stafilokoku aureus
PS)E

Pyetja 588 V)2

Një cist i absceduar i Bartolinit duhet:

A) Hequr me ndërhyrje kirurgjikale
B) Drenuar duke praktikuar një marsupializim
C) Kuruar me kompresa të njoma të ngrohta
D) Kuruar me antibiotikë
E) Kontrolluar shpesh duke shmangur ndërhyrjen kirurgjikale
PS)B

Pyetja 589 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtme në lidhje me kancerin e vezores nuk është i saktë?

A) Është kanceri më i zakonshëm i apartit gjenital femëror
B) Ka shkallën më të lartë të mortalitetit midis kancereve më të zakonshëm të aparatit gjenital femëror

C) Ka prirjen të jetë asimptomatik deri sa arrin një stad të caktuar
D) Zhvillimi i tij mund të influencohet nga faktorë ambientale, kulturalë e socio-ekonomikë
E) PAP test nuk është efikas në screening diagnostik të rutinës
PS)A

Pyetja 590 V)2

Në kryerjen e një torakocenteze duhet me qenë të kujdesshëm, për të shmangur perforimin e vazave që ndodhen në:

A) Bordin superior të brinjëve
B) Gjatë bordit inferior të indeve
C) Menjëherë pas brinjëve
D) Në hapësirat interkostale
E) Asgjë sepse nuk ka vaza në këtë regjon
PS)B

Pyetja 591 V)2

Në cilat nga sëmundjet e mëposhtme, përmbajtja e glukozës në likuorin cerebro-spinal ulet në mënyrë të theksuar?

A) Encefaliti nga fruthi
B) Encefaliti herpetik
C) Meningiti tuberkular
D) Poliomieliti
E) Meningiti nga coxackivirus
PS)C

Pyetja 592 V)1

Insulina stimulon sintezën e enzimës:

A) Ekzokinazë
B) Glukokinaza hepatike
C) Glukozë-6 -fosfataza
D) Fruktozë difosfataza
E) Piruvik karboksilaza
PS)B

Pyetja 593 V)2

Cila nga gjendjet e mëposhtme është shkaku më i zakonshëm i hidronefrozës pielike tek fëmija?

A) Stenoza në nivel të junksionit pielo-uretral

B) Vaza anormale
C) Kalkuloza
D) Refluksi veziko-uretral
E) Valvula e uretrës posteriore
PS)A

Pyetja 594 V)1

Në cilën nga sëmundjet e mëposhtme kundër-indikohet përdorimi i Antikoagulantëve?

A) Diabeti mellitus
B) Ulçera duodenale e mëparshme
C) Gjakrrjedhje aktive
D) TIA
E) Infeksionet bakteriale
PS)C

Pyetja 595 V)1

Kush dënohet për nxjerrje të sekretit profesional nëse nga ky fakt zbulohet dëmtim?

A) vetëm mjeku në cilësinë e zyrtarit publik
B) vetëm mjeku në cilësinë e të ngarkuarit me shërbim publik
C) vetëm mjeku i mjekësisë së përgjithshme
D) vetëm mjekët me cilësinë e zyrtarëve publik, të ngarkuar me shërbim publik apo që ushtrojnë nje shërbim të nevojave publike.
E) kushdo që ka njoftim për arsye të statusit ose postit zyrtar ose të profesionit apo artit të vet.
PS)E

Pyetja 596 V)1

Miastenia është një sëmundje që godet:

A) Fibrat muskulare
B) Motoneuronin që del nga palca e kurrizit
C) Mitokondret
D) Pllakën neuromuskulare
E) Fuzet neuromuskulare
PS)D

Pyetja 597 V)1

Cilat nga metodikat e diagnozës prenatale kryhet në fazën gestacionale më të hershme?

A) Fetoskopia

B) Amniocenteza
C) Prelevimi i vileve koriale
D) Funikulocenteza
E) Biopsia fetale
PS)C

Pyetja 598 V)1

Me amenorre primare kuptohet:

A) Amenorrea nga hipoovarizmi primar
B) Amenorrea me origjinë hipofizare
C) Amenorrea me origjinë hipotalamike
D) Amenorrea te gruaja që nuk ka patur asnjëherë flukse menstruale spontane
E) Mungesa e flukseve menstruale prej të paktën një viti
PS)D

Pyetja 599 V)1

Sistemi pulmonar i mbrojtjes rezulton i ndërtuar nga sistemi i mbrojtjes mekanike dhe Biologjike?

A) E gabuar
B) E vërtetë
C) E gabuar, sepse rezulton e ndërtuar vetëm nga mekanizma të mbrojtjes mekanike
D) E gabuar, sepse rezulton e ndërtuar vetëm nga mekanizma të mbrojtjes biologjike
E) E gabuar, sepse varet nga lëvizjet e kafazit të kraharorit
PS)B

Pyetja 600 V)3

Cili është funksioni i kompleksit C5-C9?

A) Ka veprim kimiotaktik
B) Rrit permeabilitetin kapilar
C) Ushtron aktivitet citolitik
D) Nxit çlirimin e histaminës
E) Aktivizon fagocitozën
PS)C

Pyetja 601 V)1

Cili është komplikacioni më i shpeshtë i tonsilitit akut?

A) Abcesi peritonsilar
B) Abcesi laterocervikal
C) Abcesi perifaringeal

D) Abcesi cerebral
E) Abcesi retrofaringeal
PS)A

Pyetja 602 V)1

Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk është komponent i indeksit të Apgar-it?

A) Ngjyra e lëkurës
B) Tonusi muskular
C) Temperatura trupore
D) Frekuenca kardiake
E) Frymëmarrja
PS)C

Pyetja 603 V)1

Qeliza staminale progenitore e limfociteve B gjendet:

A) Në shpretkë
B) Në pllakat e Peyer
C) Në palcën e kurrizit
D) Në timus
E) Në palcën e kockës
PS)E

Pyetja 604 V)2

Tek një pacient me histori të kolikave biliare të përsëritura, ekzistenca e një rruge biliare të zgjeruar, por pa kalula, ka më shumë mundësi të jetë nga:

A) Tumori i kokës së pankreasit
B) Kolangiti sklerotizant
C) Stenoza inflamatore e papilës së Vater
D) Atonia e rrugëve biliare kryesore
E) Cirroza biliare sekondare
PS)C

Pyetja 605 V)2

Pruriti i gjeneralizuar pa manifestime të dermopatisë në evolucion observohet me frekuencë të lartë në:

A) Hiperparatiroidizëm
B) Ulçerën gastro-duodenale
C) Limfomën e Hodgkin
D) Kollën e mirë

E) Hepatitin anikterik
PS)C

Pyetja 606 V)1

Në studimin e patologjisë pulmonare difuze, ekzaminimi më i përshtatshëm është:

A) Radiologjia konvencionale
B) Ekografia
C) CT-skaneri
D) RM (rezonanca magnetike)
E) Angiografia
PS)C

Pyetja 607 V)1

Vala T e elektrokardiogramës i korrespondon :

A) Fillimit të kontraktimit izovolumetrik
B) Sistolës atriale
C) Sistolës ventrikulare
D) Ejeksionit ventrikular maksimal
E) Fillimit të ripolarizimit ventrikular
PS)E

Pyetja 608 V)2

Disfonia mund të jetë e pranishme në patologjitë e mësipërme me përjashtim të:

A) Karcinomës së ezofagut
B) Aneurizmës së harkut të aortës
C) Kancerit të laringut
D) Kancerit të pulmonit
E) Otitit kronik
PS)E

Pyetja 609 V)1

Per cilën vlerë të BMI-së një grua duhet konsideruar mbipeshë?

A) 20-25
B) 25-30
C) 30-35
D) 27.5
E) Mbi 30
PS)B

Pyetja 610 V)1

Cila masë mund të reduktojë në mënyrë të rëndësishme incidencën e infeksioneve Nozokomiale?

A) Profilaksia antibakteriale
B) Zëvendësimi i shpeshtë i kateterëve venoze
C) Larja e përshtatshme e duarve
D) Kufizimi i lëvizjeve për pacientët
E) Kufizimi i vizitave të pacientëve nga ana e familjarëve
PS)C

Pyetja 611 V)2

Statusi epileptik (etat de mal):

A) Është një situatë kronike mbi të cilën duhet ndërhyrë me rregullime të vogla të terapisë
B) Kërkon një vlerësim anesteziologjik si qasja e parë terapeutike
C) Mund të shprehet vetëm me kriza të gjeneralizuara konvulsive
D) Është një urgjencë mjekësore
E) Ka fenitoinën si terapinë e vetme të mundshme
PS)D

Pyetja 612 V)2

Cili nuk është efekt kolateral i parashikueshëm në rast të trajtimit me kolinergjik ?

A) Konstipacion
B) Reduktim i ph gastrik
C) Tharja e mukozave e oro-faringeale
D) Takikardia
E) Bronkokostriksioni
PS)E

Pyetja 613 V)1

Me abces nënkuptohet:

A) Një infeksion supurativ të disa aparateve pilosebace në vazhdim
B) Një inflamacion akut purulent i gishtave
C) Një inflamacion eksudativ purulent difuz i indeve lidhore
D) Një mbledhje e pusit në një kavitet të riformuar
E) Një flogozë akute supurative e gjendrave sudoripare
PS)D

Pyetja 614 V)2

Një pacienti me polipozë familjare të kolonit i hiqet një polip. Cili tip i polipit ka më shumë mundësi t`i gjendet?

A) Një adenomë viloze
B) Një polip hiperplazik
C) Një polip adenomatoz
D) Një polip mbetës (rezidual)
E) Një pseudo-polip
PS)C

Pyetja 615 V)1

Treguesi morfologjik karakteristik i inflamacionit akut është:

A) Mastociti
B) Histiociti
C) Limfociti
D) Granulociti bazofil
E) Granulociti neutrofil
PS)E

Pyetja 616 V)2

Pacientët psikiatrikë trajtohen:

A) Në bazë të konsensusit për kurën
B) Si në mënyrë të vullnetshme dhe me detyrim sipas fazës te patologjisë së tyre
C) Vetëm në trajtimin obligator
D) Ekskluzivisht me iniciativë të familjes
E) Sipas kërkesave sociale
PS)B

Pyetja 617 V)1

Në elektrokardiogramë:

A) Kompleksi QRS ndjek menjëherë kontraksionin e ventrikujve
B) Vala T është shprehje e ripolarizimit të ventrikujve
C) Intervali PR korrespondon me propagimin e depolarizimit të atriumeve
D) Intervali RT korrespondon me zgjatjen e platosë të potencialit të veprimit ventrikular
E) Vala P është shprehje e depolarizimit të septumit interventrikular
PS)B

Pyetja 618 V)2

Kriza tireotoksike nuk karakterizohet nga:

A) Hipertermia e rëndë
B) Përgjigje e mirë ndaj dozave të mëdha të steroideve
C) Nëse nuk trajtohet, mortaliteti është të paktën 70%
D) Takikardia e rëndë
E) Hipotermia
PS)E

Pyetja 619 V)2

Cili nga këto pohime është i vërtetë?

A) Teknika e limfonodulit sentinel ndiqet vetëm nëse një lezion mamar rezulton beninj
B) Limfonoduli sentinel është limfonoduli i parë i zinxhirit lokoregjonal drenues, në të cilin duhet të kërkohen qeliza eventuale neoplazike që vijnë nga vendi i tumorit
C) Limfonoduli sentinel i një neoplazie mamare lokalizohet në nivel inguinal
D) Nëse limfonoduli sentinel është negativ, në rast të neoplazisë mamare malinje, do të jenë me siguri pozitivë limfonodujt aksilarë mbi të
E) Ndiqet teknika e limfonodulit sentinel në sëmundjen inflamatore kronike të zorrës së hollë
PS)B

Pyetja 620 V)1

Prania e 47 kromozomeve në kariogramë është karakteristike për sindromën e:

A) Turner
B) Klinefelte
C) Morris
D) Del Castillo
E) Bonnevie-Ulrich
PS)B

Pyetja 621 V)2

Në hipotiroidizmin kongenital, terapia fillohet:

A) Sa më shpejt të jetë e mundur
B) Tre muaj pas lindjes
C) Gjashtë muaj pas lindjes
D) Pas vitit të parë të jetës
E) Në pubertet
PS)A

Pyetja 622 V)1

Në rastin e flatter atrial, frekuenca e valëve F është zakonisht:

A) 240-320/ min
B) 380-480/ min
C) 60-100/ min
D) 100-150/min
E) 40-80/ min
PS)A

Pyetja 623 V)1

Stimulimi i nervit Vag sjell:

A) Takikardi
B) Reduktim të sekretimit gastrik
C) Rritje të salivacionit
D) Reduktim të salivacionit
E) Hipertension
PS)C

Pyetja 624 V)2

Ku dallojnë yndyrat ushqimore solide nga ato likuide (vajore)?

A) Nga gjatësia e acideve yndyrorë që i përbëjnë
B) Nga prania e përkatësisht mungesa e steroleve
C) Nga shkalla e josaturimit të acideve yndyrorë që i përbëjnë
D) Nga prania e acideve yndyrorë të degëzuar
E) Nga prania e vitaminave liposolubël
PS)C

Pyetja 625 V)1

Me jonizim kuptohet fenomeni që përcakton lëshimin e:

A) Një elektroni dhe një protoni
B) Një elektroni, një protoni dhe një neutroni
C) Një ose më shumë elektroneve
D) Një neutroni
E) Asnjë grimce
PS)C

Pyetja 626 V)2

Një pacient paraqet një kalkul oksalat-kalçiumi më të vogël se 1 cm në fossa renale të djathtë duke induktuar kolika recidivante. Cila është terapia e parë e zgjedhur?

A) Pielolitotomia kirurgjike

B) Ureterorenoskopia
C) Litotripsia ekstrakorporea
D) Dhënia e sasive të mëdha të ujit
E) Pielolitotomia perkutane
PS)C

Pyetja 627 V)2

Kur kryhet një prerje cesariane me incizion klasik mbi viscerën uterine, rreziku më i madh është:

A) Hapja e cikatrices në një gravidancë ose gjatë një lindjeje tjetër
B) Formimi i aderencave
C) Dhimbja post-operatore
D) Lezionet e vazave uterine
E) Vështirësi për të arritur kokën e fetusit për tërheqje
PS)A

Pyetja 628 V)2

Anoreksia nervore:

A) Shoqërohet rregullisht me amenorre kur shfaqet te gratë e reja, ose me probleme të identitetit seksual kur prek meshkujt
B) Është një sëmundje psiko-somatike ekskluzive e seksit femër
C) Është simptoma sekondare e depresionit
D) Është një manifestim i neurozës obsesive
E) Është një sëmundje neurologjike që kërkon një diagnozë të vëmendshme diferenciale me anoreksitë sekondare dhe dëmtimet psikiatrike e funksionale
PS)A

Pyetja 629 V)1

Tumori pulmonar që lokalizohet më shpesh në rrugët ajrore qëndrore është:

A) Karcinoma bronko alveolare
B) Mikrokarcinoma
C) Karcinoma epidermoide
D) Adenokarcinoma
E) Karcinoma me qeliza gjigande
PS)C

Pyetja 630 V)1

Tonusi muskulor:

A) Është rezistenca që një muskul i paraqet lëvizjes së vullnetshme

B) Është shkalla e kontraksionit muskular bazë
C) Është rezistenca që muskuli i kundërvë lëvizjes pasive
D) Është shkalla e eksitabilitetit muskulor bazë
E) Është kapaciteti i një muskuli për të mbajtur një posturë
PS)C

Pyetja 631 V)1

Subjektet me sindromë Klinefelter kanë kariotip:

A) 45, XO
B) 47, XX, + 21
C) 48, XXYY
D) 47, XXY
E) 47, XYY
PS)D

Pyetja 632 V)1

Splenomegalia nuk është normalisht e pranishme në:

A) Cirrozë
B) Karcinoma metastatike e kolon
C) Policitemia vera
D) Leukemia limfoide kronike
E) Mononukleoza infektive
PS)B

Pyetja 633 V)1

Masazhi i jashtëm kardiak është i nevojshëm kur:

A) Pacienti nuk merr frymë
B) Pacienti është midriatik e cianotik dhe pulsi central mungon
C) Pacienti është i pavetëdijshëm dhe paraqet mavijosje të gjymtyrëve
D) Pulsi radial mungon
E) Pulsi femoral mungon
PS)B

Pyetja 634 V)2

Cili nga mikroorganizmat përgjegjës për vaginitin kërkon trajtim të të dy partnerëve?

A) Trichomonas
B) Candida
C) Streptokoku i grupit B
D) Herpes Simplex Virus

E) Lactobacillus
PS)A

Pyetja 635 V)2

VIP është:

A) Prekusor hormonal
B) Hormon gastrointestinal
C) Enzimë pankreatike
D) Enzimë duodenale
E) Ko-enzimë
PS)B

Pyetja 636 V)2

Cili nga parametrat që vijojnë përcakton nëse një diarre është inflamatore ose jo?

A) Prania e temperaturës së lartë
B) Prania e dhimbjeve të forta në formë krampesh abdominale
C) Leukocitoza neutrofile në gjakun periferik
D) Prania e leukociteve dhe eritrociteve ne feçe
E) Rritja e shpejtësisë së ES dhe proteinës C reaktive edhe në mungesë të temperaturës
PS)D

Pyetja 637 V)2

Modulatori hipotalamik i inhibimit të sekretimit të prolaktinës është:

A) Somatostatina
B) TRH
C) Dopamina
D) Galanina
E) CRH
PS)C

Pyetja 638 V)2

Një pacient 60 vjeç shfaq prej kohësh kollë intensive dhe ka herë pas here ethe. Ekzaminimi i parë që është e nevojshëm të kërkohet me qëllim përcaktimin e një diagnoze është:

A) Radiografia e toraksit
B) Ekzaminimi citologjik i ekspektoratit
C) Tine testi
D) Bronkoskopia
E) Hematokriti
PS)A

Pyetja 639 V)2

Klasifikimi i emfizemës në centrolobulare ose panacinare bazohet në kriteret:

A) Topografike, në bazë të lokalizimit të lezioneve brenda acinit
B) Etiologjikë
C) E rëndesës, në bazën e kompromentimit funksional, verifikuar në spirografi
D) Anamnestike
E) Semiologjike
PS)A

Pyetja 640 V)2

Cili ekzaminim instrumental është i nevojshëm për diagnozën e IRK-së (insuficiences renale kronike)?

A) Ortopantomografia
B) Klizma opake
C) Ezofago-Gastro-Duodenoscopia
D) Ekografia renale
E) CT crani
PS)D

Pyetja 641 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë lidhur me reaksionet e hipersensibilitetit imediat (Tipi 1 i Gell e Coombs)?

A) Lidhja e komplementit ose ige me mastocitet ose membranat e bazofileve
B) Janë të ndërmjetësuar si nga aminat vazoaktive të para-formuara dhe ato të sapo-sintetizuara
C) Shfaqja e menjëhershme e simptomave që përmirësohen krejtësisht brenda 1 ore
D) Sindroma alergjike, si riniti alergjik dhe astma ekstrinseke
E) Simptoma si nauze, të vjella, diarre, edema laringeale ose urtikaria
PS)C

Pyetja 642 V)2

Cili nga kriteret e mëposhtëm nuk është kriter diagnostik madhor për sëmundjen Still të adultit?

A) Temperaturë 39° të paktën një javë
B) Artralgji ose artrite
C) Rash makular ose makulopapular, jo pruriginoz, ngjyre rozë-salmon
D) Leukocitozë (të paktën 10000/ul) me 80% ose më shumë granulocite
E) Pozitivitet për faktorin reumatoid

PS)E

Pyetja 643 V)2

Shkaqet më të shpeshta të diarresë akute janë:

A) Infektive ose toksiko-infektive
B) Alergjitë ushqimore
C) Sëmundjet inflamatore intestinale
D) Ishemia intestinale
E) Marrja e medikamenteve
PS)A

Pyetja 644 V)2

Testi i Ham është pozitiv në:

A) Sarkoidozë
B) Hemoglobinurinë Paroksistike Nokturne
C) Leukeminë Limfoide Kronike
D) Trombocitopeninë
E) Policiteminë Vera
PS)B

Pyetja 645 V)2

Medikamentet për terapinë e astmës administrohen me rrugë inhalatore, me qëllim administrimin e efekteve sistemike. Gjithë agjentët e mëposhtëm janë efikas kur administrohen në këtë rrugë, përveç:

A) Ipratropit të bromurit
B) Salmeterolit
C) Flutikazonit
D) Aminofilinës
E) Nedokromilit
PS)D

Pyetja 646 V)1

Faktori kryesor që rregullon aktivitetitn eritropoetik është:

A) Veshka
B) Eritropoetina
C) Njësitë që formojnë kolonitë eritroide
D) Oksigjeni
E) Palca hemopoetike
PS)D

Pyetja 647 V)1

Etiologjia e sëmundjes reumatike lidhet me:

A) Streptokokun viridans
B) Streptokokun beta hemolitik grupi A
C) Pneumokokun
D) Stafilokokun
E) Enterokokun
PS)B

Pyetja 648 V)2

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk ka aktivitet antiviral?

A) Aciclovir
B) Ganciclovir
C) Indinavir
D) Vidarabine
E) Ciprofloksacinë
PS)E

Pyetja 649 V)2

Cili nga pohimet është i vërtetë?

A) Nitroprusidi i natriumit aktivizon adenilat-ciklazën
B) Nitroprusidi i natriumit mund të shkaktojë torsion të majës
C) Nitroprusidi i natriumit është një vazodilatator si arterial, ashtu edhe venoz
D) Nitroprusidi i natriumit ka një gjysmë-jetë rreth 3 orë
E) Nitroprusidi i natriumit jepet vetëm me rrugë transdermike
PS)C

Pyetja 650 V)2

Lezioni kockor në profil, radiologjikisht i cilësuar si 'ngrënie thoji' është tipik për:

A) Artritin reumatoid
B) Artrozën
C) Podagrën
D) Osteoporozën
E) Osteomën osteoide
PS)A

Pyetja 651 V)2

Cili nga fenomenet që vijojnë gjeneron krepitacione inspiratore?

A) Spazma e bronkiolave terminale
B) Prania e likidit në alveola
C) Fibroza pulmonare
D) Emfizema pulmonare
E) Bronkiti kronik
PS)B

Pyetja 652 V)2

Manifestimi klinik më i shpeshtë në neoformacionet e timusit është:

A) Miastenia grave
B) Dhimbja epigastrike
C) Dhimbja torakale
D) Kolla
E) Hemoptizia
PS)A

Pyetja 653 V)2

Tregoni se cili nga këto pohime është i saktë?

A) Ekuilibri midis faktorëve pro-koagulantë dhe anti-koagulantë redukton trombozën
B) Defektet në sistemin antikoagulant fiziologjik favorizojnë shfaqjen e trombozës
C) Sistemi i VIIa-tissue factor nuk nxit kaskadën trombotike
D) Sistemi i proteinës S është një sistem pro-koagulant fiziologjik
E) Sistemi i antitrombinës III është një sistem pro-koagulant fiziologjik
PS)B

Pyetja 654 V)2

Hipersplenizmi nënkupton:

A) Hipertension portal nga mbifluksi
B) Humbje e aftësive hemopoetike të shpretkës
C) Rritje e volumit të shpretkës
D) Eritropenia, leukopenia e trombopenia për shkak të rritjes së shkatërrimit të këtyre qelizave në shpretkë
E) Tromboza e venës splenike
PS)D

Pyetja 655 V)3

Një koncept themelor i terapisë relacionale është ai i:

A) Komunikimit
B) Këshillimit
C) Subkoshiencës
D) Eksperiencës së jetuar
E) Të mësuarit
PS)A

Pyetja 656 V)1

Në hiper-kortiko-surrenalizëm nuk rritet:

A) Natremia
B) Kalemia
C) Glicemia
D) Presioni arterial
E) Frekuenca kardiake
PS)B

Pyetja 657 V)1

Cili prej faktorëve të mëposhtëm nuk mund të konsiderohet midis faktorëve etio-patologjikë të hipertensionit portal?

A) Hiperfluksi splenik
B) Blloku suprahepatik
C) Litiaza e rrugëve biliare kryesore
D) Cirroza
E) Tromboza e venës porta
PS)C

Pyetja 658 V)2

"Myku" i mukozave nënkupton:

A) Kandidozën e cavum orale
B) Kandidozën e plikave të mëdha të lëkurës
C) Onicodistrofinë nga Candida albicans
D) Epidermofizia inguinale
E) Intertrigo
PS)A

Pyetja 659 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i vërtetë?

A) Fluksi i gjakut përcaktohet në rradhë të parë nga variacione të rezistencës në arteriet e mëdha

B) Një rritje e viskozitetit të gjakut ul rezistencën vaskulare
C) Ndryshimet e diametrit te vazave kanë efekt në rezistencën më të vogël të variacioneve të viskozitetit
D) Rënia më e madhe e presionit në shtratin vaskular ndodh në arteriet e vogla dhe në arteriola
E) Rezistencat ndahen në mënyrë uniforme gjatë degëve të sistemit qarkullues
PS)D

Pyetja 660 V)1

Me përkufizim, temperatura e lartë verifikohet kur:

A) Temperatura e trupit rritet nga stimujt që arrijnë qendrën termo-rregullatore.
B) Temperatura e gojës kalon 37.7 °C.
C) Prodhimi trupor i nxehtësisë e kalon humbjen e saj.
D) Pacienti paraqet simptoma të shoqëruara me rritjen e temperaturës.
E) Ka një disekuilibër midis temperaturës së muskujve dhe asaj të lëkurës.
PS)A

Pyetja 661 V)2

Talasemitë përbëjnë një familje të sëmundjeve kongenitale që hasen në mënyrë të veçantë në popullatat që jetojnë ose origjinojnë nga zonat mesdhetare dhe i detyrohen:

A) Sintezës së mangët të një tipi të zinxhirit globinik.
B) Mungesës së shoqërimit të zinxhirëve alfa me zinxhirët beta.
C) Zëvendësimi i një aminoacidi ne zinxhirët beta.
D) Ndryshimeve të tretshmërisë së hemoglobinës në formën e saj të deoksigjenuar.
E) Oksidimi irreversibël i jonit ferroz(bivalent) në jon ferrik (trivalent).
PS)A

Pyetja 662 V)2

Në cilin kompartiment qelizor ndodh cikli i Krebs-it?

A) Membranë
B) Citosol
C) Mitokondri
D) Vakuola
E) Citoskelet
PS)C

Pyetja 663 V)1

"Spektri i veprimit" të një antibiotiku nënkupton:

A) Tërësinë e mikroorganizmave të ndryshëm potencialisht të ndjeshëm ndaj antibiotikëve.
B) Efektin bakterostatik ose baktericid të një antibiotiku.
C) Origjinën natyrale ose sintezën e antibiotikut.
D) Molekulat e ndryshme tëqelizës bakteriale në gjendje të lidhin antibiotikun.
E) Karakteristikat e absorbimit e të eleminimt të antibiotikut.
PS)A

1.Fondi B
Pyetja 1 V)2

Vendndodhja më e zakonshme e metastazave ekstra-limfonodale të tumorit të prostatës Është:

A) Kolona lumbo-sakrale
B) Pulmoni
C) Hepari
D) Surrenalja
E) Truri
PS)A

Pyetja 2 V)1

Shkaku më i shpeshtë i hemorragjisë subaraknoidale është:

A) Aneurizma cerebrale
B) Malformacionet artero-venoze cerebrale
C) Tumoret cerebral
D) Traumat kraniale
E) Koagulopatitë
PS)A

Pyetja 3 V)2

Sindroma e Guillain-Barrè prek:

A) Padallim, fëmijë e të rritur, të të dy sekseve
B) Ekskluzivisht të rriturit e të dy sekseve
C) Qartësisht kryesisht të moshuarit
D) Kryesisht meshkujt
E) Kryesisht femrat
PS)A

Pyetja 4 V)2

Cili nga këto trajtime të hiperkalemisë nuk është korrekt?

A) Infuzioni i Kalçium glukonatit
B) Administrimi i glukozës e insulinës
C) Alkalinizimi
D) Dhënia e rezinave me këmbim jonik
E) Dhënia e albuminës
PS)E

Pyetja 5 V)2

Koma hipoglicemike dallohet nga:

A) Hipertonusi muskular
B) Humbje e shpejtë e koshiencës
C) Rritje e lirimit të ADH
D) Prani e glukozurisë
E) Prani e acetonurisë
PS)B

Pyetja 6 V)2

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme rritet glukoza në gjak ?

A) Morbus Adison
B) Insulinoma
C) Glukogenesi
D) Feokromocitoma
E) Hipotiroidizmi
PS)D

Pyetja 7 V)2

Në pemën gjenealogjike të një familjeje të prekur nga një sëmundje autosomike dominante vihet re që:

A) Individët e prekur mund t'i kenë të dy prindërit e shëndetshëm
B) Nënat e subjektëve të prekur janë mbartëse të shëndosha
C) Gjithë fëmijët e një individi të prekur janë të sëmurë
D) Çdo subjekt i prekur ka të paktën një prind të sëmurë
E) Vetëm meshkujt janë të sëmurë
PS)D

Pyetja 8 V)2

Qelizat intersticiale të Lyding marrin pjesë në prodhimin e :

A) Spermatogonëve.

B) Estrogenëve.
C) Testosteronit.
D) Mineralokortikoideve.
E) Glukokortikoideve.
PS)C

Pyetja 9 V)2

Një burrë 45 vjeç ankon për një dhimbje në fiankun e majtë, katër orë pas një traume kontuzive në fiank. Ekzaminimi fizik rezulton normal. Presioni arterial është 110/60 mmhg, frekuenca e pulsit është 80/min; ekzaminimi i urinës evidenton prezencën e 5 e
A) Urografia.
B) CT skan.
C) Ekografia renale.
D) Shintigrafia.
E) Mbajtje nën observim.
PS)C

Pyetja 10 V)3

A jane statinat në gjendje të shkaktojnë një rritje të dukshme të HDL kolesterolit (HDL-C)?

A) Po, por vetëm tek pacientët me nivele lehtësisht të reduktuara të HDL-C
B) Po, por vetëm tek pacientë me nivele rëndësishëm të reduktuara të HDL-C
C) Jo, efekti i statinave në nivelin e HDL-C është i kufizuar
D) Po, vetëm tek pacientët me nivele të ulëta të HDL-së të shoqëruara me hipertrigliceridemi
E) Po, vetëm tek format gjenetike të dislipidemive
PS)C

Pyetja 11 V)2

Cila nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristike e tinea capitis?

A) Një njollë e vetme me skuama me ngjyrë gri-argjend dhe qime të këputura
B) Njolla të shumta me qime të këputura
C) Pak njolla me përmasa të mëdha me qime të këputura
D) Prani e qeres
E) Eritema e shprehur
PS)E

Pyetja 12 V)2

Nuk është shkak për formimin e një plage dekubituesi tek një pacient që:

A) është i kequshqyer
B) është i detyruar të qëndrojë në shtrat
C) është diabetik

D) është vaskulopat
E) vuan nga glaukoma
PS)E

Pyetja 13 V)1

Është faktor i rëndësishëm predispozues për hipertension esencial:

A) historia familjare pozitive
B) cefaletë e zgjatura
C) marrja e sasive të mëdha të hekurit me dietë
D) feokromocitoma
E) infeksionet virale të përsëritura
PS)A

Pyetja 14 V)1

Cili nga hormonet e mëposhtëm stimulon maturimin e folikulit ovarial?

A) LH
B) FSH
C) Estrogjeni
D) Progesteroni
E) Prolaktina
PS)B

Pyetja 15 V)1

Epidemitë e sëmundjeve që shtrihen ndërmjet kontinenteve paraqiten në formë:

A) universale
B) pandemike
C) endemike
D) sporadike
E) lokale
PS)B

Pyetja 16 V)2

Cor pulmonare akute e shkaktuar nga embolia masive karakterizohet nga:

A) mbingarkesa ventrikulare e majtë
B) mbingarkesa ventrikulare e djathtë
C) mbingarkesa atriale e majtë
D) hipotensioni venoz
E) vazodilatacioni periferik
PS)B

Pyetja 17 V)1

Fremitus vokale taktile e rritur, vërehet në rastet e:

A) empiemës
B) versamentit pleural
C) pneumotoraksit
D) kondensimit pulmonar
E) astmës bronkiale
PS)D

Pyetja 18 V)2

Meningokoku:

A) ka kapsulë
B) ka spore
C) nuk ka cilje
D) është shumë i lëvizshëm
E) është anaerob
PS)C

Pyetja 19 V)3

Kalikset renale, të emërtuar nga pikëpamja radiologjike si "çomangë", shfaqen zakonisht në:

A) glomerulonefrit kronik
B) nefrosklerozë
C) sëmundje policistike
D) pielonefrit kronik
E) tumor renal
PS)D

Pyetja 20 V)2

Forma e rëndë ose subakute e hepatitit viral nuk mund të evoluojë drejt:

A) atrofisë subakute
B) cirrozës post-nekrotike
C) hepatitit kronik inaktiv
D) fibrozës portale reziduale
E) amiloidozës
PS)E

Pyetja 21 V)2

Arteria e septumit e merr fillesën:

A) nga dega cirkumflekse e koronares së majtë
B) nga arteria koronare e djathtë
C) nga dega zbritëse anteriore e koronares së majtë
D) direkt nga aorta
E) nga trungu brakio-cefalik
PS)C

Pyetja 22 V)2

Në cilin nga indet e mëposhtme vërehet fillimisht hipertrofia?

A) Në indet që përbëhen nga qeliza të paafta për t'u ndarë, si p.sh muskuli skeletik dhe kardiak
B) në indet tumorale
C) në të gjitha indet, në vijim të stimulimit të shtuar endokrin
D) në indet e inflamuar
E) në indin dhjamor
PS)A

Pyetja 23 V)2

Blloku atrio-ventrikular nuk mund të jetë në relacion me:

A) kardiopatinë iskemike akute ose kronike
B) degjenerimin idiopatik të sistemit të konduksionit
C) miokarditin
D) konektivitin
E) perikarditin
PS)E

Pyetja 24 V)2

Incizura kardiake është:

A) ana e majtë e zemrës
B) ana e djathtë e zemrës
C) formohet nga ventrikuli i djathtë dhe atriumi i djathtë
D) septumi interventrikular
E) aurikula e djathtë
PS)A

Pyetja 25 V)1

Në duart e pacientit me artrit reumatoid dallojmë:

A) nodula të Heberden
B) nodula të Bouchard
C) nodula të Meynet
D) onikogrifozë
E) paronihi
PS)C

Pyetja 26 V)2

Karotidograma e stenozës aortike sub-valvulare muskulare paraqet gati gjithmonë:

A) valë rritjeje lineare dhe valë zbritjeje të bikuspiduar si M
B) valë rritjeje të bikuspiduar dhe valë zbritjeje lineare
C) valë rritjeje lineare dhe valë zbritjeje lineare
D) valë rritjeje dhe valë zbritjeje të bikuspiduara
E) valë lineare të thjeshta
PS)A

Pyetja 27 V)1

Në insuficiencën e qarkullimit arterial të këmbës, dallojmë lokalisht:

A) hipertrikozë
B) hipertrofi muskulare reaktive
C) rritje të shpejtuar të thonjve
D) eritrocianozë
E) nxehtësi lokale
PS)D

Pyetja 28 V)2

Ethet butonoze ose ethet ekzantematike mesdhetare shkaktohen nga rikecia conori, vektor i së cilës është:

A) morri
B) rriqna
C) pleshti
D) mushkonja
E) mizat
PS)B

Pyetja 29 V)2

Cili nga hormonet e mëposhtëm nuk është antagonist i insulinës?

A) Prolaktina
B) STH

C) kortizoli
D) glukagoni
E) katekolaminat
PS)A

Pyetja 30 V)3

Prania e antikorpeve anti-endomysial në gjak tregon:

A) Tiroiditit autoimun
B) Cirrozë autoimune
C) Pankreatit akut
D) Sëmundje celiake
E) Kolit ulcerativ
PS)D

Pyetja 31 V)2

Ndryshimi i shpejtësisë së reaksionit në raport me përqendrimin e substratit për një enzimë jo alosterike përfaqësohet me:

A) një kurbë sigmoidale
B) një hiperbolë drejtkëndore
C) një kurbë e tipit eksponencial
D) një vijë që kalon nga origjina
E) një kurbë Gauss
PS)B

Pyetja 32 V)3

Tek një neonat me virilizëm të gjenitaleve dhe hiponatremi dyshohet:

A) Sindroma Prader - Willi
B) Sindroma adrenogenitale
C) Sindroma Turner
D) Sindroma Klinefelter
E) Sindroma CHARGE
PS)B

Pyetja 33 V)2

Një neonat paraqet një angiomë të sheshtë në nivelin medial të palpebrës së sipërme. Lezione të tilla ka shumë mundësi që:

A) të mbeten stabël për gjithë jetën
B) të tentojnë të rriten
C) të zhduken brenda vitit të parë të jetës

D) të përbëjnë fazën fillestare të një melanome
E) të zhduken brenda ditëve të para të jetës
PS)C

Pyetja 34 V)1

Vena azigos gjendet:

A) në nivel të pleksit brakial
B) në pelvis
C) në hemitoraksin e majtë
D) në hemitoraksin e djathtë
E) në rajonin cervikal
PS)D

Pyetja 35 V)2

Nga ana radiologjike, ileusi abdominal i sipërm paraqitet me:

A) distendim abdominal difuz
B) pneumomatosis intestinale
C) bulë e dyfishtë hidro-aerike gastro-duodenale
D) ajër të lirë në abdomen
E) likid të lirë në abdomen
PS)C

Pyetja 36 V)1

Shkëmbimi gazor intra-pulmonar ndodh zakonisht:

A) në nivel alveolar
B) në nivel të bronkiolave terminale
C) në nivel të trakesë
D) në rrugët e sipërme respiratore
E) në "hapësirën e vdekur"
PS)A

Pyetja 37 V)2

Nga cila zonë e korteksit surenal sekretohet kortizoli?

A) glomerulare
B) fashikulare
C) retikulare
D) glomerulare+retikulare
E) kapsula
PS)B

Pyetja 38 V)2

Manovra e Valsalva-s:

A) redukton kthimin venoz në atriumin e djathtë.
B) shton kthimin venoz në atriumin e djathtë.
C) shton fluksin venoz koronar.
D) shton kthimin venoz në anësitë inferiore.
E) shton kthimin e gjakut nga vena kava superiore
PS)A

Pyetja 39 V)1

Sindromi i tunelit karpal nënkupton:

A) komprimimin e nervit ulnar.
B) komprimimin e nervit radial.
C) komprimimin e nervit ulnar e radial.
D) komprimimin e nervit peroneal
E) komprimimin e nervit median.
PS)E

Pyetja 40 V)1

T-ja e Studentit është:

A) një kalim në limit për llogaritjen e derivatit të parë.
B) një metodë e integraleve.
C) nje test statistikor
D) nje metodë për llogaritjen e debitit kardiak
E) një test për llogaritjen e kalorazhit
PS)C

Pyetja 41 V)1

Në trombocitopeninë idiopatike është e zgjatur:

A) koha e lizës së koagulit plazmatik
B) koha e hemorragjisë
C) koha e tromboplastinës
D) koha e trombinës
E) INR
PS)B

Pyetja 42 V)2

Cili mekanizëm fizio-patologjik shpjegon insuficiencën respiratore tek pacientët e prekur nga sëmundja neuro-muskulare?

A) alterimi i raportit Ventilim-Perfuzion
B) hypoventilimi alveolar
C) alterimi i difuzionit
D) anemia
E) çrregullimi i perfuzionimit pulmonar
PS)B

Pyetja 43 V)2

Kur administrohet Digitali, me cilin aspekt të EKG mund të kontrollohet efekti toksik i tij?

A) sub-denivelimi i segmentit ST
B) inversioni i valës T
C) shkurtimi i intervalit QT
D) prania e valës U
E) zgjatje e intervalit PR
PS)E

Pyetja 44 V)2

Tuberkulozi shkaktohet nga një reaksion imunitar i tipit:

A) gjysmë të vonuar
B) nga komplekse imunitare qarkulluese
C) imediat
D) i tipit qelizor
E) anafilaktik
PS)D

Pyetja 45 V)2

Në siringomieli, zakonisht shenjat fillestare janë:

A) fashikulacione.
B) dhembje të lokalizuara në një anësi të sipërme.
C) çrregullime sfinkteriane.
D) humbje të ndjeshmërise termo-algjike të duarve dhe/ose atrofi.

E) kontraktura
PS)D

Pyetja 46 V)1

Pika e palpacionit të pulsit femoral është e lokalizuar:

A) mbi simfizën pubike
B) në faqen laterale të kofshës
C) menjëherë nën arkadën inguinale
D) në faqen posteriore të kofshës
E) në fossa iliake
PS)C

Pyetja 47 V)2

Skleroza laterale amiotrofike:

A) fillon vetëm në nivel të muskulaturës proksimale.
B) shpesh shkakton dizartri dhe disfagi.
C) provokon hyperrefleksi.
D) provokon fashikulacione: intensiteti i tyre është proporcional me gravitetin e sëmundjes.

E) provokon kontraktura të muskujve abdominalë
PS)B

Pyetja 48 V)1

Ekzaminimi që duhet kryer për të diagnostikuar shkallën dhe tipin e stenozës së arteries renale është:

A) CT skaner të abdomenit
B) arteriografi selektive
C) ekografi renale
D) urografi
E) ro-grafi direkte
PS)B

Pyetja 49 V)1

Kontrolli për zbulimin e Diabetit nga shtatzania parashikon:

A) një ngarkesë të vogël glukoze prej 50gr
B) një ngarkesë glukoze prej 75gr
C) matjen e përditshme të glicemisë
D) matjen e Hb së glukozuar
E) praninë e trupave ketonike në urinë
PS)A

Pyetja 50 V)2

Parametri i vlerësimit të efektshmërisë së terapisë adjuvante është:

A) zgjatja e mbijetesës
B) arritja e remisionit komplet
C) reduktimi i masës tumorale
D) reduktimi i simptomave të lidhura me sëmundjen
E) kontrolli i dhimbjes
PS)A

Pyetja 51 V)1

Erizipela është:

A) një malformacion i rrallë renal
B) një sëmundje e aparatit tretës
C) një sinonim i inkontinencës fekale
D) një sëmundje e SNQ
E) një sëmundje infektive
PS)E

Pyetja 52 V)2

Faktori i riskut më i rëndësishëm për karcinomën vezikale në Europë është :

A) infeksioni nga Shistosoma
B) refluksi veziko-ureteral me cistopielit kronik
C) pirja e duhanit
D) ekzpozicimi profesional ndaj azbestit
E) përdorimi i alkoolit
PS)C

Pyetja 53 V)1

Hidradeniti është inflamacion i:

A) gjëndrës lakrimale
B) gjëndrës salivare
C) gjëndres sudoripare
D) gjëndres sebacea
E) gjëndrës limfatike
PS)C

Pyetja 54 V)2

Sindromi Pickwick nuk manifestohet me:

A) hypoksemi te shtuar
B) hipertension pulmonar
C) insuficience kardiake

D) kaheksi
E) cor pulmonale
PS)D

Pyetja 55 V)2

Në insuficiencën arteriale të këmbës lokalisht evidentohet:

A) hipertrikozë
B) hipertrofi muskulare reaktive
C) rritje e thonjve e shpejtë
D) edemë
E) dobësim dhe/ose mungesë e pulsit
PS)E

Pyetja 56 V)2

Në cilën nga sëmundjet e mëposhtme është i dobishëm administrimi i ekstrakteve pankreatike?

A) sëmundja celiake
B) sprue tropikale
C) gastriti atrofik
D) ulcera duodenale
E) pankreatiti kronik
PS)E

Pyetja 57 V)2

Pacienti adult me hipotireozë vuan më shumë nga:

A) të nxehtit
B) të ftohtit
C) pagjumësia
D) etja
E) dhembjet
PS)B

Pyetja 58 V)1

Kirurgjia moderne e meniskut nënkupton:

A) artrotominë
B) laser
C) osteosintezën
D) artroskopinë
E) imobilizimin

PS)D

Pyetja 59 V)1

Pamja e pacientit:

A) është një parametër i ekzaminimit psikatrik
B) nuk ka ndikim në vlerësimin psikiatrik
C) varion sipas nivelit shoqërore
D) është e lidhur vetëm me të veshurit
E) nuk përbën të dhënë me vlerë
PS)A

Pyetja 60 V)1

Klasifikimi i pneumonisë nozokomiale ose të fituar në komunitet (jashtë-spitalor) bazohet në kritere:

A) anatomopatologjike
B) epidemiologjike
C) radiologjike
D) klinike
E) gazometrike
PS)B

Pyetja 61 V)2

Komplikacioni jo tipik i sëmundjes Crohn është:

A) stenoza intestinale
B) abscedimi
C) fistulizimi
D) reumatizmi enterogen
E) glomerulonephritis
PS)E

Pyetja 62 V)2

Likuori cerebro-spinal futet në hapësirën subaraknoidale përmes:

A) vileve araknoidale
B) plekseve koroidale
C) foramen Monroe
D) foramen Luschka e Magendie
E) lamina cribrosa
PS)D

Pyetja 63 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtme është korrekt kur flasim për Fotodermatizimin?

A) lokalizohet veçanërisht në zonat jo të foto-ekspozuara
B) lokalizohet veçanërisht në fytyrë dhe duar
C) lokalizohet veçanërisht në plika
D) nuk ka dekurs stinor
E) lokalizohet në abdomen
PS)B

Pyetja 64 V)1

Eritropoetina është një sialo-glikoproteinë e prodhuar sidomos:

A) në hepar
B) në veshka
C) në surenale
D) në shpretkë
E) në hipofizë
PS)B

Pyetja 65 V)1

Fibrat e mielinizuara:

A) paraqesin një shpejtësi të rritur të konduksionit
B) nuk kanë nyje Ranvier
C) nuk lejojnë konduksionin saltator
D) përbëjnë shumicën e fibrave periferike
E) janë të pajisura me enë gjaku
PS)A

Pyetja 66 V)2

Në dekursin e lupusit eritematoz te diseminuar më shpesh vërehet:

A) një leukocitozë e rendësishme me rritje të limfociteve qarkulluese (limfocitosis).
B) një leukopeni.
C) një poliglobulinemi.
D) një trombocitozë.
E) rritje e hematokritit.
PS)B

Pyetja 67 V)2

Struma me konsistencë të fortë vërehet në:

A) karcinomën e tiroides
B) sarkomën e tiroides
C) tiroiditin Riedel
D) Strumën endemike
E) strumën polikistike
PS)C

Pyetja 68 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me LDL-në (lipoproteina me densitet të ulët) është i vërtetë?

A) Mënyra më e rëndësishme e grumbullimit të LDL-së, nga ana e qelizave bazohet tek ndërveprimi me një receptor specifik
B) Kanë për funksion transportimin e triglicerideve me origjinë ushqimore
C) Formohen në plazmë duke u nisur nga kilomikronet
D) LDL është prekursor i VLDL (lipoproteina me densitet shumë të ulët)
E) midis proteinave të ndryshme, jane ato me përmbajtje të shtuar në fosfolipide dhe proteina
PS)A

Pyetja 69 V)1

Cila nga këto endokrinopati nuk mund të shkaktojë diabet melitus?

A) feokromocitoma
B) akromegalia
C) hipertiroidizmi
D) sindromi Cushing
E) hipotiroidizmi
PS)E

Pyetja 70 V)1

Ralet janë zhurmat respiratore patologjike:

A) ekspiratore
B) të thata
C) sibilante
D) të njoma
E) pleurale
PS)D

Pyetja 71 V)1

Cili nga modifikimet e mëposhtëm të gjakut periferik që pasojnë splenektominë është i gabuar?

A) prania e eritrociteve "të shënjuar"
B) prania e eritrociteve me rezidua nukleare (trupat e Jolly)
C) trombocitopenia
D) neutrofilia tranzitore
E) prania e eritrociteve që përmbajnë granula hemosiderine
PS)C

Pyetja 72 V)1

Vigjilenca është:

A) shprehje e aktivizimit të korteksit cerebral
B) shprehje e aktivizimit të neuroneve cerebelare
C) shprehje e aktivizimit të formacionit retikular ascendent
D) shprehje e aktivizimit të cirkuitit hypokampo-talamo-mamilar
E)) shprehje e frenimit të impulsit në cornua dorsalis të medullës spinale
PS)C

Pyetja 73 V)1

Radiografia e abdomenit:

A) duhet të realizohet esëll
B) duhet të paraprihet nga CT skaner abdominal
C) është e indikuar në dyshimin për okluzion intestinal
D) nuk paraqet rreziqe gjatë shtatzanisë
E) nuk realizohet më, pasi është zëvendësuar nga CT skaner
PS)C

Pyetja 74 V)1

Mbi cilin parim mbeshtetet tomografia aksiale e kompjuterizuar?

A) rrezatimi jonizues
B) rrezatimi ultraviolet
C) rrezatimi infra i kuq
D) ultratinguj
E) lazer
PS)A

Pyetja 75 V)2

Nivelet plazmatike të rritura të reninës takohen në:

A) hiperaldosteronizmin primar
B) hepatitin akut

C) karcinoma surrenaliene
D) hipertiroidizmi
E) hemorragjinë masive
PS)E

Pyetja 76 V)1

Zëri është një fenomen fizik i tipit:

A) elektromagnetik.
B) elektrotermik.
C) biokibernetik.
D) mekanik.
E) nuk eshte nje fenomen fizik.
PS)D

Pyetja 77 V)3

Në glomerulonefritin akut difuz nuk është e zakonshme:

A) hematuria .
B) kolesterolemia e rritur.
C) proteinuria.
D) prania e cilindrave në urinë.
E) edema.
PS)B

Pyetja 78 V)2

Cili nga pohimet është i saktë ne lidhje me konstatimin se graviteti i insuficiencës kardiake gjykohet mbi bazën e:

A) pranisë së çrregullimeve në qetësi dhe në efort
B) pranisë së mbingarkesës ventrikulare të djathtë ose të majtë
C) dekursit akut ose kronik
D) patogenezës së mbingarkesës tensive ose volumetrike
E) prania e ekstrasisolisë supraventrikulare
PS)A

Pyetja 79 V)2

Deskuamimi në përfundim të ekzantemës vërehet tek:

A) fruthi.
B) lija e dhenve
C) rubeola
D) skarlatina

E) rozeola
PS)D

Pyetja 80 V)1

Nga se përbëhet një anestezi e përgjithshme?

A) sedacion e miorelaksim
B) amnezi e sedacion
C) sedacion, amnezi, analgjezi dhe miorelaksim
D) analgjezi e miorelaksim
E) miorelaksim dhe amnezi
PS)C

Pyetja 81 V)1

Retinopatia proliferante takohet:

A) në ureminë kronike.
B) në diabetin e komplikuar.
C) në hipertensionin nefro-vaskular.
D) në glaukomë
E) kataraktë
PS)B

Pyetja 82 V)2

Cirroza mund të verifikohet tek një pacient me:

A) lupus eritematoz sistemik
B) hemokromatozë
C) sarkoidozë
D) helmimi nga fosforo-organikët
E) ulçer gastrike
PS)B

Pyetja 83 V)2

Cila nga alternativat nuk perfaqëson një faktor risku të sigurtë për Sëmundje Kronike Obstruktive Pulmonare (COPD)?

A) infeksionet respiratore rekurente
B) pirja e duhanit
C) ndotja atmosferike
D) ndotja në vendin e punës
E) refluksi gastroezofageal
PS)E

Pyetja 84 V)1

Përdorimi i kontrastit intra-venoz është përcaktues në diagnozën skanerike (CT) të :

A) fibrozes pulmonare idiopatike
B) bronkoektazisë
C) trombembolisë pulmonare
D) versamentit pleural
E) astmës bronkiale
PS)C

Pyetja 85 V)2

Hematomielia vërehet më shpesh në vijim të:

A) hemo-diskrazisë
B) rupturës së një malformacioni arterio-venoz
C) rupturës së nje vaze arteriosklerotike
D) traumës
E) anemisë
PS)B

Pyetja 86 V)2

Mjeku përjashtohet nga detyrimi për konsensusin e pacientit kur:

A) kërkohet një vendim në urgjencë
B) në rast të çrregullimit mendor
C) në rastin e pacientit minor (fëmijë)
D) në rastin e hemotransfuzionit
E) operacionet e planifikuara
PS)A

Pyetja 87 V)1

Volvulus është:

A) një torsion aksial i një segmenti të zorrës së hollë rreth vetes ose rreth mezenterit të tij, çka sjell një obstruksion proksimal të lumenit
B) një torsion aksial i një segmenti të zorrës së trashë rreth vetes ose rreth mezenterit të tij, çka sjell një obstruksion proksimal të lumenit
C) një torsion aksial i një segmenti të zorrës së hollë ose të trashë rreth vetes ose rreth mezenterit të tij, çka sjell një obstruksion proksimal të lumenit
D) një torsion aksial i një segmenti të zorrës së hollë ose të trashë rreth vetes ose rreth mezenterit të tij, çka sjell një obstruksion si proksimal ashtu edhe distal të lumenit

E) një torsion aksial i një segmenti të zorrës së hollë ose të trashë rreth vetes ose rreth mezenterit të tij, çka sjell një obstruksion distal të lumenit
PS)D

Pyetja 88 V)1

Rinorreja është:

A) rrjedhja e likuorit nga cavum timpani
B) humbja e nuhatjes
C) një alterim i funksionit të dëgjimit
D) rrjedhje e likuorit nga fossa nazale
E) rrjedhje e gjakut nga veshi
PS)D

Pyetja 89 V)1

Sindromi i tunelit karpal:

A) prek shpesh nervin muskulokutan
B) nuk prek shpesh nervin median
C) mund të vërehet në miksedemë, akromegali dhe gjatë shtatzanisë
D) nuk shkakton atrofi të eminencës tenare
E) komprimon nervin ulnar
PS)C

Pyetja 90 V)1

Në cilin sindrom vërehet kariotipi 47, XXY:

A) sindromi Turner
B) sindromi Down
C) sindromi Angelman
D) sindromi Kleinefelter
E) sindromi Carpenter
PS)D

Pyetja 91 V)1

Efekt anësor i kortikosteroidëve nuk është:

A) hipertensioni
B) obeziteti
C) osteoporoza
D) diabeti mellitus
E) humbja në peshë
PS)E

Pyetja 92 V)1

Me termin 'bakteremi' kuptojmë:

A) një infeksion.
B) baktere në traktin gastro-intestinal.
C) praninë e bakterieve në gjak.
D) prania e bakterieve në urine
E) praninë e bakterieve në plagë
PS)C

Pyetja 93 V)2

Përballë këtyre vlerave të astrupogramës: ph - 7.29, paco2 - 70mmhg, HCO3 - 36meq/L, pao2 - 55mmhg, në çfarë gjendje acido-bazike ndodhet i sëmuri?

A) acidozë respiratore
B) acidozë metabolike
C) alkalozë respiratore
D) alkaloze metabolike
E) normale
PS)A

Pyetja 94 V)1

Cili nga ekzaminimet e mëposhtëm është specifik në arteriopati?

A) CT skaner
B) arteriografi
C) shintigrafi
D) fotopletizmografi
E) radiografi
PS)B

Pyetja 95 V)2

Tumoret insulare pankreatike me sekretim glukagonik provokojnë:

A) diabet
B) hypokaliemi
C) steatorrhe
D) aklorhidri
E) oliguri
PS)A

Pyetja 96 V)1

Në rastin e një frakture të hapur të këmbës, rreziku më i madh është:

A) embolia dhjamore.
B) lezioni nervor.
C) infeksioni.
D) konsolidimi vicioz.
E) edema.
PS)C

Pyetja 97 V)2

Heparina me peshë të ulët molekulare administrohet:

A) me rrugë intravenoze
B) me rrugë intravenoze, vetëm me perfuzion të ngadaltë
C) me rrugë intra-arteriale
D) me rrugë subkutane
E) me rrugë intra- spinale
PS)D

Pyetja 98 V)2

Në sindromin sino-karotidien nuk vërehet :

A) bradikardi
B) çrregullime të përçimit të impulseve kardiake
C) sinkopi
D) krizë hipertensive
E) hipotension
PS)D

Pyetja 99 V)2

Embolia arteriale nuk mund të prekë:

A) anësitë e sipërme
B) anësitë e poshtme
C) rajonin mezenterik
D) rajonin cerebral
E) të gjitha rajonet njëherazi
PS)E

Pyetja 100 V)1

Likidi cerebro-spinal:

A) gjendet në hapësirën midis dura mater dhe araknoides
B) nuk prodhohet nga plekset koroide
C) përmban një sasi të pakët glukoze në krahasim me plazmën
D) permban nje sasi te madhe te proteinave ne krahasim me plazmen
E) përmban qeliza leukocitare
PS)C

Pyetja 101 V)1

Në astmë, cilat nuk janë alterimet karakteristike që takohen në nivel të bronkeve?

A) hipertrofia e muskulatures se lëmuar
B) trashje e membranës bazale
C) edema e pareteve bronkiale
D) formimi i tapave të mukusit në disa rruge ajrore
E) fistula bronkiale
PS)E

Pyetja 102 V)1

Çfarë kuptohet me neurotmesis?

A) ndërprerje komplete e nervit
B) ndërprerje funksionale në përçim pa degjenerim të fibrave nervore
C) humbje e kontinuitetit të fibrave nervore me pasojë humbjen totale të funksionit
D) humbjen e kontinuitetit të fibrave nervore me pasojë degjenerimin periferik
E) humbje e kontinuitetit të membranës rrethuese të nervit
PS)A

Pyetja 103 V)2

Për të parandaluar sëmundjen hemolitike tek neonati, është e nevojshme:

A) administrimi tek nëna Rh- që mbart neonatin Rh+ , të një doze imunoglobuline anti-D
B) këshillimi i ndarjes së subjekteve me Rh jo-kompatibël (ndërprerja e barrës)
C) transfuzion gjakur komplet i nënës pas lindjes së një neonati Rh +
D) administrimi tek nëna që ka lindur neonatin Rh-, imunoglobulinë anti-D
E) administrimi i imunoglobulinë anti-D, te neonati Rh+
PS)A

Pyetja 104 V)2

Prognoza e karcinomës mamare të operuar nuk lidhet me:

A) limfonodujt aksilare pozitivë
B) gradën histologjike të tumorit
C) praninë e receptorëve hormonale

D) përmasave te tumorit
E) praninë e dhimbjes
PS)E

Pyetja 105 V)2

Çfarë kuptojmë me stadin I të sarkoidozës?

A) prekje e izoluar parenkimatoze
B) prekje e strukturave limfoglandulare hilare bilaterale, në mungesë të prekjes parenkimale
C) prekje e izoluar kutaneale
D) prekje e izoluar kardiake
E) prekje e izoluar renale
PS)B

Pyetja 106 V)3

Në cilën nga patologjitë tumorale të mëposhtme, beta-HCG, është markues selektiv?

A) karcinoma ovariale
B) karcinoma mamare
C) karcinoma e tiroides
D) korioepitelioma
E) adenokarcinoma e stomakut
PS)D

Pyetja 107 V)2

Tirozinemitë janë sëmundje të:

A) katabolizmit të tirozinës.
B) anabolizmit të tirozinës.
C) katabolizmit të purinave.
D) katabolizmit te pirimidinës
E) të metabolizmit të triglicerideve
PS)A

Pyetja 108 V)2

Cili nuk është faktor etiopatogjenetik i përfshirë në zhvillimin e astmës bronkiale?

A) aktiviteti i sistemit nervor autonom në rrugët ajrore
B) infeksioni i rrugëve ajrore
C) rimodelimi i rrugëve ajrore
D) çlirimi i mediatorëve me veprim bronkokonstrikor
E) efuzioni pleural
PS)E

Pyetja 109 V)2

Në sindromën nefrotike, proteinuria i atribuohet:

A) riabsorbimit të pakësuar tubular të proteinave.
B) permeabilitetit të shtuar të membranës bazale glomerulare.
C) hiperproteinemisë
D) hipoalbuminemisë
E) nekrozës tubulare
PS)B

Pyetja 110 V)2

Cila nga këto neoplazi pulmonare ka një lokalizim tipik central?

A) carcinoma me qeliza të mëdha
B) hamartoma
C) karcinoma me qeliza të vogla
D) karcinoma bronkiolo-alveolare
E) morbus Hodgkin
PS)C

Pyetja 111 V)1

Candida Albicans është një:

A) bakter
B) virus
C) myk dimorf
D) protozoar
E) spiroketë
PS)C

Pyetja 112 V)2

Adenokarcinoma është nje neoplazi malinje që merr origjinën nga:

A) epiteli glandular
B) qelizat endoteliale
C) fibroblastet
D) epiteli skuamoz
E) indi lidhor
PS)A

Pyetja 113 V)2

Cila nga sëmundjet hematologjike të mëposhtme gjendet shpesh rastësisht në ekzaminimet hemokromocitometrike të kryera për motive klinike te tjera?

A) leucemia limfoide kronike
B) hemofilia
C) limfoma nodulare
D) anemia ferriprive
E) poliglobulia
PS)A

Pyetja 114 V)2

Fraksioni i ejeksionit përkufizohet si:

A) raporti midis volumit të ejeksionit sistolik dhe volumit telesistolik.
B) raportit midis volumit te ejeksionit sistolik dhe volumit telediastolik
C) produkti i volumit te ejeksionit sistolik dhe volumit telesistolik
D) produkti i volumit te ejeksionit sistolik dhe volumit telediastolik
E) produkti i volumit te ejeksionit sistolik dhe frekuencës kardiake
PS)B

Pyetja 115 V)1

Glicemia esëll - prag për diagnozën e diabetit melitus është:

A) 110mg%.
B) 126mg%.
C) 140mg%.
D) 220mg%
E) 250mg%
PS)B

Pyetja 116 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtme e karakterizon më mirë gentamicinën?

A) është një antibiotik me spektër selektiv (vetëm bakteret gram-pozitive) për të cilën është i dobishëm preparati intravenoz.
B) administrohet më shpesh me rrugë orale.
C) është një antibiotik baktericid, i karakterizuar nga nefrotoksiciteti i shprehur.
D) nuk ka rezistencë të shprehur ndaj tij.
E) preferohet të përdoret i pa kombinuar me antibiotikë të spektrit tjetër.
PS)C

Pyetja 117 V)2

Cila nga këto rrethana patologjike nuk është manifestim ekstra-artikular i artritit reumatoid ?

A) kaheksia
B) noduli reumatoid i valvules aortike
C) vaskuliti reumatoid
D) perikarditi
E) çrregullimi i dëgjimit.
PS)E

Pyetja 118 V)2

Cilat qeliza insulare pankreatike sintetizojnë glukagon?

A) qelizat alfa
B) qelizat beta
C) qelizat delta
D) qelizat gama
E) qelizat theta
PS)A

Pyetja 119 V)2

Cila nga simptomat nuk është në përgjithësi e pranishme tek pacientët me insuficiencë kardiake kongjestive të rëndë?

A) përqendrimi plazmatik i rritur i ADH-ësë.
B) edemë e gjeneralizuar.
C) rritje e volumit hepatik.
D) etje
E) rënie në peshë
PS)E

Pyetja 120 V)3

Niveli i shtrimeve në spital shprehet si:

A) përqindje e shtretërve për 1000 banorë
B) frekuenca vjetore e shtrimeve për 1000 banorë
C) raporti midis numrit total të ditëve në spital me numrin e shtrimeve për një popullatë të caktuar
D) raporti në përqindje midis numrit të shtretërve të zënë me numrin e atyre disponibël
E) raporti i numrit të shtretërve me të shtruarit në 1 vit
PS)B

Pyetja 121 V)2

Cilët janë faktorët e riskut, përgjegjës për instalimin e pneumonisë nga hipersensibiliteti?

A) inhalacioni okazional i pluhurave inorganike.
B) inhalacion i përsëritur i pluhurave inorganike.
C) inhalacioni i përsëritur i pluhurave organike me dimensione më pak se 5um.
D) inhalacion i pluhurave organike më të mëdha se 5um
E) inhalacioni i gazit toksik për qëllim suicidi
PS)C

Pyetja 122 V)2

Shkaku me i shpeshtë i kolapsit të lobit pulmonar superior të majtë tek adulti është

A) tuberkulozi.
B) tumori beninj.
C) karcinoma bronkogjene
D) trauma
E) hemotoraksi.
PS)C

Pyetja 123 V)2

Cili është trajtimi më i përshtatshëm për CIN III (Cervical Intraepithelial Neoplasia)?

A) histerektomia
B) elektrokoagulimi
C) terapia mjekësore
D) konizimi cervikal
E) radiacioni
PS)D

Pyetja 124 V)2

Cila nga patologjitë e mëposhtme nuk është shkak për disfunksionin diastolik?

A) krdiomiopatia hipertrofike
B) kardiomiopatia infiltrative
C) iskiemia e miokardit
D) morbus Paget
E) insuficienca kardiake kronike
PS)D

Pyetja 125 V)3

Në morbus Hodgkin me limfoadenopati latero-cervikale, limfonodujt janë:

A) të dhimbshëm në palpim.
B) me konsistencë elastike.
C) të aderuara me lëkurën

D) të padhimbshëm e të fortë
E) të inflamuar
PS)D

Pyetja 126 V)2

Pneumonitë tipike:

A) prekin kryesisht fëmijët
B) karakterizohen nga një inflamacion kryesisht endoalveolar
C) karakterizohen nga një inflamacion kryesisht intersticial
D) kanë agjentë etiologjikë, kryesisht viruset e funget
E) janë bilaterale
PS)B

Pyetja 127 V)1

Insuficienca renale akute tradicionalisht:

A) ndahet në pre-renale, post-renale, renale.
B) nuk është zakonisht e ndarë, përveç rasteve kur merret në konsideratë agjenti etiologjik (toksik, iskemik etj.)
C) shumë e lehtë, e lehtë, e moderuar, e rëndë, shumë e rëndë (5 stade)
D) është primare dhe sekondare
E) nga shkaqe endogjene dhe egzogjene
PS)A

Pyetja 128 V)2

Një trajtim konsiderohet definitivisht aktiv:

A) nëse rrit mbijetesën, por nuk ul dimensionet e tumorit.
B) nëse ul dimensionet e tumorit.
C) nëse ka efekte kolaterale të limituara.
D) nëse ka efekte kolaterale të rëndësishme.
E) nëse nuk shkakton efekte anësore
PS)B

Pyetja 129 V)2

Frekuenca e infeksionit fetal si pasojë e rubeolës maternale:

A) është më e lartë nëse rubeola e maternale ndodh në trimestrin e parë të shtatzënisë.
B) është më e lartë nëse rubeola maternale ndodh në trimestrin e dytë të shtatzënisë.
C) është më e lartë nese rubeola maternale ndodh ne trimestrin e tretë të shtatzënisë
D) është me e larte ne rast re-infeksioni matern
E) është më e lartë në barrat primipare

PS)A

Pyetja 130 V)2

Cili nga këta faktorë nuk përbën rezik aterosklerotik?

A) diabeti
B) hipertensioni
C) hiperlipidemia
D) duhani
E) kalkuloza e kolecistës
PS)E

Pyetja 131 V)2

Një krizë migrenoze:

A) zakonisht fillon papritmas
B) mund të zgjasë me javë
C) shpesh paraprihet nga skotoma
D) shpesh ka skotoma periferike që avancojnë drejt qendrës
E) fillon në gjumë
PS)C

Pyetja 132 V)1

Ngarkesa post-kardiake në hipertensionin arterial është:

A) e rritur
B) e ulur
C) normale
D) e pavarur
E) e neglizhueshme
PS)A

Pyetja 133 V)2

Mjekimi i toksicitetit nga anestetikët lokalë bëhet me:

A) suxamethonium
B) ?-bllokatorë
C) vazopresorë
D) hyperventilation
E) analgjezikë
PS)C

Pyetja 134 V)3

Cili nga fenomenet e mëposhtëme është i vërtetë gjatë shtatzënisë?

A) çrregullimet në drejtim të dhjamosjes së heparit ndodhin më shumë në trimestrin e dytë.
B) nuk ka ndryshime në ashpërsinë e astmës bronkiale .
C) krizat drepanocitare ngjasin më shpesh gjatë trimestrit të parë.
D) hemoliza, rritja e enzimave hepatike dhe rënia e trombociteve (sindroma HELLP) janë një variant i toksemisë pre-eklamptike.
E) ulja e dëgjimit ndodh në fund të barrës.
PS)B

Pyetja 135 V)2

Tek një pacient me diabet insulino-vartës të kontrolluar mire, që operohet në kirurgji të planifikuar, cili pohim është i vërtetë?

A) duhet të përdoret glukozë.
B) në periudhën preoperatore bëhet vlerësimi çdo orë i urinës për glukozë .
C) ?-bllokatorët janë të kundëridikuar.
D) mund të përdoren agjentët anestetikë volatilë.
E) në ditën e interventit duhet bërë doza e plotë e insulinës në mëngjes
PS)D

Pyetja 136 V)2

Rënia e Tensionit Arterial të gjakut pas endarterektomisë karotide shkaktohet nga:

A) humbja e tonusit simpatik cervikal.
B) humbja e funksionit të kemioreceptorëve.
C) humbja e funksionit të baroreceptorëve.
D) hemoragjia.
E) dhembja.
PS)C

Pyetja 137 V)2

Në Insuficiencën Renale Akute (IRA) post-traumatike:

A) mortaliteti është 50%.
B) manitoli është i indikuar për trajtim
C) faza oligurike zgjat 10 ditë.
D) nuk mund të shkaktohet Koagulimi Intravaskular i Diseminuar (KID) .
E) ka rritje të nivelit të uresë urinare dhe nivel normal të kreatininës .
PS)B

Pyetja 138 V)3

Cili nga fenomenet nuk është i vërtetë pas transfuzionit të shpejtë të gjakut të ngrohur në 37°C?

A) ulje e PaCO2
B) ulje e toksicitetit të citrateve
C) rritje e kaliumit serik
D) ulje kalciumit serik
E) ulje e presionit të pulsit
PS)B

Pyetja 139 V)3

Koagulimi Intravaskular i Diseminuar nuk shkaktohet në:

A) karcinomën metastatike.
B) hipertensionin esencial.
C) leukeminë akute promielocitike.
D) septiceminë meningokoksike.
E) insuficiencën akute hepatike .
PS)B

Pyetja 140 V)2

Stimulimi simpatik shkakton:

A) kontraksion të vezikës biliare.
B) çlirim të glukozës nga hepari.
C) reduktim të debitit kardiak.
D) reduktim të djersitjes.
E) shtim të peristaltikës.
PS)A

Pyetja 141 V)2

Cili është trajtimi në një pacient që axhitohet dhe bëhet konfuz pas heqjes së zhgutit gjatë anestezisë intravenoze regjionale me lidokainë?

A) suxamethonium
B) diazepam
C) furosemid
D) manitol
E) fentanyl
PS)B

Pyetja 142 V)2

Status epileptikus:

A) përcaktohet si një aktivitet i vazhdueshëm për më shumë se 1 orë
B) ndodh në mungesë të një anamneze për epilepsi në 10% të rasteve
C) shkakton hipotension.
D) mekanizmi autorregullues cerebral mbahet për 30 minuta
E) diazepami është trajtimi i zgjedhur.
PS)D

Pyetja 143 V)2

Cili komplikacion nuk është tipik për laparoskopinë:

A) pneumotoraksi.
B) dhimbja e shpatullës.
C) embolia gazore.
D) aspirimi.
E) blloku i degës së majtë
PS)E

Pyetja 144 V)2

Cila nga komplikacionet mund të mos ngjasë te një i moshuar me obstruksion të zgjatur intestinal, i dehidruar dhe që respiron në ajrin e dhomës?

A) alkaloza respiratore
B) acidoza metabolike
C) hypoxaemia
D) uremia
E) anemia
PS)E

Pyetja 145 V)3

Në prani të temperaturës, takikardisë, hipotensionit, takipnesë dhe leukopenisë, mund të mendohet për:

A) sepsis nga Gram-pozitivë.
B) leptospirozë.
C) sepsis nga Gram-negativë.
D) shok hipovolemik.
E) insuficiencë kardiake .
PS)C

Pyetja 146 V)1

Në faktorët e riskut për sepsisin nuk ka rëndësi:

A) shtrimi në spital dhe kohëzgjatja e shtrimit.
B) tipi i shtrimit (terapi intensive).
C) teknikat invazive.
D) kateterët urinarë.
E) ushqyerja per os.
PS)E

Pyetja 147 V)2

Cila e dhënë nuk është karakteristike në përmbajtjen e likuorit në meningitin purulent bakterik?

A) proteinë e rritur
B) klori i rritur
C) glukozë e rritur
D) leukocitozë-neutrofile
E) eritrocite
PS)E

Pyetja 148 V)2

Cili infeksion gjatë shtatzanisë mund të shkaktojë dëme fetale?

A) varicela
B) rubeola
C) fruthi
D) skarlatina
E) herpes simplex
PS)B

Pyetja 149 V)3

Mbulesa vaksinale kundër gripit epidemik është sidomos e kështillueshme tek:

A) fëmijët mbi 1 vjeç.
B) tek të rinjtë 20-30 vjeç.
C) popullata mbi 64 vjeç.
D) fëmijët e shkollës
E) atletët
PS)C

Pyetja 150 V)2

Patogjeneza e manifestimeve kutane gjatë sëmundjeve infektive nuk lidhet me:

A) shumëzimin e patogjenit në nivel kutan
B) fenomenet imunologjike

C) lëshimin e toksinave
D) fenomenet vaskulare
E) voleminë
PS)E

Pyetja 151 V)2

Aktualisht rruga më e shpeshtë përmes së cilës merret hepatiti C është:

A) përmes transfuzionit të gjakut të infektuar
B) përmes rrugës parenterale të padukshme
C) përmes imunoglobulinave endovenoze
D) përmes përdorimit të faktorëve të koagulimit
E) përmes ushqyerjes parenterale
PS)B

Pyetja 152 V)2

Rezistenca ndaj barnave antiretrovirale:

A) provokohet nga një predispozitë gjenetike e pacientit.
B) ekziston paraprakisht në fillim të trajtimit dhe seleksionohet prej terapisë
C) është një karakteristikë e brendshme e HIV dhe seleksionohet vetëm disa muaj pas ndërprerjes së terapisë antiretrovirale.
D) zhduket kur fillohet nje terapi antiretrovirale.
E) lidhet me rezistencën ndaj antibiotikëve.
PS)B

Pyetja 153 V)3

Ekzantema variceloze i detyrohet kryesisht:

A) lokalizimit direkt të virusit në nivel kutan.
B) reaksionit imuno-mediator të bartësit.
C) efektit të toksinës së prodhuar në vendin e hyrjes së virusit.
D) hipertermisë.
E) volemisë.
PS)A

Pyetja 154 V)3

Angiomatoza bacilare është më e shpeshtë tek:

A) pacientët me imunodepresion
B) meshkujt
C) femrat
D) pacientët alergjike

E) fëmijët
PS)A

Pyetja 155 V)2

Cili është faktori më i rëndësishëm i riskut prioritar për bakthereminë/sepsisin nozokomial?

A) diabeti mellitus
B) prania e kateterit venoz qendror
C) shtrimi në kirurgji
D) prania e kateterit vezikal
E) anemia
PS)B

Pyetja 156 V)2

Cila nga sëmundjet infektive është më e shpeshtë dhe me dekurs më të rëndë tek pacientet pas splenektomisë?

A) babesioza
B) malaria
C) infeksioni pneumokoksik
D) kandidoza
E) lambliaza
PS)C

Pyetja 157 V)2

Testi pozitiv i tuberkulinës tregon për:

A) infeksion tuberkular
B) sëmundjen tuberkulare
C) sëmundje nga mykobaktere atipike
D) bashkëinfeksion nga M. tuberculosis dhe HIV
E) sëmundje kutane
PS)A

Pyetja 158 V)3

Një mashkull 45 vjeçar ankon dhimbje në regionin lumbar të majtë katër orë pas një traume kontuzive. Ekzaminimi fizik rezulton normal. Presioni arterial është 110/60 mmHg, pulsi 80/min., analiza e urinës: 5 eritrocite për fushë. Veprimi i nevojshëm i rra
A) urografia intravenoze.
B) skaneri.
C) ekografia renale.
D) shintigrafia renale.
E) observimi aktiv.

PS)C

Pyetja 159 V)3

Nuk është/janë faktor risku i vërtetuar për hepatokarcinomën:

A) hemokromatoza
B) HBV
C) HCV
D) aflatoksina
E) estroprogestativët
PS)E

Pyetja 160 V)2

Likuori cerebro - spinal përbëhet nga uji në masën:

A) 30%
B) 90%
C) 68%
D) 99%
E) 69%
PS)D

Pyetja 161 V)2

Në cilën nga situatat e mëposhtme klinike, bilirubina indirekte është më e lartë sesa direktja?

A) cirroza biliare parësore
B) kanceri i kokës së pankreasit
C) sindroma e Rotor
D) talasemia
E) kalkuloza e duktusit koledok
PS)D

Pyetja 162 V)3

Në etilizmin kronik, steatoza hepatike shkaktohet nga një grumbullim i:

A) acideve yndyrore
B) triglicerideve
C) kolesterolit të lirë
D) kolesterolit të esterifikuar
E) fosfolipideve
PS)B

Pyetja 163 V)2

Purpura ndeshet më shpesh në rastin e:

A) anemisë hemolitike autoimune
B) trombocitozës
C) koagulopatisë së fituar
D) trombocitopenisë
E) koagulopatisë së lindur
PS)D

Pyetja 164 V)2

Cili nga ngjyrimet e mëposhtme përdoret për kërkimin e bacileve alkool-acid rezistente në ekzaminimin mikroskopik të ekspektoratit:

A) Gram
B) May-Grunwald-Giemsa
C) Ziehl - Nielsen
D) Hematoksilinë - Eozinë
E) Pearls
PS)C

Pyetja 165 V)3

Sëmundja e Lyme është

A) një sëmundje e kockave
B) një variant i konektivitit sistemik
C) një formë e artritit kronik juvenil
D) një zoonozë me përfshirje sistemike shumëfazëshe.
E) një sëmundje e lindur e kolagjenit
PS)D

Pyetja 166 V)3

Paraliza e nervit rekurrent mund të shkaktohet nga:

A) limfopatia mediastinale
B) tumori i maksilës
C) aneurizma e a. subklavia
D) kanceri i gjuhës
E) cisti brakial i qafës
PS)A

Pyetja 167 V)3

Shpejtesia e një reaksioni të katalizuar nga një enzimë varet:

A) nga diferenca e entropisë mes reagentëve dhe produkteve
B) nga diferenca e entalpisë mes reagentëve dhe produkteve
C) nga konstantja e ekuilibrit
D) nga reaktiviteti i enzimës
E) nga përqendrimi i substrateve dhe aktiviteti i enzimës
PS)E

Pyetja 168 V)2

Kalcitonina shoqërohet zakonisht me cilën prej neoplazive ?

A) karcinoma e tiroides
B) karcinoma e kolonit
C) karcinoma e prostatës
D) karcinoma e pulmonit
E) tumori karcinoid
PS)A

Pyetja 169 V)2

Prania e formacioneve unazore në brendesi të eritrociteve është tregues i infeksioneve nga:

A) plasmodet
B) leishmaniat
C) trepanozomat
D) amebat
E) kriptosporidët
PS)A

Pyetja 170 V)3

Cila nga pohimet e mëposhtme nuk vlen për granulocitet neutrofile?

A) janë qeliza fagocitare
B) kanë shumë lisozome
C) kanë një bërthamë të ndarë në dy apo më shumë lobe
D) nuk kanë granula specifike
E) i kryejnë veprimet e tyre në enët e gjakut
PS)D

Pyetja 171 V)2

Çfare kuptojmë me termin 'melena'?

A) daljen rektale të feçeve me ngjyrë të zezë katran
B) daljen rektale të gjakut të kuq në fund të defekimit

C) daljen rektale të gjakut të kuq të përzier me feçet
D) daljen rektale të gjakut të kuq të shoqëruar me mukus
E) daljen e feçeve likuide me ngjyrë kafe të errët
PS)A

Pyetja 172 V)2

Cili pohim nuk është i vërtetë në lidhje me infeksionet septike nekrotizante ano-rektale?

A) pacienti me defiçite imunitare dhe virulenca e lartë bakteriale janë faktorë të rëndësishëm favorizues
B) shpesh pasojnë vonesën diagnostike të një abscesi ano-rektal.
C) indikohet trajtimi i menjëhershëm me antibiotikë me spektër të gjërë me doza të larta.
D) trajtimi i zgjedhur është terapia hiperbarike
E) shenjat klinike përfshijnë tokseminë, celulitin dhe krepitacionin indor
PS)D

Pyetja 173 V)2

Përmbajtja e ujit në organizmin e njeriut, varion nga:

A) 0 - 3%.
B) nga 1 - 4%.
C) nga 5 - 10%
D) nga 60 - 80%, në varësi të indit dhjamor të pranishëm
E) mbi 90%
PS)D

Pyetja 174 V)2

Cila nga patologjitë e mëposhtme karakterizohet nga fenomeni i Raynaud, sklerodaktilia, teleangiektazitë, nodujt e kalcifikuar dhe insuficienca renale?

A) lupusi eritematoz sistemik
B) acne rosacea
C) sklerodermia sistemike
D) amiloidoza
E) artriti reumatoid
PS)C

Pyetja 175 V)2

Cila nga alternativat nuk bën pjesë në ekzaminimet kryesore që duhen bërë gjithmonë tek një pacient, i cili vlerësohet për herë të parë për hipertension arterial?

A) të gjitha analizat biokimike
B) gjaku komplet

C) urina komplet
D) EKG, ekografi kardiake dhe renale, radiografi toraksi, fundus occuli
E) Elektroencefalogramë
PS)E

Pyetja 176 V)3

Në fazën akute të artritit reumatoid nuk indikohet:

A) terapia termale.
B) terapia me barna biologjike
C) sinoviektomia
D) terapia imunosupresive
E) terapia me antiinflamatorë jo-steroidë
PS)A

Pyetja 177 V)3

Si konsiderohet sot vitiligo?

A) një sëmundje infektive
B) një sëmundje paraneoplazike
C) një sëmundje hereditare
D) një sëmundje me patogjenezë autoimune
E) një sëmundje e enëve të gjakut
PS)D

Pyetja 178 V)2

Kur kemi dyshimin diagnostik të okluzionit intestinal, ekzaminimi i zgjedhur është

A) ekografia abdominale.
B) radiografia direkte e abdomenit.
C) skaneri.
D) laparoskopia.
E) rezonanca magnetike.
PS)B

Pyetja 179 V)2

Si përkufizohet ideja që vazhdon të persistojë, pavarësisht vullnetit të personit, që dëshiron ta eliminojë?

A) ide obsesive
B) ide prevalente
C) ide e veçantë
D) ide jo-koherente

E) ide delirante
PS)A

Pyetja 180 V)2

Terapia e hipogonadizmit parësor mashkullor kryhet me

A) gonadotropina.
B) testosteron.
C) klomifen.
D) GnRH
E) dopaminë.
PS)B

Pyetja 181 V)1

Çfarë nënkuptohet me sekretim endokrin?

A) sekretimi i hormoneve që veprojnë vetëm mbi qeliza me të njëjtën origjinë embriologjike.
B) sekretimi i hormoneve që veprojnë mbi po të njëjtin organ.
C) sekretimi i hormoneve që veprojnë në distancë
D) sekretim i hormoneve në organe kavitare
E) sekretim i polipeptideve
PS)C

Pyetja 182 V)3

Çfarë është sistemi parakrin?

A) sekretimi i hormoneve që veprojnë mbi qelizat e afërta.
B) sekretimi i hormoneve që veprojnë mbi vetë qelizat sekretuese.
C) sekretimi i hormoneve që veprojnë në distancë.
D) sekretim i hormoneve në organe kavitare
E) sekretim i polipeptideve
PS)A

Pyetja 183 V)2

Cili është ndërlikimi më i shpeshtë i radioterapisë së adenomës hipofizare?

A) hipopituitarizmi
B) hipertensioni endokranial
C) diplopia
D) hiperprolaktinemia
E) hiperkolesterolemia
PS)A

Pyetja 184 V)2

Abuzimi me steroidë anabolizues gjatë aktivitetit sportiv shkakton:

A) rritje të rezistencës muskulore.
B) avantazh në rendimentin e vrapuesve sprinter
C) avantazh në rendimentin e notuesve
D) rritje të forcës dhe të masës muskulore
E) impotencë
PS)D

Pyetja 185 V)3

FSH mbi normë është karakteristik për:

A) dëmtimin testikular sekondar.
B) format obstruktive të rrugëve gjenitale.
C) varikocelë.
D) dëmtimin testikular primar.
E) trauma të testeve
PS)D

Pyetja 186 V)2

Aktiviteti fizik:

A) frenon sekretimin e GH-ësë.
B) stimulon sekretimin e GH-ësë.
C) nuk ndikon sekretimin e GH-ësë.
D) redukton efektin e stimujve të ndryshëm mbi sekretimin e GH-ësë.
E) rrit hormonin antidiuretik.
PS)B

Pyetja 187 V)2

Enzima që konverton proinsulinën në insulinë është

A) beta-galaktozidaza
B) acid glutamik dekarboksilaza
C) karboksipeptidaza H
D) hekzokinaza
E) anihidraza karbonike
PS)C

Pyetja 188 V)3

Cili nga këta progestinikë ushtron edhe aktivitet antiandrogjenik?

A) levonorgestreli
B) ciproteron acetati
C) deksogestreli
D) testosteroni
E) dihiroepiandrosteroni
PS)B

Pyetja 189 V)2

Zgjatja e trupit favorizohet nga:

A) progesteroni.
B) testosteroni.
C) parathormoni.
D) kortizoli.
E) aldosteroni
PS)B

Pyetja 190 V)3

Cila karcinomë tiroidiene është TSH-vartëse?

A) karcinoma medulare
B) karcinoma folikulare
C) karcinoma anaplazike
D) limfoma tiroidiene
E) adenokarcinoma
PS)B

Pyetja 191 V)2

Formula me të cilën përllogaritet indeksi i masës trupore (BMI) është

A) pesha trupore në kg/gjatësinë në metra në fuqi të dytë
B) pesha trupore në kg/sipërfaqen trupore në metra katrorë
C) sipërfaqja trupore në metra katrorë/gjatësinë në centimetra
D) perimetri i belit/perimetrin e ijeve
E) perimetri i tricepsit
PS)A

Pyetja 192 V)2

Cili është prekursori biologjik i insulinës?

A) peptidi C

B) preproinsulina
C) proinsulina
D) sekretina
E) pepsina
PS)C

Pyetja 193 V)3

Cilat janë neoplazitë e MEN1 (multiple endocrine neoplasia type 1)?

A) karcinoma medulare e tiroides, feokromocitoma, adenoma hipofizare
B) adenoma paratiroidiene, karcinoma renale, feokromocitoma
C) karcinoma ovariene, karcinoma mamare, karcinoma papilare e tiroides
D) adenoma paratiroidiene, neoplazia endokrine gastrointestinale, adenoma hipofizare
E) tumore të hipofizës
PS)D

Pyetja 194 V)3

Ciproteroni (Androcur) është bar me veprim:

A) estrogjenik
B) progesteronik
C) kortikosteroid
D) androgjenik
E) antihipertensiv
PS)B

Pyetja 195 V)2

Cilat nga metodikat antropometrike të mëposhtme rekomandohet aktualisht për vlerësimin e shpërndarjes së masës dhjamore trupore?

A) indeksi i masës trupore (BMI)
B) plikometria
C) raporti bel/ije
D) kreatinina urinare
E) uremia
PS)C

Pyetja 196 V)2

Cili është shkaku i parë i infertilitetit femëror në vëndet perëndimore?

A) endometriti
B) aneksiti
C) fibromatoza uterine

D) sindroma e ovarit polikistik
E) obeziteti
PS)D

Pyetja 197 V)2

Gjatë hiperaldosteronizmit parësor, gjendja hipertensive shkaktohet nga

A) hiperreninemia.
B) hipervolemia.
C) hiperkalemia.
D) rritja e rezistencave periferike
E) retensioni hidrik
PS)E

Pyetja 198 V)2

Shkaku më i shpeshtë i tireotoksikozës gjatë shtatzënisë është

A) struma nodulare toksike.
B) morbus Basedow.
C) adenoma toksike.
D) tiroiditi toksik
E) rritja e presionit intraabdominal
PS)B

Pyetja 199 V)2

Cila është patologjia që shoqërohet më shpesh me insuficiencën ovariene premature?

A) morbus Addison
B) hipoparatiroidizmi
C) sindroma Turner
D) diabeti mellitus
E) sindromi Kavasaki
PS)C

Pyetja 200 V)2

Inhibina B

A) prodhohet nga qelizat beta të pankreasit.
B) inhibon insulinën.
C) inhibon FSH
D) inhibon PRL
E) inhibon testosteronin
PS)C

Pyetja 201 V)2

Receptorët e angiotenzinës II ndodhen në

A) membranat qelizore.
B) citoplazmë.
C) bërthamë.
D) citoplazmë dhe në bërthamë.
E) mitokondri.
PS)A

Pyetja 202 V)2

Cila është shenjë apo simptomë e anoreksisë nervore?

A) poliuria dhe nikturia
B) hipertensioni arterial
C) amenorrea
D) hipertermia
E) bulimia
PS)C

Pyetja 203 V)2

Glicemia 220 mg/dl, 2 orë pas ngarkesës orale me glukozë, sugjeron :

A) metabolizëm normal të karbohidrateve.
B) tolerancë të dëmtuar ndaj karbohidrateve.
C) diabet mellitus.
D) diabet latent.
E) diabet insipid.
PS)C

Pyetja 204 V)2

Gjatë menopauzës është i rritur:

A) estrogjeni.
B) FSH
C) progesteroni
D) prolaktina
E) TSH
PS)B

Pyetja 205 V)3

Cila nga këto substanca ndikon në sekretimin e GH endogjen?

A) kreatina
B) arginina
C) propanololi
D) glukoza
E) valsartani
PS)B

Pyetja 206 V)2

Cili është përkufizimi i saktë për 'koloidin'?

A) Koloidi është forma e magazinimit të jodit dhe është i pranishëm në intersticiumin ndërmjet folikujve tiroidiene.
B) Koloidi është produkti i sekretimit të qelizave parafolikulare.
C) Kolodi është forma e magazinimit të tireoglobulinës në lumenin e folikulit tiroidien.
D) Koloidi është eksudat i arterieve tiroidiene.
E) Koloidi është substancë "ngjitëse" të qelizave
PS)C

Pyetja 207 V)1

Ndërmjet estrogjenëve ovarialë, më aktivi është:

A) estradioli
B) estroni
C) estrioli
D) prolaktina
E) fosfofruktokinaza
PS)A

Pyetja 208 V)2

Cila substancë ka strukturë të ngjashme me insulinën?

A) PRL
B) GH
C) Estradioli
D) Somatomedina
E) TSH
PS)D

Pyetja 209 V)3

Cila vlerë e FSH konsiderohet patognomonike për insuficiencën ovariale premature?

A) >10 UI/l
B) >20 UI/l
C) >30 UI/l
D) >40 UI/l
E) <40 UI/l
PS)D

Pyetja 210 V)2

Ndaj cilit kancer të aparatit urogjenital është më i prirur një mashkull obez?

A) Karcinomë e vezikulave seminale
B) Karcinomë e prostatës
C) Karcinomë e testikulit
D) Karcinomë e vezikës
E) Karcinoma e veshkës
PS)B

Pyetja 211 V)2

"Glukotoksiciteti" që shoqëron ekspozimin kronik ndaj hiperglicemisë shkakton:

A) rritje të përgjigjes pankreatike ndaj stimujve sekretues
B) reduktim të përgjigjes pankreatike ndaj stimujve sekretues
C) rritje të sensibilitetit periferik ndaj insulinës
D) intolerancë ndaj glukozës
E) ulje të sensibilitetit periferik ndaj insulinës
PS)B

Pyetja 212 V)2

Cila nga këto proteina konsiderohet si proteinë e fazës akute të sëmundjeve kritike dhe si rrjedhojë i rritet sinteza gjatë këtyre patologjive?

A) albumina
B) fibronektina
C) transferrina
D) proteina C-reaktive
E) ferritina
PS)D

Pyetja 213 V)2

Cila shenjë klinike mungon gjatë hiposurenalizmit sekondar?

A) astenia
B) hipotensioni

C) anoreksia
D) hiperpigmentimi kutan
E) edema
PS)D

Pyetja 214 V)1

Cila nga të mëposhtmet ka strukturë të ngjashme me kolesterolin?

A) ACTH
B) T4
C) vitamina D
D) prostaglandinat
E) TSH
PS)C

Pyetja 215 V)1

Rritja e nivelit të progesteronit gjatë fazës luteale të ciklit tregon

A) ovulacionin.
B) ciklin anovulator.
C) insuficiencën hipotalamo-hipofizare.
D) gravidancën e sigurtë
E) barrë ekstrauterine
PS)A

Pyetja 216 V)2

Çfarë janë bifosfatet?

A) substanca të pasura me fosfate që indikohen në osteomalaci
B) analogë të pirofosfatit inorganik, në të cilat atomi i oksigjenit zëvendësohet nga një atom karboni
C) analogë të monofluorofosfatit
D) derivate të acidit fosforik
E) hormone
PS)B

Pyetja 217 V)1

Efekti kryesor i kortizolit është stimulimi i:

A) aktivitetit seksual.
B) neoglukogjenezës.
C) hipoglicemisë.
D) veprimit insulinik

E) prolaktinës
PS)B

Pyetja 218 V)2

Cila nga të mëposhtmet stimulon sekretimin e GH?

A) arginina
B) L-dopa
C) hipoglicemia insulinike
D) GHRH
E) TSH
PS)D

Pyetja 219 V)2

Çfarë efekti ushtron testosteroni mbi riabsorbimin kockor dhe mineralizimin?

A) asnjë efekt
B) rrit riabsorbimin kockor dhe inhibon mineralizimin.
C) redukton riabsorbimin kockor dhe stimulon mineralizimin.
D) rrit vetëm riabsorbimin kockor pa ndikuar mbi mineralizimin.
E) ul aktivitetin e osteoblasteve.
PS)C

Pyetja 220 V)3

Në sindromën Morris, nivelet e testosteronit janë:

A) normale te një mashkull i rritur.
B) të reduktuara te një mashkull i rritur.
C) në nivel prepuberteti.
D) të barabartë me nivelet e testosteronit te femrat.
E) të larta.
PS)A

Pyetja 221 V)3

Në rast terapie me antiandrogjenë, tek një femër në moshë riprodhuese:

A) nuk është e nevojshme që të merren masa paraprake.
B) është e nevojshme që medikamentet të jepen në fazën e dytë të ciklit.
C) është e nevojshme dhënia e medikamenteve antikoncepsion
D) është e nevojshme që medikamentet të jepen vetëm gjatë fazës menstruale
E) duhet të përdorim antikoagulantët
PS)C

Pyetja 222 V)2

Pasoja më e shpeshtë e tiroiditit Hashimoto është:

A) shërimi pa pasoja
B) hipertiroidizmi i herëpashershëm
C) hipotiroidizmi
D) kisti tiroidien
E) tumoret
PS)C

Pyetja 223 V)1

Peptidi C

A) prodhohet nga degradimi i glukagonit.
B) është fragment i molekulës origjinale nga e cila formohet insulina
C) sekretohet nga qelizat alfa të pankreasit
D) është inhibitor i fuqishëm i sekretimit të insulinës
E) sekretohet nga qelizat delta të pankreasit
PS)B

Pyetja 224 V)2

Cila nga këto alterime respiratore vërehet më shpesh në provat funksionale tek pacientët obezë që nuk shfaqin episode apneje gjatë gjumit?

A) deficiti i tipit restriktiv
B) deficiti i tipit obstruktiv
C) deficiti i tipit miks
D) hiperventilimi
E) hipoventilimi
PS)A

Pyetja 225 V)3

Gjatë hiperaldosteronizmit primar vërehet:

A) rritje e aldosteronit dhe reninës
B) rritje e aldosteronit dhe reduktim i reninës
C) reduktimi i aldosteronit dhe i reninës
D) reduktim i aldosteronit dhe rritje e reninës
E) hiperkalemia
PS)B

Pyetja 226 V)3

Çfarë janë SERM (Selective estrogen receptor modulators)?

A) Grup tumoresh neuroendokrine.
B) Faktorë të rritjes që prodhohen nga fibroblastet.
C) Inhibitorë të sintezës së reninës.
D) Klasë e re medikamentesh që modulojnë receptorët estrogjenikë.
E) Hormone
PS)D

Pyetja 227 V)2

Cila janë efektet anësore kryesore të insulinës te një person i shëndetshëm?

A) krizat hipoglicemike
B) dëmtimet cerebrale nga neuroglukopenia
C) A dhe B
D) rritja e aktivitetit fizik
E) Rritje e libidos
PS)C

Pyetja 228 V)2

Sindroma endokrine paraneoplazike është:

A) sindromë endokrine që shfaqet tek një pacient i prekur nga një tumor jo endokrin
B) sindromë endokrine e shkaktuar nga hipersekretimi hormonal nga një tumor endokrin
C) sindromë endokrine e shkaktuar nga sekretimi i hormoneve ose e substancave të ngjashme me hormonet nga një tumor jo endokrin.
D) sindromë e insuficiencës hormonale e shkaktuar nga shkatërrimi i një gjëndre endokrine nga një tumor joendokrin
E) shfaqje e uljes së imunitetit
PS)C

Pyetja 229 V)2

Në rast hipotiroidizmi dhe hiposurenalizmi sekondar të njëkohshëm, terapia zëvendësuese me hormone tiroidiene

A) fillohet përapara fillimit të terapisë me glukokortikoide.
B) fillohet pas fillimit të terapisë me glukokortikoide.
C) fillohet menjëherë me doza të larta.
D) nuk fillohet kurrë.
E) fillohet pas dy javësh.
PS)B

Pyetja 230 V)1

Cili nga këta aminoacide është aminoacid esencial?

A) arginina
B) leucina
C) izoleucina
D) valina
E) triptofani
PS)A

Pyetja 231 V)2

Cila karcinomë është neoplazi malinje e tiroides me ecuri invazive shumë të shpejtë?

A) karcinoma anaplazike
B) karcinoma folikulare
C) karcinoma papilare
D) karcinoma medulare
E) adenokarcinoma
PS)A

Pyetja 232 V)2

Cila terapi mund të propozohet në ditët e sotme për hiperkolesteroleminë familjare homozigotë?

A) LDL-afereza
B) fibratet në doza të larta
C) statinat në doza të larta
D) hemodializa
E) transplanti zemër-hepar
PS)A

Pyetja 233 V)2

Cila është shenja e lidhur më shumë me diagnozën e bronkitit kronik?

A) kolla e thatë
B) dispneja në sforcim
C) kolla produktive
D) dispneja në qetësi
E) apneja
PS)C

Pyetja 234 V)1

Renina:

A) përcakton transformimin e angiotensinogjenit në angiotensinë I.
B) përcakton transformimin e angiotensinës II në angiotensinë III.
C) prodhohet në nivel pulmonar.
D) aktivizohet në nivel hepatik.
E) prodhohet në shpretkë.
PS)A

Pyetja 235 V)2

Në cilin vend Neisseria gonorrheae, nuk formon koloni?

A) uretra
B) kanali cervikal
C) rektumi
D) konjuktiva
E) cavum nasi
PS)E

Pyetja 236 V)2

Cili prej këtyre ekzaminimeve arrin të përcaktojë nëse një lezion që prek një organ parenkimatoz ka përbërje të lëngshme apo është solid?

A) radiografia
B) shintigrafia
C) termografia
D) ekografia
E) limfografia
PS)D

Pyetja 237 V)2

Në prani të një opaciteti pulmonar në një subjekt 40 vjeçar është e nevojshme:

A) të fillohet një cikël terapie me antibiotikë.
B) të ndërhyhet sa më shpejt me kirurgji.
C) të fillohet një cikël kimioterapie antituberkulare.
D) të sqarohet diagnoza përpara fillimit të terapisë.
E) të trajtohet me antiinflamatorë jo-steroidë.
PS)D

Pyetja 238 V)3

Insuficienca renale akute obstruktive:

A) mund të verifikohet edhe nëse obstruksioni ureteral është monolateral

B) verifikohet vetëm nëse obstruksioni ureteral është bilateral ose nëse është prezent vetëm një veshkë funksionale
C) ka si shkak më të shpeshtë karcinomën bilaterale te ureterëve
D) mund të zgjidhet gjithmonë me kateterizimin vezikal
E) kërkon gjithnjë ndërhyrje urgjente kirurgjikale
PS)B

Pyetja 239 V)2

Cili nga faktorët e mëposhtëm përcakton rritjen e kuotës së filtrimit glomerular?

A) rritja e presionit onkotik të plazmës
B) rritja e presionit hidrostatik në kapsulën e Bowman
C) rritja e presionit hidrostatik në kapilarët glomerulare
D) vasokonstriksioni i arteriolave aferente
E) rënia e presionit arterial
PS)C

Pyetja 240 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtme është korrekt për dermatomiozitin?

A) është një prekje inflamatore e sistemit nervor
B) është një neoplazi kutane
C) mund të jetë një sindrom paraneoplazik
D) është një sëmundje infektive
E) është një sëmundje endokrine
PS)C

Pyetja 241 V)2

Në acinusin pulmonar, barriera ajër-gjak anatomikisht nuk përfaqësohet nga:

A) surfaktanti.
B) epiteli alveolar.
C) membrana bazale.
D) qelizat endoteliale.
E) bronkiolat respiratore.
PS)E

Pyetja 242 V)2

Diabeti mellitus i tipit I:

A) i detyrohet pjesërisht sekretimit difektoz të insulinës dhe pjesërisht rezistencës periferike të reduktuar.
B) i detyrohet rezistencës së rritur periferike ndaj veprimit të insulinës.

C) shkaktohet nga shkatërrimi i insulave në kuadër të një dëmtimi parenkimal
D) shkaktohet nga një defekt i përthithjes së glukozës
E) shoqëron kancerin e pankreasit
PS)C

Pyetja 243 V)3

Cili është komplikacioni më i rëndë i infeksionit nga virusi i varicella-zoster?

A) miokarditi dhe perikarditi
B) pankreatiti
C) meningoencefaliti
D) iridocikliti
E) gastriti
PS)C

Pyetja 244 V)2

Klirensi i kreatininës është tregues i:

A) peshës specifike urinare
B) fluksit plazmatik renal
C) filtrimit glomerular
D) Ph-it urinar
E) debitit urinar
PS)C

Pyetja 245 V)2

Për të bërë diagnozën diferenciale midis cistit renal dhe hipernefromës, rruga më e dobishme është:

A) dozimi i reninës-aldosteronit.
B) ekzaminimi i urinës.
C) arteriografia renale.
D) dozimi i titrit të CEA
E) cistografia.
PS)C

Pyetja 246 V)2

Cilat janë shenjat dhe/ose simptomat kryesore të preeklampsisë?

A) hipertension dhe skotoma
B) hipertension dhe cianozë
C) hipertension, cefale, konvulsione
D) hipertension dhe proteinuri

E) hipotension dhe anemi
PS)D

Pyetja 247 V)1

Sindromi nefrotik, insuficienca kardiake kongjestive, cirroza hepatike

A) janë të gjitha të karakterizuara nga prezenca e edemës dhe për këtë arsye të përkufizuara edhe si sindroma edemigjene
B) kanë gjithmonë të njëjtën etiopatogjenezë
C) janë të trajtueshme me sukses vetëm me medikamente antiviralë
D) nuk i interesojnë specialistit nefrolog
E) trajtohen vetëm nga mjekët kardiologë
PS)A

Pyetja 248 V)2

Cili është roli fiziologjik esencial i tonsilave palatine?

A) hemopoetik
B) imunitar
C) filtrues
D) nuk kanë rol esencial
E) endokrin
PS)B

Pyetja 249 V)2

Nuk bën pjesë në faktorët përgjegjes për rritjen e presionit arterial pulmonar tek pacientët me pneumopati obstruktive kronike?

A) shkatërrimi parcial i shtratit kapilar pulmonar
B) vasokonstriksioni hipoksik në zona me raport të ulët ventilim/perfuzion
C) policitemia
D) hipertrofia e muskulaturës së lëmuar të arteriolave pulmonare
E) bronkodilatacioni
PS)E

Pyetja 250 V)1

Sistemi i konduktor i zemrës nuk përbehet nga:

A) nyja sinusale (Keith&Flack)
B) junksioni atrio-ventrikular (Tawara-Aschoff)
C) fascikuli i His-it
D) fibrat atriale internodale
E) aurikula

PS)E

Pyetja 251 V)1

Aftësia e mikroorganizmave për të shkaktuar një dëm tek mbartësi varet nga:

A) invaziviteti
B) patogjeniciteti
C) kontagioziteti
D) infektiviteti
E) ngjyrimi sipas Gram-it
PS)B

Pyetja 252 V)2

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme është e pranishme ekzoftalmia?

A) seminoma
B) sindromi Cushing
C) hipotiroidizmi
D) osteopatia fibrocistike
E) morbus Bazedow
PS)E

Pyetja 253 V)2

Cila nga situatat e mëposhtme nuk është e lidhur me një propabilitet të rritur për hemorragji post-partum?

A) lindja e gjatë
B) lindja e shpejtë
C) stimulimi i lindjes me oksitoksinë
D) shtatzëni binjakësh
E) fillimi i parakohshëm i aktivitetit të lindjes
PS)E

Pyetja 254 V)1

Paraliza e gjysmës së trupit, e majtë apo e djathtë quhet:

A) hemiplegji.
B) paraplegji.
C) tetraplegji.
D) diplegji.
E) vazoplegji.
PS)A

Pyetja 255 V)2

Cilindrat në sedimentin urinar tregojnë:

A) tubulopati kongjenitale.
B) rritje të sekretimit të proteinës Tamm-Horsfall.
C) tumor renal.
D) nefropati primare apo sekondare.
E) kancer të veshkës.
PS)D

Pyetja 256 V)2

Cili prej pohimeve të mëposhtme për apendisitin nuk është i vërtetë?

A) simptomatologjia mund të mos jetë shumë e qartë
B) format retrocecale shoqërohen në përgjithësi me dhimbje gjatë fleksionit të kofshës
C) diagnoza mund të vendoset me ekografi
D) pozicionimi anormal i apendiksit të inflamuar mund të shkaktojë mbylljen e ureterit
E) shoqërohet në të gjitha rastet me absces të muskulit ilio-psoas
PS)E

Pyetja 257 V)3

Cili është trajtimi i përzgjedhur në kancerin pulmonar me qeliza të vogla në stadin IV?

A) kirurgjia
B) kemioterapia
C) radioterapia
D) imunoterapia
E) brakiterapia
PS)B

Pyetja 258 V)1

Rakitizmi shkaktohet:

A) nga mungesa e vitaminës D
B) nga mungesa e vitaminës E
C) nga deficiti i kalcitoninës
D) nga mungesa e vitaminës A
E) nga mungesa e vitaminës K
PS)A

Pyetja 259 V)2

Nuk është shkak që mund të çojë në pamjaftueshmëri të acidit folik:

A) alkolizmi
B) cirroza hepatike
C) limfoma intestinale
D) kontraceptivët oralë
E) hipertensioni arterial
PS)E

Pyetja 260 V)2

Cili nga pohimet është i vërtetë për pankreatitin akut me koleksione nekrotike të infektuara?

A) ka prognozë identike me pankreatitin akut edematoz
B) nuk ka nevojë për trajtim me ndërhyrje kirurgjikale
C) përfaqëson një indikacion për trajtim vetëm me inhibitorë të proteazës
D) shërohet me nutricion normal
E) kërkon drenim kirurgjik të koleksioneve të infektuara
PS)E

Pyetja 261 V)2

Dy helikat e ADN mbahen bashkë nga:

A) lidhje hidrogjeni
B) lidhje kovalente
C) forcat e Van der Waals
D) ndërveprime hidrofobike
E) ndërveprime hidrofilike
PS)A

Pyetja 262 V)3

Një frakturë patologjike diafizare e femurit te një i rritur është më shpesh pasojë e:

A) tumorit kockor primar
B) osteomielitit kronik
C) lesionit metastatik
D) osteogjenezës jo perfekte
E) osteoporozës
PS)C

Pyetja 263 V)2

Sindromi nefrotik nuk karakterizohet nga:

A) prania e edemave periferike
B) hipoalbuminemia e rëndë

C) dislipidemia
D) proteinuria më e madhe se 3g/ditë
E) poliglobulia
PS)E

Pyetja 264 V)1

Me 'klirens' kuptojmë:

A) transportin maksimal të një substance në një organ
B) transportin mesatar të një substance në një organ
C) volumin e gjakut të pastruar nga një substance e administruar, në njësinë e kohës
D) fluksin plazmatik të një organi
E) transportin aktiv përmes membranave biologjike
PS)C

Pyetja 265 V)2

Në një pacient të prekur nga cirroza hepatike, cili nga komplikacionet e mëposhtëm është më i shpeshtë?

A) infeksion pulmonar
B) infeksion urinar
C) peritonit bakterial spontan
D) karcinomë prostatike
E) sindroma hepato-renale
PS)C

Pyetja 266 V)3

Cilit medikament do ti referohemi në terapinë mbajtëse të karcinomës së rektumit?

A) 5- fluorouracil
B) metotreksat
C) irinotekan
D) oksaliplatin
E) pancuronium
PS)A

Pyetja 267 V)2

Gjatë cilës fazë të ciklit kardiak është pranishëm fluksi koronar?

A) në fazën proto-mezosistolike
B) gjatë gjithë zgjatjes së sistolës
C) gjatë gjithë zgjatjes së diastolës
D) në fazën telediastolike

E) në sistol
PS)C

Pyetja 268 V)1

Sela turcika:

A) mban hipofizën.
B) gjendet në pjesën e përparme të kiazmës optike.
C) është e kthyer përkundrejt fosave nazale.
D) përmban qelizat etmoidale posteriore.
E) përbëhet nga ind lidhor.
PS)A

Pyetja 269 V)2

Shenja e akullit është karakteristike:

A) e pulmonitit
B) e abceseve të ekinokokut
C) e versamenteve peritoneale
D) e arteriopative periferike
E) e tumoreve renale
PS)C

Pyetja 270 V)2

Në insufiçencen kardiake ulja e debitit kardiak:

A) intereson të gjitha zonat e trupit në mënyrë të barabartë
B) është më e madhe në mëlçi dhe në veshka
C) është më e madhe në zonat muskulo-kutane dhe shpretkë
D) është më e madhe në zonën e trurit, zemrës dhe veshkës
E) është më e madhe në pulmone
PS)C

Pyetja 271 V)1

Mekanizmi patogjenik përgjegjës për sëmundjen e Bazedovit është i natyrës:

A) infektive
B) neoplazike
C) autoimune
D) traumatike
E) jatrogjenike
PS)C

Pyetja 272 V)2

Cila nga simptomat e mëposhtme nuk paraqet një nga simptomat tipike të karcinomës së rektumit?

A) dhembje hiperperistaltike ne FID (fossa iliake djathtë)
B) prania e anemisë
C) tenezma
D) mukorrea e mëngjesit
E) konstipacion në rritje
PS)A

Pyetja 273 V)2

Në fushën cerebro-vaskulare, egzaminimi i likidit mund të paraqesë mbështetje të dobishme për diagnozën:

A) në trombozën e enëve bazilare
B) në hemorraginë subaraknoide
C) në disekacionin të karotides ose vertebraleve
D) në meningitis
E) në vasculitis
PS)B

Pyetja 274 V)2

Kariotipi i plotë i molës hidatiforme është:

A) 46, XY
B) 45, XO
C) 46, XX
D) 69, XXX
E) 45, XX
PS)C

Pyetja 275 V)3

Tek një i porsalindur që nuk jep shenja jete, ku e kërkojmë pulsin?

A) në nivel të arteries temporale
B) në nivel të arteries brakiale
C) në nivel të radiales
D) në nivel të arteries pedidike
E) në nivel të arteries karotide
PS)B

Pyetja 276 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me intervalin P-R të ECG-së është e saktë?

A) ndryshon në varësi nga pozicioni i elektrodave
B) nuk ka sinjifikancë fiziologjike
C) ka lidhje me kohën e përçueshmërisë në nyjen atrio-ventrikulare
D) zgjat në përgjithësi 0,25 sekonda
E) ka lidhje me kohën e përçueshmërisë në tufën e Hisit
PS)C

Pyetja 277 V)3

Cili tip i oftalmoplegjisë shkaktohet nga një polineuropati akute e nervave kranialë?

A) bilateral
B) unilateral
C) internuklear
D) unilateral i pjesshëm
E) internuklear i pjesshëm
PS)A

Pyetja 278 V)2

Bëhet fjalë për hipokalemi kur kaliumi është:

A) < 0 mEQ/L (ose mmol/L).
B) < 3,5 mEQ/L.
C) > 6 mEQ/L.
D) 3,5-4,5 mEQ/L.
E) 4,5-6 mEQ/L.
PS)B

Pyetja 279 V)2

Përkufizohet si hernie e brendshme:

A) keqvendosje anormale e omentumit në hapësirat natyrale apo të riformuara në kavitetetin peritoneal.
B) keqvendosje anormale e një ose më shumë organeve të brendshme apo të riformuara në kavitetin peritoneal
C) prezenca e hernies në stadin absolutisht fillestar
D) prezenca e laparocelës në stadin absolutisht fillestar
E) torsion i omentumit
PS)B

Pyetja 280 V)2

Vlera fiziologjike e përqëndrimit plazmatik të kalçiumit total është

A) 8.9-10.4 mg/dl.
B) 2.2-2.6 mg/dl.
C) 8.9-10.4 mmol/l.
D) 4.2-4.6 mmol/l.
E) 2,6-8,9 mg/dl.
PS)A

Pyetja 281 V)3

Në krahasim me të rriturit, hiperplazia e indit limfatik në përgjigje të një infeksioni tek fëmijët është:

A) më e shprehur
B) më pak e shprehur
C) me të njëjtin intensitet, por e vonuar
D) me të njëjtin intensitet, por i rastit
E) bifazike
PS)A

Pyetja 282 V)2

Cili nga faktorët e mëposhtëm duket të jetë qartësisht përgjegjës i mezoteliomës malinje?

A) duhanpirja
B) azbesti
C) benzeni
D) ndotja atmosferike
E) pleuritet kronike
PS)B

Pyetja 283 V)2

Ikteri nga dëmtimet e rrugëve biliare intra dhe ekstrahepatike është ai që vjen nga:

A) hemoliza e shprehur
B) defiçiti i uridindifosfoglukuroniltransferaza
C) inaktivizimi i proteinave transportuese Y dhe Z
D) kolestaza
E) kolecistiti
PS)D

Pyetja 284 V)2

Tingujt mund të arrijnë në organin e Cortit (të dëgjimit) nëpërmjet:

A) vetëm rrugës ajrore
B) vetëm rrugës kockore
C) rrugës ajrore dhe rrugës kockore
D) stimulimit me anë të prekjes
E) veshit të jashtëm
PS)C

Pyetja 285 V)3

Vendi primar i thithjes së folateve është:

A) ileumi fundor
B) jejunumi proksimal
C) stomaku
D) të dyja (B+C)
E) duodeni
PS)B

Pyetja 286 V)2

Lokalizimi më i shpeshtë i endometriozës është:

A) sipërfaqja peritoneale e zorrës së hollë.
B) omentumi
C) apendiksi
D) vezika
E) peritoneumi i Cavum Douglas
PS)E

Pyetja 287 V)3

Organizimi aktual i asistencës pediatrike bazohet mbi:

A) pavionin spitalor
B) strukturat komunitare
C) njësitë operative me shumë drejtues
D) ambulatorit
E) mjekun e familjes
PS)C

Pyetja 288 V)2

Çrregullimet e personalitetit:

A) janë çrregullime me dëmtime të theksuara të sjelljes(ose komportamentit)
B) janë kodifikuar mbi aksin II të ICD-10
C) janë çrregullime të fushës psikotike

D) janë gjithmonë të shoqëruara nga çrregullimet e perceptimit
E) janë gjithmonë të shoqëruara nga keqformime të lindura
PS)A

Pyetja 289 V)3

Çfarë është cistouretrogafia miksionale?

A) studimi morfologjik i vezikës dhe uretrës
B) studimi morfofunksional i vezikës dhe uretrës
C) rregjistrimi i presionit vezikal dhe uretral gjatë urinimit
D) studimi i kapacitetit vezikal maksimal para urinimit
E) regjistrimi i urinës reziduale
PS)B

Pyetja 290 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme në lidhje me njësitë motore është e vërtetë?

A) janë sinonime të pllakave motorike
B) janë grup i një motoneuroni dhe fibrave muskulare inervuar prej tij
C) janë grup i një fije të muskujve dhe nervave që vijnë me të
D) janë grup i muskujve dhe nervave te cilët paraqiten me të
E) janë pa mielinë
PS)B

Pyetja 291 V)2

Rritja e bilirubinemisë indirekte është karakteristike:

A) e leukozës mieloide kronike.
B) e anemisë nga mungesa e hekurit.
C) e anemisë hemolitike.
D) e limfomave limfocitike.
E) e kolestazës.
PS)C

Pyetja 292 V)1

Terapia antiagregante është e indikuar:

A) në parandalimin sekondar të ishemisë cerebrale
B) në hemorragjinë subaraknoidale
C) në të gjithë subjektet mbi 50 vjeç edhe në mungesë të faktorëve të riskut vaskular
D) në parandalimin sekondar të hemorragjisë cerebrale intraparenkimale
E) në tromboembolinë pulmonare
PS)A

Pyetja 293 V)3

Limfomat jo-Hodgkiniane të lidhura dhe me SIDA-n janë:

A) kryesisht linfogjëndrore.
B) kryesisht jashtëlinfogjëndrore
C) kryesisht hepatike
D) kryesisht splenike
E) kryesisht hepatike dhe splenike
PS)B

Pyetja 294 V)3

Hemianopsia bitemporale vihet re në:

A) në pienalomë
B) në kraniofaringeomë
C) në aneurizmin e arteries komunikante posteriore
D) në glomën e nervit optik
E) në aterosklerozë
PS)B

Pyetja 295 V)2

Proteinuria nga sforcimi:

A) nuk egziston
B) është e lehtë dhe vjen pas një sforcimi fizik të fortë
C) i paraprin gjithmonë zhvillimit të limfomës Hodgkin
D) është markuesi tipik i melanomës
E) lidhet me nivelin plazmatik të proteinave
PS)B

Pyetja 296 V)1

Cili është markuesi tumoral më indikues për karcinomën e prostatës?

A) AFP
B) MCA
C) CA 125
D) PSA
E) CEA
PS)D

Pyetja 297 V)2

Cili hormon i hipofizës së përparme frenohet nga somatostatina?

A) ACTH
B) PRL
C) GH
D) FSH
E) LH
PS)C

Pyetja 298 V)2

Egzaminimet në plan të parë për diagnozën e karcinomës së prostatës janë:

A) PSA, eksploracioni rektal, ekografia transrektale + biopsia.
B) PSA, shintigrafia e kockës, skaneri abdominal.
C) PSA, eksplorimi rektal, skaneri abdominal.
D) PSA, eksplorimi rektal
E) vetëm PSA.
PS)D

Pyetja 299 V)2

Tuberkulozi pulmonar transmetohet kryesisht:

A) prej ajrit nëpërmjet spërklave të ekspektoratit
B) nëpërmjet objekteve që vijnë në kontakt me subjektet e infektuara
C) nëpërmjet ushqimeve dhe pijeve
D) prej mikobaktereve të pranishme në ambient
E) jatrogjenike
PS)A

Pyetja 300 V)2

Është shenja më karakteristikë e karcinomës së ezofagut:

A) disfagia progresive (ose e përparuar)
B) prevalenca e adenokarcinomës
C) prevalenza në seksin femër
D) lokalizimi në një të tretën e sipërme
E) rënia në peshë
PS)A

Pyetja 301 V)3

Në sindromin e tunelit karpal:

A) gjejmë një vonesë vetëm në përçimin motor të nervit median nën dorë

B) gjejmë një vonesë nën dorë të përçimit motor dhe sensitiv të nervit median
C) të dyja sekset preken pothuajse në mënyrë të barabartë
D) është raportuar shoqërimi me miksedemën, artritin, amiloidozën dhe gutën, por jo me akromegalinë
E) shoqërohet me keqformime të lindura
PS)B

Pyetja 302 V)2

Diametri më i vogël anteroposterior i shtratit pelvik quhet:

A) diametri interspinal
B) konjugata vera
C) konjugata diagonale
D) konjugata obstetrike
E) diametri dalës
PS)D

Pyetja 303 V)1

Natremia është:

A) përqëndrimi në feçe i natriumit.
B) përqëndrimi i natriumit në likuorin cerebrospinal
C) përqëndrimi i natriumit në likidin pleural
D) përqëndrimi plazmatik i natriumit
E) përqëndrimi urinar i natriumit
PS)D

Pyetja 304 V)2

Dukti arterial i Botalit në jetën fetale shërben për të:

A) shkurtuar qarkullimin pulmonar
B) shkëmbyer gjakun midis gjymtyrëve
C) mos marrë pjesë mëlçia në zhvillimin e fetusit
D) parandaluar koarktacionin
E) ulur shuntin
PS)A

Pyetja 305 V)2

Trajtimi kimioterapeutik antiblastik me bleomicin në doza të rritura mund të shkaktojë:

A) edemën pulmonare
B) fibrozën pulmonare
C) pleuritin fibrinoz

D) fibrozën cistike
E) emfizemën pulmonare
PS)B

Pyetja 306 V)2

Cila nga masat e mëposhtme nuk përbën një profilaksi specifike?

A) sterilizimi, dezinfektimi, dizinfestimi (kontrolli i insekteve)
B) administrimi i vaksinave
C) administrimi i imunoglobulinave
D) kemioprofilaksia
E) skema kombëtare e vaksinimit
PS)A

Pyetja 307 V)2

Cila nga thëniet e mëposhtme mbi një karakter dominant të lidhur me autozomet tek njeriu është e saktë?

A) karakteri manifestohet në të dyja sekset me frekuencë të barabartë
B) vetëm femrat e transmetojnë karakterin
C) meshkujt e transmetojnë karakterin vetëm tek vajzat
D) vetëm meshkujt manifestojnë karakter
E) vetëm femrat manifestojnë karakter
PS)A

Pyetja 308 V)1

Frekuenca normale sinusale është e përfshirë midis:

A) 60-100 bpm
B) 30-80 bpm
C) 50-130 bpm
D) 30-40 bpm
E) 40-60 bpm
PS)A

Pyetja 309 V)1

Receptorët alfa-adrenergjik stimulohen nga:

A) vetëm adrenalina.
B) vetëm noradrenalina.
C) adrenalina dhe noradrenalina.
D) histamina
E) johimbina

PS)C

Pyetja 310 V)3

Një delir i pajisur me një organizim të fortë të brendshëm përcaktohet si:

A) i sistematizuar.
B) luçid (i kthjellët).
C) paranoid.
D) sekondar
E) primar
PS)A

Pyetja 311 V)2

Pjesa kortikale e mbiveshkores nga ana histologjike është e organizuar në shtresa të përcaktuara si:

A) glomerulare, fashikolare, retikulare.
B) glomerulare, intersticiale, medulare.
C) glomerulare, retikulare, fashikolare.
D) në asnjë nga mënyrat e mësipërme
E) nuk egzistojnë stadifikime
PS)A

Pyetja 312 V)2

Hematuria nuk mund të takohet në:

A) litiazën renale
B) glomerulonefritin
C) cistitin
D) trombozën e venës renale
E) kolecistitin
PS)E

Pyetja 313 V)2

Shkaqe të neutropenisë nuk mund të jenë:

A) anomali kongjenitale (sindromi Kostmann)
B) dëmtimi medular (p.sh nga medikamente)
C) kequshqyerja, malabsorbimi
D) neutropenia ciklike
E) hemorragjitë akute
PS)E

Pyetja 314 V)3

Një gjendje hipoksie e rëndë nuk mund të provokojë:

A) takikardi
B) laktacidemi
C) hemorragji retinale
D) turbullim te funksioneve superiore
E) alkalozë metabolike
PS)E

Pyetja 315 V)2

Faktorë risku për carcinomen mamare postmenopauzale janë:

A) duhanpirja
B) obeziteti
C) shtati i shkurtër
D) poliuria
E) rënia e flokëve
PS)B

Pyetja 316 V)2

Në sëmundjen Wilson (degjenerim hepatolentikular rritet):

A) bakri në plazëm
B) përqëndrimi i ceruloplazminës në plazem
C) ekskretimi urinar i zinkut
D) kalciemia
E) potasiemia
PS)A

Pyetja 317 V)2

Scaleniusi është:

A) ligamenti mbajtes i lienit
B) llozha splenike
C) një muskul i qafës
D) vena lienale
E) muskul i parakrahut
PS)C

Pyetja 318 V)2

Sekrecioni i kortizolit dhe androgenëve kontrollohet nga:

A) CRH/ACTH
B) sistemi reninë-angiotenzinë
C) kalemia
D) presioni arterial
E) glukagoni
PS)A

Pyetja 319 V)3

Cilat janë qelizat që te adulti lejojnë rinovimin e epidermës?

A) qelizat e shtreses basale që janë te vetmet te afta për ndarje
B) qelizat e shtreses basale dhe spinoze që janë te vetmet akoma te afta për ndarje
C) qelizat e shtreses granuloze
D) qelizat e te gjitha shtresave në te cilat nukleusi është akoma vital
E) qelizat limfocitare
PS)A

Pyetja 320 V)2

Incidentaloma është:

A) një tumor hipotalamo-hipofizar-post traumatik
B) një tumor i derivuar nga xhepi i Rathke
C) një granulome dentare.
D) një tumor i zbuluar rastësisht gjate një ekzaminimi instrumentar
E) tumor malinj i kockave
PS)D

Pyetja 321 V)1

Një arsye prerenale e insuficencës renale akute është:

A) obstruksioni bilateral nga kalkulat
B) shoku traumatik
C) pielonefriti akut
D) insuficencë renale kronike
E) kalkuloza vezikale
PS)B

Pyetja 322 V)2

Cila nga këto karakteristika mbështet diagnozën e natyres malinje të një noduli mamar?

A) multipël e bilateral
B) i fiksuar në indin glandular

C) ndryshueshmeri e volumit e lidhur me ciklin menstrual
D) shfaqja ka lidhje me stinën
E) shoqërohet me nauze
PS)B

Pyetja 323 V)2

Nga 10 ml urinë e fresket, e ekzaminuar me zmadhim te lartë, hematuria microskopike përcaktohet nga prezenca e të paktën:

A) 0-1 eritrocite/fushë
B) 3-5 eritrocite/fushë
C) më shume se 5 eritocite/fushë.
D) më shume se 10 eritrocite / fushë
E) prania e kristaleve oksalate
PS)B

Pyetja 324 V)3

Cili nga pohimet është i saktë për 'Epitelioma basocelulare'?

A) manifestohet vetëm në subjekte të rinj.
B) nuk është kurrë e pigmentuar.
C) lokalizohet në mënyrë elektive në fytyrë.
D) nuk është kurrë e ulceruar.
E) shoqërohet me anemi.
PS)C

Pyetja 325 V)2

Cilat janë masa terapeutike të dobishme në kurimin e pielonefritit akut?

A) terapia me antibiotike për profilaksi
B) antibiotike për 2 javë sipas antibiogramës
C) hidratim i pacientit
D) për profilaksi nga recidivat përdoret penicilina për 2 muaj
E) diuretikët
PS)B

Pyetja 326 V)2

Individualizimi te një i sëmurë i antitrupave ekskluzivisht të klasës IgG, të drejtuara ndaj një mikroorganizmi, të lejon te vendosësh diagnozën për :

A) infeksion aktiv
B) ekspozim recent
C) ekspozim i mëparshëm

D) serokonversion
E) intoksikacion
PS)C

Pyetja 327 V)2

Aldosteroni në nivelin renal vepron mbi:

A) osmolaritetin e urinës
B) eleminimin e uresë
C) ripërthithjen e natriumit
D) ripërthithjen e uresë
E) vaskularizimin e nefronit
PS)C

Pyetja 328 V)2

Shenja që ndihmon për diagnozën e tromboembolisë pulmonare është:

A) dozimi i LDH
B) dozimi i SGOT
C) dozimi i azotemisë
D) dozimi i glicemise
E) dozimi i D-dimerit
PS)E

Pyetja 329 V)1

Indikator i citolizës hepatike është:

A) dozimi hematik i haptoglobinës
B) hiperglicemia
C) ulja e transaminazave në gjak
D) rritja e transaminazave në gjak
E) dispepsia
PS)D

Pyetja 330 V)2

Një luksacion i rregjur (inveteratam) koksofemoral është:

A) një proces inflamator i koksofemoralit te luksuar
B) një luksacion i patrajtuar
C) një frakture e femurit në një koksofemoral të luksuar
D) inflamacion specifik koksofemoral
E) komplikacion akut postoperator
PS)B

Pyetja 331 V)2

Një edeme peri-malleolare mund te jetë sekondare e një:

A) hipoglobulinemie
B) hipoalbuminemie
C) hipofibrinogjenemie
D) hiperglobulie
E) poliglobulie
PS)B

Pyetja 332 V)3

Cila është shenja dhe/ose simptoma më e zakonshme me të cilën paraqitet karcinoma endometriale?

A) rritja volumetrike e uterusit
B) kolika abdominale
C) hemorragjia
D) leukorrea
E) apoliuria
PS)C

Pyetja 333 V)2

Cila është diagnoza që ka më shumë të ngjarë të jetë në një grua të re me një nodul mamar me konture të qarta dhe i lëvizshëm?

A) fibroadenomë
B) karcinomë in situ
C) karcinomë infiltruese
D) ektazi duktale
E) mastit akut
PS)A

Pyetja 334 V)3

Cili është objektivi i një nderhyrje trombektomie të arteries karotide?

A) të rivaskularizoje një territor cerebral pas një eventi iscemik
B) të parandaloje një event iskemik cerebral
C) të kuroje një ictus cerebral
D) të korrigjojë aritmitë shoqëruese
E) të normalizojë TA sistemik
PS)B

Pyetja 335 V)2

Cila nga sindromat e mëposhtme te imunodeficiences transmetohet gjenetikisht me kromozomin X?

A) hipogamaglobulinëmia tip Burton
B) sindroma George
C) sindroma Chediack-Higashi
D) sindroma Nezelof
E) sindroma Klainfelter
PS)A

Pyetja 336 V)3

Shkak endokrin për shtatin e shkurtër në femrat nuk është:

A) sindroma Turnër
B) hipotiroidizmi
C) hiperplazia surrenale
D) sëmundja Cushing
E) feokromocitoma
PS)E

Pyetja 337 V)2

Ileusi nga mekoniumi është një manifestim i:

A) megacolonit të lindur
B) mucoviscidiozës
C) invaginacion intestinal
D) atrezisë së ezofagut
E) anemisë hemolitike
PS)B

Pyetja 338 V)3

Cila nga simptomat e mëposhtme ose shenjat radiologjike nuk është karakteristike për një infarkt pulmonar?

A) opacitet trekendor me baze te kthyer nga pareti torakal
B) ngritje e hemidiafragmes nga ana e goditur
C) hipodiafania në gjithë zonën pulmonare te interesuar
D) kongjestion i hilusit pulmonar
E) prania e pneumotoraksit
PS)E

Pyetja 339 V)2

Në kompresionin neoplastik ose diskal te cauda equina, simptoma e pare përgjithësisht është:

A) parestezia
B) dhimbja
C) paraliza
D) shenja e Babinski
E) cefalea
PS)B

Pyetja 340 V)1

Një deficit i trombociteve manifestohet shumë shpesh me:

A) hematoma
B) hemoartroza
C) petekie
D) ikter
E) edemë
PS)C

Pyetja 341 V)2

Diuretikët tiazidike nuk përdoren kur:

A) është e pranishme hiperkalemia
B) është i pranishem hipertensioni arterial
C) filtravioni glomerular është më i ulët se 10 ml/min
D) ka hipokalcemi
E) ka anemi kronike
PS)C

Pyetja 342 V)2

Përpara një pacienti me rrjedhje hemorragjike nga thithat është e indikuar të bëhet:

A) ecografia mamare.
B) duktogalaktografia.
C) mamografia.
D) thithje me age e lezionit të palpueshëm.
E) grafi e thjeshtë.
PS)B

Pyetja 343 V)3

Vitamina D3 sintetizohet:

A) në hepar
B) në kocka
C) në veshka
D) në paratiroide
E) në stomak
PS)C

Pyetja 344 V)2

Sindroma e venës cava superiore nuk mund të shkaktohet nga:

A) karcinoma pulmonare
B) limfoma
C) tumori mediastinal
D) metastaza intratorakale
E) mastopatia polikistike
PS)E

Pyetja 345 V)2

Një përshpejtim i theksuar i fluksit që ndeshet në një segment arterial do të thotë:

A) që vaza është e trombozuar
B) që presioni arterial është mjaft i rritur
C) që ka një stenozë të rëndësishme të vazës
D) që gjaku është shume i holluar
E) që hemtokriti është i rritur
PS)C

Pyetja 346 V)2

Fluksi koronar:

A) nuk rregullohet nga faktorë lokalë
B) verifikohet vecanërisht në sistola
C) verifikohet vecanërisht në diastola
D) verifikohet si në sistola dhe në diastola
E) nuk varet nga pozicioni
PS)C

Pyetja 347 V)3

Katabolizmi i hemoglobinës nuk shkakton:

A) formim të pigmenteve biliare
B) thyerje oksidative te unazes porfirinike
C) formim të biliverdinës

D) formim të urobilinogjenit
E) hipoalbumineminë
PS)E

Pyetja 348 V)1

Një dhimbje torakale akute nuk të bën të mendosh për:

A) një infarkt miokardi
B) aneurizëm disekante të aortës
C) perikardit
D) pleurit
E) kolikë renale
PS)E

Pyetja 349 V)2

Në cilën prej patologjive, faktori reumatoid nuk mund të jetë i pranishëm?

A) endokarditin bakterial subakut
B) sarkoidozë
C) vaskulit
D) sindromi Sjogren
E) detres respirator të adultit
PS)E

Pyetja 350 V)3

Hipotrofia e një dore në sindromin Hornër mund te indikojë ekzistencën e:

A) sklerozës laterale amiotrofike
B) sindromës të tunelit carpal
C) tumor Pancoast
D) amiloidozë sistemike
E) neurit i nervit axillar
PS)C

Pyetja 351 V)3

Klirensi i një substance:

A) shpreh volumin e plazmës totalisht të pastruar nga kjo substancë në njësinë e kohës
B) shprehet në kg/ditë.
C) i referohet volumit të feceve te ekskretuara në 24 orë
D) shprehet me gradë Fahrenhait
E) varet nga temperatura
PS)A

Pyetja 352 V)2

Nervi laringeal inferior i majtë (rekurrent) në rrugën e tij rrethon:

A) arterien subklavia
B) arterien carotide
C) harkun e aortës
D) bronkun e majtë
E) venën subklavia
PS)C

Pyetja 353 V)2

Tek një subjekt me diabet te tipit 2 me mbipeshë, një dietë hipokalorike:

A) shton riskun e hipoglicemisë
B) përmireson kontrollin glikometabolik
C) duhet të jetë edhe hiperptoteinike
D) shton nivelet plazmatike te lipideve
E) shton fluksin e urinës
PS)B

Pyetja 354 V)3

Mund të flasim për aneurizëm të aortës abdominale kur:

A) aorta është e disekuar
B) kemi një fibrozë retroperitoneale
C) aorta kalon diametrin trasversal 3cm
D) aorta është e mbyllur
E) aorta ka pllakë sklerotike
PS)C

Pyetja 355 V)2

Në një subjekt me Insufiçencë Renale kronike me nivel të hemoglobinës 12 gr %, cila terapi këshillohet:

A) transfuzione me gjak të plotë
B) zëvendësues të plazmës
C) kortikosteroide me doza të larta
D) terapi me inhbitorë të pompës protonike
E) terapi dialitike
PS)E

Pyetja 356 V)2

Halucinoza alkolike akute është:

A) percepsion i gabuar i etilistevë
B) e pranishme kryesisht në subjekte ciklotimikë ose ekstroversë
C) përcaktohet nga faktorë personaliteti të mëparshëm
D) është kryesisht një reaksion psikologjik shkaktuar nga një ekses alkoli
E) një fenomen halucinator tipik i skizofrenisë
PS)A

Pyetja 357 V)3

Cili prej pohimeve të mëposhtme mbi anurinë është i saktë?

A) është paaftësia për të mbajtur urinën
B) është humbja e vullnetshme e urinës
C) është humbja e urinës gjatë gjumit
D) është paaftësia për të urinuar gjatë gjumit
E) është mungesa totale e prodhimit të urinës
PS)E

Pyetja 358 V)3

Sëmundja Alzheimer ndryshon nga ajo Pick sepse:

A) e para është funksionale
B) e para ka një tendencë më të madhe për inerci në fazat e zhvilluara
C) e para ka një defiçit më të madh memorieje në fazën e fillimit
D) e dyta ka një konfuzion më të madh në stadet e fillimit
E) është më e shpeshtë
PS)E

Pyetja 359 V)2

Tumoret e testikujve me qeliza të Leydig prodhojnë:

A) LH
B) PRL
C) FSH
D) TSH
E) testosteron
PS)E

Pyetja 360 V)1

Tek eritrociti i pjekur vërehen:

A) një bërthamë
B) kompleksi i Golxhit
C) mitokondritë
D) disa berthama
E) mungesa e berthamës
PS)E

Pyetja 361 V)3

Rritja e IgA është më e shpeshtë:

A) në kalkulozat biliare
B) në hepatitin C akut
C) në cirrozat alkolike
D) në mononukleozën infektive
E) në kalkulozat e koledokut
PS)C

Pyetja 362 V)2

Gjatë hiperplazisë surenale të lindur shkaktuar nga defiçiti i 11 - Beta - Hidroksilazës shfaqet:

A) vetëm hipertensioni.
B) vetëm virilizmi
C) vetëm pseudopuberteti i parakohshëm
D) hipertensioni, virilizmi dhe pseudopuberteti i parakohshëm
E) pruriti
PS)D

Pyetja 363 V)2

Proceset kryesore fiziopatologjike të arteriosklerozës përfshijnë:

A) disfunksionin endothelial
B) gjëndje febrile
C) pruritin
D) cefalenë
E) epigastralgjinë
PS)A

Pyetja 364 V)2

Nga vena aksilare dalin:

A) disa vena brakiale
B) vena e qafës
C) disa vena ndërkostale të pasme

D) vena mamare
E) vena palmare
PS)A

Pyetja 365 V)1

Trego faktorët që nuk ndikojnë tek numri i rruazave te kuqe dhe përmbajtja e Hb-së?

A) mosha
B) seksi
C) aktiviteti musculor
D) lartësia mbi nivelin e detit
E) ankthi
PS)E

Pyetja 366 V)2

Sarkoidoza është një sëmundje që karakterizohet nga:

A) një histori natyrale që karakterizohet nga periudha aktivizimi dhe qetësie
B) është një sëmundje me progresion gjithmonë fatal
C) është një sëmundje që shfaqet sidomos në moshë të avancuar
D) është një sëmundje që prek ekskluzivisht mushkëritë
E) është një sëmundje e veshit të mesëm
PS)A

Pyetja 367 V)2

Gjatë artritit podagrik (guta) hasim:

A) hiperkreatininemi
B) hiperuricemi
C) hiperfosfatemi
D) hipotransferrinemi
E) rritje të sudoracionit periferik
PS)B

Pyetja 368 V)2

Çfarë dëmtimesh të menjëhershme mund të shkaktojë intubimi trakeal në rast manovrash reanimacioni?

A) stenozë trakeale
B) trakeomalaci
C) dëmtim trakeal penetrues
D) hemorragji tiroidiene
E) dëmtim të paratiroideve

PS)C

Pyetja 369 V)3

Në cilat rrethana nuk është i nevojshëm, për të kryer një akt mjekësor, aprovimi i pacientit?

A) është gjithmonë i nevojshëm
B) nëse bëhet fjalë për një gjendje nevoje dhe pacienti nuk eshte koshient per gravitetin
C) nëse bëhet fjalë për një subjekt në një moshë më të vogël se 14 vjeç
D) nëse pacienti ka një sëmundje neoplazike
E) nëse pacienti ka një sëmundje infektive
PS)B

Pyetja 370 V)2

Sekretimi i aciditetit gastrik nuk mund të ndikohet nga:

A) antagonistët e receptorit H2
B) frenuesit e pompës protonike
C) antagonistët muskarinikë si psh. Pirenxepina
D) hipertensioni arterial
E) ushqimi
PS)D

Pyetja 371 V)3

Cila prej substancave të mëposhtme nuk mund të shkaktojë një hepatit toksik?

A) trikloroeltileni
B) tetrakloruri i karbonit
C) halotani
D) izoniazidi
E) ranitidina
PS)E

Pyetja 372 V)2

Cila prej substancave të mëposhtme nuk mund të shkaktojë hepatit toksik?

A) trikloroeltileni
B) tetrakloruri i karbonit
C) alotani
D) izoniazidi
E) ranitidina
PS)E

Pyetja 373 V)2

Humbja e aftësive psikomotore të fituara më parë quhet:

A) vonesë
B) ndërprerje
C) pamjaftueshmëri
D) regres
E) projektim
PS)D

Pyetja 374 V)2

Insight përkufizohet si:

A) një difekt viziv psikogjen
B) një prirje për të përvetësuar ankthin
C) një simptomë aksesore e depresionit
D) aftësia introspektive e një subjekti
E) aftësia e një subjekti për kritikë
PS)D

Pyetja 375 V)2

Cila prej gjendjeve të mëposhtme karakterizohet nga çorientimi hapësinoro-kohor?

A) gjendja krepuskolare
B) çmenduria
C) shqetësime delirante
D) neurozë obsesive compulsive
E) depresioni
PS)A

Pyetja 376 V)3

Cili është roli i lavazhit bronko alveolar në diagnozën e pneumonisë nga hipersensibiliteti?

A) asnjë rol
B) dokumenton me saktësi praninë e në alneoliti me natyrë limfocitare
C) alveoliti limfocitik nuk haset vetëm tek polmoniti nga hipersensibiliteti
D) specificiteti i rastit rritet nëse alveoliti limfocitik shoqërohet me një inversion të raportit CD4/CD8
E) dedektimi i faktorit mikrobiologjik
PS)D

Pyetja 377 V)2

Cili prej kushteve të mëposhtëm mund të jetë shkak i një artriti gotik dytësor:

A) obezitet trajtuar me dietë hipokalorike të skajshme
B) dhënie e tepruar e xantin-oksidazës
C) terapi e tepruar me kortizonikë
D) terapi me kolkicinë
E) aktiviteti sportiv
PS)A

Pyetja 378 V)3

Pneumonitë eosinofilike nuk përfshijnë:

A) infeskionet parazitare
B) sindromën Loeffler
C) pneumoninë eosinofilike akute
D) pneumoninë eosinofilike kronike
E) pneumoninë stafilokoksike
PS)E

Pyetja 379 V)1

Me termin leukocituri kuptohet:

A) prania e rruazave të kuqe në urinë
B) prania e leukociteve me feçe
C) sekrecione të pasura me leukocite
D) prania e leukociteve në urinë
E) prania e shkopinjve në urinë
PS)D

Pyetja 380 V)2

Një pacient i prekur nga një infeksion bakterial merr trajtim me antibiotikë intramuskular me bazë peniciline. Disa minuta pas injeksionit pacienti shfaq një sindromë respiratore akute dhe humbet ndjenjat. Ky reagim ndërmjetësohet nga:

A) limfocitet T
B) IgG dhe IgM
C) IgE
D) IgG dhe plotësues të tyre
E) IgA
PS)C

Pyetja 381 V)3

PET është:

A) tomografia elektromagnetike protonike
B) tomografia helikoidale pozitronike
C) tomografia me çlirim pozitronesh
D) tomografia me çlirim protonesh
E) tomografia aksiale e kompjuterizuar
PS)C

Pyetja 382 V)2

Tek prekjet e artritit reumatoid nuk përfshihet:

A) kërci artikular
B) lëngu sinovial
C) kocka subkondriale
D) palca e kockës
E) strukturat intraartikulare
PS)D

Pyetja 383 V)2

Komplikacionet e një abscesi pulmonar të patrajtuar nuk mund të jenë:

A) fistula bronko-pleurale
B) empiema pleurale
C) absesi metastatik cerebral
D) asnjë prej të mësipërmeve
E) aritmia atriale
PS)E

Pyetja 384 V)1

Në cilat nga gjendjet e mëposhtme patologjike haset hipoalbuminemia?

A) cirroza hepatike, sindromë nefrotike
B) dehidratimi
C) defiçiti i alfa1- antitripsinës
D) sëmundja Wilson
E) sindroma Sjogren
PS)A

Pyetja 385 V)2

Dispnea tek koma diabetike karakterizohet përgjithësisht nga:

A) frymëmarrja Biot.
B) frymëmarrja Kussmaul.
C) frymëmarrja Cheyne-Stokes

D) dispnea ortostatike
E) dispnea në Tredelenburgh
PS)B

Pyetja 386 V)2

Klinikisht Insufiçienca Renale kronike:

A) nuk ka asnjë simptomë deri në reduktimin e skajshëm të funksionit të veshkave (FG prej 5 ml/min)
B) shfaqet me paralizë të papritur cerebrale
C) fillon me amaurozë, skotoma me shkëndija, reduktim të papritur të shikimit
D) është menjëherë vdekjeprurëse
E) shfaqet me dispne
PS)A

Pyetja 387 V)2

Një efekt anësor i zakonshëm i terapisë me sulfat të hekurit në rrugë orale është:

A) kriza anafilaktike
B) hipetrikozë në fytyrë
C) dispepsia
D) hipogonadizëm sekondar dhe hemosiderozë
E) melena
PS)C

Pyetja 388 V)2

Kurba e shkëputjes së hemoglobinës nuk spostohet djathtas për shkak të:

A) rritjes së 2,3 DPG-së
B) hipoksisë
C) acidozës
D) rritjes së temperaturës
E) hipertensionit
PS)E

Pyetja 389 V)1

Pulsi arterial është ritmik nëse:

A) intervali nga një pulsim tek tjetri është konstant dhe i rregullt
B) mungon në disa pjesë të matshme me palpacion
C) shoqërohet nga dridhje palpatore
D) gjendet lehtë
E) paraqet ekstrasistola

PS)A

Pyetja 390 V)2

Emërtimi Rh pozitiv tregon praninë tek njeriu të eritrociteve me antigen:

A) D.
B) C.
C) C.
D) E.
E) N.
PS)A

Pyetja 391 V)2

Stenoza mitrale rezulton etiologjikisht e lidhur me shpeshtësi të lartë në rast:

A) reumatizmi artikular akut
B) artrit rheumatoid
C) spondilit ankilizant
D) ulçere gastrike
E) dermatiti
PS)A

Pyetja 392 V)3

Cilat prej karakteristikave të mëposhtme nuk shfaqin pacientet me risk të lartë të karcinomës endometriale?

A) hypertension
B) diabet
C) obezitet
D) historik familjar të karcinomës endometriale
E) etilizëm
PS)E

Pyetja 393 V)2

Një ndërhyrje për të hequr e një faktor risku mjedisor mund të klasifikohet si:

A) parandalim dytësor
B) parandalim tretësor
C) parandalim parësor
D) rehabilitim
E) terapi onkologjike
PS)C

Pyetja 394 V)2

Silikoza në të gjitha fazat e saj nga pikëpamja funksionale është:

A) një shqetësim përhapjeje shkaktuar nga shpeshtimi i membranës bazë të alveoleve
B) një shqetësim ventilator i llojit restriktiv me humbje progresive te elasticitetit pulmonar
C) një shqetësim shkëmbimi gazesh që shkakton në rradhë të parë hipokapni
D) një shqetësim ventilator bllokues
E) një shqetësim ventilator kardiogjen
PS)B

Pyetja 395 V)3

Cila prej vaksinave të mëposhtme është e detyrueshme?

A) antigrip
B) antimeningokok
C) antihepatit B
D) antihepatit A
E) anti ekinokok
PS)C

Pyetja 396 V)3

Degëzimi i dytë i trigeminalit hyn në kontakt me:

A) tonsilën palatine
B) ganglionin sfeno-palatin
C) uvulën
D) muskulin hyoglos
E) kanalin lakrimal
PS)B

Pyetja 397 V)2

Në cilën prej sëmundjeve të mëposhtme mund të vërehet proteinuria tip Bence-Jones:

A) glomerulonefrit
B) leukozë akute
C) leukozë limfoide kronike
D) mielomë multiple
E) infeksion urinar
PS)D

Pyetja 398 V)2

Rezultati elektroencefalografik më i zakonshëm tek sindroma e West-it konsiston në:

A) asimetri ndërhemisferike
B) hypsaritmi
C) sheshimi i përgjithshëm i gjurmës
D) koma depasé (që ka kaluar)
E) disnivelim të valeve T
PS)B

Pyetja 399 V)2

Në rast acidoze metabolike mushkëria kompenson nëpërmjet:

A) rritjes së frekuencës respiratore
B) uljes së frekuencës respiratore
C) uljes së intensitetit të frymëmarrjes
D) rritjes së intensitetit të frymëmarrjes
E) uljes se volumit respirator
PS)A

Pyetja 400 V)3

Fjala aneuploidi përcakton:

A) një anomali strukturore të kromozomeve
B) një anomali numerike të kromozomeve
C) një anomali gjenike
D) një malformim të sistemit nervor qëndror
E) një dislokacion gjenik
PS)B

Pyetja 401 V)2

Nga të mëposhtmet, ku nuk gjëndet Candida albicans?

A) në farings
B) pështymë
C) urinë
D) gjak
E) djersë
PS)E

Pyetja 402 V)3

Kushti që të përcaktohet "vdekja cerebrale" për dhurimin e mundshëm të organeve të zemrës dhe organeve të tjera është?

A) prania e frymëmarrjes spontane
B) mioza paralitike
C) mungesa e aktivitetit elektrik cerebral
D) mungesa e lëvizjeve aktive
E) mungesa e pulsit periferik
PS)C

Pyetja 403 V)3

Një dëmtim i kiazmës optike përcakton:

A) hemianopsinë temporale e së njëjtës anë + kuadrantopsi hundore të sipërme kundërlaterale
B) kuadrantopsi hundore e poshtme e së njëjtës anë + kuadrantopsi temporale e poshtme kundërlaterale
C) hemianopsinë temporale e së njëjtës anë + kuadrantopsi temporale e poshtme kundërlaterale
D) hemianopsinë bitemporale
E) kuadrantopsi temporale bilaterale
PS)D

Pyetja 404 V)3

Cila prej intersticiopative të mëposhtme është më e ndjeshme ndaj terapisë me steroide?

A) histiocitoza X
B) pneumonia intersticiale e zakonshme
C) pneumonia eosinofilike akute
D) pneumonia intersticiale akute
E) pleuriti bazal
PS)C

Pyetja 405 V)3

Cila është terapia që duhet zgjedhur gjatë sarkoidozës?

A) methotrexate
B) kolkicinë
C) prednizoloni
D) aziotripinë
E) albendazol
PS)C

Pyetja 406 V)3

Cili prej këtyre veprimeve nuk bën pjesë tek roli fiziologjik i parathormonit?

A) rrit ripërthithjen e Ca dhe P nga kockat
B) rrit shndërrimin e kalcifediolit në kalcitriol
C) redukton ripërthithjen e fosfateve dhe bikarbonateve në nivel renal
D) redukton ripërthithjen e Ca në nivel renal
E) rrit nivelet e Ca në gjak
PS)D

Pyetja 407 V)2

Cili prej elementëve të mëposhtëm nuk është i pranishëm tek kërci artikular?

A) kondrocitet
B) kolagjeni lloji II
C) proteoglikani
D) terminacionet nervore
E) acidi hialuronik
PS)D

Pyetja 408 V)2

Cila prej simptomave të mëposhtme është tipike e fibrozës pulmonare idiopatike?

A) dispnea progresive
B) dispnea akute
C) hemoptoe
D) ethet
E) cefalea
PS)A

Pyetja 409 V)3

Tek personat e rritur pjesa më e madhe e aneurizmave intrakranialë ndodhin:

A) në nivelin e komunikueses anteriore dhe të karotides interne
B) në nivelin ventrobrobazilar
C) në nivelin e arteries cerebri media
D) në nivelin e arteries perikalloze
E) në nivelin e arteries vertebrale
PS)A

Pyetja 410 V)3

Sekretimi i prolaktinës nuk rritet pas:

A) thithjes së gjirit
B) stresit
C) gjumit

D) ushtrimit fizik
E) të ngrënit
PS)E

Pyetja 411 V)3

Cilat prej pohimeve të mëposhtme rreth Osteogenesis imperfecta është e saktë:

A) karakterizohet nga një delikatesë e lartë kockore
B) karakterizohet nga një dendësi e lartë kockore
C) karakterizohet nga sklera kafe
D) ka lidhje me vonesë mendore në 95% të rasteve
E) lidhet me aktivitetin fizik
PS)A

Pyetja 412 V)2

Në cilën pjesë të unazës Waldeyer shfaqen me më shumë frekuencë limfomat jo Hodgkiniane?

A) në bazën e gjuhës
B) rinofaring
C) tonsila
D) faring
E) koane
PS)C

Pyetja 413 V)2

Në rast trombocitopenie nga aplazia palcore nga trajtimi me citostatikë, masa që duhet marrë menjëherë është:

A) infuzioni i trombociteve
B) terapia me steroide në doza të larta
C) splenektomia
D) infuzioni i plazmës
E) terapia me antibiotikë
PS)A

Pyetja 414 V)2

Për pregatitjen e pacientit për ndërhyrje kirurgjikale nuk është e nevojshme:

A) të hiqen papastërtitë e lëkurës përpara pregatitjes antiseptike.
B) të bëhet pregatitja antiseptike e lëkurës.
C) dushi antiseptik një natë më parë
D) nëse është e nevojshme të bëhet depilimi përpara ndërhyrjes
E) të ushqehet pacienti në 6 orët para ndërhyrjes

PS)E

Pyetja 415 V)2

Bllokimi bronkial sipas përkufizimit të BPCO-së është:

A) i pranishëm në mënyrë konstante edhe pse në formë të ndryshme dhe të pakthyeshme
B) nuk është gjithmonë i pranishëm por është i kthyeshëm
C) jo domosdoshmërisht është gjithmonë i pranishëm dhe mund të jetë pak a shumë i kthyeshëm
D) është gjithmonë i pranishëm dhe i kthyeshëm
E) nuk është i pranishëm
PS)A

Pyetja 416 V)2

Rakicenteza është manovra diagnostike që duhet kryer në rastin e:

A) meningitit
B) cirrozës së përparuar
C) pneumonisë
D) tumorit cerebral
E) traumës së kolonës vertebrale
PS)A

Pyetja 417 V)3

Sindroma Nelson karakterizohet nga:

A) tumori mbiveshkor
B) tumori hipofizar
C) shtim i hormonit të tiroides
D) shtim i HCG-së
E) tumor i paratiroides
PS)B

Pyetja 418 V)2

Pacientët me neoplazi në stadin IV paraqesin:

A) metastaza në distancë klinikisht të dallueshme
B) nyje limfatike lokale klinikisht pozitive
C) tumor të përmasave të vogla
D) sindroma paraneoplastike
E) mungesë të metastazave në distancë
PS)A

Pyetja 419 V)2

Tek një pacient me insufiçencë renale kronike dhe kalemi prej 6 mEq/l tek EKG-ja del

A) valë P dyfundore
B) valë T të larta dhe me majë
C) zgjatim i pjesës QT
D) disnivelim i lehtë i pjesës ST
E) vale T thuajse të sheshta
PS)B

Pyetja 420 V)2

Kardiotokografia:

A) regjistron njëkohësisht me dy sensorë frekuencën kardiake fetale dhe aktivitetin e kontraksioneve të miometrit
B) regjistron njëkohësisht me dy sensorë frekuencën kardiake të nënës dhe aktivitetin e kontraksioneve të miometrit
C) bën të mundur vlerësimin e morfologjisë kardiake fetale
D) llogarit kohën e pritshme të lindjes
E) zëvendëson ekzaminimet ekografike të fetusit
PS)A

Pyetja 421 V)2

Cili prej kushteve të mëposhtme nuk është shkak i hiperkaliemisë?

A) hemoliza e kampionit të gjakut të marrë
B) intoksikimi digital
C) insufiçenca renale akute
D) rabdomioliza
E) kostipacioni
PS)E

Pyetja 422 V)3

Arteriosklerozа dhe koronaropatia iskemike reduktohen dukshëm nga:

A) hiperkolesterolemia familjare
B) diabeti melit i tipit 2
C) insuficenca renale kronike
D) sindroma metabolike
E) dieta mesdhetare
PS)E

Pyetja 423 V)2

Cilat janë format më të shpeshta të HP (hipertensionit pulmonar):

A) HP primitiv
B) HP dytësor dhe kardiopati të majta
C) HP nga qëndrimi në lartësi të mëdha
D) HP dytësor tek sëmundjet respiratore kronike
E) HP kardiogjen
PS)D

Pyetja 424 V)2

Subjekti i prekur nga një sëmundje infektive që bën të mundur përçimin e agjentëve përgjegjës edhe nëpërmjet një vektori konsiderohet:

A) burim infeksionesh
B) mjet
C) mjet transmetimi
D) agjent infektiv
E) i shëruar
PS)A

Pyetja 425 V)2

Termi ektopi renale tregon:

A) praninë e veshkave në nivel të kapakut të kafkës
B) lokalizimin e veshkës në seli të ndryshme nga ajo lumbare; mund të jetë pelvike ose torakale
C) patologji funksionale renale që përfshihet në kuadrin e MEN
D) pani të një veshke të trete
E) mungesën e një veshke
PS)B

Pyetja 426 V)1

Glomerulonefriti është një sëmundje me patogjenezë:

A) infektive
B) imunologjike
C) dismetabolike
D) virale
E) mikrobiale
PS)B

Pyetja 427 V)2

Cili prej pohimeve është i saktë?

A) diarrea infektive është gjithmonë një formë e lehtë
B) diarrea infektive nuk shoqërohet asnjëherë me temperaturë
C) diarrea infektive shoqërohet gjithmonë me prani gjaku në feçe
D) diarrea infektive është shpesh një formë e rëndë që prek gjendjen e përgjithshme me dehidtratim dhe hipovolemi
E) diarrea është gjithmonë kronike.
PS)D

Pyetja 428 V)3

Prevalenca i një neoplazie rritet pasi:

A) rritet numri i rasteve dhe rritet shkalla e vdekshmërisë
B) ulet numri i rasteve dhe ulet shkalla e vdekshmërisë
C) rritet numri i rasteve dhe ulet shkalla e vdekshmërisë
D) ulet numri i rasteve dhe rritet shkalla e vdekshmërisë
E) rritet numri i të shëruarve nga kjo neoplazi
PS)C

Pyetja 429 V)1

Amebat janë:

A) protozoarë
B) kërpusha
C) eubaktere
D) mikrobaktere
E) viruse
PS)A

Pyetja 430 V)2

Pacienti seropozitiv për HIV nuk:

A) mund ta transmetojë infeksionin
B) mund të mos ketë simptoma të sëmundjes
C) mund të jetë i infektuar që prej shumë vitesh
D) nuk do të vuajë nga sëmundja por e transmeton atë
E) mund të ketë përdorur drogë në të kaluarën
PS)D

Pyetja 431 V)2

Cili prej mekanizmave të mëposhtëm është i rëndësishëm për kontrollin renal të ph-it?

A) vetëm kombinimi i joneve të hidrogjenit me bikarbonatin
B) vetëm kombinimi i joneve të hidrogjenit me fosfatin
C) vetëm kombinimi i joneve të hidrogjenit me amoniakun që jep jone amoniumi
D) vetëm kombinimi i joneve të hidrogjenit me bikarbonatin, fosfatin dhe amoniakun që jep amoniemi
E) volumi i urinës së ekskretuar
PS)D

Pyetja 432 V)2

Cila nga të mëposhtmet nuk është simptomë e shpeshtë e infeksionit primar nga HIV?

A) temperatura
B) faringodinia
C) artralgjia
D) rashi lëkuror makulo-papuloz
E) miopia
PS)E

Pyetja 433 V)3

Cila është një përgjigje normale e tensionit të gjakut gjatë ushtrimit aerobik?

A) si tensioni sistolik dhe ai diastolik rriten në mënyrë proporcionale me shtimin e ngarkesës së punës
B) tensioni sistolik rritet dhe tensioni diastolik ulet
C) tensioni i gjakut sistolik rritet në mënyrë proporcionale me shtimin e ngarkesës së punës ndërsa tensioni diastolik ulet lehtësisht ose mbetet i pandryshuar
D) si tensioni sistolik dhe ai diastolik ulen në pjesën e parë të ushtrimit dhe më pas rriten ne mënyrë proporcionale me rritjen e intensitetit të ushtrimit
E) tensioni sistolik dhe ai diastolik nuk ndryshojnë
PS)C

Pyetja 434 V)3

Çfarë kuptohet me fibrozë pulmonare idiopatike?

A) një formë fibroze pulmonare me evolucion të lehtë
B) një formë fibroze pulmonare që shfaqet papritur
C) një forme fibroze pulmonare e transmetueshme
D) është forma e pneumonisë intersticiale idiopatikd që karakterizohet nga paraqitja anatomopatologjike e pneumonisë intersticiale të zakonshme dhe nga ecuria klinike progresive
E) fibrozë pulmonare kongenitale
PS)D

Pyetja 435 V)3

Me kancer të hershëm kuptohet:

A) një tumor i stomakut i diagnostifikuar prej të paktën 6 muajsh
B) një tumor me diametër maksimal më të vogël se 1 cm
C) një tumor që tejkalon serozën e organeve të brendshme
D) një tumor që infiltron vetëm mukozën dhe submukozën e traktit tretës
E) një tumor infiltrativ
PS)D

Pyetja 436 V)2

Vonesa e maturimit kockor nuk shkaktohet prej:

A) defiçitit të GH-së.
B) defiçitit të hormoneve tiroidiene
C) tepricës së glukokortikoidësh
D) defektit të androgjenëve
E) ushqyerjes hiperproteinemike
PS)E

Pyetja 437 V)2

Tek infeskionet spitalore cili prej agjentëve të mëposhtëm etiologjikë është më i shpeshti?

A) bakteret gram pozitivë
B) viruset
C) bakteret gram negative
D) myket dhe protozoarët
E) parazitozat intestinale
PS)C

Pyetja 438 V)2

Cili prej këtyre mikroorganizmave është shpesh shkaktar infeksionesh nozokomialë?

A) salmonella typhi
B) treponema pallidum
C) pseudomonas aeruginosa
D) virusi i rubeolës
E) haemofilus influenzae
PS)C

Pyetja 439 V)2

Cilat ekzaminime rekomandohen në një person me traumë kraniale?

A) RM (resonance magnetike)
B) TC (scaner)
C) TC me kontrast
D) RX kraniale
E) Ekografi e indeve sipërfaqsore
PS)B

Pyetja 440 V)3

Tek korea Huntington:

A) simptomatologjia psikiatrike (ndryshime të karakterit, depression) paraprin gjithmonë simptomatologjinë motore
B) tek fëmijët, lëvizjet koreike shoqërohen me një hipotoni shumë të dukshme muskulare (korea e butë)
C) ekzaminimi neurologjik tregon hipotoni të përhapur
D) kohëzgjatja mesatare e sëmundjes në rast se shfaqet në moshë të rritur është 5 vjet
E) hipertonia e përhapur karakterizon shumcën e rasteve
PS)C

Pyetja 441 V)1

Quhet parangarkesë:

A) tensioni endoventrikular gjatë sistolave ventrikulare
B) mbushja diastolike ventrikulare
C) gjendja e kontraktuar e miokardit
D) gjendja e kontraktuar atriale
E) zbrazja sistolike ventrikulare
PS)B

Pyetja 442 V)2

Cila është shenja që lidhet më shumë me diagnozën e bronkitit kronik?

A) kolle e thate
B) dispne ne sforcim
C) kolle produktive
D) dispne ne qetesi
E) gjëndja febrile
PS)C

Pyetja 443 V)1

Renina:

A) përcakton transformimin e angiotensinogjenit në angiotenzinë I

B) përcakton transformimin e angiotenzinës II në angiotenzinë III
C) prodhohet në nivel pulmonar
D) aktivizohet në nivel hepatik
E) prodhohet në kocka
PS)A

Pyetja 444 V)2

Cili është vendi ku zakonisht nuk formohen koloni të Neisseria gonorrhoeae?

A) uretra
B) kanali cervikal
C) rektumi
D) konjuktiva
E) bronket
PS)E

Pyetja 445 V)3

Lezionet tipike të artikulacioneve interfalangeale distale të subjekteve artrozike janë:

A) nyjet e Maynet
B) nyjet e Charcot
C) nyjet e Osler
D) nyjet senoatriale
E) nyjet e Eberden
PS)E

Pyetja 446 V)2

Cili prej ketyre ekzaminimeve arrin te përcaktojë në se një lezion që prek një organ parenkimatoz ka përberje të lengshme apo është solid?

A) Rx
B) scintigrafia
C) termografia
D) ekografia
E) Rx me kontrast
PS)D

Pyetja 447 V)2

Në prani te një opaciteti pulmonar në një subjekt 40 vjeçar është e nevojshme:

A) të fillohet një cikël terapie me antibiotikë
B) të ndërhyet sa me shpejt me kirurgji
C) të filloje një cikël kimioterapie antituberkulare

D) të sqarohet diagnoza përpara fillimit të terapisë
E) të pritet 6 muaj
PS)D

Pyetja 448 V)2

Insfuficienca renale akute obstruktive:

A) mund të verifikohet edhe në se obstruksioni ureteral është monolateral
B) verifikohet vetëm në se obstruksioni ureteral është bilateral ose në se është prezent vetëm një veshkë funksionale
C) ka si shkak më të shpeshtë carcinomën bilaterale të ureterëve
D) mund të zgjidhet gjithmonë me kateterizimin vesikal
E) duhet ti nënshtrohet detyrimisht dializës
PS)B

Pyetja 449 V)2

Përqëndrimi i bikarbonatit në gjak është normalisht i barabartë me:

A) 5-7mMol/L.
B) 7-10 mMol/L.
C) 10-15 mMol/L.
D) 15-18 mMol/L.
E) 20-25 mMol/L.
PS)E

Pyetja 450 V)3

Cili nga faktorët e mëposhtëm përcakton rritjen e kuotës së filtrimit glomerular:

A) rritja e presionit onkotik të plazmës
B) rritja e presionit hidrostatik në kapsulën Bowman
C) rritja e presionit hidrostatik në kapilaret glomerularë
D) vazokonstriksioni i arteriolave aferente
E) vazokonstriksioni i arterieve renale
PS)C

Pyetja 451 V)2

Janë përbërës të bilës të gjitha substancat e mëposhtme, me përjashtim të:

A) acide biliare
B) pigmente biliare
C) lipaza
D) kolesteroli
E) uji

PS)C

Pyetja 452 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtme është korrekt lidhur me Dermatomiozitin?

A) është një prekje inflamatore e sistemit nervor
B) është një neoplazi kutane
C) mund të jetë një sindromë paraneoplazike
D) nuk mund të jetë një sindromë paraneoplazike
E) është një sëmundje e sistemit kockor
PS)C

Pyetja 453 V)2

Në alveolen pulmonare, barriera ajër gjak anatomikisht nuk përfaqësohet nga:

A) surfaktanti
B) epiteli alveolar
C) membrana bazale
D) qelizat endoteliale
E) eritrocitet
PS)E

Pyetja 454 V)3

Mbingarkesa transfuzionale në hekur nuk sjell:

A) hipogonadizëm hipogonadotropik
B) diabet mellitus
C) cirrozë hepatike
D) ulçera peptike
E) hipertiroidizëm
PS)D

Pyetja 455 V)2

Cili është komplikacioni më i rëndë i infeksionit nga virusi i varicella-zoster?

A) miokarditi dhe perkrditi
B) pankreatiti
C) meningoencefaliti
D) iridocikliti
E) uretriti
PS)C

Pyetja 456 V)2

Gjate përiudhës dritare për HIV:

A) evidentohet anti-HIV në serum por viremia nuk është akoma prezente
B) nuk është e mundur te transmetohet sëmundja
C) evidentohet HIV-ARN në gjak por antitrupat nuk janë shfaqur akoma
D) shfaqen antitrupat në gjak
E) mbartësi është simptomatik
PS)C

Pyetja 457 V)3

Cilat janë shenjat dhe/ose simptomat kryesore të preeklampsisë:

A) hypertension dhe scotoma
B) hypertension dhe cianozë
C) hipertension, cefale, konvulsione
D) hipertension dhe proteinuri
E) cefale
PS)D

Pyetja 458 V)2

Sindromi nefrotik, insuficienca kardiake kongjestive, cirroza hepatike:

A) janë të gjitha të karakterizuara nga prania e edemave dhe për këtë arësye të përkufizuara edhe si sindroma edemigjene
B) kanë gjithmonë te njëjten etiopatogjenëze
C) janë te trajtueshme me sukses vetem me medikamente antivirale
D) nuk i interesojnë specialistit nefrolog
E) duhet të trajtohen me antibiotikë
PS)A

Pyetja 459 V)2

Cili prej këtyre çrregullimeve të ekuilibrit elektrolitik është tipik për fibrozën cistike?

A) acidoza metabolike
B) alkaloza hipokloremike
C) alkaloza hiperkloremike
D) alkaloza e kompensuar
E) acidoza respiratore
PS)B

Pyetja 460 V)2

Cili është roli fiziologjik esencial i tonsilave palatine?

A) hemopoetik
B) imunitar antikorpopoetik
C) drenazh
D) nuk kanë një rol esencial
E) maturojnë linfocitet T
PS)B

Pyetja 461 V)3

Faktorët përgjegjës për rritjen e presionit arterial pulmonar tek pacientët me pneumopati kronike obstruktive nuk përfshijnë?

A) shkatërrimin parcial të shtratit kapilar pulmonar
B) vasokonstriksionin hipoksik në zona me raport të ulët ventilim/perfuzion
C) policiteminë
D) hipertrofinë e muskulaturës së lëmuar të arteriolave pulmonare
E) hiperlipeminë
PS)E

Pyetja 462 V)2

Cila/cilat nga gjendjet e mëposhtme nuk është e lidhur me një propabilitet të rritur për hemorragji post partum?

A) lindje e gjatë
B) lindje e shpejtë
C) stimulim i lindjes me oksitoksinë
D) shtatzani binjakësh
E) pluripariteti
PS)E

Pyetja 463 V)2

Cilindrat në sedimentin urinar tregojnë

A) tubulopati congenitale
B) rritje të sekretimit të proteinës Tamm-Horsfall
C) tumor renal
D) nefropati primare apo sekondare
E) neoplazi të uretrës
PS)D

Pyetja 464 V)2

Terapia hormonale zëvendesuese e post-menopauzës vendoset:

A) në çdo rast
B) vetëm në paciente te prekura nga osteopenia
C) me qëllim parandalimin e riskut për tromboemboli
D) për mbrojtje ndaj sindromës vazomotore
E) për tu mbrojtur nga reziku i kancerit të gjirit
PS)D

Pyetja 465 V)2

Ndërlikime të mundshme të pielonefritit akut nuk janë:

A) pionefroza
B) abscesi perinefritik
C) nekroza kapilare
D) amiloidoza renale
E) djegia gjatë urinimit
PS)D

Pyetja 466 V)2

Një rritje e volumit telediastolik shoqërohet me:

A) efekt inotrop pozitiv
B) efekt kronotrop negativ
C) efekt batmotrop negativ
D) efekt inotrop negativ
E) takikardi
PS)A

Pyetja 467 V)3

Cila është masa terapeutike e parë më e përshtatshme në trombozën venoze të anësive të poshtme?

A) pushim absolut
B) fashiaturë e kembës së prekur
C) pozicionim lart dhe mbajtje në lagështirë të ngrohtë
D) heqje e trombit pas qartësimit flebografik
E) terapia antikoagulante
PS)E

Pyetja 468 V)2

Lidh defektin anatomik me triaden: zhurmë diastolike në pakësim, reduktim të tonit të II, zhurmë proto-mesosistolike

A) insufiçienca trikuspidale

B) insufiçienca mitrale
C) stenoza e aortës
D) stenoza mitrale
E) insufiçienca aortale
PS)E

Pyetja 469 V)3

Mungesa e Faktorit von Willebrand është shkak për defekte të:

A) hemopoezës
B) mbrojtjes imunitare
C) përthithjes proteinike
D) linfopoiezës
E) koagulimit
PS)E

Pyetja 470 V)2

Acidoza në një diabet të dekompensuar është:

A) direkt e lidhur me shpejtësinë e glukogjenezës
B) e lidhur më së pari me rritjen e përqëndrimit plazmatik të acidit karbonik
C) direkt e lidhur me shpejtësinë e lipolizës dhe ketogjenezës
D) e palidhur me faktorë specifikë
E) e lidhur me moshën e pacientit
PS)C

Pyetja 471 V)3

Cili prej pohimeve të mëposhtme mbi tensionin alveolar të anhidritit karbonik është i vërtetë?

A) është i ngjashëm në të gjitha alveolat
B) është më i lartë në bazat pulmonare
C) është direkt proporcional me fraksionin inspirator të oksigjenit
D) rritet progresivisht me moshën
E) është më i lartë në apekset pulmonare
PS)B

Pyetja 472 V)1

Nje grua 49 vjeçare paraqet kollë produktive, ethe me frisone, opacitet homogjen në lobin pulmonar medial dex. Ekzaminimi bakterioskopik i ekspektorantit evidenton koke gram pozitive. Cili agjent etiologjik ka mundësi të jetë më i akuzuari ?

A) Mycoplasma pneumonie
B) Streptococcus pneumonie

C) Staphylococcus aureus
D) Legionela pneumophila
E) Mycobacterium tuberculosis
PS)B

Pyetja 473 V)1

Cili është medikamenti më i përdorur për kontrollin e inflamacionit të rrugëve ajrore tek një pacient astmatik?

A) Kortikosteroid në rrugë sistemike
B) Kortikosteroid në rrugë inhalatore
C) Teofilina
D) Inhibitori i Cox-2
E) Beta-2 agonisti
PS)B

Pyetja 474 V)1

Vendi më i shpeshtë i hemorragjive cerebrale është:

A) Cerebelumi
B) Cauda
C) Truncus cerebri
D) Capsula interna
E) Nucleus ruber
PS)D

Pyetja 475 V)1

Qelizat akustike janë të lokalizuara në nivel të:

A) Membranes Reissner
B) Organit të Cortit
C) Kanalit koklear
D) Utrikulit
E) Sakulit
PS)B

Pyetja 476 V)2

Mendimi në konfuzionin mendor është:

A) I kthjellët dhe i logjikshëm
B) Jo i logjikshëm dhe i fragmentarizuar
C) I shpejtuar por i logjikshëm
D) J mbushur me ide obsesive

E) Qartësisht delirant
PS)B

Pyetja 477 V)1

Në cilën nga këto artropati aspekti radiologjik artikular është plotësisht negativ?

A) Sindroma e Felty
B) Artrit reumatoid
C) Podagër kronike
D) Artrozë
E) Reumatizmi artikular akut
PS)E

Pyetja 478 V)1

Cila nga citokinat e mëposhtme është thelbësore për proliferimin e qelizave T në përgjigjen imunitare?

A) IL-1
B) IL-2
C) IL-6
D) GM-CSF
E) G-CSF
PS)B

Pyetja 479 V)1

Cili nga ekzaminimet e mëposhtëm duhet të bëhet fillimisht për një burrë 64 vjeçar që ka ikter prej 4 javësh?

A) Echografia
B) CT skaner
C) Kolangiopankreatografia endoskopike
D) Kolangiografia transhepatike perkutane
E) Koleshintigrafia
PS)A

Pyetja 480 V)2

Piku i LH-së në pubertet është:

A) Mungues
B) Diurn
C) Nokturn
D) Në raport me pikun e kortizolit
E) I ndryshueshëm

PS)C

Pyetja 481 V)1

Aspekti histologjik 'në mozaik' është tipik për:

A) Osteomën osteoide
B) Sëmundjen e Camerati-Engelman
C) Morbus Paget
D) Sëmundjen e Albers-Schoenberg
E) Osteomielitin kronik
PS)C

Pyetja 482 V)1

Të gjitha rrethanat e mëposhtme përfaqësojnë faktorët e riskut të kolelitiazës kolesterinike, përveç:

A) Obezitetit
B) Terapisë me clofibrate
C) Terapisë me estrogjenike
D) Rezeksionit kirurgjikal të ileusit
E) Rekto-kolitit ulceroz
PS)E

Pyetja 483 V)2

Një embol i madh që bllokon arterien pulmonare të djathtë mund ta ketë origjinën:

A) Nga atriumi i majtë
B) Nga arteria subklavie e djathtë
C) Nga vena pulmonare e djathtë
D) Nga vena axilare e majtë
E) Nga ventrikuli i majtë
PS)D

Pyetja 484 V)1

Çfarë është një mesazh paradoksal?

A) Është një mesazh që pohon diçka në një nivel (psh verbal)Dhe kundërshton në një nivel tjetër (psh jo verbal) .
B) Është një mesazh negativ duke mos patur mundësinë e komenteve.
C) Është një mesazh i karakterizuar nga ironia.
D) Është një mesazh i tërthortë.
E) Është një mesazh autoritar.
PS)A

Pyetja 485 V)1

Karakteriskat e edemës pulmonare karakteristikat e mëposhtme, përveç:

A) Dispnesë
B) Dhimbjes pleurale
C) Kollës
D) Raleve në bazat pulmonare
E) Alteracioneve radiologjike
PS)B

Pyetja 486 V)2

Sindroma e Waterhouse-Friderichsen provokohet nga:

A) Trauma kraniale
B) Tromboza e a.koronare të djathtë
C) K.I.D (koagulimi intravaskular i diseminuar)
D) Hipertensioni arterial
E) Hipotiroidizmi
PS)C

Pyetja 487 V)1

Me termin 'efekt të kalimit të parë' kuptojmë:

A) Efektin e parë që një medikament përcakton kur mbërrin në vendin e veprimit
B) Efektet neurologjike që një medikament jep gjate kalimit të parë në sistemin nervor qendror
C) Biotransformimin e plotë që medikamenti pëson në kalimin e parë përmes mëlçisë
D) Eleminimin e plotë të medikamentit në kalimin e tij të parë përmes veshkës
E) Efektin intestinal të një medikamenti të administruar per os
PS)C

Pyetja 488 V)1

Përqindja vdekshmërisë foshnjore është raporti midis:

A) Numrit vjetor të të vdekurve në moshë më pak se një vjeç dhe numrit të lindjeve (të gjallë ose të vdekur) në të njëjtin vit
B) Numrit vjetor të vdekjeve tek fëmijet me moshë me pak se se një vjeç dhe numrit të të lindurve gjallë në të njëjtin vit
C) Numrit të vdekjeve në 28 ditët e para të jetës dhe numrit të të lindurve gjallë në një vit
D) Numrit të të lindurve të vdekur plus (+) numrin e të vdekurve në javën e parë dhe numrit të të lindurve gjallë plus (+) numrit të të lindurve të vdekur
E) Numrit të vdekjeve në një vit dhe popullatës infantile (=8 vjeç)

PS)B

Pyetja 489 V)1

Me hermafrodizëm të vërtetë nënkuptohet:

A) Prania e njëkohshme e testikulit dhe uterusit
B) Prania e njëkohshme e penisit dhe uterusit
C) Prania e njëkohshme e indit ovarian dhe testikular
D) Prania e kavitetit vaginal dhe testikujve
E) Organe genitale te padiferencuara, hipertrofi klitori dhe fuzionim labio-scrotal
PS)C

Pyetja 490 V)1

Inhibitor i enzimës xantin-oksidaze është medikamenti që quhet:

A) Probenicid.
B) Metotrexate.
C) Allopurinol.
D) Etambutol.
E) Metoprolol.
PS)C

Pyetja 491 V)2

Në sklerozën sistemike progresive, rezultati laboratorik më i rëndesishem në diagnozë është:

A) Prania e faktorit reumatoid në serum.
B) Prania e antikorpeve antinukleare.
C) Pozitiviteti i testeve biologjike të inflamacionit.
D) Eozinofilia.
E) Rritja e hidroksiproliniurisë.
PS)B

Pyetja 492 V)1

Endospora është:

A) Një etapë e detyrueshme e ciklit të jetës së prokarioteve.
B) Një formë e veçantë riprodhimi e disa bakterieve Gram-pozitive.
C) Një formë e veçantë riprodhimi e disa bakterieve Gram-negative.
D) Një fleksion extern i paretit bakterial.
E) Një formë e rezistencës ndaj kushteve ambientale te pafavorshme.
PS)E

Pyetja 493 V)1

Nuk bën pjesë tek vendet e privilegjuara imunologjike:

A) Truri.
B) Testikujt.
C) Apendiksi .
D) Kornea.
E) Dhoma anteriore e syrit.
PS)C

Pyetja 494 V)1

Simptoma e hershme më e zakonshme në embolinë pulmonare ështëNJe

A) Dispnea.
B) Cianoza.
C) Hemoptisia.
D) Edema e anesive inferiore.
E) Dhimbje torakale te lidhura me frymarrjen.
PS)A

Pyetja 495 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme është manifestim alergjik nga medikamentet?

A) Lupus eritematoz nga procainamidi
B) Të vjellat nga estrogjeniket
C) Insuficienca kardiake nga beta-bllokuesit
D) Agranulocitoza nga anti-neoplaziket alkilante
E) Ulcera gastrike nga salicilatet
PS)A

Pyetja 496 V)1

Në lidhje me ndërveprimet host-parazit, flora mikrobike intestinale

A) Ka një rol fiziologjik.
B) Formohet nga parazitët.
C) Formohet nga patogenët oportunistë.
D) Eshtë kercunuese për hostin.
E) Favorizon mbivendosjen e patogenëve të jashtëm.
PS)A

Pyetja 497 V)1

Prania e dhimbjes torakale retro-sternale, dispnesë, hemoptizisë, hypotensionit arterial dhe hipoksisë shkakton

A) Pneumoninë lobare.
B) IAM të komplikuar.
C) Edemën pulmonare.
D) Pneumotoraksin.
E) Perikarditin.
PS)C

Pyetja 498 V)1

Cili nga tumoret e mëposhtëm nuk bashkëshoqëron AIDS?

A) Sarcoma e Kaposit
B) Carcinoma e cervix-it uterin
C) Carcinoma e gjirit
D) Limfoma Jo-Hodgkiniane me malinjitet të shtuar
E) Limfoma cerebrale
PS)C

Pyetja 499 V)1

Tetraciklinat janë të efektshme për të gjitha infeksionet e mëposhtëm, përveç:

A) Brucellozës.
B) Kolerës.
C) Candidosis.
D) Rikeciosis.
E) Amebiasis.
PS)C

Pyetja 500 V)1

Cili nga faktorët e mëposhtëm konsiderohet si faktor risku i rëndësishëm për karcinomën skuamoze të ezofagut?

A) Ekspozim i shtuar i mukozës ezofageale ndaj acidit.
B) Refluksi gastro-ezofageal.
C) Obeziteti.
D) Alkooli.
E) Kandidoza ezofageale.
PS)D

Pyetja 501 V)1

Simptomat dhe shenjat klasike të kolangitit akut janë:

A) Të vjella biliare, dhimbje në hypokondrin e djathtë, ikter

B) Ethe, të vjella biliare, leukocitoze neutrofilike
C) Dhimbje në hypokondrin e djathtë, melena, ethe
D) Dhimbje në hypokondrin e djathtë, ikter, ethe
E) Leukocitoze neutrofilike, melena, të vjella ushqimore
PS)D

Pyetja 502 V)1

Cila nga alterimet EKG-ive të mëposhtme nuk është e pranishme në perikarditin akut?

A) Supranivelin e segmentit S-T
B) Prania e valëve Q në derivacionet prekordiale
C) Inversionin e valës T në derivacionet prekordiale
D) Kompleksi QRS me voltazh të ulur
E) Aritmi atriale
PS)B

Pyetja 503 V)1

Markuesi më specifik i diagnozës bio-humorale'enzimatike' të infarktit akut të miokardit përfaqësohet nga:

A) LDH-ëja.
B) GOT-i
C) Mioglobina
D) Troponina
E) Kolinesteraza
PS)D

Pyetja 504 V)2

Një grua e re dëshiron të shkojë në Afrikën Qendrore për turizëm. Profilaksia me meflokinë për malarjen:

A) Nuk duhet të kryhet sepse efektshmëria e saj është e debatueshëm.
B) Do të bëhet vetëm nëse do të shkojë në vendet ku P. Vivax është endemik.
C) Duhet të behet duke u nisur nga një ditë para nisjes drejt zonës endemike dhe do të perfundoje një javë para rikthimit në atdhe.
D) Duhet të realizohet duke u nisur një javë para nisjes, gjatë gjithë qëndrimit dhe të vazhdohet deri 4 jave pas rikthimit.
E) Nuk duhet të realizohet nëse pacientja është shtatzënë, sepse është vërtetuar se risku i pickimit të mushkonjës Anopheles është tepër i ulët tek gratë shtatzëna.
PS)D

Pyetja 505 V)1

Cili është vendi kryesor i degradimit të insulinës?

A) Veshka
B) Hepari
C) Pulmoni
D) Indi muskular
E) Indi dhjamor
PS)B

Pyetja 506 V)1

Një rritje e Transferinemisë së pamaturuar vihet re:

A) Në anemine hemolitike.
B) Në hemokromatozën idiopatike.
C) Në aneminë hipokromike hiposideremike.
D) Në aneminë megaloblastike.
E) Në aneminë aplazike.
PS)C

Pyetja 507 V)2

Në rast të apendisitit akut, një eksplorim rektal dhe/ose vaginal i dhimbshëm, në përgjithësi shkakton:

A) Piosalpingit.
B) Fistule rekto-vaginale.
C) Cistit adjacent.
D) Peritonit endopelvik.
E) Peritonit difuz.
PS)D

Pyetja 508 V)2

Cili nga risqet maternale të mëposhtëm shtohet në shtatzënësinë gemelare?

A) Infeksioni i rrugeve urinare
B) Hipertensioni i induktuar nga shtatzënësia.
C) Diabeti gestacional.
D) Nivele të ulëta të alfa-feto proteinës serike tek nëna.
E) Kandidoza vaginale
PS)B

Pyetja 509 V)1

Cili është komplikacioni që pason një okluzion intestinal të sipërm?

A) Infarkti i miokardit

B) Nekroza tubulare
C) Anemia severe
D) Septicemia
E) Dizekuilibri elektrolitik
PS)E

Pyetja 510 V)1

Në cilën nga hemopatitë e mëposhtme është i pranishëm një shtim i HbA2 ?

A) Hemofili
B) Talasemia minore
C) Purpura trombocitopenike idiopatike
D) Limfoma Hodgkin
E) Leucemia limfoide kronike
PS)B

Pyetja 511 V)1

Mastocitet e subjekteve alergjike paraqesin në siperfaqen qelizore:

A) IgE specifike
B) IgA specifike
C) Antikorpet anti-IgE
D) IgG specifike
E) IgA sekretore
PS)A

Pyetja 512 V)1

Kimioterapia antiblastike ka nje veprim:

A) Lokal.
B) Sistemik.
C) Të dyja të mësipërmet (lokal dhe sitemik).
D) Në bazë të seksit të pacientit.
E) Në bazë të moshës së pacientit.
PS)B

Pyetja 513 V)1

Fibrat nervore të mielinizuara të një nervi periferik përbëhen nga:

A) Aksoni, astrocitet dhe membrane bazale.
B) Aksoni, dendritet dhe membrane bazale.
C) Aksoni, mbeshtjellja mielinike dhe membrana bazale.
D) Aksoni dhe oligodendrocitet.

E) Neuroni, mbështjellja mielinike dhe membrana bazale.
PS)C

Pyetja 514 V)1

Hiperuricemia haset shpesh në:

A) Leuceminë mieloide kronike nën trajtim citolitik.
B) Mononukleoze infektive.
C) Hemofili.
D) Sindromën Gilbert.
E) Aplazinë medulare.
PS)A

Pyetja 515 V)1

Infeksioni nozokomial më i shpeshtë është:

A) Infeksioni i plagës operatore.
B) Bakteremia e kateterit venoz.
C) Infeksioni i rrugëve urinare.
D) Pneumonia.
E) Diarreja nga variante rezistente ndaj antibiotikeve të zakonshëm.
PS)C

Pyetja 516 V)1

Embolia e arteries pulmonare pasohet nga:

A) Pneumotoraksi.
B) Atelektazia.
C) Infarkti pulmonar.
D) Sindromi i Asman-Redecker.
E) Sindromi i Bernard-Horner.
PS)C

Pyetja 517 V)2

Përse karcinoma pulmonare skuamoze quhet ndryshe 'kanceri-abces'?

A) Sepse shkakton një nekrozë likuidiene centrale
B) Sepse shkakton një nekrozë koagulative centrale
C) Sepse shkakton një nekrozë supurative në indet adjacente
D) Të gjitha tipet e neoplazive pulmonare përkufizohen në këtë mënyrë
E) Asnje tip neoplazie pulmonare nuk përkufizohet në këtë mënyrë
PS)A

Pyetja 518 V)1

Mediatorët e para-formuar të mastociteve dhe bazofileve janë:

A) Prostaglandina.
B) TNF alfa.
C) Histamina.
D) Leukotrieni.
E) IL-3.
PS)C

Pyetja 519 V)2

Një vajzë 2-vjeçare ishte në gjendje të mirë deri para 10 orësh, kur fillon të paraqesë letargji, të vjella, të qara të përsëritura me ndërprerje , me retraksion të anësive të poshtme mbi abdomen. Në spital paraqet fece në ngjyre kafe. Diagnoza më e mun
A) Stenozes pilorike.
B) Apendisitit.
C) Infeksionit të rrugëve urinare.
D) Invaginacionit intestinal.
E) Ulcerës duodenale.
PS)D

Pyetja 520 V)1

Në Morbus Hodgkin, në përgjithësi janë të pranishme të gjitha shenjat klinike të mëposhtme, përveç :

A) Rënies në peshë.
B) Etheve.
C) Pruritis.
D) Djersitjes nokturne.
E) Hipertensionit arterial.
PS)E

Pyetja 521 V)1

Glukagoni sekretohet:

A) Kur janë të ulëta nivelet e glukozës në gjak.
B) Kur janë të larta nivelet e glukozës në gjak.
C) Në vijim të një inflamacioni.
D) Në vijim të një stimuli hormonal
E) Pas nje vakti ushqimor
PS)A

Pyetja 522 V)1

Sideremia është e rritur në:

A) Aklorhidrinë gastrike.
B) Hypovitaminozën C.
C) Hypovitaminozën B6.
D) Aneminë hemolitike.
E) Aneminë hipokromike.
PS)D

Pyetja 523 V)1

Hipoventilimi si pasojë e depresionit të qendrës respiratore shfaqet me:

A) Hypoksia nga hypokapb=nia.
B) Hypoksia dhe hiperkapnia.
C) PO2 normal dhe hiperkapnia.
D) Hypoksia dhe PO2 normal.
E) PO2 normal dhe hypokapnia.
PS)B

Pyetja 524 V)2

Cila nga patologjitë kronike të organeve mund të shkaktojë osteodistrofi?

A) Miokardioskleroza
B) Hepatopatia kronike
C) Insuficienca renale kronike
D) Gastriti kronik
E) Pankreatiti kronik
PS)C

Pyetja 525 V)1

Cili nga faktorët e mëposhtëm kufizon përdorimin diagnostik të radiografisë tradicionale në studimin e trurit?

A) Diferenca tepër e vogël e imbibimit të rrezatimit midis strukturave të ndryshme të parenkimës cerebrale
B) Imbibim i njëjtë i rrezatimit nga ana e calvarias dhe trurit
C) Prania e hapësirave likuorale
D) Pamundësia e vizualizimit të kalcifikimeve.
E) Ekzistenca e barrierës hemato-encefalike
PS)A

Pyetja 526 V)1

Cili nga keto pohime është i gabuar?

A) Oftalmopatia Basedowiene mund të paraprijë ose të pasojë disfunksionin e tiroides.
B) TSH-ëja është e ulët në morbus Graves.
C) Normalizimi i funksionit të tiroides siguron regresionin e oftalmopatisë Basedowiene
D) Në oftalmopatinë Basedowiene, fibroblastët prodhojnë acid hialuronik që çon në rritje të presionit osmotik indor.
E) Femrat vuajnë nga oftalmopatia basedowiene më shpesh se meshkujt.
PS)C

Pyetja 527 V)1

Çfarë nënkupton shenja e Bauer-it?

A) Shfaqjen e venave pre-tibiale
B) Shfaqjen e dhembjes në pulpën e këmbës nga dorsofleksioni pasiv i sforcuar i këmbës
C) Shfaqjen e dhembjes në palpacionin e fortë të pulpës
D) Mungesën e pulseve arteriale periferike
E) Shfaqjen e dhembjes krampi-formë në pulpë gjatë ecjes
PS)C

Pyetja 528 V)2

Cila nga simptomat e mëposhtme nuk haset në rastin e një gravidance tubarike (extra-uterine)?

A) Dhembje në kuadrantin abdominal inferior
B) Humbje hematike vaginale ose spoting
C) Amenorrhea
D) Proktorragjia
E) Dhembje në sup
PS)D

Pyetja 529 V)1

Vëzhgimi i ngjarjeve që ndodhin 'ex novo', gjatë një periudhe kohe të caktuar, në një popullatë në të cilën nuk ishin shfaqur më parë nënkupton:

A) Prevalencë.
B) Frekuencë.
C) Prevalencë periodike.
D) Incidencë.
E) Përqindje
PS)D

Pyetja 530 V)1

Artikulacionet më të prekura në artritin reumatoid janë:

A) Radiokarpale dhe të dorës.
B) Coxofemorale.
C) Akromio-klavikulare.
D) Temporo-mandibulare.
E) Genu.
PS)A

Pyetja 531 V)2

Cila është forma më e shpeshtë e pneumo-mediastinit?

A) Idiopatike
B) Spontanisht-patologjike
C) Esenciale
D) Traumatike
E) Iatrogene
PS)D

Pyetja 532 V)1

Anoreksia nervosa paraqet shpesh:

A) Alopecia.
B) Amenorrhea.
C) Sprue celiaki.
D) ?rregullime të gjumit.
E) Cefale.
PS)B

Pyetja 533 V)1

Diagnoza e infarktit të miokardit konfirmohet kryesisht me:

A) Matjen e TA-së.
B) EKG-në dhe dozimin e CPK-ës dhe troponinës I.
C) Ekokardiogramën bi-direksionale.
D) Radiografi toraksi.
E) Matjen e presionit venoz qendror.
PS)B

Pyetja 534 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar?

A) Viruset janë agjentë të fuqishëm piogenikë.

B) Bakteret patogenë që penetrojnë në organizëm shpesh provokojnë infeksione të rënda.
C) Disa baktere mund të jenë 'gëlltitur' nga fagocitet por jo "tretur/shpërbërë'.
D) Sasia, zgjatja e ekspozimit dhe patogeniciteti i një agjenti modifikon pergjigjen imune.
E) Bakteret e fagocituara para se të shpërbëhen duhet të vriten.
PS)A

Pyetja 535 V)1

Shërimi biologjik i një frakture karakterizohet nga:

A) Reduktimi anatomik i fragmenteve.
B) Rikthimi i shpejtë funksional.
C) Formimi i kallusit kockor.
D) Mungesa e komplikacioneve të hershme ose tardive.
E) Nevoja e një traksioni skeletik.
PS)C

Pyetja 536 V)2

Struktura kimike e beta-endorfinës është:

A) Aminoacidike.
B) Glikoproteinike.
C) Polipeptidike.
D) Steroidiene.
E) Lipoproteinike.
PS)C

Pyetja 537 V)1

Astma tek një fëmijë 6-vjeçar mund të lidhet me të gjitha alternativat e mëposhtme, përveç:

A) Anamnezës familjare për atopi.
B) Alergjisë nga agjentët inhalatorë.
C) Alergjisë ushqimore.
D) Infeksioneve virale.
E) Deficitit e IgA -asë.
PS)E

Pyetja 538 V)1

Tek mashkulli, hiperprolaktinemia mund të induktojë:

A) Infertilitet sekretor+impotencë ereksioni.
B) Infertilitet sekretor.
C) Infertilitet ekskretor.
D) Impotence ereksioni.

E) Hirsutizem.
PS)A

Pyetja 539 V)1

Në bllokun e degës, vonesa e konduksionit është në nivel:

A) Të nyjes atrio-ventrikulare.
B) Të njerës nga degët e tufës së His-it.
C) Të sinusit atrial.
D) Interatrial.
E) Të fillimit të tufës së His-it.
PS)B

Pyetja 540 V)1

Aldosteroni:

A) Prodhohet në medulën renale.
B) Prodhohet në korteksin renal.
C) Hipersekretimi i tij shkakton sindromën Cushing.
D) Rrit ri-absorbimin tubular të Na-së.
E) Rrit ri-absorbimin tubular të K-së.
PS)D

Pyetja 541 V)2

Cili është gjeni onko-supresor që akuzohet shpesh në gjenezën e tumoreve pulmonare?

A) P47
B) P53
C) RAS
D) Myc
E) Fos
PS)B

Pyetja 542 V)1

Skleroza multiple quhet ndryshe edhe:

A) Sklerodermi.
B) Sklerozë sistemike.
C) Sklerozë sistemike progresive.
D) Sklerozë me pllaka.
E) Arteriosklerozë polifokale
PS)D

Pyetja 543 V)1

Cila nga neoplazitë e mëposhtme shkaktohet me siguri nga H. Pylori?

A) Adenocarcinoma e ezofagut.
B) Adenocarcinoma e stomakut.
C) Limfoma gastrike primitive MALT.
D) Leiomiosarkoma e stomakut.
E) Fibrosarkoma e stomakut.
PS)C

Pyetja 544 V)1

Në një ind me inflamacion akut, në mënyrë karakteristike hasim një numër të madh:

A) Të qelizave plazmatike.
B) Të polimorfonukleareve neutrofile .
C) Të eritrociteve.
D) Të qelizave gjigande.
E) Të limfociteve.
PS)B

Pyetja 545 V)3

Në cilin tip patologjie indikohet interventi i gastro(fundo)plication sipas Nissen?

A) Refluksin veziko-ureteral
B) Stenoza hipertrofike të Pilorit.
C) Refluksi gastro-ezofageal
D) Ulcera peptike
E) Megaezofag
PS)C

Pyetja 546 V)1

Cila nga molekulat e mëposhtme mund të kalojë membranën përmes difuzionit të thjeshtë:

A) Molekula e oksigjenit.
B) Molekula proteinike jonike.
C) Molekula e ujit.
D) Joni i kaliumit.
E) Acidi yndyror.
PS)A

Pyetja 547 V)1

Hiperventilimi nënkupton:

A) Acidozë respiratore.
B) Alkalozë respiratore.
C) Hiperkapni.
D) Hiperoksigjenim.
E) Hipotension arterial.
PS)B

Pyetja 548 V)1

Një burrë 50-vjeçar, ndërkohë që shihte televizor, tregon për dhimbje retrosternale me irradim në krahun e majtë. Simptomatologjia regredon spontanisht në harkun e një gjysmë ore dhe rishfaqet me vonë në gjumin e natës. Çfarë diagnoze provizore do të bë
A) Infarkti subendokardial i sigurtë
B) Angina e efortit
C) Sindromi koronarien akut
D) Arteriti Kawasaki
E) Angina stabile
PS)C

Pyetja 549 V)1

Me cilën mënyrë trashëgimie transmetohet distrofia muskulare e Duchenne?

A) Recesive e lidhur me kromozomin X
B) Autosomale recesive
C) Multifaktoriale
D) Dominante e lidhur me kromozomin X
E) Autozomale dominante
PS)A

Pyetja 550 V)1

Manovra e Giordano-s konsiston në:

A) Palpacionin e llozhave renale nen harkun kostal ekstern të muskulit quadratum.
B) Perkusioni i llozhave renale mbi harkun kostal extern te muskulit quadratum.
C) Perkusionin e llozhave renale mbi harkun kostal në nivel të fiankeve.
D) Kompresionin e llozhave renale mbi harkun kostal të fiankeve.
E) Perkusionin e llozhave renale në nivel të brinjëve të fundit në paravertebral.
PS)B

Pyetja 551 V)1

Divertikuliti i Meckel-it mund të shkaktohet nga abdomeni akut:

A) Vetëm tek adultët.

B) E vërtetë.
C) E vërtetë, por vetëm nëse shoqërohet me apendisit akut.
D) Nuk është e vërtetë.
E) Vetëm tek një pacient që i është nënshtruar më pare laparotomisë eksplorative.
PS)B

Pyetja 552 V)1

Tek adulti i shëndoshë feritinemia është:

A) Në përpjestim të zhdrejtë me sasinë e depozituar të hekurit.
B) Në proporcion të drejtë me volumin total eritrocitar.
C) Në proporcion të drejtë me sasinë e depozituar të hekurit.
D) Në proporcion të drejtë me transferineminë.
E) Në proporcion të zhdrejtë me sidereminë.
PS)C

Pyetja 553 V)2

Cili prej hormoneve të mëposhtëm nuk shpjegon veprimin e vertetë integrues me receptorët nuklearë?

A) Testosteroni
B) Aldosteroni
C) Estradioloi
D) Glukagoni
E) Kortizoli
PS)D

Pyetja 554 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm rreth vështirësisë diagnostike tek një pacient me ethe është i gabuar?

A) Disa mikro-organizma izolohen dhe kultivohen me vështirësi.
B) Është i nevojshëm një laborator serologjik shumë i specializuar për të përcaktuar diagnozën.
C) Radiologjia e toraksit nuk sjell asnjë informacion për ekzaminimin objektiv.
D) Pacienti mund të mbajë të fshehur të dhëna anamnestike shumë të rëndësishme.
E) Disa terapi të mëparshme ose konkomitante mund të jenë ngatërruese .
PS)C

Pyetja 555 V)1

Cili nga medikamentet përdoret në trajtimin e infeksioneve sistemike nga funget ?

A) Ciproflaksacina

B) Amfotericina B
C) Penicilina
D) Amiodaroni
E) Streptomicina
PS)B

Pyetja 556 V)1

Mastiti akut më shpesh vërtetohet gjatë:

A) Ciklit menstrual normal
B) Pubertetit
C) Laktacionit
D) Shtatzënësisë.
E) Menopauzës.
PS)C

Pyetja 557 V)1

Në hiperparatiroidizëm, përqindja plazmatike e kalciumit dhe fosforit modifikohet. Cila nga këto rrethana është e vërtetë?

A) Hyperkalcemi, hyperfosforemi
B) Hyperkalcemi, hypofosforemi
C) Hypokalcemi, hypofosforemi
D) Hypokalcemi, hyperfosforemi
E) Normokalcemi, normofosforemi
PS)B

Pyetja 558 V)1

Të gjithë medikamentet e mëposhtëm mund të perdoren në trajtimin e statutit astmatik, përveç:

A) Salbutamolit.
B) Oksigjenit.
C) Kortikosteroirdit.
D) Aminofilinës.
E) Fenobarbitalit
PS)E

Pyetja 559 V)1

Punksion-biopsia pulmonare është e vlershme për diagnozën e:

A) Bronkoektazisë.
B) Emfizemës.

C) Tbc miliar.
D) Kancerit bronkogen.
E) Fistulës arteriovenoze.
PS)D

Pyetja 560 V)2

Sindroma e Plummer-Vinson konsiston në:

A) Purpura trombocitopenike, diarre, ataksi.
B) Divertikul ezofageal me ulcera peptike.
C) Piroze retrosternale dhe regurgitim acidik.
D) Anemi, disfagi, glosit.
E) Sindromë gastro-ezofageale.
PS)D

Pyetja 561 V)1

Faktori kryesor i riskut për nekrozën avaskulare të 'caput femuri' është:

A) Diabeti.
B) Podagra.
C) Terapia kortikoide.
D) Hiperparatiroidizimi.
E) Hipotiroidizmi.
PS)C

Pyetja 562 V)1

Shkaku i hipertensionit sekondar sistolo-diastolik është:

A) Hemorragjia.
B) Miokarditi.
C) Glomerulonefriti akut.
D) Tuberkulozi.
E) IAM.
PS)C

Pyetja 563 V)2

Cila nga etiologjitë e mëposhtme të meningitit kërkon fillimin e një antibio-profilaksie me të afërmit e pacientit?

A) Listeria monocitogenes
B) Streptococcus pneumonie
C) Neisseria meningitis
D) Mycobacterium tuberculosi

E) Escheria Coli
PS)C

Pyetja 564 V)2

Terapia antikoagulante me warfarine mund të shoqërohet me nekroza kutane tek pacientët e prekur nga nje nga patologjia e:

A) Deficitit të antitrombines III.
B) Deficitit të proteines C.
C) Deficitit të faktorit VIII.
D) Deficitit të plasminogenit.
E) Disfibrinogenemisë.
PS)B

Pyetja 565 V)1

Tek pacientët e prekur nga kontuzioni kardiak nuk duhet të administrohen:

A) Medikamente antiaritmike.
B) Medikamente anksiolitike.
C) Medikamente antikoagulante.
D) Medikamente anlagjezike.
E) Medikamente antibiotike
PS)C

Pyetja 566 V)1

Cila nga këto qeliza nuk bën pjesë tek lëkura?

A) Melanociti
B) Celulat e Langerhansit
C) Celulat e Meckel
D) Fibroblastet
E) Celulat e Clara-s
PS)E

Pyetja 567 V)1

Gishtat e Hipokratit konsistojnë:

A) Në sklerodaktilinë.
B) Në ngjyrën cianotike të shprehur.
C) Në rritjen e falangës së fundit me thonjtë si xhama sahati.
D) Në shfaqjen e noduseve tendinoze të dhimbshëm në falangje.
E) Në rënien e thonjëve.
PS)C

Pyetja 568 V)1

Në cilën nga koagulopatitë e mëposhtme hasen në një frekuencë të shtuar hemartrozat e artikulacione të mëdha ?

A) Trombocitemia idiopatike
B) Deficiti i protrombinës
C) Koagulimi intravaskular i diseminuar
D) Hemofilia A, B
E) Hiperfibrinolize
PS)D

Pyetja 569 V)2

Cili pohim është i saktë? Të ashtuquajturat qeliza në formë kokërr tërshëre (oat cells) janë tipike për:

A) adenokarcinomën polmonare
B) karcinomën mamare
C) tumorin Pancoast
D) karcinomën polmonare me qeliza dysheme të pakeratinizuara
E) karcinomë bronkiale me qeliza të vogla
PS)E

Pyetja 570 V)1

Cila është ecuria e glomerulonefritit akut post-streptokoksik?

A) evoluon drejt insufiçencës renale kronike
B) shërohet
C) evoluon drejt sindromës nefrozike
D) mbetje proteineurie
E) mbetje hipertensioni arterial
PS)B

Pyetja 571 V)2

Cili është shkaku më i mundshëm i tiroiditit subakut?

A) mungesa e jodit
B) marrja e ilaçeve që përmbajnë jod
C) infeksioni mykotik
D) infeksioni viral
E) shintigrafi të përsëritura të tiroides
PS)D

Pyetja 572 V)2

Cili prej shkaqeve të mëposhtëm të insufiçiencës renale akute do të klasifikohet si "postrenal"?

A) insuficiencë kardiake
B) septicemi
C) kalcifikime
D) rabdomiolizë
E) glomerulonefrit akut
PS)C

Pyetja 573 V)2

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me bilirubinën e konjuguar është i saktë?

A) Është forma e bilirubinës më e tretshme që sekretohet nëpërmjet bilës
B) Vjen nga lidhja e albuminës me bilirubinën
C) Prodhohet nga katabolizmi i acideve biliare
D) Është një pararendës i hematinës
E) Shtyn sintezën e vitaminës B12
PS)A

Pyetja 574 V)1

Eksperimentimi tek njeriu duhet të ketë aprovimin paraprak nga ana e një komiteti etik të pavarur:

A) vetëm në rast eksperimentimi tek të miturit ose personat e paaftë
B) në asnjë rast
C) në çdo rast
D) kur mungon aprovimi i subjektit që po eksperimentohet
E) kur eksperimentimi paraqet rreziqe potenciale
PS)C

Pyetja 575 V)1

Fibrilacioni ventrikular karakterizohet klinikisht nga:

A) kardiomiopatia
B) dispnea e rëndë
C) infarkti akut
D) arresti kardiocirkulator
E) cianoza
PS)D

Pyetja 576 V)2

Rezistenca ndaj insulinës mund të shkaktohet nga:

A) një alterim pre-receptorial, receptorial dhe post-receptorial
B) vetëm nga një alteracion i tejçimit të sinjalit
C) një alterim i molekulës së insulinës
D) një defekt sasior i receptorëve
E) prania e antikorpeve bllokuese të lidhjes së receptorit me insulinën
PS)A

Pyetja 577 V)1

Ngjyra e zakonshme kafe e feçeve varet nga prania e:

A) sterkobilinës
B) biliverdinës
C) bilirubinës
D) verdoglobinës
E) acidit kolik
PS)A

Pyetja 578 V)1

Tek cilat inde ndodh glikogenoliza?

A) mëlçi dhe muskul
B) mëlçi, muskul kardiak dhe adipocitet
C) miokard, veshkë, mushkëri dhe mëlçi
D) muskul, zorrë dhe mëlçi
E) muskul i lëmuar dhe muskul i vijëzuar
PS)A

Pyetja 579 V)2

Një hemianopsi e djathtë mund të shkaktohet nga një dëmtim:

A) i nervit optic
B) i kiazmës optike
C) i retinës së djathtë
D) i kores oksipitale të djathtë
E) i traktit optik të majtë
PS)E

Pyetja 580 V)1

Cili është stimuli ndaj të cilit janë më të ndjeshëm kemoceptorët e karotides?

A) hipokapnia
B) alkaloza respiratore
C) alkaloza metabolike
D) hiperkapnia
E) anoksiemia
PS)E

Pyetja 581 V)2

Një inflamacion granulomatoze është karakteristike e:

A) artritit Takayasu
B) LES
C) panartrit nodoz
D) sklerodermisë
E) sindromës Sjorgen
PS)A

Pyetja 582 V)1

Në cilën prej sëmundjeve të mëposhtme haset njolla në ngjyrë kafe të zbardhur në lëkurë?

A) Recklinghausen
B) Bourneville
C) Sturge - Weber
D) Tay - Sachs
E) Von Hippel Lindau
PS)A

Pyetja 583 V)1

Feokromocitoma është një neoplazi e cilit prej këtyre organeve ose indeve?

A) kortikal mbiveshkor
B) qëndror veshkor
C) indi kromafin
D) hipofiza
E) timusi
PS)C

Pyetja 584 V)3

Personaliteti histrionik karakterizohet nga elementët e mëposhtëm me përjashtim të:

A) sjelljes gjithmonë të arsyeshme
B) paqëndrueshmërisë emotive
C) kërkesës për vëmendje

D) varësisë
E) Joshjes
PS)A

Pyetja 585 V)1

Ekzaminimi Doppler-sonografik jep të dhëna në lidhje me:

A) fluksin hematik
B) shpejtësinë mesatare të gjakut tek ena e ekzaminuar
C) shpejtësinë e çastit e gjakut tek ena e ekzaminuar
D) kalibrin tek ena e ekzaminuar
E) drejtimin dhe shpejtësinë e gjakut tek ena e ekzaminuar
PS)E

Pyetja 586 V)1

Cili prej hormoneve të mëposhtëm mund të japë hiponatriemi nëse sekretohet me shumicë?

A) angiotensina II
B) ANP (peptid natriuretic atrial)
C) vazopresinë/adiuretinë
D) aldosterone
E) testosterone
PS)C

Pyetja 587 V)2

Cila prej situatave të mëposhtme paraqet më saktë evolucionin e karcinomës papilare të tiroides?

A) Metastazat nuk janë shumë të shpeshta. Rritja lokale është e shpejtë; infiltrimi i trakesë dhe i enëve të mëdha është i shpeshtë
B) Metastazat dhe invazioni lokal nuk verifikohen praktikisht kurrë, dhe fjala karcinomë është e pavërtetë
C) Janë të shpeshta metastazat kockore të llojit osteolitik, sidomos në nivel vertebrar
D) Shpesh shfaqen metastaza të nyjeve limfatike cervikale; invazioni lokal është i rrallë
E) Përfshirja me metastaza në mënyrë të shpejtë dhe të përhapur e mëlçisë, mushkërive dhe palcës së kurrizit bën që përqindja për të mbijetuar 5 vjet të jetë rreth 10 %
PS)D

1.Fondi B
Pyetja 1 V)1

Zona akustike ndodhet në lobin:

A) oksipital

B) frontal
C) parietal
D) temporal
E) limbik
PS)D

Pyetja 2 V)1

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme rezultojnë të jenë rritur Anti-streptolizinat?

A) gjendje akute e sëmundjes reumatike
B) gjendje nënakute e artridit rheumatoid
C) spondilit ankilosant
D) artropati uretike
E) osteoartrozë e përhapur
PS)A

Pyetja 3 V)1

Kur mund të rezultojë testi i shtatëzanisë pozitiv nga data e mosardhjes së menstruacioneve?

A) pas 5 ditësh
B) pas 20 ditësh
C) pas 28 ditësh
D) pas 40 ditësh
E) pas 60 ditësh
PS)A

Pyetja 4 V)3

Një pacient 75 vjeçar vdes për insufiçencë kardiake kongjestive. Në anamnezë rezulton një histori hipertensioni arterial e largët dhe disa episode angine nga sforcimi. Gjatë autopsisë haset hipertrofi ekscentrike të ventrikulit të majtë të zemrës. Miokar
A) pasoja të ngurtësuara të infarktit të miokardit
B) kardiomiopati dilaktative
C) prolaps i mitrales
D) kardiopati iskemike kronike
E) kardiomiopati aritmogjenike
PS)D

Pyetja 5 V)2

Cili prej gjendjeve të mëposhtme favorizon zhvillimin e peritonitit bakterial spontan?

A) divertikuliti
B) apendiciti
C) përqëndrim i ulët proteinik i lëngut peritoneal

D) paracenteza te përsëritura
E) kolangite të shpeshta
PS)C

Pyetja 6 V)1

Cili prej këtyre medikamenteve çon në Hiperprolaktinemi?

A) metoklopropamidi
B) indometacina
C) cefalosporina
D) furosemide
E) digitalis purpurea
PS)A

Pyetja 7 V)1

Në cilën prej gjendjeve të mëposhtme vërehet shtimi i numrit të trombociteve ?

A) pas splenektomisë
B) sindroma karenciale gravis
C) anemi ekstreme
D) metaplazi mieloide e plazmocitomës
E) metaplazi miloide e leuçemisë
PS)A

Pyetja 8 V)2

Cilat janë ekzaminimet diagnostike kryesore për të bërë diagnozën e sklerozës multiple?

A) CT cerebral, EEG
B) EMG, ekzaminim i lëngut rakido spinal, biopsi e nervit
C) MRI e trurit , ekzaminim i lëngut rakido spinal, potencialet e evokuara multimodale
D) RM e trurit, ekokolordoppler e enëve epiaortike, screening hemokoagulativ
E) TC cerebral, potencialet e evokuara multimodale, biopsi e nervit
PS)C

Pyetja 9 V)2

Trajtimi i vazhdueshem (agresiv):

A) është i ligjshem pasi mjeku ka për detyrë ta nënshtrojë pacientin në trajtimin mjekësor edhe kur në thelb nuk pritet ndonjë benefit për pacientin.
B) është i ligjshem pasi mjeku ka për detyrë që përveçse të mjekojë të pengojë vdekjen me çdo kusht.
C) është këmbëngulja për të vënë pacientin në trajtimin mjekësor kirurgjikal edhe kur nuk ka më mundësi të arsyeshme për të shpëtuar jetën e individit.

D) përbën vepër penale të rëndësishme .
E) ndëshkohet me heqje lirie deri në 5 vjet.
PS)C

Pyetja 10 V)2

Proteina C aktivizohet nga:

A) fibrinogjeni
B) kompleksi trombinë/trombomodulinë
C) kompleksi fibrinogjen/fibronektinë
D) antitrombinë III
E) kompleksi trombinë/ fosfolipide të membranës
PS)B

Pyetja 11 V)2

Në kuadrin e eksperimentimit klinik, farmakovigjilanca ka për qëllim të ushtrojë kontroll mbi barnat:

A) gjatë gjithë kohëzgjatjes së përdorimit të tyre në terapi
B) vetëm për gjashtë muajt e parë nga hyrja në qarkullim
C) vetëm nëse përdoren në ambiente spitali
D) vetëm nëse bëhet fjalë për barna me pagesë
E) para hyrjes së tyre në qarkullim
PS)A

Pyetja 12 V)2

Si është më mirë që të organizohet një terapi antiepileptike tek një femër shtatzënë kur nuk këshillohet pushimi i plotë i përdorimit të mjekimeve?

A) të përdoret një terapi polifarmakologjike ne mënyrë që të kursehet tek doza e çdo ilaçi
B) të përdoret vetëm mënyra e dhënies me injektim
C) të përdoret një medikament i vetëm në doza sa më të vogla që të jetë e mundur
D) të jepet një medikament vetëm në rrugë rektale
E) të vazhdohet me terapinë e mëparshme duke intensifikuar kontrollet hematokimike
PS)C

Pyetja 13 V)1

Ndaj cilës sëmundje janë më të ekspozuar të toksodipendentët nga heroina?

A) silifiz
B) dermatite alergjike
C) encefalopati
D) virus të hepatitit B

E) mononukleozë infektive
PS)D

Pyetja 14 V)2

Postura karakteristike "fetale" vërehet në:

A) insuficiencë kongjestive të qarkullimit
B) morbus Fallot
C) mikromë atriale
D) insuficiencë respiratore
E) miksedemë
PS)B

Pyetja 15 V)3

Vendosja e ajrit në formë "drapëri" ndërmjet heparit dhe diafragmës vërehet gjatë ekzaminimit klinik dhe radiologjik të:

A) interpozicioni të kolonit ndërmjet heparit dhe diafragmës
B) perforacionit intestinal
C) rupturës së bulës enfizematoze pulmonare
D) kistit ajror të lobit pulmonar inferior të djathtë
E) hidropneumotoraksit
PS)B

Pyetja 16 V)3

Cili bakter është pothuajse gjithmonë shkaktari i një endokarditi të ngadaltë?

A) streptokoku beta-hemolitik tip 12
B) streptokoku beta-hemolitik tip 49
C) streptokoku viridans
D) stafilokoku aureus
E) korinebakteri i difteritit
PS)C

Pyetja 17 V)2

Tetania normokalcemike vërehet në:

A) pankreatit akut
B) spazmofili
C) acidozë tubulare
D) avitaminozë D
E) hipoparatiroidizëm primar
PS)B

Pyetja 18 V)3

Gjatë fillimit të leucemisë limfatike kronike nuk është e shpeshtë:

A) limfocitoza medulare
B) limfocitoza absolute në gjakun periferik
C) adenomegalia
D) splenomegalia
E) trombocitopenia e rëndë
PS)E

Pyetja 19 V)2

Në embolinë dhe infarktin pulmonare nuk vërehet:

A) hiperkapnia
B) takipnea
C) kolla
D) hemoptizia
E) hiperbilirubinemia
PS)A

Pyetja 20 V)3

Shenja venoze Kussmaul karakterizohet nga:

A) rënia protodiastolike e presionit të venave të qafës
B) reduktimi i palpueshëm i forcës së pulsit gjatë inspirimit të qetë
C) rritja e presionit venoz jugular gjatë inspirimit
D) rënia e presionit sistolik me 20 mmHg gjatë inspirimit të qetë
E) goditja perikardiake
PS)C

Pyetja 21 V)2

Zmadhimi i ventrikulit të majtë ndodh gjatë:

A) koarktacionit të aortës
B) morbus Ebstein
C) stenozës valvulare pulmonare
D) stenozës mitrale
E) pneumopatisë kronike obstruktive
PS)A

Pyetja 22 V)2

Melanoza jomelanocitare (pra që nuk shkaktohet nga rritja e numrit të melanociteve) vërehet në:

A) hemokromatozë
B) neurofibromatozë
C) melanomë
D) sindromë Albright
E) sindromë neurokutane kongjenitale
PS)A

Pyetja 23 V)3

Insuficienca e pankreasit endokrin shfaq ndonjëherë karakter permanent gjatë formave tardive të:

A) pankreatitit akut
B) pseudokistit pankreatik
C) pankreatitit kronik
D) gastroduodenitit
E) ulçerës duodenale të vjetër
PS)C

Pyetja 24 V)1

Niveli normale i bazave totale në serum është:

A) 20 - 50 m Eq/l
B) 70 - 80 m Eq/l
C) 80 - 100 m Eq/l
D) 145 - 155 m Eq/l
E) 200 - 250 m Eq/l
PS)D

Pyetja 25 V)2

Transplanti ndërmjet individëve të të njëjtës specie por gjenetikisht të ndryshëm quhet:

A) izolog
B) heterolog
C) singjenik
D) allogjenik
E) ksenogjenik
PS)D

Pyetja 26 V)2

Embolia adipoze është më e shpeshtë pas:

A) frakturave të sternumit
B) frakturave të brinjëve
C) hematomave të kofshës
D) frakturave të kockave të gjata
E) frakturave të tekës kraniale
PS)D

Pyetja 27 V)2

Struma është përgjithësisht e dhembshme gjatë:

A) strumës eutiroidiene
B) strumës së thjeshtë post-natale
C) strumës Hashimoto
D) strumës me qeliza gjigande De Quervain
E) strumës nga medikamentet tireostatike
PS)D

Pyetja 28 V)3

Rritja e rezistencave vaskulare pulmonare nga alterimi primar vaskular lokal ndodh në:

A) sarkoidozë
B) pneumokoniozë
C) sindromë Pickwick
D) hipertension pulmonar idiopatik
E) kifoskoliozë
PS)D

Pyetja 29 V)2

Shenja Hill (presioni arterial në gjymtyrët e poshtme shumë më i lartë se sa presioni arterial në gjymtyrët e sipërme) vërehet në:

A) insuficiencë të aortës
B) koarktacion të aortës
C) stenozë mitrale
D) insuficiencë mitrale
E) stenozë të arteries pulmonare
PS)A

Pyetja 30 V)2

Karakteristikë për sindromën Cushing është:

A) melanodermia

B) osteoporoza difuze
C) hipotensioni
D) eozinofilia
E) ekskretimi urinar i reduktuar i 17-hidroksikortikoideve
PS)B

Pyetja 31 V)2

Ulçera peptike duodenale vërehet shpesh gjatë:

A) miksedemës
B) hiperparatiroidizmit
C) anemisë pernicioze Biermer
D) morbus Addison
E) të gjitha të mësipërmet
PS)B

Pyetja 32 V)3

Në pielonefritin akut gjatë periudhës prenatale të gravidancës, cili medikament duhet të evitohet pasi mund të shkaktojë ikter nuklear?

A) ampicilina
B) kolimicina
C) cefalosporina
D) eritromicina
E) sulfamidet
PS)E

Pyetja 33 V)2

Piuria vërehet pothuajse gjithmonë gjatë:

A) nefritit intersticial
B) pielonefritit
C) glomerulonefritit kronik
D) tubulonefrozës
E) nefrosklerozës malinje
PS)B

Pyetja 34 V)2

Te femrat gjatë trimestrit të tretë të shtatzënisë nuk vërehet:

A) rritja në peshë
B) edemat
C) oliguria

D) proteinuria
E) hipotensioni arterial
PS)E

Pyetja 35 V)3

Zgjerimi i hijes mediastinale mund të demonstrohet radiologjikisht në të gjitha patologjitë e mëposhtme. Në cilën prej tyre ajo mund të regredojë në mënyrë spontane?

A) fibrozë mediastinale idiopatike
B) kiste ezofageale
C) kiste bronkiale
D) limfomë malinje
E) liposarkomë
PS)A

Pyetja 36 V)3

Në cilën nga këto hiperbilirubinemi hereditare vërehet prania e trombeve biliare të pakëta gjatë ekzaminimit anatompatologjik?

A) hiperbilirubinemia konstitucionale e Gilbert
B) ikteri Dubin-Johnson
C) ikteri Crigler-Najjar
D) sindroma Rotor
E) të gjitha të mësipërmet
PS)C

Pyetja 37 V)2

Simptomë konstante e kolonit të irritueshëm është:

A) dhembja abdominale
B) diarrea
C) cefalea
D) konstipacioni
E) lemza
PS)A

Pyetja 38 V)2

Normalisht hemoliza fillon të manifestohet pasi eritrocitet fiksohen me një solucion kripor me përqendrim të NaCl:

A) 0,9%
B) 0,8%
C) 0,4%

D) 0,2%
E) 0,1%
PS)C

Pyetja 39 V)2

Cila nga këto substance mund të tamponojë hemorragjinë e shkaktuar nga heparina?

A) manitoli
B) acetazolamidi
C) citrati i natriumit
D) sulfati i protaminës
E) tromeksani
PS)D

Pyetja 40 V)3

Sindroma Albright (acidoza tubulare renale) karakterizohet nga:

A) eleminimi urinar i reduktuar i kalciumit
B) hiperkalcemia
C) hiperkloremia
D) pH urinar i reduktuar
E) pH urinar i rritur
PS)C

Pyetja 41 V)1

Normalisht, në formulën leukocitare, granulocitet bazofile janë:

A) 10 - 12 %
B) 7 - 10 %
C) 5 - 7 %
D) 2 - 5%
E) 0,5 - 1 %
PS)E

Pyetja 42 V)2

Anizopoikilocitoza e eritrociteve do të thotë:

A) prani e mikrociteve
B) ndryshueshmëri e formës së eritrociteve
C) makrocitozë
D) variacion i vëllimit të eritrociteve
E) variacion i formës dhe i vëllimit të eritrociteve
PS)E

Pyetja 43 V)2

Poliglobulia mund të vërehet gjatë:

A) hipernefromës
B) sindromës Zieve
C) uremisë kronike
D) morbus Crohn
E) morbus Simmonds
PS)A

Pyetja 44 V)2

Sindroma Sjogren shoqërohet shpesh me:

A) artrit infektiv
B) artrit reumatoid
C) artrozë
D) reumatizëm artikular akut
E) pneumokoniozë
PS)B

Pyetja 45 V)3

Klinikisht, vetëm prania e hipokalcemisë mund të shkaktojë çrregullime të koagulimit?

A) kurrë
B) pothuajse kurrë
C) rrallë
D) shpesh
E) gjithmonë
PS)A

Pyetja 46 V)3

Riabsorbimi tubular i fosforit është normalisht i barabartë me një përqindje të ngarkesës së administruar të fosforit. Kjo përqindje është:

A) 20-40%
B) 40-50%
C) 50-60%
D) 60-80%
E) 80-95%
PS)E

Pyetja 47 V)3

Sindroma Morgagni-Adam-Stokes nuk mund të provokohet nga:

A) asistolia në prani të bllokut kardiak të qëndrueshëm
B) sindroma e sinusit të sëmurë
C) ndërprerja e papritur e transmetimit atrioventrikular që shkakton asistoli tranzitore
D) aritmia respiratore
E) fibrilacioni ventrikular
PS)D

Pyetja 48 V)2

Cili nga këta glukozidikë është specifik për digitalis lanata?

A) digoksina
B) digitoksina
C) gitoksina
D) glukogitaloksina
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)A

Pyetja 49 V)1

Kuadri hemodinamik i hipertiroidizmit nuk karakterizohet nga:

A) rritja e debitit kardiak
B) rritja e hedhjes kardiake
C) rritja e presionit arterial diferencial
D) rritja e rezistencave vaskulare periferike totale
E) rritja e efortit kardiak
PS)D

Pyetja 50 V)1

Medula megaloblastike është karakteristike për anemitë:

A) nga mungesa e hekurit
B) nga mungesa e acidit folik
C) nga humbet hemorragjike
D) nga ankilostomiaza
E) nga hipersplenizmi
PS)B

Pyetja 51 V)3

Reduktimi i aktivitetit hemolitik komplementar total (inkomplementemia), që vërehet gjatë glomerulonefritit kronik membranoz-proliferative, karakterizhet nga:

A) C3 i rritur dhe C4 i reduktuar
B) C3 i rritur dhe C4 normal
C) C3 normal dhe C4 i reduktuar
D) C3 i reduktuar dhe C4 normal
E) C3 i reduktuar dhe C4 i rritur
PS)D

Pyetja 52 V)1

Derivacioni i parë (I) ekografik arrihet duke përdorur potencialet e matura nëpërmjet:

A) një elektrode
B) dy elektrodave
C) tre elektrodave
D) dy çifte elektrodash
E) pesë elektrodave
PS)B

Pyetja 53 V)1

Reaksioni i Kveim është pozitiv gjatë:

A) tuberkulozit
B) sifilizit
C) sarkoidozës
D) brucelozës
E) silikozës
PS)C

Pyetja 54 V)2

Anemia hemolitike me steatozë hepatike (sindroma Zieve) vërehet në:

A) uremi kronike
B) incidentet e transfuzionit
C) mononukleozë infektive
D) alkoolizëm i rëndë
E) hipertension arterial
PS)D

Pyetja 55 V)1

Te fëmijët, splenektomia ndërlikohet shpesh me:

A) versament pleurik
B) emboli

C) sepsis
D) trombocitopati
E) cirrozë hepatike
PS)C

Pyetja 56 V)2

Guanetidina shkakton:

A) reduktim të presionit endookular te pacientët me glaukomë
B) hipotoni enterike
C) hipomotilitet intestinal
D) të gjitha këto fenomene
E) asnjë nga këto fenomene
PS)A

Pyetja 57 V)3

Gjatë panarteritit nodoz (periarteriti nodoz), cili nga rezultatet laboratorike të mëposhtme është i pranishëm vetëm në 20% të rasteve dhe si rrjedhojë ka vlerë diagnostike shumë të ulët?

A) rritja e eritrosedimentimit
B) hipergamaglobulinemia
C) leukocitoza me eozinofili
D) hematuria, cilindruria
E) faktori reumatoid pozitiv
PS)E

Pyetja 58 V)3

Gjatë komës uremike zakonisht është e pranishme kjo simptomë:

A) glukozuria
B) pigmentet biliare në urinë
C) të vjellat
D) midriaza
E) reflekset tendinoze të theksuara
PS)C

Pyetja 59 V)1

Cilin nga këto hormone kortikosurrenaliene prodhohet në shtresën fashikulare?

A) aldosteroni
B) kortizoni
C) deoksikortikosteroni

D) adrenosteroni
E) 11-hidroksiandrostenedioni
PS)B

Pyetja 60 V)2

Përmbajtja proteinike mesatare e mishit të lopës është:

A) 5 %
B) 10 %
C) 15 %
D) 20 %
E) 40 %
PS)D

Pyetja 61 V)3

Gjatë hepatopative në përgjithësi, alterimi kryesor qe u ndodh eritrociteve është:

A) mikrocitoza
B) makrocitoza
C) sferocitoza
D) stomatocitoza
E) drepanocitoza
PS)B

Pyetja 62 V)2

Cila nga këto vena rrjedh në venën kava inferior?

A) vena mezenterike inferiore
B) vena mezenterike superiore
C) vena rektale inferiore
D) vena lienale
E) vena gastrike
PS)C

Pyetja 63 V)2

Leucemia limfatike akute e fëmijëve është një sëmundje:

A) gjithmonë fatale
B) e kurueshme por asnjëherë e shërueshme
C) që bëhet kronike
D) e shërueshme në 5% të rasteve
E) e shërueshme në 50% të rasteve
PS)E

Pyetja 64 V)2

Gjatë glomerulonefritit akut post-streptokoksik, në urinë nuk vërehen:

A) eritrocite
B) leukocite
C) proteina plazmatike të tepërta
D) qeliza tubulare
E) florë bakteriale polimorfe
PS)E

Pyetja 65 V)1

Cila është alkaloid ksantinik?

A) acetilkolina
B) kolina
C) muskarina
D) pentetrazoli
E) kafeina
PS)E

Pyetja 66 V)3

Glukozë 6-fosfat-dehidrogjenaza është e rritur në:

A) ikter obstruktiv
B) infarkt të miokardit
C) hepatit viral
D) cirrozë hepatike
E) kolecistit
PS)B

Pyetja 67 V)2

Retensioni urinar akut është shpesh pasojë e:

A) shokut
B) insuficiencë renale
C) adenomës së prostatës
D) neoplazisë renale
E) të të gjitha patologjive të mësipërme
PS)C

Pyetja 68 V)1

Gjatë arrestit kardiak:

A) duhet kryer masazhi kardiak ekstern
B) duhet kryer asistenca respiratore dhe masazhi kardiak ekstern
C) duhen të ngrihen lart këmbët e pacientit
D) duhet dhënë plazmë
E) duhet dhënë gjak i plotë
PS)B

Pyetja 69 V)3

Morbus Brill-Symmers është një:

A) sarkomë retikulare
B) limfoblastomë gjigandoqelizore
C) retikulosarkomë
D) limfosarkomë
E) limfogranulomë
PS)B

Pyetja 70 V)2

Pulsi radial i shpejtë vërehet në:

A) tireotoksikozë
B) hipovolemi
C) infarkt akut të miokardit
D) shok
E) perikardit konstriktiv kronik
PS)A

Pyetja 71 V)3

Në rastet kur sindroma Ebstein ndërlikohet nga një komunikimi interatrial ndodh:

A) hiperfluksi pulmonar
B) ektazia e aortës
C) sheshimi i valës P në EKG
D) kalimi i gjakut nga atrium i majtë në atë të djathtë
E) cianoza
PS)E

Pyetja 72 V)2

Në flebogramë, vala a pozitive shpreh:

A) sistolën atriale

B) kontraksionin e ventrikulit të djathtë
C) fazën e kolapsit venoz
D) fazën e rimbushjes së atriumit të djathtë
E) fazën e zbrazjes së djathtë
PS)A

Pyetja 73 V)1

Sideremia është:

A) hekuri indor
B) hekuri i lidhur me transferrinën në serum
C) hekuri hemoglobinik
D) hekuri ferritinik serik
E) hekuri hemosiderinik serik
PS)B

Pyetja 74 V)1

Normalisht, sasia e proteinave në urinën e 24 orëve është maksimumi:

A) 150 mg
B) 200 mg
C) 250 mg
D) 300 mg
E) 500 mg
PS)A

Pyetja 75 V)3

Struma tiroidiene e thjeshtë post-natale shkaktohet nga:

A) niveli plazmatik i lartë i jodit
B) sekretimi i rritur i TSH
C) sekretimi i reduktuar i TSH
D) reduktimi i TRF (thyreotropin releasing factor)
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)B

Pyetja 76 V)2

Ig M:

A) transmetohen nga nëna te fetusi
B) e ushtrojnë aktivitetin vetëm brenda rrymës qarkulluese
C) e ushtrojnë aktivitetin kryesisht në hapësirat ndërqelizore
D) ushtrojnë aktivitet mbrojtës efektiv në mukoza

E) ushtrojnë aktivitet reaginik
PS)B

Pyetja 77 V)3

Në cilën artropati vërehen uretriti, konjuktiviti dhe alterimet kutane?

A) artrozë
B) artrit reumatoid
C) sindromë Reiter
D) gutë
E) spondilit reumatoid
PS)C

Pyetja 78 V)2

Cianoza nga insuficienca ventilatore restriktive vërehet në:

A) bronkit kronik
B) astmë bronkiale
C) enfizemë pulmonare
D) kifoskoliozë
E) policitemi vera
PS)D

Pyetja 79 V)2

Teratoma është masë mediastinale që lokalizohet kryesisht në:

A) mediastinin anterior
B) mediastinin posterior
C) zonën paravertebrale
D) zonën paraezofageale
E) zonën retrokardiake
PS)A

Pyetja 80 V)1

Cili hormon ka strukturë proteinike?

A) ACTH
B) kortizoni
C) aldosteroni
D) testosteroni
E) progesteroni
PS)A

Pyetja 81 V)3

Cilët faktorë prodhohen gjatë shpërthimit respirator (burst respirator)

A) ROI (mediatorët e oksigjenit reaktiv)
B) NO (oksidi nitrik)
C) lizozima
D) LPS (lipopolisaharidi)
E) difensinat
PS)A

Pyetja 82 V)2

Zhurma diastolike vërehet gjatë:

A) insuficiencës trikuspidale
B) stenozës mitrale
C) stenozës pulmonare
D) tetradës Fallot
E) insuficiencës mitrale
PS)B

Pyetja 83 V)1

Niveli normal i kalcemisë serike është:

A) 1,5 - 2,0 mEq/l
B) 2,5 - 3,0 mEq/l
C) 3,5 - 4,0 mEq/l
D) 4,5 - 5,5 mEq/l
E) 6,0 - 7,0 mEq/l
PS)D

Pyetja 84 V)3

Cila nga këto substanca antikoagulante është acid mukoitinpolisulfurik?

A) heparina
B) (tromeksani) bishidroksikumarina
C) fenidioni
D) acidi aminokaproik
E) menadioni
PS)A

Pyetja 85 V)1

Në pozicioni horizontal, presioni normal i likuorit është:

A) 5-15 mm H2O
B) 20-40 mm H2O
C) 40-50 mm H2O
D) 70-200 mm H2O
E) 250-500 mm H2O
PS)D

Pyetja 86 V)2

Dhembja në regjionin gluteal, që rrezatohet në kofshë dhe në këmbë në zonën laterale dhe posteriore, vërehet gjatë sindromës së radikulopatisë:

A) L5
B) L5, S1
C) L1
D) T12, L1
E) T11, T12, L1
PS)B

Pyetja 87 V)3

Gjinekomastia patologjike te meshkujt nuk vërehet gjatë:

A) diabetit mellitus
B) neoplazive testikulare
C) karcinomës bronkogjene
D) hipertiroidizmit
E) sindromës Paget - von Schroetter
PS)E

Pyetja 88 V)2

Embolia pulmonare nga embolat dhjamorë mund të shkaktohet nga:

A) tromboflebitet
B) flebotrombozat
C) frakturat kockore
D) distakimi i materialit septik nga vatrat supurative
E) ruptura e shpretkës
PS)C

Pyetja 89 V)3

Duktusi i Botallo-s patent shkakton:

A) hipertension arterial

B) cianozë
C) hiperfluks pulmonar
D) manifestimet ishemike cerebrale
E) hipotension arterial
PS)C

Pyetja 90 V)3

Gjatë stenozës aortale subvalvulare hipertrofike idiopatike, ndryshe nga ajo valvulare, mungon gjithmonë simptoma e:

A) krizave lipotimike
B) pulsi të vogël dhe të vonuar
C) hipotensionit arterial
D) ineficiencës së manovrës Valsalva mbi intensitetin e zhurmës
E) reduktimi i vëllimit të imët kardiak
PS)D

Pyetja 91 V)3

Osteoporoza difuze e kokës së humerusit, të pulsit dhe të gishtërinjve, vërehet në:

A) akrocianozë
B) sindromën shpatull-dorë
C) sindromën Raynaud
D) sëmundjen Raynaud
E) fenomenin Raynaud
PS)B

Pyetja 92 V)3

Neurinoma mediastinale përgjithësisht ndodh në zonën:

A) mediastinale anteriore superior
B) mediastinale anteriore inferior
C) paradiafragmatike anteriore
D) hilare
E) paravertebrale
PS)E

Pyetja 93 V)3

Cili antibiotik mund të jepet në doza jo të reduktuara gjatë insuficiencës renale kronike (IRK):

A) rifampicina
B) vankomicina
C) ampicilina

D) amoksicilina
E) tetraciklina
PS)A

Pyetja 94 V)1

Timoma shoqërohet shpesh me:

A) brucelozë
B) neoplazi uterine
C) miasteni
D) divertikulozë të perikardit
E) kiste bronkiale
PS)C

Pyetja 95 V)2

Shkaqet më të shpeshta të trombocitopenisë akute janë:

A) glomerulonefritet
B) sëmundjet ekzantematike
C) tuberkulozi dhe sifilizi
D) parazitozat
E) pankreatitet akute
PS)B

Pyetja 96 V)3

Për të dokumentuar variçet ezofageale duhet të kryhet:

A) splenoportografia
B) ekzaminimi radiologjik i tranzitit ezofago-gastrik
C) arteriografia e tripodit
D) ezofagogastroskopia
E) eko doppler
PS)D

Pyetja 97 V)2

Edema e shkaktuar kryesisht nga reduktimi i presionit onkotik, vërehet gjatë:

A) stazës venoze
B) insuficiencës kardiocirkulatore
C) miksedemës
D) edemës Quincke
E) sindromës nefrozike
PS)E

Pyetja 98 V)1

Hipostenuria është:

A) reduktimi i vëllimit urinar të 24 orëve
B) vështirësi gjatë urinimit
C) urinë me densitet 1025-1030
D) urinë me densitet 1012-1018
E) urinim i shpeshtë dhe me sasi të vogla
PS)D

Pyetja 99 V)1

Lobi anterior i hipofizës nuk prodhon:

A) prolaktinë
B) vazopresinë
C) hormon kortikotrop
D) hormon tireotrop
E) gonadotropinë folikulstimuluese
PS)B

Pyetja 100 V)1

Reaginat, antitrupa alergjikë, janë:

A) Ig A
B) Ig D
C) Ig E
D) Ig G
E) Ig M
PS)C

Pyetja 101 V)2

Diagnoza e skarlatinës vërtetohet nga:

A) prania e pseudomembranave faringeale
B) prania e fuzo-spiroketave
C) kultura pozitive me telurit
D) testi i Schick
E) testi i Dick
PS)E

Pyetja 102 V)2

Dhembja akute, e papritur, si thikë, në epigastër është karakteristike për:

A) perforacionin e ulçerës gastro-duodenale
B) pankreatitin akut
C) kolecistitin akut
D) apendisitin akut
E) gravidancën ektopike
PS)A

Pyetja 103 V)2

Reduktimi i hedhjes sistolike si pasojë e reduktimit të energjisë kontraktile të miokardit vërehet në:

A) djegie të gjerë
B) perikardit
C) diarre
D) miokardit
E) dehidratim
PS)D

Pyetja 104 V)2

Morbus Pott shkaktohet nga:

A) sifilizi
B) tuberkulozi
C) traumat
D) toksoplasmoza
E) lepra
PS)B

Pyetja 105 V)1

Gjeni është:

A) një strukturë përgjegjëse për kromozomokinetikën
B) një segment kromozomik që përbën një njësi hereditare
C) një zigot
D) një antikodon
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)B

Pyetja 106 V)2

Karcinomat më të shpeshta të aparatit urinar mashkullor janë karcinomat e:

A) veshkës
B) bacinit
C) fshikëzës urinare
D) ureterit proksimal
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)C

Pyetja 107 V)1

Cilat molekula kanë përqindjen më të larta të proteinave?

A) kilomikronet
B) lipoproteinat me dendësi shumë të ulët
C) lipoproteinat me dendësi të ulët
D) lipoprateinat me dendësi të mesme
E) lipoproteinat me dendësi të lartë
PS)E

Pyetja 108 V)1

Presioni venoz qendror reduktohet gjatë:

A) perikarditit eksudativ
B) shokut hipovolemik
C) insuficiencës kronike kongjestive
D) rritjes së presionit intratorakal
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)B

Pyetja 109 V)3

Në 20% të rasteve me periartrit nodoz ndodh:

A) endokarditi
B) leukocitoza eozinofile
C) leukopenia limfopenike
D) fenomeni LE pozitiv
E) poliseroziti
PS)B

Pyetja 110 V)3

Cili nga këta purgantë është një "purgë mekanike"?

A) kaskara-sagrada
B) agar-agar
C) gjethet e senës

D) fenolftaleina
E) kivi
PS)B

Pyetja 111 V)2

Poliglobulia vërehet në:

A) hipertension arterial sistemike
B) cor pulmonar kronik
C) mbingarkesë ventrikulare të majtë
D) infarkt të miokardit
E) miokardiosklerozë koronare
PS)B

Pyetja 112 V)1

Mesatarja aritmetike është:

A) mesatare gjeometrike
B) mesatare harmonike
C) mesatare pozicioni
D) mesatare analitike
E) e ashtuquajtura "mediane"
PS)D

Pyetja 113 V)1

Dhembja diafragmatike shoqërohet shpesh me:

A) lemzë
B) lumbalgji
C) cefale
D) dizuri
E) meteorizëm
PS)A

Pyetja 114 V)3

Në fazat fillestare të artritit reumatoid, ekzaminimi radiologjik i artikulacioneve të vogla karakterizohet nga:

A) hiperostoza
B) kistet kockore
C) osteoporoza
D) të gjitha këto alterime
E) asnjë nga këto alterime

PS)C

Pyetja 115 V)3

Sëmundja Ormond është një fibrozë retriperitoneale shpeshherë:

A) idiopatike
B) e shkaktuar nga limfosarkoma
C) e shkaktuar nga spondiliti tuberkular
D) koliti ulçeroz
E) prostatiti kronik
PS)A

Pyetja 116 V)2

Metameri kutan korrespondues për qafën dhe pjesën inferiore të mjekrës është:

A) C1
B) C2
C) C3
D) C4
E) C5
PS)B

Pyetja 117 V)3

Përveç se në glomerulonefritin nga krioglobunilemia, krioglobulinat plazmatike janë shumë të rritura edhe gjatë:

A) glomerulonefritit me lezione minimale
B) glomerulonefritit membranoz
C) glomerulonefritit lupoid
D) pielonefritit akut
E) glomerulonefritit membranoz-proliferativ
PS)C

Pyetja 118 V)3

Në sindromën Weber vërehen të gjitha këto simptoma me përjashtim të:

A) hemiplegjisë kontralaterale ndaj lezionit
B) ptozës palpebrale homolaterale
C) midriazës homolaterale
D) syrit homolateral të devijuar lateralisht poshtë
E) gjuhës in situ që largohet nga ana e lezionuar
PS)E

Pyetja 119 V)2

ARN-m (acidi ribonukleik mesazher) ka strukturë:

A) si katërfil
B) spirale të dyfishtë
C) me filament unik
D) me filament të trefishtë helikoidal
E) të panjohur
PS)C

Pyetja 120 V)1

Vena safena major rrjedh në venën:

A) poplitea
B) iliake eksterne
C) renale
D) femurale
E) kava inferior
PS)D

Pyetja 121 V)2

Poliglobulia që vërehet gjatë disa sëmundjeve renale (karcinoma renale, kistet renale, hidronefroza, etj.) shkaktohet nga:

A) hipoksia kronike dhe stimuli medular që e ndjek atë
B) hiperkapnia dhe stimuli medular që e ndjek atë
C) hiperprodhimi i eritropoietinës
D) toksikoza medulare kronike
E) hiposplenizmi i njëkohshëm
PS)C

Pyetja 122 V)2

Cianoza nga insuficienca ventilatore obstruktive vërehet gjatë:

A) kifoskoliozës
B) obezitetit
C) bronkitit kronik
D) policitemisë vera
E) anomalive kardiovaskulare kongjenitale me shunt djathtas-majtas
PS)C

Pyetja 123 V)1

Lizozomet ndodhen në:

A) bërthamëz
B) bërthamë
C) citoplazmë
D) aparatin e Golgi-t
E) mitokondri
PS)C

Pyetja 124 V)2

Gjatë cirrozës hepatike të pandërlikuar nga variçet ezofageale, shkaku më i shpeshtë i vdekjes është:

A) koma hepatike
B) kancer-cirroza
C) sindroma hepatorenale
D) hemorragjitë digjestive
E) insuficienca renale akute
PS)A

Pyetja 125 V)2

Përgjithësisht hematokriti nuk është i rritur gjatë:

A) kolapsit vaskular
B) shokut
C) poliglobulisë
D) dehidratimit akut
E) anemisë uremike me anuri
PS)E

Pyetja 126 V)1

Hematemeza nuk mund të vërehet në:

A) ezofagite
B) hernie hiatale
C) sindromë Mallory-Weiss
D) ulçerë gastrike
E) morbus Crohn
PS)E

Pyetja 127 V)2

Izoproterenoli është një:

A) beta-adrenergjik
B) alfa-adrenergjik
C) kolinergjik
D) konstriktor i muskulaturës së lëmuar bronkiale
E) ndihmës i degranulimit mastocitar
PS)A

Pyetja 128 V)1

Normalisht, në likuor ka:

A) 1-2 limfocite/mm3
B) 2-3 limfocite/mm3
C) 0-5 limfocite/mm3
D) 10-15 limfocite/mm3
E) 20-2 limfocite/mm3
PS)C

Pyetja 129 V)2

Serotonina derivon nga:

A) tirozina
B) triptofani
C) fenilalanina
D) adrenalina
E) noradrenalina
PS)B

Pyetja 130 V)2

Uji në kompartimentin jashtëqelizor të organizmit përbën normalisht:

A) 60% të peshës trupore
B) 50% të peshës trupore
C) 45% të peshës trupore
D) 15% të peshës trupore
E) 5% të peshës trupore
PS)D

Pyetja 131 V)1

Azoti ureik në gjakun e plotë normalisht ndodhet në nivel:

A) 10-20 mg%
B) 25-35 mg%
C) 40-55 mg%

D) 65-80 mg%
E) 80-100 mg%
PS)A

Pyetja 132 V)3

Hipokolesterolemia vërehet gjatë:

A) kolelitiazës
B) diabetit mellitus
C) sëmundjes celiake
D) morbusit Niemann-Pick
E) hipotiroidizmit
PS)C

Pyetja 133 V)3

Gjatë pielonefritit kronik vërehen shumë shpesh:

A) funksioni renal i konservuar mirë
B) mikroabscese në parenkimën renale
C) proteinuri tranzitore
D) hipotension arterial
E) alterime morfologjike të kaliceve
PS)E

Pyetja 134 V)3

Gjatë sarkoidozës në gjak vërehet:

A) pO2 normal
B) pO2 i reduktuar
C) pO2 i rritur
D) pCO2 shumë i reduktuar
E) pH shumë i reduktuar
PS)B

Pyetja 135 V)1

Prodhimi i enzimave pankreatike stimulohet nga:

A) sekretina
B) pepsina
C) tripsina
D) insulina
E) polipeptidi pankreatik
PS)A

Pyetja 136 V)2

Zbrazja e shpejtë gastrike, hiperglicemia pasuese dhe hipoglicemia reaktive e mëpasshme karakterizojnë:

A) ulçerën gastrike
B) ulçerën duodenale
C) kolecistitin kronik
D) pankreatitin kronik
E) sindromën dumping tardive
PS)E

Pyetja 137 V)3

Maleati i ergonovinës:

A) përdoret si test diagnostikues për anginën Prinzmetal
B) përdoret si test diagnostikues për anginën nga stenoza koronare organike fikse
C) është krejtësisht e padëmshme gjatë përdorimit diagnostikues
D) ushtron veprim parasimpatikomimetik
E) ushtron veprim beta-adrenergjik
PS)A

Pyetja 138 V)2

Nodujt Heberden shfaqen në:

A) reumatizën artikular akut
B) artrit reumatoid
C) spondilit ankilozant
D) osteoartrozë primare
E) gutë
PS)D

Pyetja 139 V)1

Gjatë hiperhidratimit hipotonik, natremia është:

A) e reduktuar
B) normale
C) e rritur
D) shumë e rritur
E) e rritur në përpjestim të drejtë me rritjen e kloremsë
PS)A

Pyetja 140 V)3

Sindroma e sekuestrimit mezenterik shfaqet me:

A) claudicatio intermittens të gjymtyrëve të poshtme
B) anginë mezenterike në gjendje qetësie
C) anginë mezenterike që paraprin claudicatio intermittens të gjymtyrëve të poshtme
D) sindromë Ortner
E) dispragi intermitente angiosklerotike intestinale
PS)C

Pyetja 141 V)3

Tumefaksioni limfoglandular që mund të prekë disa stacione limfatike vërehet gjatë:

A) tuberkulozit
B) limfogranulomës veneriane
C) sifilizit primar (sifilomës)
D) tularemisë
E) sëmundjes së gërvishtjes nga macja
PS)D

Pyetja 142 V)2

Riniti alergjik mund të shkaktojë:

A) epistaksis
B) tumor
C) tonsilit
D) polipozë nazale
E) humbje dëgjimi
PS)D

Pyetja 143 V)1

Tremori në gjendje qetësie, hipokinezia dhe rigiditeti muskulor vërehen zakonisht gjatë:

A) morbusit Parkinson
B) morbusit Sturge-Weber
C) sklerozës laterale amiotrofike
D) siringomielisë
E) meningitit tuberkular
PS)A

Pyetja 144 V)2

Faciesi leonin mund të shfaqet shpesh gjatë:

A) miksedemës
B) hipertiroidizmit
C) sindromës Cushing
D) leucemisë limfatike
E) lupusit eritematoz
PS)D

Pyetja 145 V)2

Niveli plazmatik i fosfolipideve është normalisht:

A) 30-40 mg%
B) 50-70 mg%
C) 70-100 mg%
D) 120-130 mg%
E) 150-250 mg%
PS)E

Pyetja 146 V)2

Gjatë artrozës nuk vërehet:

A) asnjë kompromet im i gjendjes së përgjithshme
B) osteofite dhe kondrofite
C) dhembje artikulare
D) zhurmë artikulare
E) ankilozë
PS)E

Pyetja 147 V)1

Cila nga këto struktura mungon në bronket më të vogla?

A) epiteli
B) fasciet muskulore
C) membrana bazale
D) unaza kartilaginoze
E) submukoza
PS)D

Pyetja 148 V)2

Fosfataza alkaline e leukociteve është e reduktuar në një përqindje të lartë rastesh me:

A) retikulocitozë neoplazike
B) osteomielosklerozë
C) leucemi megakariocitare

D) leucemi mieloide kronike
E) policitemi vera
PS)D

Pyetja 149 V)2

Për diagnostikimin e abdomenit akut, cila nga shenjat e mëposhtme ka rëndësi madhore?

A) pulsimi i aortës abdominale i perceptueshëm qartë
B) pareti abdominal i flashkët gjatë palpacionit
C) pareti abdominal rigid gjatë palpacionit
D) takipnea
E) takikardia dhe dhembjet abdominale difuze
PS)C

Pyetja 150 V)2

Dhembja në zonën suprapubike vërehet gjatë sëmundjeve të:

A) zorrës së hollë
B) kolonit ascendent
C) kolonit transvers
D) kolonit descendent
E) rektumit, sigmës
PS)E

Pyetja 151 V)2

Postura ortopneike vërehet gjatë:

A) fazave fillestare të pleuritit
B) versamentit pleurik të theksuar
C) insuficiencës kardiovaskulare
D) krizave abdominale të dhembshme
E) kolikave renale
PS)C

Pyetja 152 V)1

Grumbullimi i likidit transudativ në kavitetin pleurik vërehet gjatë:

A) fibrotoraksit
B) empiemës pleurale
C) pleuritit serofibrinoz
D) hidrotoraksit
E) hemotoraksit
PS)D

Pyetja 153 V)2

Vala T me majë, e theksuar, vërehet shpesh gjatë një prej çrregullimeve elektrolitike të mëposhtme:

A) hipokalemi e moderuar
B) hiperkalemi e moderuar
C) hipermagnezemi e theksuar
D) hiponatremi e moderuar
E) hipernatremi e moderuar
PS)B

Pyetja 154 V)2

Vlerat më të larta në absolut të eritrosedimentimit vërehen gjatë:

A) pneumonisë krupoze
B) mielomës multiple
C) kolecistitit kronik
D) granulomës dentare
E) tonsilitit kronik
PS)B

Pyetja 155 V)3

Versamenti pleural "si këmishë" vërehet gjatë:

A) pleuritit mediastinal
B) elasticitetit pulmonar të modifikuar
C) insuficiencës kardiovaskulare
D) pleuritit diafragmal
E) pleuritit interlobar
PS)B

Pyetja 156 V)3

Gjatë ekspozimit të të dhënave kualitative, pra që nuk shprehen dot nëpërmjet numrave, shpërndarja e frekuencave duhet bërë sipas:

A) shpërndarjes binominale
B) shpërndarjes Poisson
C) shpërndarjes Gaussiane
D) aplikimit të të gjitha kritereve të mësipërme
E) një metologjie të ndryshme nga të mësipërmet
PS)A

Pyetja 157 V)1

Në eritrocitin matur vërehen:

A) bërthama
B) kompleksi i Golgi-t
C) centriolat
D) mitokondritë
E) asnjë nga këto organela
PS)E

Pyetja 158 V)2

Cila nuk është karakteristikë e IgE?

A) janë termolabël
B) janë të pranishme në sekrecione
C) nuk e kapërcejnë dot filtrin placentar
D) fiksojnë komplementin
E) janë aktive edhe në sasi minimale
PS)D

Pyetja 159 V)1

Ekzantema vezikulare vërehet gjithmonë gjatë:

A) herpesit simplex
B) megaloeritemës
C) tifo ekzantematoze
D) tifo abdominale
E) erizipelës
PS)A

Pyetja 160 V)2

Karcinoma gastrike që vërehet më shpesh ka pamje:

A) fungoide
B) të ulçeruar dhe me karakter lokal
C) të ulçeruar dhe pa karakter lokal
D) infiltruese difuze të ulçeruar ose të paulçeruar
E) polipoide
PS)D

Pyetja 161 V)3

Gjatë porfirisë eritropoietike, në urinë vërehet:

A) porfobilinogjen i rritur
B) porfobilinogjen normal
C) uroporfirinë e rritur
D) koproporfirinë e rritur
E) acidi delta-aminolevulinik (ALA) i rritur
PS)B

Pyetja 162 V)3

Në flebogramë, kontraksioni ventrikular i djathtë shprehet nga vala:

A) a pozitive
B) c pozitive
C) v pozitive
D) x negative
E) y negative
PS)B

Pyetja 163 V)2

Ndërlikimi më i shpeshtë i trakeotomisë në moshë pediatrike është:

A) pneumotoraksi
B) arresti kardiak
C) enfizema mediastinale
D) granuloma trakeale
E) stenoza trakeale
PS)A

Pyetja 164 V)2

Gjatë pielonefritit akut, kohëzgjatja e trajtimit me antibiotikë nuk duhet të jetë më pak se:

A) 5 ditë
B) 10 ditë
C) 20 ditë
D) 40 ditë
E) 80 ditë
PS)C

Pyetja 165 V)3

Sialorrea mund të vërehet gjatë:

A) parotitit hipertrofik senil
B) sindromës Mikulicz

C) parotitit epidemik
D) hemorragjive të rënda
E) lezioneve të kordës timpanike
PS)C

Pyetja 166 V)2

Hipotrombinemia mund të vërehet gjatë:

A) trombozave venoze
B) cirrozës hepatike
C) morbusit Basedow
D) arteriopative obliterante periferike
E) trombozave koronare
PS)B

Pyetja 167 V)3

Beta1 C globulina (C3 i komplementit) është përgjithësisht e reduktuar në plazmë gjatë:

A) nefropatisë diabetike
B) glomerulonefritit akut post-streptokoksik
C) amiloidozës renale
D) nefropatisë nga mieloma
E) trombozave të venave renale
PS)B

Pyetja 168 V)3

Intoksikimi akut nga klonidina shkakton:

A) takikardi sinusale dhe hipotension arterial
B) takikardi sinusale dhe hipertension arterial
C) bradikardi sinusale dhe hipotension arterial
D) bradikardi sinusale dhe hipertension arterial
E) frekuencë dhe presion normal
PS)C

Pyetja 169 V)3

Tumoret me qeliza të qarta të tiroides janë:

A) neoplazitë primare tiroidiene më të shpeshta
B) më të shpeshta te fëmijët
C) më të shpeshta te meshkujt e rritur
D) më të shpeshta në moshën mbi 50 vjeç
E) neoplazi që nuk shkaktojnë kurrë metastaza

PS)D

Pyetja 170 V)2

Presioni kapilar pulmonar është:

A) 1-4 mmHg
B) 5-15 mmHg
C) 15-25 mmHg
D) 25-50 mmHg
E) 50-75 mmHg
PS)B

Pyetja 171 V)2

Kreatininemia është e rritur gjatë:

A) gastritit hipoklorhidrik
B) anemisë hipokromike
C) astmës bronkiale
D) insuficiencës renale
E) miastenisë
PS)D

Pyetja 172 V)1

Cilët janë mediatorët kryesorë të reaksioneve të hipersensibilitetit të vonuar?

A) neutrofilet
B) limfocitet T CD4
C) limfocitet B
D) bazofilet
E) trombocitet
PS)B

Pyetja 173 V)1

Sasia e rekomanduar ditore e proteinave që duhet të konsumojë një mashkull i rritur, mbi 20 vjeç, peshë 65 kg dhe gjatësi 170 cm, është rreth:

A) 15 g
B) 20 g
C) 30 g
D) 40 g
E) 60 g
PS)E

Pyetja 174 V)2

Cila nga këto sëmundje është autozomike recesive?

A) feokromocitoma
B) albinizmi
C) skleroza tuberoze
D) neurofibromatoza
E) retinoblastoma
PS)B

Pyetja 175 V)1

Eksudati purulent karakterizohet nga:

A) përmbajtja e ulët proteinike
B) neutrofile dhe baktere piogjene
C) përmbajtje e lartë mukusi
D) përmbajtje e lartë eozinofilesh
E) përmbajtje e lartë trombocitesh
PS)B

Pyetja 176 V)3

Rritja difuze ose e lokalizuar e transparencës e fushave pulmonare vërehet gjatë:

A) atelektazisë
B) infarktit pulmonar
C) bronkopneumonisë
D) emfizemës
E) pneumopatisë uremike
PS)D

Pyetja 177 V)1

Gjatë bllokut të plotë atrio-ventrikular, ritmi ventrikular paraqet një frekuencë:

A) 120-140 rrahje/minutë
B) 100-120 rrahje/minutë
C) 80-100 rrahje/minutë
D) 40-60 rrahje/minutë
E) 15-40 rrahje/minutë
PS)E

Pyetja 178 V)1

Peristaltika intestinale mungon gjatë:

A) okluzionit mekanik
B) ascitit
C) infarktit të miokardit
D) peritonitit
E) traumave të toraksit
PS)D

Pyetja 179 V)2

Ndryshe nga çfarë ndodh në stenozën mitrale të vërtetë, gjatë stenozës mitrale relative vërehet:

A) mungesë e elevacionit sistolik ventrikular të majtë
B) prani e elevacionit sistolik ventrikular të djathtë
C) prani e fremitusit të apeksit
D) mungesë e kërcitjes së hapjes
E) toni i parë kardiak i fortë
PS)D

Pyetja 180 V)2

Shenja e llokoçitjes abdominale vërehet gjatë:

A) versamentit ascitik
B) ansës intestinale të dilatuar mbi nivelin e stenozës, me nivele hidroaerike
C) empiemës së kolecistës
D) veshkës të lëvizshme ptozike
E) splenomegalisë
PS)B

Pyetja 181 V)2

Antiepileptiku i zgjedhur, pasi ushtron edhe aktivitet depresiv mbi zonat kortikomotore, është:

A) barbitali
B) allobarbitali
C) amobarbitali
D) butobarbitali
E) fenobarbitali
PS)E

Pyetja 182 V)2

Gjatë stenozës së arteries renale, në urografi veshka e furnizuar nga ena stenozike duket:

A) më dense se sa veshka kontralaterale

B) me të njëjtën densitet në krahasim me veshkën kontrolaterale
C) më pak dense se sa veshka kontralaterale
D) më e shpejtë për sa i përket eleminimit të kontrastit
E) me diametër longitudinal rreth 0,5 cm më të shkurtër
PS)A

Pyetja 183 V)1

Në përqindje, Na+ total jashtëqelizor është:

A) 78,7% e Na+ total trupor
B) 81,2% e Na+ total trupor
C) 85,7% e Na+ total trupor
D) 97,6% e Na+ total trupor
E) 99,4% e Na+ total trupor
PS)D

Pyetja 184 V)3

Sindroma Caplan është një:

A) pneumokoniozë reumatoide
B) antrakozë pulmonare
C) siderozë pulmonare
D) baritinozë pulmonare
E) stenozë pulmonare
PS)A

Pyetja 185 V)2

Shoku hipovolemik vërehet gjatë:

A) infarktit të miokardit
B) takikardisë paroksistike
C) hemoperitoneumit
D) brakikardisë ektreme
E) tamponadës kardiake
PS)C

Pyetja 186 V)1

Cili nuk është faktor risku për trombozë?

A) diabeti
B) hipertensioni arterial
C) obeziteti
D) anemia

E) dislipidemia
PS)D

Pyetja 187 V)3

Metastazat karcinomatoze të stomakut vërehen në qafë të lokalizuar:

A) në marzhin posterior të muskulit sternokleidomastoid
B) në zonën submandibulare
C) në regjionin superior të qafës
D) bilateralisht
E) monolateralisht
PS)E

Pyetja 188 V)3

Cila simptomë nuk është tipike për aneminë hemolitike akute?

A) ikteri
B) zbehja
C) takikardia
D) dispnea
E) polakiuria
PS)E

Pyetja 189 V)3

Zhurma sistolike nga fluksi në zonën e auskultimit aortal dhe zhurma diastolike me intensitet decrescent në zonën aortale ose në pikën Erb (hapësira e tretë interkostale në marzhin sternal të majtë) vërehen gjatë:

A) insuficiencës mitrale
B) stenozës aortale
C) stenozës së arteries pulmonare
D) stenozës mitrale
E) insuficiencës aortale dhe stenozës aortale relative
PS)E

Pyetja 190 V)1

Lokalizimi më i shpeshtë i ulçerës gastrike është:

A) kurbatura major
B) kurbatura minor
C) fundusi
D) pareti posterior
E) antrumi

PS)B

Pyetja 191 V)3

Gjatë malaries tropikale, që sot është forma më e shpeshtë e malaries, temperatura:

A) shfaqet në ditë të alternuara
B) shfaqet një ditë po dhe dy ditë jo
C) është e lartë, remitente ose intermitente
D) mund të manifestohet në të gjitha mënyrat e mësipërme
E) nuk manifestohet në asnjë nga mënyrat e mësipërme
PS)C

Pyetja 192 V)2

Kardiopatia kongjenitale me shunt arterio-venoz dexter është:

A) triada Fallot
B) tetrada Fallot
C) kompleksi Eisenmenger
D) komunikimi interatrial
E) atrezia e trikuspidales
PS)D

Pyetja 193 V)3

Anemia Fanconi është:

A) aplazi medulare
B) sëmundje autoimune
C) hepatit kronik aktiv
D) leukopeni nga hipersplenizmi
E) mielofibrozë
PS)A

Pyetja 194 V)2

Gjatë sindromës së harkut të aortës nuk vërehet:

A) sinkopa ortostatike
B) afazia
C) torpori psikik
D) amauroza tranzitore
E) pulsi radial i shpejtë
PS)E

Pyetja 195 V)1

Në lidhjen ekografike AVL, elektroda pozitive është e vendosur në:

A) krahun e majtë
B) krahun e djathtë
C) këmbën e majtë
D) këmbën e djathtë
E) në zonën prekordiale
PS)A

Pyetja 196 V)2

Gjatë shokut kardiogjen ndodh:

A) rritja e hedhjes kardiake
B) rritja e presionit arterial
C) rritja e presionit venoz qendror
D) të gjitha këto simptoma
E) asnjë nga këto simptoma
PS)C

Pyetja 197 V)2

Intoksikimi alkoolik akut mund të provokojë lezion akut të mukozës gastrike nëpërmjet:

A) alterimeve kualitative të lëngut gastrik
B) stimulimit hipotalamik
C) ishemisë së mukozës
D) hipersensibilizimit alergjik
E) kongjestionit vazal të mukozës
PS)E

Pyetja 198 V)3

Perikarditi konstriktiv shkaktohet më shpesh nga:

A) hemoperikardi
B) stenoza e arteries pulmonare
C) infarkti i miokardit
D) perikarditi tuberkular
E) miokardioskleroza
PS)D

Pyetja 199 V)1

Gjatë hipertrofisë ventrikulare të djathtë, në lidhjen V1 të EKG vërehet një valë:

A) R me voltazh të lartë
B) R me voltazh të ulët
C) S që mungon
D) S me voltazh të lartë
E) S me voltazh më të lartë se sa vala R
PS)A

Pyetja 200 V)1

Gjetja e antigjenit HbsAg nuk vërehet gjatë:

A) hepatitit tip B aktiv
B) gjendjes portator i shëndetshëm i hepatitit tip B
C) leprës
D) hepatitit tip A
E) hepatitit kronik persistent tip B
PS)D

Pyetja 201 V)1

Cili është funksioni i acidit deoksiribonukleik (ADN)?

A) shumëzimi qelizor
B) transmetimi i tipareve hereditare
C) prodhimi i ARN
D) të gjitha këto funksione
E) asnjë nga këto funksione
PS)B

Pyetja 202 V)2

Vena testikulare e majtë rrjedh në venën:

A) iliake komune të majtë
B) iliake eksterne të majtë
C) kava inferior
D) renale të majtë
E) iliake interne të majtë
PS)D

Pyetja 203 V)2

Temperatura me frisone të vërteta nuk vërehet gjatë:

A) pielonefritit akut
B) endokarditit të ngadaltë
C) erizipelës

D) reumatizmës artikulare akute
E) meningitit meningokoksik
PS)D

Pyetja 204 V)3

Sa më i ulët është presioni intrapleural gjatë inspirimit normal në krahasimi me presionin atmosferik?

A) -2 - -2,5 mmHg
B) -2,5 - -3 mmHg
C) -3 - -4 mmHg
D) -4,5 - -8 mmHg
E) -8 - -16 mmHg
PS)D

Pyetja 205 V)3

Gjatë reumatizmës artikulare akute, mund të dyshohet inflamacioni intersticial miokardiak kur shfaqet:

A) zhurma e rrjedhës sistolike në apeks
B) zhurma e rrjedhës diastolike në apeks
C) zhurma e rrjedhës sisto-diastolike në apeks
D) theksimi i tonit të parë
E) galopi ventrikular ose protodiastolik
PS)E

Pyetja 206 V)2

Gishtat si shkopa tamburi dhe thonjtë si xham ore vërehen gjatë:

A) siringomielisë
B) pneumopative kronike
C) sëmundjes Raynaud
D) onikomikozës
E) nen-ushqyerjes kronike
PS)B

Pyetja 207 V)2

Ikteri i lehtë, që vërehet duke ekzaminuar sklerat nën dritë natyrore, vërehet zakonisht kur niveli i bilirubinës serike është:

A) 1,5 - 2 mg/dl
B) 3,5 - 4,5 mg/dl
C) 2,5 - 3 mg/dl

D) 1 - 1,5 mg/dl
E) > 5 mg/dl
PS)C

Pyetja 208 V)1

Sindroma Rendu-Oster njihet edhe si:

A) trombocitopenia idiopatike
B) sëmundja e Krishtlindjeve
C) teleangiektazia hemorragjike hereditare
D) eritema multiforme
E) disostoza multiple
PS)C

Pyetja 209 V)1

Qendra e krijimit të energjisë në qelizë është:

A) ribozomi
B) mitokondri
C) bërthama
D) nukleoplazmina
E) kromozomi
PS)B

Pyetja 210 V)3

Cila nga këto alterime kockore është më e shpeshtë gjatë sifilizit kongjenital?

A) lezionet distrofike metafizare
B) lezionet distrofike të tipit osteit
C) lezionet distrofike perikockore
D) lezionet lakunare në korteks në zonën diafizo-metafizare
E) porozitet i alternuar me zona hiperdensiteti kockor
PS)C

Pyetja 211 V)1

Nga ku e marrin origjinën arteriet koronare?

A) nga sinusi koronar
B) nga arteria suklavia homolaterale
C) nga aorta
D) nga arteria pulmonare homolaterale
E) drejtpërdrejtë nga ventrikuli kardiak i majtë
PS)C

Pyetja 212 V)3

Sindroma tipike e reaksionit mezenkimal hepatik është:

A) hepatiti kronik agresiv
B) nekroza hepatike akute
C) obstruksioni biliar intrahepatik
D) obstruksioni biliar ekstrahepatik
E) hepatiti viral
PS)A

Pyetja 213 V)2

Gjinekomastia bilaterale nuk mund të shkaktohet dot nga:

A) cirroza hepatike
B) tumoret testikulare
C) tumoret kortikosurrenaliene
D) sindroma Klinefelter
E) insuficienca ovariene primare
PS)E

Pyetja 214 V)3

Cilat linja të diferencimit e marrin origjinën nga prekursori mieloid i përbashkët?

A) qelizat natural killer
B) trombocitet
C) plazmocitet
D) limfocitet B
E) limfocitet T
PS)B

Pyetja 215 V)2

Cilat janë simptomat klasike të sëmundjes Meniere?

A) nauze dhe vertigo
B) cefale, nauze, tinitus dhe vertigo
C) hipakusi, vertigo dhe tinitus
D) hipoakusi, nauze, vertigo
E) vertigo dhe hipoakusi
PS)C

Pyetja 216 V)2

Cila është metoda e përzgjedhur për vendosjen e diagnozës së refluksit acid gastroezofageal?

A) manometria ezofageale
B) pH-metria ezofageale e 24 orëve
C) ekzaminimi radiologjik i ezofagut
D) ezofagogastroduodenoskopia
E) testi Bernsten
PS)B

Pyetja 217 V)2

Claudicatio intermittens është shenjë e:

A) embolisë arteriale
B) infarktit të miokardit
C) insuficiencës venoze kronike
D) insuficiencës vaskulare arteriale
E) stazës limfatike
PS)D

Pyetja 218 V)2

Shenja fillestare e obstruksionit arterial akut të një gjymtyre të poshtme është:

A) dhembja
B) impotenca funksionale
C) cianoza
D) hipoestezia
E) gangrena
PS)A

Pyetja 219 V)2

Mungesa e lëshimit të një sfinkteri në momentin e mbërritjes së valës peristaltike nga segmentet luminale të mësipërme përkufizohet si:

A) akalazi
B) akatalazi
C) akatafazi
D) akatizi
E) akapni
PS)A

Pyetja 220 V)2

Cila simptomë është gjithnjë e pranishme gjatë leucemisë mieloide kronike?

A) splenomegalia
B) dhembja sternale nën shtypje
C) temperatura
D) hepatomegalia
E) priapizmi
PS)A

Pyetja 221 V)2

Cili nga këta diuretikë është antagonist i aldosteronit?

A) furosemidi
B) spironolaktoni
C) manitoli
D) acetazolamidi
E) acidi etakrinik
PS)B

Pyetja 222 V)2

Ishemia e miokardit karakterizohet në EKG nga:

A) zgjatja e P-Q
B) inversionit të valës T
C) zgjatjes së Q-S
D) shkurtimit të T-Q
E) shfaqjes së ekstrasistolave
PS)B

Pyetja 223 V)3

Sindroma karakteristike e dëmtimit hepatoqelizor difuz nuk shkaktohet nga:

A) citoliza hepatike difuze akute
B) ikteri medikamentoz
C) hepatitet virale
D) neoplazia hepatike
E) hepatiti nga substancat toksike
PS)D

Pyetja 224 V)2

Normalisht, vëllimi i O2 në ajrin e inspiruar është:

A) 5%
B) 11%
C) 16%

D) 21%
E) 26%
PS)D

Pyetja 225 V)3

Gjatë astmës bronkiale mund të vërehen anomali lokale të raportit ventilim/perfuzion, për shkak se shumica e alveolave është:

A) e ventiluar pak dhe e perfuzionuar pak
B) e ventiluar normalisht dhe e perfuzionuar pak
C) shumë e ventiluar dhe e perfuzionuar pak
D) e ventiluar pak dhe e perfuzionuar normalisht
E) shumë e ventiluar dhe e perfuzionuar normalisht
PS)D

Pyetja 226 V)2

Antitrupat anti-Rhezus:

A) i përkasin klasës IgG
B) i përkasin klasës IgM
C) i përkasin klasës IgA
D) i përkasin klasës Ig
E) janë të pranishme në serum në mënyrë natyrore te personat Rhezus negativ
PS)A

Pyetja 227 V)2

Diferenca e vlerave të matura në dy grupe individësh, të cilët krahasohen mes tyre, është statistikisht shumë sinjifikante kur mundësia e rastësisë (vlera p) është:

A) < 0,01
B) 0,01 - 0,05
C) > 0,05
D) > 0,10
E) > 0,15
PS)A

Pyetja 228 V)3

Ndalimi i menjëhershëm i çurgut urinar gjatë urinimit është shenjë e:

A) cistitit
B) hipertrofisë së prostatës
C) sklerozës së qafës
D) kalkulozës së fshikëzës së urinës

E) kalkulozës renale
PS)D

Pyetja 229 V)2

Në tetradën Fallot nuk vërehet:

A) stenoza pulmonare
B) komunikimi interventrikular
C) komunikimi interatrial
D) dekstropozicionimi i aortës
E) hipertrofia ventrikulare e djathtë
PS)C

Pyetja 230 V)3

Në cilën aritmi frekuenca atriale është >100/minutë, e çrregullt dhe me përçim ventrikuar zakonisht në raport 1:1?

A) flateri atrial
B) takikardia atriale multifokale
C) takikardia sinusale
D) fibrilacioni atrial
E) takikardia supraventrikulare
PS)E

Pyetja 231 V)3

Në rastet me hiperkalemi, vdekja mund të ndodhë si pasojë e:

A) arrestit kardiak gjatë diastolës
B) arrestit kardiak gjatë sistolës
C) anurisë
D) hemorragjisë cerebrale
E) edemës pulmonare akute
PS)A

Pyetja 232 V)2

Feçet e errëta nga melena vërehen te personat me:

A) variçe ezofageale
B) kolit ulçeroz
C) hemorroide
D) ragade anale
E) proktosigmoidit ulçeroz
PS)A

Pyetja 233 V)3

Gjatë hiperaldosteronizmit parësor, simptoma klinike më konstante është:

A) arefleksia
B) hipertensioni arterial
C) krizat tetanike
D) aritmitë kardiake
E) paraliza periodike
PS)B

Pyetja 234 V)3

Cili nuk është efekt anësor i mundshëm i përdorimit të ciklofosfamidit?

A) cistiti hemorragjik
B) leukopenia
C) trombocitopenia
D) hepatiti
E) hipertrikoza
PS)E

Pyetja 235 V)1

Valvula mitrale është e formuar nga:

A) katër kuspide
B) një kuspide antero-mediale dhe një kuspide postero-laterale
C) një kuspide e djathtë dhe një kuspide e majtë
D) një kuspide aortale dhe një kuspide anteriore
E) një kuspide aortale dhe një kuspide posteriore
PS)B

Pyetja 236 V)2

Cila është aritmia më e shpeshtë në rastet me stenozë mitrale?

A) takikardia ventrikulare
B) bigeminizmi ventrikular monocentrik
C) takikardia supraventrikulare paroksistike
D) fibrilacioni dhe flateri atrial
E) ekstrasistolia politope
PS)D

Pyetja 237 V)3

Gjatë hidrartrisë intermitente vërehet:

A) eritrosedimentim normal
B) temperaturë
C) leukocitozë neutrofile
D) manifestime poliartikulare
E) prania e të gjitha këtyre simptomave
PS)A

Pyetja 238 V)1

Gjenotipi me dy alele identike në një lokus të caktuar quhet:

A) monozigotë
B) dizigotë
C) heterozigotë
D) homozigotë
E) gamet
PS)D

Pyetja 239 V)2

Termi imunitet i fituar nënkupton përgjigje imunitare:

A) të arritura përmes transferimit të antitrupave
B) që zhvillohen në mungesë të stimulimit antigjenik
C) të ndërmjetësuara nga limfocitet T dhe B
D) të ndërmjetësuara nga makrofagët
E) që nuk përforcohen nga ekspozimet e përsëritura nga antigjenit
PS)C

Pyetja 240 V)3

Në cilën patologji antigjeni HLA-B27 është i pranishëm në mbi 90% të rasteve?

A) morbus Reiter
B) reumatizëm enterogjen
C) spondiloartrit ankilozant
D) artrit psoriatik
E) asnjë nga këto sëmundje
PS)C

Pyetja 241 V)2

Proteina e Bence-Jones vërehet në rastet me:

A) makroglobulinemi Waldenstrom

B) sëmundje nga zinxhirët e rëndë
C) krioglobulinemi mikse
D) hemoglobinuri paroksistike nga i ftohti
E) sëmundje nga zinxhirët e lehtë të shoqëruar ose jo me plazmocitomë
PS)E

Pyetja 242 V)3

Zhurma sistolike e ejeksionit nuk shfaq këtë karakteristikë:

A) fillon gjatë tonit I
B) fillon pas tonit I
C) është krescente-dekrescente
D) shfaq kulm mezosistolik
E) nëse nuk shkaktohet nga lezioni stenozik valvular mund të shfaqë kulm protosistolik
PS)A

Pyetja 243 V)2

Ventilimi maksimal pulmonar është:

A) normal në pneumopatitë obstruktive
B) normal në pneumopatitë restriktive
C) i rritur në pneumopatitë obstruktive
D) i rritur në pneumopatitë obstruktive
E) i reduktuar në pneumopatitë obstruktive dhe restriktive
PS)E

Pyetja 244 V)3

Cila strukturë nuk është pjesë e hipotalamusit?

A) nukleusi mamilar
B) nukleusi paraventrikular
C) nukleusi para-optik
D) nukleusi i habenulës
E) recesi mamilar
PS)E

Pyetja 245 V)3

Tubujt renalë shfaqin pamje pseudotiroidiene në biopsinë e veshkës në rastet me:

A) pielonefrit akut
B) pielonefrit kronik
C) glomerulonefrit post-streptokoksik
D) glomerulonefrit Schonlein-Henoch

E) hipernefromë
PS)B

Pyetja 246 V)2

Citokinat:

A) kanë natyrë lipoproteinike
B) prodhohen vetëm nga limfocitet T
C) veprojnë vetëm mbi limfocitet
D) ushtrojnë veprim antigjen-specifik
E) lidhen me receptorë specifikë
PS)E

Pyetja 247 V)2

Reaksioni imunitar tip IV (reaksioni i vonuar) fillohet nga:

A) qeliza njëbërthamore të afta për të reagur drejtpërdrejtë me antigjenin
B) alergjenet
C) antitrupa serike që reagojnë me përbërësit e qelizave indore ose me antigjenë të konjuguar me to
D) antitrupa precipituese që reagojnë me antigjenin në hapësirat indore
E) reaginat
PS)A

Pyetja 248 V)3

Gjatë sindromës së sekuestrimit aorto-iliak të shkaktuar nga stenoza e arteries iliake komune nën pikën e origjinës së arteries mezenterike inferiore, gjaku që merret nga arteriet mezenterike arrin në arterien iliake interne dhe më pas arterien iliake ek
A) mezenterike superior
B) rektale inferior
C) rektale media
D) celiake
E) renale
PS)C

Pyetja 249 V)3

Vertigo periferike, pra me origjinë otolabirintike, shfaq:

A) nistagmus vertikal
B) konvulsione okazionale
C) ekzaminim otologjik negativ
D) shenjë Romberg pozitive pas ndryshimit të pozicionit të kokës
E) shenjë Romberg negative pas ndryshimit të pozicionit të kokës

PS)D

Pyetja 250 V)1

Për meshkujt e rritur, nevoja ditore për hekur është:

A) 2 mg
B) 4 mg
C) 8 mg
D) 10 mg
E) 12 mg
PS)D

Pyetja 251 V)1

Aneurizma është një:

A) dilatim venoz
B) dilatim arterial
C) grumbullim limfatik
D) ekstravazim hemorragjik
E) tumor vaskular
PS)B

Pyetja 252 V)2

Sindroma nefrozike e shoqëruar me hepatosplenomegali shkaktohet zakonisht nga:

A) cirroza hepatike
B) glomeruloskleroza
C) stenoza e arteries renale
D) tromboza e venës renale
E) amiloidoza
PS)E

Pyetja 253 V)2

Gjatë poliurisë së diabetit mellitus, zakonisht humbja e H2O është:

A) më e lartë se sa humbja e Na
B) e barabartë me humbjen e Na
C) më e ulët se sa humbja e Na
D) e barabartë me humbjen e globulinave plazmatike
E) më e ulët se sa humbja e globulinave plazmatike
PS)A

Pyetja 254 V)3

Kompleksi tuberkular primar nuk karakterizohet nga:

A) vatra parenkimale
B) limfoangioiti intermedia
C) formacioni bipolar në radiografi
D) adeniti hilar
E) kaverna tuberkulare
PS)E

Pyetja 255 V)2

Sarkomeri përbëhet nga:

A) brezi H
B) brezi A
C) pjesë miofibrilash që shtrihen ndërmjet dy linjave Z
D) brezi I
E) brezi A dhe gjysma e brezit I
PS)E

Pyetja 256 V)3

Trismusi me origjinë qendrore vërehet gjatë:

A) sindromës Duchenne
B) paralizës bulbare kronike progresive
C) disodontiazës së nervit VIII
D) infeksionit tetanik
E) hemikranias oftalmoplegjike
PS)D

Pyetja 257 V)3

Atelektazia e plotë e një pulmoni vërehet shumë shpesh gjatë:

A) neoplazisë bronkiale
B) pleuritit diafragmatik
C) sëmundjeve mediastinale
D) pneumotoraksit hipertensiv
E) pneumonisë lobare
PS)D

Pyetja 258 V)2

Dhembjet, që lindin vonë pas marrjes së ushqimeve, dhe që kanë ecuri episodike dhe janë të lokalizuara kryesisht në pjesën e majtë të abdomenit shkaktohen nga:

A) ulçera gastrike e vjetër
B) ulçera duodenale
C) ulçera peptike jejunale
D) sindroma Crohn
E) typhlitis kronik
PS)C

Pyetja 259 V)2

Procesi përmes të cilit informacioni gjenetik transmetohet nga ADN te ARN quhet:

A) meiozë
B) translacion
C) transkriptim
D) duplikim
E) diploidi
PS)C

Pyetja 260 V)3

Cili nga lidhjet që mban të bashkuara pjesët e ndryshme të molekulës proteinike krijohet nga forcat e Van der Waals?

A) lidhja kovalente
B) lidhja jonike
C) lidhja elektrostatike
D) lidhja hidrogjenike
E) lidhja hidrofobike
PS)E

Pyetja 261 V)3

Tumoret mikse shfaqen kryesisht në:

A) gjëndrën submandibulare
B) gjëndrën sublinguale
C) gjëndrën parotide
D) të gjitha të mësipërmet
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)C

Pyetja 262 V)2

Bronkiektazia është një:

A) dilatim kongjenital i bronkiolit

B) proces inflamator kronik i bronkeve
C) proces supurativ i alveolave pulmonare
D) keqformim arterio-venoz në nivel bronkial
E) dilatim i lumenit bronkial nga alterimi kronik i pareteve
PS)E

Pyetja 263 V)2

Melanodermia, diabeti mellitus, cirroza hepatike, karakterizojnë:

A) amiloidozën hepatike
B) hemokromatozën ose siderokromatozën idiopatike
C) cirrozën Wilson
D) morbusin Niemann-Pick
E) neoplazinë melanocitare nga nevusi
PS)B

Pyetja 264 V)3

Gjatë hirsutizmit, te femrat shfaqet zhvillimi i:

A) sektorit pilifer të varur nga estrogjeni
B) sektorit pilifer të varur nga androgjeni
C) sektorit pilifer të pavarur nga hormonet seksuale
D) asnjë nga këto sektore
E) të tre këta sektore
PS)B

Pyetja 265 V)2

Zmadhimi difuz i tiroides vërehet zakonisht gjatë:

A) struës koloidocistike
B) adenomës toksike
C) karcinomës tiroidiene
D) morbus Basedow
E) adenomës joradiokaptante
PS)D

Pyetja 266 V)3

Në infiltratin pulmonar eozinofilik të Loeffler-it, eozinofilia e gjakut arrin kulmin e saj shumë shpesh:

A) përpara shfaqjes së infiltratit
B) njëkohësisht me shfaqjen e infiltratit
C) pasi infiltrati ka arritur maksimumin e shtrirjes së tij

D) në mënyrë kronologjikisht të pavarur nga infilatrati
E) të gjitha këto situata janë të mundshme
PS)C

Pyetja 267 V)3

Gjatë sfingomielinozës Niemann-Pick, nuk vërehet:

A) lipemi totale normale
B) rritje e nivelit të sfingomielinave në gjak
C) anemi hipokrome e lehtë
D) leukopeni me limfocitozë relative
E) vakuolizim i limfociteve dhe monociteve
PS)B

Pyetja 268 V)2

Gjatë anemisë sideropenike kronike nuk vërehet:

A) atrofia e mukozës orale
B) keiloza
C) çrregullimet e gëlltitjes
D) megalocitoza
E) lëkura e thatë dhe e fisurizuar
PS)D

Pyetja 269 V)2

Hemoglobina është:

A) fosfolipid
B) glikoproteinë
C) nukleoproteinë
D) lipoproteinë
E) kromoproteinë
PS)E

Pyetja 270 V)1

Në cilën sëmundje ka rritje të nivelit të antitrupave anti-O-streptolizinikë?

A) artrozë
B) artrit reumatoid
C) reumatizëm artikular akut
D) cermë
E) të gjitha të mësipërmet
PS)C

Pyetja 271 V)3

E dhëna anatompatologjike më karakteristike për intoksikimin akut nga cianuri është:

A) edema cerebrale e gjerë
B) zonat me atelektazi pulmonare
C) zonat me edemë pulmonare
D) edema gastro-intestinale
E) dilatimi kardiak
PS)A

Pyetja 272 V)3

Pulsimi epigastrik vërehet gjatë:

A) hipertrofisë së ventrikulit të djathtë
B) hipertrofisë së ventrikulit të majtë
C) mediastino-perikarditit adeziv
D) perikarditit eksudativ
E) obezitetit
PS)A

Pyetja 273 V)2

Kaliemia është e reduktuar gjatë:

A) insuficiencës renale akute
B) insuficiencës surrenaliene kronike
C) krizave hemolitike akute
D) acidozës respiratore ose metabolike
E) diarresë kronike
PS)E

Pyetja 274 V)3

Galopi nga përmbledhja shkaktoket nga përmbledhja auskultative e:

A) tonit të shtuar presistolik me tonin protodiastolik
B) tonit I me tonin e shtuar presistolik
C) tonit I me tonin e shtuar protodiastolik
D) tonit II me tonin e shtuar presistolik
E) tonit II me tonin e shtuar protodiastolik
PS)A

Pyetja 275 V)3

Gjatë artritit reumatoid, komplementi rezulton pothuajse gjithmonë:

A) i rritur në serum dhe në likidin sinovial
B) normal në serum dhe në likidin sinovial
C) i reduktuar në serum dhe në likidin sinovial
D) normal në serum dhe i reduktuar në likidin sinovial
E) i reduktuar në serum dhe i rritur në likidin sinovial
PS)D

Pyetja 276 V)3

Pneumonia nga ethja Q vërehet më shpesh në:

A) pranverë
B) verë
C) vjeshtë
D) dimër
E) çfarëdo stine
PS)A

Pyetja 277 V)3

Gjatë shokut mund të shfaqet acidoza laktike e shkaktuar nga:

A) reduktimi i pO2 në gjak
B) rritja e pO2 në gjak
C) reduktimi i proteinave plazmatike
D) hiperkalemia
E) dehidratimi
PS)A

Pyetja 278 V)3

Beta1C globulina (C3 i komplementit) shpesh është i rritur gjatë:

A) glomerulonefritit të panarteritit nodoz
B) nekrozës tubulare akute
C) trombozës së venave renale
D) amiloidozës renale
E) nefropatisë diabetike
PS)A

Pyetja 279 V)1

"Faktori reumatoid" përbëhet nga autoantikorpe kundër:

A) kolagjenit tip II

B) qelizave kartilaginoze
C) ADN
D) qelizave sinoviale
E) Fc së Ig
PS)E

Pyetja 280 V)1

Versamenti pleural është shumë i rrallë gjatë:

A) endoteliomës pleurale
B) sarkomës pleurale
C) sindromës Meigs
D) obstruksionit të duktusit torakal
E) insuficiencës kardiake kongjestive
PS)B

Pyetja 281 V)2

Kloramfenikoli nuk është aktiv kundër:

A) riketcieve
B) brucelave
C) protozoarëve
D) Escherichia coli
E) Klebsiella pneumoniae
PS)C

Pyetja 282 V)3

Ralet sonore dëgjohen gjatë:

A) fibrozës pulmonare
B) fërkimeve pleurale
C) fërkimeve pleuro-perikardiake
D) dendësimeve pulmonare
E) bronkospazmës
PS)D

Pyetja 283 V)2

Agjenti etiologjik specifik i glomerulonefritit akut është:

A) adenovirusi
B) treponema pallidum
C) streptokoku beta-hemolitik
D) stafilokoku aureus

E) streptokoku alfa-hemolitik
PS)C

Pyetja 284 V)2

Dispnea kardiake nuk vërehet gjatë:

A) astmës kardiake
B) edemës pulmonare akute
C) bllokut alveolo-kapilar
D) versamentit perikardial
E) vesit të mitrales së trikuspidalizuar
PS)C

Pyetja 285 V)3

Porfirinuria vërehet gjatë:

A) uremisë akute
B) hipertiroidizmit
C) poliartritit kronik primar
D) intoksikimit nga plumbi
E) mielomës multiple
PS)D

Pyetja 286 V)3

Gjatë glomerulonefritit lupoid, IgG plazmatike janë:

A) normale
B) shumë të rritura
C) shumë të reduktuara
D) ndonjëherë të rritura, ndonjëherë të reduktuara
E) mungojnë
PS)B

Pyetja 287 V)2

Në rastet me morbus Hodgkin, lokalizimet ekstralimfonodale më të shpeshta janë lokalizimet:

A) kutane
B) renale
C) cerebrale
D) hepatike
E) pankreatike
PS)D

Pyetja 288 V)1

Glositi atrofik i Hunter vërehet në rastet me:

A) deficit të niacinës
B) ariboflavinozë
C) deficit të hekurit
D) infeksion skarlatinoz
E) deficit të vitaminës B12
PS)E

Pyetja 289 V)1

Gjatë të vjellave rekurente nga obstruksioni pilorik, vërehet:

A) kaliemi e reduktuar
B) vëllim urinar i rritur
C) kloremi e rritur
D) natreami e rritur
E) azoti ureik i reduktuar
PS)A

Pyetja 290 V)2

Dermatiti i kontaktit është një reaksion imunitar:

A) i asnjë tipi
B) i tipit I: reaginik
C) i tipit II: citotoksik
D) i tipit III: nga komplekset imunitare
E) i tipit IV: qelizor
PS)E

Pyetja 291 V)2

Gjatë aortosklerozës, zhurma që dëgjohet në bazën e zemrës është:

A) mezosistolike
B) telesistolike
C) protodiastolike
D) telediastolike
E) mezodiastolike
PS)A

Pyetja 292 V)3

Cila është pika korrespondente e kardias në kolonën vertebrale?

A) vertebra torakale IX
B) vertebra torakale VIII
C) vertebra torakale XII
D) vertebra lumbare II
E) disku intervertebral ndërmjet vertebrave torakale X dhe XI
PS)E

Pyetja 293 V)2

Cili faktor nuk shkakton edemë?

A) pletora hidrosaline
B) permeabiliteti kapilar i alteruar
C) presioni onkotik i reduktuar
D) presioni hidrostatik i reduktuar
E) drenazhi limfatik i penguar
PS)D

Pyetja 294 V)2

Gjatë cirrozës hepatike, vërehet rritje e:

A) pseudokolinesterazës
B) protrombinemisë
C) albuminemisë
D) gama-globulinemisë
E) amilazemisë
PS)D

Pyetja 295 V)2

Fibrinogjenemia është e reduktuar gjatë:

A) pneumonive
B) bronkopneumonive
C) infeksioneve akute
D) sindromës nefrozike
E) cirrozës hepatike
PS)E

Pyetja 296 V)2

Splenopatitë neoplazike primare janë:

A) shumë të shpeshta
B) të shpeshta

C) të rralla
D) shumë të rralla
E) nuk ekzistojnë
PS)D

Pyetja 297 V)2

Gjatë insuficiencës aortale valvulare nuk vërehet:

A) zbehja
B) rritja e presionit arterial diferencial
C) pulsi i vonuar
D) vallëzimi i arterieve
E) zhurma e Flint
PS)C

Pyetja 298 V)3

Diateza hemorragjike nga reduktimi i trombociteve vërehet gjatë:

A) mungesës së protrombinës nga hepatopatia
B) sindroma Ehlers-Danlos
C) purpura e Schonlein-Henoch
D) hemofilia B
E) morbus Werlhof
PS)E

Pyetja 299 V)2

Si është temperatura gjatë fazës II të tifos?

A) intermitente
B) e vazhdueshme-remitente
C) e çrregullt
D) e vazhdueshme
E) ondulante
PS)D

Pyetja 300 V)2

Cila substancë është parasimpatiko-mimetike?

A) izoprenalina
B) dopamina
C) tiramina
D) acetilkolina
E) kromoglikati bisodik

PS)D

Pyetja 301 V)1

Vena kava inferior përfundon në:

A) sinusin koronar
B) ventrikulin e djathtë
C) venën kava superior
D) atriumin e djathtë
E) atriumin e majtë
PS)D

Pyetja 302 V)3

Gjatë ketoacidozës diabetike, reduktimi i pH plazmatik shkakton:

A) reduktim të frekuencës respiratore
B) vazokonstriksion periferik
C) humbje urinare të kaliumit
D) efekt inotrop pozitiv mbi miokardin
E) reduktim të perspiratio insensibilis
PS)C

Pyetja 303 V)2

Escherichia coli:

A) është gram-pozitiv
B) është sporigjen
C) nuk ka cilie
D) nuk ka kapsulë
E) ka formë sferike
PS)E

Pyetja 304 V)2

Gjatë hepatiteve akute anikterike, shfaqet rritje e:

A) urobilinurisë
B) albuminemisë
C) amonemisë
D) protrombinemisë
E) pseudokolinesterazës
PS)A

Pyetja 305 V)1

Antrumi pilorik ndodhet ndërmjet:

A) kanalit pilorik dhe duodenit
B) kanalit pilorik dhe trupit të stomakut
C) trupit dhe tuberozitetit major (fundusit) të stomakut
D) pilorit dhe duodenit
E) trupit dhe regjionit kardial
PS)B

Pyetja 306 V)2

Cila simptomë mungon gjithmonë në leuceminë mieloide kronike?

A) limfocitoza
B) splenomegalia
C) leukocitoza
D) hepatomegalia
E) prania e kromozomit Philadelphia
PS)A

Pyetja 307 V)2

Gjatë adenopatisë laterocervikale Hodgkin, limfoglandulat:

A) janë të padhembshme dhe të forta
B) janë të dhembshme gjatë shtypjes
C) u nënshtrohen fenomeneve kolikuative
D) janë të aderuara me lëkurën
E) kanë konsistencë elastike
PS)A

Pyetja 308 V)1

Vëllimi total i likideve brendaqelizore normalisht është:

A) 10-15% e peshës trupore
B) 15-20% e peshës trupore
C) 30-40% e peshës trupore
D) 50-60% e peshës trupore
E) 60-70% e peshës trupore
PS)C

Pyetja 309 V)3

Katekolaminat e eleminuara normalisht gjatë 24 orëve janë:

A) <100 mcg
B) 100-120 mcg
C) 120-130 mcg
D) 130-140 mcg
E) 140-200 mcg
PS)A

Pyetja 310 V)3

Cilat janë mjetet më të rëndësishme të fiksimit të stomakut në pozicionin e tij?

A) vazhdimësia natyrore me ezofagun dhe enët e gjakut që shkojnë drejt tij, veçanërisht arteria koronare e stomakut
B) vazhdimësia natyrore me ezofagun dhe aderenca e faqes posteriore të stomakut (në nivelin e fundusit) me diafragmën
C) vazhdimësia natyrore me ezofagun dhe junksionin pilorik
D) enët gastrike dhe palosjet peritoneale që përbëjnë respektivisht ligamentin gastrolienal dhe gastrokolik
E) C dhe D
PS)B

Pyetja 311 V)2

Gjatë hipertiroidizmit vërehet shpesh edhe:

A) katarakta
B) cirroza hepatike
C) amiloidoza hepatike
D) hepatopatia akute
E) ulçera gastro-duodenale
PS)E

Pyetja 312 V)3

Miksedema pretibiale e lokalizuar shoqërohet shpesh me:

A) reduktim të mukopolisaharideve
B) hiperparatiroidizëm
C) hipoparatiroidizëm
D) ekzoftalmi
E) mikroglosi
PS)D

Pyetja 313 V)1

Ralet janë zhurma respiratore patologjike:

A) inspiratore
B) të thata
C) të njoma
D) me flluska të vogla
E) me flluska mesatare dhe të mëdha
PS)B

Pyetja 314 V)2

Gishtat si bajonetë vërehen gjatë:

A) bronkopatisë kronike enfizematoze
B) reumatizmës artikulare akute
C) artritit rheumatoid
D) gutës
E) kardiopative cianogjene me shunt djathtas-majtas
PS)C

Pyetja 315 V)3

Cila është përqindja normale e alfa-2-globulinave në plazmë?

A) 4-6 %
B) 6-10 %
C) 8-12 %
D) 15-20 %
E) 20-30 %
PS)B

Pyetja 316 V)3

Kofaktori heparinik është:

A) alfa2-makroglobulina
B) alfa1-makroglobulina
C) antitrombina progresive
D) plazminogjeni
E) plazmina
PS)C

Pyetja 317 V)1

Si rrjedhojë e obstruksionit të rrugëve biliare në nivelin e koledokut, feçet janë:

A) të bardha në gri
B) të verdha
C) të verdha në kafe

D) ngjyrë kafe e errët
E) ngjyrë jeshile e errët
PS)A

Pyetja 318 V)2

Temperatura me natyrë joinfektive mund të vërehet gjatë:

A) mastoiditit
B) kolecistitit
C) osteomielitit
D) pankreatitit akut
E) pneumonisë atipike primare
PS)D

Pyetja 319 V)3

Cili nga këta muskuj është dilatuesi i glotissit?

A) muskuli krikoid-aritenoid posterior
B) aritenoid
C) aritenoid oblik
D) aritenoid transvers
E) të gjithë këta muskuj
PS)A

Pyetja 320 V)3

Bilirubina indirekte (e pakonjuguar) nuk është e rritur gjatë ikterit familjar:

A) Crigler-Najjar
B) Lucey-Driscoll
C) Gilbert tip I
D) Gilbert tip II
E) Dubin-Johnson
PS)E

Pyetja 321 V)3

Fenomeni Argyll-Robertson (rigiditet pupilar ndaj ekspozimit në dritë me akomodim të ruajtur) mund të vërehet në të gjitha këto sëmundje, por në njërën prej tyre është simptomë konstante. Në cilën?

A) neurosifiliz
B) sklerozë multiple
C) parkinsonizëm
D) meningizëm

E) neoplazi cerebrale
PS)A

Pyetja 322 V)2

Edema periorbitale vërehet shpesh gjatë:

A) insuficiencës kronike kongjestive
B) cirrozës hepatike
C) sindromës Meigs
D) sindromës uremike
E) uremisë kronike
PS)D

Pyetja 323 V)2

Auskultimi abdominal i ileusit mekanik nga okluzioni karakterizohet nga:

A) fërkimet peritoneale
B) mungesa e peristaltikës
C) hiperperistaltika
D) zhurma sistolike aorto-abdominale
E) asnjë nga këto të dhëna
PS)C

Pyetja 324 V)3

Zhurma telesistolike në hapësirat II-III interkostale në parasternalen e majtë që dëgjohet qartë edhe ndërmjet skapulave, në të majtë të paravertebrale, dhe që nis shumë pak kohë pas tonit të pare, dëgjohet gjatë:

A) tetradës Fallot
B) kompleksin Eisenmenger
C) stenozës së istmusit aortal
D) defektit të septumit interventrikular
E) stenozës aortale aterosklerotike
PS)C

Pyetja 325 V)3

Gjatë insuficiencës valvulare aortale nuk vërehet:

A) zbehja
B) rritja e presionit arterial diferencial
C) pulsi i vonuar
D) kërcimi i arterieve
E) zhurma e Flint-it

PS)C

Pyetja 326 V)1

Paraliza e nervit abducens shkakton:

A) strabizëm konvergjent
B) strabizëm divergjent
C) anizokori
D) ptozë palpebrale
E) midriazë
PS)A

Pyetja 327 V)1

Në cilin organ ushtron aktivitetin e saj më intens dhe më të dukshëm ergotamina?

A) kolecistë
B) uretere
C) fshikëz urinare
D) bronke
E) uterus
PS)E

Pyetja 328 V)3

Hirsutizmi me origjinë hipofizare vërehet gjatë:

A) sindromës Stein-Leventhal
B) arenoblastomës ovariene
C) morbusit Cushing
D) tumorit me qeliza Leydig
E) tumorit Krukenberg
PS)C

Pyetja 329 V)2

Simptoma më e shpeshtë e karcinomës bronkiale (e pranishme në 90% të rasteve) është:

A) espektorati hematik
B) dhembja torakale
C) kolla
D) temperatura
E) dispnea
PS)C

Pyetja 330 V)3

Testi Little-Katz (testi i stimulimit me prednizolon) kryhet për të evidentuar pielonefritin okult nëpërmjet vlerësimit të:

A) leukociturisë
B) bilirubinurisë
C) natriurisë
D) hematurisë
E) proteinurisë
PS)A

Pyetja 331 V)2

Diateza hemorragjike nga hemokoagulimi i alteruar është:

A) purpura idiopatike trombocitopenike
B) purpura Schonlein-Henoch
C) hemofilia A
D) tromboastenia Glanzmann
E) trombocitopenia nga hipersplenizmi
PS)C

Pyetja 332 V)2

Shenja e ballonimit vërehet gjatë:

A) megakolonit
B) veshkës së lëvizsshme dhe të palpueshme
C) ansës së dilatuar suprastenozë
D) versamentit ascitik
E) splenomegalisë
PS)B

Pyetja 333 V)3

Komplementemia e karakterizuar nga C3 normal dhe C4 e reduktuar vërehet përgjithësisht gjatë:

A) angioedemës hereditare
B) lupusit eritematoz në fazë aktive
C) hepatitit kronik aktiv
D) endokarditit bakterial subakut
E) sëmundjes së serumit
PS)A

Pyetja 334 V)2

Gjatë perikarditit konstriktiv vërehet:

A) presioni atrial i djathtë < 10 mmHg
B) rritja e diferencës ndërmjet presionit në atriumin e djathtë dhe presionit në atriumin e majtë
C) presioni sistolik pulmonar 60-80 mmHg
D) të gjitha këto simptoma
E) asnjë nga këto simptoma
PS)E

Pyetja 335 V)2

Cili nga këta mekanizma bën të mundur emisionin e ajrit gjatë fazës ekspiratore?

A) kontraksioni i muskujve ekspiratorë
B) elasticiteti i parenkimës pulmonare
C) ngritja e diafragmës
D) kontraksioni i muskujve inspiratorë
E) A dhe B
PS)B

Pyetja 336 V)1

Dhembja torakale viscerale karakterizohet nga një nga këto fakte. Ajo është:

A) e lokalizueshme mirë
B) evokohet nga shtypja në pika të caktuara
C) difuze dhe pak e lokalizueshme
D) e ndikuar nga lëvizjet respiratore
E) e ndikuar nga lëvizjet e zinxhirit skapular
PS)C

Pyetja 337 V)3

Bradilalia vërehet gjatë:

A) morbusit Parkinson
B) miksedemës
C) laringitit kronik
D) miastenisë gravis
E) paralizës unilaterale të nervit rekurent
PS)B

Pyetja 338 V)2

Në cilën sëmundje vazhdon të jetë e dobishme terapia me kripëra të arit?

A) sindromë nefrozike
B) hernie diskale
C) artrozë
D) reumatizëm artikular akut
E) artrit reumatoid në fazë aktive
PS)E

Pyetja 339 V)1

Frymëmarrja Cheyne-Stokes karakterizohet nga:

A) alternimi i apnesë dhe hiperpnesë në formë krescente-dekrescente
B) rritja e vëllimit respirator/minutë
C) reduktimi i frekuencës së akteve respiratore
D) rritja e frekuencës së akteve respiratore
E) ekspirimi i sforcuar me glottis të mbyllur
PS)A

Pyetja 340 V)1

Kalkuloza e kolecistës është kryesisht:

A) kolesterinike
B) pigmentare
C) kalcike
D) fosfatike
E) uretike
PS)A

Pyetja 341 V)2

Insuficienca kortikosurenaliene kronike primare karakterizohet nga:

A) hipertensioni arterial
B) rritja e panikulit adipoz
C) eritrodermia
D) melanodermia
E) hipertrikoza
PS)D

Pyetja 342 V)2

Fibroza pulmonare nuk mund të vërehet gjatë:

A) karcinomës bronkiale
B) pneumokoniozës
C) sarkoidozës

D) tuberkulozit
E) sklerodermisë
PS)A

Pyetja 343 V)2

Cili nga këto ushqime është veçanërisht i pasur me kalcium?

A) mishi i deles
B) djathi
C) spinaqi
D) frutat e detit
E) karrotat
PS)B

Pyetja 344 V)3

Salicilatet në doza të larta mund të shkaktojnë:

A) inhibim direkt të qendrave medulare që rregullojnë frekuencën respiratore
B) inhibim të qendrave pontine që përcaktojnë thellësinë respiratore
C) reduktim të prodhimit të CO_2 nga muskuli skeletik
D) depresion respirator të rëndë
E) alkalozë respiratore
PS)E

Pyetja 345 V)2

Gjatë ikterit hemolitik nuk vërehet:

A) urobilinuria shpeshherë e rritur
B) bilirubinuria e theksuar
C) përqendrimi i hemoglobinës shpeshherë i reduktuar
D) shtimi i retikulociteve
E) mbijetesa eritrocitare e reduktuar
PS)B

Pyetja 346 V)1

Sa janë kuadrantët e abdomenit?

A) 3
B) 6
C) 9
D) 12
E) 4
PS)E

Pyetja 347 V)1

Gjatë maturimit medular, mieloblasti paraprihet nga:

A) promielociti
B) megakariociti
C) metamielociti
D) plazmaciti
E) hemocitoblasti
PS)E

Pyetja 348 V)1

Talasemitë klasifikohen si anemi:

A) normocitare
B) megaloblastike
C) post-hemorragjike
D) hemolitike kongjenitale
E) hemolitike të fituara
PS)D

Pyetja 349 V)3

Cili nga këta produkte është elementi i ndërmjetëm në sintezën e kolesterolit nga acetati?

A) acidi urik
B) skualeni
C) triptofani
D) fruktoza
E) lecitina
PS)B

Pyetja 350 V)1

Gjatë gastropative proteino-disperdente vërehet:

A) hiperprotidemi
B) hiperalbuminemi
C) albuminuri
D) edema
E) hiperglobuli
PS)D

Pyetja 351 V)1

Shenja Courvoisier dhe Terrier (zmadhimi i palpueshëm i kolecistës në prani të ikterit obstruktiv) vërehet gjatë:

A) kolecistitit kronik alitiazik
B) kolecistitit kronik litiazik
C) kolelitiazës
D) neoplazisë gastrike
E) neoplazisë së kokës së pankreasit
PS)E

Pyetja 352 V)2

Trupat Hassall janë:

A) trupëza timike
B) formacione mesangiale të glomerulit renal
C) elemente të sinapsit neuro-muskulor
D) qeliza satelit të vendosura ndërmjet plazmalemës dhe laminës bazale
E) miofilamente
PS)A

Pyetja 353 V)3

Reduktimi i aktivitetit hemolitike komplementar total (hipokomplementemia), që vërehet gjatë hepatitit aktiv, karakterizohet nga:

A) C3 e rritur dhe C4 normale
B) C3 e rritur dhe C4 e reduktuar
C) C3 e reduktuar dhe C4 e reduktuar
D) C3 normale dhe C4 normale
E) C3 e reduktuar dhe C4 e rritur
PS)C

Pyetja 354 V)2

Mungesa e vitaminës K nuk vërehet gjatë:

A) hepatokolangitit
B) fistulave biliare
C) sindromës së malabsorbimit
D) hipertensionit arterial
E) ikterit okluziv
PS)D

Pyetja 355 V)3

Sekuestrimi i arteries suklavia është në përpjesëtim të drejtë me:

A) obstruksionin e arterieve karotide
B) stenozën e traktit proksimal të arteries suklavia
C) stenozën e traktit distal të arteries suklavia
D) implanti anormal i trungut anonim
E) stenoza e trungut bazilar
PS)B

Pyetja 356 V)2

Gjatë ksantelazmës vërehet:

A) hiperkolesterolemi konstante
B) hiperlipidemi konstante
C) hipertrigliceridemi konstante
D) hiperdislipidemi jokonstante
E) hiperdisprotidemi
PS)D

Pyetja 357 V)1

Hemotoraksi është:

A) grumbullim qelbi dhe gjaku në kavitetin pleural
B) grumbullim gjaku në kavitetin pleural
C) grumbullim gjaku dhe ajri në kavitetin pleural
D) grumbullim ajri në kavitetin pleural
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)B

Pyetja 358 V)1

Hiperpnea është:

A) rritja e ndjesisë vetiake për frymëmarrjen
B) reduktimi i frekuencës respiratore
C) rritja e numrit të frymëmarrjeve në minutë
D) rritja e ventilimit nëpërmjet rritjes së thellësisë së frymëmarrjes
E) asnjëra nga të mësipërmet
PS)D

Pyetja 359 V)2

Reaksioni imunitar i tipit hemolitik, që shkaktohet nga incidentet e transfuzionit, është:

A) tip I: reaginik
B) tip II: citotoksik

C) tip III: nga komplekset imune
D) tip IV: qelizor
E) tjetër tip
PS)B

Pyetja 360 V)1

Qelizat Reed-Stenberg janë karakteristike për:

A) limfoadenitin tuberkular
B) sarkoidozë
C) sëmundjen e gërvishtjes së maces
D) limfosarkomë
E) limfogranulomë Hodgkin
PS)E

Pyetja 361 V)1

Retikuli Mya në likuor vërehet gjatë:

A) gjendjes normale
B) tabes dorsalis
C) meningitit tuberkular
D) meningitit gjatë eritematozës
E) parkinsonizmit
PS)D

Pyetja 362 V)2

Accretio cordis (perikarditi kronik adeziv) karakterizohet nga:

A) postura genu-pektorale
B) rrahja e apeksit e padukshme
C) tonet kardiake të largëta dhe të zbehura
D) respiracioni Wenckebach
E) këndi hepatokardiak i topitur
PS)D

Pyetja 363 V)3

Gjatë cirrozës hepatike janë shumë të reduktuar:

A) pseudokolinesteraza
B) urobilinuria
C) fosfatemia alkaline
D) transaminazemia
E) retensioni nga galaktozi

PS)A

Pyetja 364 V)1

Eleminimi i një bakteri ndërmjetësohet kryesisht nga:

A) antitrupat dhe komplementi
B) eozinofilet
C) qelizat natural killer
D) limfocitet T citotoksike
E) trombocitet
PS)A

Pyetja 365 V)1

Hiperplazia eritroide megaloblastike vërehet në palcën kockore si rrjedhojë e:

A) lezioneve medulare nga aminopirina
B) mungesa e vitaminës B12
C) insuficienca renale kronike
D) inhibimi metabolik i palcës së kockave
E) të gjitha këto shkaqe të mundshme
PS)B

Pyetja 366 V)2

Nuk është sëmundje e kolagjenit:

A) sklerodermia
B) periartriti nodoz
C) neurofibromatoza Recklinghausen
D) poliartriti reumatik
E) eritematoza
PS)C

Pyetja 367 V)1

Gjatë dehidratimit izotonik, natremia është:

A) e reduktuar
B) normale
C) e rritur në mënyrë të moderuar
D) shumë e rritur
E) ndonjëherë normale, ndonjëherë e rritur
PS)B

Pyetja 368 V)2

Histamina favorizon:

A) proliferimin e mastociteve
B) fagocitozën
C) vazodilatacionin
D) temperaturën
E) rritjen e proteinave të fazës akute
PS)C

Pyetja 369 V)2

Amilazemia është e rritur gjatë:

A) mononukleozës infektive
B) cirrozës hepatike
C) ikterin obstruktiv
D) pankreopative
E) infarktit të miokardit
PS)D

Pyetja 370 V)3

Dizuria dhe poliakiuria vërehen më shpesh gjatë:

A) nefritit intersticial
B) pielonefritit
C) glomerulonefritit kronik
D) nefrosklerozës malinje
E) tubulonefrozës akute
PS)B

Pyetja 371 V)2

Prania e limfonodujve laterocervikalë me konsistencë të fortë parenkimatoze jokonfluente, e shoqëruar me temperaturë shpeshherë ondulante, flet për praninë e:

A) adenitit tuberkular
B) metastazave të tumoreve gastrike
C) limfosarkomës
D) limfoadenitit jospecifik
E) morbus Hodgkin
PS)E

Pyetja 372 V)2

Të ashtuquajturit faktorë vitaminë K-dependentë janë faktorët:

A) I - VII - IX - X
B) II - V - VII - X
C) II - VII - IX - X
D) I - II - IX - X
E) I - II - VII - X
PS)C

Pyetja 373 V)3

Sindroma Sheehan shkaktohet nga:

A) kontuzioni kranial
B) meningiti meningokoksik
C) shoku post-partum
D) kraniostenoza
E) neurinoma e këndit ponto-cerebelar
PS)C

Pyetja 374 V)2

Ketonuria përgjithësisht shfaqet kur ketonemia është:

A) > 15 mg%
B) > 20 mg%
C) > 25 mg%
D) > 30 mg%
E) > 50 mg%
PS)A

Pyetja 375 V)3

Cili nga këto acide yndyrore ka numrin më të lartë të lidhje të dyfishta (4 lidhje të dyfishta)?

A) acidi oleik
B) acidi erucik
C) acidi linoleik
D) acidi linolevik
E) acidi arakidonik
PS)E

Pyetja 376 V)3

Tumori i tiroides që nuk kap jodinështë:

A) papiloma malinje
B) stuma malinje Langhans

C) adenoma me qeliza të mëdha
D) karcinoma solide anaplazike
E) adenoma toksike
PS)D

Pyetja 377 V)2

Shoku me rritje të presionit venoz qendror ndodh gjatë:

A) kolapsit nga debiti insuficient nga infarkti i miokardit
B) hemorragjive profuze
C) ustioneve të gjera
D) hemoperitoneumit
E) formimit të shpejtë të versamentit peritoneal të madh
PS)A

Pyetja 378 V)2

Retikulocitet janë shpeshherë në numër mbi dyfish gjatë të gjitha këtyre sëmundjeve me përjashtim të:

A) deficiencës së glukozë-6-fosfat dehidrogjenazës
B) anemisë nga hemorragjia akute
C) anemisë hemolitike autoimune
D) anemisë hemolitike farmakologjike
E) anemisë nga nefropatia kronike
PS)E

Pyetja 379 V)2

Encefalopatia porto-sistemike shkaktohet nga:

A) hiperbilirubinemia
B) çrregullimet e ekuilibrit acido-bazik
C) çlirimi i substancave neurotoksike nga liza hepatocitare
D) hiperhidratimi
E) hiperamonemia
PS)E

Pyetja 380 V)1

Në kushte normale, uji përbën rreth:

A) 40% të feçeve
B) 55% të feçeve
C) 65% të feçeve
D) 70% të feçeve

E) 80% të feçeve
PS)C

Pyetja 381 V)3

Gjatë sindromës Sjogren, ndërlikimi visceral më i mundshëm është:

A) splenomegalia kongjenitale
B) fibroza pulmonare
C) cirroza biliare
D) miokarditi
E) gastriti atrofik
PS)E

Pyetja 382 V)3

LATS (long acting thyroid stimulator) është një imunoglobulinë e tipit:

A) Ig G
B) Ig M
C) Ig A
D) Ig E
E) Ig D
PS)A

Pyetja 383 V)2

Pulsimi në nivelin e hapësirës II interkostale të djathtë mund të vërehet gjatë:

A) hipertrofisë ventrikulare të djathtë
B) perikarditit eksudativ
C) dilatimit të aortës ascendente
D) dilatimit të aortës pulmonare
E) stenozës mitrale
PS)C

Pyetja 384 V)2

Të vjellat janë jashtëzakonisht të rralla gjatë:

A) stenozës pilorike
B) gastritit akut
C) ulçerës duodenale
D) pankreatitit kronik
E) intoksikimit nga digitali
PS)C

Pyetja 385 V)3

Purpura trombotike trombocitopenike (sindroma Moschcowitz) shkakton shfaqjen e:

A) insuficiencës renale
B) sindromës nefrozike
C) tubulonefrozës
D) glomerulosklerozës
E) infarktit renal të gjerë
PS)A

Pyetja 386 V)2

Tuberkuloma nuk karakterizohet nga:

A) prirja e paktë për t'u rritur
B) lokalizimi preferencial në lobin superior
C) prania e alterimeve satelitare
D) fenomenet e mundshme kolikuative që mund të demonstrohen gjatë stratigrafisë
E) mungesa e shenjave radiologjke të kalcifikimit
PS)E

Pyetja 387 V)1

Luksacioni është:

A) lezion i kartilagos artikulare
B) lezion kockor
C) humbja e plotë e raporteve normale ndërmjet dy sipërfaqeve artikulare
D) shkëputja e një epifize
E) keqformim kockor
PS)C

Pyetja 388 V)1

Hematoma është:

A) tumor i gjakut
B) grumbullim seroz
C) grumbullim limfe
D) grumbullim gjaku
E) grumbullim i bilës
PS)E

Pyetja 389 V)1

Anemia pernicioze shkaktohet nga:

A) insuficienca alimentare me vitaminë B12
B) mungesa e absorbimit të acidit folik
C) mungesa e hekurit
D) rritja e ekskretimit të vitaminës B12
E) mungesës së absorbimit të vitaminës B12
PS)E

Pyetja 390 V)3

Në rastet me karcinomë medulare të tiroides shumë shpesh vërehet:

A) reduktim i aktivitetit histaminik të serumit
B) konstipacioni serioz
C) mungesa e metastazave në limfonodujt regjionalë
D) kalcitonina e rritur
E) mungesa e prostaglandinave E2 dhe F2 në indin neoplazik
PS)D

Pyetja 391 V)2

Clostridium tetani është i ndjeshëm ndaj:

A) penicilinës
B) streptomicinës
C) tetraciklinës
D) kloramfenikolit
E) të gjithëve këtyre antibiotikëve
PS)A

Pyetja 392 V)1

Cilët nga këta mediatorë janë përgjegjës për dhimbjen gjatë inflamacionit?

A) prostaglandinat
B) leukotrienet
C) histamina dhe serotonina
D) lipoksinat
E) citokinat
PS)A

Pyetja 393 V)1

Metaplazia është:

A) një modifikim në të cilin nuk është e mundur njohja e një tipi qelizor të diferencuar

B) një modifikim në të cilin një lloj qelizor i diferencuar zëvendësohet nga një tjetër lloj qelizor i diferencuar
C) një reduktim i numrit të qelizave, që shkaktohet nga humbja e përbërësve qelizorë
D) një tumor me origjinë mezenkimale
E) një lloj përgjigje inflamatore
PS)B

Pyetja 394 V)2

ADN formohet nga një zinxhir polinukleotidik i dyfishtë (spirale e dyfishtë), dhe dy zinxhirët mbahen të bashkuar falë bazat e azotuara brenda zinxhirëve që janë të lidhura me lidhje hidrogjen që formohen ndërmjet:

A) adeninës nga një krah dhe acidit fosforik nga krahu tjetër
B) adeninës nga një krah dhe glukozës nga krahu tjetër
C) adeninës nga një krah dhe timinës nga krahu tjetër
D) citozinës nga një krah dhe uracilit nga krahu tjetër
E) citozinës nga një krah dhe acidit urik nga krahu tjetër
PS)C

Pyetja 395 V)3

Gjatë shokut nga reduktimi absolut i vëllimit qarkullues vërehet:

A) pO2 i rritur
B) pCO2 i rritur
C) bikarbonatemi i rritur
D) hiperkalemi
E) pH plazmatik i rritur
PS)D

Pyetja 396 V)2

Cili nga këto acide yndyrore ka strukturë ciklike?

A) acidi prostanoik
B) acidi oleik
C) acidi erucik
D) acidi arakidik
E) acidi palmitik
PS)A

Pyetja 397 V)2

Gjatë hipernefromës vërehet shpesh:

A) anemi sideropenike

B) anemi hemolitike
C) anemi nga eritropoieza e reduktuar
D) eozinofilia
E) poliglobulia
PS)E

Pyetja 398 V)3

Simptomatologjia e karakterizuar nga pareza distale tardive, dhimbja intense, të vjella dhe diarre fillestare dhe shfaqja e strieve ungueale Mees, flet për polineuropati:

A) nga arseniku
B) nga alkooli
C) nga plumbi
D) nga taliumi
E) nga diabeti mellitus
PS)A

Pyetja 399 V)3

Cianoza hemoglobinike qendrore (nga sëmundjet pulmonare ose kardiake) diferencohet nga ajo periferike nga prania e cianozës edhe në:

A) lobet e veshëve
B) buzë
C) gjuhë
D) mollëza
E) gjymtyrë
PS)C

Pyetja 400 V)2

Sindroma Waterhouse-Friederichsen mund të shfaqet gjatë:

A) cirrozës hepatike
B) infeksionit meningokoksik
C) uremisë kronike
D) glomerulonefritit akut difuz
E) artritit reumatoid
PS)B

Pyetja 401 V)2

Glomerulonefriti akut mund të shfaqet me të gjitha simptomat e mëposhtme me përjashtim të:

A) hematurisë makroskopike

B) hipertensioni arterial
C) edemës pulmonare akute
D) dizurisë
E) urinave me peshë specifike të lartë
PS)D

Pyetja 402 V)3

Gjatë insuficiencës ventilator obstruktive:

A) kapaciteti vital është i rritur
B) vëllimi rezidual është i reduktuar
C) kapaciteti pulmonar total është i reduktuar
D) ventilimi maksimal është i reduktuar
E) raporti VEMS/CV (indeksi Tiffeneau) është i rritur
PS)E

Pyetja 403 V)2

Natremia është shpeshherë e rritur gjatë:

A) diarresë së rëndë
B) të vjellave persistente
C) insuficienca surenaliene
D) sekretimi i papërshtatshëm i HAD
E) sindroma Cushing
PS)E

Pyetja 404 V)3

Respiracioni fillestar i thellë i ndjekur nga frymëmarrja sipërfaqësore dhe nga pauza apneike të gjata 10 ose më shumë sekonda karakterizon respiracionin:

A) e sindromës Pickwick
B) Kussmaul
C) Biot
D) Cheyne-Stokes
E) e komës diabetike
PS)A

Pyetja 405 V)2

Cili nga këto viruse nuk ka mbështjellje perikapsidike?

A) arenavirusi
B) pikornavirusi
C) ortomiksovirusi

D) herpesvirusi
E) koronavirusi
PS)B

Pyetja 406 V)2

Staza papilare vërehet gjatë:

A) cefalesë nga neuralgjia e nervave kranialë
B) cefalesë nga hipertensioni endokranial
C) cefalesë nga intoksikimi alkoolik
D) cefalesë nga arteriti temporal
E) hemikrania oftalmoplegjike
PS)B

Pyetja 407 V)3

Gjatë infeksionit të rrugëve urinare te një pacient i moshuar, prognoza është më pak e favorshme nëse:

A) infeksioni është i pranishëm prej 7-8 muajve
B) infeksioni shkaktohet nga enterokokët
C) nuk është dhënë asnjë terapi më parë
D) infeksioni shkaktohet nga E. coli
E) kreatinina serike është 1,5-2 mg%
PS)B

Pyetja 408 V)1

Refleksi spinal rezulton qartësisht më i theksuar në rast:

A) lezioni mbi metamerin e traktit piramidal
B) lezioni të neuronit motor periferik
C) lezioni të neuronit sensor periferik
D) lezioni të efektorit
E) në asnjë nga situatat e mësipërme
PS)A

Pyetja 409 V)2

Normalisht, pH i lëngut gastrik është:

A) 0,5 - 0,8
B) 1,0 - 1,8
C) 2,5 - 2,8
D) 3,5 - 3,8
E) 4,5 - 4,8

PS)B

Pyetja 410 V)2

Hiperprolaktinemia nuk vërehet gjatë:

A) adenomës kromofobe të hipofizës
B) sindromës Chiari-Frommel
C) sindromës Argonz-Del Castillo
D) akromegalisë
E) feokromocitomës
PS)E

Pyetja 411 V)1

Presioni venoz qendror gjatë shokut hemorragjik është:

A) normal
B) fillimisht i rritur
C) i rritur në mënyrë konstante
D) fillimisht i reduktuar
E) i reduktuar në mënyrë konstante
PS)E

Pyetja 412 V)1

Prania e gjakut në sipërfaqe të feçeve vërehet gjatë:

A) ulçerës duodenale
B) divertikulit duodenal
C) hemorroideve
D) kolitit ulçeroz
E) ileitit terminal
PS)C

Pyetja 413 V)3

Aorta me lumen të dyfishtë si pasojë e aneurizmës disekante të tunikës media shkaktohet nga:

A) hipokortikosurenalizmi
B) valvuliti aortal reumatik
C) infeksioni nga rabiesi
D) panarteriti nodoz
E) nekroza kistike e medias
PS)E

Pyetja 414 V)1

CO_2 gjendet në gjak në formën e gazit të tretur në përqindje:

A) 1,2%
B) 2,3%
C) 4,6%
D) 8,3%
E) 9,5%
PS)D

Pyetja 415 V)1

Dhembja kardiake e projektuar mund të manifestohet në dermatomerë të ndryshëm. Seria e dermatomerëve në të cilat ajo projektohet më shpesh është:

A) T1 T2 T3 T4 C8
B) C1 C2
C) pjesa posteriore e T3
D) C3
E) T7 T8
PS)A

Pyetja 416 V)2

Hemorragjitë që mungojnë gjatë hemofilisë janë:

A) petekiet
B) hematomat
C) hemartritë
D) epistaksis
E) hematuritë
PS)A

Pyetja 417 V)3

Gjatë cilës sëmundje vërehen aq shpesh cilindrat granulozë sa që e bëjnë karakteristik analizën mikroskopike të urinës?

A) uretriti akut
B) litiaza e fshikëzës së urinës
C) glomerulonefriti akut
D) sindroma nefrozike
E) glomerulonefriti kronik
PS)D

Pyetja 418 V)2

Simptomatologjia e papritur me dhembje shumë akute, dispne, emfizemë cervikale, dhe shok te një portator ulçere peptike të ezofagut, bën të mendosh se ulçera ka shkaktuar:

A) perforacion në aortë
B) perforacion në kavitetit pleural
C) perforacion në mediastinum
D) perforacion subdiafragmatik
E) hemorragji akute
PS)C

Pyetja 419 V)3

Sindroma me nanizëm disharmonik, gjymtyrë të shkurtëra, kifozë, cefalomegali, inteligjencë normale, opacitet korneal karakterizon:

A) sëmundjen Morquio
B) gargoilizmin
C) osteitin Paget
D) osteopsatirozën Lobstein
E) displazinë fibroze polikistike Jaffe'-Lichtenstein
PS)A

Pyetja 420 V)1

Cili element ka masë atomike 1,00797?

A) heliumi
B) oksigjeni
C) azoti
D) hidrogjeni
E) karboni
PS)D

Pyetja 421 V)1

Levodopa është medikamenti i zgjedhur për trajtimin e:

A) anginës pektoris
B) hipertensionit arterial
C) ethes nga kashta
D) morbusit Parkinson
E) astmës bronkiale
PS)D

Pyetja 422 V)1

Ndër kolagjenopatitë e mëposhtme, vetëm një ka si shkak etiopatogjenik të sigurt reaksionin e organizmit ndaj infeksionit nga streptokoku hemolitik i grupit A:

A) periartriti nodoz
B) arteriti me qeliza gjigande
C) dermatomioziti
D) ethja reumatike
E) sklerodermia
PS)D

Pyetja 423 V)1

Faqja diafragmatike e zemrës është:

A) faqja superiore
B) faqja inferiore
C) faqja anteriore
D) faqja supero-laterale
E) faqja e majtë
PS)B

Pyetja 424 V)1

Kërcitja e hapjes së valvulës mitrale shkaktohet nga:

A) fluksi i gjakut në aortë me vorbulla
B) refluksi i gjakut nga aorta në ventrikul
C) diastola atriale
D) kordat tendinoze miokardiake të laceruara që fshikullojnë gjakun afluent në ventrikul
E) hapja e fletëve valvulare të mitrales nën tension
PS)E

Pyetja 425 V)3

Cerebelumi është i lidhur me sistemin nervor nëpërmjet:

A) një pedunkuli
B) dy pedunkujve
C) tre pedunkujve
D) katër pedunkujve
E) korpusit kalloz
PS)C

Pyetja 426 V)2

Fenomeni Chvostek vërehet gjatë:

A) hiperkalcemisë
B) hipokalcemisë
C) sindromës nga alkalet
D) hiperparatiroidizmit primar
E) morbusit Paget
PS)B

Pyetja 427 V)1

Cila simptomë nuk vërehet gjatë furnizimit insuficient me gjak në një regjion vaskular periferik?

A) rezultati oscilografik normal
B) oscilometria e reduktuar e pulsimeve
C) zbehja kutane
D) lëkura e hollë, e lëmuar dhe e shkëlqyeshme
E) lëkura e ftohtë
PS)A

Pyetja 428 V)1

Nga ku e merr origjinën arteria koronare e majtë?

A) nga sinusi aortal anterior i djathtë
B) nga sinusi aortal anterior i majtë
C) nga sinusi aortal posterior i majtë
D) nga arteria pulmonare
E) asnjë nga të mësipërmet
PS)B

Pyetja 429 V)2

Cila nga këto substanca është polisaharid?

A) galaktozi
B) glicina
C) mioglobina
D) heparina
E) glukopiranozi
PS)D

Pyetja 430 V)2

Amenorrea është primare në rastet kur menarka nuk është shfaqur ende në moshën:

A) 12 vjeç
B) 13 vjeç

C) 15 vjeç
D) 17 vjeç
E) 19 vjeç
PS)E

Pyetja 431 V)3

Tifo dermatike shkaktohet nga:

A) salmonella typhosa
B) rickettsia prowazeki
C) salmonella typhi murium
D) clostridium perfrigens
E) shigella flexneri
PS)B

Pyetja 432 V)3

Dispnea gjatë acidozës metabolike është:

A) psikogjene
B) pulmonare
C) kardiake
D) dismetabolike
E) mikse
PS)D

Pyetja 433 V)1

Gjatë anemisë pernicioze vërehet:

A) vlera globulare e rritur
B) mikrocitoza
C) retikulocitemia e rritur
D) leukocitoza
E) hiperklorhidria
PS)A

Pyetja 434 V)3

Cila brucelë është e ndjeshme ndaj tioninës?

A) brucella abortus
B) brucella melitensis
C) brucella suis
D) asnjë nga këto brucela
E) të gjitha këto brucela

PS)A

Pyetja 435 V)1

Të gjitha kromozomet që nuk janë kromozome seksuale quhen:

A) autozomike
B) alele
C) dizigotike
D) kromatide
E) kodone

PS)A